REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA E POSAÇME E SHKALLËS SË PARË PËR KORRUPSIONIN DHE KRIMIN E ORGANIZUAR

**NR. 7 AKTI**

**Datë 09.02.2025**

**VENDIM**

**"NË EMËR TË REPUBLIKËS"**

**Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar me trup gjykues të përbërë prej:**

**GJYQTAR: ERJON BANI**

Pasi mori në shqyrtim, në Dhomë Këshillimi pa praninë e palëve dhe të sekretares gjyqësore kërkesën penale me Nr. 7 Akti, me:

**KËRKUESE:** Prokuroria e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, përfaqësuar nga prokurorët **Altin Dumani dhe Ols Dado.**

**Person nën hetim:** **1. Erion Veliaj**, i biri i Luan dhe i Shqiponjë, i datëlindjes 17.12.1979, lindur dhe banues në Tiranë, me adresë: Kodra e Diellit, Nd. 22, H.1, Farkë, Selitë, me shtetësi shqiptare, gjendja gjyqësore *"I dënuar"*,[1] gjendja civile *"I martuar"* dhe mbajtës i dokumentit identifikues kartë identiteti me numër personal (ID) H91217035J.

**DYSHUAR:** Për veprat penale *"Korrupsioni pasiv i funksionarëve të lartë shtetërorë ose i të zgjedhurve vendorë"*, kryer në bashkëpunim (9 herë), parashikuar nga neni 260 e 25 i Kodit Penal dhe *"Pastrimi i produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale"*, kryer në bashkëpunim më shumë se një herë, parashikuar nga neni 287/2 i Kodit Penal.

**Person nën hetim:** **2. Ajola Xoxa**, e bija e Arben dhe e Valbona, e datëlindjes 16.07.1983, lindur dhe banues në Tiranë, me adresë: Kodra e Diellit, Nd. 22, H.1,

[1] Sipas Çertifikatës Elektronike të gjendjes gjyqësore me Nr. 5488 Prot., datë 23.01.2025 të gjeneruar nga hetuesi i Byros Kombëtare të Hetimeve, e cila gjendet në fashikullin 63.



SPEKTI.AL

Farkë, Selitë, me shtetësi shqiptare, gjendja civile "*E martuar*" dhe gjendja gjyqësore "*E padënuar*", mbajtëse e dokumentit identifikues kartë identiteti me numër personal (ID) I35716050T

**DYSHUAR:** Për veprat penale "*Korrupsioni pasiv i funksionarëve të lartë shtetërorë ose i të zgjedhurve vendorë*", kryer në bashkëpunim (9 herë), parashikuar nga neni 260 e 25 i Kodit Penal, "*Pastrimi i produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale*", kryer në bashkëpunim më shumë se një herë, parashikuar nga neni 287/2 i Kodit Penal, "*Refuzimi për deklarimin, mosdeklarimi, fshehja ose deklarimi i rremë i pasurive, interesave private të personave të zgjedhur dhe nëpunësve publikë ose i çdo personi tjetër që ka detyrimin ligjor për deklarim*", parashikuar nga neni 257/a/2 i Kodit Penal.

**Person nën hetim:** **3. Elman Abule,** i biri i Manush dhe i Fatmira, i datëlindjes 29.04.1981, lindur dhe banues në Tiranë, me adresë: Rruga "Zef Jubani 6/1", Ap. Nd. 021, Njësia Bashkiake nr. 5, Tiranë, me shtetësi shqiptare, gjendja civile "*I martuar*" dhe gjendja gjyqësore "*I padënuar*", mbajtës i dokumentit identifikues kartë identiteti me numër personal I10429045E.

**DYSHUAR:** Për veprën penale "*Pastrimi i produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale*", kryer në bashkëpunim dhe më shumë se një herë, parashikuar nga neni 287/2 i Kodit Penal.

**Person nën hetim:** **4. Gentjan Sula,** i biri i Astrit dhe i Myzejen, i datëlindjes 29.07.1970, lindur dhe banues në Tiranë, me adresë: Kodra e Diellit, Nd. 106, H.1, Farkë, Selitë, me shtetësi shqiptare, gjendja civile "*I martuar*" dhe gjendja gjyqësore "*I padënuar*", mbajtës i dokumentit identifikues kartë identiteti me numër personal H0072909311.

**DYSHUAR:** Për veprat penale "*Korrupsioni aktiv i funksionarëve të lartë shtetërorë ose i të zgjedhurve vendorë*", parashikuar nga neni 245 i Kodit Penal.

**Person nën hetim:** **5. Meriman Palushi,** i biri i Ahmet dhe i Xhemile, i datëlindjes 01.05.1959, lindur në Somanaj Kukës dhe banues në Tiranë, me adresë: Rruga "Xhorxh Martini", Nd. 14, H.1, Njësia Administrative nr. 2, Tiranë, me shtetësi shqiptare, gjendja civile "*I martuar*" dhe gjendja gjyqësore "*I padënuar*", mbajtës i dokumentit identifikues kartë identiteti me numër personal F90501328P.

**DYSHUAR:** Për veprat penale "*Korrupsioni aktiv i funksionarëve të lartë shtetërorë ose i të zgjedhurve vendorë*", parashikuar nga neni 245 i Kodit Penal.

5PYETJET.AL

**Person nën hetim:** **6. Fatmir Bektashi,** i biri i Petrit dhe i Fitnete, i datëlindjes 24.11.1957, lindur dhe banues në Tiranë, me adresë: Rruga "Frosina Plaku", me shtetësi gjermane, kombësi shqiptare, gjendja civile *"I martuar"*, gjendja gjyqësore *"I padënuar"*, i pajisur me numër personal F74124001N.

**DYSHUAR:** Për veprat penale *"Korrupsioni aktiv i funksionarëve të lartë shtetërorë ose i të zgjedhurve vendorë"*, parashikuar nga neni 245 i Kodit Penal.

**Person nën hetim:** **7. Sokol Kryeziu,** i biri i Feim dhe i Lefterije, i datëlindjes 06.08.1987, lindur në Verri, Librazhd dhe banues në Tiranë, me adresë: Rruga "Pjetër Budi", Nd. 10, H.1, Njësia Administrative nr. 2, Tiranë, me shtetësi shqiptare, gjendja civile *"I martuar"* dhe gjendja gjyqësore *"I padënuar"*, mbajtës i dokumentit identifikues kartë identiteti me numër personal I70806002Q.

**DYSHUAR:** Për veprat penale *"Korrupsioni aktiv i funksionarëve të lartë shtetërorë ose i të zgjedhurve vendorë"*, parashikuar nga neni 245 i Kodit Penal.

**Person nën hetim:** **8. Shkëlqim Fusha,** i biri i Demir dhe i Tije, i datëlindjes 05.12.1964, lindur dhe banues në Farkë, Tiranë, me adresë: Rruga "E Elbasanit", Nd. 182, H.2, Njësia Administrative nr. 2, Tiranë, me shtetësi shqiptare, gjendja civile *"I martuar"* dhe gjendja gjyqësore *"I padënuar"*, mbajtës i dokumentit identifikues kartë identiteti me numër personal G41205103E.

**DYSHUAR:** Për veprat penale *"Korrupsioni aktiv i funksionarëve të lartë shtetërorë ose i të zgjedhurve vendorë"*, parashikuar nga neni 245 i Kodit Penal.

**Objekti:**

1. Të caktohet ndaj personit nën hetim **Erion Veliaj,** masa e sigurimit ***"arrest në burg"*** e parashikuar nga neni 238 i K.Pr.Penale, si person i dyshuar për kryerjen e veprës penale të *"Korrupsioni pasiv i funksionarëve të lartë shtetërorë ose i të zgjedhurve vendorë"*, kryer në bashkëpunim (9 herë), parashikuar nga neni 260 e 25 i Kodit Penal dhe *"Pastrimi i produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale"*, kryer në bashkëpunim dhe më shumë se një herë, parashikuar nga neni 287/2 i Kodit Penal.

2. Të caktohet ndaj personit nën hetim **Ajola Xoxa** masa e sigurimit personal me karakter shtrëngues *"Arresti në shtëpi"*, parashikuar nga neni 237 i Kodit të Procedurës Penale, si person i dyshuar për kryerjen e veprës penale të *"Korrupsioni pasiv i funksionarëve të lartë shtetërorë ose i të zgjedhurve vendorë"*, kryer në bashkëpunim (9 herë), parashikuar nga neni 260 e 25 i Kodit Penal, *"Pastrimi i*

*produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale*", kryer në bashkëpunim më shumë se një herë, parashikuar nga neni 287/2 i Kodit Penal, "*Refuzimi për deklarimin, mosdeklarimi, fshehja ose deklarimi i rremë i pasurive, interesave private të personave të zgjedhur dhe nëpunësve publikë ose i çdo personi tjetër që ka detyrimin ligjor për deklarim*", parashikuar nga neni 257/a/2 i Kodit Penal.

**3.** Të caktohet ndaj personit nën hetim **Elman Abule** masa e sigurimit personal me karakter shtrëngues "*Arrest në burg*", parashikuar nga neni 238 i Kodit të Procedurës Penale, si person i dyshuar për kryerjen e veprës penale të "*Pastrimi i produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale*", kryer në bashkëpunim dhe më shumë se një herë, parashikuar nga neni 287/2 i Kodit Penal.

**4.** Të caktohet ndaj personit nën hetim **Gentjan Sulaj** masa e sigurimit personal me karakter shtrëngues "*Detyrimi për t'u paraqitur në policinë gjyqësore*", parashikuar nga neni 234 i Kodit të Procedurës Penale, si person i dyshuar për kryerjen e veprës penale të "*Korrupsioni aktiv i funksionarëve të lartë shtetërorë ose të zgjedhurve vendorë*", parashikuar nga neni 245 i Kodit Penal.

**5.** Të caktohet ndaj personit nën hetim **Meriman Palushi** masa e sigurimit personal me karakter shtrëngues "*Detyrimi për t'u paraqitur në policinë gjyqësore*", parashikuar nga neni 234 i Kodit të Procedurës Penale, si person i dyshuar për kryerjen e veprës penale të "*Korrupsioni aktiv i funksionarëve të lartë shtetërorë ose të zgjedhurve vendorë*", parashikuar nga neni 245 i Kodit Penal.

**6.** Të caktohet ndaj personit nën hetim **Fatmir Bektashi** masa e sigurimit personal me karakter shtrëngues "*Detyrimi për t'u paraqitur në policinë gjyqësore*", parashikuar nga neni 234 i Kodit të Procedurës Penale, si person i dyshuar për kryerjen e veprës penale të "*Korrupsioni aktiv i funksionarëve të lartë shtetërorë ose të zgjedhurve vendorë*", parashikuar nga neni 245 i Kodit Penal.

**7.** Të caktohet ndaj personit nën hetim **Sokol Kryeziu** masa e sigurimit personal me karakter shtrëngues "*Detyrimi për t'u paraqitur në policinë gjyqësore*", parashikuar nga neni 234 i Kodit të Procedurës Penale, si person i dyshuar për kryerjen e veprës penale të "*Korrupsioni aktiv i funksionarëve të lartë shtetërorë ose të zgjedhurve vendorë*", parashikuar nga neni 245 i Kodit Penal.

**8.** Të caktohet ndaj personit nën hetim **Shkëlqim Fusha** masa e sigurimit personal me karakter shtrëngues "*Detyrimi për t'u paraqitur në policinë gjyqësore*", parashikuar nga neni 234 i Kodit të Procedurës Penale, si person i dyshuar për kryerjen e veprës penale të



5 PYETJE.AL

*"Korrupsioni aktiv i funksionarëve të lartë shtetërorë ose të zgjedhurve vendorë"*, parashikuar nga neni 245 i Kodit Penal.

**<u>Baza ligjore:</u>** Nenet 228, 229, 234, 237, 238 dhe 244 i Kodit të Procedurës Penale.

## <u>VËREN:</u>

### I. Procedura.

**1.** Prokuroria e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar i është drejtuar Gjykatës me kërkesë me objekt: Caktimin e masës së sigurimit shtrënguese ndaj personave nën hetim sipas pjesën hyrëse të këtij vendimi.

**2.** Gjykata çmon se kërkesa objekt gjykimi është regjistruar pranë Gjykatës së Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar dhe i kaloi për shqyrtim gjyqtarit të hetimit paraprak,[2] të cilit iu depozituan nga sekretaria gjyqësore kërkesa dhe materialet në një zarf të mbyllur. Lidhur më shqyrtimin e kësaj kërkese, Gjykata vendosi ta shqyrtoi kërkesën në dhomë këshillimi pa praninë e palëve dhe të sekretares gjyqësore.[3] Kjo për faktin pasi me ndryshimet që iu bën K.Pr.Penale me Ligjin Nr. 35/2017, në nenin 244 të këtij Kodi nën titullin **"Kërkesa për caktimin e masave të sigurimit"** parashikohet shprehimisht se: *"1. Masat e sigurimit vendosen me kërkesën e prokurorit, i cili i paraqet gjykatës kompetente arsyet ku bazohet kërkesa.* ***Vendimi merret në dhomë këshillimi dhe jepet i arsyetuar.*** *2. Edhe kur gjykata deklaron moskompetencën e vet për çdo lloj shkaku, në qoftë se janë kushtet dhe ekziston urgjenca për marrjen e masës ajo vendos marrjen e saj dhe i dërgon aktet gjykatës kompetente. 3. Gjykata nuk mund të caktojë një masë sigurimi më të rëndë se ajo e kërkuar nga prokurori."*. Për të kuptuar qëllimin e Ligjvënësit, duhet t'i referohet relacionit dhe raportit të Komisionit për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut që shoqëroi miratimin e Ligjit Nr. 35/2017 "Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin Nr. 7905, datë 21.03.1995, "Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, në të cilët thuhet shprehimisht: *"Në paragrafin 1 të nenit 244 është shtuar parashikimi që gjykata vendos mbi kërkesën e prokurorit për caktimin e masës së* ***sigurimit në dhomë këshillimi****, duke i dhënë kështu kuptim parashikimit aktual të nenit 248 mbi marrjen në pyetje të personit të arrestuar, parashikim i cili është keqkuptuar dhe zbatuar gabim në praktikë, duke u konsideruar kjo seancë thjesht si seancë verifikimi e identitetit të personit të arrestuar. Në të kundërt nga aplikimi në praktikë, ligji ka si synim caktimin e masës së sigurimit arrest në burg në mungesë në rastet e ngutshmërisë dhe seanca e marrjes*

---

[2] Gjyqtare e hetimit paraprak për këtë procedim ka qenë gjyqtare Atalanta Zeqiraj, e cila më datë 20.01.2025 referuar dokumentit "Raport për leje barrëlindje" ka marrë paralindjen. Gjithashtu, sipas urdhërit nr. 2, datë 06.01.2025 "Për përditësimin e ndarjes së gjyqtarëve sipas gadishmërisë javore për muajin janar 2025" gjyqtar i gatshëm për periudhën 20.01.2025 – 26.01.2025 është gjyqtari Erjon Bani. Gjatë periudhës së gadishmërisë më datë 23.01.2025 ora 09:00 në kuadër të procedimit nr. 27 të vitit 2024, është paraqitur kërkesa me Nr. 81, datë 23.01.2025, me Kërkues: Altin Kumara: **Objekti:** Vleftësimin e paligjshëm të veprimit hetimor të sekuestrimit të aparatit celular që i përket shtetasit Altin Kumara, si dhe kërkohet kthimi i këtij aparati telefoni celular. Ndodhur në këto kushte, duke qenë se mungon gjyqtare Atalanta Zeqiraj për arsye të marrjes së lejes së lindjes të gjitha kërkesat penale që lidhen me procedimin penal 27 të vitit 2024 gjykohen nga gjyqtari i hetimit paraprak Erjon Bani, në respektim të nenit **278** pika 2 të K.Pr.Penale.

[3] Në nenin 112 pika 4 të K.Pr.Penale nën titullin **"Format e disponimit të gjykatës"** parashikohet shprehimisht se: *"4. Vendimi merret në dhomën e këshillimit, pa praninë e sekretarit dhe të palëve."*.

*në pyetje të të pandehurit është një seancë reale, në të cilën gjykata duhet t'i nënshtrojë debatit gjyqësor ekzistencën e kushteve dhe kritereve për caktimin e masave të sigurimit, duke marrë edhe provat eventuale të mbrojtjes:".* Pra, nga përmbajtja e kësaj dispozite rezulton se qëllimi i Ligjvënësit ka qenë shqyrtimi i shqyrtimi në dhomë këshillimi pa praninë e palëve, duke u mbështetur vetëm mbi bazën e shkaqeve të parashtruara nga prokurori në mënyrë të shkruar. Pra, procesi vijon vetëm mbi bazën e akteve të depozituara nga prokurori përpara gjykatës dhe është eleminuar seanca gjyqësore në funksion të shqyrtimit sa më shpejt të kërkesës e për të eleminuar zvarritjet e gjykimit për mungesë të palës.

**II. Rrethanat e çështjes.**

**3.** Nga aktet e prokurorisë rezulton se, Prokuroria Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar Tiranë, ka regjistruar procedimin penal Nr. 27 të vitit 2024, që bën fjalë për kryerjen e veprës penale të *"Korrupsioni pasiv i funksionarëve të lartë shtetërorë ose i të zgjedhurve vendorë"*, *"Korrupsioni aktiv i funksionarëve të lartë shtetërore ose të zgjedhurve vendorë"*, *"Pastrimi i produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale"*, *"Refuzimi për deklarimin, mosdeklarimi, fshehja ose deklarimi i rremë i pasurive, interesave privatë të personave të zgjedhur dhe nëpunësve publikë ose i çdo personi tjetër që ka detyrimin ligjor për deklarim"*, dhe *"Veprime që pengojnë zbulimin e së vërtetës"*, parashikuar nga neni 260, 245, 287/2, 257/a/2, 305/b e 301 i Kodit Penal, në ngarkim të shtetasve:

**3.1. Erion Veliaj**, i biri i Luan, lindur më 17.12.1979, i dyshuar për kryerjen e veprës penale të *"Korrupsioni pasiv i funksionarëve të lartë shtetërorë ose i të zgjedhurve vendorë"* dhe *"Pastrimi i produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale"*, parashikuar nga neni 260 e 59 dhe 287/2 i Kodit Penal;

**3.2. Ajola Xoxa**, e bija e Arben, lindur më 16.07.1983, e dyshuar për kryerjen e veprës penale të *"Korrupsioni pasiv i funksionarëve të lartë shtetërorë ose i të zgjedhurve vendorë"*, *"Pastrimi i produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale"*, *"Refuzimi për deklarimin, mosdeklarimi, fshehja ose deklarimi i rremë i pasurive, interesave privatë të personave të zgjedhur dhe nëpunësve publikë ose i çdo personi tjetër që ka detyrimin ligjor për deklarim"*, parashikuar nga neni 260 e 59, 287/2 dhe 257/a/2 i Kodit Penal;

**3.3. Elman Abule**, i datëlindjes 29.04.1981, me numër personal I10429045E, i dyshuar për kryerjen e veprës penale të *"Pastrimi i produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale"*, kryer në bashkëpunim, parashikuar nga neni 287/2 i Kodit Penal. Në kushtet kur ky shtetas është përfaqësues ligjor i subjektit tregtar **"Rametal"** shpk, me NIPT L41517502C, atëherë në bazë të nenit 45 të Kodit Penal dhe ligjit nr. 9754 datë 14.06.2007 *"Për përgjegjësinë penale të personave juridikë"*, për veprimet e tij mban përgjegjësi penale edhe personi juridik i treguar më lart;

**3.4. Gentjan Sula**, i datëlindjes 29.07.1970, me numër personal H00729093H, i dyshuar për kryerjen e veprës penale të *"Korrupsioni aktiv i funksionarëve të lartë shtetërorë ose të zgjedhurve vendorë"*, parashikuar nga neni 245 i Kodit Penal. Në kushtet kur ky shtetas është përfaqësues ligjor i subjektit tregtar **"Agi Kons"** shpk, me NIPT K21622001M, atëherë në bazë të nenit 45 të Kodit Penal dhe ligjit nr. 9754 datë 14.06.2007 *"Për përgjegjësinë penale të personave juridikë"*, për veprimet e tij mban përgjegjësi penale edhe personi juridik i treguar më lart;

**3.5. Meriman Palushi,** i datëlindjes 01.05.1959, me numër personal F90501328P, i dyshuar për kryerjen e veprës penale të "*Korrupsioni aktiv i funksionarëve të lartë shtetërore ose të zgjedhurve vendorë*", parashikuar nga neni 245 i Kodit Penal. Në kushtet kur ky shtetas është përfaqësues ligjor i subjektit tregtar **"Palushi"** shpk, me NIPT K12202004R, atëherë në bazë të nenit 45 të Kodit Penal dhe ligjit nr. 9754 datë 14.06.2007 "*Për përgjegjësinë penale të personave juridikë*", për veprimet e tij mban përgjegjësi penale edhe personi juridik i treguar më lart;

**3.6. Fatmir Bektashi,** I datëlindjes 24.11.1957, me nr. personal F74124001N, i dyshuar për kryerjen e veprës penale të "*Korrupsioni aktiv i funksionarëve të lartë shtetërore ose të zgjedhurve vendorë*", parashikuar nga neni 245 i Kodit Penal. Në kushtet kur ky shtetas është përfaqësues ligjor i subjektit tregtar **"Kontakt"** shpk, me NIPT J92108006V, atëherë në bazë të nenit 45 të Kodit Penal dhe ligjit nr. 9754 datë 14.06.2007 "*Për përgjegjësinë penale të personave juridikë*", për veprimet e tij mban përgjegjësi penale edhe personi juridik i treguar më lart;

**3.7. Sokol Kryeziu,** i datëlindjes 06.08.1987, me numër personal I70806002Q, i dyshuar për kryerjen e veprës penale të "*Korrupsioni aktiv i funksionarëve të lartë shtetërore ose të zgjedhurve vendorë*", parashikuar nga neni 245 i Kodit Penal. Në kushtet kur ky shtetas është përfaqësues ligjor i subjektit tregtar **"Gerard-A"** shpk, me NIPT L12407005L, atëherë në bazë të nenit 45 të Kodit Penal dhe ligjit nr. 9754 datë 14.06.2007 "*Për përgjegjësinë penale të personave juridikë*", për veprimet e tij mban përgjegjësi penale edhe personi juridik i treguar më lart;

**3.8. Shkëlqim Fusha**, i datëlindjes 05.12.1964, me numër personal G41205103E, i dyshuar për kryerjen e veprës penale të "*Korrupsioni aktiv i funksionarëve të lartë shtetërore ose të zgjedhurve vendorë*", parashikuar nga neni 245 i Kodit Penal. Në kushtet kur ky shtetas është përfaqësues ligjor i subjektit tregtar **"Fusha"** shpk, me NIPT J61922018S, atëherë në bazë të nenit 45 të Kodit Penal dhe ligjit nr. 9754 datë 14.06.2007 "*Për përgjegjësinë penale të personave juridikë*", për veprimet e tij mban përgjegjësi penale edhe personi juridik i treguar më lart.

**4.** Në kërkesën e Prokurorisë së Posaçme theksohet se procedimi i mësipërm në ngarkim të personave që i është regjistruar emri në regjistrin e njoftimit të veprave penale është bërë pasi është arritur në këto përfundime:

**4.1. Kështu, provat e grumbulluara deri në këtë fazë të hetimit ekspozojnë ekzistencën e një mekanizmi të mirëmenduar, krijuar dhe vënë në funksion nga shtetasit nën hetim me qëllim përfitimin nga fondet publike dhe pasurimin personal përmes veprimeve të kamufluara dhe të paligjshme. Në lidhje me praktikat e ndjekura nga këta shtetas, siç do të prezantohet në vijim, nisur nga provat e administruara në fashikull, të paktën në 10 raste krijohet dyshimi i arsyeshëm për kryerjen e veprimeve me natyrë korruptive nga i zgjedhuri vendor, si edhe pastrim të produkteve të veprës penale në nivelin më të lartë të qeverisjes vendore.**

**4.2.** Kryetari i Bashkisë Tiranë, shtetasi Erion Veliaj, përmes nënshkrimit të tij, ka miratuar në çdo rast shpërndarjen e fondeve publike tek disa subjekte tregtarë të lidhur ngushtë me të, fonde këto që më pas kanë përfunduar tek disa organizata jofitimprurëse, shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, persona fizikë të kontrolluar nga bashkëshortja e tij, shtetësja Ajola Xoxa, si edhe individë të afërt me këtë të fundit, duke krijuar një rrjet të



SPIFETUJET.AL

dyshimtë e të komplikuar transaksionesh. Sipas Prokurorisë së Posaçme provat e grumbulluara krijojnë dyshimin e arsyeshëm se fondet publike që dalin nga institucioni i bashkisë Tiranë, me nënshkrimin e titullarit, *i)* kanë kaluar drejtpërdrejt tek bashkëshortja e këtij të fundit dhe rrethi i saj familjar; *ii)* kanë kaluar nëpërmjet sponsorizimeve dhe huapërdorjes pa kundërshpërblim të pasurive të paluajtshme në zona të shtrenjta të kryeqytetit, prej subjekteve tregtare, të cilët nga ana e tyre kanë përfituar fonde publike nga bashkia Tiranë, tek bashkëshortja e kryetarit të bashkisë, OJF-të, shpk-të dhe personat fizikë të kontrolluar nga kjo e fundit; *iii)* kanë kaluar si pasuri të paluajtshme në vlerë të konsiderueshme, dhënë si përfitim i parregullt nga persona konkretë të cilët zotërojnë dhe administrojnë subjekte tregtarë të lidhur ngushtë me Bashkinë Tiranë nëpërmjet përfitimit të fondeve publike si edhe lejeve të ndërtimit, tek familja e kryetarit të bashkisë Tiranë; *iv)* janë shpenzuar për blerje me vlera të mëdha nga familjarë të kryetarit të bashkisë Tiranë, duke u kamufluar këto blerje përmes personave të tjerë. Çdo transferim i këtyre fondeve publike është kryer me miratimin e kryetarit të Bashkisë Tiranë, shtetasit Erion Veliaj.

**4.3.** Gjithashtu, sipas Prokurorisë së Posaçme faktet dhe provat që i janë paraqitur gjykatës, krijojnë gjithashtu dyshimin e arsyeshëm se në rastin konkret bëhet fjalë për një sistem të organizuar korrupsioni dhe shpërdorimi të fondeve publike, të udhëhequr nga kryetari i bashkisë Tiranë dhe bashkëshortja e këtij të fundit. **Në qendër të kësaj skeme korrupsioni dhe pastrimi të produkteve që burojnë nga kjo vepër, rezulton të jetë kryetari i Bashkisë Tiranë, nënshkrimi i të cilit ka qenë determinant për shpërndarjen e fondeve publike, prej të cilave ai dhe familjarët e ngushtë të tij kanë përfituar drejtpërsëdrejti në mënyrë të parregullt. Nga hetimet paraprake të kryera deri në këtë fazë, organi procedues ka arritur në konkluzionin se, përveç pasurive të paluajtshme të përfituara nga shtetasit nën hetim Erion Veliaj dhe Ajola Xoxa** (*nën regjimin pasuror të bashkësisë ligjore*), **këta të fundit përmes shoqërive "Partners Law" shpk, "Arts Lab" shpk, "Ava Studio" shpk, "Nan Gallery" shpk, "Byl-A" OJF, "Harabel" OJF, "Eventus" OJF dhe "Muza" OJF, për të cilat do të provojmë në vijim se kontrollohen tërësisht nga bashkëshortja e kryetarit të Bashkisë Tiranë, kanë gjeneruar të ardhura të cilat kapin shifrën e <u>rreth 110.000.000 lekë.</u>**

**4.4. Gjithashtu, nga hetimet e kryera deri në këtë fazë, sipas Prokurorisë së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar ajo ka siguruar prova të mjaftueshme për të konkluduar se shtetësja Ajola Xoxa, vetë ose nëpërmjet personave të tjerë të afërt me të, për një periudhe kohore prej rreth 6 vitesh, ka bërë blerje online të cilat konsistojnë në veshje personale, fustane, bluza, çanta, funde, pallto, produkte kozmetike, buzëkuq, vathë, etj, në masën <u>86,721,175 lekë.</u>**

5. Nga aktet e administruara nga ana e Gjykatës të sjella nga Prokuroria e Posaçme të cilat i bashkëlidhen kërkesës objekt gjykimi rezultojnë të provuara faktet si më poshtë vijon:

*A. Lidhur me verifikimin e kallëzimit dhe referimin e veprës penale.*

6. Më datë 19.07.2023 është administruar në Prokurorinë e Posaçme një informacion i cili është protokolluar me nr. K536, dërguar nga një shtetas i vetëidentifikuar si Nesti Angoni, me adresë në Rr. "5 Maji", Nr. 71, Tiranë. Në informacionin e përcjellë fillimisht nga shtetasi i vetëidentifikuar si Nesti Angoni, përmenden disa fakte rreth shtetasit Erion

Veliaj, me detyrë kryetar i bashkisë Tiranë, të cilat çmohen si kompromentuese për një zyrtar publik. Këto fakte, lidhen me funksionin e kryetarit të bashkisë si edhe marrëdhenien e këtij të fundit me shtetasin Genti Sula, pronar i shoqërisë tregtare "AGI CONS".

**6.1.** Sipas kallëzuesit, në kohën që shtetasi Erion Veliaj u emërua Ministër i Punës, bleu një pasuri të paluajtshme-banesë, të ndodhur në bllokun rezidencial "Kodra e Diellit", në pronësi të shtetasit Genti Sula. Pas kësaj, bashkëshortja e këtij të fundit u emërua zv.Ministre tek Ministria ku shtetasi Erion Veliaj ishte titullar. Më pas, banesa në fjalë është shtuar me një kat dhe për të është ndërtuar një ashensor i veçantë.

**6.1.1.** Gjithashtu, në këtë kallëzim shpjegohet se që prej asaj kohe marrëdhënia e këtyre dy shtetasve është e pandarë. Shoqëria "AGI KONS" me pronar shtetasin Genti Sula ka përfituar një pafundësi ndërtimesh në Tiranë, si shkollën tek ish Sheshi Shqiponja, Parkun Rinia, Operan, Maternitetin, Spitalin e ri, Godina tek Universiteti Bujqësor dhe tani flitet edhe për Teatrin Kombetar.

**6.1.2.** Gjithashtu, në informacion përmendet se shtetasi Erion Veliaj aktualisht posedon 3 vila në Fshatin Rezidencial në Qerret Kavajë të ndërtuar nga shoqëria Agikons e shtetasit Genti Sula. Një nga këto vila posedohet nga vëllai i shtetasit Erion Veliaj, ndërsa të tretën ky i fundit e ka shembur, ndërkohë që të dyja vilat ekzistuese i ka rikonstruktuar. Vlera e vilave, sipas kallëzuesit kap shifrën e rreth 500 mije Euro. Ndërsa vilën e tretë, kallëzuesi shpjegon se shtetasi Erion Veliaj e ka rrafshuar, duke shpërdoruar 500.000 Euro me qëllim krijimin e hapësirave shtesë. Për prishjen e objektit janë shfrytëzuar makineritë e Ujësjellësit Kavajë. Në këtë pikë, kallëzuesi shtron pyetjen nëse për këtë shëmbje është marrë më parë një leje apo ekziston ndonjë faturë që dokumenton shpenzimet e bëra.

**6.1.3.** Të gjitha këto, vijon kallëzuesi, të shtyjnë të mendosh se ku i gjeti shtetasi Erion Velaj mundësitë financiare dhe nëse ekzistojnë dokumenta të blerjeve, pagesa bankare etj.

**6.2.** Me administrimin e kallëzimit pranë Prokurorisë së Posaçme, nga ana e Hetuesit të Byrosë Kombëtare të Hetimit janë kryer disa verifikime paraprake, të cilat konsistojnë fillimisht në sigurimin e të dhënave për kallëzuesin, shtetasin e identifikuar si Nesti Angoni. Nga rezultatet konstatohet se nuk ekzistojnë të dhëna për këtë shtetas.

**6.3.** Në Sistemin C@ts të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve u verifikua historiku i punësimit i shtetasit Gentian Sula, ku rezultoi se ky shtetas ka qenë i punësuar pranë subjektit "AGI KONS" me datë 01.12.2011 dhe është larguar me datë 01.12.2011.

**6.4.** U verifikua historiku i punësimit të shtetases Gentiana Sula, bashkëshortja e shtetasit Gentjan Sula, nga ku rezulton se ka qenë e punësuar te Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë me datë 07.10.2013 dhe është larguar me datë 13.09.2016.

**6.5.** Në lidhje me subjektin "AGI KONS" shpk, me Administrator shtetasin Alban Çinari dhe Ortak shtetasin Gentjan Sula, u këqyr ekstrakti historik i regjistrimit tregtar për të dhënat e këtij subjekti në faqen e internetit të "Qendrës Kombëtare të Biznesit".

**6.5.1.** Gjithashtu, u procedua me këqyrjen në internet në faqen "openprocurement.al", ku u verifikuan procedurat e prokurimit në të cilat subjekti "AGI KONS" shpk ka marrë pjesë dhe ka fituar, si edhe procedurat në lidhje me "Koncesion/PPP", ku i njëjti subjekt "AGI KONS" ka marrë pjesë dhe është shpallur fitues.

**6.6.** Nga Regjistri i Gjendjes Civile, u administrua në fashikull çertifikata familjare e shtetasit Erion Luan Veliaj, nga ku rezulton se bashkëshortja e tij është shtetasja Ajola Arben

Xoxa. Gjithashtu, u administrua në fashikull edhe çertifikata familjare e shtetasit Arbër Luan Veliaj, nga ku rezulton në përbërje të certifikatës familjare bashke me të ëmën e tij, shtetasen Shqiponjë Veliaj.

**6.7.** Në Sistemin C@ts të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve u verifikua historiku i punësimit i shtetasit Arbër Luan Veliaj, nga ku rezultoi se ky shtetas është i punësuar te subjekti "GOGEL" me NIPT "K91621020U" nga data 01.12.2011.

**6.8.** Në Sistemin C@ts të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve u verifikua historiku i punësimit i shtetasit Erion Luan Veliaj, ku rezultoi se ky shtetas ka qenë i punësuar te Ministria e Mirëqënies Sociale dhe Rinisë me datë 16.09.2013 dhe është larguar me datë 27.05.2015.

**6.9.** U kryen verifikime në sistemin e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës, në lidhje me pasuritë e shtetasit Erion Luan Veliaj nga ku rezultoi se nuk ka pasuri të regjistruara.

**6.10.** Gjithashtu, u kryen verifikime në sistemin e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës, në lidhje me pasuritë e shtetasit **Arbër Luan Veliaj** nga ku rezultoi se ky shtetas ka 3 (tre) pasuri të regjistruara si më poshtë: **1) Pasuria me numër 1/650**, zona Kadastrale 3101, volumi 29, faqe 166, me adresë Kavajë, Qerret, më përshkrim "Z. Stimuluar Ardian Çarçani, Regjistrim leje legalizimi Nr. 705512, datë 21.09.2020. Objekt banimi 2 kat, sipërfaqe kati përdhe 80.42 m2, sipërfaqe verandës 5.35 m2, sipërfaqe kati i parë 83.10 m2. Adresa Kavajë, Qerret, Shkalla 1"; **2) Pasuria me numër 118/81/ND5+1+1**, zona kadastrale 3292, volumi 65, me adresë Tiranë, Selitë, me përshkrim: Sip e përbashkët = 5.87m2; **3) Pasuria me numër 118/81/ND5+1+2**, zona kadastrale 3292, volumi 65, me adresë Tiranë, Selitë, me përshkrim: Sip.e përbashkët = 5.12m2.

**6.11.** U kryen verifikime në sistemin e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës, në lidhje me pasuritë e shtetases **Ajola Arben Xoxa** nga ku rezultoi se kjo shtetase ka 3 (tre) pasuri të regjistruara si më poshtë: **1) Pasuria me numër 2/461+1-32**, zona Kadastrale 8270, volumi 33, faqe 266, me adresë 8270 33 236; **2) Pasuria me numër 25**, zona kadastrale 1414, volumi 5, faqe89, me adresë Fier, Rr. Fshati Clirim, me pronarë Valbona Xhemil Xoxa, Ajola Arben Xoxa, Mariza Aleko Xoxa; **3) Pasuria me numër 109/239+7-0**, zona kadastrale 3292, volumi 46, faqja 45, me përshkrim: 23.42m2 verandë.

**6.12.** U kryen verifikime në sistemin e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës, në lidhje me pasuritë e shtetases **Shqiponjë Maliq Veliaj**, nga ku rezultoi se kjo shtetase ka 5 (pesë) pasuri të regjistruara si më poshtë: **1) Pasuria me numër 2/579/ND+1-14**, zona Kadastrale 8150, volumi 57, faqe 225, me përshkrim Sip. Përbashkët 14.74 m2; **2) Pasuria me numër 623/5/1**, zona kadastrale 3152, volumi 4, faqe 105, me adresë Vlorë, Selenicë, Rr. Ramicë, me pronarë Fatos Maliq Ormënaj; Kristina Njazi Ormënaj; Dea Aleks Ormënaj; Malior Aleks Ormënaj; Xhoi Aleks Ormënaj: Shqiponje Maliq Veliaj; Qatip Maliq Ormënaj; Fadil Maliq Ormenaj; Jonus Maliq Ormënaj; Kastriot Maliq Ormënaj; Syrja Maliq Ormënaj; **3) Pasuria me numër 623/5/2**, zona kadastrale 3152, volumi 4, faqe 106, me adresë Vlorë, Selenicë, Rr. Ramicë, me pronarë Kristina Njazi Ormënaj; Dea Aleks Ormënaj; Malior Aleks Ormënaj; Xhoi Aleks Ormënaj; Shqiponje Maliq Veliaj; Qatip Maliq Ormënaj; Fadil Maliq Ormenaj; Jonus Maliq Ormënaj; Fatos Maliq Ormënaj; Kastriot Maliq Ormënaj; Syrja Maliq Ormënaj; **4) Pasuria me numër 623/3**, zona kadastrale 3152, volumi 4, faqe 101, me adresë Vlorë, Selenicë, Rr. Ramicë, me pronarë Syrja Maliq Ormënaj; Kastriot Maliq Ormënaj; Jonus Maliq Ormënaj; Fadil Maliq Ormenaj; Qatip Maliq Ormënaj; Shqiponje Maliq Veliaj; Xhoi

Aleks Ormënaj; Malior Aleks Ormënaj; Dea Aleks Ormënaj; Kristina Njazi Ormënaj; Fatos Maliq Ormënaj; 5) **Pasuria me numër 623/3/1**, zona kadastrale 3152, volumi 4, faqe 164, me adresë Vlorë, Selenicë, Rr. Ramicë, me pronarë Syrja Maliq Ormënaj; Kastriot Maliq Ormënaj; Jonus Maliq Ormënaj; Fadil Maliq Ormenaj; Qatip Maliq Ormënaj; Shqiponje Maliq Veliaj; Xhoi Aleks Ormënaj; Malior Aleks Ormënaj; Dea Aleks Ormënaj; Kristina Njazi Ormënaj; Fatos Maliq Ormënaj.

**6.13.** U kryen verifikime në QKB në lidhje me subjektin GOGEL, në pronësi të vëllait të kryetarit të Bashkisë Tiranë, shtetasit Arbër Veliaj, ku rezultuan të dhëna të cilat lidhen me objektin e aktivitetit, datën e regjistrimit dhe administrimin e shoqërisë, të cilat do të analizohen në vijim.

**6.14.** U kryen kërkime në burimet e hapura në lidhje "*Deklaratën e Interesave Private*" të shtetasit Erion Veliaj dhe shtetases Ajola Xoxa. Gjithashtu, u administrua nga burimet e hapura "*Formulari i Vetëdeklarimit*" i shtetasit Erion Luan Veliaj, për zbatimin e ligjit nr. 138/2015 "*Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike*" i datës 13/05/2019, bashkëngjitur dhe CV e këtij shtetasi. *Adresa e vendbanimit qe ka plotësuar ky shtetas në këtë formular është Rruga e Ullinjve, Kodra e Diellit, shkalla 26, hyrja nr. 5, Tiranë.*

**6.15.** U administrua nga burimet e hapura "*Formulari i Vetëdeklarimit*" i shtetasit Erion Luan Veliaj, për zbatimin e ligjit nr. 138/2015 "*Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike*" i datës 24/03/2023, bashkëngjitur dhe formulari *Model KQZ-04-10* i Komisionit Qëndror të Zgjedhjeve, mbi jetëshkrimin e kandidatit për kryetar bashkie/anëtar në këshillin bashkiak, të këtij shtetasi.

**6.16.** U kryen verifikime në QKB në lidhje me subjektin "Partners Laë" nga ku rezultoi: **NUIS** - L81829013O. **Data e Regjistrimit** - 29/06/2018. **Data e themelimit** - 27/06/2018. **Emri i Subjektit - "Partners Law". Zyra qendrore e shoqërisë në Shqipëri** - Tirane Njesia Bashkiake Nr.5, Rruga Ibrahim Rugova, Sky Tower, Kati 10/4. **Objekti i aktivitetit** - Shoqëria ka për objekt parësor të saj ofrimin e konsulencës, kryesisht ligjore, nëpërmjet këshillimit ligjor për çështje të ndryshme, përgatitjes së kërkesë padive ose të kërkesave gjatë procedimit civil, dhe administrativ, penal si dhe të kërkesave ankimore, rekurseve kundër vendimeve gjyqësore, arbitrazhit ose të organeve të Administratës Publike; përgatitjes se ankesave dhe kërkesave të personave fizike apo shoqërive të ndryshme tregtare vendase dhe të huaja, përpilimit të akteve që i nënshtrohen veprimtarive noteriale, hartimit të kontratave e të marrëveshjeve, si dhe të çdo dokumenti tjetër që sjell ose synon të sjellë pasoja juridike; këshillimit e asistencës ligjore, përpilimit të akteve, krijimin, regjistrimin e shoqërive tregtare ose personave të tjerë juridike, asistencës ligjore në vazhdimësi të aktivitetit të tyre si dhe marrëdhëniet e tyre me personat fizike dhe juridik për arritjen e marrëveshjeve tregtare si brenda dhe jashtë vendit. Shoqëria mund të ofrojë edhe konsulenca të tjera të cilat ndihmojne objektin me sipër. Shoqëria mund të ofroje çdo shërbim konsulence, pa kufizim, që ka të bëjë me njohjen apo zbatimi apo hartimin e ligjit. Shoqeria mund të kryejë edhe aktivitete që kanë të bëjnë me hartimin, zbatimin, krijimin dhe asistencën të çdo produkti të lidhur me fushen juridike dhe akademike, botime të çdo lloji, si për vetë shoqërinë, ashtu edhe për të tretë, dhe për zhvillim e aktiviteteve tregtare, industriale të çdo lloji, blerjen, shitjen, shkëmbimin, qiramarrjen, menaxhimin, administrimin e pronave të veta të luajtshme e të paluajtshme, e të të tretëve, si dhe zhvillimin e të gjitha aktiviteteve

të lidhura në mënyrë direkte ose indirekte me aktivitetin e pronave të veta në përgjithësi. Shoqëria mund të kryejë edhe aktivitet për llogari të të treteve, lidhur me aktivitetet më sipër. Shoqëria do të mund të blejë, jo në kundër të aktivitetit të saj parësor, pjesëmarrje aksionare apo jo aksionare në shoqëri të tjera, ente, konsortiume, të themeluara apo në themelim, të cilat kanë objekt të ngjashëm apo sidoqoftë të ndërlidhur apo plotësues të objektit të saj, apo sidoqofte në funksion të arritjes së qëllimeve të shoqërisë. Shoqëria, për efekt të realizimit të objektit të saj, gjithashtu, do të mund të zhvillojë aktivitete ndërtimi, shitblerjeje dhe menaxhimi të pasurive të paluajtshme. Shoqëria do të mund të kryejë çdo veprim qe ka të bëjë me pasurine e luajtshme, të paluajtshme apo financiare që kanë lidhje me objektin e shoqërise, përfshirë këtu, por pa u limituar në të, nënshkrimin e marrjes së kredive me institucione të autorizuara nga ligji si dhe me shoqëri dhe ndërmarrje private. Më në përgjithësi, shoqëria do të mund të kryeje çdo aktivitet të nevojshëm apo të dobishëm për përmbushjen e qëllimeve të shoqërisë. Shoqëria nuk mund të zhvillojë aktivitet që shkel ligjin shqiptar në fuqi. **Administratori** - Ajola Xoxa. **Ortakët** – AjolaXoxa, Vlera e kapitalit Para: 100,00 Numri i pjesëve 1,00. Pjesëmarrja në përqindje (%) 100. **Statusi** – Aktiv.

**6.17.** U kryen verifikime në QKB në lidhje me subjektin "Botimet Enciklopedike" ku rezultoi: **NUIS** - J61807025P. **Data e Regjistrimit** - 15/05/1996. **Data e themelimit** - 18/03/1996. **Emri i Subjektit - "BOTIMET ENCIKLOPEDIKE". Forma ligjore** – **Shoqëri Aksionare. Zyra qendrore e shoqërisë në Shqipëri** - Tirane M.GJOLLESHA. **Objekti i aktivitetit** - Botim dhe tregtim librash, revistash, kalendarësh, blloqesh, pllakatesh dhe gjithcka tjetër që shtypet mbi letër, karton ose material e të tjera. Tregtim i materialeve të kancelarisë që nuk futen në kategorinë e mësipërme, si lapsa, bojra, mjete të ndryshme për zyrat, shkollat dhe institucionet e tjera. Tregtimin e pajisjeve të zyrash. Tregtimim të letres dhe çdo materiali tjetër mbi të cilin mund të shtypet, në të gjitha format. Tregtimi i instrumentave dhe pajisjeve të ndryshme për të gjitha fushat e artit (muzikës, arteve figurative, filmit, fotografisë, lojrave elektronike, programeve komjuterike etj.). Në përputhje me ligjin dhe të drejtën e autorit, realizon riprodhimin dhe tregtimin e materialeve artistike e kulturore, si kaseta, vidiokaseta, vidiogames, riprodhime pikture e 2 skulpture, filma etj. **Administratori** - Ajola Xoxa. **Statusi** – Aktiv.

**6.18.** U kryen verifikime nga ana jonë ne sistemin e Raportimeve të Llogarive Bankare nga ku rezultoi se shtetasi **Erion Luan Velinj** me NID H91217035J, ka 15 (pësëmbëdhjetë) llogari bankare sa poshtë vijon: **1)** Në bankën Credins ka 11 llogari, 2 me status llogari e hapur dhe 9 me status llogari e bllokuar; **2)** Në bankën Raiffeisen ka 2 llogari me status llogari e hapur; **3)** Në bankën Intesa San Paolo ka 2 llogari me status llogari e bllokuar.

**6.19.** Shtetësja **Ajola Arben Xoxa** me NID I35716050T, ka 16 (gjashtëmbëdhjetë) llogari bankare si më poshtë: **1)** Në Bankën Kombëtare Tregtare ka 5 llogari, 3 me status llogari e hapur dhe 2 me status llogari e bllokuar; **2)** Në bankën Intesa San Paolo ka 4 llogari, 1 me status llogari e hapur dhe 3 me status llogari e bllokuar; **3)** Në bankën Credins ka 5 llogari, 3 me status llogari e hapur dhe 3 me status llogari e bllokuar; **4)** Në bankën Raiffeisen ka 2 llogari me status llogari e bllokuar.

**6.20.** Shtetasi **Arbër Luan Velinj** me NID I51225008D, ka 31 (tridhjetë e një) llogari bankare si më poshtë: **1)** Në bankën OTP ka 13 llogari, 8 me status llogari e hapur, 4 me

status llogari e bllokuar dhe 1 me status Dormant; **2)** Në Bankën Kombëtare Tregtare ka 8
llogari, 4 me status llogari e hapur, 3 me status llogari e bllokuar dhe 1 me status Dormant; 3)
Në bankën Credins ka 5 llogari, 3 me status llogari e bllokuar dhe 2 me status Dormant; 4)
Në bankën Raiffeisen ka 2 llogari me status llogari e bllokuar; 5) Në bankën First Investment
Bank ka 2 llogari me status llogari e hapur; 6) Në Bankën Amerikane të Investimeve ka 1
llogari me status llogari e hapur.

**6.21.** Shtetasja **Shqiponjë Maliq Veliaj** me NID E95108067D, ka 3 (tre) llogari
bankare si më poshtë: 1) Në Bankën e Tiranës ka 1 llogari me status llogari e bllokuar; 2) Në
bankën Raiffeisen ka 2 llogari me status llogari e bllokuar.

**6.23.** U krye këqyrja e Sistemeve TIMS dhe Raporte e Statistika TIMS nga ku rezultoi
se: **i)** Më datë 13.08.2004, ora 16:46 në Pikën Kufitare Rinas, shtetasi **Erion Veliaj** ka
udhëtuar me linjë e udhëtimit CHARTER. Më datë 13.08.2004, ora 17:08 në Pikën Kufitare
Rinas, shtetasi **Gentjan Sulaj** ka udhëtuar me linjë e udhëtimit CHARTER; **ii)** Më datë
04.08.2006, ora 12:07 në Pikën Kufitare Rinas, shtetasi **Gentjan Sulaj** ka udhëtuar me linjë e
udhëtimit CHARTER. Më datë 04.08.2006, ora 14:40 në Pikën Kufitare Rinas, shtetasi **Erion
Veliaj** ka udhëtuar me linjë e udhëtimit CHARTER; **iii)** Më datë 15.08.2017, ora 08:29 në
Pikën Kufitare Rinas, shtetasi **Erion Veliaj** ka udhëtuar me linjë e udhëtimit TURKISH
AIRLINES - TK 1073/1074 STAMB. Më datë 15.08.2017, ora 08:37 në Pikën Kufitare
Rinas, shtetasi **Gentjan Sulaj** ka udhëtuar me linjë e udhëtimit TURKISH AIRLINES - TK
1073/1074 STAMB.

**6.24.** Nga tërësia e akteve të administruara nga hetuesit e Byrosë Kombëtare të
Hetimit, deri në fazën që i paraprin regjistrimit të procedimit penal, rezultoi se shtetësja
Gentiana Sulaj, bashkëshortja e shtetasit Gentjan Sulaj, ka qënë e punësuar në Ministrinë e
Mirëqenies Sociale dhe Rinisë nga data 07.10.2013 deri me datë 13.09.2016, periudhë kur
ministër i kësaj ministrie ka qënë Erion Veliaj nga 16.09.2013 deri me datë 27.05.2015.

**6.25.** Subjekti "AGI KONS" shpk ka marrë pjesë dhe ka fituar procedurat e
prokurimit publik, të cilat do të trajtohen në vijim: 1) Rehabilitimi i parkut Rinia me
institucion prokurues Bashkinë Tiranë; 2) Ndërtimi i objektit "Godina e Teatrit Tiranë-Faza I-
rë" me institucion prokurues Bashkia Tiranë; 3) Koncesion/Partneritet Publik Privat për
Përmirësimin e e Infrastrukturës Arsimore në Bashkinë Tiranë në Zonën Tirana 1, me
autoritet kontraktor Bashkia Tiranë dhe Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë.

**6.26.** Vëllai i Erion Veliaj, Arbër Veliaj, ka në pronësi një objekt banimi 2 kat,
sipërfaqe kati përdhe 80.42 m2, sipërfaqe verandës 5.35 m2, sipërfaqe kati i parë 83.10 m2,
me adresë Kavajë, Qerret, Shkalla 1, ku nga informacioni i administruar, në atë fazë të
hetimit është dyshuar se mund të jetë Vilë e ndodhur në Fshatin Rezidencial në Qerret
Kavajë, e ndërtuar nga subjekti AGI KONS.

**6.27.** Në deklarimin e pasurisë me datë 31.03.2017, bashkëshortja e shtetasit Erion
Veliaj, Ajola Xoxa, deklaron në pronësi apartament me adresë në rezidencën Kodra e Diellit,
Tiranë. Kjo rezidencë banimi është ndërtuar nga subjekti "AGI KONS".

**6.28.** Më datë **08.02.2024**, pas disa verifikimeve të kryera nga policia gjyqësore për të
siguruar elementë të provës, që konfirmojnë të dhënat e përmbajtjes së informacionit të
përmendur më lart, hetuesit e Byrosë Kombëtare të Hetimit kanë referuar një material
procedural *"Informacion për referimin e veprës penale"*, i cili është protokolluar me nr. 2473
datë 08.02.2024 në Prokurorinë e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar.

Pas konsultimit me informacionin e referuar, është proceduar me regjistrimin e tij si kallëzim penal me Nr. 37 datë 08.02.2024 dhe në vijim, duke qenë se u konstatua ekzistenca e elementëve që lidhen me veprën penale të "*Korrupsioni pasiv i funksionarëve të lartë shtetërorë ose i të zgjedhurve vendorë*", parashikuar nga neni 260 i Kodit Penal, u proceduа me regjistrimin e procedimit penal me këtë objekt hetimi, me nr. 27 datë **08.02.2024**, me qëllim kryerjen e veprimeve hetimore të mëtejshme.

**6.29.** Pas kryerjes së veprimeve hetimore, më datë **27.12.2024** u konstatua se, përveç elementëve që i përkasin veprës penale për të cilën është regjistruar fillimisht ky procedim, rezultojnë edhe elementë që lidhen me veprat penale të "*Korrupsioni aktiv i funksionarëve të lartë shtetërore ose të zgjedhurve vendorë*", parashikuar nga neni 245, "*Pastrimi i produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale*", parashikuar nga neni 287/2 i Kodit Penal dhe "*Refuzimi për deklarimin, mosdeklarimi, fshehja ose deklarimi i rremë i pasurive, interesave private të personave të zgjedhur dhe nëpunësve publikë ose i çdo personi tjetër që ka detyrimin ligjor për deklarim*", parashikuar nga neni 257/a pgf 2 i Kodit Penal. Në këto kushte, në Regjistrin e njoftimit të veprave penale në Prokurorinë e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, krahas veprës penale të parashikuar nga neni 260 i Kodit Penal, më datë 27.12.2024 u shënuan dhe veprat penale sipas nenit 245, 287/2 e 257/a/2 të Kodit Penal.

**6.30.** Më datë **16.01.2025** në Regjistrin e njoftimit të veprave penale u shënua dhe vepra penale e "*Deklaratat e rreme përpara oficerit të policisë gjyqësore*", parashikuar në nenin 305/b të Kodit Penal.

**6.31.** Më datë **24.01.2025** në Regjistrin e njoftimit të veprave penale u shënua dhe vepra penale e "*Veprime që pengojnë zbulimin e së vërtetës*", parashikuar nga neni 301 i Kodit Penal.

***1. Lidhur me pasuritë e deklaruara nga shtetasit Erion Veliaj dhe Ajola Xoxa.***

7. Gjatë shqyrtimit gjyqësor rezultoi se shtetasi Erion Veliaj është subjekt i Prokurorisë së Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, veprat penale në ngarkim të të cilit janë të parashikuara në nenin 75/a gërma "ç", pasi hynë në kategorinë e subjekteve të posaçme. Ky shtetas është bërë subjekt deklarues në ILDKPKI në vitin 2013 dhe në zbatim të Ligjit Nr. 9049, datë 10.4.2003, "*Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë*", i ndryshuar dhe të ligjit nr. 9367, dt. 7.4.2005, "*Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike*", i ndryshuar, ka dorëzuar ndër vite deklaratat e interesave private, *Para fillimit të detyrës 2013, Periodike/Vjetore 2014, 2015, 2016, 2017, 2018, 2019, 2020, 2021, 2022 dhe 2023.* Me qëllim administrimin në fashikull të të dhënave që lidhen me deklaratat e plotësuara nga shtetasit nën hetim Erion Veliaj dhe Ajola Xoxa, të paraqitura pranë ILDKPI, nga kjo e fundit, sipas kërkesës së organit procedues me Nr. 8055 Prot., datë 23.05.2024, u dërgua shkresa me Nr. 2445/1 Prot., datë 24.05.2024, nëpërmjet së cilës janë vënë në dispozicion kopje të njësuar me origjinalin të interesave private "*Para fillimit të detyrës 2013*", "*Periodik vjetor 2013*" deri "*Periodik vjetor 2023*" për subjektin Erion Luan Veliaj dhe personit të lidhur Ajola Arben Xoxa.

- ***Deklarimi i pasurisë para fillimit të detyrës viti 2013.***

**7.1.** Nga aktet e administruara rezulton se, shtetasi **Erion Veliaj,** më datën **16.10.2013** ka dorëzuar pranë ILDKPKI-së deklaratën e interesave private *"Para fillimit të detyrës 2013"*, si Ministër i Ministria e Mirëqënies Sociale dhe Rinisë, më datë emërimi në detyrë 16.09.2013. Në këtë deklaratë pasurie shtetasi **Erion Veliaj** ka deklaruar pasuritë si më poshtë vijon:

1. **Apartament banimi sip. 111.2 m2, Rr. "Hoxha Tahsim", Kompleksi Aurora, Tiranë,** kontratë shitje me datë 3.09.2013., Nr. 2/543+1-29, Kontrata noteriale Nr. 3405 Rep., Nr. 1939 Kol., noter Violeta Sulkaj. **Burimi i krijimit:** Të ardhurat nga shitja e apartamentit të zotëruar nga prindi dhe paga. **Vlera e pasurisë:** 5,115,200 Lekë. **Rivlerësuar me datë 03.10.2013 me 12,810,240 Lekë. Pjesa takuese:** Zotërimi 100%.
2. **Automjet tip PUGEOT, prodhim i vitit 2008, targa TR72511P,** me nr. shasie VF36DRHRJ21700253, blerë me 17.04.2008, nga AVEL SHPK. **Burimi i krijimit:** Të ardhurat nga paga. **Vlera e pasurisë:** Shuma e paguar 23,000 Euro. **Pjesa takuese:** 100%.
3. **Automjet tip VOLKSËAEGEN TUAREG, targa AA747AM, prodhim i vitit 2003,** me numër shasie ËVGZZZZLZD011224. Kontrata noteriale 10.09.2013, Nr. 11749 Rep,. dhe Nr. 1929 Kol., noter Majlinda Demollari. **Burimi i krijimit:** Të ardhurat nga paga. **Vlera e pasurisë:** Shuma e paguar 6000 Euro. **Pjesa takuese:** 100%.
4. **Llogari Bankare** SAN PAOLO në Euro dhe dollarë. **Burimi i krijimit:** Të ardhurat nga paga. **Vlera e pasurisë: 5,290 Euro dhe 7,500 USD. Pjesa takuese:** 50%.
5. **Llogari Bankare Banka Credins:** nuk ka gjëndje të deklaruar.

**7.1.2.** Lidhur me përshkrimin e detyrimeve të tij, shtetasi **Erion Veliaj,** në Deklaratën *"Para fillimit të detyrës 2013"*, nuk ka deklaruar detyrime.

- ***Deklarimi i vjetor i vitit 2013.***

**8.** Në deklaratën e interesave private ***periodike vjetor të vitit 2013*** shtetasi Erion Veliaj në seksionin *"Ndryshimet e pasurive dhe burimet e krijimit"* ka deklaruar pasuritë si më poshtë vijon:

1. **Llogari bankare Intesa San Paolo në Euro, nr. 98084938001. Burimi i krijimit:** Të ardhurat nga paga. **Vlera e pasurisë:** 5,297.95 Euro. **Pjesa takuese:** Zotërimi 50%.
2. **Llogari bankare Intesa San Paolo në Dollarë, nr. 98084938002. Burimi i krijimit:** Të ardhurat nga paga. **Vlera e pasurisë:** 7,503,51 USD. **Pjesa takuese:** Zotërimi 50%.
3. **Llogari bankare Credins Bank Nr. 491825. Burimi i krijimit:** Të ardhurat nga paga. **Vlera e pasurisë:** 168,168.57 Lekë. **Pjesa takuese:** Zotërimi 100%.

4. **Llogari bankare Credins Bank Nr.12032.** **<u>Burimi i krijimit:</u>** Të ardhurat nga paga. **<u>Vlera e pasurisë:</u>** 209.08 Euro. **<u>Pjesa takuese:</u>** Zotërimi 100%.
5. **Llogari bankare Credins Bank Nr. 500181.** **<u>Burimi i krijimit:</u>** Të ardhurat nga paga. **<u>Vlera e pasurisë:</u>** -3.05 Euro. **<u>Pjesa takuese:</u>** Zotërimi 100%.

**8.1.** Në deklaratën e interesave private ***periodike vjetor të vitit 2013*** shtetasi **Erion Veliaj** në seksionin *"Të ardhurat dhe angazhimet në veprimtari publike dhe/ose private"* ka deklaruar këto të ardhura si më poshtë vijon:

1. Paga mujore-Ministri i Mirëqënies Sociale dhe Rinisë. Shuma e të ardhurave: **595, 000 Lekë bruto;**
2. Shpërblim Kuvendi. Shuma e të ardhurave: **52,896 Lekë bruto;**

**8.2.** Në deklaratën e interesave private ***periodike vjetor të vitit 2013*** shtetasi **Erion Veliaj** në seksionin *"Detyrimet financiare ndaj personave juridike dhe fizikë"* nuk rezulton të jetë deklaruar ndonjë detyrim.

- ***<u>Deklarimi i vjetor i vitit 2014.</u>***

9. Në deklaratën e interesave private ***periodike vjetor të vitit 2014*** shtetasi **Erion Veliaj** në seksionin *"Ndryshimet e pasurive dhe burimet e krijimit"* ka deklaruar pasuritë si më poshtë vijon:

1. **Automjeti VOLKSËAGEN me targa AA747AM, vitit 2003.** Fituar me Kontratë Shitblerje automjeti me Nr. 2173 Rep., dhe Nr. 686 Kol., datë 22.07.2014.
2. **Llogari bankare Credins Bank Nr. 491825.** **<u>Burimi i krijimit:</u>** Të ardhurat nga paga. **<u>Vlera e pasurisë:</u>** 25,000.02 Lekë. **<u>Pjesa takuese:</u>** Zotërimi 100%.
3. **Llogari bankare Credins Bank Nr.12032.** **<u>Burimi i krijimit:</u>** Të ardhurat nga paga. **<u>Vlera e pasurisë:</u>** 692.4 Euro. **<u>Pjesa takuese:</u>** Zotërimi 100%.
4. **Llogari bankare Credins Bank Nr. 500181.** **<u>Burimi i krijimit:</u>** Të ardhurat nga paga. **<u>Vlera e pasurisë:</u>** -9.58 Euro. **<u>Pjesa takuese:</u>** Zotërimi 100%.
5. **Llogari bankare Intesa San Paolo në Euro, nr. 98084938001.** **<u>Burimi i krijimit:</u>** Të ardhurat nga paga. **<u>Vlera e pasurisë:</u>** 5305 Euro. **<u>Pjesa takuese:</u>** Zotërimi 50%.
6. **Llogari bankare Intesa San Paolo në Dollarë, nr. 98084938002.** **<u>Burimi i krijimit:</u>** Të ardhurat nga paga. **<u>Vlera e pasurisë:</u>** 7,516 USD. **<u>Pjesa takuese:</u>** Zotërimi 50%.

**9.1.** Në deklaratën e interesave private ***periodike vjetor të vitit 2014*** shtetasi **Erion Veliaj** në seksionin *"Të ardhurat dhe angazhimet në veprimtari publike dhe/ose private"* ka deklaruar këto të ardhura si më poshtë vijon:

1. Paga mujore-Ministri i Mirëqënies Sociale dhe Rinisë. Shuma e të ardhurave **1,551,834 Lekë neto.**

**9.2.** Në deklaratën e interesave private ***periodike vjetor të vitit 2014*** shtetasi **Erion Veliaj** në seksionin *"Detyrimet financiare ndaj personave juridike dhe fizikë"* dhe

SPIEGJETAL

*"Shpenzimet e deklarueshme"* nuk rezulton të ketë deklaruar ndonjë detyrim apo shpenzim i deklarueshëm.

**9.3.** Në deklaratën e interesave private ***periodike vjetor të vitit 2014,*** të personit të lidhur **Ajola Arben Xoxa (bashkëjetuesja)**, në seksionin *"Ndryshimet e pasurive dhe burimet e krijimit"* ka deklaruar pasuritë si më poshtë vijon:

1. **Llogari bankare BKT nr. 503094870.** **Burimi i krijimit:** Të ardhurat nga ushtrimi i profesionit/punësimi. **Vlera e pasurisë:** 19,801.84 Euro. **Pjesa takuese:** Zotërimi 100%.
2. **Llogari bankare San Paolo Bank, nr. 437688735102.** **Burimi i krijimit:** TTë ardhura nga ushtrimi i profesionit/punësimi. **Vlera e pasurisë:** 4,879 Euro. **Pjesa takuese:** Zotërimi 100%.
3. **Llogari bankare San Paolo Bank, nr. 437688735103.** **Burimi i krijimit:** TTë ardhura nga ushtrimi i profesionit/punësimi. **Vlera e pasurisë:** 11,241 Lekë. **Pjesa takuese:** Zotërimi 100%.
4. **Llogari bankare San Paolo Bank, nr. 98084938001.** **Burimi i krijimit:** TTë ardhura nga paga. **Vlera e pasurisë:** 5305 Euro. **Pjesa takuese:** Zotërimi 50%.
5. **Llogari bankare San Paolo Bank, nr. 98084938002.** **Burimi i krijimit:** TTë ardhura nga paga. **Vlera e pasurisë:** 7,516 USD. **Pjesa takuese:** Zotërimi 50%.
6. Kontratë sipërmarrje (Për ndërtim apartamenti) mes shoqërisë AGIKONS SHPK me nipt: K21622001M dhe Arben Xoxa, Valbona Xoxa dhe Ajola Xoxa, me datë 6.5.2012, me sipërfaqe apartamenti 171.2 m2 dhe verandë 19.4m2, me adresë Rezidenca Kodra e Diellit, Rruga "Ullinjtë" Shkalla 11, ap. 5 Tiranë.[4]

**9.3.1.** Në deklaratën e interesave private ***periodike vjetor të vitit 2014,*** të personit të lidhur **Ajola Arben Xoxa (bashkëjetuesja)**, në seksionin *"Të ardhurat dhe angazhimet në veprimtari publike dhe/ose private"* ka deklaruar këto të ardhura si më poshtë vijon:

1. Shërbim konsulence ligjore perosn fizik me NIPT K91503025N ndaj Zyrës Ligjore Pashko-Pustina SHPK, nga 1 Janar-31 Mars 2014. **Shuma e të ardhurave neto: 733, 920 Lekë.**
2. Shërbim konsulence ligjore perosn fizik me NIPT K91503025N ndaj Zyrës Ligjore The Partners SHPK, 1 Nëntor-31 Dhjetor 2014. **Shuma e të ardhurave neto: 360,000** Lekë.
3. Lektore Universitare pranë Universiteti Europian i Tiranës 1 Janar-28 Shkurt 2014. **Shuma e të ardhurave: 70,226** Lekë.

**9.3.2.** Në deklaratën e interesave private ***periodike vjetor të vitit 2014,*** të personit të lidhur **Ajola Arben Xoxa (bashkëjetuesja)**, në seksionin *"Detyrimet financiare ndaj personave juridike dhe fizikë"* dhe *"Shpenzimet e deklarueshme"* nuk rezulton të jetë deklaruar ndonjë detyrim.

- ***Deklarimi i vjetor i vitit 2015.***

[4] Nuk është deklaruar burimi i krijimit të të ardhurave për pronotimin e këtij dhe sa është vlera e kësaj pasurie.



SPIRITUAL.AL

**10.** Në deklaratën e interesave private ***periodike vjetor të vitit 2015*** shtetasi **Erion Veliaj** në seksionin *"Ndryshimet e pasurive dhe burimet e krijimit"* ka deklaruar pasuritë si më poshtë vijon:

1. **Llogari bankare Intesa San Paolo në Euro, nr. 98084938001.** **Burimi i krijimit:** Të ardhurat nga paga. **Vlera e pasurisë:** 5,307 Euro. **Pjesa takuese:** Zotërimi 50%.
2. **Llogari bankare Intesa San Paolo në Dollarë, nr. 98084938002.** **Burimi i krijimit:** Të ardhurat nga paga. **Vlera e pasurisë:** 8,288 USD. **Pjesa takuese:** Zotërimi 50%.
3. **Llogari bankare Credins Bank Nr. 491825.** **Burimi i krijimit:** Të ardhurat nga paga. **Vlera e pasurisë:** 867,633.42 Lekë. **Pjesa takuese:** Zotërimi 100%.
4. **Llogari bankare Credins Bank Nr.12032.** **Burimi i krijimit:** Të ardhurat nga paga. **Vlera e pasurisë:** 427.83 Euro. **Pjesa takuese:** Zotërimi 100%.
5. **Llogari bankare Credins Bank Nr.** 4020. **Burimi i krijimit:** Të ardhurat nga paga. **Vlera e pasurisë:** 5.66 Euro. **Pjesa takuese:** Zotërimi 100%.

**10.1.** Në deklaratën e interesave private ***periodike vjetor të vitit 2015*** shtetasi **Erion Veliaj** në seksionin *"Të ardhurat dhe angazhimet në veprimtari publike dhe/ose private"* ka deklaruar këto të ardhura si më poshtë vijon:

1. Paga mujore -Ministri i Mirëqënies Sociale dhe Rinisë. Shuma e të ardhurave **557,764 Lekë neto.**
2. Paga- Bashkia e Tiranës. Shuma e të ardhurave: **656,832 Lekë neto.**

**10.2.** Në deklaratën e interesave private ***periodike vjetor të vitit 2015*** shtetasi **Erion Veliaj** në seksionin *"Detyrimet financiare ndaj personave juridike dhe fizikë"* dhe *"Shpenzimet e deklarueshme"* nuk rezulton të jetë deklaruar ndonjë detyrim apo shpenzim i deklarueshëm.

**10.3.** Në deklaratën e interesave private ***periodike vjetor të vitit 2015,*** të personit të lidhur **Ajola Arben Xoxa (bashkëjetuesja)**, në seksionin *"Ndryshimet e pasurive dhe burimet e krijimit"* ka deklaruar pasuritë si më poshtë vijon:

1. **Llogari bankare BKT nr. 503094870.** **Burimi i krijimit:** Të ardhurat nga ushtrimi i profesionit/punësimi. **Vlera e pasurisë:** 23,649.84 Euro dhhe 1,025,169.41 lekë. **Pjesa takuese:** Zotërimi 100%.
2. **Llogari bankare San Paolo Bank, nr. 437688735102.** **Burimi i krijimit:** TTë ardhura nga ushtrimi i profesionit/punësimi. **Vlera e pasurisë:** 2,930 Euro. **Pjesa takuese:** Zotërimi 100%.
3. **Llogari bankare San Paolo Bank, nr. 437688735103.** **Burimi i krijimit:** TTë ardhura nga ushtrimi i profesionit/punësimi. **Vlera e pasurisë:** 15,072 Lekë. **Pjesa takuese:** Zotërimi 100%.
4. **Llogari bankare San Paolo Bank, nr. 98084938001.** **Burimi i krijimit:** TTë ardhura nga paga. **Vlera e pasurisë:** 5307 Euro. **Pjesa takuese:** Zotërimi 50%.
5. **Llogari bankare San Paolo Bank, nr. 98084938002.** **Burimi i krijimit:** TTë ardhura nga paga. **Vlera e pasurisë:** 8,288 USD **Pjesa takuese:** Zotërimi 50%.

6. **Llogari bankare San Paolo Bank, nr.** 20654835301 në Euro. **Burimi i krijimit:** Të ardhura nga ushtrimi i profesionit/punësimi. **Vlera e pasurisë:** 217 Euro. **Pjesa takuese:** Zotërimi 100%.
7. **Llogari bankare San Paolo Bank, nr. 20654835302 në Lekë. Burimi i krijimit:** Të ardhura nga ushtrimi i profesionit/punësimi. **Vlera e pasurisë:** 8,288 USD **Pjesa takuese:** Zotërimi 100%.

**10.4.** Në deklaratën e interesave private ***periodike vjetor të vitit 2015,*** të personit të lidhur **Ajola Arben Xoxa (bashkëjetuesja)**, në seksionin *"Të ardhurat dhe angazhimet në veprimtari publike dhe/ose private"* ka deklaruar këto të ardhura si më poshtë vijon:

1. Shërbim konsulence ligjore person fizik, biznes i vogël me NIPT K91503025N. **Shuma e të ardhurave neto:** 3,264,735 Lekë neto.
2. Shërbim konsulence për SH.I.Z.I., financuar na USAID dhe UN Eomen: Vlera: **170,000 lekë.**

**10.5.** Në deklaratën e interesave private ***periodike vjetor të vitit 2015,*** të personit të lidhur **Ajola Arben Xoxa (bashkëjetuesja)**, në seksionin *"Detyrimet financiare ndaj personave juridike dhe fizikë"* dhe *"Shpenzimet e deklarueshme"* nuk rezulton të jetë deklaruar ndonjë detyrim.

- ***Deklarimi i vjetor i vitit 2016.***

**11.** Në deklaratën e interesave private ***periodike vjetor të vitit 2016*** shtetasi **Erion Veliaj** në seksionin *"Ndryshimet e pasurive dhe burimet e krijimit"* ka deklaruar pasuritë si më poshtë vijon:

1. **Llogari bankare Credins Bank Nr. 491825. Burimi i krijimit:** Të ardhurat nga paga. **Vlera e pasurisë:** 1,172,041.66 Lekë. **Pjesa takuese:** Zotërimi 100%.
2. **Llogari bankare Credins Bank Nr.12032. Burimi i krijimit:** Të ardhurat nga paga. **Vlera e pasurisë:** 1,025.51 Euro. **Pjesa takuese:** Zotërimi 100%.
3. **Llogari bankare Credins Bank Nr. 8095 në USD. Burimi i krijimit:** Të ardhurat nga paga. **Vlera e pasurisë:** 0 USD. **Pjesa takuese:** Zotërimi 100%.
4. **Llogari bankare Credins Bank Nr.** 4020. **Burimi i krijimit:** Të ardhurat nga paga. **Vlera e pasurisë:** 5.66 Euro. **Pjesa takuese:** Zotërimi 100%.
5. **Llogari bankare Intesa San Paolo, nr. 98084938001 në Euro. Burimi i krijimit:** Të ardhurat nga paga. **Vlera e pasurisë:** 5,308.29 Euro. **Pjesa takuese:** Zotërimi 50%.
6. **Llogari bankare Intesa San Paolo në Dollarë, nr. 98084938002. Burimi i krijimit:** Të ardhurat nga paga. **Vlera e pasurisë:** 8,295.1 USD. **Pjesa takuese:** Zotërimi 50%.

**11.1.** Në deklaratën e interesave private ***periodike vjetor të vitit 2016*** shtetasi **Erion Veliaj** në seksionin *"Të ardhurat dhe angazhimet në veprimtari publike dhe/ose private"* ka deklaruar këto të ardhura si më poshtë vijon:

1. Paga- Bashkia e Tiranës. Shuma e të ardhurave: **1,555,204 Lekë neto.**

**11.2.** Në deklaratën e interesave private ***periodike vjetor të vitit 2016*** shtetasi **Erion Veliaj** në seksionin *"Detyrimet financiare ndaj personave juridike dhe fizikë"* ka deklaruar:

1. Kredi në bankën Credins me vlerën 6,100,000 Lekë, me afat 180 muaj, e disbursuar me 31.08.2015. Vlera e shlyer nga deklarimi i mëparshëm deri në 31 Dhejtor: 720,826.03 Lekë. Gjëndja e detyrimit të mbetur pa shlyer: **5, 815, 845.86 Lekë.**

**11.3.** Në deklaratën e interesave private ***periodike vjetor të vitit 2016***, të personit të lidhur **Ajola Arben Xoxa (bashkëjetuesja)**, në seksionin *"Ndryshimet e pasurive dhe burimet e krijimit"* ka deklaruar pasuritë si më poshtë vijon:

1. **Llogari bankare BKT nr. 503094870.** **<u>Burimi i krijimit:</u>** Të ardhurat nga ushtrimi i profesionit/punësimi. **<u>Vlera e pasurisë:</u>** 40,253.62 Euro dhe 33,969.41 Lekë. **<u>Pjesa takuese:</u>** Zotërimi 100%.
2. **Llogari bankare San Paolo Bank, nr. 437688735102.** **<u>Burimi i krijimit:</u>** Të ardhura nga ushtrimi i profesionit/punësimi. **<u>Vlera e pasurisë:</u>** 1,948.39 Euro. **<u>Pjesa takuese:</u>** Zotërimi 100%.
3. **Llogari bankare San Paolo Bank, nr. 437688735103.** **<u>Burimi i krijimit:</u>** Të ardhura nga ushtrimi i profesionit/punësimi. **<u>Vlera e pasurisë:</u>** 13,272.64 Lekë. **<u>Pjesa takuese:</u>** Zotërimi 100%.
4. **Llogari bankare San Paolo Bank, nr. 98084938001.** **<u>Burimi i krijimit:</u>** Të ardhura nga paga. **<u>Vlera e pasurisë:</u>** **5,308.29 Euro.** **<u>Pjesa takuese:</u>** Zotërimi 50%.
5. **Llogari bankare San Paolo Bank, nr. 98084938002.** **<u>Burimi i krijimit:</u>** Të ardhura nga paga. **<u>Vlera e pasurisë:</u>** 8,295.1 USD. **<u>Pjesa takuese:</u>** Zotërimi 50%.
6. **Llogari bankare San Paolo Bank, nr.** 20654835301 në Euro. **<u>Burimi i krijimit:</u>** Të ardhura nga ushtrimi i profesionit/punësimi. **<u>Vlera e pasurisë:</u>** 37,828.66 Euro. **<u>Pjesa takuese:</u>** Zotërimi 100%.
7. **Llogari bankare San Paolo Bank, nr. 20654835302 në Lekë.** **<u>Burimi i krijimit:</u>** Të ardhura nga ushtrimi i profesionit/punësimi. **<u>Vlera e pasurisë:</u>** 1,574.00 Lekë **<u>Pjesa takuese:</u>** Zotërimi 100%.
8. Kontratë finale shitje apartamenti datë 26.07.2016, Nr. 3325 Rep., dhe Nr. 1884 Kol., apartament 162 m2, me AGIKONS SHPK, porositës dorëheqës Arben Xoxa dhe Valbona Xoxa në favor të prorositësit të tretë Ajola Xoxa dhe çertifikatë pronësie 1403368, nr. pasurie 109/239+7-9, vol 46, f 65. në vijim të zatim final të kontrtës së sipërmarrjes për ndërtim apartamenti, adresa Rezidenca Kodra e Diellit. **Vlera 88,641 Euro.**[5] Pjesa takuese 100%.

**11.3.1.** Në deklaratën e interesave private ***periodike vjetor të vitit 2016***, të personit të lidhur **Ajola Arben Xoxa (bashkëjetuesja)**, në seksionin *"Të ardhurat dhe angazhimet në veprimtari publike dhe/ose private"* ka deklaruar këto të ardhura si më poshtë vijon:

---

[5] Nuk është deklaruar burimi i krijimit të të ardhurave për blerjen e këtij apartamenti asnjëherë. Pra, as në deklaratën periodike të vitit 2014 dhe as në deklaratën periodike të vitit 2016 nuk është deklaruar burimi i krijimit të kësaj pasurie.

1. Shërbim konsulence ligjore person fizik, biznes i vogël me NIPT K91503025 N.[6] **Shuma e të ardhurave neto**: 7,597,703 Lekë neto.
2. Konsulencë për B.Y.L.A, finacuar nga UNICEF.Vlera: **112,400 Lekë.**
3. Drejtuese e konsulentëve, projekt për UNICEF. Vlera **153,000 Lekë neto.**

**11.3.1.** Në deklaratën e interesave private ***periodike vjetor të vitit 2016***, të personit të lidhur **Ajola Arben Xoxa (bashkëjetuesja)**, në seksionin *"Detyrimet financiare ndaj personave juridike dhe fizikë"* dhe *"Shpenzimet e deklarueshme"* nuk rezulton të jetë deklaruar ndonjë detyrim dhe shpenzim i deklarueshëm.

- ***Deklarimi i vjetor i vitit 2017.***

**12.** Në deklaratën e interesave private ***periodike vjetor të vitit 2017*** shtetasi **Erion Veliaj** në seksionin *"Ndryshimet e pasurive dhe burimet e krijimit"* ka deklaruar pasuritë si më poshtë vijon:

1. **Llogari bankare Credins Bank Nr. 491825. Sipas deklarimit në këtë vitë është shtuar kjo llogari me 856.007, 73 lekë. Burimi i krijimit:** Të ardhurat nga paga, dieta dhe rimbursimi i biletave për lëvizjet jashtë shtetit për pjesëmarrjen në aktivitetet ndërkombëtare. **Gjendja e llogarisë në 31.12.2017:** 2,028,049.39 Lekë. **Pjesa takuese:** Zotërimi 100%.
2. **Llogari bankare Credins Bank Nr.12032. Sipas deklarimit në këtë vitë është shtuar kjo llogari me 9110.11 Euro. Burimi i krijimit:** Të ardhurat nga paga, dieta dhe rimbursimi i biletave për lëvizjet jashtë shtetit për pjesëmarrjen në aktivitetet ndërkombëtare si dhe shitja e autoveturës tip Peugot. **Gjendja e llogarisë në 31.12.2017:** 10,135.32 Euro. **Pjesa takuese:** Zotërimi 100%.
3. **Llogari bankare Credins Bank Nr. 8095 dhe Nr. 4020 në USD.** Nuk kanë ndryshime nga deklarimi i mëparshëm. Tashmë këto llogari janë mbyllur.
4. **Shitje automjeti tip Peugeot, me targa TR7251 P**, sipas Kontratës Noteriale Nr. 5812 Rep., dhe Nr. 1641 Kol., datë 19.12.2017. **Vlera 8000 Euro.** Pjesa takuese 100%.
5. **Llogari bankare Intesa San Paolo, nr. 98084938001 në Euro. Burimi i krijimit:** Të ardhurat nga paga. **Vlera e pasurisë:** 5,308.29 Euro. **Pjesa takuese:** Zotërimi 50%. Nuk ka ndryshim nga deklarimi i mëparshëm.
6. **Llogari bankare Intesa San Paolo në Dollarë, nr. 98084938002. Burimi i krijimit:** Të ardhurat nga paga. **Vlera e pasurisë:** 8,302.10 USD. **Pjesa takuese:** Zotërimi 50%. Shtuar me 7 dollar amerikanë nga deklarimi i mëparshëm.

**12.1.** Në deklaratën e interesave private ***periodike vjetor të vitit 2017*** shtetasi **Erion Veliaj** në seksionin *"Të ardhurat dhe angazhimet në veprimtari publike dhe/ose private"* ka deklaruar këto të ardhura si më poshtë vijon:

2. Paga- Bashkia e Tiranës. Shuma e të ardhurave: **1,573,940 Lekë.**

[6] Në deklaratën periodike vjetore të vitit 2014 është me këtë NIPT është deklaruar Zyra Ligjore Tashko – Pustina sh.p.k.

**12.2.** Në deklaratën e interesave private ***periodike vjetor të vitit 2017*** shtetasi **Erion Veliaj** në seksionin *"Detyrimet financiare ndaj personave juridike dhe fizikë"* ka deklaruar:

1. Kredi në bankën Credins me vlerën 6,100,000 Lekë, me afat 180 muaj, e disbursuar me 31.08.2015 dhe përfundon në vitin 2030. Vlera e shlyer nga deklarimi i mëparshëm deri në 31 Dhejtor: 720,769.26 Lekë. Gjëndja e detyrimit të mbetur pa shlyer: **5,580,250.38 Lekë.**

**12.3.** Në deklaratën e interesave private ***periodike vjetor të vitit 2017***, shtetasi **Erion Veliaj** në seksionin *"Shpenzimet e deklarueshme"* është shënuar *"Nuk ka"*.

**12.4.** Në deklaratën e interesave private ***periodike vjetor të vitit 2017***, të personit të lidhur **Ajola Arben Xoxa (bashkëjetuesja)**, në seksionin *"Ndryshimet e pasurive dhe burimet e krijimit"* ka deklaruar pasuritë si më poshtë vijon:

1. **Llogari bankare BKT nr. 503094870.** **<u>Burimi i krijimit:</u>** Të ardhurat nga ushtrimi i profesionit/punësimi. **<u>Vlera e pasurisë:</u>** 50,253.62 Euro dhe 32,169.41 Lekë. **<u>Pjesa takuese:</u>** Zotërimi 100%.
2. **Llogari bankare San Paolo Bank, nr. 437688735102.** **<u>Burimi i krijimit:</u>** Të ardhura nga ushtrimi i profesionit/punësimi. **<u>Vlera e pasurisë:</u>** 5,497.03 Euro. **<u>Pjesa takuese:</u>** Zotërimi 100%.
3. **Llogari bankare San Paolo Bank, nr. 437688735103.** **<u>Burimi i krijimit:</u>** Të ardhura nga ushtrimi i profesionit/punësimi. **<u>Vlera e pasurisë:</u>** 11,472.64 Lekë. **<u>Pjesa takuese:</u>** Zotërimi 100%.
4. **Llogari bankare San Paolo Bank, nr. 98084938001.** **<u>Burimi i krijimit:</u>** Të ardhura nga paga. **<u>Vlera e pasurisë:</u>** 5,308.41 Euro. **<u>Pjesa takuese:</u>** Zotërimi 50%.
5. **Llogari bankare San Paolo Bank, nr. 98084938002.** **<u>Burimi i krijimit:</u>** Të ardhura nga paga. **<u>Vlera e pasurisë:</u>** 8,302.1 USD. **<u>Pjesa takuese:</u>** Zotërimi 50%.
6. **Llogari bankare San Paolo Bank, nr. 20654835301 në Euro.** **<u>Burimi i krijimit:</u>** Të ardhura nga ushtrimi i profesionit/punësimi. **<u>Vlera e pasurisë:</u>** 33,049.79 Euro. **<u>Pjesa takuese:</u>** Zotërimi 100%.
7. **Llogari bankare San Paolo Bank, nr. 20654835302 në Lekë.** **<u>Burimi i krijimit:</u>** Të ardhura nga ushtrimi i profesionit/punësimi. **<u>Vlera e pasurisë:</u>** 1,875,910 Lekë. **<u>Pjesa takuese:</u>** Zotërimi 100%.

**12.4.1.** Në deklaratën e interesave private ***periodike vjetor të vitit 2017***, të personit të lidhur **Ajola Arben Xoxa (bashkëjetuesja)**, në seksionin *"Të ardhurat dhe angazhimet në veprimtari publike dhe/ose private"* ka deklaruar këto të ardhura si më poshtë vijon:

1. Shërbim konsulence ligjore person fizik, biznes i vogël me NIPT K91503025 N.[7] **Shuma e të ardhurave neto:** 5,706,013 Lekë neto.

[7] Në deklaratën periodike vjetore të vitit 2014 është me këtë NIPT është deklaruar Zyra Ligjore Tushko – Pustina sh.p.k.

**12.4.2.** Në deklaratën e interesave private *periodike vjetor të vitit 2017*, të personit të lidhur **Ajola Arben Xoxa (bashkëjetuesja)**, në seksionin *"Detyrimet financiare ndaj personave juridike dhe fizikë"* dhe *"Shpenzimet e deklarueshme"* nuk rezulton të jetë deklaruar ndonjë detyrim dhe shpenzim i deklarueshëm.

- ***Deklarimi i vjetor i vitit 2018.***

**13.** Në deklaratën e interesave private ***periodike vjetor të vitit 2018*** shtetasi **Erion Veliaj** në seksionin *"Ndryshimet e pasurive dhe burimet e krijimit"* ka deklaruar pasuritë si më poshtë vijon:

1. **Llogari bankare Credins Bank Nr. 491825. Sipas deklarimit në këtë vitë është shtuar kjo llogari me 2348 661 lekë.** **Burimi i krijimit:** Të ardhurat nga paga, dieta dhe rimbursimi i biletave për lëvizjet jashtë shtetit për pjesëmarrjen në aktivitetet ndërkombëtare. **Gjendja e llogarisë në 31.12.2018:** 2.376.710,93 Lekë. **Pjesa takuese:** Zotërimi 100%.
2. **Llogari bankare Credins Bank Nr.12032. Sipas deklarimit në këtë vitë kjo llogari është pakësuar nga deklarimi i mëparshëm me 8.012.24 Euro. Gjendja e llogarisë në 31.12.2018:** 2.124,62 Euro. **Pjesa takuese:** Zotërimi 100%.
3. **Llogari bankare Intesa San Paolo, nr. 98084938001 në Euro**. S'ka ndryshim nga deklarimi i mëparshëm. **Gjendja e llogarisë në 31.12.2018:** 5308.51 Euro. **Pjesa takuese:** Zotërimi 50%.
4. **Llogari bankare Intesa San Paolo në Dollarë, nr. 98084938002. Burimi i krijimit:** Të ardhurat nga paga. **Vlera e pasurisë:** 8,302.10 USD. **Pjesa takuese:** Zotërimi 50%. S'ka ndryshim nga deklarimi i mëparshëm.

**13.1.** Në deklaratën e interesave private ***periodike vjetor të vitit 2018*** shtetasi **Erion Veliaj** në seksionin *"Të ardhurat dhe angazhimet në veprimtari publike dhe/ose private"* ka deklaruar këto të ardhura si më poshtë vijon:

1. Paga- Bashkia e Tiranës. Shuma e të ardhurave: **1,585, 076 Lekë.**

**13.2.** Në deklaratën e interesave private ***periodike vjetor të vitit 2018*** shtetasi **Erion Veliaj** në seksionin *"Detyrimet financiare ndaj personave juridike dhe fizikë"* ka deklaruar:

1. Kredi në bankën Credins me vlerën 6,100,000 Lekë, me afat 180 muaj, e disbursuar me 31.08.2015 dhe përfundon në vitin 2030.Vlera e shlyer nga deklarimi i mëparshëm deri në 31 Dhejtor: 720,766.5 Lekë. Gjëndja e detyrimit të mbetur pa shlyer: **5,323,833.33 Lekë.**[8]
2. Kartë krediti pranë Raiffeisen Bank. Gjëndja e detyrimit **2337.87 Euro.**

**13.3.** Në deklaratën e interesave private ***periodike vjetor të vitit 2018,*** shtetasi **Erion Veliaj** në seksionin *"Shpenzimet e deklarueshme"* është shënuar *"Nuk ka"*.

**13.4.** Në deklaratën e interesave private ***periodike vjetor të vitit 2018,*** të personit të lidhur **Ajola Arben Xoxa (bashkëshortja)**, në seksionin *"Ndryshimet e pasurive dhe burimet e krijimit"* ka deklaruar pasuritë si më poshtë vijon:

[8] Nuk është deklaruar në asnjë deklaratë periodike vjetore qëllimi i kredisë.

1. **Llogari bankare BKT nr. 503094870. Burimi i krijimit:** Të ardhurat nga ushtrimi i profesionit/punësimi. **Vlera e pasurisë:** 54,950.16 Euro. **Pjesa takuese:** Zotërimi 100%.
2. **Llogari bankare San Paolo Bank, nr. 437688735102. Burimi i krijimit:** Të ardhura nga ushtrimi i profesionit/punësimi. **Vlera e pasurisë:** 8,314.72 Euro. **Pjesa takuese:** Zotërimi 100%. Mbyllur llogaria në lekë.
3. **Llogari bankare San Paolo Bank, nr. 98084938001. Burimi i krijimit:** Të ardhura nga paga. **Vlera e pasurisë:** 5308.53 Euro. **Pjesa takuese:** Zotërimi 50%.
4. **Llogari bankare San Paolo Bank, nr. 98084938002. Burimi i krijimit:** Të ardhura nga paga. **Vlera e pasurisë:** 8,309.16 USD. **Pjesa takuese:** Zotërimi 50%.
5. **Llogari bankare San Paolo Bank, nr.** 20654835301 në Euro. **Burimi i krijimit:** Të ardhura nga ushtrimi i profesionit/punësimi. **Vlera e pasurisë:** 5,823.17 Euro. **Pjesa takuese:** Zotërimi 100%.
6. **Llogari bankare San Paolo Bank, nr. 20654835302 në Lekë. Burimi i krijimit:** Të ardhura nga ushtrimi i profesionit/punësimi. **Vlera e pasurisë:** 5,495,881.56 Lekë. **Pjesa takuese:** Zotërimi 100%.
7. Kontratë shitje pasurie të paluajtshme, apartament 107 m2, Rr. Brigada 8, Tiranë, ZK 8270, pranë notere Mimoza Sadushi, Nr. 98 Rep. Nr. 51 Kol., dt. 11.01.2018. **Vlera 105,000 Euro.**[9]
8. Pas mbylljes se NIPTI-t person fizik K91503025N është themeluar shoqëria e re me përgjegjësi të kufizuar "The Partners Laë Firm". Kapitali i shoqërisë i barabartë me 100 Lekë. Zotërimi 100%.

**13.4.1.** Në deklaratën e interesave private *periodike vjetor të vitit 2017*, të personit të lidhur **Ajola Arben Xoxa (bashkëshortja)**, në seksionin *"Të ardhurat dhe angazhimet në veprimtari publike dhe/ose private"* ka deklaruar këto të ardhura si më poshtë vijon:

1. Te ardhura nga aktiviteti konsulence ligjore, biznes me NIPT: K91503025N (i mbyllur). **Shuma e të ardhurave: 7,385,251 Lekë.**
2. Të ardhura sipas kontratës për konsulentë përfaqësuese për Shqipërinë, me Energy Community Secretariat (Sekretariati i Komunitetit të Energjisë, agjenci e Komisionit Europian). Shuma e të ardhurave: **20,825 Euro.**
3. Të ardhura nga qiradhënia. **Shuma 3000 Euro.**

**13.4.2.** Në deklaratën e interesave private *periodike vjetor të vitit 2017*, të personit të lidhur **Ajola Arben Xoxa (bashkëshortja)**, në seksionin *"Detyrimet financiare ndaj personave juridike"* nuk rezulton të jetë deklaruar ndonjë detyrim.

**13.4.3.** Në deklaratën e interesave private *periodike vjetor të vitit 2018*, të personit të lidhur **Ajola Arben Xoxa (bashkëshortja)**, në seksionin *"Shpenzimet e deklarueshme"* është deklaruar se:

1. 2 pagesa secila nga 35,000 Euro (Total 70,000 Euro) për blerjen e apartamentit 107 m2, Rr. Brigada 8, Tiranë, ZK 8270, Kontrata 98 Rep. nr. 51 Kol, dt. 11.01.2018, noter Mimoza Sadushi.

[9] Nuk deklarohet se kush është burimi i krijimit të kësaj pasurie.

**13.4.4.** Në deklaratën e interesave private *periodike vjetor të vitit 2018,* të personit të lidhur **Ajola Arben Xoxa (bashkëshortja)**, në seksionin *"Të dhënat konfidenciale"* është deklaruar se:

1. Lidhur me kontratën e shitblerjes si më sipër, vlera totale e kontratës është 105,000 Euro. Ajola Xoxe ka paguar në total 70,000 Euro, konkretisht: **i)** është transferuar më datë 23.01.2018 nga llogaria e saj në Bankën Kombëtare Tregtare (BKT), Tiranë. Sipas Kontratës së shitjes (pjesa e parë e pagesës, nga tre); **ii)** është transferuar më datë 23.01.2018 nga llogaria e saj në Bankën Intesa San Paolo Bank, Tiranë. Sipas Kontratës së shitjes (pjesa e dytë e pagesës, nga tre); **iii) ndërsa pjesa tjetër 35,000 Euro ka deklaruar se është shlyer nga babai Arben Xoxa.** Pra, çmimi i kontratës është tashmë i shlyer plotësisht dhe disponon çertifikatën e pronësisë.
2. Gjithashtu ka sqaruar se karta e kreditit, lidhur me dy llogaritë pranë Intesa San Paolo Bank, është përdorur ndër të tjera për të kryer pagesa lidhur për disa blerje për shoqërinë aksionare Botimet Enciklopedike SHA, shoqëri ku Arben Xoxa zotëron 77.2 % të kapitalit. Shoqëria ka për të shlyer ndaj Ajola Xoxës shumën prej 8,719 Euro në vititn 2019.

- ***Deklarimi i vjetor i vitit 2019.***

**14.** Në deklaratën e interesave private *periodike vjetor të vitit 2019* shtetasi **Erion Veliaj** në seksionin *"Ndryshimet e pasurive dhe burimet e krijimit"* ka deklaruar pasuritë si më poshtë vijon:

1. **Llogari bankare Credins Bank Nr. 491825. Sipas deklarimit në këtë vitë është shtuar kjo llogari me 1 292 364.88 lekë.** **Burimi i krijimit:** Të ardhurat nga paga, dieta dhe rimbursimi i biletave për lëvizjet jashtë shtetit për pjesëmarrjen në aktivitetet ndërkombëtare. **Gjendja e llogarisë në 31.12.2019:** 3.669.075,18 Lekë. **Pjesa takuese:** Zotërimi 100%.
2. **Llogari bankare Credins Bank Nr.12032. Sipas deklarimit në këtë vitë është kjo llogari pakësuar nga deklarimi i mëparshëm me 2096.98 Euro. Gjendja e llogarisë në 31.12.2019:** 27.64 Euro. **Pjesa takuese:** Zotërimi 100%.
3. **Llogari bankare Intesa San Paolo, nr. 98084938001 në Euro,** ka kaluar në pronësi të bashkëshortes së tij Ajola Xoxa.
4. **Llogari bankare Intesa San Paolo në Dollarë, nr. 98084938002** ka kaluar në pronësi të bashkëshortes së tij Ajola Xoxa.

**14.1.** Në deklaratën e interesave private *periodike vjetor të vitit 2019* shtetasi **Erion Veliaj** në seksionin *"Të ardhurat dhe angazhimet në veprimtari publike dhe/ose private"* ka deklaruar këto të ardhura si më poshtë vijon:

1. Paga- Bashkia e Tiranës. Shuma e të ardhurave: **1.591.120 Lekë.**

**14.2.** Në deklaratën e interesave private *periodike vjetor të vitit 2019* **shtetasi Erion Veliaj** në seksionin *"Detyrimet financiare ndaj personave juridike dhe fizikë"* ka deklaruar:



SEKRETARIA

1. Kredi në bankën Credins me vlerën 6,100,000 Lekë, me afat 180 muaj, e disbursuar me 31.08.2015 dhe përfundon në vitin 2030. **Vlera e shlyer nga deklarimi i mëparshëm deri në 31 Dhejtor: 720,840 Lekë.** Gjëndja e detyrimit të mbetur pa shlyer: **5,044,754.61 Lekë.**
2. Kartë krediti pranë Raiffeisen Bank me limit 5000 euro. Gjendja e detyrimit për tu shlyer në 31 dhjetor 2019 është 541.86 euro. Gjendja e mbetur në kartë krediti më 31 dhjetor 2019 është 4458.14 euro.

**14.3.** Në deklaratën e interesave private *periodike vjetor të vitit 2019,* shtetasi **Erion Veliaj** në seksionin *"Shpenzimet e deklarueshme"* është shënuar *"Nuk ka".*

**14.4. Mbështetur në deklarimin e bërë nga vetë shtetasi Erion Veliaj në këtë deklaratë pasurie, ky i fundit rezulton me mungesë të burimeve të ligjshme për krijimin e pasurive, sepse niveli i kursimeve dhe i shpenzimeve është më i lartë se totali i të ardhurave vjetore, pa llogaritur shpenzimet e jetesës. Kështu, totali i të ardhurave është 1.591.120 Lekë ndërkohë që totali i shpenzimeve vetëm për shtimin e të ardhurave të llogarinë bankare pranë Credins Bank Nr. 491825 dhe për shlyerjen e kredisë është: 2.013.204.88 (dy milion e trembëdhjetë mijë e dyqind e katër pikë tetëdhjetë e tetë) lekë (1 292 364.88 lekë (kursim në llogari bankare + 720,840 Lekë (shlyerje e kredisë). Kjo bën që për këtë vitë shtetasi Erion Veliaj të ketë mungesë të burimeve të ligjshme për të justifikuar krijimin e pasurive në vlerën 422, 084.88 lekë, duke mos llogaritur shpenzimet e minimumit jetik sipas INSTAT, e cila do ta thellonte edhe më tej bilancin. Në këtë përfundim arrihet duke pasur parasysh faktin që në krijimin e llogarisë bankare nuk është deklaruar ndonjë burim tjetër që vjen nga të ardhurat e bashkëshortes. Pra, nga kontrolli aritmetik e logjik rezulton kjo deklaratë pasurie është me probleme.**

**14.5.** Në deklaratën e interesave private *periodike vjetor të vitit 2019,* të personit të lidhur **Ajola Arben Xoxa (bashkëshortja)**, në seksionin "*Ndryshimet e pasurive dhe burimet e krijimit*" ka deklaruar pasuritë si më poshtë vijon:

1. **Llogari bankare BKT nr. 503094870.** **__Burimi i krijimit:__** Të ardhurat nga ushtrimi i profesionit/punësimi. **__Vlera e pasurisë:__** 61,466.75 Euro. **__Pjesa takuese:__** Zotërimi 100%.
2. **Llogari bankare San Paolo Bank, nr. 437688735102.** **__Burimi i krijimit:__** Të ardhura si pasojë e çeljes së trashëgimisë ligjore të babait, pas ndarjes së tij nga jeta (sipas të dhënave konfidenciale listuar më tej në këtë deklaratë); Të ardhura nga ushtrimi i profesionit/punësimit/dividenti; Mbyllje llogarie në Intesa Sanpaolobank Nr. 20654835301/02 në Euro dhe Lekë (kutiza nr. 3 më poshtë) dhe kaluar shumat te kjo llogari; Mbyllje llogarive në emrin e saj dhe të bashkëshortit (Erion Veliaj) në San Paolo Bank në Euro dhe në USD dhe kalimi në këtë llogari. **__Vlera e pasurisë:__** 98.613.74 Euro. **__Pjesa takuese:__** Zotërimi 100%.
3. **Llogari bankare San Paolo Bank, nr. 20654835301/02 në Euro** dhe Lekë janë mbyllur dhe fondet janë transferuar në llogarinë në emrin e saj në të njëjtën bank, San Paolo Intesa Bank Nr. **43768735102.**

4. **Llogari bankare San Paolo Bank, nr. 98084938001 në Euro,** më parë 50% në pronësinë e saj dhe 50% në pronësinë e bashkëshortit të saj Erion Veliaj është mbyllur dhe shuma e plotë në Euro ka kaluar në llogarinë e saj primare në Euro.
5. **Llogari bankare San Paolo Bank, nr. 98084938002 në USD,** më parë 50% në pronësinë e saj dhe 50% në pronësinë e bashkëshortit të saj Erion Veliaj, pas konvertimit nga USD në Euro, është mbyllur dhe shuma e plotë ka kaluar në llogarinë e saj primare në Euro Nr. 2065483501.
6. **Llogari bankare Banka Credins 00001196381 në Euro.** **Burimi i krijimit:** Të ardhurat si pasojë e çeljes së trashëgimisë ligjore të babait pas ndarjes së tij nga jeta.**Vlera e pasurisë:** 100,839.86 Euro**. Pjesa takuese:** Zotërimi 100%.
7. 2314 aksione të shoqëris aksionare me NIPT: J61807025P nga trashëgimia ligjore pas ndarjes nga jeta të babait Arben Xoxa.
8. 3/24 Trual, ZVRPP, ZK 1414, nr. pasurie 25, 2940m2, nga trashëgimia ligjore pas ndarjes nga jeta të babait Arben Xoxa.

**14.5.1.** Në deklaratën e interesave private *periodike vjetor të vitit 2019,* të personit të lidhur **Ajola Arben Xoxa (bashkëshortja),** në seksionin *"Të ardhurat dhe angazhimet në veprimtari publike dhe/ose private"* ka deklaruar këto të ardhura si më poshtë vijon:

1. Të ardhura nga shpk-ja me nipt L81829013O "Partners Law", (shërbime juridike/zyrë ligjore). Shuma e të ardhurave: **1,680,000 Lekë.**
2. Paga Shoqëria Aksionare me NIPT: J61807025P BOTIMET ENCIKLOPEDIKE. **Shuma e të ardhurave: 851,116 lekë.**
3. Të ardhura nga qiradhënia: **Shuma 6,000 Euro.**
4. **Divident Shoqëria Aksionare me nipt** NIPT: J61807025P BOTIMET ENCIKLOPEDIKE (dividentë të pashpërndarë në vite, deri në vitin 2018). **Shuma 3,497,456 lekë.**
5. **Divident shoqëria Aksionare me nipt** NIPT: J61807025P BOTIMET ENCIKLOPEDIKE. **Shuma 417,461 lekë.**
6. Divident shpk me nipt: L81829013O (Partners Law) për vitin 2019. **Shuma: 5,355,861 Lekë.**
7. Pagë OST (Operatori i sistemit të transmetimit) (3 muaj). **Shuma: 300,111 Lekë.**

**14.5.2.** Në deklaratën e interesave private *periodike vjetor të vitit 2019,* të personit të lidhur **Ajola Arben Xoxa (bashkëshortja),** në seksionin *"Detyrimet financiare ndaj personave juridike"* nuk rezulton të jetë deklaruar ndonjë detyrim.

**14.5.3.** Në deklaratën e interesave private *periodike vjetor të vitit 2019,* të personit të lidhur **Ajola Arben Xoxa (bashkëshortja),** në seksionin *"Shpenzimet e deklarueshme"* është deklaruar se *"Nuk ka".*

**14.5.4.** Në deklaratën e interesave private *periodike vjetor të vitit 2019,* të personit të lidhur **Ajola Arben Xoxa (bashkëshortja),** në seksionin *"Të dhënat konfidenciale"* është deklaruar se si pasojë e ndarjes nga jeta të babait Arben Xoxa, më 24 Shkurt 2019 dhe çeljes së trashëgimisë ligjore përmes vendimit noterial nr. 1257 rep., nr. 505 kol, "Vendim për lëshimin e trashëgimisë ligjore", 18 Mars 2019, është njohur trashëgimtare për të gjitha pasuritë trashëgimore të tij, në masën ½ . Ku ka trashëguar: **1)** 2314 aksione të shoqërisë



SHPYETUET.AL

aksionare me nipt NIPT: J61807025P BOTIMET ENCIKLOPEDIKE; **2)** 25,000 Euro në Bankën Credins; **3)** 1,095 Euro në Bankën Credins; **4)** 46,483 Euro si pasojë e konvertimit të obligacioneve të konvertueshme në bankën Credins; **5)** 10 Euro në bankën Credins; **6)** 13,161 Euro në Bankën Intesa San Paolo; **7)** ¼ e apartamenteve nr. 3/561/ND+1-4, nr. 3/572/ND+1-4, ZK 8270 të cilat ia ka kaluar mamasë me dhurim; **8)** ¼ e apartamentit nr. 3/117+2-28, ZK 8270, të cilën ia ka kaluar mamasë me dhurim; **9)** ¼ e apartamentit nr. 118/8/7+1-5, ZK 3292, të cilin ia ka kaluar mamasë me dhurim; **10)** 3/24 truall, Fier, nr. 25, ZK 1414, 2940m2.

- ***Deklarimi i vjetor i vitit 2020.***

**15.** Në deklaratën e interesave private ***periodike vjetor të vitit 2020*** shtetasi **Erion Veliaj** në seksionin *"Ndryshimet e pasurive dhe burimet e krijimit"* ka deklaruar pasuritë si më poshtë vijon:

1. **Llogari bankare Credins Bank Nr. 491825. Sipas deklarimit në këtë vitë është shtuar kjo llogari me 643,181.97 lekë.** **Burimi i krijimit:** Të ardhurat nga paga, dieta dhe rimbursimi i biletave për lëvizjet jashtë shtetit për pjesëmarrjen në aktivitetet ndërkombëtare. **Gjendja e llogarisë në 31.12.2020:** 4,312,257.15 Lekë. **Pjesa takuese:** Zotërimi 100%.
2. **Llogari bankare Credins Bank Nr.12032. Gjendja e llogarisë në 31.12.2020:** 15.44 Euro. **Pjesa takuese:** Zotërimi 100%.

**15.1.** Në deklaratën e interesave private ***periodike vjetor të vitit 2020*** shtetasi **Erion Veliaj** në seksionin *"Të ardhurat dhe angazhimet në veprimtari publike dhe/ose private"* ka deklaruar këto të ardhura si më poshtë vijon:

1. Paga- Bashkia e Tiranës. Shuma e të ardhurave: 1,458,710 Lekë.

**15.2.** Në deklaratën e interesave private ***periodike vjetor të vitit 2020*** shtetasi **Erion Veliaj** në seksionin *"Detyrimet financiare ndaj personave juridike dhe fizikë"* ka deklaruar:

1. Kredi në bankën Credins me vlerën 6,100,000 Lekë, me afat 180 muaj, e disbursuar me 31.08.2015 dhe përfundon në vitin 2030. Vlera e shlyer nga deklarimi i mëparshëm deri në 31 Dhejtor: 720,815 Lekë. Gjëndja e detyrimit të mbetur pa shlyer: **4,741,020.55 Lekë.**
2. Kartë krediti pranë Raiffeisen Bank: Gjëndja e detyrimit 0 Euro.

**15.3.** Në deklaratën e interesave private ***periodike vjetor të vitit 2020,*** shtetasi **Erion Veliaj** në seksionin *"Shpenzimet e deklarueshme"* është shënuar *"Nuk ka"*.

**15.4.** Në deklaratën e interesave private ***periodike vjetor të vitit 2020,*** të personit të lidhur **Ajola Arben Xoxa (bashkëshortja)**, në seksionin *"Ndryshimet e pasurive dhe burimet e krijimit"* ka deklaruar pasuritë si më poshtë vijon:

1. **Llogari bankare BKT nr. 503094870. Burimi i krijimit:** Të ardhurat nga ushtrimi i profesionit/punësimi. **Shtuar vlera e pasurisë: 19,727.4 Euro. Pjesa takuese:** Zotërimi 100%.
2. **Llogari bankare San Paolo Bank, nr. 437688735102. Burimi i krijimit:** Të ardhura si pasojë e celjes së trashëgimisë ligjore të babait, pas ndarjes së tij nga

jeta. Të ardhura nga ushtrimi i profesionit/punësimit/dividenti. **<u>Shtuar vlera e pasurisë:</u>** 42,512.25 Euro. **<u>Pjesa takuese:</u>** Zotërimi 100%.

**15.4.1.** Në deklaratën e interesave private ***periodike vjetor të vitit 2020,*** të personit të lidhur **Ajola Arben Xoxa (bashkëshortja)**, në seksionin *"Të ardhurat dhe angazhimet në veprimtari publike dhe/ose private"* ka deklaruar këto të ardhura si më poshtë vijon:

1. Të ardhura nga shpk-ja me nipt L81829013O "Partners Law", (shërbime juridike/zyrë ligjore). **Shuma e të ardhurave: 13,408.73 Euro.**
2. Paga Shoqëria Aksionare me NIPT: J61807025P BOTIMET ENCIKLOPEDIKE. **Shuma e të ardhurave: 9,679 Euro.**
3. Të ardhura nga qiradhënia: **Shuma 6,000 Euro.**
4. **Divident Shoqëria Aksionare me nipt** NIPT: J61807025P BOTIMET ENCIKLOPEDIKE (dividentë të pashpërndarë në vite, deri në vitin 2018). **Shuma 51,885 Euro.**
5. Pagë OST (Operatori i sistemit të transmetimit) (2 muaj). **Shuma: 1,644.6 Euro.**
6. Pagesë kontrate nga ECA (Economic Consulting Associates) shoqëri e bazuar në Londer, si pasojë e drejtimit të një projekti të financuar nga BERZH. **Shuma: 6,300 Euro.**

**15.4.2.** Në deklaratën e interesave private ***periodike vjetor të vitit 2020,*** të personit të lidhur **Ajola Arben Xoxa (bashkëshortja)**, në seksionin *"Detyrimet financiare ndaj personave juridike"* nuk rezulton të jetë deklaruar ndonjë detyrim.

**15.4.3.** Në deklaratën e interesave private ***periodike vjetor të vitit 2020,*** të personit të lidhur **Ajola Arben Xoxa (bashkëshortja)**, në seksionin *"Shpenzimet e deklarueshme"* është deklaruar se:

1. Gjatë vitit 2020 përmes kartës së debitit lidhur me llgoarinë rrjedhëse pranë San Paolo Bank ka shpenzuar shumën prej 14,054 Euro, për blerjen e sendeve të ndryshme për përdorim familjar dhe personal.

**15.4.4.** Në deklaratën e interesave private ***periodike vjetor të vitit 2020,*** të personit të lidhur **Ajola Arben Xoxa (bashkëshortja)**, në seksionin ***"Të dhënat konfidenciale"*** është deklaruar se:

1. Si pasojë e ndarjes së jeta të babait, ka trashëguar prej tij në vitin 2020 pasuri truall 546.12 m2 me ndërtesë 130 m, ZVRPP DR Tirana Veri, nr. 3/173, ZK 8150, Vol 18, fq. 180, pjesë takuese 36/720. **Këtë pronë e ka shitur te Valmir (Agron) Xoxa për vlerën e barabartë me 40,000 Euro. Asnjë pagesë për këtë shumë nuk është kryer në vitin 2020.**
2. Si pasojë e ndarjes së jeta të babait, ka trashëguar prej tij në vitin 2020 pasuri truall 369 m2, me ndërtesë 147 m2, ZVRPP DR Tirana Veri, nr. 3/197, ZK 8150, Vol. 20, fq. 117, pjesa takuese 36/720. **Këtë pronë e ka shitur te Valmir (Agron) Xoxa për vlerën e barabartë me 20,000 Euro. Asnjë pagesë për këtë shumë nuk është kryer në vitin 2020.**

3. Aktualisht te shoqëria Botiet Enciklopedike ka 2410 aksione. (2314 trëshëguar nga babai, 87 aksione të blera nga Spiro Kote, me vlerën 140,000 lekë, 9 aksione të blera nga Engjell Licaj, për vlerën 1000 Euro.).
4. Në vijim të deklarimt të pasurisë për vitin 2018, shoqëria Botimet Enciklopedike akoma nuk ka shlyer borxhin e barabartë prej 8,719 Euro.

- ***Deklarimi i vjetor i vitit 2021.***

**16.** Viti 2021 është viti i parë ku subjektet e deklarimit kanë bërë deklarimin periodik vjetor në formatin elektronik. Gjithashtu, në rubrikën e deklarimit të aseteve në këtë deklaratën nuk deklarohen shtesat mbi pasuritë nga viti i kaluar, por **deklarohen dhe përshkruhen hollësisht të gjitha pasuritë e akumuluara ndër vite sipas gërmës a, b, c, ç, d të Ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003, i ndryshuar, burimet e krijimit të tyre dhe të drejtat reale sipas Kodit Civil e cila është gjendje deri më datë 31.12.2021.** Ndodhur në këto kushte, shtetasi **Erion Veliaj** në seksionin "*Deklarimi i pasurive dhe burimet e krijimit*" ka deklaruar pasuritë si më poshtë vijon:

1. Apartament **nr.2/543+1-29, TR-N-13, ZK 8150, ZK 8150, Vol 50, faqe 34., 111.2 m2, Rr. Hoxha Tahsim, Tiranë.** **Vlera e pasurisë: 5,115,200 Lekë.** **Burimi i krijimit**: Shuma për blerjen e këtij apartamenti janë krijuar nga kursimet familjare, si dhe shitja e apartamentit të vjetër në pronësi të prindërve.
2. Llogari bankare Credins Bank Nr. 491825. **Burimi i krijimit**: Të ardhurat nga paga ndër vite dhe shpërblimet/dietat nga udhëtimet dhe shërbimet jashtë. **Pjesa takuese** 100%. **Balanca 31.12.2021: 3, 200,543.73 Lekë.**

**16.1.** Në deklaratën e interesave private ***periodike vjetor të vitit 2021*** shtetasi **Erion Veliaj** në seksionin "*Të ardhurat dhe angazhimet në veprimtari publike dhe/ose private*" ka deklaruar këto të ardhura si më poshtë vijon:

1. Paga- Bashkia e Tiranës. Shuma e të ardhurave: **1,536,208.00 ALL.**
2. Të ardhura nga shpërblimet Bashkia Tiranë. Shuma e të ardhurave: **743,380 All.**

**16.2.** Në deklaratën e interesave private ***periodike vjetor të vitit 2021*** shtetasi **Erion Veliaj** në seksionin "*Detyrimet financiare ndaj personave juridike dhe fizikë*" ka deklaruar:

1. Kredi në bankën Credins me vlerën 6,100,000 Lekë, me afat 180 muaj, e disbursuar me 31.08.2015 dhe përfundon në vitin 2030. Vlera e shlyer nga deklaruesi i mëparshëm deri në 31 Dhejtor: 330,588.36 Lekë. Gjëndja e detyrimit të mbetur pa shlyer: **4,41,432.19 Lekë.**
2. Kartë krediti pranë Raiffeisen Bank: Gjëndja e detyrimit 0 Euro.

**16.3.** Në deklaratën e interesave private ***periodike vjetor të vitit 2021,*** shtetasi **Erion Veliaj** në seksionin "*Shpenzimet e deklarueshme*" është shënuar "*Nuk ka*".

**16.4.** Në deklaratën e interesave private ***periodike vjetor të vitit 2020,*** të personit të lidhur **Ajola Arben Xoxa (bashkëshortja)**, në seksionin "*Deklarimi i pasurive dhe burimet e krijimit*" ka deklaruar pasuritë si më poshtë vijon:

1. Pasuri e paluajtshme apartament, nr. 109/239+7-9, ZK 3292, vol 46, faqe 65, 162 m2, adresa Kodra e Diellit, porositur te AGIKONS në vitin 2012. **Vlera: 88,641 EUR. Burimi i krijimit:** Të ardhura nga prindërit shuma 57,000 Euro (pagesat nga prindërit), të ardhura nga punësimi dhe biznesi shuma 31,641.00 Euro.
2. Truall, nr. pasurie 25, ZK 1414, Fier, sip. 2940 m2, pjesa takuese: 12.5%. **Burimi i krijimit:** Me trashëgimi.
3. Apartament me nr. pasurie 2/461+1-32, ZK 8270, Vol 33, faqe 236, Rr. "Brigada 8", Tiranë. Pjesa takuese 100%. **Vlera: 105,000.00 Euro. Burimi i krijimit:** 35,000 Euro pagesa e kryer nga babai. Të ardhura 70,000 Euro, të ardhura nga punësimi dhe biznesi.
4. Aksione te subjekti Tregtar Partners LAW SHPK. **Pjesa takuese:** 100%.
5. Aksione te Botimet Enciklopedike SHA. Pjesa takuese 19.8%. Vlera: **2,410,000 lekë.**
6. Llogari Bankare INTESA SAN PAOLO BANK, me nr. 4376735102, llogari rrjedhëse. Balanca: **196,699.91 Euro. Burimi i krijimit:** Të ardhura nga trashëgimia si dhe punësimi dhe bizneset dhe shpërndarje dividenti.
7. Llogari Bankare CREDINS BANK, me nr. 00001196381, llogari rrjedhëse. Balanca: **100,839.53 Euro. Burimi i krijimit:** Të ardhura nga trashëgimia si dhe punësimi dhe bizneset dhe shpërndarje dividenti.
8. Llogari Bankare BANKA KOMBETARE TREGTARE, me nr. 503094870CLIDCFEUREK. Balanca: **203,997.00 Euro. Burimi i krijimit:** Krijuar nga kalimi i trashëgimisë pas vdekjes së babait, punësimi si dhe të ardhurat nga biznesi dhe shpërndarja e dividentëve. **Gjithashtu është derdhur edhe shuma e shitjes së 2 pasurive nr.** 3/197 (truall + ndërtesë) dhe nr. 3/175 (truall + ndërtesë), me kontratë shitje nr. 3333 rep., nr. 1457 kol. Dt. 21.12.2020, deklaruar paraprakisht në deklaratën e vitit 2020. Shuma e derdhur **60,000 Euro.**

**16.4.1.** Në deklaratën e interesave private *periodike vjetor të vitit 2021,* të personit të lidhur **Ajola Arben Xoxa (bashkëshortja)**, në seksionin *"Të ardhurat dhe angazhimet në veprimtari publike dhe/ose private"* ka deklaruar këto të ardhura si më poshtë vijon:

1. Të ardhura nga shpk-ja me nipt L81829013O "Partners Law", (shërbime juridike/zyrë ligjore). **Shuma e të ardhurave: 14,400 Euro.**
2. Paga Shoqëria Aksionare me NIPT: J61807025P BOTIMET ENCIKLOPEDIKE. **Shuma e të ardhurave: 12,000 Euro.**
3. Të ardhura nga qiradhënia **Qëndra Harabel: Shuma 10,800 Euro.**
4. **Të ardhura nga shitja e pasurive të paluajtshme: 2 pasurive nr. 3/197** (truall + ndërtesë) dhe nr. 3/175 (truall + ndërtesë), me kontratë shitje nr. 3333 rep., nr. 1457 kol. Dt. 21.12.2020, deklaruar paraprakisht në deklaratën e vitit 2020. Shuma e derdhur **60,000 Euro.**

**16.4.2.** Në deklaratën e interesave private *periodike vjetor të vitit 2021,* të personit të lidhur **Ajola Arben Xoxa (bashkëshortja),** në seksionin *"Detyrimet financiare ndaj personave juridike" dhe "Shpenzimet e deklarueshme"* nuk rezulton të jetë deklaruar ndonjë detyrim apo shpenzim i deklarueshëm.

- ***Deklarimi i vjetor i vitit 2022.***

17. Në deklaratën e interesave private ***periodike vjetor të vitit 2022*** shtetasi **Erion Veliaj** në seksionin *"Ndryshimet e pasurive dhe burimet e krijimit"* ka deklaruar pasuritë si më poshtë vijon:

1. **Llogari bankare Credins Bank Nr. 491825.** Sipas deklarimit në këtë vitë është pakësuar kjo llogari me 2,118,377.00 lekë. **Burimi i krijimit:** Të ardhurat nga paga. **Gjendja e llogarisë në 31.12.2022:** 1,082,165.75 Lekë. **Pjesa takuese:** Zotërimi 100%.

**17.1.** Në deklaratën e interesave private ***periodike vjetor të vitit 2022*** shtetasi **Erion Veliaj** në seksionin ***"Të ardhurat dhe angazhimet në veprimtari publike dhe/ose private"*** ka deklaruar këto të ardhura si më poshtë vijon:

1. Paga- Bashkia e Tiranës. Shuma e të ardhurave: **1,577,598.00 Lekë.**
2. Të ardhura nga shpërblimet-Bashkia e Tiranës, Kryetar i Bashkisë. Të ardhura nga diteta dhe udhëtimet jashtë vendit. Shuma e të ardhurave: **1,668,971 Lekë.**

**17.2.** Në deklaratën e interesave private ***periodike vjetor të vitit 2022*** shtetasi **Erion Veliaj** në seksionin *"Detyrimet financiare ndaj personave juridike dhe fizikë"* ka deklaruar:

1. Kredi në bankën Credins me vlerën 6,100,000 Lekë, me afat 180 muaj, e disbursuar me 31.08.2015 dhe përfundon në vitin 2030. Vlera e shlyer nga deklarimi i mëparshëm deri në 31 Dhjetor: **724,150 Lekë**. Gjëndja e detyrimit të mbetur pa shlyer: **4,052,739.77 Lekë.**
2. Kartë krediti pranë Raiffeisen Bank: Gjëndja e detyrimit 0 Euro.

**17.3.** Në deklaratën e interesave private ***periodike vjetor të vitit 2022,*** shtetasi **Erion Veliaj** në seksionin *"Shpenzimet e deklarueshme"* është shënuar *"Nuk ka"*.

**17.4.** Në deklaratën e interesave private ***periodike vjetor të vitit 2022,*** të personit të lidhur **Ajola Arben Xoxa (bashkëshortja)**, në seksionin *"Ndryshimet e pasurive dhe burimet e krijimit"* ka deklaruar pasuritë si më poshtë vijon:

1. Llogari Bankare INTESA SAN PAOLO BANK, me nr. 4376735102, llogari rrjedhëse. **Shtuar me 2,207.74 Euro.** Balanca: **198,907.65 Euro. Burimi:** Të ardhura paga dhe si pagesë drejtim projekti.
2. Llogari Bankare BANKA KOMBETARE TREGTARE, me nr. 503094870CLIDCFEUREK. **Shtuar me: 23,996.85 Euro.** Balanca: **227,993.85 Euro. Burimi:** Të ardhura nga paga si dhe nga qiradhënia e Qëndrës Harabel.

**17.4.1.** Në deklaratën e interesave private ***periodike vjetor të vitit 2022,*** të personit të lidhur **Ajola Arben Xoxa (bashkëshortja)**, në seksionin *"Të ardhurat dhe angazhimet në veprimtari publike dhe/ose private"* ka deklaruar këto të ardhura si më poshtë vijon:

1. Të ardhura nga si drejtuese Projekti BALKAN YOUTH LINK. Shuma e të ardhurave neto: **340,000 Lekë.**
2. **Të ardhura nga qeraja Qëndra Harabel:** Shuma e të ardhurave neto: **12,000 Euro.**

3. Të ardhura nga paga Botimet Enciklopedike SHA. Shuma e të ardhurave neto: **12,000 Euro.**
4. Të ardhura nga paga PARTNERS LAË SHPK. Shuma e të ardhurave neto: **14,400.00 Euro.**

**17.4.2.** Në deklaratën e interesave private ***periodike vjetor të vitit 2022,*** të personit të lidhur **Ajola Arben Xoxa (bashkëshortja)**, në seksionin *"Detyrimet financiare ndaj personave juridike"* nuk rezulton të jetë deklaruar ndonjë detyrim.

**17.4.3.** Në deklaratën e interesave private ***periodike vjetor të vitit 2022,*** të personit të lidhur **Ajola Arben Xoxa (bashkëshortja)**, në seksionin *"Shpenzimet e deklarueshme"* ka shënimet: *"Me kartën time të debitit (e lidhur me llogarinë rrjedhëse pranë Intesa San Paolo Bank) në datën 20.04.2022 është kryer pagesa prej **1,911.74** Euro në Booking..com, për prenotim, pagesën e disa netëve qëndrim të stafit të organizatës Harabel në Venezia. Rimbursimi i kësaj shume nga Harabel është kryer në vitin 2023."*.

- ***Deklarimi i vjetor i vitit 2023.***

**18.** Në deklaratën e interesave private ***periodike vjetor të vitit 2023*** shtetasi **Erion Veliaj** në seksionin *"Ndryshimet e pasurive dhe burimet e krijimit"* ka deklaruar pasuritë si më poshtë vijon:

1. **Llogari bankare Credins Bank Nr. 491825**. Sipas deklarimit në këtë vitë është pakësuar kjo llogari me 162,634.94 lekë. **Burimi i krijimit:** Të ardhurat nga paga. **Gjendja e llogarisë në 31.12.2023:** 919,531.79 Lekë. **Pjesa takuese:** Zotërimi 100%.

**18.1.** Në deklaratën e interesave private ***periodike vjetor të vitit 2023*** shtetasi **Erion Veliaj** në seksionin *"Të ardhurat dhe angazhimet në veprimtari publike dhe/ose private"* ka deklaruar këto të ardhura si më poshtë vijon:

1. Të ardhura nga pjesëmarrja në borde dhe këshilla drejtues FSHZ (Fondi Shqiptar i Zhvillimit). Shuma e të ardhurave: **34,000 Lekë.** Të ardhura si anëtar i bordit në FSHZH.
2. Paga- Bashkia e Tiranës. Shuma e të ardhurave: **2,402,208.00 Lekë.**
3. Të ardhura nga shpërblimet-Bashkia e Tiranës, Kryetar i Bashkisë. Të ardhura nga diteta dhe udhëtimet jashtë vendit. Shuma e të ardhurave: **1,692,352.00 Lekë.**

**18.2.** Në deklaratën e interesave private ***periodike vjetor të vitit 2023*** shtetasi **Erion Veliaj** në seksionin *"Detyrimet financiare ndaj personave juridike dhe fizikë"* ka deklaruar:

1. Kredi në bankën Credins me vlerën 6,100,000 Lekë, me afat 180 muaj, e disbursuar me 31.08.2015 dhe përfundon në vitin 2030. Vlera e shlyer nga deklarimi i mëparshëm deri në 31 Dhejtor: **731,041.96 Lekë.** Gjëndja e detyrimit të mbetur pa shlyer: **3,665,864.41 Lekë.**
2. Kartë krediti pranë Raiffeisen Bank: Gjëndja e detyrimit 0 Euro.

**18.3.** Në deklaratën e interesave private ***periodike vjetor të vitit 2023,*** shtetasi **Erion Veliaj** në seksionin *"Shpenzimet e deklarueshme"* është shënuar *"Nuk ka"*.

**18.4.** Në deklaratën e interesave private *periodike vjetor të vitit 2023*, të personit të lidhur **Ajola Arben Xoxa (bashkëshortja)**, në seksionin *"Ndryshimet e pasurive dhe burimet e krijimit"* ka deklaruar pasuritë si më poshtë vijon:

1. Llogaria Bankare CREDINS, 00001196381: Balanca: **100,839.53 Euro. Kjo llogari ka kaluar si llogari depozitë.**
2. Llogari Bankare INTESA SAN PAOLO BANK, me nr. 4376735102, llogari rrjedhëse. Balanca: **198,907.65 Euro. Shtuar deri 31.12.2023 me 66,652.20 Euro. Burimi:** Të ardhura paga dhe si pagesë drejtim projekti. Ky shtim i llogarisë ka ardhur si pasojë e pagës si e punësuar (administratore) të Studio Ligjore "Partners Law" SHPK.
3. Llogari Bankare BANKA KOMBETARE TREGTARE, me nr. 503094870CLIDCFEUREK. Balanca dt. 31.12.2022 **227,993.85 Euro. Shtuar deri dt. 31.12.2023 me: 24,002.36 Euro.**[10] **Burimi:** Të ardhura nga paga Botimet Enciklopedike SHA, plus qiradhënia.

**18.4.1.** Në deklaratën e interesave private *periodike vjetor të vitit 2023*, të personit të lidhur **Ajola Arben Xoxa (bashkëshortja)**, në seksionin *"Të ardhurat dhe angazhimet në veprimtari publike dhe/ose private"* ka deklaruar këto të ardhura si më poshtë vijon:

1. **Të ardhura nga Qendra HARABEL:** Shuma e të ardhurave neto: **22,481 Euro.** Të ardhura sipas projekteve me Qëndrën; **i)** 10,421 Euro si Koordinatore për projektin SPA:RE, financuar nga CREATIVE EUROPE (fonde të BE); **ii)** 5,100 Euro si drejtuese artistike dhe prodhim filmi financuar nga Fondacioni MERC (Itali); **iii)** 1,960 Euro si rimbursim i pagesës së kartës për blerjen me të njëjtën shume që ka bërë për stafin.
2. Të ardhura nga si drejtuese Projekti BALKAN YOUTH LINK. **Projekte të ndryshme.** Shuma e të ardhurave neto: **22,000 Euro.**
3. **Të ardhura nga paga PARTNERS LAW SHPK.** Shuma e të ardhurave neto: **15,754.65 Euro.** Administratore. Këto të ardhura përfshijnë pagesa të prapambetura të kompanisë ndaj Ajola Xoxa, vitet 2018-2022.[11]
4. **Të ardhura nga qeraja Qëndra Harabel.** Shuma e të ardhurave neto: **12,000 Euro.**
5. Të ardhura nga paga Botimet Enciklopedike SHA. Shuma e të ardhurave neto: **12,000 Euro.**
6. Të ardhura nga paga PARTNERS LAW SHPK. Shuma e të ardhurave neto: **13,200 Euro.**

**18.4.2.** Në deklaratën e interesave private *periodike vjetor të vitit 2023*, të personit të lidhur **Ajola Arben Xoxa (bashkëshortja)**, në seksionin *"Detyrimet financiare ndaj personave juridike"* nuk rezulton të jetë deklaruar ndonjë detyrim.

18.4.3. Në deklaratën e interesave private *periodike vjetor të vitit 2023*, të personit të lidhur **Ajola Arben Xoxa (bashkëshortja)**, në seksionin *"Shpenzimet e deklarueshme"* nuk ka shënime.

[10] Duke i mbledhur, gjendja 31.12.2023 i bie të jetë **251,996.21 Euro.**
[11] Nuk rezulton të jetë deklaruar më parë si detyrim i shoqërisë ndaj saj.

**19. Sa më sipër, nga analiza e të gjitha deklaratave të shtetasve Erion Veliaj dhe Ajola Xoja rezulton se nuk janë deklaruar adresa dytësore si shtëpitë e pushimit etj. Gjithashtu, konstatohet nga të gjitha deklaratat se nuk është deklaruar asnjë shpenzim për mobilim/arredim edhe pse disponojnë apartamente dhe zyra të deklaruara për ushtrim aktiviteti. Gjithashtu, janë deklaruar si të ardhura edhe dietat për t'u shpenzuar jashtë shtetit në takimet zyrtare si dhe bilitat e udhëtimit për jashtë shtetit të cilat duhet të blihen nga Autoriteti Kontraktor, Bashkia Tiranë nëpërmjet procedurës së prokurimit publik. Ndodhur në këto kushte, lind pyetja kush ja ka mbulur shpenzimet jashtë shtetit shtetasit Erion Veliaj përderisa ka kursyer dietat dhe përse duhet t'i kalojnë në llogarin bankare shpenzimet e biletave, të cilat sipas akteve ligjore e nënligjore në fuqi duhet të sigurohen paraprakisht nga institucioni nëpërmjet procedurave të prokurimit përpara udhëtimit.**

***1.1. Lidhur me veprimet hetimore për verifikimin e pasurive të deklaruara.***

***i. Lidhur me pasuritë në emër të shtetasit Erion Veliaj***

**19.** Në përgjigje të kërkesës Nr. 7642 Prot., datë 17.05.2024, të Prokurorisë së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, ASHK ka kthyer përgjigjen Nr. 6591/1 Prot., datë 29.05.2024, nga ku ndër të tjera rezulton se shtetasi *Erion Veliaj* zotëron pasuritë: Referenca 022014, zk: 8150, **nr. i Pasurisë 2/543+1-29**, indeksi i hartes tr-n-13, vol: 50, faqe 34, pronari *Erion Luan Veliaj* dhe i pajisur me çertifikatë për vërtetim të pronësisë nr. 581954, dt. 18.09.2013, nga ZVRPP Tiranë, Zk. 8150, nr. i pasurisë 2/543+1-29, vol 50, faqe 34, lloji i pasurisë "apartament", sipërfaqja 111.20 m2, pronësia Erion Luan Veliaj, adresa e pasurisë: *Rr. "Hoxha Tahsim", Tiranë, Shk 1, Kt 8, AP. 29.* Ky apartament rivlerësuar në vitin 2013 me çmimin **12,810,240 Lekë.**

**19.1.** Këtë apartament shtetasi Erion Veliaj e ka blerë sipas kontratës noteriale Nr. 3405 Rep., dhe Nr. 1839 Kol., datë 12.09.2013, Notere Violeta Sulkaj, nga shitësit Agron JauplIari nr. personal F80701165M, në cilësinë si invesitor me NIPTIN: K41914803B (Person Fizik Agron Jauplari) dhe Thanas Popa, nr. personal F90920192F, në cilësinë e investitorit me nipt: K41914807K, si dhe Sulejman Hajdari, nr. personal E30807092H, në cilësinë e investitorit me nipt K41914801I. Çmimi i shitjes së deklaruar nga palët në kontratë është **5,115,200 Lekë.** **Në kontratë parashikohet se "Bleresi deklaron se pranon ta blejë dhe se shuma e mësipërme është likujduar plotësisht jashtë kësaj zyre sipas kontratës së sipërmarrjes që në vitin 2003. Nga aktet e administruara nuk ka asnjë të dhënë se si është bërë pagesa dhe nga praktikat e administruara nga institucionet shtetërore nuk gjendet kontrata e sipërmarrjes të vitit 2003. Për më tepër që shitësit në rastin konkret e kanë marrë cilësinë e investitorit më datë 14.07.2004 nga Çeritifikatat e Regjistrimit si persona të tatueshëm. Pra, nuk ka asnjë gjurmë se si është bërë pagesa për blerjen e këtij apartamenti. Gjithashtu, nuk provohet që të jetë shitur ndonjë apartament nga prindërit e shtetasit Erion Veliaj që të ketë shërbyer si burim për blerjen e këtij apartamenti sikurse deklarohet në deklaratën e pasurisë.**

***ii. Lidhur me pasuritë në emër të shtetasit Arber Veliaj***

**20.** Nga aktet e administruara nga ASHK rezulton se shtetasi **Arber Veliaj** disponon pasuritë:

**20.1.** Referenca 7049, ZK 3101, nr. i pasurise 1/650, volum 29, faqe 166. Sipas kartelës së pasurisë, lloji i pronës **"Truall"**, vendodhja **Bashkia Qerret**, Kavaje, sipërfaqja totale 446.6 m2 *(nga të cilat trual 446.6 m2; Ndërtesë 80.42 m2)*. Sipas dosjes së referencës së pasurisë, Arbër Veliaj e ka blerë pronën sipas Kontratës Noteriale **Nr. 3198 Rep., dhe Nr. 1175 Kol., datë 23.12.2020,** notere Edlira Telharaj, nga shitësit Alban Shehri nr. personal: H10216139J dhe Eliana Bakiri, nr. personal: H95913137R. Sipas kontratës noteriale: Pasuria është fituar nëpërmjet legalizimit sipas lejes nr. 70551, dt. 21.09.2020 (Zona e Stimuluar "Ardian Çarçani", Kavajë) dhe kontratës së blerjes së truallit 2034 Rep/759 Kol, dt. 14.09.2020. Palët kanë rënë dakord midis tyre dhe kanë përcaktuar që çmimi i shitjes së pasurisë është në total, **<u>164,000 Euro.</u>** Shuma prej **59,000 Euro** është paguar nga blerësi tek shitësi, me kontratën e kalimit të të drejtave reale Nr. 2799 Rep., dhe Nr. 1043 Kol., datë 23.11.2020 Noter E. Telharaj. Pjesa e mbetur prej **105,000 Euro** do të likujdohet nga blerësi në llogarinë e noterit pranë bankës CREDINS, me nr. llogarie 00001070673 nëpërmjet financimit bankar që blerësi do të marrë pranë Credins Bank, jo më vonë se 10 ditë pune nga data e firmosjes së kësaj kontratë. Mandati bankar i pagesës së çmimit përbën provë të plotë për fillimin e efekteve të këtij akti.

**20.1.1.** Sipas vetë kontratës **Nr. 2799 Rep., dhe Nr. 1043 Kol., datë 23.11.2020** Noter E. Telharaj, *"Për kalimin e të drejtave reale"*, lidhur midis shitësit Alban Shehri nr. personal: H10216139J dhe Eliana Bakiri, nr. personal: H95913137R dhe blerësit Arbër Veliaj, palët kanë rënë dakord se çmimi i plotë për kalimin e të drejtave me qëllim transferimin e pasurisë në momentin e regjistrimit të saj pranë AKSH do të jetë 164,000 Euro. Sipas pikës 2.2 të kësaj kontratë, brenda 10 ditëve punë nga lidhja, blerësi do të depozitojë në llogarinë bankare të shitësit, pranë bankës OTP BANK IBAN AL23 2131 1109 0000 0000 019550567, shumën e barabartë me vlerën 59,000 Euro (Kësti i parë). Në praktikën e referencës së pasurisë, ndodhet edhe një kopje mandati bankar, sipas të cilit, në datën 23.12.2020, në llogarinë e Noteres Edlira Telharaj në Credins Bank, është kaluar nga Arbër Veliaj shuma prej 105,000 Euro.

**20.1.2.** Shtetasi Alban Shehri, me kontratën **Nr. 1732 Rep., dhe Nr. 669 Kol., datë 21.08.2020, ka blerë** objektin **"Vila nr. 5"**, me sipërfaqe bruto ndërtimi 165.97 m2, e përbërë nga kati përdhe dhe 1 kat mbi tokë, sipërfaqe gjurme 91.42 m2, si dhe parcelë ndërtimore me sip. 446.62 m2, mbi të cilën ngrihet kjo vilë. Sipas kontratës, çmimi do të jetë 150,000 Euro për të cilin është rënë dakord të shlyhet në 2 këste: **i)** Kësti i **Parë** prej 25,000 Euro është likujduar sipas Kontratës së Kaparit Nr. 1366 Rep., dhe Nr. 512 Kol., datë 01.07.2020 në llogarinë bankare të ceduesit (shitësit); **ii)** Kësti i fundit prej 125,000 Euro do të paguhet në llogarinë bankare të noterit Edlira Telharaj pranë bankës Intesa San Paolo me IBAN AL872081 1008 0000 0209 5463 5902, jo më vonë se 5 ditë nga nënshkrimi i kontratës. Kësti i fundit do të lirohet në favor të Ceduesit (shitësit-pala e parë), vetëm pas legalizimit e regjistrimit të pasurisë pranë ASHK-së. Sipas kontratës së kaparit të lidhur Nr. 1366 Rep., dhe Nr. 512 Kol., datë 01.07.2020, kapari prej 25,000 Euro do të paguhet nga kapardhënësi drejtpërdrejt në llogarinë e kaparmarrësit në llogarinë e tij bankare. Ndërsa pagesa prej 125,000 Euro, referuar praktikës së kontratave të marra me pv. dt. 10.10.2024 te noteri

Edlira Telharaj, rezulton se në datën 29.12.2020, rezulton një kopje mandati bankar ku shuma prej 125,000 Eurosh është kaluar nga llogaria e noteres te llogaria e Ardian Carcani.

**20.2.** Referenca 25109, ZK 3292, për pasuritë: **1)** Nr. **118/81/Nd5+1-1**, Volumi 65, Faqe 24, Lloji i Pasurisë Apartament, Sip. 56.3 M2, Vendodhja **Selitë**, Pronari **Arbër Veliaj; 2)** Nr. **118/81/Nd5+1-2**, Volumi 65, Faqe 24, Lloji i Pasurisë Apartament, Sip. 56 M2, Vendodhja **Selitë**, Pronari **Arbër Veliaj.** Ky i fundit këtë pasuri e ka blerë me kontratën noteriale Nr. 497 Rep., dhe Nr. 219 Kol., datë 03.03.2022, nga shitësi **"AGI KONS" SHPK**, përfaqësuar nga administratori Alban Çinari. **Sipas kontratës**, çmimi i **shitjes është 49,000 Euro** pasuria nr. 118/81/ND5+1-1 dhe **48,407 Euro** pasuria nr. 118/81/ND5+1-2; Sipas kontratës palët deklarojnë se *"çmimi total i blerjeve të pasurive të mësipërme nr. 118/81/ND5+1-1 dhe nr. 118/81/ND5+1-2 është* ***97,407 EURO, e cila është likuiduar tërësisht në ekzekutim të të drejtave dhe detyrimeve të kontratës së sipërmarrjes nr. 1685 Rep dhe nr. 522 Kol, dt. 27.03.2009, notere A. Mallkuci****"*.

**20.2.1.** Sipas Kontratës së Sipërmarrjes **Nr. 1685 Rep., dhe Nr. 522 Kol., datë 27.03.2009,** me palë sipërmarrëse AGI KONS Sh.p.k dhe palë porositëse Arbër Veliaj, sipërmarrësi merr përsipër të ndërtojë për Arbër Veliaj apartamentin 01, zona E sipas genplanit bashkëngjitur kontratës, me sipërfaqe ndërtimore 123.3 m2. Sipas nenit 3 të kontratës, çmimi do të jetë 790 Euro m2. Vlera totale e kontratës është 97,407 Euro e cila do të paguhet me këste: **i)** Kësti i parë 35,000 Euro me firmosjen e kontratës; **ii)** Kësti i fundit 62,407 Euro në bazën e lëvrimit të kredisë bankare sipas kontratës së huasë që parashikohet në nenin 4 të kësaj kontrate. Sipas nenit 4 të kontratës parashikohet se porosistësi do të marrë kredi bankare. Në praktikën e referencës së ardhur nga ASHK, rezulton edhe një kopje e ekstraktit të llogarisë së AGI KONS (IBAN AL35202110130000001296798 EUR, nuk dallohet banka), nga data 13.01.204-13.12.2014, sipas të cilës në datën: 10.03.2014, përshkrimi *"Blendi Rroshi derdh në llog per Arber Veliaj Kest apartamenti"*, shuma 10,000 Euro.

***iii. Lidhur me pasuritë në emër të shtetases Ajola Xoxa.***

**21.** Nga aktet e administruara nga ASHK-ja rezulton se provuar se shtetësja **Ajola Xoxa** ka pasuritë si më poshtë vijon:

**21.1.** Referenca 12363, ZK 3292, nr. i pasurise **109/239+7-9**, volum 46, **faqe 65, sip. 162 m2 dhe verandë me sip. 23.4 m2**, Selitë, pronari **Ajola Xoxa**. (Rezidenca Kodra e Diellit). Këtë apartament Ajola Xoxa e ka blerë sipas kontratës shit-blerje Nr. 3325 Rep., dhe Nr. 1884 Kol., datë 26.07.2016, notere Mimoza Sadushi, nga shitësi "AGI KONS" SHPK. Sipas kontratës shtetësja Ajola Xoxa është 1 nga 3 porositësit e këtij apartamenti, por 2 porositësit e tjetë të apartamentit, shtetasit Valbona Xoxa dhe Arben Xoxa kanë hequr dorë duke ia kaluar vajzës së tyre pjesët e tyre të bashkëpronësisë. Në kontratën Nr. 3325 Rep., dhe Nr. 1884 Kol., datë 26.07.2016 më sipër, palët i referohen kontratës së sipërmarrjes datë 06.05.2012. Sipas kontratës, neni 2, çmimi është 88,641 EURO. Palët deklarojnë se çmimi për blerjen e pasurisë së mësipërme 109/239+7-9 ***është likujduar nga bleresi në ekzekutim të kontratës për ndërtim apartamenti, dt. 06.05.2012.***

**21.1.1.** Nga praktika e kontratës Nr. 3325 Rep., dhe Nr. 1884 Kol., datë 26.07.2016 e marrë pranë noteres Mimoza Saduashj me proçesverbalin e datës 02.07.2024 "Për këqyrjen dhe marrjen e dokumenteve", bashkëlidhur saj është kontrata e sipërmarrjes *"Për ndërtim*

*Apartamenti" (Kontratë e thjeshtë jo noteriale)* ***datë 06.05.2012.*** Sipas kontratës së sipërmarrjes, porositësit janë Arben Xoxa, Valbona Xoxa dhe Ajola Xoxa. Në nenin 3 të kontratës është përcaktuar çmimi: Çmimi i sipërfaqes së apartamentit: 171.2 m2 x 490 Euro/m2 ne vlere 83,888 Euro. Çmimi i verandës: 19.4 m2 x 245 Euro/m2 ne vlere 4,753 Euro. Sipas kontratës së sipërmarrjes, neni 3 pikat "a" dhe "b", përcaktohet se: Brenda muajit qershor 2013 Porositësi duhet t'i paguajë sipërmarrësit 40,000 Euro. Brenda muajit nëntor 2013 Porositësi duhet t'i paguajë sipërmarrësit 48,641 Euro. Në praktikën e kontratës marrë pranë noterit Mimoza Sadushaj, rezultojnë edhe disa dokumente pagese si më poshtë: **i)** Printim i një pasqyre llogarie të shoqërisë AGI KONS ku evidentohen disa transaksione lidhur me pagesat e çmimit të kontratës. Ky dokument fotokopje nuk është shumë i qartë, as çfarë banke i përket. Në të janë shënuar: *Data 11.10.2013, "Pagese ...Kontrate Apartamenti nr. 5, sipas kontrates se sipërmarrjes...", Valbona Xoxa, pagesa* ***17,000 Euro*** *(nuk dallohet qartë shifra, mund të jetë edhe ndryshe). Data 11.10.2013, "Pagese Kest kontrate Apartamenti nr. 5, shkalla 11". vlera* ***16,966*** *Euro, Xoxa Ajola Arben;* **ii)** 16 fotokopje mandate arkëtimi të thjeshta të mbajtura nga shoqëria AGI KONS si më poshtë: Dt. 07.02.2013, Arben Xoxa, "Kest kontrate ap. 5 shkalla 11 Selite", shuma **2000 Euro;** Dt. 22.01.2013, Arben Xoxa, "Kest kontrate ap. 5 shkalla 11 Selite", shuma **2000 Euro;** Dt. 06.02.2013, Arben Xoxa, ""Kest kontrate ap. 5 shkalla 11 Selite", shuma **2000 Euro;** Dt. 12.02.2013, Arben Xoxa, "Kest kontrate ap. 5 shkalla 11 Selite", shuma **2000 Euro;** Dt. 06.03.2013, Arben Xoxa, "Kest kontrate ap. 5 shkalla 11 Selite", shuma **3000 Euro;** Dt. 20.02.2013, Arben Xoxa, "Kest kontrate ap. 5 shkalla 11 Selite", shuma **2000 Euro;** Dt. 15.03.2013, Arben Xoxa, "Kest kontrate ap. 5 shkalla 11 Selite", shuma **2000 Euro;** Dt. 26.03.2013, Arben Xoxa, "Kest kontrate ap. 5 shkalla 11 Selite", shuma **3000 Euro;** Dt. 03.04.2013, Arben Xoxa, "Kest kontrate ap. 5 shkalla 11 Selite", shuma **3,500 Euro;** Dt. 16.04.2013, Arben Xoxa, "Kest kontrate ap. 5 shkalla 11 Selite", shuma **2000 Euro;** Dt. 03.05.2013, Arben Xoxa, "Kest kontrate ap. 5 shkalla 11 Selite", shuma **2,500 Euro;** Dt. 26.04.2013, Arben Xoxa, "Kest kontrate ap. 5 shkalla 11 Selite", shuma **3,500 Euro;** Dt. 05.06.2013, Arben Xoxa, "Kest kontrate ap. 5 shkalla 11 Selite", shuma **3000 Euro;** Dt. 27.05.2013, Arben Xoxa, "Kest kontrate ap. 5 shkalla 11 Selite", shuma **2000 Euro;** Dt. 20.06.2013, Arben Xoxa, "Kest kontrate ap. 5 shkalla 11 Selite", shuma **3000 Euro;** Dt. 14.05.2013, Arben Xoxa, "Kest kontrate ap. 5 shkalla 11 Selite", shuma **2,500 Euro.** Në total këto këto mandate bëjnë shumën: **40,000 Euro; iii)** Pasqyrë llogarie të AGI KONS (EUR) AL35202110130000001296798, ku me datë 02.02.2015, rezulton veprimi *"Ajola Xoxa Pagese kest kontrate apartamnet nr. 5, sh 11, kontrate sipermarrje dt. 06.05.2012",* vlera **14,641 Euro. Duke marrë për bazë vlerat e mësipërme, për kontratën e sipërmarrjes më sipër është paguar vlera total prej <u>88,607 Euro.</u>**

**21.2.** Referenca 40555, ZK: 8270, nr. Pasurie **2/461+1-32**, Indeksi i Hartës TR-R-11, volum 33, faqe 236, pronari **Ajola Xoxa**, *Rr. Brigada 8*, Tirane, **sip. 107.10 m2.** Këtë apartament Ajola Xoxa e ka blerë me Kontratën Noteriale Nr. 98 Rep., dhe Nr. 51 Kol., datë 11.01.2018, notere Mimoza Sadushaj, nga shitësi Shpëtim Balla[12] dhe Miranda Balla. Çmimi

[12] Sipas referenca 09067, ZK: 8270, nr. i Pasurise 4/150+1-30, indeksi i hartes: tr-r-11, emri i pronarit Shpetim Balla. Kjo pasuri është apartament 107.1 m2, kati i nëntë, ZK 8270, rr. "Brigada VIII", ap. 32, Tiranë, për të cilin është lëshuar vërtetimi hipotekor nr. 432, dt. 15.07.2008 nga ZVRPP Tiranë. pasuria me nr. <u>2/461+1-32.</u>

i blerjes është **105,000 Euro.** Sipas kontratës palët kanë rënë dakord që kalimi i titullit të pronësisë të bëhet PAS nëshkrimit të kësaj kontrate dhe pagimit të çmimit total të shitjes në llogarinë e noteres Mimoza Sadushaj. PalëT kanë rënë dakord që shuma e blerjes të shlyhet në dy këste, të cilat do të depozitohen **në llogarinë e noteres Mimoza Sadushaj pranë Raiffeisen Bank me nr. 0040384773.** Bashkëlidhur kontratës gjendet ekstrakt nga llogaria e noterit ku rezulton se në datën **23 Janar 2018** Ajola Xoxa ka transferuar në llogarinë e noterit shumën prej 35,000 Euro. Gjithashtu, rezulton mandat arkëtimi datë **24.01.2018** pranë Credins BANK, llogaria e MIMOZA SADUSHAJ PF, ku është derdhur CASH kësti sipas kontratës AJOLA XOXA, shuma 35,000 Euro, Ajola Xoxa. Edhe nga praktika e marrë pranë noteres Mimoza Sadushaj me procersverbalin e datës 02.07.2024 "Për këqyrjen dhe marrjen e dokumenteve", rezulton se bashkëlidhur kontratës është vetëm mandati apo pagesa e këstit të parë prej 35,000 Euro. Ajola Xoxa, sipas Mandatit "Credins Bank", datë 24.01.2018, veprime në llogarinë nr. 00000767899 MIMOZA SADUSHAJ P.F, është kryer veprimi: "Derdhje CASH, PAGESE KESTI SIPAS KONTR AJOLA XXOXA, 35,000 EURO".

**21.2.1.** Vetë shtetasi Shpëtim Balla, e ka blerë pasurinë më sipër me Kontratën Nr. 7937 Rep., dhe Nr. 729 Kol., datë 30.12.2007, nga shitësi Shoqëria ndërtuese "APOLLONIA" SHPK, **për një çmim prej 3,000,000 Lekë**. Shpëtim Balla është ortak i vetëm dhe administrator i shoqërisë "APOLLONIA" SHPK, e cila është krijuar në vitin 1994, me objekt veprimtarie "Ndërtime, prodhime të materialeve të ndërtimit, tregtimi, eksport import me shumice e pakice". Në vitin 2011, Shpëtim Balla i ka kryer rivlerësim pasurisë dhe sipas aktit raportit të rivlerësimit, apartamenti është vlerësuar se ka vlerën e tregut **29, 988, 000 lekë. Pra, të njëjtin apartament që pronari e rivlerëson në shumën rreth 30.000.000 lekë, që supozohet të jetë vlera e tregut për këtë pronë, e shet rreth 7 vjet më pas, në favor të shtetases Ajola Xoxa, në vlerën rreth 100.000 euro.**

***iv. Lidhur me pasuritë në emër të shtetases Valbona Xoxa.***

**22.** Nga kthim përgjigja Nr. 6837/1 Prot., datë 24.06.2024 nga ASHK, rezulton se **Valbona Xhemil Xoxa** ka pasurinë **nr. 118/8/7+1-5, vol 41 faqe 122, ZK 3292**, sipërfaqe **185 m2 dhe aksesori i tij, verandë 26.3 m2.** Kjo pasuri (sipas referencës nr. 012362) rezulton se është blerë me **Kontratën e Shitje me rezerve, me Nr. 3326 Rep., dhe Nr. 1885 Kol., datë 26.07.2016**, shitësi **Astrit Sula dhe Myzejen Sula,** blerësit Arben Xoxa dhe Valbona Xoxa. Çmimi i shitjes është 85,232 Euro. Palët kanë parashikuar në këtë kontratë që ajo do shlyhet në 4 këste nga blerësi në llogarinë e shitësit pranë RAIFFEISEN BANK nr. 08 001 29 67 98; **i)** Kësti i parë **25,232 Euro**, brenda datës 30 nëntor 2016; **ii)** Kësti i dytë **20,000 Euro**, brenda datës 30 Nëntor 2017; **iii)** Kësti i tretë **20,000 Euro**, brenda datës 30 Nëntor 2018; **iv)** Kësti i katërt **20,000 Euro**, brenda datës 30 Nëntor 2019. Për këtë kontratë është lëshuar Deklarata-noteriale Nr. 543 Rep., dhe Nr 223 Kol., datë 05.02.2019, me të cilën shitësit kanë deklaruar se pala blerëse **e ka likuiduar totalisht çmimin e shitjes së**

vol 33, fq 236. Këtë apartament Shpëtim Balla e ka blerë nga subjekti "Apollonia" SHPK (admistrator dhe ortak vete shpetim Balla), sipas kontratës nr. 2937 rep (nuk dallohet mirë numri i repertorit), nr. 729 Kol, dt. 30.12.2007, noter Dh. Brisku, për çmimin prej 3,000,000 lek. Ky apartament është rivlerësuar në Dhjetor 2011, me çmimin **29, 988,000 Lek**.

**apartamentit.** Kjo pasuri (sipas referencës 00019074 (me shkrim dore te kontrata e noterit është numri 8000 96 217) i ka kaluar me trashëgimi trashëgimtarëve Valbona Xoxa dhe Ajola Xoxa. Pjesën e vet takuese ¼ (sipas referencës 019591) në këtë pasuri Ajola Xoxa ia ka dhuruar nënës së saj sipas Kontratës Nr. 317 Rep., dhe Nr. 118 Kol., datë 04.06.2020.

**22.1.** Gjithashtu, shtetësja **Valbona Xoxa**, sipas referencës nr. 45534, është pronare e pasurive: **1)** Nr. 3/572/ND+1-4, vol 92, fq. 36, ZK 8270, apartament 21.6 m2; **2)** Nr. 3/561/ND+1-4, vol 92, fq. 37, ZK 8270, apartament 31.5 m2, (përshkrim i veçantë: Leje Legalizimi nr. 119852, dt. 27.02.2018 Shtesa anësore 5 ka ne objektin ekzistues 5 kat); **3)** Nr. 3/117+2-28, vol 19, fq.101, ZK 8270, apartament 54.9 m2, (përshkrim i veçantë: Dhome, Kuzhine dhe Ambjente Ndihmese). Në këto 3 pasuri, Ajola Xoxa i ka dhuruar shtetases Valbona Xoxa pjesën e saj takuese prej ¼, Ajola Xoxa ¼ pjesë të pasurive më sipër, e ka me dëshmi trashëgimie, me trashëgimlënës Arben Xoxa.

**22.2.** Referenca Nr. 0004186, ZK: 1414 (ÇLIRIM) NR. i PASURISE 25, volum 5, faqe 89, pronari **Valbona Xoxa dhe Ajola Xoxa, Aleko Xoxa, Agron Xoxa**, vendodhja Fier, lloji i pasurise "Truall", sip. 2,940 m2, mënyra e fitimit të pasurisë, me trashëgimi ligjore. Ajola Xoxa ka 1/8 pjesë takuese. *Bashkëlidhur janë edhe referenca të tjera lidhur me këtë pronë (si dhurim nga Agron Xoxa te Valbona Xoxa, referenca për lëshimin e dëshmisë së trashëgimisë etj.).*

***v. Lidhur me pasuritë në emër të shtetases Shqiponjë Veliaj.***

**23.** Nga aktet e administruara nga ASHK-ja rezulton se provuar se shtetësja *Shqiponjë Veliaj* ka pasuritë si më poshtë vijon:

**23.1.** Referenca 028075, ZK 8150, nr. i Pasurisë 2/576/nd+1-14, Indeksi i Hartës TR-P-14, vol 57, faqe 225, pronari **Shqiponje Maliq Veliaj:** ZK, 8150, Nr. i pasurise 2/576/ND+1-14, vol 57, fq. 225, indeksi i Hartes TR-N-13, *Adresa Tiranë, Rr. "H. Tasim"*, sip. 88.27 m2, pronari **Shqiponjë Maliq Veliaj. Sipas** kësaj dosjeje, Shqiponjë Maliq Veliaj e ka blerë këtë apartament sipas kontratës Nr. 95 Rep., dhe Nr. 52 Kol., datë 10.01.2018, Noter Violeta Sulkaj, nga shitësit Agron Jaupllari nr. personal F80701165M, në cilësinë si invesitor me NIPTIN: K41914803B (Person Fizik Agron Jauplari), si dhe Thanas Popa, nr. personal F90920192F, në cilësinë e investitorit me nipt: K41914807K. Sipas kontratës së shitjes, Shqiponjë Veliaj e ka blerë këtë apartament për shumën prej **6,985,550 Lekë** (vlerë e barabartë me 55,000 Euro sipas parashikimit në kontratë). Palët në kontratë deklarojnë se blerësi ka paguar shumën prej 6,985,550 Lek përmes aktmarrëveshjes së datës 21.04.2004 bashkëngjitur këtij akti.

**23.1.1. Kontrata e sipërmarrjes për objektin Hoxha Tahsim, me dt. 21.04.2004, kontratë me shkrim lidhur midis palëve (jo kontratë noteriale), mes sipërmarrësit "Aurora Konstruksion" shpk përfaqësuar nga Astrit Haxhiu dhe porositësit Shqiponja Veliaj, për porosi apartamenti në objektin në rrugën "Hoxha Tahsim", leje ndërtimi nr. 362, dt. 16.07.2003 të KRRT Tiranë.** Me këtë kontratë Shqiponja Veliaj porosit një apartament 2+1, në katin e gjashtë të banimit, me çmim ndërtimi 550 Euro/m2, dhe vlerë apartamenti 55,000 Euro. Lidhur me pagesën palët kanë deklaruar në këtë kontratë se: **1)** më datë 21.04.2004 u paguan 10,000 Euro; **2)** më datë 30.10.2004 u paguan 15,000 Euro; **3)** më datë 30.03.20005 u paguan 15,000 Euro; **4)** me datë 30.06.2005 u paguan 7,000 Euro.

Gjithashtu, në fund të kontratës te nënshkrimi i palëve vihen re disa shënime që bëjnë fjalë për pagesat: me datë 12.06.2006 u paguan 3,000 Euro; Me datë 06.12.2005 u paguan 3,000 Euro; Me datë 16.09.2005 u paguan 2,000 Euro; Me datë 21.04.(nuk dallohet viti) u paguan 10,000 Euro; Me datë 4.11.2005 u paguan 2,000 Euro; Me datë 20.12.2004 u paguan 5,000 Euro; Me datë 30.01.2006 u paguan 2,000 Euro; U paguan datë 11.2.2005 5,000 Euro; U paguan 19.05.2005 14,000 Euro; Me datë 22.8.2005 u paguan 2,000 Euro. **Bashkëlidhur kontratës ndodhen disa mandate arkëtimi:** Datë 13.11.2014, shuma 7,000 Euro, Investitori Agron Jaupllari, arkëton nga Shqiponja Veliaj, shuma 7,000 Euro, "Diferenca e mbetur per blerje ap. Te obj. Hoxha Tasim"; Datë 12.06.2006, nr. 149, investitori Aurora Konstruksion, arkëton nga Shqiponja VEliaj, shuma 3,000 Euro, "Blerje ap. Te Hoxha Tahsim"; Datë 30.01.2006, nr. 32, investitori Aurora Konstruksion, arkëton nga Shqiponja Veliaj, shuma 2,000 Euro, "Apartament te H.Tahsim"; Datë 06.12.2005, nr. 12, investitori Aurora Konstruksion, arkëton nga Shqiponja Veliaj, shuma 3,000 Euro, "Apartament te Hoxha Tahsim"; Datë 04.11.2005, nr. 7, investitori Aurora Konstruksion, arkëton nga Shqiponja Veliaj, shuma 2,000 Euro, "Apartament te Hoxha Tahsim"; Datë 16.09.2005, nr. 10, investitori Aurora Konstruksion, arkëton nga Shqiponja Veliaj, shuma 2,000 Euro, "Apartament te Rr. Hoxha Tahsim"; Datë 22.08.2005, nr. 4, investitori Aurora Konstruksion, arkëton nga Shqiponja Veliaj, shuma 2,000 Euro, "Apartament te H.Tahsim 2"; Datë 19.05.2005, nr. 6, investitori Aurora Konstruksion, arkëton nga Shqiponja Veliaj, shuma 14,000 Euro, "Apart. te Hoxha Tahsim 2"; Datë 11.02.2005, nr. 5, investitori Aurora Konstruksion, arkëton nga Shqiponja Veliaj, shuma 5,000 Euro, "Apartament te H.Tahsim"; Datë 20.12.2004, nr. 4, investitori Aurora Konstruksion, arkëton nga Shqiponja Veliaj, shuma 5,000 Euro, "Per Apartament te H.Tahsim"; Datë 21.04.04, nr. 6, investitori Aurora Konstruksion, arkëton nga Shqiponja Veliaj, shuma 10,000 Euro, "Ap. 2+1, obj. H. Tahsim godina e dyte". Duke i mbledhur shumat në këto mandate arkëtimi, vlera del **55,000 Euro.**

23.2. Referenca NR. 000016, ZK. 3152 Ramice, Vlorë, 2017, Pasuria nr. 623/1 Vol. 3, ZK. 3152, Sip. 268100 m2, Kullotë, Trashëgimtarët e Kastriot Maliq Ormënaj. *(Përfituar me vendimin e Kthimit dhe Kompesimit të Pronave nr. 77, dt. 27.11.2001 në emër të subjektit të shpronësuar Maliq Ormëni.)*. Sipas Referencës nr. 0031 RAMICE 0083 BRATAJ, pasuria më sipër nr.623/1, ZK 3152 është ndarë në 3 pasuri (nr. 623/3 me 212,000 m2, nr. 623/4 me 4000 m2, nr. 623/5 me 52100 m2). Gjithashtu pjesa tjetër e pasurisë është marrë në fshatin Brataj ku me nr. pasurie 27/1, e cila është ndarë po ashtu në pasuritë 27/2, 27/3, 27/4. Sipas Çertifikatës së Pronësisë, pasuria nr. 623/1 ka kaluar në emër të trashëgimtarëve, ku ndër të tjerë është edhe Shqiponja Ormenaj **(Shqiponjë Veliaj)**, me pjesë takuese 12/96. Sipas Referencës nr. 0034, ZK 3152 Ramice, pasuria e ndarë 623/5, vol. 4, faqe 103, sip. 52100 m2, është ndarë në 2 pasuri të tjera, 623/5/1 (8350m2) dhe 623/5/2 (45,750m2). Edhe kjo pasuri në emër të të gjithë trashëgimtarëve, ku ndër tjera, Shqiponja Veliaj ka 4/32 pjesë takuese te secila pasuri e ndarë. Gjithashtu, sipas referencës 000045 (Shtesë Reference), ZK 3152; 1265, **është depozituar Vendimi i gjykatës për sigurim padie, nr. 1281 akti, dt. 20.03.2023 Gjykata Rrethit Gjyqësor Vlorë, Sekuestro Konservative lidhur me pasuritë e paluajtshme** objekt i vendimit nr. 77, datë 27.11.2001 të ish-KKKP pranë Prefektit të qarkut Vlorë.

3. ***Lidhur me zotërimin faktit nga shtetasit Erion Veliaj dhe Ajola Xoxa të vilës në Marea Resort, në Qerret, Kavajë me numër pasurie 1/647, Vol 29, faqe 103, ZK. 3101, në pronësi të subjektit tregtar "Agi Kons" shpk.***

**24.** Nga aktet e administruara rezulton se në informacionin e përcjellë nga shtetasi i vetëidentifikuar si Nesti Angoni, citohet se në kohën që shtetasi Erion Veliaj u emërua Ministër i Punës, bleu një pasuri të paluajtshme-banesë, të ndodhur në bllokun rezidencial "Kodra e Diellit", në pronësi të shtetasit Genti Sula. Pas kësaj, bashkëshortja e këtij të fundit u emërua zëvendësministre tek Ministria ku shtetasi Erion Veliaj ishte titullar. Më pas, banesa në fjalë është shtuar me një kat dhe për të është ndërtuar një ashensor i veçantë. Më tej, shpjegohet se që prej asaj kohe marrëdhënia e këtyre dy shtetasve është e pandarë. Shoqëria "AGI KONS" me pronar shtetasin Genti Sula ka përfituar një pafundësi ndërtimesh në Tirane. **Gjithashtu, në informacion përmendet se shtetasi Erion Veliaj aktualisht posedon 3 vila në Fshatin Rezidencial në Qerret Kavajë të ndërtuar nga shoqëria Agikons e shtetasit Genti Sula. Një nga këto vila posedohet nga vëllai i shtetasit Erion Veliaj, ndërsa të tretën ky i fundit e ka shembur, ndërkohë që të dyja vilat ekzistuese i ka rikonstruktuar. Vlera e vilave, sipas kallëzuesit kap shifrën e rreth 500 mije Euro.** Ndërsa vilën e tretë, kallëzuesi shpjegon se shtetasi Erion Veliaj e ka rrafshuar, duke shpërdoruar 500.000 Euro me qëllim krijimin e hapesirave shtesë. Për prishjen e objektit janë shfrytëzuar makineritë e Ujësjellësit Kavajë. Në këtë pikë, kallëzuesi shtron pyetjen nëse për këtë shembje është marrë më parë një leje apo ekziston ndonjë faturë që dokumenton shpenzimet e bëra.

**25.** Me administrimin e kallëzimit pranë Prokurorisë së Posaçme, nga ana e Hetuesit të Byrosë Kombëtare të Hetimit janë kryer disa verifikime paraprake, të cilat konsistojnë fillimisht në sigurimin e të dhënave për kallëzuesin, shtetasin e identifikuar si Nesti Angoni. Nga rezultatet konstatohet se nuk ekzistojnë të dhëna për këtë shtetas.

**26.** Gjithashtu, u verifikua historiku i punësimit të shtetases **Gentiana Sula**, bashkëshortja e shtetasit Gentjan Sula, nga ku rezultoi se ka qenë e punësuar te Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë me datë 07.10.2013 dhe është larguar me datë 13.09.2016. **Punësimi i kësaj shtetase pranë kësaj ministrie përkon si periudhë kur ministër i kësaj ministrie ka qënë Erion Veliaj nga 16.09.2013 deri me datë 27.05.2015.** Këto fakte provohen me procesverbalet "Për kqyrjen dhe marrjen e të dhënave nga sistemi C@TS i Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve" mbajtur më datë 06.09.2023 për shtetasit Gentiana Sula dhe Erion Veliaj dhe me procesverbalin "Për kqyrjen dhe verifikimin me printim nga Regjistri Kombëtar i Gjëndjes Civile (NCR)" mbajtur më datë 06.09.2023, ku është administruar Çertifikata Familjare e shtetasit Gentjan Sula.

**27.** U krye këqyrja e Sistemeve TIMS dhe Raporte e Statistika TIMS nga ku rezultoi se: **1)** Më datë 13.08.2004, ora 16:46 në Pikën Kufitare Rinas, shtetasi **Erion Veliaj** ka udhëtuar me linjë e udhëtimit CHARTER. Më datë 13.08.2004, ora 17:08 në Pikën Kufitare Rinas, shtetasi **Gentjan Sulaj** ka udhëtuar me linjë e udhëtimit CHARTER; **2)** Më datë 04.08.2006, ora 12:07 në Pikën Kufitare Rinas, shtetasi **Gentjan Sulaj** ka udhëtuar me linjë e udhëtimit CHARTER. Më datë 04.08.2006, ora 14:40 në Pikën Kufitare Rinas, shtetasi **Erion Veliaj** ka udhëtuar me linjë e udhëtimit CHARTER; **3)** Më datë 15.08.2017, ora 08:29 në Pikën Kufitare Rinas, shtetasi **Erion Veliaj** ka udhëtuar me linjë e udhëtimit TURKISH

AIRLINES - TK 1073/1074 STAMB. Më datë 15.08.2017, ora 08:37 në Pikën Kufitare Rinas, shtetasi **Gentjan Sulaj** ka udhëtuar me linjë e udhëtimit TURKISH AIRLINES - TK 1073/1074 STAMB. Këto fakte provohen me procesverbalet "Për kqyrjen dhe marrjen e të dhënave nga sistemi TIMS" për shtetasit Erion Veliaj dhe Gentjan Sulaj mbajtur më datë 06.09.2023.

**28.** Në lidhje me subjektin "AGI KONS" u këqyr ekstrakti historik i regjistrimit tregtar për të dhënat e këtij subjekti në faqen e internetit të "Qendrës Kombëtare të Biznesit" nga ku u morën këto të dhëna: ***Numri Unik i Identifikimit të Biznesit*** *– K21622001M.* ***Data e Regjistrimit*** *– 24/02/2002.* ***Data e Themelimit*** *– 04/02/2002.* **Zyra Qëndrore e shoqërisë në Shqipëri** – Tiranë, Farkë Kodra e Diellit, Kompleks Hotelerie me struktura 2.3 dhe 5 kate, me dy kate nën tok, Nr. Pasurie 51/256. **Objekti i aktivitetit** - Veprimtari ne fushen e ndertimit te pergjithshem. Veprimtari ne fushen e projektimit. Tregtim materialesh ndertimi, import-export. Ndertim e shfrytezim linjash e fabrikash per prodhimin e materialeve te ndertimit. Sherbim Bar- Restorant. Shitje dhe tregtim me pakice te karburantit, stacion karburanti. Prodhimin e veprave te artit, skulptura, piktura, skica, grafite, mozaike etj. Tregtimin e ketyre. veprave te artit brenda territorit te Republikes se Shqiperise, dhe eksportimi i tyre jashte saj. Ndertime te pergjithshme industriale dhe civile, ndertimi i rrugeve, autostradave, mbikalime, hekurudha, tramvai, metro dhe pista aeroportuale si dhe rikonstruksioni i rrugeve te kategorive te ndryshme. Shtimin e objektit te veprimtarise se shoqerise duke perfshire ne veprimtarine e saj Rikonstruksion dhe mirembajtje godinash civile e industriale, veshje e fasada, punime nentokesore, ura e vepra arti, diga dhe tunele hidroteknike, ujesjellesa, vajsjellesa, gazsjellesa, vepra kullimi e vaditje, ndertime detare dhe punime thellimi ne uje, punime dhe mbrojtje lumore, sistemime hidraulike dhe bonifikime, ndertim i impianteve per prodhimin e energjise elektrike, ndertime per nenstacionet, kabinat e transformatoreve, linja e TN te mesem dhe shperndarjen e energjise, punime te inxhinierise se mjedisit, impiante hidro-sanitare, kuzhina lavanderi, mirembajtja e tyre, impiante ngritese dhe transportues, ashensore, shkalle levizese, transportues, impiante te sinjalistikes ndriçuese te trafikut, sinjalistike rrugore jo ndriçuese, impiante teknologjike termike dhe te kondicionimit, impiante dhe linja telefonie dhe telekomunikacioni, impiante te brendshme, elektrike, telefoni, radiotelefoni, tv, ndertimi i impianteve te ujit te pijshem dhe pastrimi i tij, ndertimi impianteve te grumbullimit dhe trajtimit te mbetjeve urbane, punime topogjeodezike, shpime gjeologo inxhinierike, puse e shpime per uje. Rehabilitim dhe rikonstruksion monumente arkitekture te kategorive te ndryshme. Prodhim, tregtim i farave dhe fidaneve. Grumbullim, transportim, ruajtje, riciklim, perpunim dhe asgjesim i mbetjeve te llojeve te ndryshme. Punime të mirëmbajtjes dhe sinjalizimit në rrugë. Tregtimi pajisjeve elektrike, elektronike për përdorim industrial. Import i materialeve, porfileve plastike dhe alumini te cilat sherbejne per prodhimin e dyerve, dritareve dhe permbushin kriteret e eficences energjitike, aktivitetin e prodhimit, tregetimit dhe shperndarjes se betonit. **Administrator** - Alban Çinari. **Ortakët – Gentjan Sula, me vlerë kapitali 1.501.000.000,00 me nr të pjesëve 1,00 dhe përqindje 100,00.**

**29.** Më pas u proceduа me këqyrjen në internet në faqen "*openprocurement.al*", ku u verifikuan tenderat në të cilat **subjekti "AGI KONS" sh.p.k** ka marrë pjesë dhe i ka fituar, të cilat janë si vijon:

**29.1.** Me datë **30.04.2019,** institucioni prokurues Bashkia Tiranë, ka njoftuar për tenderin me objekt **"Rehabilitimi i Parkut Rinia" me nr. REF-19931-04-26-2019.** Me datë 25/06/2019 është bërë shpallja e fituesit, i cili është operatori ekonomik "AGI KONS". **Kjo procedure është shënuar në faqen "openprocurement.al" me RedFlag.** *Një shënim me RedFlag është një fakt, ngjarje, ose grup i rrethanave ose informacione të tjera që mund të tregojnë një shqetësim apo ekspozim dhe mbi rrezik potencial të pajtueshmërisë ligjore për sjellje të paligjshme ose joetike të biznesit, veçanërisht në lidhje me praktika korruptive dhe mosrespektimit të ligjeve anti-korrupsion. Vlerësimi për këto kategori do të bëhet në mënyrë automatike, me filtra analitik të paracaktuar.* **Në shënimin RedFlag për këtë tender shënohet që: Skualifikim i të gjithë operatoreve konkurrues përveç fituesit.**

**29.2.** Më datë **04.10.2022,** institucioni prokurues Bashkia Tiranë, ka njoftuar për tenderin me objekt **"Ndërtimi i objektit "Godina e Teatrit Tiranë - Faza I-rë" me nr. REF- 44309-10-03-2022.** Me datë 01/12/2022 është bërë shpallja e fituesit, i cili është operatori ekonomik "AGI KONS – BE-IS". Kjo procedure është shënuar në faqen "openprocurement.al" me RedFlag. **Në shënimin RedFlag për këtë tender shënohet që: Skualifikim i të gjithë operatoreve konkurrues përveç fituesit. Vlera e kësaj kontrate është 1 840 784 139, 00 lekë. Kohëzgjatja e kontratës është 27 muaj.**

**29.3. Po kështu, u procedua me kryerjen e verifikimeve në Sistemin Elektronik të Prokurimeve nga ku rezultoi:** me datë 06.02.2020, autoriteti kontraktues, Ministria e Kulturës ka ngarkuar në SPE procedurën me negocim, pa njoftim, me objekt "Kryerja e punimeve shtesë për projektin "Rehabilitimi i Teatrit Kombëtar të Operas dhe Baletit", me nr. REF-49766-02-06-2020. Me datë 19.02.2020 është publikuar në SPE njoftimi i kontratës me fitues "AGI KONS". Gjithashtu u bë dhe këqyrja e faqes së internetit te "AGI KONS", ku shfaqen të dhëna për këtë projekt.

**29.3. Nga këqyrja në internet në faqen "*openprocurement.al*", përkatësisht në rubrikën "Koncesion/PPP", kanë rezultuar procedurat prokuruese në të cilat subjekti "AGI KONS" ka marrë pjesë dhe është shpallur fitues.** Konkretisht: Me datë **03.11.2017,** autoriteti kontraktues Qeverisja Vendore Tiranë, ka shpallur koncesionin me objekt "Koncesion/Partneritet Publik Privat (PBOTM) për Përmirësimin e Infrakstrukturës Arsimore në Bashkinë e Tiranës në Zonën Tirana 1" ku me datë 15.02.2018 është shpallur fitues dhe është Kompania Koncesionare Z.M.A. me nipt L81729026T.

**29.3.1. Objekti i Kontratës** - Projektim, Financim, Ndërtim, Mobilim, Mirëmbajtje, Mbikëqyrje dhe Kolaudim e pesë objekteve arsimore në zonën nr. 1 Bashkia e Tiranës Kostoja e vlerësuar e projektit njëkohësisht fond limit për këtë tenderim është **1 940 859 276 (një miliard e nëntëqind e dyzetë milion e tetëqind e pesëdhjetë e nëntë mijë e dyqind e shtatëdhjetë e gjashtë) Lekë pa TVSH.**

**29.3.2. Forma e kontratës:** Koncesion/Partneritet Publik Privat (PBOTM).

**29.3.2. Burimi i financimit:** Bashkia Tiranë dhe Ministria e Arsimit Sportit dhe Rinisë (Autoriteti Kontraktor). <u>**Kohëzgjatja e kontratës PPP të Koncesionit do të jetë: 7 (shtatë) vite e 18 (tetëmbëdhjetë) muaj.**</u> Për Zonën Tirana 1 janë parashikuar gjithsej 5 shkolla. Autoriteti Kontraktor do të ofrojë një sipërfaqe prej 27 936 metra katrorë vendosur përkatësisht: Tre objekte arsimore janë vendosur në njësinë Administrative 11 dhe dy objekte arsimore në njësinë Administrative nr. 9. Kompania Koncesionare që do të krijohet pas lidhjes së kontratës së Koncesionit do të shlyhet tërësisht (likuidohet) për totalin e shumës së

investuar (shpenzuar) në një periudhë kohore prej 7 vitesh nga data e dorëzimit të objekteve duke i përllogaritur edhe një rimbursim për marzh fitimi në masën 6.28 % në vit. Koncesionari do të përballojë me të ardhurat e veta të gjithë investimin për projektimin ndërtimin mobilimin pajisjen me laboratorë, mirëmbajtjen, mbikëqyrjen dhe kolaudimin si dhe vënien në funksion të tyre. Objektet arsimore duhet të ndërtohen si dhe të jenë funksionale në një afat kohor prej 18 (tetëmbëdhjetë) muaj nga data e lidhjes së kontratës. Pas ndërtimit dhe vënies në funksion të objekteve arsimore, koncesionari/PPP do të mirëmbajë objektet për një periudhë 7 (shtatë) vjeçare. Pas përfundimit të ndërtimit, Autoriteti Kontraktor do i paguajë koncesionarit/PPP një shumë të caktuar vjetore deri në përfundim të plotë të shumës së investuar.

**29.4. Nga kryerja e verifikimeve (këqyrje) në QKB në lidhje me shoqërinë koncesionare Z.M.A. ka rezultuar sa vijon:** *Numri unik i identifikimit te subjektit (NUIS) - L81729026T.* ***Data e Regjistrimit** - 29/05/2018.* ***Data e themelimit** - 22/05/2018.* ***Emri i Subjektit** - Shoqëria Koncesionare Z.M.A.* ***Zyra qendrore e shoqërisë në Shqipëri** - Tirane Rruga Unaza e Re, njesia II 04, nr.pasurie 440/142, ZK 2679.* **Objekti i aktivitetit** - projektimi, financimi, ndertimi, mobilimi, mirembajtja, mbikëqyrja dhe kolaudimi i pese objekteve arsimore ne Zonen Tirana 1, qe percaktohen Kontraten e Koncesionit me Bashkine Tirane ("Projekti"). 2. 2. Shoqeria, ne menyre dytesore dhe jo ne menyre direkte, dhe sidoqofte vetem per te permbushur objektin tregtar te Shoqerise, mund te kryeje cdo veprimtari tregtare, industriale, financiare dhe transaksione ne lidhje me pasuri te luajtshme dhe te paluajtshme te cilat do te konsiderohen si te nevojshme dhe te domosdoshme nga administratoret per permbushjen e objektit te Shoqerise. 2.3. Shoqeria mund te ushtroje aktivitete te tjera ndihmese ose te lidhura duke perfshire importin dhe eksportin, si dhe te gjitha aktivitetet e nevojshme dhe te domosdoshme per te permbushur objektin e Shoqerise ne perputhje me ligjin. ***Statusi** – Aktiv.* ***Administratori** - Endrit Bruci.* ***Ortakët:*** **1) ZENIT&CO,**[13] Vlera e kapitalit Para: 301.800,00, Numri i pjesëve 1,00 Pjesëmarrja në përqindje (%) ,15; **2) AGI KONS, Vlera e kapitalit Para: 174.943.400,00, Numri i pjesëve 1,00, Pjesëmarrja në përqindje (%) 86,95;** 3) **MET-ENGENEERING,** Vlera e kapitalit Para: 25.954.800,00 Numri i pjesëve **1,00** Pjesëmarrja në përqindje (%) 12,90.

**29.5.** U procedua me këqyrjen e faqes së internetit te **"AGI KONS"**, ku tek rubrika "Projektet", **"Arsimi"** është konstatuar ndërtimi i shkollës **9-vjeçare** "Andrea Stefani" me adresë rruga rruga "Vangjel Noti", Tiranë. Nga verifikimet e kryera rruga "Vangjel Noti" ndodhet në Njësinë Administrative 11, Tiranë.

**30.Gjithashtu, procedua me verifikimin në faqen e internetit *"opencorporates.al"* aksioner/ortakë me emrin AGI KONS ku morëm rezultatet: 1)** Clean Energy **dhe 2)** Shoqëria Koncesionare Z.M.A.

**30.1. U kryen verifikime në QKB në lidhje me subjektin Clean Energy Al ku rezultoi: NUIS** – L21505008E. **Data e Regjistrimit** - 05/03/2012. **Data e themelimit** - 06/01/2012. **Emri i Subjektit** - Clean Energy Al. **Zyra qendrore e shoqërisë në Shqipëri** - Tirane Farke SELITE Kodra e Diellit II, Godine e kombinuar 4 kat + 1 kat nentoke, nr. pasurie 51/159, Farke Selite, Tiranë. **Objekti i aktivitetit** - Financimi, projektimi, ndërtimi, operimi dhe transferimi i Hidrocentraleve "Në pellgun ujëmbledhës të zallit të

[13] https://opencorporates.al/sq/nipt/k61731002d. (Kjo kompani ka qenë ish Zenit – 06).



SPIKATUEJAL

Bulqizës/Vajkal-Rrethi Bulqize" tek Autoriteti Kontraktues, ku përfshihet: Financimi, ndërtimi, vënia në punë, prodhimi, furnizimi, transmetimi, shpërndarja, eksportimi dhe shitja e energjisë elektrike, në zbatim të Kontratës së Koncesionit. **Administratori** - Kelmend Hodaj. **Ortakët** – AGI KONS, Vlera e kapitalit Para: 10.000,00. Numri i pjesëve 1,00. Pjesëmarrja në përqindje (%) 100. **Statusi** – Pezulluar.

**31.** Në kuadër të verifikimeve, u proceduа me kërkime të dhënash në lidhje me shtetasin **Gentjan Sula** në burime të hapura në internet nga ku rezultoi se gjatë verifikimeve në **"Agjencinë e Regjistrimit të Bizneseve të Kosovës"**, të Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë, u administruan në fashikull të dhënat e mëposhtme: **Emri i Biznesit** – STELLA CONSULTING SH.P.K. **Numri unik identifikues** – 810792269. **Data e Regjistrimit** – 16/05/2008. **Adresa** – Shtërpcë, mështekna Rruga, Nr.210. **Pronar/Aksionarë** – Veton Surroi me kapital ne euro 1,500.00 dhe kapital në përqindje 30.00%. **Gentjan Sula** me kapital ne euro 3,500.00 dhe kapital në përqindje 70.00%. **Me aktivitet primar** – Aktivitetet e këshillimit për biznes dhe këshillat e tjera për manaxhim.

**31.1.** Në vijim u proceduа me verifikime në lidhje me shoqërinë "STELLA CONSULTING SH.P.K", burim internet, ku u administrua artikulli i datës 03/03/2022 i faqes së internetit "*ekonomiaonline.com*" me titull "*Aksioni "Brezovica": Arrestohen dy ish-zyrtarë të lartë, në kërkim edhe dhëndri i ministrit Liburn Aliu*". Gjithashtu, në të bëhet me dije edhe fakti se ***Prokuroria (Kosovë) javë më parë ka ngrirë mjete financiare edhe të kompanisë "Stella Consulting" Sh.P.K., firmës private në bashkëpronësi të biznesmenit shqiptar Gentjan Sula dhe publicistit Veton Surroi. Këta të fundit dyshohet se i kanë dhënë ryshfet prej rreth 400 mijë eurove ish-kryetarit të Komunës së Shtërpcës, Bratisllav Nikoliç, në këmbim të lejeve ndërtimore në Brezovicë.***

**32.** Gjithashtu, në kuadër të verifikimit të faktit me shkresën Nr. 11712 Prot., datë 16.07.2024 është kërkuar informacion pranë Bashkisë Tiranë, lidhur me procedurat e prokurimit për punë publike/shërbime, koncesionet apo çdo kontratë tjetër që ka lidhur subjekti "Agi Kons" shpk me Bashkinë Tiranë. **Kjo e fundit, me kthim përgjigjen Nr. 27684/4 Prot., datë 31.07.2024, ka dërguar kopje të dokumentacionit që lidhet me Kontratat e Sipërmarrjes dhe të Shërbimit të lidhura midis Bashkisë së Tiranës si investitor dhe subjektit "Agi Kons" sh.p.k si sipërmarrës apo si bashkim operatorësh, të cilat janë si më poshtë vijon:**

**32.1. Kontrata e Sipërmarrjes Nr. 20772/77 Prot., datë 04.10.2016 me objekt** "Rikualifikimi i bllokut nr. 1 Laprake, kufizuar nga rruga Don Bosko-Shina Trenit Finlanto-Turhan Pash Përmeti-Ibrahim Pashë Bushatlliu-Lorg Bajron-Riza Cuka-Riza Cuka-Learton Vathi-Pandi Dardha-Dritan Hoxha". Nga përmbajtja e kësaj kontrate rezulton se vlera e kontratës është: <u>**331, 763, 607 lekë pa TVSH**</u>. Afati i realizimit të punimeve **18 muaj**. Bazuar në nenin 8 të kësaj kontrate nën titullin **"Mbikqyrësi i punimeve"** rezulton se Bashkia e Tiranës me të drejtën e investitorit ka përzgjedhur si mbikqyrës operatorin ekonomik **"Zenit – 06" sh.p.k tek ky projekt.** Ndërkohë ky i fundit tek procedura "Koncesion/Partneritet Publik Privat (PBOTM) për Përmirësimin e Infrakstrukturës Arsimore në Bashkinë e Tiranës në Zonën Tirana 1" ku me datë 15.02.2018 është shpallur fitues (kanë krijuar Kompaninë Koncesionare Z.M.A. me nipt L81729026T) bashkë me subjektin Agi Kons sh.p.k, për rrjedhojë janë ortak. **Pra, në kohën kur është lidhur kontrata e**

**konçesionit (ortakët Agi Kons sh.p.k me Zenit&CO** (ish Zenit -06)[14] **kanë qenë njëkohësisht në pozitën e sipërmarrës – mbikqyrës punimesh sipas Kontratës së Sipërmarrrjes Nr. 20772/77 Prot., datë 04.10.2016. Sipas pikë 2 të Udhëzimit Nr.3, datë 15.2.2001 "PËR MBIKËQYRJEN DHE KOLAUDIMIN E PUNIMEVE TË NDËRTIMIT" i ndryshuar, mbikëqyrësi i punimeve nuk duhet të jetë i lidhur, në asnjë mënyrë, me zbatimin e objektit, që do të drejtojë.** Në cilësinë e titullarit të Autoritetit Kontraktor ka nënshkruar shtetasi Erion Veliaj.

**32.2. Kontrata e Sipërmarrjes Nr. 26639/6 Prot., datë 11.11.2016** me objekt "Rikonstruksion rruga Zallit Selite". Nga përmbajtja e kësaj kontrate rezulton se vlera e kontratës është: **116, 977, 814 lekë pa TVSH**. Afati i realizimit të punimeve 10 muaj. Në cilësinë e titullarit të Autoritetit Kontraktor ka nënshkruar shtetasi Erion Veliaj.

**32.3. Kontrata e Sipërmarrjes Nr. 20932/6 Prot., datë 18.08.2017** me objekt "Rikualifikim urban i bllokut të kufizuar nga Rr. "Llambi Bonata", Rr. "Haki Stërmilli", "Musine Kokalar"" dhe rikonstruksion i rrugës "Zyber Zeneli", vazhdim i rrugës "Ali Këlmendi". Nga përmbajtja e kësaj kontrate rezulton se vlera e kontratës është: **101, 425, 728.71 lekë pa TVSH**. Afati i realizimit të punimeve 8 muaj. Bazuar në nenin 8 të kësaj kontrate nën titullin **"Mbikqyrësi i punimeve"** rezulton se Bashkia e Tiranës me të drejtën e investitorit ka përzgjedhur si mbikqyrës operatorin ekonomik **"Zenit – 06" sh.p.k**, i cili tek procedura "Koncesion/Partneritet Publik Privat (PBOTM) për Përmirësimin e Infrakstrukturës Arsimore në Bashkinë e Tiranës në Zonën Tirana 1" ku me datë 15.02.2018 është shpallur fitues, ka krijuar Kompaninë Koncesionare Z.M.A. me nipt L81729026T) bashkë me subjektin Agi Kons sh.p.k, për rrjedhojë janë ortak. **Pra, në kohën kur është lidhur kontrata e konçesionit (ortakët Agi Kons sh.p.k me Zenit&CO (ish Zenit -06)[15] njëkohësisht kanë qenë në pozitën e sipërmarrës – mbikqyrës punimesh sipas Kontratës së Sipërmarrrjes Nr. 20932/6 Prot., datë 18.08.2017. Sipas pikë 2 të Udhëzimit Nr.3, datë 15.2.2001 "PËR MBIKËQYRJEN DHE KOLAUDIMIN E PUNIMEVE TË NDËRTIMIT" i ndryshuar, mbikëqyrësi i punimeve nuk duhet të jetë i lidhur, në asnjë mënyrë, me zbatimin e objektit, që do të drejtojë.**

**32.4. Kontrata e Sipërmarrjes Nr. 22461/6 Prot., datë 06.09.2017**, me objekt "Rikonstruksion i shkollës 9-vjeçare "Dora D'Istria". Nga përmbajtja e kësaj kontrate rezulton se vlera e kontratës është: **81.007.083 lekë pa TVSH**. Afati i realizimit të punimeve 8 muaj.

**32.5. Kontrata e Sipërmarrjes Nr. 17836/7 Prot., datë 28.05.2018** me objekt "Shtesë kontrate për objektin "Rikonstruksioni "Rruga e Zallit Selite". Nga përmbajtja e kësaj kontrate rezulton se vlera e kontratës është: **23, 276, 746 lekë pa TVSH**. Afati i realizimit të punimeve 2 muaj. Në cilësinë e titullarit të Autoritetit Kontraktor ka nënshkruar shtetasi Erion Veliaj.

**32.6. Kontrata e Sipërmarrjes Nr. 17445/7 Prot., datë 10.07.2019** me objekt "Rehabitimi i Parkut Rinia". Nga përmbajtja e kësaj kontrate rezulton se vlera e kontratës është: **94, 446, 931 lekë pa TVSH**. Afati i realizimit të punimeve 8 muaj. **Bazuar në nenin 8** të kësaj kontrate nën titullin **"Mbikqyrësi i punimeve"** rezulton se Bashkia e Tiranës me të

[14] https://opencorporates.al/sq/nipt/k61731002d.
[15] https://opencorporates.al/sq/nipt/k61731002d.

drejtën e investitorit ka përzgjedhur si mbikqyrës operatorin ekonomik **"Infratech" sh.p.k.** Në cilësinë e titullarit të Autoritetit Kontraktor ka nënshkruar shtetasi Erion Veliaj.

**32.7. Kontrata e Sipërmarrjes Nr. 24117/39 Prot., datë 29.09.2020, me objekt "Ndërtim i shkollës 9-Vjeçare "Qazim Turdiu"**, në zbatim të Marrëveshjes Kuadër nr. 25117/6 Prot., datë 28.08.2020, me objekt: "Rindërtimi i 8 (tetë) objekteve arsimore". Nga përmbajtja e kësaj kontrate rezulton se vlera e përgjithshme e kontratës është: <u>362, 713, 599</u> <u>**lekë pa TVSH**</u>. Afati i realizimit të punimeve 8 muaj. Ndërkohë në nenin 3 të kësaj Kontrate nën titullin **"Drejtuesi i projektit"** parashikohet shprehimisht se: *"3.1. Drejtuesi i Projektit do të jetë: Mbikqyrësi i punimeve, Bashkimi i Operatorëve Ekonomikë **"Zenit & CO" & Derbie-E" sh.p.k & "Zetakonsult" sh.p.k."***. **Pra, rezulton "Zenit & CO" është përzgjedhur si mbikqyrës në këtë projekt, ndërkohë që tek procedura "Koncesion/Partneritet Publik Privat (PBOTM) për Përmirësimin e Infrakstrukturës Arsimore në Bashkinë e Tiranës në Zonën Tirana 1" ku me datë 15.02.2018 është shpallur fitues, ka krijuar Kompaninë Koncesionare Z.M.A. me nipt L81729026T bashkë me subjektin Agi Kons sh.p.k, <u>për rrjedhojë janë ortak.</u> Kohëzgjatja e kontratës PPP të Koncesionit do të jetë: 7 (shtatë) vite e 18 (tetëmbëdhjetë) muaj. Kjo bën që në dy kontrata të ndryshme në të njëjtën kohë subjektet Agi Kons sh.p.k dhe "Zenit & CO" janë ortak dhe sipërmarrës-mbikqyrës. Sipas pikë 2 të Udhëzimit Nr.3, datë 15.2.2001 "PËR MBIKËQYRJEN DHE KOLAUDIMIN E PUNIMEVE TË NDËRTIMIT" i ndryshuar, mbikëqyrësi i punimeve nuk duhet të jetë i lidhur, në asnjë mënyrë, me zbatimin e objektit, që do të drejtojë.**

**32.8. Kontrata e Sipërmarrjes Nr. 42000/4 Prot, datë 16.12.2022 me objekt** "Ndërtim i Godinës së Teatrit Tiranë Faza e I-rë 2022". Nga përmbajtja e kësaj kontrate rezulton se vlera e kontratës është: <u>**1, 840, 784, 139.32 lekë pa TVSH**</u>. Afati i realizimit të punimeve 27 muaj. Ndërkohë në nenin 4 të kësaj Kontrate nën titullin **"Drejtuesi i projektit"** parashikohet shprehimisht se: *"3.1. Drejtuesi i Projektit do të jetë: Mbikqyrësi i punimeve, **"INFRATECH" shpk & "Engineering Consulting" sh.p.k...**"*.

**32.9. Kontrata e Shërbimit Nr. 14214/8 Prot., datë 07.04.2023** me objekt "Studim Projektim: Rikonstruksion i Godinës së Fakultetit të Historisë dhe Filologjisë". Në cilësinë e palës furnizuese në këtë kontratë është Bashkimi i Operatorëve Ekonomik **"INFRATECH" shpk & "Engineering Consulting" sh.p.k & "AGI KONS" shpk.** Çmimi i kontratës është <u>**23, 935, 080 lekë**</u>. Afati i realizimit të punimeve 10 muaj. **Konstatohet nga kjo kontratë se në bashkimin e operatorëve ekonomik me "AGI KONS" sh.p.k janë dhe operatorët ekonomik që janë mbikqyrësit e punimeve sipas Kontratës së Sipërmarrjes Nr. 42000/4 Prot, datë 16.12.2022 me objekt "Ndërtim i Godinës së Teatrit Tiranë Faza e I-rë 2022", ku afati i mbikqyrjes mbaron rreth muajit Mars 2025. Sipas pikë 2 të Udhëzimit Nr.3, datë 15.2.2001 "PËR MBIKËQYRJEN DHE KOLAUDIMIN E PUNIMEVE TË NDËRTIMIT" i ndryshuar, mbikëqyrësi i punimeve nuk duhet të jetë i lidhur, në asnjë mënyrë, me zbatimin e objektit, që do të drejtojë.**

**32.10. Kontrata e koncesionit/Partneritet Publik Privat për "Përmirësimin e Infrastrukturës Arsimore në Bashkinë e Tiranës"**, Loti I me **Nr. 9513 Rep, dhe Nr. 3756 Kol., datë 17.10.2018.** Në cilësinë e Autoritetit Kontraktor kjo kontratë është nënshkruar nga shtetasit Erion Veliaj dhe Lindita Nikolla.

**33.** Nga organi procedues është proceduar me këqyrjen e faqes së internetit te "AGI KONS", ku tek rubrika "Projektet", "Rezidenciale", ku është konstatuar ndërtimi i rezidencës së banimit *"Kodra e Diellit"* në Tiranë dhe të resortit *"Marea"* që ndodhet në fshatin Qerret, Kavajë. Nga provat e administruara rezulton e provuar se shtetasi Erion Veliaj dhe të afërmit e tij kanë blerë pasuri të paluajtshme në këto komplekse/resorte që janë ndërtuar nga **"AGI KONS" shpk**.

**34.** Nga hetimet rezultoi se shtetasi Gentjan Sula është gjithashtu aksioner tek Kompania "S&D Invest" sh.a. e cila ka si objekt të aktivitetit: *Menaxhim dhe shperndarje te ujit te pijshëm dhe largimin e ujrave te ndotura. Shërbime në fushën e mirëmbajtjes dhe administrimit të pronës së përbashket. Konsulencë teknike, projektim në fusha të ndryshme. Tregtim, import-eksport etj. Menaxhim dhe shërbim bar - restorante.*

**34.1.** Në lidhje me këtë kompani, me shkresën me Nr 17383/3 Prot., datë 30.10.2024 Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve ka dërguar informacion mbi deklarimet e kryera në librat e shitjes dhe librat e blerjes të shoqërive "Agi Kons" shpk me NIPT K21622001M dhe "S&D Invest" shpk me NIPT K82112004C. **Nga analizimi i deklarimeve të kryera nga shoqëria S&D Invest" me NIPT K82112004C, rezulton se <u>për shtetasin Erion Veliaj janë deklaruar 10 (dhjetë) fatura përgjatë viteve 2020-2021 duke shënuar në kolonën emri i blerësit "Erion Veliaj 6A" dhe "Erion Veliaj Vila 4A" dhe në rubrikën *Rrethi i blerësit* "Durrës".</u>** Të dhënat janë sipas tabelës së mëposhtme:

| Nipti_shitesit | emri_shitesit | muaji | viti | nr_fatures. | seriali. | data | emri_bleresit | rrethi_bleresit | nipti_bleresit | ot |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| K82112004C | SD Invest sha | 8 | 2020 | 10842 | 370572676 | 8/13/2020 | Erion Veliaj | Tirane | Individ | 8 |
| **K82112004C** | **SD Invest sha** | **8** | **2020** | **11494** | **370573228** | **8/15/2020** | **Erion Veliaj 6A** | **Durres** | **Individ** | [illegible] |
| **K82112004C** | **SD Invest sha** | **10** | **2020** | **14858** | **370578592** | **10/16/2020** | **Erion Veliaj 6A** | **Durres** | **Individ** | [illegible] |
| K82112004C | SD Invest sha | 10 | 2020 | 15589 | 370579143 | 10/20/2020 | Erion Veliaj | Tirane | Individ | [illegible] |
| **K82112004C** | **SD Invest sha** | **11** | **2020** | **16800** | **370579354** | **11/16/2020** | **Erion Veliaj 6A** | **Durres** | **Individ** | [illegible] |
| K82112004C | SD Invest sha | 11 | 2020 | 17756 | 370580310 | 11/22/2020 | Erion Veliaj | Tirane | Individ | [illegible] |
| ~~**K82112004C**~~ | ~~**SD Invest sha**~~ | ~~**9**~~ | ~~**2020**~~ | ~~**13160**~~ | ~~**370574894**~~ | ~~**9/16/2020**~~ | ~~**Erion Veliaj 6A**~~ | ~~**Durres**~~ | ~~**Individ**~~ | [illegible] |
| K82112004C | SD Invest sha | 9 | 2020 | 13631 | 370575365 | 9/22/2020 | Erion Veliaj | Tirane | Individ | |
| **K82112004C** | **SD Invest sha** | **12** | **2020** | **18952** | **370581456** | **12/15/2020** | **Erion Veliaj Vila 4 A** | **Durres** | **Individ** | |
| **K82112004C** | **SD Invest** | **4** | **2021** | **8970** | **370590332** | **4/19/2021** | **Erion Veliaj** | **Durres** | **Individ** | |

SPYETJE.AL

| | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | sha | | | | | | Vila 4 A | | |
| K82112004C | SD Invest sha | 1 | 2021 | 866 | 370584029 | 1/15/2021 | Erion Veliaj Vila 4 A | Durres | Individ |
| K82112004C | SD Invest sha | 2 | 2021 | 5106 | 370586469 | 2/25/2021 | Erion Veliaj Vila 4 A | Durres | Individ |
| K82112004C | SD Invest sha | 3 | 2021 | 7011 | 370588374 | 3/15/2021 | Erion Veliaj Vila 4 A | Durres | Individ |
| K82112004C | SD Invest sha | 5 | 2021 | 11802 | 372755011 | 5/31/2021 | Erion Veliaj Vila 4 A | Durres | Individ |

**35.** Pranë kompanisë "ONE ALBANIA", me shkresën Nr. 18985 O.D., datë 09.10.2024, është kërkuar informacion lidhur me numrin celular **67 20 55 982** (identifikuar si numri celular në përdorim të shtetasit Erion Veliaj). "One" ka kthyer përgjigjen me Nr. 3576/1 Prot., datë 23.10.2024, me të cilën ka dërguar edhe tabulatet telefonike të disponuara për këtë numër. Këto tabulate janë analizuar pjesërisht sipas procesverbalit datë 30.10.2024. **Nga analiza ka rezultuar se numri celular më sipër ka patur logime të shpeshta në zonën e Qerretit. Nga kjo analizë, rezulton se këto logime janë kryesisht gjatë fundjavave, por ka edhe logime të cilat janë gjatë ditëve të caktuara të javës.**

**35.1.** Kështu, referuar shkresës Nr. 3576/1 Prot., datë 23.10.2024 ka rezultuar se: Numri celular 0672055982, është i regjistruar në emër të "Test Quality Assurance (k)". Nr. Identf: 14444. Gjithashtu, ONE Albania, në CD përkatëse, ka dërguar tabulatet telefonike për këtë numër, të cilat në ndodhen në CD, në 3 file "Excel" me titujt si më poshtë: **1)** "KOMUNIKIMET E NR.CEL. 355672055982 P.1.xlsx"; **2)** "KOMUNIKIMET E NR.CEL. 355672055982 P.2.xlsx"; **3)** "KOMUNIKIMET E NR.CEL. 355672055982 P.3.xlsx".

**35.2.** Në file-in e parë excel me titull **"Komunikimet e Nr. Cel. 355672055982 P.1.xlsx"** duke përdorur kolonat e filtrit **"Cell district name"** (përzgjedhur opsioni **"Durres" dhe "Kavaje"**) dhe filtrit **"Cell Locality"** (përzgjedhur opsioni **"Golem", "Kavaje", "Lekaj")**, shfaqen gjithsej **87** rezultate, të cilat datojnë nga data **08.04.2023-13.05.2023.** Këto rezultate kanë emrat e qelizave telefonike: "Cell name" si FABRI_KAVA A, FABRI_KAVA N, FABRIKAVAM9, GOLEMI C, GOLEMI EUROCOL B, GOLEMI F, GOLEMI O, GOLEMI, SOUTH A, GOLEMI SOUTH C, GOLEMI SOUTH F, GOLEMI V, GOLEMSOUTM9, HARIZAJ A, HARIZAJ B, HARIZAJ E, HARIZAJ U, HARIZAJ V, KAVAJA NEË T, KAVAJA NEË U, KAVAJANEËL9, KAVAJANEËQ4, KAVAJANEËQ9, KAVAJE NEË E, KAVAJE NORTH B, KAVAJE NORTH C, MALI ROBIT A, MALI ROBIT C, MALI ROBIT D, MALI ROBIT F, MALI ROBIT V,MALIROBITK9, QERETIBEAM9, QERRETI BEACH C.

**35.3.** Nga analiza rezulton se këto qeliza antenash i përkasin datave: **15.04.2023-Ditë e Shtunë, 30.04.2023-Ditë e Dielë, 01.05.2023-Ditë e Hënë, 03.05.2023-Ditë e Mërkurë, 06.05.2023-Ditë e Shtunë, 07.05.2023-Ditë e Dielë, 09.05.2023-Ditë e Martë, 12.05.2023-Ditë e Premte, 13.05.2023-Ditë e Shtunë.** Ndër to konstatohen edhe qelizat e antevave

telefonike me emër qelize ("Cell name") si QERETIBEAM9 (data 03.05.2023) apo QERRETI BEACH C/QERRETI BEACH F (data 07.05.2023).

**35.4.** Në file-in tjetër excel me titull "**Komunikimet e nr. cel. 355672055982 P.2.xlsx**", duke përdorur kolonat e filtrit "**Cell district name**" (përzgjedhur opsioni "**Durres**" **dhe** "**Kavaje**") dhe filtrit "**Cell Locality**" (përzgjedhur opsioni "**Golem**", "**Lekaj**", "**Gose e Madhe**", "**Synej**"), shfaqen gjithsej 137 rezultate, të cilat datojnë nga data **08.04.2023-13.05.2023.** Këto rezultate kanë emrat e qelizave telefonike: MALI ROBIT F, HARIZAJ A, MALI ROBIT C, MALI ROBIT V, MALIROBITM9, PLAZHGJENB4, HARIZAJ V, HARIZAJ C, GOLEMI O, HARIZAJ D, GOSE B, QERETIBEAC4, GOLEMI EUROCOL A, QERETIBEAM9, QERRETI BEACH F, QERRETI, BEACH C, MALI ROBIT A, GOLEMI SOUTH V, HARIZAJL9.

**35.5.** Nga analiza, rezulton se këto qeliza antenash i përkasin datave 04.06.2023 **-Ditë e Dielë**, 01.07.2023 **-Ditë e Dielë**, 02.07.2023 **-Ditë e Hënë**, 08.07.2023 **-Ditë e Hënë**, 11.07.2023 **-Ditë e Martë**, 18.07.2023 **-Ditë e Martë**, 19.07.2023 **--Ditë e Mërkurë**, 23.07.2023 **-Ditë e Dielë**, 24.07.2023 **-Ditë e Hënë**, 28.07.2023 - **Ditë e Premte**, 30.07.2023-**Ditë e Dielë**, 27.08.2023 - **Ditë e Dielë**, 02.09.2023 - **Ditë e Dielë**, 06.09.2023 **-Ditë e Mërkurë**, 15.12.2023-Ditë e Mërkurë. Ndër to konstatohen edhe qelizat e antevave telefonike me emër qelize ("Cell name") si **QERETIBEAC4 (data 23.07.2023-ora: 18:25-24.07.2023 ora 08:04)** etj.

**35.6.** Në file-in tjetër excel me titull "**Komunikimet e nr. cel. 355672055982 P.3.xlsx**", duke përdorur kolonat e filtrit "**Cell district name**" (përzgjedhur opsioni "**Durres**" **dhe** "**Kavaje**") dhe filtrit "**Cell Locality**" (përzgjedhur opsioni "**Golem**", "**Gose e Madhe**", "**Kavaje**", "**Synej**" **dhe** "**Lekaj**"), shfaqen gjithsej 356 rezultate, të cilat datojnë nga data **25.01.2024-07.10.2024.** Këto rezultate kanë emrat e qelizave telefonike: GOLEMI SOUTH T, KAVANORTHA4, GOLEMSOUTP4, GOLEMI SOUTH F, GOLEMI O, KARPEN A4, GOLEMI U, SEFERAJC4, HARIZAJ T, QERETIBEAA4, PLAZHGJENC4, KAVANORTHB4, MALI ROBIT V, MALI ROBIT C, QERRETI BEACH F, QERETIBEAC4, MALI ROBIT F, MALI ROBIT A, GOLEMIN4, MALIROBIN4, MALI ROBIT E, KAVANORTHC4, KAVAJA NEË U, MALIROBIO4, MALIROBIG4, KAVAJE NORTH C, GOLEMI EUROCOL A, KAVAJE NEË E, SEFERAJA4, QERRETI BEACH C, GOLEMI2M9, GOLEMIO4, GOLEMI 2 T, GOLEMI EUROCOL A4, SEFERAJ F, MALIROBIQ4, GOLEMI SOUTH U, HARIZAJG4, GOSE B.

**35.7.** Nga analiza, rezulton se këto qeliza antenash i përkasin datave 25.01.2024-**Ditë e Hënë**, 07.03.2024-**Ditë e Enjte**, 20.03.2024--**Ditë e Mërkurë**, 29.03.2024-**Ditë e Premte**, 24.04.2024-25.04.2024-E Mërkurë-E Enjte, 04.05.2024-**Ditë e Shtunë**, 9.05.2024-Ditë e Enjte, 12.05.2024-**Ditë e Dielë**, 07.06.2024-**Ditë e Premte**, 16.06.2024--**Ditë e Dielë**, 17.06.2024--Ditë e Hënë, 22.06.2024--**Ditë e Shtunë**, 23.06.2024-**Ditë e Dielë**, 24.06.2024-**Ditë e Hënë**, 27.06.2024-30.06.2024-**E Enjte-E Dielë**, 07.07.2024-**Ditë e Dielë**, 13.07.2024-**Ditë e Shtunë**, 14.07.2024- **Ditë e Dielë**, 21.07.2024 **Ditë e Dielë**, 24.07.2024-**Ditë e Mërkurë**, 03.08.2024-**Ditë e Shtunë**, 04.08.2024-**Ditë e Dielë**, 08.08.2024-**Ditë e Enjte**, 14.08.2024 **Ditë e Mërkurë**, 17.08.2024-**Ditë e Shtunë**, 20.08.2024-**Ditë e Martë**, 28.08.2024-**Ditë e Mërkurë**, 29.08.2024, 07.09.2024-08.09.2024-**E shtunë-E Dielë**, 17.09.2024-**Ditë e Martë**, 28.09.2024-29.09.2024=**E shtunë-E Dielë**, 07.10.2024-**E Hënë.** Ndër to konstatohen edhe qelizat e antevave telefonike m "Cell site name" si "Golemi South



SPECIALE.AL

(25.01.2024), "Qerreti Beach" (04.05.2024, 22.06.2024-23.06.2024, 17.08.2024, 20.08.2024, 28.08.2024), "Qerreti Beach F" apo "QeretiBeachC4" (22.06.2024), "Mali Robit" (shumica prej tyre) etj.

**35.8.** Lidhur me vendodhjen e kompleksin "Marea Resort", Qerret, Kavajë, në të cilin ndodhet *zona e stimuluar "Ardian Çarçani"*, me qëllim për të verifikuar se nga kush antena të telefonisë telefonike të "One Albania" mbulohen, është kërkuar informacion pranë kësaj kompanie. Për qëllim të përcaktimit të vendndodhjes objekt kërkese, janë marrë koordinatat nga Google Maps.

**35.8.1.** "One Albania" ka kthyer përgjigjen Nr. 3852/1 Prot., datë 01.11.2024, sipas të cilës, zona me koordinatat Latitude 41.225959, Longitude19.513629, mbulohet nga antenat me emër *"Qeretibead4"*, *"Qeretibeak4"*, *"Qeretibeaa4"*, *"Qeretibeak9"*, *"Qeretiban4"*, *"GoelmSoutf4"*, *"Golemsoutm4"*, *"Golemsoutc4"*, *"Golemisoutm9"*, *"Golemsoutp4"*, *"MaliRobif4"*, *"MaliRobim4"*, *"MaliRobic4"*, *"Malirobitm9"*, *"Malirobip4"*.

**35.8.2.** Nga kjo analizë, rezulton se këto logime janë kryesisht gjatë fundjavave, por ka edhe logime të cilat janë gjatë ditëve të caktuara të javës (Premte-E hëne, E martë, E mërkurë). **Këto logime janë në zonën e Qerretit, Kavajë. Nisur nga përgjigja më sipër e One Albania këto logime konkludohet të jenë në zonën e Qerretit, në ose në afërsi të Marea Resort.**

**35.8.3.** Konkluzioni më sipër mbështet edhe nga krahasimi i bërë me tabulatet e numrit celular 355674096731, të shtetasit **Arbër Veliaj**. Ky i fundit, edhe për shkak të vilës së regjistruar në emër të tij në këtë zonë, ka frekuentime të shpeshta referuar këtyre tabulateve.

**36.** Gjithashtu, në përmbledhje të rezultateve të kontrollit të miratuar nga Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, me Vendimin nr. 698 datë 05.12.2024, lidhur me dy banesat: **1.) Pasuria** Nr. 1/650, volum 29, faqe 166, ZK 3101, ndodhur në Zonën e Stimuluar **"Ardian Çarçani"**, Qerret, lloji "truall", sipërfaqja totale 446.6 m2 (nga të cilat truall 446.6 m2; **Ndërtesë 80.42 m2**), referuar ndryshe si Vila nr. 5, në pronësi të **Arbër Veliaj**; dhe **2) Pasuria** Nr. 1/647, Vol 29, faqe 103, ZK. 3101, ndodhur në Zonën e Stimuluar "Ardian Çarçani", Qerret, lloji **"truall"**, sipërfaqe trualli të objektit 494 m2, vilë, me sipërfaqe të bazës së njësisë 82 m2, në pronësi të **"Agi Kons" shpk, (MAREA RESORT, QERRET), rezulton se ka dyshime të arsyeshme të bazuara në prova se shtetasi Erion Veliaj dhe bashkëshortja e tij Ajola Xoxa, janë zotëruesit faktikë të pasurisë nr. 1/647.**

**37.** Këto dyshime mbështeten edhe në deklarimet e marra nga Administratori i resortit, shtetasi **Maksim Greva**, i cili konfirmon ndër të tjera praninë e shtetases Ajola Xoxa në objekt. **Sipas deklaruesit pasuria në fjalë administrohet nga shoqëria "S&D Invest" Tiranë. Ky informacion i dhënë nga shtetasi Maksim Greva paraqet mjaft interes për hetimin, pasi konfirmon pagesat e bëra nga shtetasi Erion Veliaj, pranë shoqërisë së mësipërme (S&D Invest në pronësi të Gentian Sulës) për mirëmbajtjen e objektit të emërtuar 4A, siç më sipër u përshkrua.** Këto fakte provohen me procesverbalin *"Për pyetjen e personit që ka dijeni për rrethana të dobishme për hetimin"* mbajtur më datë 6.12.2024.

**37.1. Nga tabela e pagesave, rezulton se ka qenë shtetasi Erion Veliaj, që gjatë periudhës 2020-2021 (periudhë që përkon me blerjen e vilës tjetër nga Arbër Veliaj) ka**



SYRI.NET

**bërë pagesa për mirëmbajtjen e objektit të emërtuar si Vila 4A.**

38. Gjithashtu, këto dyshime mbështeten në rezultatet e kontrollit të ushtruar në *pasurinë nr. 1/647, Vol 29, faqe 103, ZK. 3101 (Vila nr. 4)*. Sipas procesverbalit datë 06.12.2024 *"Për kontrollin e vendeve"*, rezulton se kontrolli në këtë vilë është kryer në praninë e shtetasit Erald Simixhiu dhe të shtetasit Dashamir Allaraj. Nga kontrolli kanë rezultuar një sërë sendesh të cilat lidhen me shtetasen Ajola Xoxa, Valbona Xoxa, apo familjarë të tyre. Ajo çfarë paraqet interes janë sendet të cilat dokumentojnë lidhjen e shtetases Ajola Xoxa me mirëmbajtjen e objektit. Konkretisht, në banesë është gjetur dhe sekuestruar në cilësinë e provës materiale ndër të tjera dhe sa poshtë vijon: **i)** Një letër format A4, si e lagur, në të cilën është një tabelë më mbishkrimin **"Shërbim mirëmbajtje pishine", klienti "Arjola", me përshkrim "Mirëmbajtje Gusht, Shtator, Tetor 2024", me vleftë të shënuar "45000"; ii)** Një letër format A4, e cila është një tabelë me kokën **"Shërbim mirëmbajtje pishine", me shënimet Muaji "2023-2024", Klienti "Arjola"**, përshkrimi për shërbimet në vleftën totale "102500", faturë e cila është e vulosur me vulë rrethore të subjektit me NUIS: K71630041Q, me emër "Počatec-AL" shpk; **iii)** Një bllok i vogël shënimesh në brendësi të të cilit ndodhet një shënim në dukje i shkruar nga shtetasja Valbona Xoxa. Konkretisht kjo e fundit shkruan më datë 03.07.2023: *Sot pagova Kujtimin x muajt Mars, Prill, Maj, Qershor, Korrik=350 mijë.* ***I dhashë 400 mijë (më tha Jolka), meqë ujit edhe oborrin tjetër. Siç më tha Jolka, i thashë se "që nga gushti do ta rrisim rrogën".*** **Ndërsa është pyetur si person që ka dijeni për veprën penale, për mënyrën si e thërret nëna e saj Valbona Xoxa në përditshmëri, shtetësja Ajola Xoxa është përgjigjur: "JOLKA"; iii)** Shënime dore të cilat kanë lidhje me arredimin e vilës, si: ***me tapa+bamboo+koshi i madh. Dhoma e vogël: Pikturë/dekor mbi krevat. Dhoma e madhe-bamboo, dollap, komodinë, komo, dekor. Dorezat e shkallës.*** Këto shënime duket se i përkasin shkrimit të shtetases Ajola Xoxa.

**38.1.** Përveç sa më lart, në bllok evidentohen pagesa të tjera mirëmbajtje për pasurinë në fjalë, të cilat shënohen me kujdes nga shtetësja Valbona Xoxa, për faktin se i duhet të raportojë për to tek shtetësja Ajola Xoxa, e cila paguan në të vërtetë shpenzimet për këto shërbime.

**38.2.** Veç sendeve më sipër, në banesë, sipas procesverbalit datë 06.12.2024 *"Për kontrollin e vendeve"*, janë evidentuar edhe një sërë sendesh si **veshje për të rritur, veshje për fëmijë, të cilat tregojnë se në këtë banesë kanë banuar/banon shtetësja Ajola Xoxa** dhe familjarë të saj, si dhe shtetësja Valbona Xoxa.

**39.** Nga deklarimet e shtetasit **Driant Zeneli** rezultuan të dhëna me interes për hetimin në lidhje me pasurinë e paluajtshme të llojit vilë, ndodhur në Qerret Kavajë, për të cilën shtetasi Driant Zeneli u shpreh se kishte dijeni që i përket shtetases Ajola Xoxa. Konkretisht ka deklaruar se ***"Më ka thënë Ajola disa herë që mund të shkoja me djalin tek shtëpia në Qerret, por nuk kam shkuar asnjëherë.*** *Unë kam bërë pushimet tek resorti Marea, Qerret, por i kam paguar vetë. E kam njoftuar dy tre herë që jam te resort Marea. Më ka thënë që do vinte por në të vërtetë nuk n aka takuar."*. Këto fakte provohen me procesverbalin *"Për pyetjen e personit që ka dijeni për rrethana të dobishme për hetimin"* mbajtur më datë 17.12.2024.

**40.** Nga deklarimet e shtetases **Adela Kondakçiu** rezulton se vila në zonën e Qerretit, Kavajë, njihet prej punonjësve të shtetases Ajola Xoxa, e cila duket se ka shfrytëzuar

arkitektin Olsi Efthimi për arredimin e saj. Këto fakte provohen me procesverbalin *"Për pyetjen e personit që ka dijeni për rrethana të dobishme për hetimin"* mbajtur më datë
12.12.2024.

**41.** Gjithashtu, nga deklarimi i shtetases **Anxhela Qunaj** e cila punon që prej muajit
Mars 2024 në zyrat e shoqërisë Partners Lač, administruar nga Ajola Xoxa rezulton se **nga**
**bisedat në ambjentet e punës ka kuptuar se Ajola ka një shtëpi plazhi,** por nuk ka
informacion se si e frekuenton. Këto fakte provohen me procesverbalin *"Për pyetjen e*
*personit që ka dijeni për rrethana të dobishme për hetimin"* mbajtur më datë 14.01.2025.

**42.** I pyetur më datë 16.01.2025 si person që ka dijeni për veprën penale, shtetasi
**Armand Manahasa**, shpjegon ndër të tjera se **nga muaji Shkurt i vitit 2019 deri në Nëntor**
**të vitit 2021 ka qenë i punësuar si shofer personal i shtetases Ajola Xoxa.** Këtë shtetase e
njeh nëpërmjet babait të saj Arben Xoxa, i cili ka vdekur në muajin Shkurt të vitit 2019.
**Shtetasi Armand Manahasa ka shpjeguar se e ka shoqëruar shtetasen Ajola Xoxa,**
përveç shtëpisë së saj tek "Kodra e Diellit" dhe zyrat në "Sky Tower", **<u>edhe në fshatin</u>**
**<u>Qerret, tek një vilë brenda kompleksit "Marea"</u>.** Deklaruesi shprehet se ka filluar të
shoqërojë shtetasen Ajola Xoxa dhe nënën e saj në Qerret, tek kompleksi në fjalë, në
periudhën 2019-2020. Gjithashtu, në disa raste ka shoqëruar dhe pastruesen e saj që quhej
Ela. Deklaruesi shprehet se shpesh ka transportuar në vilën brenda kompleksit edhe sende
personale shtëpiake si edhe rroba të ndryshme. **I pyetur nëse ka shoqëruar ndonjëherë**
**shtetasin Arben Xoxa tek vila në Qerret, deklaruesi shprehet <u>se nuk ka qenë asnjëherë</u>**
**<u>atje me këtë shtetas dhe as nuk e ka dëgjuar ndonjëherë të përmendej kjo vilë prej</u>**
**<u>shtetasit Arben Xoxa.</u>**

**42.1.** I pyetur rreth një mesazhi të shkëmbyer me shtetasin Olsi Efthimi më datë
16.07.2020, ku i drejtohet duke e pyetur *"Do shkoni në Qerret sot?"*, të cilit Olsi Efthimi i
përgjigjet *"Jo nuk do shkojmë se ka ditëlindjen"*, **deklaruesi shprehet se komunikimi është**
**bërë me këtë shtetas pasi ai shoqërohej herë pas here me Ajola Xoxën, dhe në dijëninë e**
**tij shkonte (Olsi Efthimi) <u>tek vila në Qerret, pasi merrej me arredimin e saj, me punë</u>**
**<u>dhe aspekte të tjera.</u>** I pyetur nëse kishte qenë në ambientet e brendshme të banesës së
shtetases Ajola Xoxa, deklaruesi shprehet se nuk ka qenë asnjëherë. Deklaruesi ka shtuar <u>se</u>
<u>banesa ndodhej në katin e dytë të banimit, ndërsa në katin tjetër sipër katit të banimit ku</u>
<u>banonte Ajola, ajo po kryente punime të cilat ndiqeshin nga shtetasi Olsi Efthimi.</u> Këto fakte
provohen me procesverbalin *"Për pyetjen e personit që ka dijeni për rrethana të dobishme*
*për hetimin"* mbajtur më datë 16.01.2025.

**43.** Gjithashtu, nga organi procedues është proceduar me këqyrjen e aparatit celular të
shtetasit Armand Manahasa, i sekuestruar në zbatim të vendimit të Gjykatës së Posaçme të
Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar Nr. 56 datë 15.01.2025. Nga
këqyrja e dokumentuar me procesverbalin e datës 17.01.2025 rezulton ndër të tjera se në
aparatin celular të këtij shtetasi është i regjistruar numri i telefonit **+355672020124,** i cili
përdoret nga shtetësja Ajola Xoxa. Me këtë numër, rezulton që shtetasi Armand Manahasa ka
patur biseda, të cilat fillojnë me datë 26 gen 2021 (26.01.2021), ndërsa komunikimi i fundit
është realizuar me datë 6 ott 2023 (06.10.2023). Nga këqyrja konstatohen komunikime të
ndryshme te realizuara me mesazhe të shkruar dhe zanore. Në aplikacionin të ËhatsApp
konstatohet se gjënden komunikime që i përkasin datës 1 nov 2021 (01.11.2021).
Konkretishtt, **numri +355672020124 (Ajola Xoxa), i dërgon Armand Manahasës mesazh**

**zanor me kohëzgjatjë 0:10 sekonda në orën 11:49.** Mesazhi ka përmbajtjen sa vijon: ***"Mandi kur ti sjellësh varëset, rri lëri këtu te dera, është dhe Ela këtu te shpia. Ndërkohë po vjen Olsi që të inspektojë punimet lart, kështu që do hypi edhe unë lart e do zbres me Olsin, kshuqë vazhdo ti pa merak."*** Shtetasi Armand Manahasa në orën 11:49, përgjigjet me mesazh të shkruar ***"Ok"***.

**43.1.** Me datë 11 nov 2021 (11.11.2021), konstatohet që numri **+355672020124**, i dërgon Armand Manahasës, mesazh skeda kontaktesh (numra kontaktesh) me tekst Juxhini Agikons Marea e altri 3 contatti. Klikojmë te shigjeta në të djathtë të skedës ku më pas shfaqen 4 (katër) kontakte, ku pasi klikojmë mbi emrat na shfaqen numrat sa vijon: *1) **Juxhini Agikons Marea me numër +355684016555;** 2) Dinepi Dyqan Bllok (Madi, Majli) me numër +355672003578; 3) Franka Anima me numër +355693282560; 4) Shpetim Baca me numër +355694570803.*

**43.2.** Më pas në të njëjtin aplikacion konstatohen dhe këqyren bisedat e zhvilluara me kontaktin e regjistruar me emrin **"Olsi Eftimi"**, me numër telefoni **+355692046626**. Këtij të fundit, më datë 16 lug 2020 (16.07.2020), shtetasi **Armand Manahasa** i dërgon mesazhe të shkruara në orën 10:51, me përmbajtjen sa vijon: *Olsi Pershendetje! Do shkoni ne Qerret sot ? Po me pyesin shoqet e Ajoles. Do dali zdo dali. Se duan ti bejne nje surprize.* Kontakti "Olsi Eftimi" i përgjigjet me mesazh të shkruar në orën 10:52, me përmbajtjen sa vijon: *Pershendetje! Jo nuk do shkojme se ka ditelindjen. Po me tha Xhoi.*

**43.3. Në përmbledhje të deklarimeve të shtetasit Armand Manahasa, rezulton edhe njëherë se vila e ndodhur në Qerret, kompleksi "Marea Resort" është në pronësinë faktike të familjes Veliaj-Xoxa. Nga këto deklarime rezulton se edhe pse ka qenë shofer i shtetasit të ndjerë Arben Xoxa, Armand Manahasa nuk ka qenë kurrë në vilën e Qerretit para vitit 2019. Kujtohet këtu se nga shtetasit nën hetim pretendohet se kjo vilë është blerë në vitin 2017 nga prindërit e shtetases Ajola Xoxa. Për herë të parë, shpjegon deklaruesi, në vilë është shkuar në vitin 2019-2020. Po ashtu, Armand Manahasa nuk ka dëgjuar asnjëherë të flitet për këtë vilë nga shtetasi i ndjerë Arben Xoxa.**

**43.3.1.** Shtetasi Olsi Efthimi nga këto deklarime, por edhe nga të dhëna të tjera, duket se është personi që ka ndjekur punimet për arredimin por edhe ndërtim të më shumë se një pasurie të paluajtshme që dyshohet se zotërohen nga bashkëshortët Veliaj Xoxa. Ky shtetas rezulton të ketë shkuar në vilën e Qerretit për t'u marrë me arredimin e saj. Nga këqyrja e realizuar në telefonin celular të shtetasit Ergys Krisiko, rezulton qartë se jo vetëm oborri i vilës, por edhe ambientet e brendshme të saj nuk kanë përfunduar akoma, të paktën deri në vitin 2020. Gjithashtu, ky shtetas rezulton se ka ndjekur edhe punimet e ndërtimit në katin e tretë të ndërtesës të ndodhur tek "Kodra e Diellit", ku bashkëshortët Veliaj-Xoxa jetojnë aktualisht. Kjo rezulton si nga deklarimet e shtetasit Armand Manahasa, por edhe nga një mesazh zanor i dërguar nga Ajola Xoxa në drejtim të shtetasit Armand Manahasa, i gjendur në telefonin e këtij të fundit, sekuestruar me vendim të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar. Në këtë mesazh, shtetësja Ajola Xoxa përmend qartë që punimet në katin "sipër" po inspektoheshin nga shtetasi Olsi Efthimi. Periudha në të cilën ky mesazh zanor është dërguar, viti 2021, përkon me informacionet e dala në median online në lidhje me një ndërtim që po kryhej mbi banesën e kryetarit të Bashkisë Tiranë, ndërtim ky mendohej të ishte pa lejen e autoriteteve kompetente.



SYRI.NET.AL

**44. Gjithashtu, referuar procesverbalit të këqyrjes së pjesshme të të dhënave të ekspertimit të aparatit celular të shtetasit <u>Driant Zeneli,</u> në përmbledhje të komunikimeve rezulton se vila në fjalë zotërohet faktikisht nga bashkëshortët Veliaj-Xoxa. Ky konkluzion arrihet nisur edhe nga komunikimet e shtetasit Driant Zeneli me Ajola Xoxa, nga ku evidentohet qartë frekuenca e shpeshtë e kësaj të fundit, por edhe bashkëshortit të saj në këtë pronë. Konkretisht: Më datë 01.08.2021 ora 7:52 pm,** shtetasi Driant Zeneli i shkruan Ajola Xoxës: *-A të ka marrë malli për Qerretin? -Ne erdhem sot.* *(faqe 6766).* Ajola Xoxa i përgjigjet: ***<u>Ajo aty në fund është shtëpia jonë.</u> (faqe 6766).*** **Ndërkohë dy bashkëbiseduesit kanë shkëmbyer një foto nga ku rezulton se Ajola Xoxa i referohet banesës së saj duke thënë "*ajo aty në fund është shtëpia jonë*". Nga foto, në pjesën ballore të saj në fund, duket qartë që bëhet fjalë për vilën objekt hetimi.**

**44.1. Më tej, në faqen 8515, që i korrespondon datës 22.06.2024, rezulton një fakt me mjaft interes për hetimin dhe për provueshmërinë e pronësisë faktike të vilës nga bashkëshortët Veliaj- Xoxa. Konkretisht: Më datë 22.06.2024, ora 12:51 pm,** Driant Zeneli i shkruan Ajola Xoxës: *-Të hënën herët në mëngjes nisemi.* Ajola Xoxa përgjigjet: *E lëmë kur të vish më mirë takohemi.* ***Se më duhet të mbyll disa punë tani dhe <u>ndërkohë Eri ka shkuar në Qerret dhe s'ka marrë celësin.</u>*** Pra, nga përmbajtja e këtij komunikimi çelsat e vilës 4 disponohecn nga çifti Veliaj – Xoxa.

45. Deklarimet e shtetases **Ajola Xoxa** në lidhje me vilën e ndodhur në Qerret, Kavajë, sipas organit procedues bien në kundërshtim të plotë me rrethanat e faktit si edhe deklarimet e shtetasve të tjerë, të cilët kanë dijeni për këtë vilë. Ajola Xoxa bën deklarime të pa mbështetur në provat e tjera kur shprehet se me shpenzimet e mirëmbajtjes së vilës merret vetëm nëna e saj, kur në fakt, nga kontrolli i ushtruar më vendim të Gjykatës së Posaçme, janë gjetur dhe sekuestruar në cilësinë e provës materiale, blloqe me shënime që dyshohet të jenë të shtetases Ajola Xoxa, në lidhje me elementë të veçantë të vilës. Gjithashtu, në këtë banesë janë gjetur shënime që dyshohet të jenë të shtetases Valbona Xoxa, e cila shkruan se sipas porosisë së Ajolës ka bërë një sërë pagesash që lidhen me mirëmbajtjen e vilës. Po ashtu, në vilë janë gjetur tabela pagesash si psh ato që lidhen me mirëmbajtjen e pishinës, në krye të të cilave është vendosur emri "Ajola". Pa përmendur këtu dhomën që pranohet nga vetë deklaruesja që është e djalit të saj, si edhe garderobën e këtij të fundit së bashku me lojrat. Në vile, gjithashtu, janë gjetur veshje të cilat duket se më shumë se me shtetasen Valbona Xoxa, kanë lidhje me vajzën e kësaj te fundit. Këtu duhet theksuar edhe sa ka rezultuar nga deklarimet e administratorit të kompleksit, i cili ka shpjeguar se ka parë vazhdimisht të frekuentojë vilën, shtetasen Ajola Xoxa. **Nga ana tjetër, këto deklarime duken të pabesueshme kur konstatohet se, edhe në këtë rast ashtu si edhe në rastet e tjera, kontrata e shkëmbimit e pretenduar nga Ajola Xoxa, mes prindërve të saj dhe AGIKONS shpk, e vitit 2017, është jo e përpiluar para noterit, edhe pse ka patur objekt shkëmbimin e pasurive. Theksohet këtu se, një kontratë shkëmbimi pasurish të paluajtshme krijon efekte të njëjta me një kontratë shitblerje apo dhurimi, përsa i përket kalimit të pronësisë, pra, si e tillë ajo regjistrohet në ASHK, por vetëm nëse përpilohet dhe nënshkruhet para një noteri.** Këto deklarime të kësaj shtetase, bien në kundërshtim edhe me sa është deklaruar nga shtetasi Olsi Efthimi. Ky i fundit referon fakte të vërteta kur pranon se për herë të parë në vilën e ndodhur në Qerret (kompleksi Marea Resort) ka shkuar në vitin 2020 dhe se personi që i ka kërkuar të shkojë atje është shtetësja Ajola

Xoxa. Ky shtetas rezulton të ketë ndjekur punimet e kryera më pas, të cilat përfshijnë edhe pjesën e oborrit të vilës. **Gjithashtu, fotot e shkëmbyera me shtetasin Ergys Krisiko provojnë qartë se të paktën deri në muajin Korrik 2020 punimet në këtë objekt nuk kishin përfunduar.**

**46.** Edhe në deklarimet e shtetasit **Erion Veliaj**, të cilat kanë lidhje me vilën e ndodhur në Qerret, Kavajë, pohohet frekuentimi prej këtij shtetasi, megjithëse justifikimi që përdoret është për të vizituar djalin që qëndronte atje. Por nga ana tjetër, në kundërshtim me provat e administruara në fashikull, Erion Veliaj shprehet se nuk ka bërë ndonjëherë ndonjë pagesë mirëmbajtje të vilës apo vilave (përfshirë këtu atë që figuron në emër të vëllait të tij Arbër Veliaj). Gjithashtu, qelizat e telefonit celular të këtij shtetasi sugjerojnë frekuentime të shpeshta në këtë zonë, gjë që bën të pabesueshme pretendimet në lidhje me vizitat sporadike të tij. Akoma më i pabesueshëm është pretendimi se, megjithëse ka miqësi prej rreth 10 vitesh me shtetasin Gentian Sula, nuk ka asnjë dijeni rreth çmimeve për apartamentet e shitura nga ky shtetas tek Kodra e Diellit (vendi ku deklaruesi jeton aktualisht) si edhe vlerën që pretendohet të jetë shtuar në shkëmbimin e pasurive në Qerret. Për më tepër, që shtetasi Gentian Sula është një përfituesit më të mëdhenj të fondeve publike që administrohen nga Bashkia Tiranë, e drejtuar nga shtetasi Erion Veliaj.

**47.** Gjithashtu, në cilësinë e personit që ka dijeni për veprën penale është pyetur dhe **shtetasi Gentian Sula,** më datë 06.01.2025. Ky shtetas ndër të tjera sqaron se zotëron disa kompani në Shqipëri dhe jashtë vendit, të cilat operojnë në fushën e ndërtimit dhe të zhvillimit, si *Agi Kons Shpk, S&D Invest Sh.a, Astrit Development etj.* Ky shtetas ka shpjeguar se shtetasin Erjon Veliaj e ka njohur si dhëndrin e Arben Xoxës, ku me këtë të fundit kishte njohje të hershme personale por edhe për shkak të punës. Ka shpjeguar se shtetasi Arben Xoxa dhe bashkëshortja Valbona Xoxa, në vitet 2009-2010, kanë blerë një banesë në rezidencën "Kodra e Diellit", për të cilën mendon se ka lidhur një kontratë sipërmarrje. Dorëzimi i objektit është bërë në vitin 2012-2013, ndërsa për kontratën e blerjes tregon se mund të jetë bërë më vonë por nuk është i sigurt për këtë gjë. Deklaruesi shpjegon se përpos këtij objekti, Arben Xoxa bleu dhe një banesë tjetër në Kodrën e Diellit, të cilën e përdorte vetë. Kohën e blerjes nuk e përcakton dot. **Në vijim, në lidhje me pasuritë tregon se në vitet 2008-2009, Arben Xoxa dhe Valbona Xoxa kanë blerë një apartament në Resortin Marea, Qerret. Apartamenti ishte 120 m2 dhe kushtonte 85,000 euro, pagesa të cilat kanë mbaruar në vitin 2013.** Deklaruesi shpjegon se për këtë apartament është lidhur një kontratë e cila është nënshkruar nga Arben dhe Valbona Xoxa. **Shpjegon se në vitin 2017-2018, këta shtetas e kanë këmbyer apartamentin me një vilë brenda resortit, <u>me një pagesë shtesë prej 30,000 euro, pagesë e cila deri sot nuk është paguar.</u>** Gjithashtu, deklaruesi shpjegon se nuk ka marrë qira nga kjo vilë, prej vitit 2017-2018, edhe pse nuk është paguar asnjë pjesë e shumës prej 30,000 euro. Shpjegon <u>se vila është përdorur nga Arben, Valbona, Ajola Xoxa dhe djali i saj.</u> Tregon se për ambjentin paguhen tarifa mirëmbajtje, të cilat mendon se janë paguar nga Valbona Xoxa.

**47.1.** Gjithashtu, deklaruesi shpjegon se kjo vilë është e pozicionuar një rrjesht më poshtë se vila e Arbër Veliaj, dhe këto dy vila ndahen nga një rrugicë këmbësorësh. Shpjegon se arsyeja që kjo vilë rezulton ende në emër të Agi Kons Shpk, lidhet me detyrimin e papaguar prej 30,000 euro, ku sipas tij nuk është paguar për shkak të pamundësisë së tyre dhe për pakënaqësitë që kanë patur në lidhje me punimet. Ka shpjeguar se në zonën e Qerretit,

kompleksi Marea, shërbimi i internetit kabilor ofrohet nga kompani Selcom, kompani në të
cilën ka 70% të kuotave ndërsa 30% të kuotave i zotëron Altin Bushka. Ka shpjeguar se nuk
ka dijeni që kompania Selcom të ketë dhënë shërbim interneti për ndonjë projekt të
Ambasadës Amerikane.

47.2. Në përmbledhje të deklarimeve të shtetasit **Gentian Sula,** rezultojnë të dhëna
me mjaft interes për hetimin, të cilat konsistojnë në: **i)** Për vilën në zonën e Qerretit **nuk ka**
**ndonjë kontratë noteriale shkëmbimi** të përpiluar mes AGI KONS dhe shtetasve Valbona
Xoxa dhe Arben Xoxa; **ii) Këta shtetas, po t'i referohemi deklarimeve, edhe sot e kësaj**
**dite nuk kanë paguar detyrimin prej 30,000 euro, duke mos dorëzuar madje as edhe një**
**këst tek shitësi, megjithëse kanë patur mundësi financiare gjatë gjithë këtyre viteve; iii)**
Për më tepër, Valbona Xoxa dhe i ndjeri Arben Xoxa, nuk kanë paguar asnjë moment, që prej
vitit 2017-2018, ndonjë qira për shfrytëzimin e ambienteve të kësaj vile, për likuidimin e së
cilës nuk kanë paguar asnjë shumë të hollash; **iv) Kjo situatë juridike nuk është rregulluar**
**as pas vitit 2020, kohë në të cilën është legalizuar dhe regjistruar vila në pronësi të AGI**
**KONS. Pra, që prej 2020, çertifikata e pronësisë vijon të jetë në emër të AGI KONS**
**shpk; v) Për të gjithë sipërfaqen e shtuar, pra nga një apartament prej 120 m2 në një**
**vilë prej rreth 190 m2 dhe 494 m2 truall përfshirë këtu edhe një pishinë, vlera shtesë që**
**Valbona Xoxa dhe Arben Xoxa duhej të paguanin, sipas deklaruesit është vetëm 30,000**
**euro. Dhe kjo madje akoma e palikuiduar; vi)** Administrimin e pronave të ndërtuara nga
AGI KONS, përfshirë këtu dhe vilat në Qerret, e bën shoqëria tjetër në pronësi të Gentian
Sulës, S&D Invest. Ky administrim ka nisur që me ndërtimin e objekteve. Ketu duhet patur
në konsideratë momenti kohor kur shtetasi Erion Veliaj fillon e paguan tarifën e
mirëmbajtjes, viti 2020, që përkon me blerjen e vilës tjetër nga vëllai i tij Arbër Veliaj.

**48. Sa më sipër, konstatohet se për <u>Vilën 4 A</u> dhe 6 A, shtetasi Erion Veliaj**
**paguan periodikisht një kuotë, në dukje tarifë administrimi, pagesë kjo që duket se nis**
**nga muaji Gusht i vitit 2020 dhe përfundon në 31.05.2021. Vila e emërtuar në atë kohë**
**4A i korrespondon objektit me numër aktual pasurie 1/647, Vol 29, faqe 103, ZK 3101,**
**në pronësi të subjektit tregtar "Agi Kons" shpk, objekt në të cilin është ushtruar**
**kontroll në zbatim të vendimit të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për**
**Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, Nr. 698, datë 05.12.2024. Nga ana tjetër,**
**periudha në fjalë (Gusht 2020) përkon me lidhjen e kontratës së lidhur mes "Agi Kons"**
**dhe Bashkisë Tiranë, me objekt ndërtimin e Shkollës 9 vjeçare "Qazim Turdiu", me nr.**
**Prot. 25117/39 datë <u>29.09.2020</u>. Vlera e përgjithshme e kontratës është <u>362,713,599 lekë</u>**
**<u>(pa TVSH).</u> Të gjitha faktet të para në unitetin e tyre provojnë dyshimin e arsyeshëm të**
**bazuar në prova se kjo është vilë e fshehur e shtetasve Erion Veliaj dhe Ajola Xoxa dhe**
**nuk është deklaruar në ILDKPKI pasi është rezultat i një përfitimi të parregullt që i**
**është dhënë nga shtetasi Gentjan Sula në cilësinë e pronarit të subjektit tregtar "Agi**
**Kons" shpk, shtetasit Erion Veliaj për shkak të detyrës së tij si Kryetar i Bashkisë**
**Tiranë. Nga vitit 2016 e në vijim subjekti që ka dhënë përfitimin e parregullt ka**
**përfituar procedura prokurimi dhe koncesioni në vlera të kosiderueshme nga fondet e**
**Bashkisë Tiranë. Gjithashtu, shumica e Kontratave të Sipërmarrjes nuk kanë**
**përfunduar efektet e saj përfshirë dhe kontratën e koncesionit. Disa nga procedurat e**
**prokurimit janë përfituar pothuajse aq sa ka qenë fondi limit duke u skualifikuar të të**
**gjithë operatorët konkurrues përveç fituesit "Agi Kons" shpk.**

### 4. *Veprimet hetimore që lidhen me kompanitë e shtetases Ajola Xoxa, OJF-të dhe personat fizikë, dhe analiza e tyre në raport me sistemet tatimore.*

**49.** Shtetasja **Ajola Xoxa,** bashkëshortja e Kryetarit të Bashkisë Tiranë, Erion Veliaj, ka deklaruar një pasuri të konsiderueshme për vitin 2023, ku përveç pasurive të paluajtshme evidentohet një balancë bankare totale prej **618.394 euro,** e cila sipas deklarimeve është krijuar nga të ardhurat nga bizneset e saj, qiradhëniet dhe trashëgimia. Pasuria financiare përfshin llogari në disa banka, ku janë raportuar rritje të ndjeshme gjatë viteve, sidomos përmes aktiviteteve të lidhura me "Partners Law" shpk dhe "Botimet Enciklopedike" Sh.a.

**50. Partners Law SHPK** me NIPT, themeluar më 27.06.2018 dhe administruar nga Ajola Xoxa, operon në në ofrimin e shërbimeve juridike dhe konsulencës. Kompania specializohet në këshillime ligjore, përgatitjen e kërkesave dhe dokumenteve për çështje gjyqësore civile, administrative dhe penale, si dhe hartimin e kontratave dhe marrëveshjeve.

**51.** Një tjetër shoqëri me interes për hetimin është **"Ava Studio" shpk**, një shoqëri kjo e themeluar më **5.10.2021** dhe administruar nga shtetasja Valbona Xoxa, nëna e shtetases Ajola Xoxa. "Ava Studio" rezulton të jetë është një kompani me qendër në Tiranë *që operon në një gamë të gjerë fushash, duke përfshirë botimin, artin, dhe kulturën. Shoqëria ka si objekt kryesor të veprimtarisë: botimin dhe shpërndarjen e librave, revistave dhe materialeve të ngjashme; organizimin e kurseve artistike dhe kulturore; realizimin e eventeve si festivale, ekspozita dhe sfilata; si dhe prodhimin dhe shpërndarjen e filmave dhe materialeve audiovizive etj.* Duke qenë një burim të ardhurash për shtetasen Valbona Xoxa dhe pasurive të lidhura me individë të tjerë në rrethin e saj, (Ajola Xoxa dhe rrjedhimisht Erion Veliaj) kjo kompani paraqet interes të veçantë për analizën financiare. Përmes shqyrtimit të transaksioneve, kryesisht deklarimeve të librave të shitjes dhe klientëve të saj, është synuar identifikimi i financimit si dhe verifikimi i burimit të të ardhurave të kësaj shoqërie.

**52.** Burime të tjera për krijim e likuiditeteve dhe krijimin e gjendjes bankare të shtetases Ajola Xoxa janë edhe përfitimet nga projekte të ndryshme (*projekte të OJF BYL-A*) dhe nga qiratë e deklaruara për OJF Qendra "Harabel", të cilat ushtrojnë aktivitetin e tyre në pasuri të zotëruara prej saj. Konkretisht, në *Deklaratën e Interesave Private të Personit të lidhur* për vitin **2023**, Ajola Xoxa ka deklaruar të ardhura të ndryshme nga angazhimet e saj profesionale dhe aktivitete të tjera:**1) Qendra Harabel**: **i)** Ka përfituar 22,481 euro nga projekte të ndryshme; **ii)** 10,421 euro si koordinatore për projektin SPA:RE, financuar nga Creative Europe (fonde të BE); **iii)** 5,100 euro si drejtuese artistike dhe për prodhim filmi, financuar nga Fondacioni MERC (Itali); **iv)** 1,960 euro si rimbursim për një pagesë karte të kryer për stafin. **2) Të ardhura nga Balkan Youth Ling Albania (Byl-A)**: 22, 000 euro të ardhura neto nga projekte të ndryshme. **3) Paga nga Partners Law SHPK:** 5,754.65 euro si administratore, duke përfshirë pagesa të prapambetura nga viti 2018 deri në 2022. **4) Qiraja me Qendrën Harabel**: Ka përfituar 12,000 euro. **5) Paga nga Botimet Enciklopedike SHA**: 12,000 euro. **6) Paga nga Partners Laë SHPK (tjetër burim)**: 13,200 euro.

**53. "Partners Law" shpk, me NIPT L81829013O,** është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar (SHPK) e themeluar më 27 qershor 2018. Selia qendrore e saj ndodhet në Tiranë, në adresën Rruga Ibrahim Rugova, Sky Toëer, Kati 10/4. Me një kapital prej 100.00 Lekë, shoqëria është 100% në pronësi të shtetases **Ajola Xoxa**, e cila mban gjithashtu rolin e

administratores për periudhën nga 28 qershor 2023 deri më 28 qershor 2028. Objekti kryesor i veprimtarisë së Partners Laë është ofrimi i shërbimeve të konsulencës ligjore. Kjo përfshin një gamë të gjerë shërbimesh, duke përfshirë: Këshillim ligjor për çështje civile, administrative, penale dhe arbitrazhi; Përgatitjen e kërkesave ankimore, rekurseve dhe dokumenteve të tjera ligjore; Asistencë në krijimin dhe regjistrimin e shoqërive tregtare, si dhe në menaxhimin e vazhdueshëm të tyre; Hartimin e kontratave, marrëveshjeve dhe akteve noteriale; Konsulencë dhe administrim të pasurive të luajtshme dhe të paluajtshme, përfshirë blerje, shitje dhe menaxhim të pronave; Ofrimin e shërbimeve në hartimin dhe implementimin e ligjeve, botime akademike, si dhe zhvillimin e aktiviteteve ndërtimore etj.

**53.1.** Me qëllim identifikimin e shoqërive apo individëve të tjerë, të cilat paraqesin interes për hetimin si dhe lëvizjen e vlerave monetare nga organi procedues janë marrë në analizë deklarimet e faturave të shitjes dhe faturave të blerjes të shoqërive të mësipërme kontretisht të "Partner Law" shpk. Referuar Librave të shitjes të deklaruara në organin tatimor, shoqëria "Partner Law" shpk rezulton se gjatë aktivitetit të saj ka patur këto klient kryesorë të renditur sipas volumit të shitjeve. **Kështu, blerësit më të mëdhenj sipas shitjeve:**

- **Sombrero (L21410040N)**: 34,089,731 lekë
- **RAMETAL (L41517502C)**: 18,522,756 lekë
- **Gogel (K91621020U)**: 10,026,300 lekë
- **ABKONS (K61926012O)**: 8,061,300 lekë
- **Idea-Teli (J72902830L)**: 7,200,000 lekë
- **Salus Konstruksion (K42428001R)**: 4,460,760 lekë
- **Hee-I Dunice (K91915024I)**: 2,834,185 lekë
- **Sapienta (L82315006R)**: 2,219,580 lekë
- **Logic Group (M01517004I)**: 1,849,200 lekë
- **Sokol Alijaj (I30704193L)**: 1,768,267 lekë
- **QENDRA "HARABEL" (L81509451A)**: 1,495,872 lekë
- **Ventus Shpk (L82212033T)**: 1,472,040 lekë
- **Art Lab (M12305006H)**: 747,936 lekë
- **QENDRA "MUZA" (M32415453B)**: 120,420 lekë

**53.2.** Sa më sipër vërehet se një pjesë e të ardhurave të kësaj shoqërie gjenerohen nga shërbime të kryera (kryesisht konsulencë ligjore) për shoqëritë: **i) RAMETAL; Sapienta; Ventus Shpk;** (shoqëri të lidhura me shtetasit Elman Abule dhe Marisa Nito), që kanë përfituar leje ndërtimi nëpërmjet shoqërive të tjera të lidhur me këto emra, nga Bashkia Tiranë; **ii) ABKONS; Salus Konstruksion,** shoqëri të cilat kanë interesa në Bashkinë Tiranë; **iii) Gogel; QENDRA "HARABEL"; Art Lab shpk; QENDRA "MUZA,** (shoqëri dhe organizata jofitimprurëse de jure në pronësi të familjarëve të shtetases Ajola Xoxa ose të themeluara prej saj) .

**54.** Nga analizimi i deklarimeve vjetore të shtetases **Ajola Xoxa,** evidentohen gjithashtu edhe dy Organizata të tjera të cilat gjenerojnë të ardhura që kanalizohen më pas tek shtetësja nën hetim Ajola Xoxa. Konkretisht kjo shtetase rezulton se deklaron të ardhura që vijnë nga ***"Qendra "Harabel" dhe OJF "Byl-A"***.

**55.** Në lidhje me **Qendrën "Harabel"**, rezulton se me aktin e themelimit të Qendrës "Harabel" me Nr. 6355 Rep., Nr. 3706 Kol., datë 21.12.2017, anëtarët themelues janë shtetasit **Ajola Xoxa, Iris Ferati dhe Lira Kryeziu,** të cilët kanë vendosur që të themelojnë një qendër joftitimprurëse me emrin "Harabel", përcaktuar kjo edhe në nenin 1 të aktit të themelimit. Në nenin 2, është përcaktuar adresa e shoqërisë, rruga Ibrahim Rugova, Sky Toëer, Tiranë. Në nenin 7 të Aktit të Themelimit, përcaktohet se bordi i drejtorëve të qendrës do të përbëhet nga Ajola Xoxa, Iris Ferati dhe Lira Kryeziu. Kapitali fillestar i qendrës për përmbushjen e qëllimit të saj është 10,000 lekë.

**55.1.** Në datë **18.12.2017**, është mbajtur Procesverbali i mbledhjes së themeluesve të qendrës Harabel, ku themeluesit shtetasit Ajola Xoxa, Iris Ferati dhe Lira Kryeziu kanë vendosur që të emërojnë veten e tyre si anëtar të Bordit të Drejtuesve. Ky dokument, është nënshkruar para noterit, sipas Vërtetim Nënshkrimit të datës 28.12.2017, me Nr. Rep 6458, Nr. Kol 3763, notere Mimoza Sadushaj.

**55.2.** Në datë **18.12.2017**, është mbajtur Procesverbali i mbledhjes së bordit të drejtorëve të qendrës Harabel, ku nga bordi është vendosur që **Dreitor ekzekutiv të jetë Driant Zeneli**, ndërsa Arkëtar Entela Bineri. Ky procesverbal është nënshruar nga të tre anëtarët e Bordit Drejtues. Ky dokument, është nënshkruar para noterit, sipas Vërtetim Nnëshkrimit të datës 28.12.2017, me Nr. Rep 6459, Nr. Kol 3764, notere Mimoza Sadushaj.

**55.3.** Në datë **18.12.2017**, është përpiluar kërkesa e cila i drejtohet Gjykatës së Tiranës për regjistrimin e qendrës "Harabel". Përshkruhet se qendra ka Bord Drejtues shtetasit Ajola Xoxa, Iris Ferati dhe Lira Kryeziu. Po kështu, në funksion të kësaj qendre, në kërkesë relatohet se Drejtori ekzekutiv është Driant Zeneli ndërsa arkëtar është Entela Bineri. Qendra do ta ketë selinë në rrugën **"Ibrahim Rugova", Sky Toëer, Tiranë.**

**55.4.** Qëllimi i veprimtarisë së qendrës *nuk ka objekt fitimin*, por ndjek si qëllim të sajin primar promovimin dhe përhapjen e kulturës dhe artit në çdo formë dhe nëpërmjet të çdo veprimtari, aktiviteti apo nisme në favor të personave që janë të interesuar. Qendra mund të kryejë aktivitete që krijojnë të ardhura sipas ligjit Nr. 8788, datë 07.05.2011 "Për organizatat jofitimprurëse", me qëllim mbledhjen e fondeve të cilat nuk do të shpërndahen si fitime ose që do të destinohen për mbështetjen e aktiviteve. Kërkesa është nënshkruar nga tre themeluesit, Drejtori ekzekutiv dhe Arkëtarja. Kërkesa e cila do t'i drejtohet Gjykatës, është vërtetuar me aktin noterial Nr. 6460 Rep., Nr 3765 Kol., datë 28.12.2017, notere Mimoza Sadushaj.

**55.5.** Në datë **28.12.2017**, shtetasit *Ajola Xoxa, Iris Ferati dhe Lira Kryeziu*, kanë lëshuar prokurë të posaçme me Nr. 6461 Rep., Nr. 3765 Kol., notere Mimoza Sadushaj, për shtetasen Iris Ferati, e cila autorizohet për kryerjen e çdo veprimi për regjistrimin e qendrës Harabel.

**55.6.** Rezulton se në datë 04.01.2018, shtetasja Iris Ferati, e cila ka marrë dhe prokurë të posaçme për regjistrimin e qendrës "Harabel", është paraqitur pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, për të dorëzuar dokumentat e nevojshme për regjistrimin e qendrës. Në lidhje me këtë veprim, ajo ka plotësuar "Formularin e dorëzimit të provave në Gjykatë", ku gjendet emri Iris Ferati dhe nënshkrimi i saj. **Në datë 04.01.2018**, nga Iris Ferati është plotësuar edhe "Formular për të dhënat e kontaktit", ku në rubrikën "Adresa kryesore e kontaktit" është ***plotësuar rruga "Ibrahim Rugova", Pallati "Sky Toëer", Kati 12, Ap 1001, Tiranë.***

SPEKTER.AL

**55.7.** Me vendimin për regjistrimin si person juridik me Nr. 1227 Vendimi, datë 24.01.2018, gjyqtari Ervin Pollozhani ka vendosur regjistrimin e organizatës jofitimprurëse "Harabel", me bord drejtues Ajola Xoxa, Iris Ferati dhe Lira Kryeziu, Drejtor ekzekutiv shtetasi Driant Zeneli dhe arkëtar Entela Bineri.

**55.8.** Në datë **07.02.2018**, është mbajtur procesverbali i mbledhjes së bordit të qendrës Harabel, me Nr. 493 Rep., Nr. 265 Kol., notere Mimoza Sadushaj, ***ku është marrë vendimi për ndryshimin e selisë dhe caktimin si adresë kryesore rrugën Brigada VIII, Hyrja 5, kati 10, Tiranë.*** Pas marrjes së këtij vendimi, nga ana e shtetases Iris Ferati në datë 14.02.2018 është paraqitur kërkesa pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, kërkesë e cila është miratuar me Vendimin Nr. 1227/1, datë 28.02.2018 të gjyqtarit Julian Haxhiu.

**55.9.** Në datë **04.05.2018**, shtetasja Iris Ferati ka paraqitur kërkesën për dorëheqje nga bordi drejtues i qendrës Harabel. Në datë 17.05.2018, është mbajtur procesverbali i mbledhjes së bordit të qendrës Harabel (*përfaqësuar nga Ajola Xoxa dhe Lira Kryeziu*), me Nr. 865 Rep., Nr. 408 Kol., noter Muli Mallkuçi, ku është marrë vendimi për pranimin e dorëheqjes së shtetases Iris Ferati dhe zëvendësimin e saj me shtetasen Entela Bineri (*arkëtare*). Është vendosur gjithashtu që arkëtari i organizatës të jetë Lira Kryeziu. **Për depozitimin e këtij vendimi pranë Gjykatës, është autorizuar shtetasi Erald Ismaili, i cili po në datë 17.05.2018, është paraqitur pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë, ku dhe ka plotësuar formularin e dorëzimit të provave dhe Formularin e të dhënave të kontaktit duke shënuar *adresën "Ibrahim Rugova, Sky Tower, Hyrja 1, Kati 12, Ap 12/3" (pavarësisht se adresa e qendrës Harabel kishte ndryshuar).*** Kërkesa është miratuar me Vendimin Nr. 1227/2, datë 01.06.2018 të gjyqtarit Julian Haxhiu.

**55.10.** Në datë **28.12.2021**, shtetasja Entela Bineri ka paraqitur kërkesën për dorëheqje nga bordi drejtues i qendrës Harabel. Në datë 04.02.2022, është mbajtur procesverbali i mbledhjes së bordit të qendrës Harabel (*përfaqësuar nga Ajola Xoxa dhe Lira Kryeziu*), ku është marrë vendimi për pranimin e dorëheqjes së shtetases Entela Bineri **dhe zëvendësimin e saj me shtetasen Ketrina Braho, si dhe zgjatjen e mandatit të drejtorit ekzekutiv Driant Brianti,** për një periudhë 2-vjeçare. Është vendosur gjithashtu që Lira Kryeziu të largohet nga bordi drejtues për shkak të angazhimeve profesionale dhe familjare, duke u zëvendësuar me shtetasen Rozi Paci. **Për depozitimin e këtij vendimi pranë Gjykatës, është autorizuar shtetasja Xhoi Skënderasi, e cili është paraqitur pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë për këtë qëllim, ku dhe ka plotësuar formularin e dorëzimit të provave dhe Formularin e të dhënave të kontaktit *duke shënuar adresën "Ibrahim Rugova, Sky Tower, Hyrja -, Kati 10, Ap 10/1" (pavarësisht se adresa e qendrës Harabel kishte ndryshuar).*** Kërkesa është miratuar me Vendimin Nr. 1227/3, datë 29.03.2022 të gjyqtarit Enkela Bajo Vlora.

**55.11.** Në datë **11.10.2023**, është nënshkruar kontrata e dhurimit (jo noteriale) ndërmjet shtetasit Driant Zeneli (dhuruesi) dhe Qendra Harabel (pranuesi i dhurimit). **Sipas kontratës, shtetasi Driant Zeneli zotëron 100% të kuotave të shoqërisë Nan Shpk me Nipt dhe këto kuota ja dhuron organizatës jofitimprurës Harabel (në të cilën është drejtor ekzekutiv).** Kjo kontratë rezulton të jetë nënshkruar në të dyja rastet nga shtetasi Driant Zeneli, si dhurues dhe si pranues i dhurimit.

**55.11.1.** Në datë **11.10.2023**, është mbajtur mbledhja e anëtarëve të bordit të qendrës Harabel (*Ajola Xoxa, Ketrina Braho, Rozi Paci*), ku kryetare e mbledhjes është caktuar Ajola

Xoxa. **Bordi drejtues ka vendosur pranimin e dhurimit të kuotave të shoqërisë Nan Gallery Shpk. Përshkruhet se, të ardhurat dhe fitimet e shoqërisë Nan Gallery Shpk, do të përdoren nga Qendra Harabel vetëm për realizimin e qëllimeve të përcaktuara në statutin dhe akt themelimin e qendrës.** Për depozitimin e këtij vendimi pranë Gjykatës, është autorizuar shtetasja Greta Domi ose Fjoralba Zeko, ku kjo e fundit është paraqitur pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë për këtë qëllim, ku dhe ka plotësuar Formularin e të dhënave të kontaktit "Qendra Harabel" ***duke shënuar adresën "Ibrahim Rugova, Sky Toëer, Hyria -, Kati 10, Ap 4".*** Kërkesa është miratuar me Vendimin Nr. 1227/4, datë 12.12.2023 të gjyqtarit Enkela Bajo Vlora.

**55.12.** Në datë **09.03.2024**, shtetësja Ketrina Braho ka paraqitur kërkesën për dorëheqje nga bordi drejtues i qendrës Harabel. Në datë 19.03.2024, është mbajtur procesverbali i mbledhjes së bordit të qendrës Harabel *(përfaqësuar nga Ajola Xoxa dhe Rozi Paci)*, ku është marrë vendimi për pranimin e dorëheqjes së shtetases Ketrina Braho dhe zëvendësimin e saj me shtetasen Arba Topalli, si dhe zgjatjen e mandatit të drejtorit ekzekutiv Driant Brianti, për një periudhë 2-vjeçare. Për depozitimin e këtij vendimi pranë Gjykatës, është autorizuar shtetasja Greta Domi ose Fjoralba Zeko, ku kjo e fundit ka përpiluar kërkesë drejtuar Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë për depozitimin e vendimit dhe pranimin e ndryshimit të anëtarëve të bordit. Kërkesa është miratuar me Vendimin Nr. 1227/5, datë 21.06.2024 të gjyqtarit Anila Guri.

**55.13.** Në datë **27.09.2024**, shtetasja Rozi Paci ka paraqitur kërkesën për dorëheqje nga bordi drejtues i qendrës Harabel. Në datë 10.10.2024, është mbajtur procesverbali i mbledhjes së bordit të qendrës Harabel *(përfaqësuar nga Ajola Xoxa dhe Arba Topalli)*, ku është marrë vendimi për pranimin e dorëheqjes së shtetases Rozi Paci dhe zëvendësimin e saj me shtetasen Reada Lemnusha, Për depozitimin e këtij vendimi pranë Gjykatës, është autorizuar shtetasja Greta Domi, e cila ka përpiluar kërkesën drejtuar Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë për depozitimin e vendimit dhe pranimin e ndryshimit të anëtarëve të bordit. **Gjithashtu, shtetasja Greta Domi, në datë 11.10.2024 ka plotësuar Formularin e të dhënave të kontaktit *duke shënuar adresën "Ibrahim Rugova, Sky Toëer, Hyrja -, Kati 10, Ap 104"*.** Kërkesa është miratuar me Vendimin Nr. 1227/6, datë 05.12.2024 të gjyqtarit Amarilda Sulaj.

**55.14.** Nisur nga deklarimet e bëra në ILDKPKI nga shtetasja **Ajola Xoxa** në lidhje me burimin e të ardhurave janë analizuar gjithashtu deklarimet në shitje dhe në blerje të OJF Qendra Harabel, me qëllim identifikimin e mënyrave të financimit të kësaj qendre dhe destinacionin e këtyre fondeve. Konkretisht nga analizimi i librave të shitjes rezulton se **Qendra Harabel ka deklaruar në shitje një vlerë totale prej 42, 028, 874 lekë** të ndara sipas blerësve të mëposhtëm:

- **Banka Amerikane e Investimeve SHA (J91725007P): 7,642,383 ALL**
- **(blank) (blank): 7,413,197 ALL (Kurse arti)**
- **Antea Cement (K61914005R): 5,425,456 ALL**
- **Fondacioni "Mane Foundation" (M31815452B): 4,248,800 ALL**
- **Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit (J91326001G): 3,000,000 ALL**
- **Intersig Vienna Insurance Group (K12201002T): 2,466,700 ALL**

- Raiffeisen Invest - Shoqëri Administruese e Fondeve të Pensionit dhe Sipërmarrjeve të Investimeve Ko (K51928001I): 2,260,000 ALL
- **BYL - A (K41828009Ë): 2,015,700 ALL**
- Teatro Pubblico Pugliese - Consorzio Regionale per le Arti e la Cultura (01071540726): 1,853,229 ALL
- Ambasada Italiane (J61912009P): 1,410.080 ALL
- Sëiss Contact (K22216501C): 1,249,000 ALL
- Banka Credins (K31608801O): 1,188,800 ALL
- **Ministria e Turizmit dhe Mjedisit** (K51716026T): 1,140,000 ALL
- One Telecommunications (J61814094Ë): 584,900 ALL
- Qendra Harabel (L81509451A): 70,329 ALL
- Palazzo Grassi S.p.A. (01959810274): 60,300 ALL

55.15. Nga analizmi i librave të blerjes rezulton se Qendra Harabel ka deklaruar në blerje një vlerë totale prej <u>25,977,849 lekë</u> të ndara sipas shitësve të mëposhtëm:

- **AVA Studio shpk (M12212012O): 4,530,637 ALL**
- **Ajola Xoxa (I35716050T): 2,308,672 ALL (përfshirë fatura nga blerësi)**
- **Arts Lab (M12305006H): 2,147,674 ALL**
- KALEMI Travel & Tours (L62303012A): 1,623,357 ALL
- Milsped Albania (L32409008B): 1,616,552 ALL
- **Partners Law shpk (L81829013O): 1,495,872 ALL**
- GECI (K71829801O): 1,176,490 ALL
- Sky Hotels (L32126014G): 1,098,006 ALL
- **Ergys Krisiko (L71703037S): 890,991 ALL**
- T.T.A Alba Lam (J62110001L): 646,210 ALL
- Enejda Muzaka (M11928001G): 525,888 ALL
- **NAN Gallery (M31920013O): 442,215 ALL**
- **KRISIKO (M41612034L): 364,800 ALL**
- Drejtorit e Shërbimit Qeveritar (J61828071I): 346,998 ALL
- Scandinavian Living (L51901006G): 346,055 ALL
- Stefano Romano (L62302019E): 300,000 ALL
- Prosound SHPK (K62320012O): 296,400 ALL
- **Bash Art OJF (L61403453L): 285,700 ALL**
- **ASLV SHPK (L31329009M): 255,336 ALL**
- Dynamic Audio Visual (L82211034A): 241,560 ALL

**55.16. Sa më sipër, sipas organit procedues evidentohet se një pjesë e konsiderueshme e financimeve të kryera për Qendrën Harabel, (kryesisht financime, sponsorizime nga subjekte të cilët lidhen në një formë apo në një tjetër me Bashkinë Tiranë, për të cilat do shpjegojmë hollësisht në vijim), përdoren për pagesat e qirasë të shtetases Ajola Xoxa si dhe likujdime të faturave për shërbime të kryera nga shoqëritë e familjarëve të saj si AVA Studio shpk (në pronësi të Valbona Xoxa); Partner Law (në pronësi të Ajola Xoxa); Arts Lab (në pronësi të Erald Simixhiu); dhe NAN Gallery shpk (në pronësi me 100% të vetë Harabel dmth). Theksohet se kjo e fundit (Nan Gallery)**



5 DITET.AL

**është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar dhe në ndryshim nga organizatat jo-fitimprurëse qëllimi i aktvivitetit ekonomik është gjenerimi i fitimeve.**

**56.** Nga aktet, **siç do të argumentohet në vijim, ka rezultuar e provuar se pavarësisht se pronar përfitues i qendrës "Harabel" dhe rrjedhimisht i shoqërisë "Nan Gallery" shpk është shtetasi Driant Zeneli, në të vërtetë kjo shoqëri kontrollohet faktikisht nga shtetasja Ajola Xoxa. E njëjta gjë evidentohet edhe në raport me shoqëritë "Ava Studio" dhe "Arts Lab" si edhe Organizata e tjera "Eventus", "Byl-A" dhe "Muza".**

**57.** Interes për hetimin sipas organit procedues përbëjnë edhe faturimet e kësaj organizate në vlerën <u>7, 413, 197 ALL</u>, të cilat përfaqësojnë shërbimet "*Kurse arti*", për të cilat, bazuar në dokumentat e administruara gjatë kontrollit të zyrave të shoqërisë Partners Laë dhe qendrës Harabel në godinën Sky Toëer, në rrugën Ibrahim Rrugova, si edhe në deklarimet e shtetasit Driant Zeneli (*shih më poshtë*), **ekziston dyshimi i arsyeshëm i bazuar në prova se nuk janë kryer sipas vlerës së deklaruar në shitje.**

- ***Lidhur me kalimin në mënyrë indirekte nga subjekti Fusha shpk të një shume të caktuar tek Qendra Harabel.***

**58.** Gjithashtu, në kuadër të hetimeve paraprake, janë administruar të dhëna që lidhen me marrëdhënien financiare që *Personat Fizikë Greta Domi dhe Ines Dani* kanë patur me Qendrën Harabel. Nga analizimi i deklarimeve në sistemin tatimor C@TS, të librave të shitjes/blerjeve të Qendrës Harabel dhe të subjekteve Greta Domi P.F dhe Ines Dani P.F rezulton si vijon:

**58.1.** Në datën **26.11.2020**, subjekti Greta Domi P.F me nipt M01427002Q ka deklaruar në shitje faturën me nr. Serial 88856706, me blerës subjektin Fusha Shpk me NIPT J61922018S në vlerën 1,336,284 lekë.

**58.2.** Në datën **30.11.2020**, subjekti Greta Domi P.F me nipt M01427002Q ka deklaruar në blerje faturën me nr. 94105702 me shitës Qendra Harabel me NIPT L81509451A në vlerën 742,380 lekë.

**58.3.** Në datën **26.11.2020**, subjekti Ines Dani P.F me nipt L82201009O ka deklaruar në shitje faturën me nr. Serial 88856706, me blerës subjektin Fusha Shpk me NIPT J61922018S në vlerën 1,336,284 lekë.

**58.4.** Në datën **30.11.2020**, subjekti Ines Dani P.F me nipt L82201009O ka deklaruar në blerje faturën me nr. 94105704 me shitës Qendra Harabel me nipt L81509451A në vlerën 593,904 lekë.

**58.5.** Sa më sipër, konstatohet se **subjekti Fusha shpk** është faturuar në vlerën <u>**2,672,568 lekë**</u> nga dy subjektet Greta Domi P.F dhe Ines Dani P.F, <u>të cilët vetëm tre ditë më pas kanë deklaruar nga një faturë në blerje</u> përkatësisht në vlerat <u>593,904 lekë dhe 742,380 lekë</u> ose ne total <u>1,336,284</u>, <u>ekzaktësisht sa gjysma e vlerës të faturar për Fusha shpk</u>. **Thënë ndryshe, gjysmën e shumës së marrë nga Fusha shpk këto shtetase, në cilësinë e personave fizikë, e kanë kaluar në llogaritë e Qendrës Harabel, siç më poshtë do të tregohet në hollësi.**

**58.6.** Të pyetura në lidhje me blerjet e deklaruara nga Qendra Harabel, siç do të <u>përshkruhet në vijim</u>, shtetaset Greta Domi dhe Ines Dani kanë deklaruar se këto vlera

përfaqësojnë *sponsorizim* kundrejt qendrës Harabel *por nuk i kujtohet se për çfarë eventi kontret e kanë bërë këtë sponsorizim.* Nga ana tjetër, duke qenë se të dyja këto shtetase kanë qenë punonjëse ose të paktën kanë patur një post pune në zyrat e shoqërisë Partners Law shpk, sipas organit proceduese **ekziston dyshimi i arsyeshëm i bazuar në prova se ky shërbim kundrejt Fusha shpk është kryer për llogari të shtetases Ajola Xoxa dhe në përfundim, ekzistojnë fakte konkrete se gjysma e kësaj vlere ka shkuar për Qendrën Harabel.**

**58.7. Nga aktet e administruara dhe të këqyrura në Bashkinë Tiranë, pjesë e fashikullit penal, rezulton e provuar se "Fusha" shpk, ndër të tjera ka përfituar nga Bashkia Tiranë edhe Lejen e Ndërtimit Nr. Prot. I-8789/8, dt. 23.11.2020, "Banesë individuale 1 kat, me mur rrethues" ndodhur në Yrshek, Tiranë, në pronë të z. Glentjan Karaj, me zhvillues z. Glentjan Karaj dhe subjekt ndërtues shoqëria "FUSHA" sh.p.k.", viti 2020. Afati i lejes 27 muaj. Gjithashtu, me shkresën Nr. 204 Prot., datë 09.11.2020 shoqëria "Fusha" shpk ka paraqitur pranë Bashkisë Tiranë kërkesën me objekt: *"Likujdimi garancie punimesh"*, që rrjedhinin nga zbatimi i punimeve në objektin "Rikualifikimi Urban i Sheshit Skënderbej, Faza e II-të", në vlerën 58, 732, 731 lekë. Gjithashtu, shoqëria "Fusha" shpk ka marrë pjesë në procedurën e prokurimit të shpallur me Urdhërin e Prokurimit Nr. 41302 Prot., datë 23.11.2020 për objektin *"Shërbimi i Pastrimit të Tiranës" Loti IV "Shërbimi i Pastrimit të Zonës Tirana IV"*, nënshkruar nga kryetari i bashkisë Tiranë Erion Veliaj. Pra, vetëm 3 ditë pas përfitimit të lejes në fjalë, si dhe gjatë kohës që ishte në pritje të shqyrtimit të kërkesës nga Bashkia Tiranë e bërë nga shoqëria nga "Fusha" shpk më datë 09.11.2020 me objekt: *"Likujdimi garancie punimesh"*, që rrjedhinin nga zbatimi i punimeve në objektin "Rikualifikimi Urban i Sheshit Skënderbej, Faza e II-të", në vlerën 58, 732, 731 lekë, si dhe tre ditë pasi është nxjerrë Udhëri i Prokurimit Nr. 41302 Prot., datë 23.11.2020 (ku doli fitues më pas), subjekti tregtar "Fusha" shpk është faturuar me një shumë prej 2,672,568 lekë nga dy personat fizikë, të kontrolluar plotësisht nga shtetësja Ajola Xoxa, të cilët nga ana e tyre, vetëm 4 ditë më pas, faturohen nga "Harabel" duke i kaluar gjysmën e të hollave kësaj organizate. Në lidhje me këtë kalim, përveç dyshimeve të krijuara për dhënie përfitimi të parregullt, komunikimet e shtetases Adela Kondakçiu dhe Ajola Xoxa ekspozojnë qartë gjithashtu edhe mekanizmin e përdorur për të "injektuar" të hollat në llogaritë bankare të një OJF-je që kontrollohet nga kjo e fundit. Në këtë skemë të mirëorganizuar përveçse ka dyshimet të arsyeshme se shoqëria "Fusha" shpk ka dhënë përfitim të parregullt ajo njëkohësisht ka ndihmuar që ky "përftim parregullt" të kamufloj natyrën e burimit. Kjo skemë duket se aplikohet pothuajse në të gjitha rastet.**

**58.8** Faktet e mësipërme provohen edhe nëpërmjet komunikimit me Whatsapp midis shtetases **Adela Kondakçiu dhe Ines Dani. Kështu, në faqen 112 evidentohet prodhimi i faturave në emër të shtetases Ines Dani, për shërbime që nuk rezultojnë të jenë kryer nga kjo e fundit, dhe për të cilat duket qartë se nuk asnjë dijeni. Jo vetëm kaq, subjektet tregtarë që kërkojnë shërbimin, pra ata që paguajnë të hollat, në këtë rast rezultojnë të lidhur ngushtë me interesa financiarë më bashkinë Tiranë.** Konkretisht, në faqen 112 shtetësja Adela Kondakçiu njofton shtetësen Ines Dani: ***Kam bërë edhe një faturë tjetër nga ty sot.*** **Pra, Ines Dani nuk ka asnjë ide për shërbimin që ka ofruar, subjektit të**

**cilit ja ka ofruar dhe sigurisht për faturën që është lëshuar. Kjo, sepse personi i parë që përmend këtë faturë dhe e njofton për lëshimin e saj është Adela Kondakçiu, pa ju kërkuar në asnjë moment kjo gjë nga shtetësja Ines Dani.** Në vijim, në faqen 113 Adela i dërgon Ines Dani *me foto një faturë tatimore shitje*. **Konkretisht bëhet fjalë për faturën nr. 15 datë 26.11.2020, lëshuar nga personi fizik Ines Dani, në cilësinë e shitësit të shërbimit, për subjektin tregtar "FUSHA" shpk, në cilësinë e blerësit të shërbimit. Nga fatura rezulton se Ines Dani ka faturuar "FUSHA" shpk për shërbime konsulencë ligjore në vlerën <u>9.000 euro + TVSH, gjithsej 10.800 euro</u>, që me kursin e kohës 1 euro=123 lekë, llogaritet në vlerën rreth <u>1.328.400 lekë (me TVSH)</u>.** Ines Dani pasi njihet me faturën i thotë Adelës vetëm: *ok*. **Por në këtë pikë, gjithnjë në faqen 113, Ines Dani kujtohet të kërkojë diçka që paraqet shumë interes për hetimin, përsa kohë provon xhirimin e parave për faturime fiktive nga subjekte tregtarë të lidhur me bashkinë Tiranë në llogarinë e saj si person fizik,** dhe përsa kohë nga ana tjetër, **shfaq mekanizmin e kalimit të këtyre përfitimeve të paligjshme nëpër llogaritë bankare deri në mbylljen e plotë të ciklit të destinacionit të të hollave, duke nxjerrë në pah mjaft qartë se në favor të kujt përfundojnë ato.**

**58.8.1.** Konkretisht, **Ines Dani** pasi njihet me faturën i thotë Adelës: *Aman na bëj një tabelë për hyrjet dhe daljet nga llogaria ime, <u>që të di sa janë të miat dhe sa jo.</u> Faqe 113.* Adela i përgjigjet në faqen 14: *Po do ta bëj.* Në faqen 115 Adela Kondakçiu mban premtimin dhe i dërgon Ines Danit tabelën e kërkuar. E sqaron pas dërgimit të fotos së tabelës: *Ines kjo ka qenë gjëndja deri në fund të tetorit me tërheqjet, nëse ke tërhequr në nëntor duhet zbritur nga vlera e mbetur dmth kjo vlera <u>357.219 lekë.</u>* Nga tabela e derguar tek shtetësja Ines Dani rezulton se totali në llogarinë e shtetases Ines Dani është <u>965.149 lekë</u>, të cilat përbëhen nga gjendja ekzistuese e llogarisë, pagat e Inesit (maj-nëntor) (ndërkohë që është person fizik). Tërheqjet e bëra nga Inesi, në muajt Qershor Tetor, sipas tabelës janë 607.930 lekë dhe pjesa e mbetur për t'u terhequr është 357.219 lekë.

**58.8.2. Për të sqaruar paqartësitë e organit procedues në lidhje me këtë tabelë, dhe në thelb me përgjigjen e pyetjes se sa realisht përfiton shtetësja Ines Dani nga puna e saj si avokate e licensuar si person fizik, ka menduar vetë kjo shtetase në komunikimet e faqes 117.** Ines Dani pasi njihet me tabelën pyet Adela Kondakçiun: ***357 janë të miat?*** Adela Kondakçiu i përgjigjet në faqen 118: ***Po.*** Por, shtetësja **Ines Dani** pas saktësimit se sa para ishin të saj dhe sa jo, i drejtohet Adelës duke i thënë në faqen 133: ***ADELA, DO E FLAS EDHE ME AJOLËN, POR PARAPRAKISHT, <u>NËSE DO JU DUHET TË TËRHIQNI LEKË NGA LLOGARIA PF (PERSON FIZIK) IME, MË THUAJ MUA MË PËRPARA QË TË TI JAP UNË DHE MOS TI TËRHEQESH TI NGA LLOGARIA.</u> (KONFIDENCIALE KJO ☺).* Pra, më se pari është e qartë se në llogarinë e personit fizik Ines Dani nuk është vetëm titullari i saj që disponon, por edhe Ajola Xoxa. Jo vetëm kaq, por ky komunikim provon faktin që të ardhurat e gjeneruara *de jure* nga personi fizik Ines Dani, në një mënyrë ose një tjetër, në rastin konkret nëpërmjet tërheqjeve në llogari, merren nga shtetësja Ajola Xoxa.** Në lidhje me këtë kërkesë, Adela Kondakçiu i thotë Ines Dani ***se këtë radhë pagesa, siç i kishte thënë Ajola, do të kalohej ndryshe. Konkretisht:*** **Në faqen 134, në përgjigje të kërkesës së Ines Dani për të mos bërë tërheqje nga llogaria e saj si person fizik,** Adela Kondakçiu i thotë: ***<u>PAGESA</u>***

***ME KA THËNË AJOLA QË DO KALOJË ME TRANSFERTË TE HARABEL NË FAKT.***

Sa është thënë në këtë komunikim provohet me xhirimet bankare të evidentuar në statement e llogarisë së OJF "Harabel". **Pra, në rastin konkret, sipas udhëzimeve të Ajola Xoxës lekët nuk do të merren direkt nga llogaria e personit fizik Ines Dani, në formë CASH, por do të kalohen me transfertë bankare në një OJF të kontrolluar plotësisht nga shtetësja Ajola Xoxa. Një gjë e tillë në fakt edhe ka ndodhur dhe është e njëjtë me mekanizmin e përdorur edhe nga personi tjetër fizik që ushtron aktivitetin e avokatisë në zyrat e "Partners Laë", shtetësja Greta Domi.** Ines Dani ka vetëm një përgjigje: *Ok.*

**58.8.3.** Në faqen 135 Adela Kondakçiu vijon diskutim në lidhje me këtë ide të Ajolës, duke i thënë Ines Danit: ***INES MUND TË KALOJMË 4.000 EURO PLUS TVSH TE HARABEL KËTË DHE PJESËN TJETËR VITIN TJETËR.*** **Thënë ndryshe, shuma e të hollave që në rastin konkret kalohet nga "FUSHA" shpk tek personi fizik Ines Dani, për shërbime konsulence ligjore, me urdhër të Ajola Xoxës kalohet më pas pjesërisht tek organizata "Harabel". Sipas organit procedues i gjithë mekanizmi që përmendet më lart, i cili nis që nga subjekti tregtar "Fusha" shpk, i lidhur ngushtë me interesa financiarë me Bashkinë Tiranë, vijon me kalimin e një sasie të hollash, rreth 2.600.000 lekë, të ndara mes personave fizikë Ines Dani dhe Greta Domi, në llogaritë e tyre bankare, dhe kalimi nga këto të fundit tek destinacioni fundor që rezulton të jetë shtetësja Ajola Xoxa, sipas udhëzimeve të qarta të lëshuara nga kjo e fundit, si nëpërmjet tërheqjeve në CASH ashtu edhe nëpërmjet transfertave në OJF të e kontrolluara nga vetë kjo shtetase, dëshmon qartë dhe plotësisht të gjithë rrugën e ndjekur për pastrimin dhe injektimin në sistemin bankar të përfitimeve të paligjshme të siguruara nga bashkëshortja e kryetarit të bashkisë Tiranë, Erjon Veliaj, shtetësja Ajola Xoxa, për shkak të veprimeve dhe mosveprimeve që lidhen me funksionin zyrtar të bashkëshortit të saj.**

**58.8.4.** Faktet e mësipërme provohen dhe gjatë deklarimit të shtetases **Adela Kondakçiu** më datë 12.12.2024 e cila ka shpjeguar se ka njohje me Greta Domin, e cila ndjek çështje ligjore të zyrës Partners Laë Shpk, por edhe të OJF-ve nëse do të kishin ndonjë çështje. Shpjegon se Greta Domit si person fizik, vetë Adela i mban kontabilitetin dhe i bën deklarimet. **Pasi është njohur me një faturë të lëshuar nga Greta Domi me blerës Fusha Shpk, *deklaruesja shpjegon se Ajola Xoxa e ka vendosur vlerën e faturimit*. Kjo shtetase shpjegon se *çdo faturë* që *është lëshuar nga Greta Domi tek subjektet tregtare të tjera apo OJF, është kërkuar* dhe *vendosur nga ana e Ajolës*. Deklaruesja shpjegon se *Greta për të gjithë shërbimet e saj kishte tarifë mujore/fee, në vlerë 120,000 lekë të reja*.**

- ***Lidhur me faturimet fiktive qira për zyrat e Qendrës Harabel.***

59. Përsa i përket faturimeve të shtetases **Ajola Xoxa (I35716050T)**, në vlerë totale **2,308,672 lekë**, *qira për zyrat e Qendrës Harabel*, ekziston dyshimi i arsyeshëm në prova se kontratat e qirasë janë përpiluar fiktivisht. Qendra Harabel ka deklaruar këto shpenzime për qiranë e zyrave të Qendrës Harabel:

| *Data* | *Vlera* | *Shitës* |
|---|---|---|
| *05.04.2023* | *ALL 399,776* | *Ajola Xoxa (fature nga Bleresi)* |
| *02.02.2023* | *ALL 410,834* | *Ajola Xoxa (Fature nga Bleresi)* |

| | | |
|---|---|---|
| *28.04.2022* | *ALL 426,070* | *Ajola Xoxa (Fature nga Bleresi)* |
| *04.02.2022* | *ALL 42,993* | *Ajola Xoxa (Fature nga Bleresi)* |
| *01.02.2022* | *ALL 384,099* | *Ajola Xoxa Indivd* |
| *16.12.2021* | *ALL 127,906* | *Ajola Xoxa Indivd* |
| *03.11.2021* | *ALL 130,109* | *Ajola Xoxa Indivd* |
| *04.10.2021* | *ALL 128,721* | *Ajola Xoxa Indivd* |
| *30.08.2021* | *ALL 129,082* | *Ajola Xoxa Indivd* |
| *30.08.2021* | *ALL 129,082* | *Ajola Xoxa Indivd* |

**59.1.** Nga aktet rezulton se i gjithë aktiviteti i Qendrës Harabel zhvillohet në godinën Sky Tower në një ambient të përbashkët me shoqërinë Partner Law, e cila zotërohet 100% nga shtetësja Ajola Xoxa, duke përdorur efektivisht të gjitha mjetet e punës, facilitetet, ambientet dhe punonjësit (personat) e kësaj zyre.

**59.2.** Në kontrollet e ushtruara në këtë ambient në zbatim të Vendimit nr. 698, datë 05.12.2024 të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar Tiranë, evidentohet qartë se në këtë ambient ushtrojnë aktivitetin e tyre të përditshëm si *Qendra Harabel dhe shoqëria Partner Law.* **Konkretisht Vendi/Zyra objekt kontrolli, ndodhet në *rrugën Ibrahim Rrugova, në objektin e quajtur Sky Toëer në katin e 10.*** Në krah të portës hyrëse të zyrës objekt kontrolli është një tabelë me shënimin 'The Partners' Laë Firm dhe në krahun tjetër një tabelë me mbishkrimin "Harabel". Në ambientin e brendshëm fillimisht ndodhet një corridor, i cili më pas shpërndahet në anën e majtë dhe të djathtë. Përballë korridorit hyrës gjendet tavolinë recepsioni i cili është dhe posti i punës së shtetases Anxhela Qunaj me detyrë asistente zyre. Në anën e djathtë të korridorit ndodhen zyrat e Organizatës Jofitimprurëse Qendra Harabel, ndërsa në krahun e majtë gjëndet një zyrë e mbyllur me kanata xhami dhe me derë, e cila është zyrë avokatie në të cilën punon shtetasja Greta Domi. Përballë kësaj zyre gjendet zyra e shtetases Ajola Xoxa e cila është administratore. Midis dy zyrave ndodhet posti i punës i shtetases Reada Lemnusha dhe shtetases Adela Kondakçiu me detyrë financiere. Këto të fundit figurojnë gjithashtu të përfshira në disa OJF dhe shoqëri të tjera për të cilat do shpjegohen në vijim.

**59.2.** Gjatë kontrollit të ushtruar në selitë e ushtrimit të aktivitetit, të deklaruara në Qendrën Kombëtare të Biznesit për qendrën Harabel dhe shoqërinë Ava Studio, Tiranë, *Rruga "Brigada VIII", Ndertesa nr 19, Hyrja 5, Kati 10, Apartamenti nr 31, Njësia Administrative nr 5, në pronësi të shtetases Ajola Xoxa,* **është evidentuar se ky ambient përdoret faktikisht thjesht si një apartament dhe nuk ka asnjë mjet, post pune, kompjuter apo faciletete të tjera për ushtrimin normal të aktivitetit të qendrës Harabel apo të shoqërisë Ava Studio shpk.**

**59.3. Sa më sipër, arrihet në konkluzionin logjik se kontratat e qirasë të nënshkruara midis shtetases Ajola Xoxa dhe Qendrës Harabel, për më tepër kontrata dypalëshe të panoterizuara, janë përpiluar fiktivisht me qëllim kalimin e fondeve nga Qendra Harabel në llogaritë bankare të shtetases Ajola Xoxa dhe deklarimin e tyre si të ardhura të ligjshme në Deklaratën e Interesave Private të ILDKPKI, si person i lidhur me Kryetarin e Bashkisë Tiranë shtetasin Erjon Veliaj. Duke qenë në regjimin e bashkësisë ligjore këto të ardhura konsiderohen ligjërisht edhe të këtij të fundit.** Ndërkohë nga provat e aministruara rezulton se vetëm në deklaratat si person i lidhur për

vitet 2022 dhe 2023 shtetasja Ajola Xoxa ka deklaruar **<u>24.000 Euro të ardhura nga qeraja Qendra Harabel.</u>**

**59.4. E pyetur në lidhje me këtë fakt, shtetasja Ajola Xoxa deklaron se ambienti në fjalë, pra apartamenti tek rruga Brigada VIII", Ndërtesa nr. 19, Hyrja 5, Kati 10, Apartamenti nr 31, përdoret për nevoja të Qendrës Harabel** për akomodimin e artistëve të ndryshëm të huaj, që ftohen përgjatë organizimeve që bën kjo qendër. Këto akomodime kanë qenë sporadike.

- ***Lidhur me veprimet hetimore ndaj organizatës "BYL-A".***

**60.** Nga kontrolli i ushtruar në ambientet (zyrat) e shoqërisë Partners Laë, në zbatim të Vendimit nr. 698, datë 05.12.2024 të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar Tiranë, kontatohet se në këto ambiente janë gjetur dokumenta financiarë, projekte, aplikime për fonde të disa organizatave të tjera jo fitimprurëse dhe të disa shoqërive të tjera, të cilat ka dyshime të arsyeshme se kontrollohen nga shtetasja Ajola Xoxa. Konkretisht, rezultojnë të jenë gjetur dokumente financiarë, fatura, preventivë, të ***BYL-A, SHIZI, Qendra Muza, Qendra Eventus, Frouthoulus, Nan Gallery shpk, Arts Lab shpk, Ava Studio shpk, Adela Kondakçiu P.F, Greta Domi P.F, Ina Goxhaj P.F etj.***

**61.** Në lidhje me organizatën **"BYL-A"**, rezulton se me vendimin Nr. 33, datë 11.04.2002, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, gjyqtare Enkela Pajo, rezulton të jetë themeluar Qendra BYL-A (Balkans Youth Link – Albania), *si një organizatë me qëllime bamirësie, shkencore dhe edukuese. Kjo organizatë jofitimprurëse është themeluar nga Endri Fuga, Borana Lushaj, Ina Verzivolli, Juela Mazniku, Marinela Lika dhe Denis Behluli. Drejtor i kësaj organizate është vendosur shtetasi Endri Fuga. Me vendimin Nr. 33/1, datë 03.06.2004, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, gjyqtare Marjana Dedi, është vendosur që Klotilda Ferhati dhe Sagita Muco të bëhen anëtarë të bordit, duke zëvendësuar Denis Behluli dhe Juela Maznikun. Po kështu është zgjatur mandati i drejtorit ekzekutiv Endri Fuga, edhe për dy vite të tjera, si dhe është ndryshuar selia e organizatës duke caktuar rrugën e Elbasanit, Ndërtesa Nr. 77. Me vendimin Nr. 33/3, datë 20.01.2011, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, gjyqtare Elena Gjoka, është vendosur ndër të tjera që Endri Fuga (pas dorëheqjes) të zëvendësohet nga Erald Ismaili, drejtori i ri ekzekutiv i kësaj qendre, si dhe është ndryshuar adresa e organizatës duke caktuar si seli apartamentin me Nr. 107/13, Ap. 6, kati i dytë, Komuna e Parisit. Relatohet gjithashtu se shtetasi Endri Fuga e ka paraqitur dorëheqjen që në datë 15.08.2009 dhe pozicionin si drejtor ekzekutiv e ka mbajtur Klotilda Ferhati (Bushka) deri në datë 01.09.2010. Gjithashtu, pas caktimit të Eraldit si drejtor ekzekutiv, është vendosur edhe ri-emërimi i Klotilda Bushkës si anëtare e Bordit Drejtues. Me vendimin Nr. 33/4, datë 28.09.2016, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, gjyqtare Enkela Pajo, është vendosur emërimi i drejtori të ri ekzekutiv, shtetasja Ina Goxhaj. Po kështu është vendosur që Erald Ismaili të jetë anëtar i bordit drejtues, si dhe është miratuar dorëheqja e Klotilda Bushka si anëtare e bordit drejtues. Me vendimin Nr. 33/6, datë 08.03.2022, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, gjyqtare Blerina Muço, është vendosur ndryshimi i anëtarëve të bordit drejtues duke u larguar Sagita Muco, Eneida Jaçaj dhe Lorena Luniku, duke u zëvendësuar me anëtarët e rinj Eni Zeneli, Viktoria Spiro dhe*

SPIFFET.AL

*Enis Goxhi. Me vendimin Nr. 33/6, datë 08.03.2022, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, gjyqtar Arben Kostandini, është vendosur miratimi i ri-emërimi të drejtori ekzekutiv, shtetases Ina Goxhaj. Kërkesën dhe dokumentat e nevojshëm që kanë shërbyer për nxjerrjen e këtij vendimi, e ka dorëzuar shtetasi Erald Ismaili, datë 07.02.2022, i cili ka shënuar të dhënat e kontaktit rruga "Medar Shtylla", Hyrja 9, Kati 7, Ap 28. Në këtë kohë, anëtarë të bordit drejtues janë shtetasit Erald Ismaili, Endrit Isufaj, Eni Zeneli dhe Enis Goxhi. Në datë 28.08.2023, shtetasja Ina Goxhaj ka paraqitur kërkesën për dorëheqje si drejtor ekzekutiv i qendrës BYL-A. Në datë 13.09.2024, është mbajtur procesverbali i mbledhjes së bordit të qendrës BYL-A (përfaqësuar nga Erald Ismaili, Endrit Isufaj, Eni Zeneli dhe Enis Goxhi), ku është marrë vendimi për pranimin e dorëheqjes së drejtorit ekzekutiv Ina Goxhaj dhe zëvendësimin e saj me shtetasen Reada Lemnusha. Nga ana e bordit drejtues, është mbajtur procesverbali i datës 14.09.2023, ku ka ndryshuar qëllimi i organizatës duke u bërë "Kjo qendër është ndërtuar në funksion për qëllime bamirësie, shkencore, edukuese,* ***kulturore, artistike, social-shëndetësore dhe social edukuese"*** *si dhe ka përcaktuar qëllime të tjera në fushën e artit, kulturës etj. Në datë 15.09.2023, është mbajtur një procesverbal tjetër nga ana e bordit drejtues, ku është marrë vendimi për ndryshimin e anëtarëve të bordit nga pesë anëtarë në tre anëtarë, vendim i cili është shoqëruar me caktimin e anëtarëve të rinj të bordit drejtues, përkatësisht shtetasit Greta Kokalari, Erald Ismaili dhe Endrit Isufaj, me drejtor ekzekutiv shtetasen Reada Lemnusha. Për depozitimin e këtyre vendimeve pranë Gjykatës (vendimet e datës 13-14-15.09.2023), është autorizuar shtetasja Greta Domi ose Fjoralba Zeko, ku kjo e fundit ka përpiluar kërkesën drejtuar Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë për depozitimin e vendimeve dhe pranimin e tyre. Gjithashtu, shtetasja Fjoralba Zeko, në datë (bosh) ka plotësuar Formularin e të dhënave të kontaktit duke shënuar adresën "Ibrahim Rugova, Sky Toëer, Hyrja 10, Kati -, Ap 4". Kërkesa është miratuar me Vendimin Nr. 33/7, datë 02.10.2023 të gjyqtarit Fatime Deçolli.*

**61.1.** Nga aktet hetimore rezulton se shtetaset Ina Goxhaj dhe Reada Lemnusha, të emëruara si Drejtor Ekzekutiv i OJF Balkan Youth Link Albania përgjatë viteve të fundit dhe shtetaset Greta Domi, Fjoralba Zeko, të cilat kanë bërë depozitimin e vendimeve pranë Gjykatës, janë punonjëse të shtetases Ajola Xoxa në ambientet e shoqërive Partners Lab dhe Qendra Harabel në rrugën"Ibrahim Rugova, Sky Tower, Hyrja 10, Kati -,Ap 4.

**61.2.** Nga analizimi i deklarimeve në sistemet tatimore C@TS dhe Portali Qendror për Kontroll dhe Menaxhim (fiskalizimi) rezulton se: Nga analizmi i librave të shitjes për periudhën 2022-2024, konstatohet se OJF Balkan Youth Link Albania (BYL-A) ka deklaruar në shitje një vlerë totale prej **31, 521, 286 lekë.** Kryesisht këto faturime përbëhen nga sponsorizime për evente të ndryshme që kjo OJF ka organizuar. Konkretisht:

- **KONTAKT SHPK (ID: J92108006V): 6,507,456 lekë**
- **BASHKIA E TIRANËS (ID: K11729002L): 5,000,000 lekë**
- **SHOQATA "KONGRESI RINOR KOMBETAR" (ID: L71729453B): 4,000,000 lekë**
- QENDRA TREGTARE UNIVERS (ID: L42411002K): 3,539,700 lekë
- MINISTRIA E KULTURËS (ID: J91326001G): 3,100,000 lekë
- **PALUSHI (ID: K12202004R): 2,158,200 lekë**
- **GOGEL (ID: K91621020U): 2,000,000 lekë**

- (Pa Emër) (ID: Blank): 1,996,500 lekë
- **JEDAS (ID: K81806505G): 1,445,730 lekë**
- BANKA CREDINS (ID: K31608801O): 1,188,800 lekë
- ALBTELECOM (ID: J61824053N): 584,900 lekë

**61.4.** Nga analizmi i librave të blerjes për periudhën **2022 – 2024**, rezulton se **OJF Balkan Youth Link Albania (BYL-A)** deklaruar në blerje vlerat e mëposhtme të ndara sipas shitësve:

- **Arts Lab (ID: M12305006H)**: 4,354,400 lekë
- **AVA Studio shpk (ID: M12212012O)**: 2,380,600 lekë
- **QENDRA "HARABEL" (ID: L81509451A)**: 2,015,700 lekë
- KALEMI TRAVEL & TOURS (ID: L62303012A): 1,897,878
- GECI (ID: K71829801O): 1,348,129 lekë
- E.G.M Company shpk (ID: M11509004P): 902,880 lekë
- **Greta Domi (ID: M01427002Q)**: 865,000 lekë
- **Ergys Krisiko (ID: L71703037S)**: 861,800 lekë
- **Partners Laç shpk (ID: L81829013O)**: 747,936 lekë
- DREJTORI E SHERB QEVERITARE (ID: J61828071I): 562,500 lekë
- GENTIAN DODA (ID: M21518027H): 468,560 lekë
- Eno Peci (Fature nga bleresi) (ID: U0522863): 352,325 lekë
- Gentian Doda (Fature nga bleresi) (ID: H80114042R): 352,325 lekë
- Marsela Cibukaj (ID: M01811013J): 325,000 lekë
- PHOENIX + SHPK (ID: K31505091L): 323,600 lekë
- DAJTI PARK 2007 shpk (ID: K11507003S): 313,600 lekë
- **Stefano Romano (ID: L62302019E)**: 300,000 lekë
- Lindar Muça (ID: L32810201U): 264,000 lekë
- Olsi Abazi (ID: L32307016C): 251,640 lekë
- AV (ID: M22130018M): 205,187 lekë
- TRIPLT TRAVEL (ID: M32120027I): 200,000 lekë
- **Adela Kondakçiu (ID: M32306039N)**: 180,000 lekë
- EBG (ID: L12121026C): 195,553 lekë
- Eldad Ben Sasson (Fature nga bleresi) (ID: 20EH31845): 176,120 lekë
- Anna Possarnig (Fature nga bleresi) (ID: U0417042): 176,120 lekë
- Felipe Santana Vieira (Fature nga bleresi) (ID: YC509872): 176,120 lekë Marina Rutzler (Fature nga bleresi) (ID: U2869413): 176,120 lekë
- Mihail Sosnovschi (Fature nga bleresi) (ID: U5006557): 176,120 lekë
- ILIR RRAPUSHAJ PF (ID: K72417015E): 139,920 lekë
- Antonio Spatuzzi (Fature nga bleresi) (ID: SPTNTN96H19F839N): 137,955 lekë
- Flurin Stocker (Fature nga bleresi) (ID: E3108026): 137,955 lekë
- Linda Kuhn (Fature nga bleresi) (ID: L0HFL0YP2): 137,955 lekë
- Anna Jirmanova (Fature nga bleresi) (ID: 206032313): 137,955 lekë
- Katharina Platz (Fature nga bleresi) (ID: L86MX0P35): 137,955 lekë
- Tim Gramboß (Fature nga bleresi) (ID: CH8MNHG3): 137,955 lekë

- Miriam Jasmin Kaya (Fature nga bleresi) (ID: L1V5RNP9C): 137,955 lekë
- Alan Jose Gregorio Gonzalez Bravo (Fature nga bleresi) (ID: 134231619): 137,955 lekë
- Speed Taxi Five Stars (ID: L12017019T): 131,490 lekë
- Altin Bushka (ID: K91713011H): 112,000 lekë
- **ASLV SHPK (ID: L31329009M)**: 102,000 lekë
- Enejda Muzaka (ID: M11928001G): 100,000 lekë
- Frida Banush (ID: L42215015J): 100,000 lekë
- ALBANIAN FOOD AND HOSPITALITY LAB Shpk (ID: L91329021O): 98,475 lekë
- GEA MADHI (ID: L92027003A): 93,900 lekë
- ANORIA (ID: J61824069Ë): 83,440 lekë
- GENT ONUZI PF (ID: L92217033A): 80,000 lekë
- S & E LAZE AUDIT (ID: L48709501U): 80,000 lekë
- **Ketrin Braho (Fature nga bleresi) (ID: J25301138L)**: 76,500 lekë
- **Enejda Muzaka (Fature nga bleresi) (ID: J56210053D)**: 76,500 lekë
- Ioannis Karalis (Fature nga bleresi) (ID: AT5295767): 70,465 lekë
- FABIAN BASHA (ID: M22211007U): 70,000 lekë
- MAGNIFISCENT (ID: M02318002Q): 61,600 lekë
- **Adela Kondakciu (Fature nga bleresi) (ID: I86023085J)**: 49,376 lekë

**61.5.** Konstatohet gjithashtu se financimet për aktivitetet e saj Organizata Byl-A i ka përfituar **nga Bashkia Tiranë, Ministria e Kulturës, shoqëria Kontakt shpk, e cila nga ana e saj ka përfituar leje ndërtimi në Tiranë; shoqëria Jedas shpk, e cila nga ana e saj ka përfituar leje ndërtimi në Tiranë; Palushi shpk (fatura të cilat dyshohen fiktive bazuar në aktet e këtij procedimi) si dhe Gogel shpk** (shoqëri në pronësi të shtetasit Arbër Veliaj, vëllai i shtetasit Erion Veliaj).

**61.6.** Gjithashtu vërehet se OJF Byl-A, një pjesë e fondeve i ka përfituar nga shoqata "Kongresi Rinor Kombetar" me NIPT L71729453b, nëpërmjet tre faturave në vitin 2022 në vlerën 3,600,000 lekë dhe në vitin 2023 në vlerën 40,000 lekë. Nga ana tjetër, Shoqata "Kongresi Rinor Kombetar" pothuajse të gjitha fondet i merr nga Bashkia Tiranë (942,895,318 lekë për 2022-2024).

**61.7. Sa më sipër, evidentohet se një pjesë e konsiderueshme e financimeve të kryera për organizatën Balkan Youth Link Albania (Byl-A), nga subjektet e sipërcituara, përdoren për likujdime të faturave për shërbime të ofruara nga Qendra Harabel (kontrolluar nga shtetasja Ajola Xoxa); Arts Lab shpk (në pronësi të shtetasit Erald Simixhiu por kontrolluar nga shtetësja Ajola Xoxa); Ava Studio shpk (në pronësi të shtetases Valbona Xoxa por kontrolluar nga shtetësja Ajola Xoxa); Ergys Krisiko P.F (person i afërt më shtetasen Ajola Xoxa, i cili dyshohet të ketë lëshuar fatura fiktive për shoqëritë e kontrolluara nga shtetësja Ajola Xoxa; Greta Domi P.F (bashkëpuntore, në të vërtetë punonjëse e shtetases Ajola Xoxa), Adela Kondakciu (ekonomiste e shtetases Ajola Xoxa), punonjësit e Harabel dhe Partners Laë shpk (në pronësi dhe të kontrolluara nga shtetësja Ajola Xoxa).**

- *Lidhur me veprimet hetimore ndaj shoqërisë "NAN Gallery" shpk*

**62.** Në funksion të hetimit janë kontrolluar edhe të dhënat statistikore të **"NAN Gallery" shpk, nga ku, sipas Ekstraktit Historik në QKB rezulton si vijon: Të Dhënat e Subjektit: Emri i Subjektit:** "NAN Gallery" SHPK. **Forma Ligjore**: Shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuar (SHPK). **Data e Themimit**: 17/07/2023. **Data e Regjistrimit**: 20/07/2023. **Numri i Identifikimit (NUIS): M31920013O. Kapitali i Subjektit**: 100 Lekë. **Administratori aktual**: Daniela Vuksani (e emëruar më 01/03/2024 deri 01/03/2029). **Adresa dhe Vendndodhja e Aktivitetit:** Shoqëria ka dy vende të ndryshme të regjistruara për aktivitetin e saj: Fillimisht, zyra qendrore e shoqërisë ishte **në Sky Toëer, Zyra 10/1, Tiranë.** Pas datës <u>**3 dhjetor 2024**</u>, zyra është transferuar në **Rrugën Ibrahim Rugova n. 33,** njësia Administrative nr.5, Tiranë.

**62.1. "Nan Gallery" shpk** rezulton të ketë objekt të gjerë aktiviteti, duke mbuluar disa fusha kryesore: *Botimi i librave dhe materialeve të ndryshme, përfshirë revistat, gazetat, katalogët, broshurat dhe çdo produkt tjetër të lidhur me botimin dhe shkrimin (edukim nëpërmjet botimeve).; Tregtimi dhe shpërndarja e këtyre materialeve, jo vetëm fizikisht, por edhe nëpërmjet platformave elektronike dhe aktiviteteve promovuese (në tregun e brendshëm dhe ndërkombëtar).; Organizimi i aktiviteteve kulturore dhe artistike, si: kurse të artit, ëorkshop-e dhe evente të ndryshme (të tilla si ekspozita, festival, koncerte, etj.).; Promovimi dhe menaxhimi i Gurgur Gallery, një nga projektet kulturore të shoqërisë.; Bashkëpunimi me institucione të tjera artistike në Shqipëri dhe jashtë vendit, për realizimin e aktiviteteve për promovimin e kulturës shqiptare dhe të shtetasve të tjerë; Aktivitetet që mbështesin grupe të margjinalizuara, si: gratë, të rinjtë me mundësi të kufizuara, dhe grupe të tjera sociale, për të integruar dhe ndihmuar në përmirësimin e kushteve të jetesës; Ofrohet konsulencë, trajnime dhe aktivitete edukative për këto grupe, si dhe projekte për rritjen e ndjeshmërisë për probleme sociale dhe shëndetësore; Shoqëria është angazhuar në promovimin dhe menaxhimin e aktiviteteve turistike, përfshirë shërbimet turistike, organizimin e eventeve dhe mbështetje për zhvillimin turistik në Shqipëri dhe jashtë saj.*

**62.2. Historiku i Regjistrimeve dhe Ndryshimeve: 20 korrik 2023** – Regjistrimi i kompanisë si "NAN Gallery" SHPK; **i) 11 tetor 2023** – Driant Zeneli dhuron kapitalin 100% të shoqërisë tek "Qendra Harabel", duke ndryshuar pjesëmarrjen e ortakëve dhe duke e bërë "Qendra Harabel" ortaku i vetëm në shoqëri; **ii) 1 mars 2024** – Driant Zeneli largohet si administrator dhe zëvendësohet me **Daniela Vuksani,** e cila emërohet administratore e re dhe do të mbajë këtë detyrë deri më 1 mars 2029; **iii) 3 dhjetor 2024** – Ndryshimi i adresës së aktivitetit të shoqërisë, ku zyra e regjistruar fillimisht në Sky Toëer është zhvendosur në një adresë të re në Tiranë, tek Rruga Ibrahim Rugova.; **Të Dhëna Kontakti: Email:** <u>driantzeneli@gmail.com</u>; **Telefon:** +355 683326363.

**62.3.** Në lidhje me adresën e cituar më lart, nga organi procedues janë kryer verifikime për objektin "Vilë", *ndodhur në rrugën "Dëshmorët e 4 Shkurtit", Tiranë,* që ka rezultuar se përdoret si Galeri nga *Qëndra Harabel/Galeria NAN SHPK.* Kështu, me procesverbalin e datës 15.11.2024 *"Për këqyrjen dhe marrjen e dokumenteve"*, pranë ASHK-së, Drejtoria Vendore Tiranë Jug, janë këqyrur dhe marrë dokumentet e pronësisë lidhur me objektin "Vilë", *ndodhur në rrugën "Dëshmorët e 4 Shkurtit", Tiranë (vila e cila përdoret si Galeri nga Qëndra Harabel/Galeria NAN SHPK).* Nga këqyrja ka rezultuar se kjo pronë ka

numrin e pasurisë 3/546, ZK 8270 "Truall" me sip totale 1100 m2, nga të cilat 269 m2 ndërtesë 2 kate dhe një kat, ku pjesa njëkatëshe është me sip 91 m2. Nga kartela aktuale e pasurisë rezulton se ajo zotërohet nga bashkëpronarët dhe pjesët e tyre takuese si më poshtë: 1) Arben Isa Xhabafti, pjesa takuese 4/16; 2) **<u>Gentian Skender Sula, pjesa takuese 4/16</u>; 3) Besiana Ilir Antoni, pjesa takuese 4/16**; 4) Miranda Elmaz Leka, pjesa takuese 2/16;5) Xhenis Arben Angjeli, pjesa takuese 1/16;6) Era Arben Xhabafti, pjesa takuese 1/16.

**62.3.1.** Shtetasit Gentian Skender Sula dhe Besiana Ilir Antoni janë bërë pronarë të pjesëve takuese përkatëse prej ¼, sipas kontratës Nr. 154 Rep., dhe Nr. 77 Kol., datë 11.02.2020, kontratë shitblerje me kusht kreditimi, pala shitëse Vilma Antoni dhe Ilir Antoni ndërsa pala blerëse Gentian Sula dhe Besiana Antoni.

**62.4.** Më pas, nga analizimi i librave të **shitjes** të **shoqërisë Nan Gallery shpk** rezulton se janë deklaruar në shitje gjithsej **<u>9,794,404 Lekë</u>** të ndara sipas blerësve të mëposhtëm:

- **Sokol Kryeziu Individ (ID: I70806002Q): 5,037,064 Lekë**
- **(Blank) (ID: Blank): 1,331,440 Lekë**
- **Frobolous (ID: M22214702R): 960,000 Lekë**
- Driant Zeneli (ID: I30425067Q): 895,000 Lekë
- **Frobolous LTD (ID: 12390371): 461,936 Lekë**
- **Qendra "HARABEL" (ID: L81509451A): 442,215 Lekë**
- **Ergys Krisiko (ID: L71703037S): 300,000 Lekë**
- Andi Balita (ID: H01130033A): 257,520 Lekë
- Klodi Beja (ID: H50321132C): 68,705 Lekë
- Erinda Ballanca (ID: H36028038R): 40,524 Lekë
- KRISIKO (ID: M41612034L): 0 Lekë.

**62.5.** Nga analizimi i librave të **blerjes** të shoqërisë **Nan Gallery shpk** rezulton se janë deklaruar në blerje **<u>5,273,456 Lekë</u>** të ndara sipas blerësve të mëposhtëm:

- **Idlir Koka (Faturë nga Blerësi) (ID: PH): 1,662,400 Lekë**
- **Partners Laë shpk (ID: L81829013O): 747,936 Lekë**
- Megatek sh.a (ID: K81607050Q): 633,515 Lekë
- **Stefano Romano (ID: L62302019E): 406,500 Lekë**
- **QENDRA "HARABEL" (ID: L81509451A): 393,647 Lekë**
- BISHA SHPK 2024 (ID: J64228824K): 256,500 Lekë
- **Adela Kondakçiu (ID: M32306039N): 180,000 Lekë**
- Aisel Oseku (Faturë nga Blerësi) (ID: I76017050J): 146,752 Lekë
- Hima Travel & Tours (ID: L72031024Q): 103,790 Lekë
- Fatmir Ali Korriku (ID: K62209511B): 89,800 Lekë
- Florian Çanga (ID: M22311023F): 84,000 Lekë
- ED - LUI (ID: M02201501T): 81,700 Lekë
- KALEMI TRAVEL & TOURS (ID: L62303012A): 69,709 Lekë
- Delta Sh.a (ID: K13127202Ë): 67,152 Lekë
- Anoria SHPK (ID: J61824069Ë): 63,400 Lekë
- Leke Gjeloshi (ID: 1): 60,384 Lekë

- Shpresa Al Computer (ID: L81325020I): 54,660 Lekë
- Lizard shpk (ID: L01508026P): 53,940 Lekë
- PHOENIX + SHPK (ID: K31505091L): 36,000 Lekë
- UNIVERS PROMOTIONS SHPK 2024 (ID: K81324039M): 24,356 Lekë
- Zgatar Electronics (ID: M21718004V): 22,308 Lekë
- Image & Communications Development shpk (ID: L01511027P): 18,206 Lekë
- SCANDINAVIAN LIVING (ID: L51901006G): 11,000 Lekë
- ABISSNET (ID: K01417001C): 5,800 Lekë.

**62.6. Sa më sipër, konstatohet se në pjesën më të madhe kjo shoqëri (Nan Gallery) financohet nga shoqëri apo individë të cilët kanë marrë fonde drejtpërdrejt ose në mënyrë të tërthortë nga Bashkia Tiranë. Konkretisht, shtetasi Sokol Kryeziu është aksioner i shoqërisë Gerard – A me nipt L12407005L, shoqëri kjo që ka fituar disa prokurime në Bashkinë Tiranë. Gjithashtu, shoqëria Nan Gallery shpk (e kontrolluar nga shtetësja Ajola Xoxa) financohet nga OJF Frobolous, e cila ka organizuar një event me fondet publike të financuara prej Bashkisë Tiranë; nga Ergys Krisiko (person i afërt i shtetases Ajola Xoxa) si dhe nga vetë Qendra Harabel.**

***- Lidhur me veprimet hetimore ndaj qendrës "Muza".***

**63.** Me dokumentin Vërtetim Nënshkrimi me Nr. 1237 Rep., datë 06.09.2023, noter Mimoza Xhafaj, është vërtetuar nënshkrimi i Statutit të qendrës **"Muza"**. Sipas Statutit, është vendosur që të themelohet organizata jofitimprurëse "Muza". Në nenin 3 "Selia dhe territori", është përcaktuar adresa e shoqërisë, rruga "Njazi Demi", Pallatet "1 Maji", shkalla 8, Ap. 50, Tiranë. **Personat Themelues të Qendrës janë Erald Simixhiu, Arben Spartaku dhe Rea Spartaku, përkatësisht daja i shtetases Ajola Xoxa dhe dy kushërinjtë e kësaj të fundit.** Në nenin 9 "Drejtori Ekzekutiv", pika 9.6, përshkruhet se Themeluesit kanë vendosur që qendra të ketë si **Drejtor Ekzekutiv shtetasin Erald Simixhiu (daja i shtetases Ajola Xoxa)**. Në nenin 13 "Burimet Financiare për themelimin e qendrës", përshkruhet se Kapitali fillestar i qendrës për përmbushjen e qëllimit të saj është 10,000 lekë.

**63.1.** Në datë **06.09.2023**, shtetasit Erald Simixhiu, Arben Spartaku dhe Rea Spartaku (të gjithë të afërm të shtetases Ajola Xoxa), kanë lëshuar prokurë të posaçme me Nr. 1240 Rep., Nr. 225 Kol., notere Mimoza Xhafaj, për shtetasen Fjoralba Zeko, e cila autorizohet për kryerjen e çdo veprimi për regjistrimin e qendrës Muza.

**63.2.** Në datë **06.09.2023,** është mbajtur Procesverbali i mbledhjes së themeluesve të qendrës Muza, ku themeluesit shtetasit **Erald Simixhiu, Arben Spartaku dhe Rea Spartaku** kanë vendosur që të emërojnë veten e tyre si anëtar të Bordit të Drejtuesve. Ky dokument, është nënshkruar para noterit, sipas Vërtetim Nënshkrimit të datës 06.09.2023, me Nr. Rep 1238, notere Mimoza Xhafaj.

**63.3.** Në datë **06.09.2023,** është mbajtur Procesverbali i mbledhjes së bordit të drejtorëve të qendrës Muza, ku nga bordi është vendosur që Drejtor ekzekutiv të jetë Erald Simixhiu, ndërsa Arkëtar Rea Lemnusha (emri është shënuar shkurt). Bashkëlidhur gjendet edhe kopje e faqes së pasaportës të shtetases Reada Lemnusha, me Nr. personal J65505078R, me Nr. pasaporte BR8118185, lëshuar në datë 08.03.2016. Ky procesverbal, është nënshkruar

para noterit, sipas Vërtetim Nëshkrimit të datës 06.09.2023, me Nr. Rep 1239, notere Mimoza Xhafaj.

**63.4.** Në datë **08.09.2023**, është përpiluar kërkesa e cila i drejtohet Gjykatës së Tiranës për regjistrimin e qendrës "Muza". Përshkruhet se qendra ka Bord Drejtues shtetasit Erald Simixhiu, Arben Spartaku dhe Rea Spartaku. Po kështu, në funksion të kësaj qendre, në kërkesë relatohet se Drejtori ekzekutiv është Erald Simixhiu ndërsa arkëtar është Rea Lemnusha (emri i saj nuk është i plotë, quhet Reada). **Qendra do ta ketë selinë në rrugën "Njazi Demi", Pallatet "1 Maji", shkalla 8, Ap. 50, Tiranë. (E njëjta adresë me qendrën Eventus).** Qëllimi i veprimtarisë së qendrës nuk ka objekt fitimin, por ndjek si qëllim të sajin primar promovimin dhe përhapjen e kulturës dhe artit në çdo formë dhe nëpërmjet të çdo veprimtari, aktiviteti apo nisme në favor të personave që janë të interesuar. Qendra mund të kryejë aktivitete që krijojnë të ardhura sipas ligjit Nr. 8788, datë 07.05.2011 "Për organizatat jofitimprurëse", me qëllim mbledhjen e fondeve të cilat nuk do të shpërndahen si fitime ose që do të destinohen për mbështetjen e aktiviteve. Kërkesa është nënshkruar nga përfaqësuesja Fjoralba Zeko. Bashkëlidhur kërkesës, përshkruhet se gjendet akti i themelimit, statuti dhe vendimet e bordit. Kërkesa e mësipërme është nënshkruar përpara noteres Mimoza Sadushaj, sipas Vërtetim Nënshkrimit Nr. 1252 Rep., datë 08.09.2023.

**63.5.** Me kërkesën datë **03.11.2023**, me Nr. 8068 Prot., hyrje në Gjykatën e Tiranës, shtetasja Fjoralba Zeko, ka dorëzuar vendimin e mbledhjes së bordit drejtues të Qendrës Muza lidhur me emërimin e drejtorit ekzekutiv dhe disa shtesa në statutin e qendrës. Bashkëlidhur kërkesës gjendet Procesverbali i mbledhjes së bordit të drejtorëve të qendrës Muza, datë 02.11.2023, ku kanë vendosur si Drejtor Ekzekutiv shtetases Alketa Spartaku, Po kështu është bërë ndryshimi edhe i mënyrës së paraqitjes së logos së qendrës.

**63.6.** Në datë (nuk përcaktohet) nga Fjoralba Zeko është plotësuar edhe "Formular për të dhënat e kontaktit", ku në rubrikën "Adresa kryesore e kontaktit" është plotësuar rruga "Sulejman Delvina", Tiranë dhe Nr. i kontaktit 0695674504.

**63.7.** Me vendimin për regjistrimin si person juridik me Nr. 1071 Regj Them., Nr. 1853 Vendimi, datë **21.11.2023**, gjyqtari Anila Karanxha ka vendosur regjistrimin e organizatës jofitimprurëse "Muza", me bord drejtues Erald Simixhiu, Arben Spartaku dhe Rea Spartaku, ndërsa drejtues ekzekutiv Alketa Spartaku.

**63.8.** Në datë **09.02.2024**, nga bordi drejtues është mbajtur procesverbali për ndryshimin e drejtorit ekzekutiv. Përshkruhet se kryetari i kësaj mbledhjeje ka qenë Erald Simixhiu. Dhe është vendosur pranimi i dorëheqjes së drejtorit ekzekutiv Alketa Spartaku dhe caktimin si drejtor të ri shtetasin Emil Simixhiu. Në lidhje me depozitimin e këtij vendimi në Gjykatë, është ngarkuar shtetasja Fjoralba Zeko ose Greta Domi. Dokumentohet se procesverbali i mësipërm është dorëzuar pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, **nga shtetasja Fjoralba Zeko, e cila ka plotësuar edhe të dhënat e kontaktit, ku ka përcaktuar si adresë kryesore kontakti rrugën "Ibrahim Rugova", pallati Sky Toëer, kati 10, Ap 4 dhe Nr. telefonik 0695674504.**

**63.9.** Në datë 15.03.2024, është përpiluar nga Alketa Spartaku një shkresë drejtuar anëtarëve të Bordit Drejtues të Qendrës Muza, në të cilën kërkohet revokimi i dorëheqies dhe vazhdimi i saj si drejtor ekzekutiv i kësaj qendre.

**63.10.** Në datë **25.03.2024**, nga bordi drejtues i qendrës Muza, është marrë vendimi i pranimit të revokimit të dorëheqies së shtetases Alketa Spartaku dhe t'i paraqesin Gjykatës së

Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, që të heqë dorë nga shqyrtimi i kërkesës së datës 14.02.2024, për ndryshimin e drejtorit ekzekutiv. Në lidhje me depozitimin e këtij vendimi në Gjykatë, nga Bordi Drejtues janë ngarkuar shtetasja Fjoralba Zeko ose Greta Domi. Dokumentohet se kërkesa në lidhje me vendimin e mësipërm është dorëzuar nga Fjoralba Zeko në datë 27.03.2024 pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, ku ka marrë Nr. 2864 Prot Hyrje. Kërkesa e mësipërme është pranuar Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, me anë të vendimit Nr. 487 Akti., Nr. 1853/1 Vendimi., datë 03.04.2024.

**63.11.** Në kuadër të hetimit paraprak, për pjesën që lidhet me pagesat e këtyre shoqërive nga institucione publike, janë kryer disa veprime hetimore të cilat fillimisht kanë konsistuar në këqyrjen që ka rezultuar nga verifikimi në Sistemin e Thesarit (SIFQ, përdorues i të cilit është edhe Bashkia Tiranë). **Nga këqyrja ka rezultuar se për Qëndra Muza, është kryer një pagesë nga Bashkia Tiranë në vlerën 1,620,248.00 Lekë, Event Muzikor "Baroques meets Jazz" datë 10 Maj 2024, sipas Urdhër shpenzimit dt. 21.06.2024, nr. 2562, firmosur nga kryetari i Bashkisë Tiranë Erion Veliaj.**

**63.11.1.** Nga këqyrja e dokumentacionit të pagesave më sipër, rezulton se fondi i financuar nga Bashkia Tiranë, është shpenzuar më pas si vijon: **Qëndra Muza, NIPT: M32415453B**, ka marrë pagesën nga Bashkia Tiranë sipas **Urdhër shpenzimit Nr. 2562, datë 21.06.2024, vlera 1,620,248 Lekë, të firmosur nga kryetari i Bashkisë Tiranë, për event muzikor "Baroques meets Jazz".** Buxheti/propozimi për financim dhe kontraktimi i zërave financuar nga bashkia Tiranë:

| Nr. | Përshkrimi | Njësia | Sasia | Çmimi/Lekë | Shuma/Lekë |
|---|---|---|---|---|---|
| 1 | Ansambli 1 instumentisteve | shërbim | 1 | 600,000 | 600,000 |
| 2 | Kengetare | person | 1 | 120,000 | 120,000 |
| 3 | Trompist | person | 1 | 30,000 | 30,000 |
| 4 | Bandi Jazz | shërbim | 1 | 500,000 | 500,000 |
| 5 | Qeraja e salles | shërbim | 1 | 332,748 | 332,748 |
| 6 | Printime | shërbim | 1 | 60,000 | 60,000 |
| | Totali | | | | 1,642,748 |

***Shpenzimet e kryera:***

- ***Vlera 600,000 Lekë*** *sipas Faturë elektronike nr. 7/2024, dt. 10.05.2024,* ***nga Arts Lab****, blerësi MUZA, përshkrimi* ***"Ansambli i instrumentistëve"****, shoqëruar me aktmarrëveshjen përkatëse lidhur mes palëve dt. 02.05.2024, si dhe Ekstrakt QKB i Arts Lab.*
- ***Vlera 500,000 Lekë****, sipas Faturë elektronike nr. 8/2024, dt. 10.05.2024,* ***nga Arts Lab****, blerësi MUZA, përshkrimi* ***"Bandi Jazz"****, shoqëruar me aktmarrëveshjen përkatëse lidhur mes palëve dt. 02.05.2024, si dhe Ekstrakt QKB i Arts Lab.*
- ***Vlera 467,748 Lekë****, qiraja e ambienteve dhe shërbim ushqimor te Pallati i Brigadave, fatura nga Drejtoria e Shërbimeve Qeveritare.*
- ***Vlera*** *50,000 Lek, sipas faturë elektronike nr. 515/2024, dt. 10.05.2024, shitësi PHOENIX + SHPK, përshkrimi "Printime", shoqëruar me aktmarrëveshjen përkatëse lidhur mes palëve.*
- ***Vlera bruto 120,000 Lekë****, sipas Bordero dt. 10.05.2024, nga MUZA, punonjësi* ***Linda Kazani****, së bashku me aktmarrëveshjen përkatëse lidhur midis palëve dhe ID e Linda Kazani.*
- *Vlera bruto 30,000 Lek, Bordero 10.05.2024, nga Muza, punonjësi Xhovana Marku, së bashku me akt marrveshjen përkatëse lidhur midis palëve dhe ID e Xhovana Marku.*

63.12. Nga analizimi i deklarimeve në Portalin Qendror për Kontroll dhe Menaxhim (fiskalizimi) rezulton se: **Subjekti Qendra Muza me NIPT M32415453B ka deklaruar shitje kundrejt Bashkisë Tiranë me NIPT K11729002L** si vijon:

- Më **10 maj 2024**, është regjistruar një faturë me vlerë **2,177,748**. Lekë;
- Më **20 maj 2024**, po kjo shumë e njëjtë (**2,177,748** lekë) është regjistruar si negative (kthim/kredit/anullim), duke e zeruar faturën e mëparshme.
- Po në **20 maj 2024**, është regjistruar një tjetër faturë pozitive me vlerë **2,042,748** lekë;
- Më **29 maj 2024**, është regjistruar një faturë me vlerë **1,642,748** lekë;
- Po më **29 maj 2024**, fatura e dytë prej (**2,042,748** lekë) është regjistruar sërish si negative (kthim/kredit/anullim), duke e anuluar faturën e datës **20 maj 2024**.

**63.13.** Në përfundim Bashkia Tiranë është faturuar për **<u>1,642,748 lekë</u>** nga Qendra Muza.

**63.14.** Nga analizimi i deklarimeve në librat e blerjes të rezulton se OJF Qendra Muza është faturuar nga subjektet e mëposhtme:

- **Arts Lab (Faturë nga Shitësi) (ID: M12305006H)**: 1,100,000 Lekë
- DREJTORI E SHERB QEVERITARE (Faturë nga Shitësi) (ID: J61828071I): 467,748 Lekë
- **Adela Kondakçiu (Faturë nga Shitësi)** (ID: M32306039N): 180,000 Lekë
- **Partners Lab shpk (Faturë nga Shitësi)** (ID: L81829013O): 120,420 Lekë
- PHOENIX + SHPK (Faturë nga Shitësi) (ID: K31505091L): 60,000 Lekë
- KALEMI TRAVEL & TOURS (Faturë nga Shitësi) (ID: L62303012A): 37,811 Lekë
- Image & Communications Development shpk (Faturë nga Shitësi) (ID: L01511027P): 6,000 Lekë
- **AVA Studio shpk (Faturë nga Shitësi)** (ID: M12212012O): 0 Lekë

63.15. Më poshtë analizimi i faturave të blerjes të **Qendra Muza** sipas datave:

**Arts Lab (M12305006H):**

- Më **10 maj 2024**, **Arts Lab** i ka lëshuar dy fatura Muza-s, përkatësisht me vlerat **600,000** dhe **500,000**.
- Totali i faturave që Muza ka pranuar nga Arts Lab është **1,100,000**.
- DREJTORI E SHERB QEVERITARE (J61828071I)
- Më **10 maj 2024**, ky subjekt i ka lëshuar Muza-s një faturë prej **467,748**.
- Më **20 maj 2024**, po i njëjti subjekt ka dërguar një faturë krediti (negativ) për (**467,748**), duke e anuluar faturën e mëparshme, dhe më pas ka lëshuar edhe një faturë të re me po të njëjtën vlerë **467,748** po atë ditë.
- Rezulton që, në fund, Muza është faturuar në një total neto prej **467,748** nga ky subjekt.
- **Adela Kondakçiu (M32306039N)**
- Janë regjistruar disa fatura me vlerë **20,000** secila, në **intervalin** kohor mes **12 mars 2024** dhe **30 tetor 2024**.
- Në total, Muza ka pranuar 9 fatura prej 20,000, që e çojnë shumën në **180,000**.

**Partners Laë shpk (L81829013O)**

- Partern Laë ka lëshuar një faturë, e lëshuar më **17 maj 2024**, me vlerën **120,420** lekë
- PHOENIX + SHPK (K31505091L)
- Më **10 maj 2024**, PHOENIX + SHPK i ka lëshuar Muza-s një faturë me vlerë **60,000** lekë
- KALEMI TRAVEL & TOURS (L62303012A)
- Ka një faturë të vetme më **26 prill 2024**, me vlerë **37,811** lekë
- Image & Communications Development shpk (L01511027P)
- **Muza** ka pranuar një faturë prej **6,000** lekë **më 29 prill 2024**.
- **AVA Studio shpk (M12212012O)**
- Më **10 maj 2024**, subjekti ka lëshuar dy fatura: **100,000** dhe **300,000**.
- Më **30 maj 2024**, ka dërguar dy fatura krediti (negativ) që anulojnë plotësisht faturat e mëparshme: **(300,000)** dhe **(100,000)**.
- Kjo e çon totalin neto në **0**, duke treguar se nuk mbetet asnjë detyrim aktiv.

**63.16. Bazuar në sa më sipër, arrihet në përfundimin se Qendra Muza, e themeluar nga shtetasi Erald Simixhiu, i cili është familjar i shtetases Ajola Xoxa, por që kontrollohet efektivisht nga kjo e fundit, ka organizuar vetëm një event gjatë gjithë aktivitetit të saj. Fondet për këtë event janë siguruar nga Bashkia Tiranë dhe më pas janë shpërndarë te shtetësja Linda Kazani (familjare e shtetases Ajola Xoxa) dhe te shoqëria tregtare Arts Lab, në pronësi ligjore të shtetasit Erald Simixhiu, por në pronësi faktike të shtetases Ajola Xoxa. Gjithashtu, nga faturimet evidentohet se Qendra Muza ka paguar shoqërinë Partner Law, në pronësi të shtetases Ajola Xoxa, si dhe janë kryer pagesa për shtetasen Adela Kondakciu, e cila shërben si ekonomiste për shoqëritë dhe organizatat e lidhura me shtetasen Ajola Xoxa. Po ashtu, vlen të theksohet fakti i lëshimit fillimisht të një fature tatimore për subjektin Ava Studio (në pronësi të shtetases Valbona Xoxa), e cila më pas është anuluar.**

*- Lidhur me veprimet hetimore ndaj OJF "Frobolous".*

64. Veprime hetimore janë kryer edhe në lidhje me **Organizatën Jofitimprurëse "Frobolous"**, e cila rezulton të jetë themeluar me aktin Nr. 1587 Rep., Nr. 580 Kol., datë 08.04.2022, noter Joana Smakaj. Anëtarë themelues rezultojnë të jenë *shtetasit Frosina Bollo, Xhesika Fazllija, Rudina Fazllija, Andrea Bollo, Luljeta Bollo, Eneida Hasko, Ariela Vardham, të cilët kanë vendosur që të themelojnë një qendër jofitimprurëse me emrin "Frobolous", përcaktuar kjo edhe në nenin 1 dhe 2 të aktit të themelimit. Në nenin 3 "Vendndodhja, Territori" është përcaktuar adresa e organizatës, Lagjia Nr.3, Sheshi Iliria, Kulla EGT, Kati i 3-të, Durrës. Në nenin 4 "Misioni", përshkruhet se misioni i organizatës është trajtimi dhe integrimi i femrave në nevojë në fushën e rrobaqepësisë. Përmes komunikimit efektiv dhe angazhimit të saj, objektivi i organizatës është që të kontribuojë në realzimin e politikave afatgjata për trajtimin dhe integrimin e femrave në nevojë në fushën e rrobaqepësisë. Në nenin 9 "Bordi Ekzekutiv", përshkruhet se veprimtaria e organizatës do të drejtohet nga Bordi ekzekutiv, i cili është i përbërë nga 5 (pesë) anëtarë. Po kështu, janë*

*përcaktuar anëtarët e bordit që rezultojnë në fakt të jenë 7 (shtatë) (Frosina Bollo. Xhesika Fazllija, Rudina Fazllija, Andrea Bollo, Luljeta Bollo, Eneida Hasko, Ariela Vardham). Po kështu janë përcaktuar si Drejtor ekzekutiv – Frosina Bollo; Zv/Drejtor ekzekutiv – Xhesika Fazllija; Sekretar Organizativ – Eneida Hasko; Financier – Ariela Vardhami; Koordinator grupesh – Andrea Bollo; Anëtar bordi – Luljeta Bollo dhe Rudina Fazllija.* Në datë **11.04.2022**, është përpiluar kërkesa e cila i drejtohet Gjykatës së Tiranës për regjistrimin e organizatës jofitimprurëse "Frobolous". Kërkesa është nënshkruar nga Frosina Bollo, Xhesila Fazllija (*emri i saj shënuar gabim Xhesika Fazllija)*, Rudina Fazllija, Andrea Bollo, Luljeta Bollo, Eneida Hasko, Ariela Vardham, por është autorizuar Ada Haxhi që të ndjekë procedurat për regjistrimin e organizatës jofitimprurëse. Rezulton se është plotësuar Formulari për të dhënat e kontaktit, ku gjendet emri Ada Haxhi, Adresa Bulevardi Gjergj Fishta, Nd. 2, Hyrja 7, Kati 2, Ap 7 dhe Nr. telefoni 0698995993. Me vendimin për regjistrimin si person juridik me Nr. 677 Akti., Nr. 6931 Vendimi, datë 12.07.2022, gjyqtari Arben Kostandini ka vendosur regjistrimin e organizatës jofitimprurëse "Frobolous", me bord drejtues prej 7 anëtarësh, me drejtues ekzekutiv Frosina Bollo.

**64.1.** Në lidhje me këtë organizatë, nga këqyrja në Sistemin e Thesarit (SIFQ, përdorues i të cilit është edhe Bashkia Tiranë), ka rezultuar se për **OJF "Frobolous"** është kryer një pagesë në vlerën **2,970,000.00 Lekë**, Projekti Artistiko-Kulturor "Tiranas's Fashion Night", datë 11 Nëntor 2023, **sipas Urdhër shpenzimit dt. 29.12.2023, nr. 6369, të firmosur nga Kryetari i Bashkisë Tiranë, Erion Veliaj. Konkretisht: OJF "Frobolous" NIPT: M22214702R**, ka marrë pagesë nga Bashkia Tiranë sipas Urdhër shpenzimi **nr. 6369, dt. 29.12.2023, vlera 2,970,000 Lekë**, Projekti *"Tirana's Fashion Night"*. Sipas Raportit të Përgjithshëm të projektit, **vlera totale e parashikuar e projektit është 6,946,845 Lekë**, mbështetur pjesa tjetër nga **Qendra "Harabel"** (3,072,945 Lekë) dhe nga Grace Models. **Buxheti/propozimi për financim dhe kontraktimi i zërave financuar nga bashkia Tiranë:**

| Nr. | Përshkrimi | Njësia | Sasia | Çmimi/Lekë | Shuma/Lekë |
|---|---|---|---|---|---|
| 1 | **Koncept** kreativ (**skenografi, vizualet**, titulli, **vizualet online dhe rrjete sociale)** | **sherbim** | **1** | **540,000** | **540,000** |
| 2 | Prodhim video (qera kamera, ndricim, staf, konceptimi video) | sherbim | 1 | 410,000 | 410,000 |
| 3 | Skenografi | | | | |
| 4 | Dj | sherbim | 1 | 1,100,000 | 1,100,000 |
| 5 | Regji levizese | sherbim | 1 | 50,000 | 50,000 |
| 6 | Drejtori I pergjithshem | sherbim | 1 | 250,000 | 250,000 |
| 7 | Asistent prodhimi | person | 1 | 110,000 | 110,000 |
| 8 | Qira karrige per publikun | person | 3 | 30,000 | 90,000 |
| 9 | Ndricimi dhe foni | sherbim | 1 | 150,000 | 150,000 |
| 10 | Backstage(karrige per modelet, stafin, tavolina, varese per veshjet, tavolina) | sherbim<br>sherbim | 1<br>1 | 200,000<br>100,000 | 200,000<br>100,000 |
| | Totali | | | | 3,000,000 |

***Shpenzimet** e kryera:*

- *Vlera **540,000 Lek**, sipas **faturë** elektronike nr. **35/2023**, dt. **12.12.2023**, nga **Ergys Krisiko**, blerësi FROBOLOUS, përshkrimi "**Koncept kreativ**", shoqëruar me aktmarrëveshjen përkatëse lidhur mes palëve, si dhe Ekstrakt QKB;*

- *Vlera **1,100,000 Lek**, sipas faturë elektronike nr. 33/2023, dt. 23.11.2023, nga **Ergys Krisiko**, blerësi FROBOLOUS, përshkrimi "Skenografi", shoqëruar me aktmarrëveshjen përkatëse lidhur mes palëve, si dhe Ekstrakt QKB;*
- *Vlera **150,000 lek**, sipas faturë elektronike nr. 6/2023, dt. 30.11.2023, nga **NAN GALLERY**, blerësi FROBOLOUS, përshkrimi "Qira Karrige per publikun", shoqëruar me aktmarrëveshjen përkatëse lidhur mes palëve, si dhe Ekstrakt QKB;*
- *Vlera **50,000 lek**, sipas faturë elektronike nr. 5/2023, dt. 30.11.2023, nga **NAN GALLERY**, blerësi FROBOLOUS, përshkrimi "DJ", shoqëruar me aktmarrëveshjen përkatëse lidhur mes palëve, si dhe Ekstrakt QKB;*
- *Vlera **250,000 lek**, sipas faturë elektronike nr. 9/2023, dt. 30.11.2023, nga **NAN GALLERY**, blerësi FROBOLOUS, përshkrimi "Regji levizeze", shoqëruar me aktmarrëveshjen përkatëse lidhur mes palëve, si dhe Ekstrakt QKB;*
- *Vlera **410,000 lek**, sipas faturë elektronike nr. 8/2023, dt. 30.11.2023, nga **NAN GALLERY**, blerësi FROBOLOUS, përshkrimi "Prodhim video", shoqëruar me aktmarrëveshjen përkatëse lidhur mes palëve, si dhe Ekstrakt QKB;*
- *Vlera **100,000 lek**, sipas faturë elektronike nr. 7/2023, dt. 30.11.2023, nga **NAN GALLERY**, blerësi FROBOLOUS, përshkrimi "Backstage", shoqëruar me aktmarrëveshjen përkatëse lidhur mes palëve, si dhe Ekstrakt QKB;*
- *Vlera **200,000 lek**, sipas faturë elektronike nr. 388/2023, dt. 05.12.2023, nga **ASLV SHPK**, blerësi FROBOLOUS, përshkrimi "Sherbim Audio Ndricim", shoqëruar me aktmarrëveshjen përkatëse lidhur mes palëve, si dhe Ekstrakt QKB;*
- *Bordero mbi stafin e angazhuar në aktivitet:*
  - *Stefano **Romano**, Drejtor i Përgjithshëm,* *paga **bruto 110,000 ALL;***
  - *Reada **Lemmusha**, Asistent prodhimi,* *paga **bruto 30,000 ALL;***
  - *Rea **Spartaku**, Asistent Prodhimi,* *paga **bruto 30,000 ALL;***
  - *Arba Topalli, Asistent prodhimi,* *paga **bruto 30,000 ALL;***

**64.2.** Nga analizimi i deklarimeve të shitjeve në Portalin Qendror për Kontroll dhe Menaxhim (fiskalizimi), rezulton se subjekti "Frobolous" ka deklaruar shitje kundrejt subjekteve të mëposhtme: **i) BASHKIA E TIRANES (ID: K11729002L): 3,000,000 Lekë; ii)** First Investment Bank - Albania sha. (ID: K72014801J): 200,000 Lekë; **iii)** Ari the Brand (ID: 811448415): 51,850 Lekë.

**64.3.** Nga analizimi i deklarimeve në librat e blerjes të rezulton se OJF Frobolous është faturuar nga subjektet e mëposhtme:

- **Ergys Krisiko (Faturë nga Shitësi) (ID: L71703037S): 1,640,000 Lekë**
- Greiss Petroviq (Faturë nga Shitësi) (ID: L21821009J): 1,331,200 Lekë
- AN Avant-Garde (Faturë nga Shitësi) (ID: M21806014R): 1,312,220 Lekë
- **NAN Gallery (Faturë nga Shitësi) (ID: M31920013O): 960,000 Lekë**
- DREJTORI E SHERB QEVERITARE (Faturë nga Shitësi) (ID: J61828071I): 547,992 Lekë
- **AVA Studio shpk (Faturë nga Shitësi) (ID: M12212012O): 540,000 Lekë**
- **ASLV SHPK (Faturë nga Shitësi) (ID: L31329009M): 200,000 Lekë**
- DRIMA (Faturë nga Shitësi) (ID: K71530002Q): 29,000 Lekë

- Idi Balla (Faturë nga Shitësi) (ID: M02313013G): 14,000 Lekë
- BNT Electronics (Faturë nga Shitësi) (ID: J61817047D): 7,188 Lekë
- Eurolab Internacional Grup SHPK. (Faturë nga Shitësi) (ID: K36503231E): 0 Lekë
- Ari the Brand (Faturë nga Shitësi) (ID: 811448415): 0 Lekë

**64.4. Bazuar në sa më sipër, arrihet në përfundimin se OJF "Frobolous", ka organizuar vetëm një event gjatë gjithë aktivitetit të saj. Fondet për këtë event janë siguruar nga Bashkia Tiranë dhe më pas të gjitha këto fonde janë shpërndarë në shoqëritë: i) Ergys Krisiko (të dyshuara fiktive bazuar në aktet dhe deklarimet e vetë këtij shtetasi); ii) tek shoqëria Ava Studio (në pronësi të Valbona Xoxa por në kontroll të Ajola Xoxa) dhe iii) NAN Gallery në pronësi të Qendra Harabel (kontrolluar nga shtetasja Ajola Xoxa).**

**64.5.** Këtu vlen për t'u theksuar se **"Ava studio" shpk** (Faturë nga Shitësi) (ID M12212012O) ka lëshuar faturën e datës 24.11.2023 ora 13:52:12: 540,000 Lekë, me përshkrimin: *Koncept Kreativ. Ergys Krisiko* (Faturë nga Shitësi) (ID: L71703037S) e ka lëshuar faturën datës 12.12.2023 ora 15:06:37 në vlerën 540,000 Lekë, me përshkrimin: *Koncept kreativ.*

**64.6. Nga aktet e administruara rezulton se për shërbimin "Koncept Kreativ" OJF Frobolous është faturuar dy herë në të njëjtën shumë, me të njëjtin përshkrim, por në data të ndryshme. Duke qenë se OJF Frobolous ka organizuar vetëm një event përgjatë aktivitetit të saj dyshohet se fatura e datës 23.11.2023, lëshuar nga "Ava Studio" nuk është depozituar qëllimisht pranë Bashkisë Tiranë, për mosevidentimin e kryerjes së pagesës kundrejt kësaj shoqërise e cila është në pronësi të shtetases Valbona Xoxa, (nëna e shtetases Ajola Xoxa). Si rrjedhojë ka dyshime të arsyeshme të bazuara në prova se edhe fatura e datës 12.12.2023 është lëshuar fiktivisht nga Ergys Krisiko P.F.**

- ***Lidhur me veprimet hetimore ndaj qendrës "Eventus" si dhe dhënia e përfitimit të parregullt nga subjekti "Palushi" shpk.***

**65.** Gjithashtu, nga aktet e administruara rezulton se familjarët e shtetases Ajola Xoxa kanë krijuar edhe një qendër tjetër me karakter jofitimprurës. Konkretisht, me aktin e themelimit të **Qendrës "Eventus"** me Nr. 3704 Rep., Nr. 1782 Kol., datë 02.11.2021, anëtarët themelues shtetasit Emil Simixhiu, Erald Simixhiu, dhe Linda Kazani (përkatësisht djali i dajës, daja dhe bashkëshortja e dajës së shtetases Ajola Xoxa), kanë vendosur që të themelojnë një qendër joftitimprurëse me emrin "Eventus", përcaktuar kjo edhe në nenin 1 të aktit të themelimit. Në nenin 2 "Selia" është përcaktuar adresa e shoqërisë, rruga "Njazi Demi", Pallatet "1 Maji", shkalla 8, Ap. 50, Tiranë. Në nenin 7 "Bordi i Drejtorëve" të Aktit të Themelimit, përcaktohet se bordi i drejtorëve të qendrës do të përbëhet nga Emil Simixhiu, Erald Simixhiu, dhe Linda Kazani, dhe në nenin 8 "Drejtori Ekzekutiv", përshkruhet se do të jetë Linda Kazani. Kapitali fillestar i qendrës për përmbushjen e qëllimit të saj është 10,000 lekë. Në datë 02.11.2021, është mbajtur Procesverbali i mbledhjes së themeluesve të qendrës Eventus, ku themeluesit shtetasit Emil Simixhiu, Erald Simixhiu, dhe Linda Kazani kanë vendosur që të emërojnë veten e tyre si anëtar të Bordit të Drejtuesve. Ky dokument, është

nënshkruar para noterit, sipas Vërtetim Nënshkrimi të datës 02.11.2021, me Nr. Rep. 3709, notere Mimoza Sadushaj. Në datë 02.11.2021, është mbajtur Procesverbali i mbledhjes së bordit të drejtorëve të qendrës Eventus, ku nga bordi është vendosur që Drejtor ekzekutiv të jetë Linda Kazani, ndërsa Arkëtar Erald Simixhiu. Ky dokument, është nënshkruar para noterit, sipas Vërtetim Nënshkrimit të datës 02.11.2021, me Nr. Rep 3717, notere Mimoza Sadushaj. **Në datë 02.11.2021, shtetasit Emil Simixhiu, Erald Simixhiu, dhe Linda Kazani, kanë lëshuar prokurë të posaçme me Nr. 3705 Rep., Nr. 1783 Kol., notere Mimoza Sadushaj, për shtetasen Xhoi Skënderasi, e cila autorizohet për kryerjen e çdo veprimi për regjistrimin e qendrës Eventus.** Në datë 02.11.2021, është përpiluar kërkesa e cila i drejtohet Gjykatës së Tiranës për regjistrimin e qendrës "Eventus". Përshkruhet se qendra ka Bord Drejtues shtetasit Erald Simixhiu, Linda Kazani dhe Emil Simixhiu. Po kështu, në funksion të kësaj qendre, në kërkesë relatohet se Drejtori ekzekutiv është Linda Kazani ndërsa **arkëtar është Erald Simixhiu.** Qendra do ta ketë selinë në rrugën "Njazi Demi", Pallatet "1 Maji", shkalla 8, Ap. 50, Tiranë. Qëllimi i veprimtarisë së qendrës nuk ka objekt fitimin, por ndjek si qëllim të sajin primar promovimin dhe përhapjen e kulturës dhe artit në çdo formë dhe nëpërmjet të çdo veprimtari, aktiviteti apo nisme në favor të personave që janë të interesuar. Qendra mund të kryejë aktivitete që krijojnë të ardhura sipas ligjit Nr. 8788, datë 07.05.2011 "Për organizatat jofitimprurëse", me qëllim mbledhjen e fondeve të cilat nuk do të shpërndahen si fitime ose që do të destinohen për mbështetjen e aktiviteve. Në pikën 8 (tetë) të kërkesës drejtuar Gjykatës për regjistrimin e qendrës Eventus, autorizohet shtetasja Xhoi Skënderasi, dtl. 08.09.1992, që të kryejë procedurën për regjistrimin e kësaj qendre pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë. Bashkëlidhur kërkesës, përshkruhet se gjendet akti i themelimit, statuti dhe vendimet e bordit. Kërkesa e mësipërme është nënshkruar përpara noteres Mimoza Sadushaj, sipas Vërtetim Nënshkrimit Nr. 3707 Rep., datë 02.11.2021. Rezulton se në datë 05.11.2021, shtetasja Xhoi Skënderasi, e cila ka marrë dhe prokurë të posaçme për regjistrimin e qendrës "Eventus", është paraqitur pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, për të dorëzuar dokumentat e nevojshme për regjistrimin e qendrës. Në lidhje me këtë veprim, ajo ka plotësuar "Formularin e dorëzimit të provave në Gjykatë", ku gjendet emri Xhoi Skënderasi dhe nënshkrimi i saj. **Në datë 05.11.2021, nga Xhoi Skënderasi është plotësuar edhe "Formular për të dhënat e kontaktit", ku në rubrikën "<u>Adresa kryesore e kontaktit" është plotësuar rruga "Ibrahim Rugova", Pallati "Sky Tower", Hyrja 1, Kati 10, Ap 104, Tiranë</u>.** Me vendimin për regjistrimin si person juridik me Nr. 1230 Akti., Nr. 1652 Vendimi, datë 01.12.2021, gjyqtari Ervin Pollozhani ka vendosur regjistrimin e organizatës jofitimprurëse "Eventus", me bord drejtues Erald Simixhiu, Linda Kazani dhe Emil Simixhiu dhe drejtues ekzekutiv Linda Kazani.

65.1. Sipas procesverbalit të këqyrjes së të dhënave të sistemit *Tims*, datë 21.12.2024, evidentohet se në Pikën e Kalimit Kufitar Rinas, seksioni Dalje, në datë 02.11.2021, janë regjistruar shtetasit Emil Simixhiu (13:59), Linda Kazani (13:58) dhe Erald Simixhiu (13:58), të cilët kanë udhëtuar nga Tirana me destinacion Vienë, me linjën Austrian Airlines. **Nga të dhënat e analizuara, evidentohet se këta shtetas kanë udhëtuar në të njëjtën ditë që kanë përgatitur të gjitha dokumentat e sipërpërshkruara, që kanë shërbyer për regjistrimin e qendrës "Eventus".**

65.2. Nga analizimi i deklarimeve në Portalin Qendror për Kontroll dhe Menaxhim (fiskalizimi) rezulton se Qendra "Eventus" ka deklaruar shitjet e mëposhtme:

- **BASHKIA E TIRANES** (Faturë nga Shitësi) (ID: K11729002L)**: <u>10,580,000</u> <u>Lekë</u>**
- **PALUSHI** (Faturë nga Shitësi) (ID: K12202004R): 3,237,300 **Lekë**
- **BANKA AMERIKANE E INVESTIMEVE SHA** (Faturë nga Shitësi) (ID: J91725007P): 2,220,000 Lekë
- **MINISTRIA E KULTURES** (Faturë nga Shitësi) (ID: J91326001G): 900,000 Lekë
- **E - BUSINESS SOLUTIONS** (Faturë nga Shitësi) (ID: L61720027D): 145,500 Lekë

**Total**: **<u>17,082,800 Lekë</u>**

**65.3.** Konstatohet se financimin më të madh kjo qendër e ka nga **Bashkia Tiranë** dhe nga subjekti **<u>Palushi shpk</u>** (faturë e cila dyshohet fiktive bazuar në aktet e këtij procedimi). Gjithashtu evidentohen edhe financime në vlera më të vogla nga Ministria e Kulturës.

**65.4.** Në lidhje me **"Palushi" shpk,** me vendim të prokurorit të datës 22.01.2025 është proceduar me këqyrje/marrjen e dokumenteve pranë Bashkisë Tiranë, Drejtoria e Përgjitshme e Planifikimit dhe Zhvillimit të Terriorit. Në sistemin elektronik të E-Leje rezulton se ky subjekt ka përfituar: ***1)*** Leje ndërtimi miratuar me **vendim nr. A14369/9, datë 05.11.2019,** të nënshkruar nga kryetari i bashkisë Tiranë, Erion Veliaj, **<u>me afat kohor 48 muaj</u>,** për godinë Banimi dhe shërbimi me 8 kat, me 2 kat parkimi nëntokë", ndërtuesi "Palushi" shpk, me NUIS K12202004R. ***2)* Leje ndërtimi nr. Prot. A-19418/8 prot., datë 19.07.2023**, të nënshkruar nga kryetari i bashkisë Tiranë, Erion Veliaj **<u>me afat kohor 60 muaj</u>,** zhvillues dhe ndërtues "Palushi" shpk, me NUIS K12202004R, banesë individuale 2 kat me 1 kat nëntokë dhe mur rrethues; ***3)* Leje ndërtimi nr. Prot. A-16289/8, dt. 04.06.2024, të nënshkruar nga kryetari i bashkisë Tiranë, Erion Veliaj,** <u>**me afat kohor 48 muaj**</u>, ndërtues dhe zhvillues "Palushi" shpk, me NUIS K12202004R, "Godinë banimi dhe shërbimi 4, 5, 6, 7, 8, 9 dhe 10 kat me 2 kat parkim nëntokë". **Në lidhje me këto leje ndërtimi të dhëna nga Bashkia Tiranë, konstatohet se marrëdhënia e subjektit tregtar me këtë të fundit vijon edhe aktualisht (kuptohet që vijonte edhe në vitin 2023), përsa kohë nuk është marrë ende çertifikata e përdorimit të objekteve të ndërtuara. Sipas organit procedues theksohet se çdo leje ndërtimi është objekt kontrolli nga bashkia deri në momentin që për të lëshohet çertifikata e përdorimit.**

**65.4.1. Gjithashtu, nga verifikimet e kryera në sistemin e tatimeve rezulton se gjatë periudhës që marrëdhënia e "Palushi" shpk me Bashkinë Tiranë vijon, ky subjekt tregtar ka financuar dy OJF, konkretisht "Qendra Eventus" me NUIS M12422451B dhe OJF- "BYL-A" me NUIS K41828009Ë, të kontrolluara faktikisht nga shtetësja Ajola Xoxa, me shumën totale prej <u>50.000 euro.</u>** Konkretisht, më datë 06.09.2023 ora 13:34, me numër fature 4, Qendra Eventues i ka faturuar subjektit "Palushi" shpk, shumën **<u>30.000 Euro</u>** me përshkrimin **"Financim festival artistik"**. Po në datë 06.09.2023 ora 13:38, **OJF- "BYL-A"**, me numër fature 23 i ka faturuar shoqërisë "Palushi" shpk, shumën **<u>20.000 Euro</u>** me përshkrimin **"Financim Festival artistik"**.

**65.4.2.** Në lidhje me fiktivitetin e këtyre faturave, **nga** komunikimet mes **shtetases Adela Kondakçiu dhe Albana Koçollari,** të zhvilluara më datë 05.09.2023, konstatohet se kjo e fundit i kërkon Adela Kondakçiut t'i niste faturat që në total bëjnë 50.000 euro.

Paraprakisht kësaj kërkese, **Albana Koçollari** i kërkon Adela Kondakçiut që faturat të lëshohen pa TVSH **nga persona fizikë, pa përcaktuar se cilët duhet të ishin këta persona. Kjo, në mënyrë që "Palushi" shpk mos paguante më tepër sesa kishin rënë dakord**. Por Adela Kondakçiu, në një material *attachment*, i nis Albana Koçollarit dy fatura, të lëshuara jo nga persona fizikë për subjektin "Palushi" shpk, **por nga OJF "BYL-A" dhe OJF "Eventus"**, përkatësisht 20.000 Euro dhe 30.000 Euro, me përshkrimin "Financim Festivali Artistik". **Me interes është fakti se për faturat flitet mes Adela Kondakçiut dhe Albana Koçollarit, dhe jo me përfaqësuesit e "Palushi" sh.p.k, si edhe të dyja faturat me këtë përshkrim lëshohen në të njëjtën datë dhe me të njëjtin përshkrim, pa TVSH, sipas kërkesës së bërë më parë nga shtetasja Albana Koçollari.**

**65.5.** Nga analizimi i deklarimeve të blerjeve në Portalin Qendror për Kontroll dhe Menaxhim (fiskalizimi) rezulton se **qendra "Eventus"** ka deklaruar blerjet e mëposhtme:

- **AVA Studio shpk (Faturë nga Shitësi) (ID: M12212012O): 3,397,774 Lekë**
- **Arts Lab (Faturë nga Shitësi) (ID: M12305006H): 2,570,000 Lekë**
- DECIBEL AUDIO SOLUTIONS (Faturë nga Shitësi) (ID: M11809047H): 1,470,000 Lekë
- Jusiald Xhani PF (Faturë nga Shitësi) (ID: M21724030R): 1,060,000 Lekë
- Kisha Orthodhokse Autoqefale / 2022 FISKALIZIM (Faturë nga Shitësi) (ID: J62221009S): 470,000 Lekë
- Florian Çanga (Faturë nga Shitësi) (ID: M22311023F): 330,000 Lekë
- Divni Gushta (Faturë nga Shitësi) (ID: M16628004I): 271,250 Lekë
- Rajkard Bardhi (Faturë nga Shitësi) (ID: M12406043T): 240,000 Lekë
- Gerta Mamutaj (Faturë nga Shitësi) (ID: M22314007P): 150,000 Lekë
- **Adela Kondakçiu (Faturë nga Shitësi) (ID: M32306039N): 80,000 Lekë**
- E - BUSINESS SOLUTIONS (Faturë nga Shitësi) (ID: L61720027D): 54,309 Lekë
- TRIPIT TRAVEL (Faturë nga Shitësi) (ID: M32120027I): 50,000 Lekë
- Enejda Muzaka (Faturë nga Shitësi) (ID: M11928001G): 30,000 Lekë
- "SUADA" (Faturë nga Shitësi) (ID: L81317451O): 25,200 Lekë
- BNT Electronics (Faturë nga Shitësi) (ID: J61817047D): 14,376 Lekë

**Total: 10,212,909 Lekë**

**65.5.1. Për sa më sipër, konstatohet se pjesa më e madhe e fondeve që kjo qendër ka përfituar (kryesisht nga Bashkia Tiranë) është përdorur për likuidimin e shërbimeve të kryera nga shoqëria "Ava Studio" shpk (në pronësi të shtetases Valbona Xoxa, por kontrolluar nga shtetësja Ajola Xoxa) dhe shoqërisë "Arts Lab" shpk (në pronësi të shtetasit Erald Simixhiu, bashkëshorti i themeluese së kësaj Qendre, por kontrolluar faktikisht nga shtetësja Ajola Xoxa).**

***- Lidhur me veprimet hetimore ndaj subjektit "Arts Lab" shpk.***

**66.** Gjithashtu, nga veprimet hetimore ka rezultuar se "Arts Lab" shpk, me NIPT M12305006H, është një Shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuar (SH.P.K) e themeluar më datë 2

nëntor 2021 me qendër në Tiranë, Shqipëri. Kapitali i saj është me origjinë austriake, ndërsa administrator i shoqërisë është **Erald Simixhiu (daja i shtetases Ajola Xoxa).**

**66.1.** Shoqëria operon në disa fusha kryesore, të cilat përfshijnë botimin, artin dhe kulturën, dhe turizmin, si dhe aktivitete sociale dhe edukative. *Në mënyrë specifike, "Arts Lab" shpk ka një gamë të gjerë aktivitetesh si: ushtrimin e veprimtarive të ndryshme në fushën e botimit, artit dhe kulturës, në fushën sociale dhe në atë edukuese dhe në fushën e turizmit. si më poshtë vijojnë, por pa u kufizuar vetëm në to: 3.1.1. Në fushën e botimit: a) Shtypjen, botimin dhe shpërndarjen e librave të të gjitha llojeve, broshurave, katalogjeve, fletëpalosjeve, materialeve prezantuese, revistave, gazetave, publikimeve periodike apo të përditshme, si dhe të çdolloj produkti tjetër që ka të bëjë me shtypin e shkruar, elektronik, apo çdolloj forme tjetër shkrimi; b)Tregtimin me shumicë ose me pakicë të artikujve të mësipërm, fizikisht por edhe përmes platformave elektronike, importin dhe eksportin e tyre, si dhe zhvillimin e aktiviteteve përfaqësuese apo etj. Kjo shoqëri zotërohet nga shtetasi Erald Simixhiu me 100 % të kuotave. Seli/Zyra Qendrore: Tiranë, Rruga Njazi Demi, Pallatet "1 Maji", Shkalla 18, Ap.50.*

**66.2.** Nga analizimi i deklarimeve në Portalin Qendror për Kontroll dhe Menaxhim (fiskalizimi) rezulton se shoqëria **"Arts Lab" shpk** ka deklaruar shitjet e mëposhtme:

- **RAMETAL (Faturë nga Shitësi) (ID: L41517502C): 5,050,470 Lekë**
- **BYL - A (Faturë nga Shitësi) (ID: K41828009E): 4,354,400 Lekë**
- **JEDAS (Faturë nga Shitësi) (ID: K81806505G): 3,002,670 Lekë**
- **QENDRA "HARABEL" (Faturë nga Shitësi) (ID: L81509451A): 2,897,674 Lekë**
- **QENDRA "EVENTUS" (Faturë nga Shitësi) (ID: M12422451B): 2,570,000 Lekë**
- **(Blank): 1,236,907 Lekë**
- **QENDRA MUZA (Faturë nga Shitësi) (ID: M32415453B): 1,100,000 Lekë**
- **QENDRA ALBANIA COMMUNITY ASSIST, (A C A) (Faturë nga Shitësi) (ID: J91620002Q): 890,000 Lekë**
- **SHOQATA "BASH-ART" (Faturë nga Shitësi) (ID: L61403453L): 800,000 Lekë**
- **KUADR.COM (Faturë nga Shitësi) (ID: L72216039R): 698,285 Lekë**
- Driant Zeneli (Faturë nga Shitësi) (ID: I30425067Q): 500,000 Lekë
- Lind & Venera (Faturë nga Shitësi) (ID: M02110040F): 326,984 Lekë
- Luis Kapllanaj (Faturë nga Shitësi) (ID: I40209017L): 200,000 Lekë
- **SHOQATA "KULTALB" (Faturë nga Shitësi) (ID: M01324451G): 150,000 Lekë**
- SHOQATA SHQIPTARE E MESUESVE TE PIANOS (Faturë nga Shitësi) (ID: M31717452H): 50,000 Lekë
- **Total: 23,827,390 Lekë**

**66.3**. Nga analizimi i deklarimeve të blerjeve në Portalin Qendror për Kontroll dhe Menaxhim (fiskalizimi) rezulton se Qendra "Eventus" ka deklaruar blerjet e mëposhtme:

SPVETJE.AL

- **Partners Laë shpk** (Faturë nga Shitësi) (ID: L81829013O): 747,936 Lekë
- **Media Art Tirana** (Faturë nga Shitësi) (ID: M21815033A): 241,200 Lekë
- **BoldCrest** (Faturë nga Shitësi) (ID: M41714029L): 235,920 Lekë
- **PROSOUND SHPK** (Faturë nga Shitësi) (ID: K62320012O): 216,000 Lekë
- **Adela Kondakçiu** (Faturë nga Shitësi) (ID: M32306039N): 200,000 Lekë
- **PHOENIX + SHPK** (Faturë nga Shitësi) (ID: K31505091L): 33,000 Lekë
- **SKY HOTEL'S** (Faturë nga Shitësi) (ID: L32126014G): 28,408 Lekë
- **BNT Electronics** (Faturë nga Shitësi) (ID: J61817047D): 26,323 Lekë
- **EBG** (Faturë nga Shitësi) (ID: L12121026C): 18,000 Lekë
- **Milsped Albania** (Faturë nga Shitësi) (ID: L32409008B): 0 Lekë
- **Total: <u>1,746,787 Lekë</u>**

**66.4.** Nga aktet rezulton se klientët kryesorë të kësaj shoqërie janë:

1. **Rametal** shpk, shoqëri e cila shfaqet disa herë si blerëse e shërbimeve të lidhura me shtetasen Ajola Xoxa (Partners Laë; Ava Studio; Arts Lab)
2. **Qendra Harabel** (themeluar nga shtetasja Ajola Xoxa)
3. **Byl-A** (dyshuar se kontrollohet nga shtetasja Ajola Xoxa)
4. **Qendra Eventus** (themeluar nga shtetasja Linda kazani bashkëshorte e shtetasit Erald simixhiut) përfituese e fondeve nga Bashkia Tiranë
5. **Qendra Muza** (themeluar nga shtetasja Linda kazani bashkëshorte e shtetasit Erald simixhiut). përfituese e fondeve nga Bashkia Tiranë
6. **SHOQATA "BASH-ART"**, përfituese e fondeve nga Bashkia Tiranë
7. **QENDRA ALBANIA COMMUNITY ASSIST, (A C A)**, përfituese e fondeve nga Bashkia Tiranë
8. **Shoqëria KUADR.COM**, përfituese e fondeve nga Bashkia Tiranë
9. **SHOQATA "KULTALB"**, përfituese e fondeve Bashkia Tiranë
10. **Shoqëria Jedas shpk**, përfituese e leje ndërtimi nga Bashkia Tiranë (dyshuar si faturë fiktive).

***- Lidhur me veprimet hetimore ndaj subjektit "Ava Studio" shpk.***

67. Në lidhje me shoqërinë tjetër të themeluar de jure nga të afërmit e shtetases Ajola Xoxa, rezulton se ajo është emërtuar "Ava Studio" dhe është një Shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuar (SHPK), e regjistruar në Republikën e Shqipërisë me Numrin Unik të Identifikimit të Subjektit (NUIS) M12212012O. Shoqëria u regjistrua më datë 12 tetor 2021 dhe është themeluar më datë 5 tetor 2021. Kohëzgjatja e saj është e pacaktuar, duke filluar nga data e themelimit. **Adresa e selisë qendrore: Tiranë, Shqipëri, Rruga "Brigada VIII", Ndërtesa Nr. 19, Hyrja 5, Kati 10, Apartamenti Nr. 31, Njësia Administrative Nr. 5. Kjo adresë rezulton të jetë e njëjtë me atë të Qendrës "Harabel", në një apartament në pronësi të shtetases Ajola Xoxa.** Kapitali fillestar i shoqërisë është 100,000.00 lekë, i ndarë në një kuotë të vetme me vlerë të barabartë me shumën totale të kapitalit. Shoqëria zotërohet 100% nga shtetasja Valbona Xoxa, e cila ortake e vetme dhe administratores kësaj shoqërie. Shtetësja Valbona Xoxa është nëna e shtetases Ajola Xoxa. Administrator "Ava Studio" shpk rezulton shtetësja Valbona Xoxa, e emëruar për një periudhë pesëvjeçare nga data 05/10/2021

deri më 05/10/2026. Objekti i aktivitetit: *Shoqeria ka per objekt ushtrimin e veprimtarive te ndryshme ne fushen e botimit, artit dhe kultures, ne fushen sociale dhe ne ate edukuese dhe ne fushen e turizmit, si me poshte vijojne, por pa u kufizuar vetem ne to: Ne fushen e botimit: a) Shtypjen, botimin dhe shperndarjen e librave te te gjitha llojeve, broshurave, katalogjeve, fletepalosjeve, materialeve prezantuese, revistave, gazetave, publikimeve periodike apo te perditshme, si dhe te çdo lloj produkti tjeter qe ka te beje me shtypin e shkruar, elektronik, apo çdo lloj forme tjeter shkrimi; b) Tregtimin me shumice ose me pakice te artikujve te mesiperm, fizikisht por edhe permes platformave elektronike, importin dhe eksportin e tyre, si dhe zhvillimin e aktiviteteve perfaqesuese apo promovuese, me apo pa depozite, te artikujve te lartpermendur etj.*

**67.1.** Me qëllim identifikimin e klientëve dhe furnitorëve kryesorë të kësaj shoqërie nga organi procedues janë analizuar librat e shitjes dhe librat e blerjes të deklaruara në organin tatimor. Shoqëria **"Ava Studio"** shpk rezulton se gjatë aktivitetit të saj ka patur këto klient kryesorë të renditur sipas volumit të shitjeve:

- **GOGEL (K91621020U):** 7,468,692 lekë
- **ASLV (L31329009M):** 4,608,000 lekë
- **QENDRA HARABEL (L81509451A):** 3,571,636 lekë
- **RAMETAL (L41517502C):** 3,501,780
- **QENDRA "EVENTUS" (M12422451B):** 3,397,777 lekë
- **Sombrero (L21410040N):** 3,390,300 lekë
- **Klient Cash (blank):** 3,311,893
- **REDCLOUD (L11331001C):** 3,014,646 lekë
- **BYL - A (K41828009Ë):** 2,380,599 lekë
- **Metani Green (M22010020N):** 1,945,200 lekë
- **COPERNICUS (M12430004E):** 1,695,150 lekë
- **SAPIENTIA (L82315006R):** 1,280,880 lekë
- **E-BUSINESS SOLUTIONS (L61720027D):** 1,241,600 lekë
- **Driant Zeneli (I30425067Q):** 600,857 lekë
- **Messier 96 Sh.p.k. (810870940):** 565,050 lekë
- **Elhaida Dani (J35217057U):** 564,401 lekë
- **FROBOLOUS (M22214702R):** 540,000 lekë
- **Boghossian Foundation (BE0888046579):** 319,056 lekë
- **SHOQATA SHQIPTARE E MESUESVE TE PIANOS (M31717452H):** 280,000 lekë
- **Koreja Soc.Coop.Impresa Sociale (01446600759):** 232,760 lekë
- **Jusuf Beshiri (G61217026G):** 100,000 lekë
- **A.SH.T.L. - DITA (K31512096R):** 4,274 lekë
- **N/A (N/A):** 0
- **QENDRA "MUZA" (M32415453B):** 0

**Shuma totale e shitjeve 44,014,551 lekë**

**67.2.** Nga analizimi i deklarimeve në librat e blerjes të shoqërise **"Ava Studio" shpk** rezulton se ka deklaruar blerje nga subjektet e mëposhtme:



SPECIAL

- **Net-A-Porter.com (02050461207): 2,916,882 lekë**
- **Drejtoria e Shërbimeve Qeveritare (J61828071I)**: 1,502,748 lekë
- **Sezon Dekor (L21327005P)**: 870,240 lekë
- **Media Art Tirana (M21815033A)**: 603.000 lekë
- **Shpresa Al Computer (L81325020I)**: 540,00 lekë

67.3. Sa më sipër, konstatohet se kjo shoqëri ka klientë këto kryesorë:

1. **Rametal** shpk, **shoqëri e cila shfaqet disa herë si blerëse e shërbimeve të lidhura me shtetasen Ajola Xoxa (Partners Laë; Ava Studio; Arts Lab)**
2. **SAPIENTIA**, shoqëri e lidhur me shtetasit Elman Abule dhe Marisa Nito
3. **Qendra Harabel** (themeluar nga shtetasja Ajola Xoxa, përfituese e fondeve publike)
4. **Byl-A** (dyshuar se kontrollohet nga shtetasja Ajola Xoxa, përfituese e fondeve nga Bashkia Tiranë)
5. **Qendra Eventus** (themeluar nga shtetasja Linda kazani bashkëshorte e shtetasit Erald Simixhiut) përfituese e fondeve publike nga Bashkia Tiranë)
6. **Qendra Muza** (themeluar nga shtetasja Linda kazani bashkëshorte e shtetasit Erald simixhiut), përfituese e fondeve nga Bashkia Tiranë, <u>faturat janë të anulluara.</u>
7. **OJF FROBOLOUS,** (përfituese e fondeve publike nga Bashkia Tiranë)
8. **Gogel shpk** (në pronësi të shtetasit Arbër Velinj)
9. **ASLV shpk** (përfituese e fondeve publike nga Bashkia Tiranë)

67.4. Në lidhje me shtetasin Elman Abule, nga këqyrja e sistemit tatimor C@ts rezulton se ky shtetas me ID I104290045E / EJ319759, është person **i** lidhur me subjektet sipas tabelës së mëposhtme:

| Emri Personit/Tatimpaguesit te Lidhur | NIPT/SSN Personit/Tatimpaguesit te Lidhur | NIPT | Tatimpaguesi | Roli tek ky Tatimpagues | Vlefshëm Nga | Deri Më |
|---|---|---|---|---|---|---|
| Elman Abule | EJ319759 | L41517502C | RAMETAL | Aksioner Individ i kompanisë | 8/31/2016 | 6/25/2018 |
| Elman Manush Abule | I104290045E | M12122501H | METAL FORM | Administrator | 9/22/2021 | 7/12/2024 |
| Elman Abule | I104290045E | L82212033T | VENTUS | Administrator | 9/29/2021 | 7/12/2024 |
| Elman Abule | I104290045E | M12122501H | METAL FORM | Administrator | 10/14/2024 | |
| Elman Abule | I104290045E | L82212033T | VENTUS | Administrator | 10/14/2024 | |
| Elman Abule | EG 155347 | L01718023B | FIDALBA | Aksioner Individ i kompanisë | 7/1/2015 | 5/9/2024 |
| Elman Abule | I104290045E | L41517502C | RAMETAL | Administrator | 6/30/2020 | 7/12/2024 |
| Elman Abule | I104290045E | L01718023B | FIDALBA | Administrator | 10/14/2024 | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| Elman Abule | I10429045E | L01718023B | FIDALBA | Aksioner Individ i kompanisë | 5/9/2024 | |
| Elman Abule | I10429045E | L41517502C | RAMETAL | Administrator | 10/14/2024 | |
| ELMAN ABULE | | L01718023B | FIDALBA | Administrator | 5/29/2009 | 3/20/2015 |
| Elman Abule | I10429045E | K91729002T | TRITAL | Administrator | 3/30/2022 | 7/12/2024 |
| Elman Abule | I10429045E | K91729002T | TRITAL | Administrator | 10/14/2024 | |
| ELMAN ABULE | | K91729002T | TRITAL | Administrator | 5/29/2009 | 3/21/2015 |
| Elman Abule | EG 155347 | K91729002T | TRITAL | Administrator | 3/21/2015 | 6/28/2018 |
| ELMAN ABULE | | L01908004U | METALE ALBANIA 2014 | Administrator | 5/29/2009 | 3/21/2015 |
| Elman Abule | EG 155347 | K91729002T | TRITAL | Aksioner Individ i kompanisë | 3/21/2015 | 6/28/2018 |
| Elman Abule | I10429045e | L51801502B | ALFEMET | Administrator | 1/11/2023 | |
| Elman Abule | EJ319759 | L51801502B | ALFEMET | Administrator | 6/1/2015 | 3/7/2022 |
| Elman Abule | I10429045E | L51621504T | FERRO CHROME HOLDING | Aksioner Individ i kompanisë | 4/21/2015 | 9/2/2020 |
| Elman Abule | I10429045E | L51621504T | FERRO CHROME HOLDING | Administrator | 4/21/2015 | 7/12/2024 |
| Elman Abule | I10429045E | L51621504T | FERRO CHROME HOLDING | Administrator | 10/14/2024 | |
| Elman Abule | EG 155347 | L01908004U | METALE ALBANIA 2014 | Administrator | 2/5/2016 | 7/12/2024 |
| Elman Abule | I10429045E | L01908004U | METALE ALBANIA 2014 | Administrator | 10/14/2024 | |
| Elman Abule | I10429045E | L01718023B | FIDALBA | Administrator | 5/9/2024 | 7/12/2024 |
| Elman Abule | EG 155347 | L01718023B | FIDALBA | Administrator | 7/1/2015 | 5/9/2024 |

**67.5.** Nga këqyrja e sistemit tatimor C@ts rezulton se shtetasja **Marisa Nito** me ID I10429045E/EJ319759, rezulton si person i lidhur me subjektet sipas tabelës së mëposhtme:

| Emri Personit/Tatimpaguesit te Lidhur | NIPT/SSN Personit/Tatimpaguesit te Lidhur | NIPT | Tatimpaguesi | Roli tek ky Tatimpagues | Vlefshëm Nga | Deri më |
|---|---|---|---|---|---|---|
| Marisa Filip Nito | I25723059K | L82315006R | SAPIENTIA | Administrator | 11/15/2018 | 7/23/2024 |
| Marisa Filip Nito | I25723059K | L64828201C | Chriss | Aksioner Individ i kompanisë | 12/28/2016 | 6/14/2018 |
| Marisa Nito | I25723059K | L82315006R | SAPIENTIA | Administrator | 10/21/2024 | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| Marisa Filip Nito | I25723059K | L82315006R | SAPIENTIA | Aksioner Individ i kompanisë | 11/15/2018 | |
| Marisa Nito | I25723059K | M21912035D | DADA CLEAN | Aplikant/Pronari person fizik | 7/12/2022 | 4/13/2023 |
| Marisa Nito | I25723059K | M21912035D | DADA CLEAN | Aksioner Individ i kompanisë | 7/12/2022 | 6/21/2024 |
| Marisa Nito | I25723059K | M21912035D | DADA CLEAN | Administrator | 7/12/2022 | 6/21/2024 |

67.6. Sa më sipër rezulton se **bashkëshortët Elman Abule dhe Marisa Nito kanë në pronë dhe administrojnë shoqëritë Rametal shpk; Sapientia shpk; Ventus shpk, të cilat janë klientët kryesorë të shoqërive të lidhura me shtetasen Ajola Xoxa dhe familjarë të saj. Gjithashtu, evidentohet se shtetasi Elman Abule zotëron shoqërinë Fidalba me NIPT L01718023B, e cila ka përfituar leje ndërtimi nga Bashkia Tiranë.**

***- Lidhur me veprimet hetimore ndaj subjektit "Gogel" shpk.***

68. Në lidhje me kompaninë **"Gogel" shpk**, rezulton të jetë themeluar më datë 17 prill 2009, me një kapital fillestar prej 9,800,000 Lekë. Aktualisht, kjo shoqëri operon me status aktiv nën administrimin e znj. Riana Muçobega. Aktiviteti kryesor i kompanisë përfshin *marketingun, promovimin dhe organizimin e eventeve, tregtimin e hapësirave mediatike, zhvillimin dhe mirëmbajtjen e sistemeve software, si dhe ofrimin e konsulencave dhe shërbimeve në fushën e mediave dhe teknologjisë.* **"Gogel" shpk është filial i kompanisë** "Gogel Holdings", **në pronësi të shtetasit Arbër Veliaj.**

**68.1.** Nga hetimet rezulton se **klienti kryesor i "Gogel" shpk është "One Albania"**, me një total shitjesh që arrin në **<u>551,639,924 Lekë</u>**, (deri më datë 5 qershor 2024). Nga ana tjetër, nga hetimet evidentohet se kompania "One Albania" ka marrë pjesë në disa procedura prokurimi publik dhe ka arritur të shpallet fituese në disa prej tyre, duke bashkëpunuar kryesisht me <u>*Qeverisjen Vendore Tiranë*</u>, përfshirë këtu tenderin me objekt "*Shërbimi i infrastrukturës së dedikuar optike dhe shërbimeve data*", me një fond limit prej **<u>74,398,398 Lekë</u>**. Për këtë tender, kompania është shpallur fituese më datë 15 tetor 2024, me një vlerë kontraktuese prej **<u>68,774,075 Lekë</u>**. Një tjetër projekt i rëndësishëm ka qenë ofrimi i shërbimeve online për monitorimin e trafikut urban në Bashkinë Tiranë. Ky tender, me një fond limit prej **<u>41,662,726 Lekë</u>**, rezultoi me nënshkrimin e kontratës më 1 nëntor 2024, me një vlerë përfundimtare prej **<u>40,383,527 Lekë</u>**.

***- Lidhur me veprimet hetimore që lidhen me shitjen dhe blerjen e automjeteve.***

69. Në vijim të veprimeve hetimore të kryera, nga DPSHTRR është administruar shkresa "Kthim përgjigje" Nr. 334/1 Prot., datë 28.05.2024, sipas së cilës shtetësja Valbona Xhemil Xoxa, NID: F86008097P, ka patur të regjistruar në DPSHTRR mjetet:

1) Targa TR9037T (AA336AC). Ky mjet është i modelit <u>Mercedes Benz, ngjyrë Blu, model A170, tipi 168, vit prodhimi 1999</u>, me targa TR9037 T. Valbona Xoxa e ka blerë me kontratën Nr. 4406 Rep., dhe Nr. 1378 Kol., datë 03.05.2010, shitësi Ervin Maçi, çmimi i **shitjes 6,500 Euro.** Valbona Xoxa e ka shitur më pas mjetin te Robert Prela, me vlerën e **100,000 lekë,** datë 19.1.2018 (kontrata Nr. 326 Rep., dhe Nr. 135 Kol.).

5PYETJET.AL

2) Targa AA439NX. Mercedes Benz (Daimler Chrysler) B200 CDI, vit prodhimi 2006 blu e hapur. Pronari Driant Zeneli, Hequr nga qarkullimi datë 24.11.2022. Driant Zeneli e ka blerë nga Valbona Xoxa, me kontratën Nr. 322 Rep., dhe Nr. 121 Kol., datë 08.06.2020, për çmimin 6000 Euro. Vetë Valbona Xoxa, e ka blerë këtë mjet nga shtetasi Demir Haxhiu, në shumën 7000 Euro, sipas kontratës Nr. 27 Rep., dhe Nr. 15 Kol., datë 20.01.2016.

3) AA813NF (AB910HZ). **Mercedes Benz E220 CDI, e Zezë, vitprodhimi 2010, Naftë.** Me kontratën Nr. **1538 Rep., dhe Nr. 983 Kol., datë 08.02.2016, Arben Xoxa** ka blerë mjetin për **shumën 7,000 (shtatë mijë euro)**, nga shitësi Arnest Behar Laze. Ky mjet, sipas çertifikatës për lëshimin e dëshmisë së trashëgimisë ligjore (1257 rep., nr. 505 kol, "Vendim për lëshimin e trashëgimisë ligjore", 18 Mars 2019 Notere Mimoza Sadushaj), **ka kaluar në pronësi të Valbona Xoxa dhe Ajola Xoxa**. Me kontratën **Nr. 1359 Rep., dhe Nr. 688 Kol., datë 14.04.2022, Valbona Xoxa dhe Ajola Xoxa** e kanë shitur mjetin kundrejt blerësve Valmir Agron Xoxa dhe Ardita Fatmir Meni.[16] **Këtë mjet, rezulton që shtetaset Valbona Xoxa dhe Ajola Xoxa e kanë shitur kundrejt çmimit prej 23,000 (njëzet e tre mijë) Euro, tek kushëriri i kësaj të fundit, shtetasi Valmir Xoxa. Palët kanë rënë dakord që çmimi i shitjes të kalojë te llogaria e Valbona Xoxa në Intesa San Paolo Bank, me IBAN: AL71208110080000048298635102.** Me kontratën Nr. 3942 Rep., dhe Nr 1826 Kol., vetë Valmir Xoxa dhe Ardita Meni ja kanë shitur mjetin shtetasit Tosun Ramis Qelasi, për çmimin prej 11,500 Euro.

**69.2.** Gjithashtu, nga aktet e administruara në fashikull rezulton se shtetasi **Arbër Veliaj**, figuron si person i lidhur në cilësinë e garantorit ose aksionerit për shoqërinë "Gogel" shpk me NIPT K91621020U dhe "Gogel Holding", me NIPT M31911003I, me "Porsche Leasing". Ky shtetas rezulton të jetë në cilësinë e garantorit në kontratën e qirasë financiare që kompania "Gogel" shpk K91621020U, ka lidhur për automjetet:

1) Audi A1 SportBack Benzin, me targa AA138JI, kontata filluar dt. 23.05.2014 dhe mbyllur Mars 2016. (sipas sistemit të brendshëm të referimit kontrata nr. 00128). Kontratë e Qirasë Financiare LEASING, nr. rep. 5687, nr. kol 1686, dt. 23.05.2014. Çmimi i blerjes së objektit të qirasë: 17,990 Euro; Parapagimi: 5,397 Euro; Shuma e Financuar: 12,593 Euro; Afati i qirasë financiare: 60 muaj. Kësti mujor 253.84 Euro.

2) Volksëagen E-ID 4 Pro, targë AB707FN, kontrata e aktivizuar në 15.09.2021 dhe aktualisht aktive, me datë maturimi 15.9.2026. (sipas sistemit të brendshëm të referimit kontrata nr.03667). Kontratë e Qirasë Financiare Leasing, nr. rep. 7669,

[16] Sipas deklaratës vjetore periodike 2020, po te Valmir Agron Xoxa ka shitur: **i)** Si pasojë e ndarjes së jeta të babait, ka trashëguar prej tij në vitin 2020 pasuri truall 546.12 m2 me ndërtesë 130 m, ZVRPP DR Tirana Veri, nr. 3/173, ZK 8150, Vol 18, fq. 180, pjesë takuese 36/720. Këtë pronë e ka shitur te Valmir (Agron) Xoxa për vlerën e barabartë me 40,000 Euro; **ii)** Si pasojë e ndarjes së jeta të babait, ka trashëguar prej tij në vitin 2020 pasuri truall 369 m2, me ndërtesë 147 m2, ZVRPP DR Tirana Veri, nr. 3/197, ZK 8150, Vol. 20, fq. 117, pjesa takuese 36/720. Këtë pronë e ka shitur te Valmir (Agron) Xoxa për vlerën e barabartë me 20,000 Euro; **iii)** Lekët kanë kaluar në vitin 2021.

nr. kol 2448, dt. 13.09.2021; **Çmimi** i blerjes së objektit të qirasë: 42,000 Euro; Parapagimi: 21,000 Euro. Shuma e Financuar: 21,000 Euro. Afati i qirasë financiare: 60 muaj. Kësti mujor 369.3 Euro.

3) Volksëagen E-ID 3 Pro, me targë AB081CY, aktivizuar dt. 02.04.2021 dhe me datë maturimi 15.05.2026. (sipas sistemit të brendshëm të referimit kontrata nr.03411). Kontratë e Qirasë Financiare LEASING, nr. rep. 2836, nr. kol 825, dt. 30.03.2021. Çmimi i blerjes së objektit të qirasë: 34,000 Euro; Parapagimi: 10,200 Euro. Shuma e Financuar: 12,593 Euro. Afati i qirasë financiare: 60 muaj. Kësti mujor 253.84 Euro.
4) Volksëagen Passat Limousine Highline, me targë AA420TS, e cila është aktivizuar si **kontratë** dt 23.04.2018 dhe është mbyllur në shtator 2021. (sipas sistemit të brëndshëm të referimit kontrata nr. 01630).

**69.3.** Gjithashtu, në cilësinë e aksionerit **100%** të shoqërisë **"Gogel Holdings"** rezulton kontratë aktive për mjetin e markës Volksëagen ID7, me targë TR707TR, kontratë e cila është aktivizuar datë 19.02.2024 dhe maturohet në dt. 15.02.2029. (sipas sistemit të brëndshëm të referimit kontrata nr. 05208).

***- Lidhur me veprimet hetimore të kryera pranë Bashkisë Tiranë.***

**70.** Gjithashtu, në kuadër të hetimeve paraprake, në Bashkinë Tiranë është proceduar me këqyrje/marrjen e praktikave të prokurimeve publike, që i përkasin disa subjekteve tregtare, të cilët rezultojnë të kenë financuar OJF-të dhe Personat Fizikë të kontrolluar efektivisht nga shtetësja Ajola Xoxa. Këtu nuk përfshihen kontratat publike të përfituara prej kompanive të shtetasit Gentian Sula, më lart përmendur.

**70.1.** Konkretisht, me vendim të prokurorit të datës 23.12.2024 është proceduar me këqyrje/marrjen e dokumenteve pranë institucionit të bashkisë, nga kërkimi në evidencat/regjistrat e protokollit të arkivës të të cilit u evidentuan procedurat e prokurimit si më poshtë vijon:

1. Kontratë Sipërmarrje Nr. **4271** Prot., **datë 31.01.2023**, "Rioptimizimi dhe standartizimi i proceseve të punës të strukturës së institucionit të Bashkisë Tiranë", **(Kontraktor "Noa Control" shpk & "Management Systems Certification Doo" shpk), me vlerë totale te kontratës pa TVSH 60.500.000** (gjashtëdhjetë milion e pesëqind pijë) lekë. Nga ana e bashkisë Tiranë, më urdhër-shpenzimi nr. 3753 datë 28.08.2023, **të nënshkruar nga kryetari i Bashkisë Tiranë Erion Veliaj**, i janë kaluar "Noa Control" shpk, **shuma prej 33,000,000 lekë.** Me urdhër-shpenzimi nr. 479 datë 27.02.2024, **të firmosur nga kryetari i Bashkisë Tiranë Erion Veliaj**, i janë kaluar "Noa Control" shpk, **shuma prej 10,890,000 lekë.** Me urdhër shpenzimi nr. 6473 datë 29.12.2023, **të firmosur nga kryetari i Bashkisë Tiranë Erion Veliaj**, i janë kaluar "Noa Control" shpk, **shuma prej 800,000 lekë.** Me urdhër-shpenzimi nr. 6471 datë 29.12.2023, **të firmosur nga kryetari i Bashkisë Tiranë Erion Veliaj**, i janë kaluar "Noa Control" shpk, **shuma prej 25,410,000 lekë.** Me Urdher shpenzimi nr. 480 datë

28.02.2024, **<u>të firmosur nga kryetari i Bashkisë Tiranë Erion Veliaj</u>**, i janë kaluar "Noa Control" shpk, **shuma prej 2,500,000 lekë.**

2. Kontratë Sipërmarrje **Nr. 28111/8 Prot., datë 02.11.2020**, "Sistemi i Lanës, FAZA 1", **(Kontraktor "Gerard-A"), me vlerë totale te kontratës pa TVSH 19,453,542** (nëntëmbëdhjetë milion e katërqind e pesëdhjetë e tre mijë e pesëqind e dyzetë e dy) lekë. Nga ana e bashkisë Tiranë, me urdhër shpenzimi nr. 5272 datë 31.12.2021, **<u>të nënshkruar nga kryetari i Bashkisë Tiranë Erion Veliaj</u>**, i janë kaluar "Gerard-A" shpk, **shuma prej 19,755,951.00 lekë.** Me urdhër-shpenzimi nr. 4079 datë 02.11.2022, **<u>të firmosur nga kryetari i Bashkisë Tiranë Erion Veliaj</u>**, i janë kaluar "Gerard-A" shpk, **shuma prej 2,421,064 lekë.**
3. Me shkresën Nr. 112 Prot., datë **<u>12.04.2021</u>** shoqëria **"Fusha" shpk** ka paraqitur pranë Bashkisë Tiranë kërkesën me objekt: *"Likujdimi garancie punimesh"*, që rrjedhinin nga zbatimi i punimeve në objektin "Rikualifikimi Urban i Sheshit Skënderbej, Faza-e-II-të", në vlerën **11, 738, 772 lekë.** Nga ana e bashkisë Tiranë më urdhër- shpenzimi nr. **1793 datë 07.06.2021**, **<u>të nënshkruar nga kryetari i bashkisë Tiranë Erion Veliaj</u>** i janë kaluar "Fusha" shpk, **shuma 11, 738, 772 lekë.**
4. Kontratë **Nr. 11087/1 Prot., datë 12.03.2021**, *Shërbimi i Pastrimit të Tiranës" Loti IV "Shërbimi i Pastrimit të Zonës Tirana IV"*, **(Kontraktor "Fusha" shpk) me vlerë totale te kontratës pa tvsh 287, 216, 290/95** (dyqind e tetëdhjetë e shtatë milion e dyqind e gjashtëdhjetë mijë e dyqind e nëntëdhjetë pikë nëndhjetë e pesë) lekë. **<u>Kjo kontratë është nënshkruar nga kryetari i bashkisë Tiranë Erion Veliaj, dhe shoqërisë "Fusha" shpk.</u>**
5. Marrëveshje Kuadër **Nr. 7476/7 Prot., datë 10.03.2021** me objekt: "Shërbimi i Pastrimit të Tiranës" Loti IV "Shërbimi i Pastrimit të Zonës Tirana IV", të lidhur midis Bashkisë Tiranë **<u>të nënshkruar nga kryetari i bashkisë Tiranë Erion Veliaj, dhe shoqërisë "Fusha" shpk.</u>**
6. Me shkresën Nr. 204 Prot., datë **<u>09.11.2020</u>** shoqëria **"Fusha" shpk** ka paraqitur pranë Bashkisë Tiranë kërkesën me objekt: *"Likujdimi garancie punimesh"*, që rrjedhinin nga zbatimi i punimeve në objektin "Rikualifikimi Urban i Sheshit Skënderbej, Faza e II-të", në vlerën **58, 732, 731 lekë.** Nga ana e bashkisë Tiranë më urdhër- shpenzimi nr. **4195 datë 31.12.2020**, **<u>të nënshkruar nga kryetari i bashkisë Tiranë Erion Veliaj</u>** i janë kaluar "Fusha" shpk, **shuma 58, 732, 731 lekë.**
7. Kontratë Sipërmarrje **Nr. 11233/6 Prot., datë 19.04.2018**, **"Shtesë kontrate** sipërmarrje, Shtesë kontrate për objektin "Ndërtim parkim nëntokësor, sheshi Skënderbej"; **(Kontraktor "Fusha" shpk) me vlerë totale te kontratës pa tvsh 44,543,018** (dyzet e katër milion e pesëqind e dyzet e tre mijë e tetëmbëdhjetë ) lekë. Nga ana e bashkisë Tiranë më urdhër- shpenzimi nr. 1246 datë 11.04.2019, **<u>të nënshkruar nga kryetari i bashksië Tiranë Erion Veliaj</u>** i janë kaluar "Fusha" shpk, **shuma 50,779,040 lekë.** Me urdhër-shpenzimi **nr.** 402 datë 18.02.2022, **<u>të firmosur nga kryetari bashkisë Tiranë Erion Veliaj</u>** i janë kaluar "Fusha" shpk, **shuma 2,672,581. Lekë.**



SPECIAL

8. Kontrata **Nr. 47392/6 Prot., datë 27.12.2018, Shtesë kontratë** sipërmarrje objekti "Shtesë kontrate për objektin "Rikualifikimi Urban i Sheshit Skenderbej, Faza e I-rë"; **(Kontraktor "Fusha" shpk, me vlerë totale pa tvsh** 105, **331,520.83** (njëqind e pesë milion e treqind e tridhjetë e një mijë e pesëqind e njëzet pikë tetëdhjetë e tre) lekë. Nga ana e bashkisë Tiranë më urdhër shpenzimi nr. 2925, datë 19.08.2019, **<u>të nënshkruar nga kryetari bashkisë Tiranë Erion</u>** **<u>Veliaj</u>**, i janë kaluar "Fusha" shpk, shuma **30,000,000** lekë. Me urdhër-shpenzimi nr.3314 datë 25.09.2019, **<u>të firmosur nga kryetari i bashkisë Tiranë Erion</u>** **<u>Veliaj</u>** i janë kaluar "Fusha" shpk, **shuma 20,000,000 lekë.** Me urdhër-shpenzimi nr.3600 datë 08.10.2019, **<u>të firmosur nga kryetari i bashkisë Tiranë Erion</u>** **<u>Veliaj</u>** i janë kaluar "Fusha" shpk, **shuma 13,201,134 lekë.** Me urdhër-shpenzimi nr. 1792 datë 07.06.2021, **<u>të firmosur nga kryetari i bashkisë Tiranë Erion</u>** **<u>Veliaj</u>** i janë kaluar **"Fusha"** shpk, **shuma 6,319,891 lekë.** Me urdhër-shpenzimi nr.496 datë 19.02.2020, **<u>të firmosur nga kryetari i bashkisë Tiranë Erion</u>** **<u>Veliaj</u>** i janë kaluar "Fusha" shpk, **shuma 31,598,346 lekë.**

9. Kontrata nr. **626/4, dt. 08.3.2017**, kontratë sipërmarrje "Rikualifikimi Urban i Sheshit Skënderbej. Faza e II-të **(Kontraktor "Fusha" shpk, me vlerë totale me tvsh 1, 174, 654, 654.54** (një miliard e njëqind e shtatëdhjetë e katër milion e gjashtëqind e pesëdhjetë e katër mijë e gjashtëqind e pesëdhjetë e katër pikë pesëdhjetë e katër) lekë.

10. Kontrata nr. **20575/6, dt. 06.9.2016**, kontratë sipërmarrje "Rikualifikimi Urban i Sheshit Skënderbej, Faza e I-rë **(Kontraktor "Fusha" shpk, me vlerë totale pa tvsh** 527,535,937.5 (pesëqind e njëzet e shtatë milion e pesëqind e tridhjete e pesëmijë e nëntëqind e tridhjetë e shtatë pikë pesë). Nga ana e bashkisë Tiranë, më Urdhër shpenzimi nr. 1626, datë 17.05.2018, **<u>të nënshkruar nga kryetari</u>** **<u>bashkisë Tiranë Erion Veliaj</u>**, i janë kaluar "Fusha" shpk, shuma **186,284,337** lekë. Me urdhër-shpenzimi nr. 3436 datë 26.12.2017, **<u>të firmosur nga kryetari i</u>** **<u>bashkisë Tiranë Erion Veliaj</u>** i janë kaluar "Fusha" shpk, **shuma 297,350,993** **lekë.**

**70.2.** Gjithashtu, me vendim të prokurorit të datës 23.12.2024 është proceduar me këqyrje/marrjen e dokumenteve pranë Bashkisë Tiranë, Drejtoria e Përgjithshme e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit, në sistemin elektronik të *E-Leje*, në lidhje me Lejet e Ndërtimit të dhëna nga Bashkia Tiranë. Nga dokumentacioni i administruar ka rezultuar se nga ky institucion janë miratuar leje ndërtimi për disa firma, të cilat nga ana e tyre kanë kaluar shuma të hollash në favor të subjekteve tregtarë të kontrolluara nga shtetësja Ajola Xoxa. Konkretisht disa prej tyre janë listuar sa vijon:

1) **Leje ndërtimi e miratuar me vendim Nr. S-16100/7, <u>të nënshkruar nga kryetari i</u>** **<u>Bashkisë Tiranë, Erion Veliaj</u>**, për **"Hoteleri studentore 2 dhe 3 kat me mur rrethues", në Sauk**, Njësia Administrative Farkë, Tiranë, me pronar dhe zhvillues Fatmir Gjeçi, Hamide Gjeçi dhe Klodjan Gjeçi, dhe subjekt ndërtues shoqëria **"Gerard-A" sh.p.k., me administrator <u>Sokol Kryeziu</u>, viti 2019.**

2) **Leje ndërtimi e miratuar me vendim Nr. S-11181/6 <u>të nënshkruar nga kryetari i</u>** **<u>Bashkisë Tiranë, Erion Veliaj</u> për "Godinë hotelerie studentore 2 kat me 2 kat**

SPYETUET.AL

pjesërisht nëntokë dhe 2 kat nëntokë dhe mur rrethues", në Sauk, Njësia Administrative Farkë, Tiranë, në pronë të shoqërisë **"Gerard-A"** sh.p.k., me zhvillues dhe subjekt ndërtues shoqërinë **"Gerard-A" sh.p.k." me administrator <u>Sokol Kryeziu</u>, viti 2023.**

3) **Leje ndërtimi e miratuar me vendim Nr. S-5746/5, <u>të nënshkruar nga kryetari i Bashkisë Tiranë, Erion Veliaj</u> për "Kompleks banimi 3 kat me 1 dhe 2** kat parkim nëntokë me mure rrethuese", Njësia Administrative Farkë, Tiranë, në pronë të Shkëlqim Fusha, me zhvillues dhe subjekt ndërtues shoqërinë **"Fusha" sh.p.k. me administrator <u>Shkëlqim Fusha</u>, viti 2019.**
4) **Leje ndërtimi e miratuar me vendim Nr. S-7627/6, <u>të nënshkruar nga kryetari i Bashkisë Tiranë</u>, për "Kompleks vila banimi 1, 2 dhe 3 kat, me 1 kat nëntokë** dhe mur rrethues", të ndodhur në Farkë e Vogël, Njësia Administrative Farkë, në pronë të Shkëlqim Fusha, me zhvillues dhe subjekt ndërtues shoqërinë **"Fusha" sh.p.k." me administrator <u>Shkëlqim Fusha</u>, viti 2021.**
5) **Leje ndërtimi e miratuar me vendim Nr. S-7522/5,** "Rishikim i kushteve të lejes dhe ndryshim të projektit gjatë ndërtimit, për objektin miratuar me Vendimin **Nr. S-7627/6, datë 10.11.2021 ("Fusha"** shpk), **<u>të nënshkruar nga kryetari i Bashkisë Tiranë, Erion Veliaj</u>.**
6) **Leje ndërtimi e miratuar me vendim Nr. E-24253/6, <u>të kryetarit të bashkisë Tiranë, Erion Veliaj</u>, për "Godinë banimi dhe shërbimi 5 dhe 7 kat dhe 2 kat** parkim nëntokë", të ndodhur në rrugën "Sabaudin Gabrani", Njësia administrative Nr. 6, Tiranë, në pronë të z. Keid Kalaja dhe z. Brugen Strati, me zhvillues dhe subjekt ndërtues shoqëria **"Fidalba" sh.p.k. me administrator <u>Elman Abule</u>, viti 2024.**

***- Në lidhje me shoqërinë "Gerard – A" shpk***

**71.** Sipas organit procedues në lidhje me shoqërinë **"Gerard – A" Shpk**, me NIPT L12407005L, kanë rezultuar disa të dhëna me interes për hetimin. Kjo shoqëri rezulton se është regjistruar fillimisht në organin tatimor në datën 31.11.2011, nga shtetasi Altin Kumara, ne objekt aktiviteti; *Import - eksport brenda dhe jashtë vendit. Transport publik, Transport urban,* me adresë; *Rruga "Ded Gjo Luli", me pasurinë e paluajtshme nr.6/901, Zona Kadastrale 8350,vol.38, faqe 211,* me kapital fillestar 33.400.000 lekë.

**71.1. Në datën 07.04.2021, pranë QKB-së është bërë Depozitimi i vendimit të ortakut të vetëm, datë 01.04.2021, ku është vendosur: Miratimi i transferimit nëpërmjet kontratës së shitjes se kuotave me Nr. 1422 Rep., Nr. 398 Kol., datë 02.04.2021, nga shtetasi Altin Kumara në favor të shtetasit** ***Sokol Kryeziu.*** Nga analizimi i historikut të punësimit në sistemin informatikë tatimor C@TS rezulton si më poshtë vijon:

| NIPT | SUBJEKTI | NR PERSONAL | EMËR | MBIEMËR | DATA E PUNESIMIT | DATA E LARGIMIT | PUNESIMI |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| L12407005L | GERARD - A | I70806002Q | Sokol | Kryeziu | 03/01/2014 | 31/12/2015 | Kontrollor sherbim transporti |
| L38725101G | Alb Tech Plast | I70806002Q | Sokol | Kryeziu | 16/03/2016 | 25/03/2016 | Punëtor ngarkim-shkarkimi mbetjesh urbane |
| L38725101G | Alb Tech Plast | I70806002Q | Sokol | Kryeziu | 29/03/2016 | 12/08/2016 | Punëtor ngarkim-shkarkimi mbetjesh urbane |
| K51725020Q | DREJTORIA E PËRGJITHSHME E PASTRIMIT, GJELBËRIMIT | I70806002Q | Sokol | Kryeziu | 21/10/2017 | 26/02/2018 | Fshesar |

| | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| L91924024I | Green Line | I70806002Q | Sokol | Kryeziu | 30/09/2020 | 31/12/2021 | Drejtor |
| L12407005L | GERARD - A | I70806002Q | Sokol | Kryeziu | 06/01/2016 | | Fatorino |

**71.2. Vihet re se shtetasi Sokol Kryeziu ka punuar më parë si *fatorino* në shoqërinë "Gerard-A" nga viti 2016. Më ky shtetas ka punuar si *kontrollor* deri në momentin që ka blerë shoqërinë. Sipas kontratës së shitjes shoqëria është blerë për shumën 33.4 mln lekë, vlerë e cila do paguhej me këste për gjashtë vjet. Gjithashtu, i njëjti shtetas rezulton se në periudhën 21.10.2017 deri në 26.02.2018, ka punuar si *punëtor fshesar* në Drejtorinë e Përgjithshme të Pastrim Gjelbërimit, dhe në vijim si *ngarkim-shkarkimi mbetjesh* në shoqërinë Alb Tech Plast. Më pas, ky shtetas rezulton të ketë punuar si *drejtor* me pagë 50,000 lekë në shoqërinë Green Line.**

**71.3. <u>Nga verifikimi në burime të hapura rezulton se shoqëria "Gerard–A" shpk me NIPT L12407005L në periudhën 2018-2023 ka fituar rreth 20 procedura me autoritet kontraktor UKT, Drejtoria e Pastrimit dhe Gjelbërimit apo Drejtoria nr. 2 e Punëtorëve të Qytetit. Me Drejtorinë e Pastrimit dhe Gjelbërimit, e cila gjatë periudhës është drejtuar nga Arlinda Binjaku, shoqëria "Gerard-A" ka fituar 13 procedura prokurimi.</u>**

**71.4. Nga analizimi i librave të shitjes të shoqërisë të deklaruara në organin tatimor, rezulton se shoqëria "Gerard – A" Shpk, me NIPT L12407005L, ka marrëdhënie tregtare me entet publike. Nga totali i deklaruar, shitjet me burim nga realizimi i kontratave me ente publike janë në vlerën <u>600,076,636 lekë me TVSh,</u> të cilat janë rezultat i procedurave të prokurimit që janë fituar nga shoqëria me entet në varësi të Bashkisë së Tiranës.**

71.5. Gjithashtu, rezulton se, për periudhën <u>11.12.2023 deri në 27.12.2023</u>, shoqëria "Gerard – A" Shpk, me NIPT L12407005L, e cila është në pronësi të shtetasit Sokol Kryeziu, ka faturuar Drejtorinë e Përgjithshme të Pastrimit, Gjelbërimit, si dhe Bashkinë e Tiranës në vlerën <u>10,627,522 lekë</u> me TVSh. Më konkretisht më datën 22/12/2023, me faturën tatimore të shitjes me numër serial 7faf11eae24eeb5ec54732867573c8fe, lëshuar për Drejtorinë e Përgjithshme e Pastrimit dhe Gjelbërimit, në vlerën 2,000,621 lekë. Në datën 27/12/2023, me faturën tatimore të shitjes me numër serial 9189ed8b4205070f1b43d34121c0c092, lëshuar për Drejtorinë e Përgjithshme e Pastrimit dhe Gjelbërimit, në vlerën 3,678,000 lek. Po ashtu, në datën 22/12/2023, është lëshuar fatura tatimore e shitjes me faturën me numër serial 649a31ea2c1408ced802edfa2e216824, për Drejtorinë e Përgjithshme e Pastrimit dhe Gjelbërimit, në shumën 2,517,000 lekë. Më datë 11/12/2023, është lëshuar fatura tatimore e shitjes me numër serial 204bbd16121c713af33c77c334a9da2a, në vlerën 431,280 lekë për Bashkinë e Tiranës. Më datën 22/12/2023, me faturën tatimore të shitjes me numër serial 85809bceebdf521a4a164a9dae3c5969,lëshuar për Drejtorinë e Përgjithshme të Pastrimit dhe Gjelbërimit, në shumën 2,000,621 lekë. Përpos shitjes, subjekti tregtar Gerard-A Shpk ka deklaruar në mënyrë të vazhdueshme fatura tatimore nga subjekte të ndryshme, nga të cilat blen materiale apo merr shërbime që janë në funksion të aktivitetit të saj.

**71.6. Nga ana tjetër, gjatë periudhës Dhjetor 2023 dhe Janar 2024, pronari i saj dhe administratori i shoqërisë Sokol Kryeziu, provohet të ketë blerë disa piktura nga shoqëria "NAN Gallery" shpk, me NIPT M31920013O, me administratore shtetasen Daniela Vuksani, shoqëri kjo e kontrolluar faktikisht nga shtetësja Ajola Xoxa dhe zotëruar ligjërisht nga "Harabel" OJF. Vlera totale e pikturave të blera është në**

shumën **<u>5, 037, 064 lekë</u>. Shitja e tyre evidentohet e deklaruar në librat e shitjes të shoqërisë Nan Gallery Shpk, në datën 28.12.2023 në vlerën <u>2,176,230 lekë me tvsh</u>, me numër fature 10/2023, me adresë "Spanjë", me blerës Sokol Kryeziu me numër personal I70806002Q, dhe faturën tjetër të datës 08.01.2024, në vlerën <u>2,860,834 lekë</u> me tvsh, me numër 1/2024, me adresë "Spanjë", me blerës Sokol Kryeziu me numër personal I70806002Q.**

*- Në lidhje me subjektin "Kontakt" shpk*

72. Gjithashtu, nga sistemi *C@ts* që administrohet nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, në rubrikën "Dokumenta" është i ngarkuar Raporti i Kontrollit i mbajtur nga Inspektorët e Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, për **subjektin "Kontakt" shpk,** më administrator shtetasin **Fatmir Bektashi**. Nga këqyrja e dokumentuar me procesverbalin përkatës, rezulton se ky subjekt tregtar ka deklaruar lejet e ndërtimit të siguruara nga Bashkia Tiranë, sipas tabelës sa vijon:

| Nr | Objektet | Nr. i lejes së ndërtimit | Afat fillimi Leje ndërtimi | Afat përfundimi Leje ndërtimi | Investitori | Ndërtuesi |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 1 | Kontakt Shpk Marga 1/ "Godinë banimi dhe shërbimi 6, 8, 9 dhe 11 kat dhe 1 kat parkim nëntokë Jordan Misja te burgu | Nr. B-6729/6, datë 09.08.2020 | 27.09.2020 | 27.09.2024 | Kontakt | Kontakt |
| 2 | Kontakt Shpk Marga 2/ "Godinë banimi dhe shërbimi 9 kat me 1 kat parkim nëntokë, në pronë të shoqërisë "KONTAKT" sh.p.k" Rruga Petrela | Nr. A-14429/6, datë 06.10.2021 | 10.11.2021 | 10.11.2025 | Kontakt | Kontakt |
| 3 | Kontakt Shpk USL/ "Godinë banimi 5, 7, 10 dhe 11 kat me 2 kat parkim nëntokë dhe godinë banimi 7, 9, 10 dhe 11 kat me 2 kat parkim nëntokë si dhe kopësht 2 rr Frosina Plaku kat me mur rrethues, | Nr. A-26619/7, datë 27.02.2020 | 09.03.2020 | 09.03.2024 | Kontakt | Kontakt |
| 4 | Kontakt Shpk Siri 2/ "Godinë banimi dhe shërbimi 6, 7 dhe 10 kat, me 1 kat parkim nëntokë" në pronë të shoqërisë "KONTAKT" sh.p.k. rruga Ramazan Bogdani | Nr. B-14994/6, datë 30.11.2021. | 20.12.2021 | 20.12.2025 | Kontakt | Kontakt |
| 5 | Kontakt Shpk Mangalem 21/ Kompleksi Mangalem 21, me struktura banimi dhe sherbimesh 3+9 kat, me 1,2 kat parkim nentoke, ne prone te familjes Kadiu rruga Mihal Grameno. | Nr. A-25138/7, date 14.12.2018 | 21.12.2018 | 21.02.2029 | Kontakt | Kontakt |

| | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 6 | Kontakt Shpk Kaimi/ "Kompleks me godina banimi 7 kat me 1 kat parkim nëntokë, në pronë të Astrit Kaimi, Silvana Shima, Jetmira Kaimi, "rruga Pasho Hysa" | Nr. B-18629/4, datë 05.10.2022 | 11.11.2022 | 11.11.2032 | Kontakt | Kontakt |

- ***Lidhur me pagesat që kanë marrë subjektet Qëndra "Muza", OJF "Frobolous", OJF "Byl-A", Qendra "ACA", Shoqata "Bash-Art" nga Bashkia Tiranë.***

73. Me procesverbalin e datës 26.12.2024, në zbatim të vendimit të prokurorit, është këqyrur dhe marrë pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Menaxhimit Financiar, Bashkia Tiranë, dokumentacioni lidhur me pagesat që kanë marrë subjektet *Qëndra "Muza", OJF "Frobolous", OJF "Byl-A", Qendra "ACA", Shoqata "Bash-Art"*, për periudhën 2015-2024. Këtu nuk përfshihet Qendra "Eventus", e financuar dhe kjo nga Bashkia Tiranë, të dhënat e së cilës janë administruar nga Dega e Thesarit dhe janë bërë pjesë e fashikullit penal. Më lart në këtë vendim, janë përshkruar hollësisht shitjet e kësaj qendre të nxjerra nga sistemet tatimore i fiskalizimit.

73.1. **Nga këqyrja, ka rezultuar se subjektet Qëndra "Muza", OJF "Frobolous", OJF "Byl-A", Qendra "ACA", Shoqata "Bash-Art", kanë marrë nga Bashkia Tiranë pagesa në formë financimesh për projekte të propozuara prej tyre.** Procedura e aplikimit në secilin rast përfshin aplikimin nga subjekti, preventivin e propozuar, vendimin përkatës të Këshillit Artistiko Kulturor të Bashkisë Tiranë për miratimin e projektit përkatës, **urdhrin nga kryetari i Bashkisë për mbështetjen financiare për projektin,** akt-marrveshjen përkatëse lidhur midis Bashkisë dhe subjektit, si dhe dokummentacionin tjetër justifikues lidhur me shpenzimet e planifikuara dhe të kryera nga subjekti për projektin (aktmarrëveshje me personat e angazhuar/subjektet, ID, QKB, Bordero,etj).

73.2. Pagesat e evidentuara kundrejt subjekteve Qëndra "Muza", OJF "Frobolous", OJF "Byl-A", Qendra "ACA", Shoqata "Bash-Art" janë si më poshtë vijon:

1) **Qëndra "Muza" 1 pagesë.** Vlera **1,620,248.00 Lekë,** Event Muzikor "Baroques meets Jazz" dt. 10 Maj 2024, sipas Urdhër Shpenzimit dt. 21.06.2024, nr. 2562, **të nënshkruar nga Kryetari i Bashkisë Erion Veliaj.**
2) **OJF "Frobolous" 1 pagesë:** Vlera **2,970,000.00 Lekë, Projekti** Artistiko-Kulturor "Tiranas's Fashion Night", dt. 11 Nëntor 2023, sipas Urdhër Shpenzimit dt. 29.12.2023, nr. 6369, **të nënshkruar nga Kryetari i Bashkisë Erion Veliaj.**
3) **OJF "Byl-A" 1 pagesë:** Vlera **5,000,000.00 Lek,** Projekti Artistiko-Kulturor "Sonoma" nga La Veronal, 5-6 Tetor 2023, sipas Urdhër Shpenzimit dt. 25.11.2023, nr. 5511, **të nënshkruar nga Kryetari i Bashkisë Erion Veliaj.**

**Qëndra "Albania Community Assist" 8 pagesa:**

1) **Vlera 1,040,100.00 Lek,** Projekti Artistiko-Kulturor "Festivali Teatror i Shkollave të Mesme në Tiranë 2018", sipas Urdhër shpenzimit dt. 30.05.2018, nr. 1786, **nënshkruar nga Kryetari i Bashkisë /Urdhëruesi Erion Veliaj.**

2) **Vlera 1,329,200.00 Lekë**, Projekti Artistiko-Kulturor " Zërat e Jetës", Tiranë 2024 nga "Kori i Tiranës", sipas Urdhër shpenzimit dt. 25.03.2024, nr. 870, **nënshkruar nga Kryetari i Bashkisë /Urdhëruesi Erion Veliaj.**
3) **Vlera 764,500.00 Lekë**, Projekti Festivali Teatror i Shkollave të Mesme në Tiranë 2017", sipas Urdhër shpenzimit dt. 26.05.2017, nr. 1245, **nënshkruar nga Kryetari i Bashkisë /Urdhëruesi Erion Veliaj.**
4) **Vlera 2,140,000.00 Lekë**, Projekti Artistiko-Kulturor "Shfaqje Teatrale Komedia Madërgona", 30-31 Korrik 2022, sipas Urdhër shpenzimit dt. 29.09.2022, nr. 3738, **nënshkruar nga Kryetari i Bashkisë /Urdhëruesi Erion Veliaj.**
5) **Vlera 3,060,000.00** Lek, Projekti Artistiko-Kulturor Koncet "Me zemër në amfiteatër", 14 Shtator 2023, sipas Urdhër shpenzimit dt. 17.10.2023, nr. 4743, **nënshkruar nga Kryetari i Bashkisë /Urdhëruesi Erion Veliaj.**
6) **Vlera 2,568,500.00 Lekë**, Projekti Artistiko-Kulturor Koncert "Me Zemër" 11 Tetor 2022, sipas Urdhër shpenzimit dt. 05.12.2022, nr. 4754, **nënshkruar nga Kryetari i Bashkisë/Urdhëruesi Erion Veliaj.**
7) **Vlera 2,125,000.00 Lekë**, Projekti Artistiko-Kulturor Komedi "Hap pas hapi" 20-22 Qershor 2024, sipas Urdhër shpenzimit dt. 09.07.2024, nr. 2804, **nënshkruar nga Kryetari i Bashkisë/Urdhëruesi Erion Veliaj.**
8) **Vlera 370,000.00 Lekë**, Projekti Artistiko-Kulturor "Teatri i Rrugës në Tiranë" 10.10.2016, sipas Urdhër shpenzimit dt. 27.12.2016, nr. 2363, **nënshkruar nga Kryetari i Bashkisë/Urdhëruesi Erion Veliaj.**

**Shoqata "Bash-Art" 9 Pagesa:**

1) **Vlera 4,798,250.00 Lekë**, Projekti "Festivali "Fem Fest 2", 4-8 Mars 2023, sipas Urdhër shpenzimit dt. 03.05.2023, nr. 1545, **nënshkruar nga Kryetari i Bashkisë /Urdhëruesi Erion Veliaj.**
2) **Vlera 4,387,250.00 Lekë**, Projekti Festivali "Fem Fest", 4-8 Mars 2024, sipas Urdhër shpenzimit dt. 08.05.2024, nr. 1142, **nënshkruar nga Kryetari i Bashkisë/Urdhëruesi Erion Veliaj.**
3) **Vlera 1,892,000.00 Lekë**, Projekti "Pesë fytyrat e heshtjes", 18-19 Nëntor 2024, sipas Urdhër Shpenzimit dt. 10.12.2024, nr. 5839, **nënshkruar nga Kryetari i Bashkisë/Urdhëruesi Erion Veliaj.**
4) **Vlera 4,512,500.00 Lekë**, Projekti "Jesus Christ Superstar" 28-30 Dhjetor 2022, sipas Urdhër shpenzimit dt. 30.12.2022, nr. 5910, **nënshkruar nga Kryetari i Bashkisë/Urdhëruesi Erion Veliaj.**
5) **Vlera 4,290,000.00 Lekë**, projekti "Jesus Christ Superstar", 28-30 Dhjetor 2023, sipas Urdhër shpenzimit dt. 02.02.2024, nr. 144, **nënshkruar nga Kryetari i Bashkisë/Urdhëruesi Erion Veliaj.**
6) **Vlera 1,862,00.00 Lekë**, projekti Koncert "Punishtja e Elfëve Kids Fest", 21-24 Dhjetor 2021, sipas Urdhër shpenzimit dt. 08.02.2022, nr. 138, **nënshkruar nga Kryetari i Bashkisë/Urdhëruesi Erion Veliaj.**

7) **Vlera 4,008,500.00 Lekë**, projekti festival "FEM-FEST, 5-8 Mars 2022, sipas Urdhër shpenzimit dt. 20.04.2022, nr. 1298, **nënshkruar nga Kryetari i Bashkisë/Urdhëruesi Erion Veliaj.**

8) **Vlera 2,167,500.00 Lekë**, projekti "Made in Albania", 15.04.2016, sipas Urdhër Shpenzimit dt. 20.05.2016, nr. 615, **nënshkruar nga Kryetari i Bashkisë /Urdhëruesi Erion Veliaj.**

9) **Vlera 4,205,000.00 Lekë**, projekti "Vizita e Inspektorit", 18.05.2019-4.06.2019, sipas Urdhër Shpenzimit dt. 12.06.2019, nr. 2092, **nënshkruar nga Kryetari i Bashkisë/Urdhëruesi Erion Veliaj.**

**73.3.** Më pas, nga këqyrja e dokumentacionit të pagesave më sipër, rezulton se fondet e financuara nga Bashkia Tiranë janë shpenzuar për secilin projekt si më poshtë:

**1. Qendra "Muza", NIPT: M32415453B,** ka marrë pagesën nga Bashkia Tiranë sipas **Urdhër shpenzimi nr. 2562, dt. 21.06.2024, vlera 1,620,248 Lekë, të nënshkruar nga Kryetari i Bashkisë Tiranë, Erion Veliaj. Event Muzikor "Baroques meets Jazz".** Buxheti/propozimi për financim dhe kontraktimi i zërave financuar nga bashkia Tiranë:

| Nr. | Përshkrimi | Njësia | Sasia | Çmimi/Lekë | Shuma/Lekë |
|---|---|---|---|---|---|
| 1 | Ansambli i instumentisteve | shërbim | 1 | 600,000 | 600,000 |
| 2 | Kengetare | person | 1 | 120,000 | 120,000 |
| 3 | Trompist | person | 1 | 30,000 | 30,000 |
| 4 | Bandi Jazz | shërbim | 1 | 500,000 | 500,000 |
| 5 | Qeraja e salles | shërbim | 1 | 332,748 | 332,748 |
| 6 | Printime | shërbim | 1 | 60,000 | 60,000 |
| | Totali | | | | 1,642,748 |

**Shpenzimet e kryera:**

- *Vlera **600,000** Lek sipas **Faturë elektronike nr. 7/2024, dt. 10.05.2024, nga Arts Lab**, blerësi MUZA, përshkrimi "Ansambli i instrumentistëve", shoqëruar me aktmarrëveshjen përkatëse lidhur mes palëve dt. 02.05.2024, si dhe Ekstrakt QKB i Arts Lab.*
- *Vlera **500,000 Lek**, sipas **Faturë elektronike nr. 8/2024, dt. 10.05.2024, nga Arts Lab**, blerësi MUZA, përshkrimi "Bandi Jazz", shoqëruar me aktmarrëveshjen përkatëse lidhur mes palëve dt. 02.05.2024, si dhe Ekstrakt QKB i Arts Lab.*
- *Vlera 467,748 Lek, qiraja e ambienteve dhe shërbim ushqimor te Pallati i Brigadave, fatura nga Drejtoria e Shërbimeve Qeveritare*
- *Vlera 50,000 Lek, sipas faturë elektronike nr. 515/2024, dt. 10.05.2024, shitësi PHOENIX + SHPK, përshkrimi "Printime", shoqëruar me aktmarrëveshjen përkatëse lidhur mes palëve.*
- *Vlera bruto **120,000 Lek**, sipas Bordero dt. 10.05.2024, nga MUZA, **punonjësi Linda Kazani**, së bashku me aktmarrëveshjen përkatëse lidhur midis palëve dhe ID e **Linda Kazani**.*

5PYETJE.AL

- *Vlera bruto 30,000 Lek, Bordero 10.05.2024, nga Muza, punonjësi Xhovana Marku, së bashku me akt marrveshjen përkatëse lidhur midis palëve dhe ID e Xhovana Marku.*

**2. OJF "Frobolous" NIPT: M22214702R**. ka marrë pagesën nga Bashkia Tiranë **sipas Urdhër shpenzimi nr. 6369, dt. 29.12.2023, vlera 2,970,000 Lekë, <u>të nënshkruar nga Kryetari i Bashkisë Tiranë, Erion Veliaj</u>.** Projekti "Tirana's Fashion Night". Sipas Raportit të Përgjithshëm të projektit, **vlera totale e parashikuar e projektit është <u>6,946,845 Lekë</u>,** mbështetur pjesa tjetër nga **Qëndra "Harabel"** (3,072,945 Lek) dhe nga "Grace Models". Buxheti/propozimi për financim dhe kontraktimi i zërave financuar nga bashkia Tiranë:

| Nr. | Përshkrimi | Njësia | Sasia | Çmimi/Lekë | Shuma/Lekë |
|---|---|---|---|---|---|
| 1 | Koncept kreativ (skenografi, vizualet, titulli, vizualet online dhe rrjete sociale) | sherbim | 1 | 540,000 | 540,000 |
| 2 | Prodhim video (qera kamera, ndricim, staf, konceptimi video) | sherbim | 1 | 410,000 | 410,000 |
| 3 | Skenografi | sherbim | 1 | 1,100,000 | 1,100,000 |
| 4 | Dj | sherbim | 1 | 50,000 | 50,000 |
| 5 | Regji levizese | sherbim | 1 | 250,000 | 250,000 |
| 6 | Drejtori I pergjitshem | person | 1 | 110,000 | 110,000 |
| 7 | Asistent prodhimi | person | 3 | 30,000 | 90,000 |
| 8 | Qira karrige per publikun | sherbim | 1 | 150,000 | 150,000 |
| 9 | Ndricimi dhe foni | sherbim | 1 | 200,000 | 200,000 |
| 10 | Backstage (karrige per modelet, stafin, tavolina, varese per veshjet, tavolina) | sherbim | 1 | 100,000 | 100,000 |
| | Totali | | | | 3,000,000 |

**Shpenzimet e kryera:**

- *Vlera **540,000 Lek**, sipas faturë elektronike nr. 35/2023, dt. 12.12.2023, nga **Ergys Krisiko**, blerësi FROBOLOUS, përshkrimi "Koncept kreativ", shoqëruar me aktmarrëveshjen përkatëse lidhur mes palëve, si dhe Ekstrakt QKB;*
- *Vlera **1,100,000 Lek**, sipas faturë elektronike nr. 33/2023, dt. 23.11.2023, nga **Ergys Krisiko**, blerësi FROBOLOUS, përshkrimi "Skenografi", shoqëruar me aktmarrëveshjen përkatëse lidhur mes palëve, si dhe Ekstrakt QKB;*
- *Vlera **150,000 lek**, sipas faturë elektronike nr. 6/2023, dt. 30.11.2023, nga **NAN GALLERY**, blerësi FROBOLOUS, përshkrimi "Qira Karrige per publikun", shoqëruar me aktmarrëveshjen përkatëse lidhur mes palëve, si dhe Ekstrakt QKB;*
- *Vlera **50,000 lek**, sipas faturë elektronike nr. 5/2023, dt. 30.11.2023, nga **NAN GALLERY**, blerësi FROBOLOUS, përshkrimi "DJ", shoqëruar me aktmarrëveshjen përkatëse lidhur mes palëve, si dhe Ekstrakt QKB;*
- *Vlera **250,000 lek**, sipas faturë elektronike nr. 9/2023, dt. 30.11.2023, nga **NAN GALLERY**, blerësi FROBOLOUS, përshkrimi "Regji levizeze", shoqëruar me aktmarrëveshjen përkatëse lidhur mes palëve, si dhe Ekstrakt QKB;*

- *Vlera **410,000 lek**, sipas faturë elektronike nr. 8/2023, dt. 30.11.2023, nga **NAN GALLERY**, blerësi FROBOLOUS, përshkrimi "Prodhim video", shoqëruar me aktmarrëveshjen përkatëse lidhur mes palëve, si dhe Ekstrakt QKB;*
- *Vlera **100,000** lek, sipas faturë elektronike nr. 7/2023, dt. 30.11.2023, nga **NAN GALLERY**, blerësi FROBOLOUS, përshkrimi "Backstage", shoqëruar me aktmarrëveshjen përkatëse lidhur mes palëve, si dhe Ekstrakt QKB;*
- *Vlera **200,000** lek, sipas faturë elektronike nr. 388/2023, dt. 05.12.2023, nga **ASLV SHPK**, blerësi FROBOLOUS, përshkrimi "Sherbim Audio Ndricim", shoqëruar me aktmarrëveshjen përkatëse lidhur mes palëve, si dhe Ekstrakt QKB;*
- *Bordero mbi stafin e angazhuar në aktivitet:*
    - *Stefano Romano, Drejtor i Përgjithshëm, paga bruto 110,000 ALL;*
    - ***Reada Lemmusha**, Asistent prodhimi, paga bruto 30,000 ALL;*
    - ***Rea Spartaku**, Asistent Prodhimi, paga bruto 30,000 ALL;*
    - *Arba Topalli, Asistent prodhimi, paga bruto 30,000 ALL;*

**3.Urdhër shpenzimi nr. 5511, dt. 25.11.2023, përfituesi OJF "Byl-A", shuma 5,000,000 Lekë, <u>nënshkruar nga Kryetari i Bashkisë Tiranë, Erion Veliaj.</u>** Projekti kulturor **"Sonoma nga La Veronal"**. Së bashku me këtë urdhër është edhe dokumentacioni justifikues. Sipas aplikimit, projekt propozimit dt.04.09.2023, BYL-A-ja ka kërkuar mbështetje nga Bashkia Tiranë në vlerën **<u>5,817,000 Lekë,</u>** që përkon me 52% të shpenzimeve që kanë të bëjnë me aktivitetet e kompanisë La Veronal. Raporti Finaciar i projektit "Sonoma" nga La Veronal", dt. 06.10.2023, tabelë me listën e shpenzimeve të projektit. **Më poshtë paraqiten shpenzimet e kryera:**

| | Emri Mbiemri | Përshkrimi | Njësia | Sasia | Çmimi/lekë | Shuma/Lekë |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 1 | **Ergys Krisiko** | Koordinator Artistik | Person | 1 | 150,000 | **150,000** |
| 2 | **Ketrina Braho** | Koordinator i festivalit | Person | 1 | 115,000 | **115,000** |
| 3 | **Iva Tiço** | Drejtor Media + PR | Person | 1 | 200,000 | **200,000** |
| 4 | **Klejvis Saliaj** | Drejtor Teknik | Person | 1 | 230,000 | **230,000** |
| Shuma e shpenzimit | | | | | | **695,000** |

**Tabela mbi shpenzimet për personat e angazhuar**

| | **Subjekti ofrues i shërbimit** | **Fatura** | **Përshkrimi faturës** | Sasia | **Vlera totale e faturës** |
|---|---|---|---|---|---|
| 1 | **ARTS LAB SHPK** | 22/2023, dt. 18.10.2023 | Dizajner | 1 | **280,000** |

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| | **ARTS LAB SHPK** | 20/2023, dt. 06.10.2023 | Qera ndriçim | 1 | **1,000,000** |
| 2 | **ARTS LAB SHPK** | 19/2023, dt. 06.10.2023 | Qera audio | 1 | **650,000** |
| 3 | **ARTS LAB SHPK** | 17/2023, dt. 06.10.2023 | Katalog | 1 | **250,000** |
| 4 | **ARTS LAB SHPK** | 18/2023, dt. 06.10.2023 | Kompzitor | 1 | **300,000** |
| 5 | **ARTS LAB SHPK** | 23/2023, dt. 18.10.2023 | Kostumograf | 1 | **480,000** |
| 6 | **ARTS LAB SHPK** | 21/2023, dt. 17.10.2023 | Prodhim skenografie | 1 | **566,200** |
| 7 | PHOENIX + SHPk | 862/2023, dt. 25.09.2023 | Print set Banera dhe Ftesa | 1 | **162,000** |
| 8 | **Ergys Krisiko PF** | 30/2023, dt. 17.10.2023 | Prodhim skenografie | 1 | **352,800** |
| 9 | Lindar Muça | 21/2023, dt.17.10.2023 | Prodhim Skene | 1 | **264,000** |
| Shuma e shpenzuar | | | | | **4,305,000** |

*Tabela mbi shpenzimet e kryera për shërbime*

Shpenzimet e mësipërme janë të shoqëruara me akt marrëveshjet përkatëse të lidhura sipas angazhimi/shërbimit, me kopje të ID/QKB përkatëse etj.

4. **Urdhër shpenzimi nr. 4754, dt. 05.12.2022, nënshkruar nga Kryetari i Bashkisë Tiranë, Erion Veliaj. Përfituesi "Qëndra Albania Community Assit", ACA, shuma 2, 568, 500 Lekë.** Sipas raportit të përgjithshëm financiar të dorëzuar nga "ACA", projekti ka patur kosto totale **5,510,000 lekë,** ku pjesa tjetër e parave është finacuar nga Lindi&Venera, "Telecom One", "Spring", vetë "ACA" dhe "DCA". Projekti kulturor **"Koncert me Zemer". Buxheti/propozimi për financim dhe kontraktimi i zërave financuar nga bashkia Tiranë:**

| Nr. | Përshkrimi | Njësia | Sasia | Çmimi/Lekë | Shuma/Lekë | **Personi/subjekti i angazhuar** | Fatura |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 2 | **Skenografi** | **Shërbim** | 1 | **890,000** | 890,000 | **ARTS LAB** | **Fatura 48/2022, përshkrimi "Skenografi** |
| 2 | Produksion muzikor (pre-post production) banda muzikore | Shërbim | 1 | 1,300,000 | 1,300,000 | SHOQATA URA | Fatura 13/2022, përshkrimi "Produksion muzikor (pre-post production) banda muzikore |
| 3 | Koordinator eventi | Person | 1 | 150,000 | 150,000 | Arnold | |

5PYETJE.AL

| | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | | Kajolli | |
| 4 | Printime materiale promocionale (baner, postera, fletushka) | | 1 | 200,000 | 200,000 | RED CLOUD SHPK | Fatura 252/2022 |
| 5 | Dizajner | Person | 1 | 60,000 | 60,000 | Gazmend Pinjolli | |
| Totali | | | | 2,600,000 | | | |

5. **Urdhër shpenzimi nr. 144, dt. 02.02.2024, <u>të nënshkruar nga Kryetari i Bashkisë Tiranë, Erion Veliaj</u>. Përfituesi "Bash-Art", shuma <u>4,290,000 Lekë</u>,** Projekti Kulturor "Jesus Christ Superstar". Buxheti/propozimi për financim dhe kontraktimi i zërave financuar nga bashkia Tiranë:

| Nr. | Përshkrimi | Njësia | Sasia | Çmimi/Lekë | Shuma/Lekë | Personi I angazhuar |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 1 | **Promotion** | **Shërbim** | **1** | **200,000** | **200,000** | **ARTS LAB SHPK, fatura nr. 28/2023** |
| 2 | Organizator | Shërbim | 1 | 200,000 | 200,000 | |
| 3 | **Vocal Coach** | **Shërbim** | **1** | **300,000** | **300,000** | **ARTS LAB SHPK, fatura nr. 29/2023** |
| 4 | Asistent Regjisor | Shërbim | 1 | 300,000 | 300,000 | Benada Shuta |
| 5 | **Korrepetitor** | **Shërbim** | **1** | **300,000** | **300,000** | **ARTS LAB SHPK, fatura 30/2023** |
| 6 | Skenë dhe kostume | Shërbim | 1 | 300,000 | 300,000 | Divni Gushta |
| 7 | Orkestrues | Shërbim | 1 | 300,000 | 300,000 | Jusiald Xhani PF |
| 8 | Koreograf | Person | 1 | 100,000 | 100,000 | Sedmir Memia |
| 9 | Band | Shërbim | 5 | 100,000 | 500,000 | Jusiald Xhani PF |
| 10 | Balerin dhe Figurant | Person | 15 | 40,000 | 600,000 | Sara Koci, Adela Gjyla, Luiza Dinellari, Erdet Miraka, Xhoni Spahi, Mario Bali, Semdir Memia, Stiv Osmanaj, Aldrin Biba, Jurgest Tomori, Orgest Hoxhallari, Maria Ademaj, Blina Muci, Egzona Bogdani, Verona Kryeziu, Sabina Dona |
| 11 | Aktor | Person | 2 | 100,000 | 200,000 | Ervis Saliasi, Amri Hasanllia |
| 12 | Aktor | Person | 1 | 80,000 | 80,000 | Egzona Ademi |
| 13 | Aktor | Person | 6 | 70,000 | 420,000 | Igli Zarka, Silvio Goskova, Ilia Kaçi, Kristo Qerama, Klinti Çollaku, Donald Shehu |
| 14 | Foni, Ndriçim | Shërbim | 1 | 700,000 | 700,000 | DECIBEL AUDIO SOLUTIONS SHPK |
| | Totali | | | | 4,500,000 | |

***- Lidhur me veprimet hetimore të kryera pranë Ministrisë së Kulturës.***

**74.** Sipas organit procedues edhe pse deri në këtë fazë të hetimit paraprak rezulton që fondet publike në favor të OJF-ve kontrollohen faktikisht nga shtetësja Ajola Xoxa, ato nuk janë shpërndarë vetëm nga Bashkia Tiranë, por edhe institucione të tjera publike. Kjo vlen

për të kuptuar akoma më mirë mekanizmin e kalimit të të hollave nga Institucionet Publike tek OJF-të, prej tyre tek shpk-të dhe individët, të gjithë të kontrolluar por edhe të lidhur ngushtë me shtetasen Ajola Xoxa dhe kryetarin e Bashkisë Tiranë. Erion Veliaj. Konkretisht, me vendimin datë 23.12.2024 të prokurorit, "Për Këqyrje/marrjen e dokumenteve", janë administruar pranë Ministrisë së Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit akte të cilat lidhen me:

*1)* Projektin "International Contemporary Dance Festival Tirana 2022", ku përfshihen kontrata të lidhura, transaksione, pagesa e fatura.
*2)* Projektin "International Contemporary Dance Festival Tirana 2023", ku përfshihen kontrata të lidhura, transaksione, pagesa e fatura.
*3)* Kontrata të lidhura ndërmjet Ministrisë së Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit dhe shoqërisë "Rametal" shpk, ku përfshihen transaksione, pagesa e fatura.

**75.** Nga këqyrja e dokumentacionit të administruar në fashikullin penal, ka rezultuar se **me anë të procesverbalit nr. 6446/5 datë 11.02.2022,** Drejtoria e Konceptimit dhe Fizibilitetit të Projekteve të Kulturës, ka dokumentuar shqyrtimin e projekteve të paraqitura. Ndër to, në subjektin me numër 44 në renditje, konstatohet **Subjekti "HARABEL - QENDRA E ARTIT BASHKËKOHOR", për projektin "Digjitalizimi i artit bashkëkohor në Shqipëri", në shumën 1,000,000 lekë. Në vijim, më datë 14.06.2022, është nënshkruar Kontrata për Mbështetje Financiare me Fonde Publike, Nr. 3260 Prot, datë 14.06.2022, me palë Ministria e Kulturës**, e përfaqësuar nga Arian AVRAZI, Drejtor i Drejtorisë së Konceptimit dhe Fizibilitetit të Projekteve të Kulturës, sipas Urdhrit të Ministrit të Kulturës nr. 93 prot., datë 21.02.2022, **dhe Driant ZENELI,** në cilësinë e përfaqësuesit **të Qendres "HARABEL".**

**75.1. Në këtë kontratë përcaktohet vlera e financimit në shumën 1.000.000 lekë,** në të cilën është përfshirë TVSH, komisionet bankare dhe të gjitha detyrimet fiskale apo detyrime të tjera që njeh legjislacioni shqiptar. Të dhënat e llogarisë bankare të individit përfitues: Emri/Mbiemri i përfituesit: QENDRA HARABEL.

**75.2.** Nga këqyrja ka rezultuar se për këtë rast është nënshkruar **Urdhër-Shpenzimi Nr. 468 datë 17.06.2022** i Ministrisë së Kulturës me të dhëna: Kreditor Përfitues: Qendra Harabel. Objekti i shpenzimit: Projekti: Digjitalizimi i artit bashkëkohor në Shqipëri, 60% sipas kontratës. **<u>Shuma në lekë: 600.000.</u>** Bashkëlidhur Fatura elektronike nr.6/2022 datë 15.06.2022, **Me Shitës:** Qendra Harabel dhe Blerës: Ministria e Kulturës. Vlera: 600.000,00 lekë.

**76.** Me datë **15.09.2022 Balkan Youth Link Albania (BYL-A)** në bashkëpunim me D18 Paris i drejtohet Ministrisë së Kulturës për zhvillimin e festivalit të kërcimit "International Contemporary Dance Festival in Tirana". Me datë 31.10.2022, është nënshkruar Kontrata për Mbështetje Financiare me Fonde Publike, Nr.5801/6 Prot, datë 31.10.2022, me palë Ministria e Kulturës, e përfaqësuar nga Arian AVRAZI, Drejtor i Drejtorisë së Konceptimit dhe Fizibilitetit të Projekteve të Kulturës, dhe "Balkan Youth Link Albania" me Ina Goxhaj, përfaqësuese e Qendrës Drejtore Ekzekutive, në cilësinë e drejtuesit të projektit.

76.1. Në këtë kontratë shpjegohet vlera e financimit në shumën 3.100.000 lekë, ku përfshihet TVSH, komisionet bankare dhe të gjitha detyrimet fiskale apo detyrime të tjera që njeh legjislacioni shqiptar. Pagesa do realizohet në 2 faza: Faza e parë: 60% të shumës dhe

SPYRETA.AL

Faza e dytë: 40% të shumës. Gjithashtu, u administrua edhe Fatura elektronike nr.6/2022 datë 02.11.2022, me Shitës: BYL-A dhe me Blerës: Ministria e Kulturës. Vlera: 1.860.000,00 lekë.

**76.2. Me interes për hetimin paraqitet përfshirja e shtetases Ajola Xoxa në këtë projekt.** Konkretisht, nga këqyrja ka rezultuar se më datë 01.11.2022 është nënshkruar një Marrëveshje Shërbimi ndërmjet: Qendra Balkan Youth Link-Albania, përfaqësuar ligjërisht nga Drejtor Ekzekutiv Ina Goxhaj, e datëlindjes 24.05.1988, me letërnjoftim me nr. Personal 185524116P, dhe shtetases **Ajola Xoxa, e datëlindjes 16.07.1983, lindur dhe banuese në Tiranë (Shqipëri), e identifikuar me letërnjoftimin me nr. 135716050T.** Sipas kësaj marrëveshje, shtetësja Ajola Xoxa e cila nga aktet e administruara në fashikull, provohet të jetë menaxhuesja faktike e OJF "BYL-A", merr përsipër për këtë të fundit, të kryejë detyrat e Drejtoreshës artistike të festivalit "International Contemporary Dance Festival in Tirana", kundrejt **çmimit bruto në vlerën 400.000 (katërqind mijë) lekë, shumë që do t'i paguhet në llogarinë bankare në bankën Intesa SanPaolo me Nr. Llogarie 43768735102.**

**76.2.1. Pas lidhjes së kësaj marrëveshje, nga dokumentet e administruara provohet se shtetësja Ajola Xoxa ka arkëtuar në llogarinë e saj një sasi të hollash prej OJF "BYL-A", të cilën e kontrollon po vetë. Konkretisht, në Formularin e Urdhrit të Transfertës, të Intesa SanPaolo Bank, Klienti urdhërues "BYL-A", i paguan klienti përfitues "Ajola Xoxa" shumën 340,000 lek. Ky formular është nënshkruar si përfaqësues i klientit urdhërues nga shtetasja Adela Kondakçiu.**

76.3. Gjithashtu, në fashikull është administruar dhe **Fatura Elektronike Nr. 8/2022 datë 03.11.2022,** me Shitës: Qendra "HARABEL" dhe Blerës: BYL-A. Vlera: 464 441,00 lekë. Bashkëlidhur dhe Formulari i Urdhrit të Transfertës lëshuar nga Intesa Sanpaolo Bank në lidhje me këtë pagesë.

**76.3.1. Fatura Elektronike Nr. 9/2022 datë 03.11.2022, me Shitës: Qendra "HARABEL"** dhe **Blerës: BYL-A.** Vlera: 347,059,00 lekë. Bashkëlidhur dhe Formulari i Urdhrit të Transfertës lëshuar nga Intesa Sanpaolo Bank në lidhje me këtë pagesë.

**76.3.2. Fatura Elektronike Nr. 23/2022 datë 03.11.2022, me Shitës: Ergys Krisiko** dhe **Blerës: BYL-A.** Vlera: 236,000,00 lekë. Bashkëlidhur dhe Formulari i Urdhrit të Transfertës lëshuar nga Intesa Sanpaolo Bank në lidhje me këtë pagesë.

**76.3.3. Fatura Elektronike Nr. 24/2022 datë 03.11.2022, me Shitës: Ergys Krisiko** dhe **Blerës: BYL-A.** Vlera: 133,000,00 lekë. Bashkëlidhur dhe Formulari i Urdhrit të Transfertës lëshuar nga Intesa Sanpaolo Bank në lidhje me këtë pagesë.

**76.3.4.** Fatura Elektronike Nr. 10/2022 datë 09.12.2022, me Shitës: BYL-A dhe Blerës: Ministria e Kulturës. Vlera: 1,240,000,00 lekë.

**76.3.5.** Gjithashtu, në fashikull janë administruar **edhe Urdhër-Shpenzimi Nr. 1337 datë 30.12.2022** i Ministrisë së Kulturës me të dhëna: Kreditor Përfitues: Qendra Harabel. Objekti i shpenzimit: Projekti: Digjitalizimi i artit bashkëkohor në Shqipëri, 40% sipas kontratës. Shuma në lekë: 400 000 **lekë**. Bashkëlidhur Fatura elektronike nr. 18/2022 datë 19.06.2022, në lidhje me këtë pagesë.

**76.3.6. Fatura Elektronike Nr. 55/2022 datë 30.11.2022, me Shitës: Arts Lab** shpk dhe **Blerës: Qendra "HARABEL".** Vlera: 300,000,00 lekë.

**76.3.7. Fatura Elektronike Nr. 56/2022 datë 30.11.2022, me Shitës: Arts Lab** shpk dhe **Blerës: Qendra "HARABEL".** Vlera: 650,000,00 lekë.

SPAK TUESJA.AL

**76.4.** Nga këqyrja ka rezultuar gjithashtu fakti se më datë **01.10.2022**, është nënshkruar një **Marrëveshje Shërbimi** ndërmjet **Organizatës jofitimprurëse "HARABEL"**, përfaqësuar ligjërisht nga Drejtor Ekzekutiv Driant Zeneli, i ditëlindjes 25.04.1983, lindur në Shkodër dhe banues në Tiranë, mbajtës i letërnjoftimit me nr. personal 130425067Q, dhe shtetasit **Valmir Xoxa**, shtetas shqiptar, i dti 27.08.1980, lindur dhe banues në Tiranë, me i identifikuar me letërnjoftim me nr. Personal 100827125U.

**76.4.1.** Objekti i marrëveshjes lidhet me zbatimin e projektit me titull *"Digjitalizimi i artit bashkëkohor në Shqipëri"* mbështetur prej Ministrisë së Kulturës. Palët lidhin këtë Kontratë Shërbimi, me qëllim realizimin e aktivitetit artistik. Sipas kësaj kontrate, **Valmir Xoxa, merr përsipër të marrë pjesë në projektin "Digjitalizimi i artit bashkëkohor në Shqipëri" duke ofruar shërbimin e tij si Grumbullues të dhënash/researcher**, në katalogun që do të publikohet informacioni/studimi i kryer, për 2 muaj, specifikisht muajt tetor dhe nëntor 2022, kundrejt **çmimit bruto në vlerën 25.000 lekë (njëzetë e pesëmijë lekë) për secilin muaj.** Person 1 x 2 muaj x 25.000 lekë 50.000 lekë, shumë që do t'i paguhet në llogarinë bankare: Banka: Banka Credins, Iban: AL45 2121 1009 0000 0000 0016 3571.

**76.4.2.** Qendra "Harabel" merr përsipër të paguajë Valmir Xoxa, në vlerën totale bruto 50.000 lekë, çmim ky që përfshin tatimin në burim (15%) si dhe të gjitha kostot shtesë për realizimin e këtij transaksioni. Ky fakt është dokumentuar me anë të dokumentit "Lajmërim Debitimi" lëshuar nga Intesa SanPaolo Bank, më datë datë 01.12.2022, me Përfitues: Valmir Xoxa dhe Informacion shtesë: Shërbim grumbullime/dhëna për digj art bashkëkohor në Shqipëri.

**76.4.3. Sa më sipër, shtetasi Valmir Xoxa paguhet nga Qendra "Harabel", e cila kontrollohet në fakt nga shtetësja Ajola Xoxa, për një shërbim që lidhet me dixhitalizimin e artit bashkëkohor në Shqipëri. Edhe në këtë rast, sipas organit procedues konstatohet ajo çfarë duket se karakterizon mënyrën e shpërndarjes së fondeve publike, njëherë që ato janë kaluar në llogaritë e OJF-ve të kontrolluara nga shtetësja Ajola Xoxa. Pra, pasi fondet publike arkëtohen ato degëzohen në shuma të copëzuara në shpk ose siç paraqitet rasti konkret, në individë të afërt me shtetasen Ajola Xoxa**. Në rastin e shtetasit Valmir Xoxa, përveç se është kushëri i shtetases Ajola Xoxa, ashtu si edhe në raste të tjera të mëparshme, konstatohet se nuk zotëron asnjë kapacitet teknik apo njerëzor për ofrimin e një shërbimi si ai i përshkruar më lart. Vetë shtetësja Ajola Xoxa pohon se ky shtetas punon si dirigjent.

77. Në vijim, me anë të shkresës Nr. 901 datë 31.07.2023, është miratuar nga Drejtori i përgjithshëm i TKOB Abigeila Voshtina, *Kërkesa për cilësi artistike* (Honorare të Huaj Grup Produksioni) e konceptuar nga Drejtoria e Produksionit Skenik e Teatrit Kombëtar të Operas, Baletit dhe Ansamblit Popullor. Në këtë kërkesë shpjegohet se në vazhdimësi të punës dhe realizimit të "Dance Festival", **bashkëpunim me "Harabel" dhe TKOBAP**, kërkohet ndjekja e procedurave për këtë projekt. Për këtë, me anë të shkresës Nr.882 datë 31.07.2023, është miratuar nga Drejtori i përgjithshëm Abigeila Voshtina, *Kërkesa për marrje me qira kostumografi dhe skenografi e konceptuar nga Drejtoria e Baletit e Teatrit Kombëtar të Operas, Baletit dhe Ansamblit Popullor.* Në këtë kërkesë shpjegohet **se nevojitet marrja me qira e pajisjeve të skenografisë dhe kostumografisë për baletin "Gravity", për të cilat përfaqesinë e ka marrë kompania "Rametal" shpk.**

**77.1. Në lidhje me këtë projekt me datë 20.09.2023 është nënshkruar "Kontratë**



SPIRANCA.AL

**Qiraje", Nr. 882/1 Prot, me palë: TEATRI KOMBËTAR I OPERËS BALETIT DHE ANSAMBLIT POPULLOR** përfaqësuar ligjërisht nga Drejtori i Përgjithshëm Znj. Abigeila Voshtina, dhe **RAMETAL sh.p.k.** identifikuar me numër unik identifikimi nr. L41517502C NUIS regjistruar në regjistrin tregtar më datë 11.03.2014, me seli në adresën Durrës Xhafzotaj, Autostrada Durrës Tiranë km5, **përfaqësuar nga administratori z. Elman Abule**, mbajtës i letërnjoftimit më nr. Personal I10429045E.

**77.2.** Sipas kontratës TKOBAP angazhohet t'i paguajë Rametal sh.pk, **shumën totale prej 1, 213, 380 lekë pa TVSH (një milion e tetëqind e gjashtëdhjetë e tetë mijë e dyqind e njëzet) lekë.** Tarifat e mësipërme do t'i paguhen RAMETAL sh.p.k., me transfertë bankare ne llogarinë rrjedhëse të dedikuar të treguar më poshtë: Të dhënat personale dhe kodi fiskal i personave të autorizuar për të kryer veprime në llogarinë rrjedhëse për Rametal sh.p.k. janë si më poshtë: "Rametal" Sh.p.k. Emri i Përfaqësuesit: z. Elman Abule. Emri i Bankës: FIBANK. IBAN: AL 52 2151 1031 ALL1 0000 0940 0000.

**77.3.** Me anë të **shkresës Nr. 902 datë 31.07.2023**, është miratuar nga Drejtori i përgjithshëm Abigeila Voshtina. kërkesa për marrje me qira kostumografi dhe skenografi e konceptuar nga Drejtoria e Baletit e Teatrit Kombëtar të Operas, Baletit dhe Ansamblit Popullor.

77.3.1. Në këtë kërkesë shpjegohet se në vazhdimësi të punës dhe realizimit të "Dance Festival", në **bashkëpunim me "Harabel" dhe TKOBAP**, kërkohet ndjekja e procedurave për këtë projekt. Gjithashtu, shpjegohet se lind nevoja e marrjes me qira të pajisjeve **të skenografisë dhe kostumografisë për baletin "Gravity" për të cilat, siç u përmend më lart, përfaqësinë e ka marrë kompania "Rametal" shpk.**

**77.4. Me datë 15.09.2023, është nënshkruar "Kontratë Qiraje", Nr. 902/1 Prot, me palë Teatri Kombëtar i Operës Baletit dhe Ansamblit Popullor,** përfaqësuar ligjërisht nga Drejtori i Përgjithshëm Znj. Abigeila Voshtina, dhe **"Rametal" sh.p.k.** identifikuar me numër unik identifikimi nr. L41517502C NUIS regjistruar në regjistrin tregtar më datë 11.03.2014, me seli në adresën Durrës Xhafzotaj, Autostrada Durrës Tiranë km5, **përfaqësuar nga administratori Elman Abule**, mbajtës i letërnjoftimit më nr. Personal I10429045E.

**77.4.1.** "Rametal" sh.p.k. i jep me qira Teatrit Kombëtar të Operës Baletit dhe Ansamblit Popullor, në kushtet e përcaktuara më poshtë dhe në gjendjen në të cilën ndodhen sipas listës së artikujve të parashikuar në Anex A, (bashkëlidhur kësaj kontrate) për vënien në skenë të baletit "SONOMA" nga datat 05,06 Tetor 2023.

**77.4.2.** Sipas kontratës TKOBAP angazhohet t'i paguajë "Rametal" sh.p.k., **shumën totale prej 1,868,220 lekë pa TVSH (një milion e tetëqind e gjashtëdhjetë e tetë mijë e dyqind e njëzet) lekë.** Tarifat e mësipërme do t'i paguhen "Rametal" sh.p.k., me transfertë bankare në llogarinë rrjedhëse të dedikuar të treguar më poshtë, ndërsa të dhënat personale dhe kodi fiskal i personave të autorizuar për të kryer veprime në llogarinë rrjedhëse për Rametal sh.p.k. janë si më poshtë: "Rametal" sh.p.k. Emri i Përfaqësuesit: Elman Abule. Emri i Bankës: FIBANK. IBAN: AL 52 2151 1031 ALL1 0000 0940 0000.

**77.5.** Në lidhje me sa më lart, në fashikull është administruar **Urdhër-Shpenzimi Nr. 677 datë 18.12.20223** i Teatrit Kombëtar të Operas dhe Baletit me këto të dhëna: Kreditor Përfitues: Rametal. Objekti i shpenzimit: Pagesa qera Rametal, Gravity. Shuma në lekë: 1,456,056 lekë. Bashkëlidhur Fatura elektronike nr. 265/2023 datë 07.12.2023, në lidhje me



SPORTELI.AL

këtë pagesë.

77.6. Gjithashtu, është administruar edhe **Urdhër-Shpenzimi Nr. 678 datë 18.12.20223** i Teatrit Kombëtar të Operas dhe Baletit me këto të dhëna: Kreditor Përfitues: Rametal. Objekti i shpenzimit: Pagesa qera Rametal, Sonoma. Shuma **në lekë: 2,241,864 lekë**. Bashkëlidhur Fatura elektronike nr.264/2023 datë 07.12.2023, në lidhje me këtë pagesë.

**78. Në përmbledhje të sa më lart, ka rezultuar e provuar se Ministria e Kulturës** i ka paguar subjektit **"Qendra Harabel", shumën <u>1.000.000 lekë,</u>** në të cilën përfshihet TVSH, komisionet bankare dhe të gjitha detyrimet fiskale apo detyrime të tjera që njeh legjislacioni shqiptar.

**78.1. Ministria e Kulturës** i ka paguar gjithashtu subjektit **"Balkan Youth Link Albania" shumën <u>3.100.000 lekë,</u>** në të cilën përfshihet TVSH, komisionet bankare dhe të gjitha detyrimet fiskale apo detyrime të tjera që njeh legjislacioni shqiptar.

**78.2.** Gjithashtu, rezulton se: **i) "Balkan Youth Link Albania"** i ka paguar shtetases Ajola **Xoxa shumën 340,000 lekë; ii) "Balkan Youth Link Albania"** i ka paguar subjektit **"Qendra Harabel" shumën 811,500 lekë; iii) "Balkan Youth Link Albania"** i ka paguar shtetasit **Ergys Krisiko shumën 369,000 lekë; iv) "Qendra Harabel"** i ka paguar subjektit **"Arts Lab" shumën 950,000 lekë; v) "Qendra Harabel"** i ka paguar shtetasit **Valmir Xoxa shumën 50,000 lekë; vi) Teatri Kombëtar i Operas,** Baletit dhe Ansamblit Popullor i ka paguar **subjektit Rametal shpk** shumën totale prej **1,213,380 lekë pa TVSH** (një milion e tetëqind e gjashtëdhjetë e tetë mijë e dyqind e njëzet) lekë; **vii) Teatri Kombëtar i Operas,** Baletit dhe Ansamblit Popullor i ka paguar **subjektit Rametal shpk** i shumën totale prej **1,868,220 lekë pa TVSH** (një milion e tetëqind e gjashtëdhjetë e tetë mijë e dyqind e njëzet) lekë.

**79. Sa më sipër, sipas organi procedues rezulton e provuar sesi fondet publike, të akorduara në këtë rast nga Ministria e Kulturës, fillimisht kalojnë në dy Organizata Jofitimprurëse nën kontrollin faktik të shtetases Ajola Xoxa. Më pas, nga këto organizata fondet kalojnë tek shtetësja Ajola Xoxa, "Arts Lab" shpk në pronësi ligjore të dajës së shtetases Ajola Xoxa (Erald Simixhiu), por në pronësi faktike të kësaj të fundit, tek shtetasi Valmir Xoxa, kushëri i afërt i shtetases Ajola Xoxa, dhe shtetasi Ergys Krisiko, njohje e afërt me shtetasen Ajola Xoxa.**

**79.1. Ndërkohë përsa i përket shuma të paguara për qiramarrje në favor të "Rametal" shpk nga TKOB, rezulton e provuar si nga faturimet përkatëse ashtu edhe nga komunikimet mes shtetases Adela Kondakçiu dhe financieres së kësaj shoqërie, se ato kalojnë pas arkëtimit në favor të "Partners Lat" shpk, shoqëri kjo në pronësi ligjore të shtetases Ajola Xoxa.**

***- Lidhur me veprimet hetimore të kryera në lidhje me Personat Fizikë që kontrollohen nga shtetësja Ajola Xoxa***

**80. Sipas organit procedues për të kuptuar më mirë një pjesë të mekanizmit që bën të mundur transferimin e fondeve publike që administrohen nga Bashkia Tiranë, prej subjekteve tregtarë përfitues të tyre, tek llogaritë bankare të OJF-ve të kontrolluara nga shtetësja Ajola Xoxa, si dhe personave fizikë gjithashtu të kontrolluar prej kësaj të fundit, mjafton t'i referohemi veprimeve hetimore që kanë patur në fokus**

**aktivitetin e personave fizikë që kanë ushtruar aktivitetin në zyrat e "Partners Laë" shpk, me pronar bashkëshorten e kryetarit të Bashkisë Tiranë.**

81. Kështu, në lidhje me shtetasen **Ines Dani, i regjistruar si Person Fizik që ushtron aktivitetin e avokatisë** në ambientet ku njëkohësisht edhe shtetësja Ajola Xoxa ushtron aktivitetin e saj me firmën "Partners Laë" shpk, rezultojnë të dhëna me interes për hetimin të përcjella nga bankat e nivelit të dytë, të cilat duhet të çmohen në raport me sa është përftuar nga komunikimet e zhvilluara nga shtetësja Adela Kondakçiu, me këtë shtetase por edhe me të tjerë, komunikime këto që do të trajtohen më poshtë.

**81.1.** Nga informacionet e administruara në fashikull, rezulton se kjo shtetase është titullare e llogarisë bankare rrjedhëse me Nr. 2109293530l, në monedhën Lekë, kredituar dhe debituar 6,163,722 lekë (pra, gjëndja aktuale 0). Në këtë llogari, evidentohen të dhëna në interes të hetimit në lidhje me lëvizjet bankare të Personit Fizik Ines Dani. **Konkretisht, fillimisht konstatohet se Personi Fizik Ines Dani ka marrë pagesa nga "Partners Laë" Shpk për muajt qershor-korrik-gusht 2019 dhe mars 2020, në vlerë fikse 120,000 lekë.** Pas muajit maj 2020, "Partners Laë" Shpk nuk ka kryer asnjë transaksion bankar kundrejt Ines Dani. Kjo duhet patur në konsideratë në vijim, ndërsa **do të evidentohet që kjo shtetase ka mbajtur një pjesë të shumave që ka marrë nga subjekte tregtare në llogarinë e saj, pra, për të kompensuar pagesat e pakryera (siç është rënë dakord më parë" nga shtetësja Ajola Xoxa.**

81.2. Më datë **14.12.2020**, llogaria bankare e **PF Ines Dani kreditohet në vlerën 1,336,284 lekë nga "FUSHA" Shpk**, me përshkrimin ***likuidim fature*.** **Menjëherë pas kreditimit të kësaj shume, Ines Dani PF transferon 593,904 lekë në llogarinë bankare të Qendrës "Harabel", me përshkrimin "*Pagesa fature Nr.03 datë 30.11.2020*".** Më pas, po kjo shtetase paguan 137,730 lekë tvsh e muajit nëntor 2020. Diferencën prej 604.650 lekë rezulton se shtetësja Ines Dani PF e ka mbajtur në llogarinë e saj. **Pra, *siç do shpjegohet në vijim gjatë paraqitjes së komunikimeve të kësaj shtetase me shtetasen Adela Kondakçiu*, Ines Dani pasi merr të hollat nga "Fusha" shpk, kalon afërsisht gjysëm e tyre në llogarinë e Qendrës "Harabel", të zotëruar nga shtetësja Ajola Xoxa.**

**81.3. Thuajse në të njëjtën mënyrë ka funksionuar mekanizmi i përfitimit të fondeve publike edhe në rastin e Bashkisë Fier.** Në lidhje me këtë, evidentohet se në qershor të vitit 2021, nga Bashkia Fier është transferuar në llogarinë e PF Ines Dani një shumë prej **3,032,690** lekë, në kuadër të një projekti që ka për objekt të tij *propozim për miratim ligjesh*. **Kjo kontratë e lidhur mes PF Ines Dani dhe Bashkisë Fier trajtohet hollësisht në vijim, tek aktet e administruara në fashikull nga një procedim tjetër, akte këto që përmbajnë komunikimet e shtetases Adela Kondakçiu me shtetasen Ines Dani. Pas kalimit të shumës prej 3,032,690** lekë në llogarinë bankare të PF **Ines Dani**, kjo e fundit fillimisht paguan 563,667 lekë për TVSH e muajit dhjetor 202. **Pas kësaj, transferon 1,234,000 lekë në llogarinë bankare** të Greta Domit PF. Kjo e fundit është gjithashtu Person Fizik që ushtron aktivitetin në zyrat e shtetases Ajola Xoxa. Në fund, diferencën prej 1,233,877.55 lekë, shtetësja Ines Dani e transferon në llogarinë bankare të bashkëjetuesit të saj, Sazan Gorishova.

**81.4. Në rastin e kalimit të të hollave në llogarinë e PF Greta Domi, duhet mbajtur në konsideratë fakti që këta dy persona fizikë, me të njëjtin objekt aktiviteti, faturojnë nga njëra tek tjetra, për shërbime konsulence ligjore. Duke qenë se më poshtë,**



SDVEKUETA AL

**në komunikimet që përmenden, evidentohet fare qartë se në realitet shtetësja Ines Dani është e punësuar tek shtetësja Ajola Xoxa dhe se regjistrimi i Personit Fizik (Ines Dani) është ideuar në koncept dhe i është kërkuar nga e njëjta shtetase, kuptohet se kjo diferencë e kaluar në llogarinë bankare të shtetasit Sazan Gorishova, bashkëjetues i shtetases Ines Dani, është në të vërtetë totali i pagave (rreth 120.000 lekë në muaj) të palikuiduara nga Ajola Xoxa që prej muajit Maj 2020. Ndërsa pjesa tjetër, siç u citua më lart, ka kaluar në llogaritë bankare të Qendrës "Harabel" dhe PF tjetër Greta Domi.**

81.4.1. Më konkretisht, transaksionet që janë në interes të hetimit pasqyrohen si më poshtë: 1) Në datë **19.06.2019**, llogaria bankare kreditohet në vlerë 120,000 lekë, nga shoqëria "Partners Laë" Shpk. Qëllimi i pagesës "Likujdim fature Nr.1 datë 17.06.2019"; **2)** Në datë **01.07.2019, llogaria** bankare kreditohet në vlerë 120,000 lekë, nga shoqëria "Partners Laë" Shpk. Qëllimi i pagesës "Likujdim fature Nr.2 datë 27.06.2019"; 3) Në datë **26.07.2019**, Ines Dani tërheq cash 100,000 lekë; **4)** Në datë **01.08.2019,** llogaria bankare kreditohet në vlerë 120,000 lekë, nga shoqëria "Partners Laë" Shpk. Qëllimi i pagesës "Likujdim fature Nr.3 datë 22.07.2019"; **5)** Në datë **03.03.2020**, llogaria bankare kreditohet në vlerë 120,000 lekë, nga shoqëria "Partners Laë" Shpk. Qëllimi i pagesës "Pagesë fature Shkurt 2020"; **6)** Në datë 23.04.2020, llogaria bankare kreditohet në vlerë 217,260 lekë, nga shtetasi Ramiz Abili. Qëllimi i pagesës "Konsulencë ligjore kundër Aleksandros Shpk. Pagesë fature Nr.07 datë 05.03.2020"; **7)** Në datë 09.06.2020, llogaria bankare kreditohet në vlerë 744,540 lekë, nga kompania BA INVEST SHA. Qëllimi i pagesës "Pagesë fature Nr.09 datë 05.06.2020"; **8)** Në datë 09.06.2020, llogaria bankare kreditohet në vlerë 148,908 lekë, nga kompania BA INVEST SHA. Qëllimi i pagesës "Pagesë fature Nr.12 datë 05.06.2020"; 9) Në datë 11.06.2020, Ines Dani tërheq cash 107,930 lekë; **10)** Në datë 24.06.2020, Ines Dani tërheq cash 350,000 lekë; **11)** Në datë 09.07.2020, Ines Dani tërheq cash 100,000 lekë; 12) Në datë **23.04.2020**, llogaria bankare kreditohet në vlerë 120,000 lekë, nga shtetasja Anila Skera. Qëllimi i pagesës "Konsulencë ligjore. Pagesë fature Nr.13 datë 25.09.2020"; **13) Në datë 14.12.2020, llogaria bankare kreditohet në vlerën 1,336,284 lekë nga FUSHA Shpk, me përshkrimin likuidim fature. Pas kreditimit të kësaj shume, Ines Dani PF, siç u përmend më lart, transferon 593,904 lekë në llogarinë bankare të Qendrës Harabel me qëllim "Pagesa fature Nr.03 datë 30.11.2020". Në lidhje me këtë, ndërsa është pyetur në cilësinë e personit që ka dijeni për veprën penale, shtetësja Ines Dani, si edhe Greta Domi, është përgjigjur se shuma e të hollave ka kaluar në favor të "Harabel" si shenjë mirënjohje për shtetasen Ajola Xoxa, në kundërshtim kjo me përshkrimin e bërë në bankë, "*likuidim fature*" për të dy këta Persona Fizikë. Dhe në fakt, një përshkrim i tillë, siç do të shihet në vijim tek komunikimet e administruara në fashikull, mes shtetases Adela Kondakçiu dhe Ajola Xoxa, kundërshtohet nga kjo e fundit. Pasi mëson për përshkrimin e bërë në bankë, (likuidim fature), shtetësja Ajola Xoxa i "tërheq vëmendjen" Adela Kondakçiut duke i thënë se duhej vënë "sponsorizim" dhe jo "faturë".** Me këtë qëndrim duket se është përshtatur edhe shtetësja Ines Dani, por edhe Greta Domi, ndërsa kanë dhënë deklarimet e tyre para hetuesve të BKH-së; **14)** Në datë **12.01.2021**, Ines Dani PF transferon 247,460 lekë në llogarinë bankare të Greta Domi PF, me përshkrimin pagesë fature; **15)** Në datë **26.02.2021**, Ines Dani PF transferon 228,000 lekë në llogarinë bankare të Greta Domi PF, me përshkrimin pagesë

fature; **15)** Më datë **14.06.2021**, llogaria bankare kreditohet në vlerën 3,032,690 lekë nga Bashkia Fier, në kuadër të projektit 3C4SME. Pas kreditimit të kësaj shume, në datë 17.06.2021 Ines Dani PF paguan 563,667 lekë për TVSH e muajit dhjetor 2020, si dhe transferon 1,234,000 lekë në llogarinë bankare të Greta Domit PF, me përshkrimin pagese fature. Shumën e mbetur prej 1,233,877.55 lekë, e transferon në datë 21.06.2021 në llogarinë bankare të bashkëjetuesit të saj, Sazan Gorishova.

**81.5. Sa më sipër, sipas organit procedues nga një përllogaritje e përafërt bazuar në fondet publike, faturat fiktive dhe të ardhurat nga shoqëri të lidhura drejtpërdrejt ose tërthorazi me Bashkinë Tiranë, përfitimet përmes shoqërive "Partners Lab" shpk, "Arts Lab" shpk, "Ava Studio" shpk, "Byl-A" OJF, "Harabel" OJF, "Nan Gallery" shpk, "Eventus" OJF dhe "Muza" OJF, kapin shifrën e rreth 110.000.000 lekë.**

***- Veprimet hetimore të kryera në lidhje me shpenzimet e bëra nga Ajola Xoxa dhe të afërmit e saj në shifrën e 86,721,175*** *(tetëdhjetë e gjashtë milion e shtatëqind e njëzet e një mijë e njëqind e shtatëdhjetë e pesë) lekë për rroba, produkte kozmetike, buzëkuq, vathë, etj*

82. Në fashikullin penal është administruar shkresa Nr. 24326/1 Prot., datë 26.11.2024, e përcjellë nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, nga ku rezulton se shtetasi **Erald Haxhi Ismaili** ka kryer **130 praktika doganore** për zhdoganimin e mallrave personale nëpërmjet deklaratave doganore *Import4*, të degës Doganore Rinas.

**82.1.** Nga këqyrja e materialit të vënë në dispozicion, evidentohet se mallrat e zhdoganuara nga shtetasi Erald Ismaili, janë blerë më parë në platformën online të rrjetit të dyqaneve *Net-a-Porter. com*, në Mbretërinë e Bashkuar, Itali, Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe Hong Kong. Gjithashtu, nga shkresa evidentohet fakti se nga i njëjti shtetas blerje janë bërë edhe në kompaninë *Moda Operandi* dhe *Mercedes Distribution Moda*. Sipas përshkrimit të mallit të zhdoganuar, sendet e blera rezulton të jenë produkte që përdoren për femra/gra. **Vlera totale e produkteve të blera online, të cilat më pas janë zhdoganuar në territorin shqiptar, për vitin 2016-2021 është 55,414,409 lekë.**

**82.2.** Konkretisht, **në vitin 2016** rezulton një zhdoganim i datës **14.12.2016**, nga kompania eksportuese *Net-A-Porter*, vendi eksportues Mbretëria e Bashkuar, përshkrimi: *veshje personale 5 copë, me vlerë produkti **702,174 lekë.***

**82.3.** Në vitin **2017**, rezultojnë **10 praktika zhdoganimi**, nga kompania eksportuese *Net-A-Porter*, vendi eksportues Mbretëria e Bashkuar, përshkrimi: *veshje personale, fustan bluza, syze etj., në një vlerë totale produkti prej **5,091,333 lekë.***

**82.4.** Në vitin **2018**, rezultojnë **90 praktika zhdoganimi**, nga kompania eksportuese më së shumti *Net-A-Porter*, vendi eksportues Mbretëria e Bashkuar, Shtetet e Bashkuara të Amerikës, përshkrimi: *veshje personale, fustan bluza, canta, funde, pallto, produkte kozmetike, buzëkuq, vathë, etj., në një vlerë totale produkti prej **14,850,236 lekë.***

**82.5.** Në vitin **2019**, rezultojnë **69 praktika zhdoganimi**, nga kompania eksportuese më së shumti *Net-A-Porter*, vendi eksportues Britania e Madhe, përshkrimi: *veshje personale, fustan bluza, canta, funde, pallto, produkte kozmetike, buzëkuq, vathë, etj., në një vlerë totale produkti prej **13,533,786 lekë.***

SPORTIET.AL

**82.6.** Në vitin **2020**, rezultojnë **81 praktika zhdoganimi**, nga kompania eksportuese më së shumti *Net-A-Porter*, vendi eksportues Mbretëria e Bashkuar, Hong Kong, përshkrimi: *veshje personale, fustan bluza, çanta, funde, pallto, produkte kozmetike, buzëkuq, vathë, etj.", në një vlerë totale produkti prej 14,453,776 lekë.*

**82.7.** Në vitin **2021**, rezultojnë **46 praktika zhdoganimi**, nga kompania eksportuese më së shumti *Net-A-Porter*, vendi eksportues Mbretëria e Bashkuar, Italia, përshkrimi: *veshje personale, fustan bluza, çanta, funde, pallto, produkte kozmetike, buzëkuq, vathë, etj.", në një vlerë totale produkti prej* **6,783,104 lekë.**

| Viti | Vlera e produkteve |
|---|---|
| 2016 | 702,174 |
| 2017 | 5,091,333 |
| 2018 | 14,850,236 |
| 2019 | 13,533,786 |
| 2020 | 14,453,776 |
| 2021 | 6,783,104 |
| Total | 55,414,409 |

**82.3. Vlerës sa më lart, duhet t'i shtohet edhe Dogana+Tvsh e paguar nga blerësi për artikujt e porositur. Nga 130 praktikat doganore është arritur të verifikohen 128 praktika të tilla, vlera e të cilave është 12,622,302 lekë (Doganë+TVSH). Në total, rezulton se për 128 praktika doganore (130 të tilla) janë paguar nga blerësi të paktën 68,036,711 lekë.**

**82.4. Me qëllim identifikimin e blerësit të artikujve për të cilat janë kryer dhe zhdoganimet përkatëse, është proceduar me printimin e praktikave nga sistemi (sistemi doganor). Nga këqyrja e dokumenteve të printuar të cilat i bashkëlidhen praktikave, në shumicën e rasteve identifikohet si blerës shtetasi Erald Ismaili, me numër kontakti +355672020124 (*në përdorim të shtetases Ajola Xoxa*), si dhe adresa për pritjen e mallit Sky Tower. Po kështu, të paktën në një nga praktikat doganore, e më konkretisht me Nr. R 30512 datë 04.12.2018, *nga ku rezulton blerja e 2 fustane me vlerë 3,323.11 dollarë amerikanë*, dogana dhe tvsh vlerë 76,022 lekë, në dokumentin me logo të DHL evidentohen të dhënat e marrësit: *"Erald Ismaili, rruga Ibrahim Rugova, Sky Toëer 12-3, ajolaxoxa@gmail.com" dhe "contact: 0355672020124".***

**83.** Në lidhje me blerjet e bëra nga shtetësja **Valbona Xoxa,** në fashikullin penal është administruar Shkresa Nr. 674 Prot., datë 14.09.2024, e përcjellë nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, nga ku rezulton se shtetasja Valbona Xoxa ka kryer 32 praktika doganore për zhdoganimin e mallrave personale nëpërmjet deklaratave doganore *Import4*, të degës Doganore Rinas.

**83.1.** Nga këqyrja e materialit të vënë në dispozicion, evidentohet se mallrat e zhdoganuara nga shtetësja Valbona Xoxa, janë mallra të blerë online kryesisht ***Net-a-Porter.com***, dhe në disa raste ***Shopbop, the Outnet*** në Mbretërinë e Bashkuar dhe në Shtetet



SPIEGUET.AL

e Bashkuara të Amerikës. Sipas përshkrimit të mallit të zhdoganuar, *rezulton të jenë mallra/produkte që përdoren për femra/gra, të llojit veshje, vathë, make up, furçe kozmetike, buzëkuq, produkte kozmetike, fustane etj.* Praktikat doganore, në 30 raste janë në monedhën GBP (*Pound*) dhe në 2 raste janë në monedhën USD (*Dollarë Amerikanë*).

**83.2. Nga këqyrja e deklaratave doganore, në rastin kur ka patur dokumenta bashkëngjitur, evidentohet në të gjitha rastet se porositë në dyqanin online *Net-a-Porter* janë bërë nga llogaria/account 133174304, emri i kontaktit dhe adresa "*Valbona Xoxa, Sky Tower 12/3, Rruga "Ibrahim Rugova"*", numri i telefonit 00355672020124 (*në përdorim nga Ajola Xoxa*), si dhe email** amarku@thepartners.al.

**83.3.** Nga praktikat e vëna në dispozicion nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, në disa raste gjëndet dhe korrespondenca e cila ka shërbyer për lëshimin e deklaratave doganore. **Nga dokumentet e vendosura në dispozicion të organit procedues, ka rezultuar se:**

1) Me praktikën doganore *Import 4, me Nr. R11036 datë 26.05.2015*, janë zhdoganuar mallra/produkte të blera nga *Net-A-Porter*, me vlerë produkti 1,665.62 GBP. Taksa Doganore + TVSH është në shumë 73,231 lekë. Në përshkrimin e mallit e cila paraqitet në rubrikën me Nr. 31, përshkruhet "*Veshje personale 6 copë*";

2) Me praktikën doganore *Import 4, me Nr. R13898 datë 29.06.2015*, janë zhdoganuar mallra/produkte të blera nga *ShopBop Madison USA*, me vlerë produkti 1,107 USD. Taksa Doganore + TVSH është në shumë 32,433 lekë. Në përshkrimin e mallit e cila paraqitet në rubrikën me Nr. 31, përshkruhet "*Veshje personale 4 copë*";

3) Me praktikën doganore *Import 4, me Nr. R13897 datë 29.06.2015*, janë zhdoganuar mallra/produkte të blera nga *The Outnet.com*, me vlerë produkti 1,249.58 GBP. Taksa Doganore + TVSH është në shumë 55,877 lekë. Në përshkrimin e mallit e cila paraqitet në rubrikën me Nr 31, përshkruhet "*Veshje personale 4 copë*";

4) Me praktikën doganore *Import 4, me Nr. R14185 datë 01.07.2015*, janë zhdoganuar mallra/produkte të blera nga *Net-A-Porter*, me vlerë produkti 1,756.67 GBP. Taksa Doganore + TVSH është në shumë 78,197 lekë. Në përshkrimin e mallit e cila paraqitet në rubrikën me Nr 31, përshruhet "*Veshje personale 8 copë*";

5) Me praktikën doganore *Import 4, me Nr. R15472 datë 16.07.2015*, janë zhdoganuar mallra/produkte të blera nga *Net-A-Porter*, me vlerë produkti 1,641.64 GBP. Taksa Doganore + TVSH është në shumë 73,509 lekë. Në përshkrimin e mallit e cila paraqitet në rubrikën me Nr 31, përshkruhet "*Veshje personale 16 copë*";

6) Me praktikën doganore *Import 4, me Nr. R15827 datë 21.07.2015*, janë zhdoganuar mallra/produkte të blera nga *Net-A-Porter*, me vlerë produkti 1,670.83 GBP. Taksa Doganore + TVSH është në shumë 74,801 lekë. Në përshkrimin e mallit e cila paraqitet në rubrikën me Nr 31, përshkruhet "*Veshje personale 8 copë*";

7) Me praktikën doganore *Import 4, me Nr. R18255 datë 18.08.2015*, janë zhdoganuar mallra/produkte të blera nga *Net-A-Porter*, me vlerë produkti 1,412.49 GBP. Taksa Doganore + TVSH është në shumë 64,044 lekë. Në përshkrimin e mallit e cila paraqitet në rubrikën me Nr 31, përshkruhet "*Veshje personale 8 copë*";

8) Me praktikën doganore *Import 4, me Nr. R2027 datë 02.02.2016*, janë zhdoganuar mallra/produkte të blera nga *Net-A-Porter*, me vlerë produkti 2.132.09 GBP. Taksa Doganore + TVSH është në shumën 92.902 lekë. Në përshkrimin e mallit e cila paraqitet në rubrikën me Nr. 31, përshkruhet "*Mallra të udhëtarëve jo të një natyre tregtare Veshje personale 10 copë*";

9) Me praktikën doganore *Import 4, me Nr. R3243 datë 18.02.2016*, janë zhdoganuar mallra/produkte të blera nga *Net-A-Porter*, me vlerë produkti 1.558.33 GBP. Taksa Doganore + TVSH është në shumë 67.297 lekë. Në përshkrimin e mallit e cila paraqitet në rubrikën me Nr. 31, përshkruhet "*Mallra të udhëtarëve jo të një natyre tregtare Veshje personale 5 copë*";

10) Me praktikën doganore *Import 4, me Nr. R9871 datë 20.05.2016*, janë zhdoganuar mallra/produkte të blera nga *Net-A-Porter*, me vlerë produkti 3.359.10 GBP. Taksa Doganore + TVSH është në shumën 137.148 lekë. Në përshkrimin e mallit e cila paraqitet në rubrikën me Nr. 31, përshkruhet "*Mallra të udhëtarëve jo të një natyre tregtare Veshje personale 13 copë*";

11) Me praktikën doganore *Import 4, me Nr. R11722 datë 14.06.2016*, janë zhdoganuar mallra/produkte të blera nga *Net-A-Porter*, me vlerë produkti 3.405.00 GBP. Taksa Doganore + TVSH është në shumë 143.518 lekë. Në përshkrimin e mallit e cila paraqitet në rubrikën me Nr 31, përshkruhet "*Mallra të udhëtarëve jo të një natyre tregtare Veshje personale 3 copë*";

12) Me praktikën doganore *Import 4, me Nr. R13559 datë 08.07.2016*, janë zhdoganuar mallra/produkte të blera nga *Net-A-Porter*, me vlerë produkti 1.279.21 GBP. Taksa Doganore + TVSH është në shumën 51.330 lekë. Në përshkrimin e mallit e cila paraqitet në rubrikën me Nr. 31, përshkruhet "*Mallra të udhëtarëve jo të një natyre tregtare Veshje personale 8 copë*";

13) Me praktikën doganore *Import 4, me Nr. R15065 datë 26.07.2016*, janë zhdoganuar mallra/produkte të blera nga *Net-A-Porter*, me vlerë produkti 2.887.20 USD. Taksa Doganore + TVSH është në shumën 84.413 lekë. Në përshkrimin e mallit e cila paraqitet në rubrikën me Nr. 31, përshruhet "*Mallra të udhëtarëve jo të një natyre tregtare Veshje personale 4 copë*";

14) Me praktikën doganore *Import 4, me Nr. R15064 datë 26.07.2016*, janë zhdoganuar mallra/produkte të blera nga *Net-A-Porter*, me vlerë produkti 2.716.93 GBP. Taksa Doganore + TVSH është në shumën 106.092 lekë. Në përshkrimin e mallit e cila paraqitet në rubrikën me Nr. 31, përshkruhet "*Mallra të udhëtarëve jo të një natyre tregtare Veshje personale 12 copë*";

15) Me praktikën doganore *Import 4, me Nr. R18412 datë 08.09.2016*, janë zhdoganuar mallra/produkte të blera nga *Net-A-Porter*, me vlerë produkti 2.712.53 GBP. Taksa Doganore + TVSH është në shumën 102.246 lekë. Në përshkrimin e mallit e cila paraqitet në rubrikën me Nr. 31, përshkruhet "*Mallra të udhëtarëve jo të një natyre tregtare Veshje personale 10 copë*";

SPRIFTJET.AL

16) Me praktikën doganore *Import 4, me Nr. R20671 datë 05.10.2016*, janë zhdoganuar mallra/produkte të blera nga *The Outnet.com*, <u>me vlerë produkti 1.227.25 GBP</u>. Taksa Doganore + TVSH është në shumën <u>48,296 lekë</u>. Në përshkrimin e mallit e cila paraqitet në rubrikën me Nr. 31, përshkruhet "*Mallra të udhëtarëve jo të një natyre tregtare Veshje personale 3 copë*";

17) Me praktikën doganore *Import 4, me Nr. R24049 datë 17.11.2016*, janë zhdoganuar mallra/produkte të blera nga *The Outnet.com*, <u>me vlerë produkti 2.871.50 GBP</u>. Taksa Doganore + TVSH është në shumën <u>101,291 lekë</u>. Në përshkrimin e mallit e cila paraqitet në rubrikën me Nr. 31, përshkruhet "*Mallra të udhëtarëve jo të një natyre tregtare Veshje personale 4 copë*";

18) Me praktikën doganore *Import 4, me Nr. R26094 datë 12.12.2016*, janë zhdoganuar mallra/produkte të blera nga *The Outnet.com*, <u>me vlerë produkti 2.302.50 GBP</u>. Taksa Doganore + TVSH është në shumën <u>85,513 lekë</u>. Në përshkrimin e mallit e cila paraqitet në rubrikën me Nr. 31, përshkruhet "*Mallra të udhëtarëve jo të një natyre tregtare Veshje personale 7 copë*";

19) Me praktikën doganore *Import 4, me Nr. R1943 datë 30.01.2017*, janë zhdoganuar mallra/produkte të blera nga *The Outnet.com*, <u>me vlerë produkti 3.806.33 GBP</u>. Taksa Doganore + TVSH është në shumën <u>138,019 lekë</u>. Në përshkrimin e mallit e cila paraqitet në rubrikën me Nr. 31, përshkruhet "*Mallra të udhëtarëve jo të një natyre tregtare Veshje personale 9 copë*";

20) Me praktikën doganore *Import 4, me Nr. R8309 datë 19.04.2017*, janë zhdoganuar mallra/produkte të blera nga *The Outnet.com*, <u>me vlerë produkti 1.873.53 GBP</u>. Taksa Doganore + TVSH është në shumën <u>70,276 lekë</u>. Në përshkrimin e mallit e cila paraqitet në rubrikën me Nr. 31, përshkruhet "*Mallra të udhëtarëve jo të një natyre tregtare Veshje personale 9 copë*";

21) Me praktikën doganore *Import 4, me Nr. R6658 datë 08.03.2021*, janë zhdoganuar mallra/produkte të blera nga *Net-A-Porter*, <u>me vlerë produkti 1,599.89 GBP</u>. Taksa Doganore + TVSH është në shumën <u>48,148 lekë</u>. Në përshkrimin e mallit e cila paraqitet në rubrikën me Nr. 31, përshkruhet "*Prej leshi apo qimesh te holla kafshësh 3 Cope fustane*". Bashkëlidhur praktikës doganore gjëndet dokumenti me logon e kompanisë DHL, ku në rubrikën e marrësit gjëndet emri "*Valbona Xoxa, Sky Toëer 12/3, Rruga Ibrahim Rugova*" dhe numri i telefonit 00355672020124, email <u>amarku@thepartners.al</u>, si dhe një numër 133174304, i cili tregon llogarinë e blerësit në ëebsiten online të tregtarit-shitës *Net-A-Porter*. Blerja e produkteve konfirmohet nga transaksioni i datës 08.03.2021, <u>pagesë me kartë në vlerë 1,855.75 euro</u>, pagesë komisioni 46.39 euro, blerje "*Net a Porter.com, London...*", nga llogaria bankare me Nr. 48298635102, në monedhën euro, në emër të shtetases Valbona Xoxa;

22) Me praktikën doganore *Import 4, me Nr. R6634 datë 08.03.2021*, janë zhdoganuar mallra/produkte të blera nga *Net-A-Porter*, <u>me vlerë produkti 1,731.34 GBP</u>. Taksa Doganore + TVSH është në shumën <u>55,442 lekë</u>. Në përshkrimin e mallit e cila paraqitet në rubrikën me Nr. 31, përshkruhet "*Përgatitjet e makiazhit të buzëve - 11*

*cope makeup për përdorim personal*" "*7 copë veshje për përdorim personal*" "*1 furçë për aplikimin e kozmetikës*";

**23)** Bashkëlidhur praktikës doganore gjëndet dokumenti me logon e kompanisë DHL, ku në rubrikën e marrësit gjëndet emri "*Valbona Xoxa, Sky Toëer 12/3, Rruga Ibrahim Rugova*" dhe numri i telefonit 00355672020124, email amarku@thepartners.al, si dhe një numër 133174304, i cili tregon llogarinë e blerësit në ëebsiten online të tregtarit-shitës *Net-A-Porter*;

**24)** Pagesa për këto mallra konfirmohet me transaksionin e datës 03.03.2021, pagesë me kartë në vlerë 2,014.13 euro, pagesë komisioni 50.35 euro, blerje "*Net a porter.com, London...*", nga llogaria bankare me Nr. 48298635102, në monedhën euro, në emër të shtetases Valbona Xoxa;

**25)** Me praktikën doganore *Import 4, me Nr. R6737 datë 09.03.2021*, janë zhdoganuar mallra/produkte të blera nga *Net-A-Porter*, me vlerë produkti 1,761.00 GBP. Taksa Doganore + TVSH është në shumë 52,723 lekë. Në përshkrimin e mallit e cila paraqitet në rubrikën me Nr. 31, përshkruhet "*1 copë veshje dhe 1 copë aksesor*". Bashkëlidhur praktikës doganore gjëndet dokumenti me logon e kompanisë DHL, ku në rubrikën e marrësit gjëndet emri "*Valbona Xoxa, Sky Toëer 12/3, Rruga Ibrahim Rugova*" dhe numri i telefonit 00355672020124, email amarku@thepartners.al, si dhe një numër 133174304, i cili tregon llogarinë e blerësit në websiten online të tregtarit-shitës *Net-A-Porter*. Në dokumentin "Commercial Invoice", sipas organit procedues përshkruhet në gjuhë angleze se është blerë një produkt veshje, ndërsa produkti tjetër është dhuratë, *një serum për fytyrë*;

**26)** Me praktikën doganore *Import 4, me Nr. R6946 datë 10.03.2021*, janë zhdoganuar mallra/produkte të blera nga *Net-A-Porter*, me vlerë produkti 1,760.92 GBP. Taksa Doganore + TVSH është në shumë 52,867 lekë. Në përshkrimin e mallit e cila paraqitet në rubrikën me Nr. 31, përshkruhet "*Përgatitjet e makiazhit të buzëve - 1 copë make up për përdorim personal*", "*4 copë veshje për përdorim personal*". Bashkëlidhur praktikës doganore gjëndet dokumenti me logon e kompanisë DHL, ku në rubrikën e marrësit gjëndet emri "*Valbona Xoxa, Sky Toëer 12/3, Rruga Ibrahim Rugova*" dhe numri i telefonit 00355672020124, email amarku@thepartners.al, si dhe një numër 133174304, i cili tregon llogarinë e blerësit në websiten online të tregtarit-shitës *Net-A-Porter*. Në dokumentin "Commercial Invoice", sipas organit procedues përshkruhet në gjuhë angleze se *janë blerë katër fustane për përdorim personal dhe një buzëkuq*;

**27)** Pagesa për këto produkte konfirmohet me transaksionin e datës 02.03.2021, pagesë me kartë në vlerë 2,030.76 euro, pagesë komisioni 50.77 euro, blerje "*Net a porter.com, London...*" nga llogaria bankare me Nr. 48298635102, në monedhën euro, në emër të shtetases Valbona Xoxa;

**28)** Me praktikën doganore *Import 4, me Nr. R8393 datë 24.03.2021*, janë zhdoganuar mallra/produkte të blera nga *Net-A-Porter*, me vlerë produkti 3,135.93 GBP. Taksa Doganore + TVSH është në shumën 93,149 lekë. Në përshkrimin e mallit e cila

paraqitet në rubrikën me Nr. 31, përshkruhet "*9 copë veshje përdorim personal*" "*7 copë produkte kozmetike & 1 copë spraj aromatizues*". Bashkëlidhur praktikës doganore gjëndet dokumenti me logon e kompanisë DHL, ku në rubrikën e marrësit gjëndet emri "*Valbona Xoxa, Sky Toëer 12/3, Rruga Ibrahim Rugova*" dhe numri i telefonit 00355672020124, email amarku@thepartners.al, si dhe një numër 133174304, i cili tregon llogarinë e blerësit në websiten online të tregtarit-shitës *Net-A-Porter*. Në dokumentin "Commercial Invoice", përshkruhen produktet e blera në gjuhën angleze;

29) Me praktikën doganore *Import 4, me Nr. R11713 datë 21.04.2021*, janë zhdoganuar mallra/produkte të blera nga *Net-A-Porter*, me vlerë produkti 1.951.20 GBP. Taksa Doganore + TVSH është në shumën 62.693 lekë. Në përshkrimin e mallit e cila paraqitet në rubrikën me Nr. 31, përshkruhet "*Përgatitjet e makiazhit të syve – 14 copër produkte kozmetike për përdorim personal*", "*5 copë veshje personale*". Bashkëlidhur praktikës doganore gjëndet dokumenti me logon e kompanisë DHL, ku në rubrikën e marrësit gjëndet emri "*Valbona Xoxa, Sky Tower 12/3, Rruga Ibrahim Rugova*" dhe numri i telefonit 00355672020124, email amarku@thepartners.al, si dhe një numër 133174304, i cili tregon llogarinë e blerësit në ëebsiten online të tregtarit-shitës *Net-A-Porter*. Në dokumentin "Commercial Invoice", përshkruhen produktet e blera në gjuhën angleze;

30) Këto mallra konfirmohen të jenë paguar në datë 20.04.2021, pagesë me kartë në vlerë 2.250.82 euro, pagesë komisioni 56.27 euro, blerje "*Net a porter.com, London...*", nga llogaria bankare me Nr. 48298635102, në monedhën euro, në emër të shtetases Valbona Xoxa;

31) Me praktikën doganore *Import 4, me Nr. R11838 datë 22.04.2021*, janë zhdoganuar mallra/produkte të blera nga *Net-A-Porter*, me vlerë produkti 1.970.88 GBP. Taksa Doganore + TVSH është në shumën 59.728 lekë. Në përshkrimin e mallit e cila paraqitet në rubrikën me Nr. 31, përshkruhet "*1 copë bluzë, 1 copë kanatjere, 1 copë fustan*". Bashkëlidhur praktikës doganore gjëndet dokumenti me logon e kompanisë DHL, ku në rubrikën e marrësit gjendet emri "*Valbona Xoxa, Sky Toëer, 12/3, Rruga Ibrahim Rugova*" dhe numri i telefonit 00355672020124, email amarku@thepartners.al, si dhe një numër 133174304, i cili tregon llogarinë e blerësit në ëebsiten online të tregtarit-shitës *Net-A-Porter*. Në dokumentin "Commercial Invoice", përshkruhen në gjuhën angleze produktet e blera;

32) Me praktikën doganore *Import 4, me Nr. R11837 datë 22.04.2021*, janë zhdoganuar mallra/produkte të blera nga *Net-A-Porter*, me vlerë produkti 2.096.31 GBP. Taksa Doganore + TVSH është në shumën 75.307 lekë. Në përshkrimin e mallit e cila paraqitet në rubrikën me Nr. 31, përshkruhet "*1 copë bizhu vathë*" "*2 copë veshje për përdorim personal*". Bashkëlidhur praktikës doganore gjëndet dokumenti me logon e kompanisë DHL, ku në rubrikën e marrësit gjëndet emri "*Valbona Xoxa, Sky Toëer 12/3, Rruga Ibrahim Rugova*" dhe numri i telefonit 00355672020124, email amarku@thepartners.al, si dhe një numër 133174304, i cili tregon llogarinë e



SPAK.GOV.AL

blerësit në ëebsiten online të tregtarit-shitës *Net-A-Porter*. Në dokumentin "Commercial Invoice", përshkruhen në gjuhën angleze produktet e blear;

33) Këto mallra konfirmohen të jenë paguar në datë 20.04.2021, pagesë me kartë në vlerë 2.420.52 euro, pagesë komisioni 60.51 euro, blerje *"Net a porter.com, London..."*, nga llogaria bankare me Nr. 48298635102, në monedhën euro, në emër të shtetases Valbona Xoxa;

34) Me praktikën doganore *Import 4, me Nr. R13876 datë 12.05.2021*, janë zhdoganuar mallra/produkte të blera nga *Net-A-Porter*, me vlerë produkti 1.455.25 GBP. Taksa Doganore + TVSH është në shumën 52.014 lekë. Në përshkrimin e mallit e cila paraqitet në rubrikën me Nr. 31, përshkruhet *"1 copë furcë make up" "3 copë veshje për përdorim personal","16 copë produkte për kujdesin e lekurës"*. Bashkëlidhur praktikës doganore gjëndet dokumenti me logon e kompanisë DHL, ku në rubrikën e marrësit gjëndet emri *"Valbona Xoxa, Sky Toëer 12/3, Rruga Ibrahim Rugova"* dhe numri i telefonit 00355672020124, email amarku@thepartners.al, si dhe një numër 133174304, i cili tregon llogarinë e blerësit në websiten online të tregtarit-shitës *Net-A-Porter*. Në dokumentin "Commercial Invoice", përshkruhen në gjuhën angleze produktet e blera, si fustanë, bluza, produkte make up;

35) Me praktikën doganore *Import 4, me Nr. R14401 datë 17.05.2021*, janë zhdoganuar mallra/produkte të blera nga *Net-A-Porter*, me vlerë produkti 3.428.38 GBP. Taksa Doganore + TVSH është në shumën 100.440 lekë. Në përshkrimin e mallit e cila paraqitet në rubrikën me Nr. 31, përshruhet *"2 copë bluzë, 2 copë funde, 2 copë fustane" "2 copë make up"*. Bashkëlidhur praktikës doganore gjëndet dokumenti me logon e kompanisë DHL, ku në rubrikën e marrësit gjëndet emri *"Valbona Xoxa, Sky Tower 12/3, Rruga Ibrahim Rugova"* dhe numri i telefonit 00355672020124, email amarku@thepartners.al, si dhe një numër 133174304, i cili tregon llogarinë e blerësit në websiten online të tregtarit-shitës *Net-A-Porter*. Në dokumentin "Commercial Invoice", sipas organit procedues përshkruhen në gjuhën angleze produktet e blera, *si fustanë, bluza, produkte make up;*

36) Me praktikën doganore *Import 4, me Nr. R15770 datë 28.05.2021*, janë zhdoganuar mallra/produkte të blera nga *Net-A-Porter*, me vlerë produkti 1.906.60 GBP. Taksa Doganore + TVSH është në shumën 82.053 lekë. Në përshkrimin e mallit e cila paraqitet në rubrikën me Nr. 31, përshruhet *"veshje lëkure 1 copë" "fustan 1 copë", "produkte kozmetike 1 copë"*. Bashkëlidhur praktikës doganore gjëndet dokumenti me logon e kompanisë DHL, ku në rubrikën e marrësit gjëndet emri *"Valbona Xoxa, Sky Toëer 12/3, Rruga Ibrahim Rugova"* dhe numri i telefonit 00355672020124, email amarku@thepartners.al, si dhe një numër 133174304, i cili tregon llogarinë e blerësit në ëebsiten online të tregtarit-shitës *Net-A-Porter*. Në dokumentin "Commercial Invoice", përshkruhen në gjuhë angleze produktet e blera. Pagesa për këto produkte konfirmohet me transaksionin e datës 31.05.2021, pagesë me kartë në vlerë 2.216.89 euro, pagesë komisioni 55.42 euro, blerje *"Net a porter.com, London..."*, nga llogaria bankare me Nr. 48298635102, në monedhën euro, në emër të shtetases Valbona Xoxa;

37) Me praktikën doganore *Import 4, me Nr. R15764 datë 28.05.2021*, janë zhdoganuar mallra/produkte të blera nga *Net-A-Porter*, me vlerë produkti 1,971.71 GBP. Taksa Doganore + TVSH është në shumë 79,557 lekë. Në përshkrimin e mallit e cila paraqitet në rubrikën me Nr. 31, përshruhet *"fustane 2 copë dhe bluzë 1 copë" "veshje këmbe 2 palë dhe një palë vathë"*. Bashkëlidhur praktikës doganore gjëndet dokumenti me logon e kompanisë DHL, ku në rubrikën e marrësit gjëndet emri *"Valbona Xoxa, Sky Toëer 12/3, Rruga Ibrahim Rugova"* dhe numri i telefonit 00355672020124, email amarku@thepartners.al, si dhe një numër 133174304, i cili tregon llogarinë e blerësit në ëebsiten online të tregtarit-shitës *Net-A-Porter*. Në dokumentin "Commercial Invoice", përshkruhen në gjuhën angleze produktet e blera. Pagesa për këto produkte konfirmohet me transaksionin e datës 27.05.2021, pagesë me kartë në vlerë 2,297.41 euro, pagesë komisioni 57.44 euro, blerje *"Net a porter.com, London..."*, nga llogaria bankare me Nr. 48298635102, në monedhën euro, në emër të shtetases Valbona Xoxa.

**83.3.1. Vlera totale e produkteve të blera online e që më pas janë zhdoganuar, për vitin 2015-2021 është 10,769,806.51 lekë. Taksat doganore dhe TVSH e paguar për 32 praktikat e zhdoganimit është në vlerë 2,494,563.00 lekë. Në total, kostoja përfundimtare për mallrat e blerë dhe pagesat pranë doganës, është në shumën 13,264,369 lekë.**

84. Në lidhje me blerjet e bëra nga shtetësja Ajola Xoxa, në fashikullin penal është administruar Shkresa Nr. 11899/1 Prot., datë 21.05.2024, e përcjellë nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, nga ku rezulton se shtetasja **Ajola Xoxa ka kryer 12 praktika doganore për zhdoganimin e mallrave personal nëpërmjet deklaratave doganore *Import4*, të degës Doganore Rinas**. Nga këqyrja e materialit të vënë në dispozicion, evidentohet se mallrat e zhdoganuara nga shtetësja Ajola Xoxa, janë mallra të blerë online tek ***Shopbop, Frank Smythson, Net-a-Porter.com etj.*** Nga praktikat e vëna në dispozicion nga Drejtoria e Përgjithshme e doganave, në disa raste gjëndet dhe korrespondenca e cila ka shërbyer për lëshimin e deklaratave doganore. **Nga dokumentet e vendosura në dispozicion të organit procedues ka rezultuar se:**

1) Me praktikën doganore *Import 4, me Nr. R18202 datë 02.09.2014*, janë zhdoganuar mallra/produkte të blera nga *ShopBop*, me vlerë produkti 1,913.00 USD. Taksa Doganore + TVSH është në shumën 44,947 lekë. Në përshkrimin e mallit që paraqitet në rubrikën me Nr. 31, përshkruhet *"Veshje & sende personale 8 copë"*;

2) Me praktikën doganore *Import 4, me Nr. R27955 datë 30.12.2014*, janë zhdoganuar mallra/produkte të blera nga *Net-A-Porter*, me vlerë produkti 2,191.00 USD. Taksa Doganore + TVSH është në shumën 56,502 lekë. Në përshkrimin e mallit që paraqitet në rubrikën me Nr. 31, përshkruhet *"Veshje personale 4 copë"*;

3) Me praktikën doganore *Import 4, me Nr. R814 datë 15.01.2015*, janë zhdoganuar mallra/produkte të blera nga *Net-A-Porter*, me vlerë produkti 1,191.05 GBP. Taksa Doganore + TVSH është në shumën 45,793 lekë. Në përshkrimin e mallit e cila paraqitet në rubrikën me Nr. 31, përshkruhet *"Veshje personale 3 copë"*;

4) Me praktikën doganore *Import 4, me Nr. R815 datë 15.01.2015*, janë zhdoganuar mallra/produkte të blera nga *Net-A-Porter*, me vlerë produkti 1.876,83 GBP. Taksa Doganore + TVSH është në shumën 76.258 lekë. Në përshkrimin e mallit e cila paraqitet në rubrikën me Nr. 31, përshkruhet *"Veshje personale 9 copë"*;

5) Me praktikën doganore *Import 4, me Nr. R1739 datë 27.01.2015*, janë zhdoganuar mallra/produkte të blera nga *Net-A-Porter*, me vlerë produkti 977,00 USD. Taksa Doganore + TVSH është në shumën 27.906 lekë. Në përshkrimin e mallit e cila paraqitet në rubrikën me Nr 31, përshkruhet *"Veshje personale 2 copë"*;

6) Me praktikën doganore *Import 4, me Nr. R57056 datë 19.07.2016*, janë zhdoganuar mallra/produkte të blera nga *MHL Creation Factory Bucharest*, me vlerë produkti 603,33 USD. Taksa Doganore + TVSH është në shumën 20.571 lekë. Në përshkrimin e mallit e cila paraqitet në rubrikën me Nr. 31, përshkruhet *"Fustan 1 copë"*;

7) Me praktikën doganore *Import 4, me Nr. R2576 datë 31.01.2019*, janë zhdoganuar mallra/produkte të blera nga *Matchesfashiton.com*, me vlerë produkti 2.017,64 GBP. Taksa Doganore + TVSH është në shumën 58.527 lekë. Në përshkrimin e mallit e cila paraqitet në rubrikën me Nr. 31, përshkruhet *"Fustan 1 copë"*. Bashkëlidhur praktikës doganore gjendet dokumenti me logon e kompanisë DHL, ku në rubrikën e marrësit gjendet emri *"Ajola Xoxa, Rezidenca Kodra e Diellit, Rruga e Trëndafilave Nr. 94,"* dhe numri i telefonit 00355672020124, email ajolaxoxa@gmail.com;

8) Me praktikën doganore *Import 4, me Nr. R7805 datë 29.03.2019*, janë zhdoganuar mallra/produkte të blera nga *Frank Smythson LTD*, me vlerë produkti 233.33 EUR. Taksa Doganore + TVSH është në shumë 7.512 lekë. Në përshkrimin e mallit e cila paraqitet në rubrikën me Nr. 31, përshkruhet *"Ditar 1 copë"*. Bashkëlidhur praktikës doganore gjendet dokumenti "Commercial Invoice", ku në rubrikën e blerësit gjendet emri *"Ajola Xoxa, Sky Tower 13/4, Rruga Ibrahim Rugova,"* dhe numri i telefonit 00355672020124, email ajolaxoxa@gmail.com;

9) Me praktikën doganore *Import 4, me Nr. R33944 datë 21.12.2019*, janë zhdoganuar mallra/produkte të blera nga *Frank Smythson LTD*, me vlerë produkti 220 GBP. Taksa Doganore + TVSH është në shumën 7.496 lekë. Në përshkrimin e mallit e cila paraqitet në rubrikën me Nr. 31, përshkruhet *"Ditar 1 copë"*. Bashkëlidhur praktikës doganore gjëndet dokumenti "Commercial Invoice", ku në rubrikën e blerësit gjëndet emri *"Ajola Xoxa, Sky Toëer 13/4, Rruga Ibrahim Rugova,"* dhe numri i telefonit 00355672020124, email ajolaxoxa@gmail.com;

10) Me praktikën doganore *Import 4, me Nr. R15947 datë 21.06.2019*, janë zhdoganuar mallra/produkte të blera nga *Matchesfashion.com*, me vlerë produkti 1.497,00 GBP. Taksa Doganore + TVSH është në shumën 44.439 lekë. Në përshkrimin e mallit e cila paraqitet në rubrikën me Nr. 31, përshkruhet *"3 copë fustane"*. Bashkëlidhur praktikës doganore gjëndet dokumenti me logon e kompanisë DHL, ku në rubrikën e marrësit gjëndet emri *"Ajola Xoxa, Rezidenca Kodra e Diellit, Rruga e Trëndafilave Nr. 94,"* dhe numri i telefonit 00355672020124, email ajolaxoxa@gmail.com;

**11)** Me praktikën doganore *Import 4, me Nr. R25667 datë 24.08.2021*, janë zhdoganuar mallra/produkte të blera nga *Luisa Via Roma Spa*, <u>me vlerë produkti 1,542.00 EUR</u>. Taksa Doganore + TVSH është në shumën <u>40,974 lekë</u>. Në përshkrimin e mallit e cila paraqitet në rubrikën me Nr. 31, përshkruhet "2 *copë fustane*". Bashkëlidhur praktikës doganore gjëndet dokumenti me logon e kompanisë DHL, ku në rubrikën e marrësit gjëndet emri "*Ajola Xoxa, Rezidenca Kodra e Diellit, Rruga e Trëndafilave Nr. 94,*" dhe numri i telefonit 00355672020124, email <u>ajolaxoxa@gmail.com</u>, si dhe një numër 105086011, i cili tregon llogarinë e blerësit në websiten online të tregtarit-shitës *Luisa Via Roma Spa*,

**12)** Me praktikën doganore *Import 4, me Nr. R25667 datë 24.08.2021*, është kryer pagesa për telefonin e harruar, i cili është deklaruar <u>me vlerë 1,600 euro</u>. Bashkëlidhur praktikës doganore, me laps, është bërë shënimi *Telefon i Harruar*, prandaj është paguar vetëm dogana në lidhje me këtë praktikë.

84.1. **<u>Vlera totale e produkteve të blera online nga shtetësja Ajola Xoxa e që më pas janë zhdoganuar, për vitin 2014-2021 është 1,916,215 lekë. Taksat doganore dhe TVSH e paguar për 12 praktikat e zhdoganimit është në vlerë 472,486 lekë. Në total, kostoja përfundimtare për mallrat e blerë dhe pagesat pranë doganës, është në shumën 2,388,701 lekë.</u>**

85. Nga këqyrja e sistemit *Asicuda*, referuar procesverbalit të datës 13.01.2025, evidentohet se **"Ava Studio" shpk ka realizuar 9 praktika zhdoganimi që i përkasin periudhës Mars 2023-Mars 2024.** Nga këqyrja e këtyre praktikave rezulton se janë kryer zhdoganime të cilat i përkasin blerjeve të bëra në ***Net-A-Porter.com (8 raste) dhe Smythson***, për veshje, bikini, makiazh, bizhu, në shumën prej <u>2,466,763 lekë</u> plus pagesat e doganës në shumën <u>564,631 lekë</u>. Totali i blerjeve rezulton <u>3,031,394 lekë</u>.

**86. <u>Në total, blerjet e bëra online nga Erald Ismaili (Ajola Xoxa), Valbona Xoxa, Ajola Xoxa dhe "Ava Studio" në pronësi ligjore të shtetases Valbona Xoxa, por e kontrolluar faktikisht nga Ajola Xoxa, kapin shifrën e 86,721,175 lekë.</u>**

87. Gjatë deklarimit në cilësinë e personit që ka dijeni për veprën penale shtetësja **<u>Adela Kondakçiu</u> në lidhje me shtetasin Erald Ismaili, deklaruesja ka treguar se si stafi kanë paguar cash zhdoganimet e Eraldit me urdhër apo me kërkesë të Ajolës. Lekët për pagesat e doganave i jepte gjithmonë Ajola. Nga paketimi ka konstatuar se ishin marka të shtrenjta të rrobave.**

**88.** Gjatë deklarimit në cilësinë e personit që ka dijeni për veprën penale shtetasi **<u>Erald Ismaili</u>** ka deklaruar se bën një jetë modeste, me të ardhura familjare rreth 2,400,000 lekë në vit si dhe nuk disponon automjet për shkak se makina është shpenzim i madh për të. I pyetur nëse kishte blerë ndonjëherë rroba të markave si Louis Vuitton apo Prada, shtetasi Erald Ismaili e mohon një gjë të tillë. I ballafaquar me faktin se për vitet 2016 deri në vitin 2021, në emër të tij janë paguar produkte të cilat janë zhdoganuar me 130 praktika doganore, në vlerë 55,414,409 lekë, pa përfshirë pagesat doganore (Tvsh etj.,) **deklaruesi është shprehur i habitur dhe <u>ka sqaruar se këto blerje nuk janë bërë nga ana e tij, por nga shtetësja Ajola Xoxa</u>. Deklaruesi kujton se i ka dhënë Ajolës njëherë kartën e identitetit, pasi e kërkonte posta, por nuk ka dijeni se si është përdorur.** Ky deklarim është në unitet me të gjitha provat e tjera të administruara pasi **shtetasi Erald Ismaili nuk ka asnjë**

**mundësi financiare për të bërë blerje online të veshjeve dhe sendeve të tjera personale, si make up etj, në një vlerë të përgjithshme prej rreth 65.000.000 lekë në harkun kohor të rreth 4 viteve (bashkë me TVSH).**

- ***Lidhur me komunikimet e shtetases Adela Kondakçiu në aplikacionin Whatsapp që provojnë krijimin e skemës së përfitimit të parregullt dhe pastrimit të produkekteve nga veprimtaria kriminale.***

**89.** Në fashikullin penal, nëpërmjet procesverbalit për marrjen e akteve nga një procedim tjetër (189/2023) datë 10.12.2024, sipas vendimit përkatës të prokurorit, janë administruar komunikimet e shtetases Adela Kondakçiu më disa shtetas të tjerë. Këto komunikime janë përftuar nga telefoni celular i kësaj shtetase, me kartë *SIM 0676020980 IMEI 358798485112178* dhe *IMEI2 35879848582650*, i sekuestruar për qëllime provuese në kuadër të një tjetër procedimi penal.

**90.** Nga komunikimet që shtetësja **Adela Kondakçiu ka patur me shtetasen Ajola Xoxa** kanë rezultuar të dhëna me mjaft interes për hetimin. Nga këto komunikime rezulton se pronarja përfituese faktike e kompanisë OJF "Harabel" është shtetësja Ajola Xoxa. Shtetasi Driant Zeneli, me detyrë Drejtor Ekzekutiv i kompanisë është plotësisht i papërfshirë në të gjitha vendimmarrjet, si ato që lidhen me menaxhimin financiar të kompanisë ashtu edhe me organizimin e eventeve të cilat kjo kompani angazhohet të kryejë. Po ashtu, plotësisht të papërfshirë rezultojnë edhe anëtarët e tjerë të Bordit të kësaj organizate.

**90.1.** Nga komunikimet rezulton e qartë se financierja Adela Kondakçiu i kërkon lejen e shtetases nën hetim Ajola Xoxa për të kryer pagesat e Drejtorit ekzekutiv Driant Zeneli. Po kështu, nga komunikimet provohet plotësisht se personi që kontrollon efektivisht kompaninë "Nan" shpk është përsëri shtetësja Ajola Xoxa. Shoqëria në fjalë, pasi është themeluar nga shtetasi Driant Zeneli, i është dhuruar prej këtij të fundit OJF-së Harabel, të kontrolluar nga Ajola Xoxa. Nga aktet rezulton se **financierja Adela Kondakçiu merr një urdhër të prerë nga shtetësja Ajola Xoxa** ***për të pyetur atë për çdo gjë dhe jo Driantin (shih faqen 140 të komunikimeve).*** Shtetësja Ajola Xoxa shkon dhe më tej kur i thotë financieres së saj se ***ajo nuk duhet të marri as lekët për një kafe pa e pyetur atë më parë (shih faqen 145).*** Gjithashtu, shtetësja Ajola Xoxa urdhëron që pagesat në formë CASH të kompanisë "Harabel" dhe "Benussi" do mbahen nga ajo dhe ***Adela (Kondakçiu) nuk duhet të pranojë shtetasin Driant Zeneli në asnjë rast (faqe 147).***

**90.2. Fiktiviteti i faturave për të cilat shtetësja Ajola Xoxa kërkon të lëshohen për subjekte të caktuara,** shkon edhe më tej, ndërsa i kërkon financieres së saj që kontratën për pronën ku ka selinë kompania **"Harabel"**, ta përpilojë duke vendosur gjysmën e çmimit. Pasi shtetësja Adela Kondakçiu i konfirmon ***se kontrata është bërë për çmimin 500 euro, shtetësja Ajola Xoxa i thotë "ok"*** *(faqe 174).* Po kështu, provohet se edhe për vendimmarrje rutinë siç është pagesa e internetit për kompaninë "Harabel", shtetasi Driant Zeneli nuk përfshihet në asnjë moment. Kjo pagesë i kërkohet shtetases Ajola Xoxa për një periudhe kohe 6 mujore.

**91. Ajo çfarë paraqet interes në drejtim të lëvizjes së të hollave brenda rrethit të ngushtë familjar të titullarit të bashkisë Tiranë, janë disa faturime që shtetësja Ajola Xoxa i bën kompanisë së shtetasit Arbër Veliaj, vëllait të kryetarit të bashkisë Erion**

**Veliaj. Në një rast (mes shumë rasteve të tjera), për kryerjen e "konsulencës ligjore", kunata e shtetasit Arbër Veliaj, Ajola Xoxa, i faturon kompanisë "Gogel" që administrohet nga ky shtetas, një shumë prej 8.000 euro (faqe 211).** Nga ana e saj, financierja **Adela Kondakçiu** duke patur në konsideratë shumat e akumuluara nga kompania "Harabel" për shkak të sponsorizimeve, **i kujton shtetases Ajola Xoxa se kjo OJF nuk duhet të dalë me** fitim, **për shkak se** ligji **nuk e lejon, kështu që shumat duhet të shpërndahen në persona të ndryshëm** (faqe 247). **Ky komunikim provon sa është pasqyruar më lart, në drejtim të konfigurimit të skemës së xhirimit të të hollave nga dhe për OJF-të e krijuara dhe menaxhuara nga shtetësja Ajola Xoxa, tek dhe për entitete të tjera, ku përfshihen vetë ajo,** shoqëri me përgjegjësi të kufizuar të saj dhe familjarëve të saj apo dhe persona të tjerë fizikë, të lidhur ngushtë më të.

**91.1. Në një pjesë të mirë të komunikimeve evidentohet qartë vendimmarrja e shtetases Ajola Xoxa përsa i përket spostimeve fiktive të punonjësve nga një kompani tek tjetra, ato të cilat kjo shtetase menaxhon, për të rregulluar në këtë mënyrë shpenzimet e tyre** (faqe 274). **Në lidhje me shtetasen Ketrina Braho, e cila ka qenë punonjëse e Harabel, shtetësja Ajola Xoxa i komunikon shtetases Adela Kondakçiu se do e sigurojnë me pagën minimale dhe pjesën tjetër të pagës do ja japin CASH në dorë** (faqe 278). Në faqet 311-312 të komunikimeve të zhvilluara mes këtyre dy shtetaseve, evidentohet vijimësia e marrëdhenies fiktive financiare me kompaninë "Gogel", së cilës shtetësja Ajola Xoxa i faturon një tjetër shërbim prej 2.000.000 lekë. **Ky fiktivitet në lëshimin e faturave për kompaninë "Gogel" provohet ndërsa shtetësja Ajola Xoxa i kërkon financieres që të prodhojë një faturë me një datë të mëvonshme, 1 javë më pas nga dita e komunikimit mes tyre, që ka ndodhur më datë 17.12.2019. (faqe 338).** Nga ana tjetër, shtetësja Adela Kondakçiu e pyet për përshkrimin që duhet të vendosi në faturë, dhe përgjigja e ardhura nga Ajola Xoxa, me *voice message* është *"sipas kontratës"*. (faqe 340). Për të mos kaluar pragun e xhiros, shtetësja Ajola Xoxa urdhëron që fatura të tjera të bëhen në janar, pra jo në momentin që shërbimi është kryer, në mënyrë që të mos paguajë tatimet shtesë. **Përsëri kompania "Gogel" faturohet nga "Partners Law" për shumën 4.000.000 lekë, me përshkrimin "konsulencë ligjore". (faqe 347).**

92. Pagesa të tjera qiraje evidentohen edhe nga këto komunikime, përveç dokumenteve bankarë të paraqitur më lart. **Interesant paraqitet pagesa e qirasë prej kompanisë "Harabel". Në një rast, shtetësja Adela Kondakçiu njofton bashkëbiseduesen se ka bërë kalimin e qirasë për kompaninë "Harabel", prej 1.500 euro. Pra, thënë ndryshe, e njëjta financiere që mbulon kompaninë "Partners Laë" mbulon edhe kompaninë "Harabel", duke kaluar nga kjo e fundit një pagesë për qira mujore në favor të "Partners Law". Deri këtu nuk do kishte ndonjë gjë të gabuar, por nga hetimi ka rezultuar e provuar se pronarja përfituese faktike e kompanisë "Harabel" është shtetësja Ajola Xoxa.** **<u>Në këtë mënyrë, kjo e fundit, vendos të kalojë nga një OJF në zotërim faktik të saj tek një kompani tjetër (sh.p.k.) në zotërim faktik dhe ligjor të saj, një shumë të hollash si pagesë mujore qiraje.</u>**

93. **Sipas organit procedues, fiktiviteti i qartë i këtij veprimi apo dhe gjithë veprimeve të tjera të kryera mes këtyre dy subjekteve, përsa i përket pagimit të qirasë, të cilat do të përshkruhen më poshtë, të krijon dyshimin e arsyeshëm të bazuar në prova se në këtë mënyrë, të hollat e përfituara nga kompania "Harabel" si përfitim i**



SPORTEL.AL

**paligjshëm, pastrohen si produkt i veprës penale duke u injektuar në llogaritë bankare të shtetases Ajola Xoxa, si pagesë për qira.** Akoma më peshë merr ky fakt duke patur në konsideratë edhe rezultatet e përftuara nga kontrolli i ushtruar më datë 06.12.2024 në banesën e ndodhur në Rr. "Brigada 8", Tiranë, e deklaruar si adresë selie e kompanisë "Harabel" dhe "Ava Studio" sh.p.k., në pronësi të shtetases Ajola Xoxa. Nga fotot që kanë dokumentuar kontrollin e ambientit në fjalë, konstatohet fare qartë se apartamenti nuk ishte i përshtatur në asnjë hapësire të tij si zyrë apo seli e ndonjë kompanie. Asnjë dokument, post pune, kompjuter apo çdo lloj mjeti tjetër që nevojitet për mbarëvajtjen dhe funksionimin normal të një biznesi, nuk u gjet nga hetuesit e Byrosë të cilët ushtruan kontrollin e miratuar nga Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë. Si rrjedhojë, nga këta të fundit nuk u bë e mundur të sigurohet nëpërmjet sekuestros asnjë e dhënë konkrete në lidhje me këto dy kompani. **Por, përkundrazi, e gjithë baza dokumentare e tyre u gjet dhe u sekuestrua pranë zyrave të "Partners Laë" në administrim të shtetases Ajola Xoxa.**

94. Komunikimet rezultojnë të ngjeshura edhe përsa i përket urdhrave që shtetësja Ajola Xoxa jep në lidhe me pagesa CASH që duhet të kryhen për persona fizikë (faqe 378-379), vendosje page minimale prej 30.000 lekë për një punonjëse të quajtur Eisa (faqe 424) etj. **Po kështu, interes paraqesin këto komunikime përsa i përket menaxhimit faktit që shtetësja Ajola Xoxa bën për kompaninë (sh.p.k.) që në dokumentet ligjorë i përket nënës së saj, Valbona Xoxa, "Ava Studio" shpk.** Në të gjitha komunikimet e pasqyruara në faqet 512-513, 514, evidentohet qartë kjo marrëdhënie dhe zotërimi faktik i shoqërisë tregtare prej shtetases nën hetim. **Në asnjë komunikim, jo vetëm mes këtyre shtetasve, por edhe mes shtetases Adela Kondakçiu dhe punonjësve të tjera të zyrës, nuk konstatohet në asnjë çast që shtetësja Valbona Xoxa të merret jo vetëm me aspektin financiar të shoqërisë por edhe me asnjë aspekt tjetër organizativ apo të çfarëdo natyre.**

**95. Gjithashtu, nga komunikimet e administruara në fashikullin penal, në faqen 612 të tyre, sipas organit procedues rezulton një fakt me mjaft interes për hetimin dhe që lidhet me shtetasin Elman Abule, njohje e afërt e titullarit të bashkisë Tiranë, shtetasit Erjon Veliaj dhe përfitues lejesh ndërtimi nga në territorin që mbulon kjo bashki.** Më datë **15.12.2020** nga biseda rezulton se shtetasi Vladimir Avrami, ortak në shoqërinë "Ventus", në të cilën rezulton ortak shoqëria "Fidalba" në pronësi të shtetasit Elman Abule, kalon në llogarinë e "Partners Laë" një shumë prej 24.000 euro, me përshkrimin "*pagese fature nr. 52 dt. 25.11.2020 si ortak i shoqërisë "Salus Konstruksion" sh.p.k*". Në këtë rast, ajo që duket si pagesë nga një shoqëri, në fakt është pagesë që urdhërohet nga llogaria personale e një individi (shtetasi Vladimir Avrami), i cili edhe pse zotëron vetëm 43% të aksioneve të shoqërisë, pra as ortak mazhoritar, në pjesën përshkruese të formularit "Urdhër Transferte" me nr. Reference 010TIR-025410, shprehet se po paguan një faturë për llogari të "Salus Konstruksion" sh.p.k. si ortak.

**96. Më tej, për të kuptuar sesi ka funksionuar mekanizmi i injektimit të shumave të parave në llogarinë e OJF-së "Harabel", që menaxhohet në të gjitha aspektet nga shtetësja Ajola Xoxa, mjafton t'i referohesh komunikimeve mes kësaj të fundit dhe financieres Adela Kondakçiu në faqen 667-670-671.** Nga këto komunikime por edhe screenshotet e printuara të nxjerra nga të njëjtat komunikime, rezulton se shtetaset Greta Domi dhe Ines Dani, të dy Persona Fizikë, të cilët ushtrojnë aktivetin e tyre privat me karakter fitimprurës, në ambientet e "Partners Laë", kanë bërë dy pagesa të konsiderueshme

në lekë. **Konkretisht, personi fizik Greta Domi ka depozituar në llogarinë e Qendrës "Harabel" një shumë prej 742,380 lekë më datë 14.12.2020.** Arsyet e pagesës, sipas përshkrimit bankar, janë *"pagesë fature nr. 02 datë 30.11.2020"*. Pra, e thënë ndryshe, një Person Fizik avokat- Greta Domi, njeri i afërt i shtetases Ajola Xoxa (kujtojmë këtu se ambienti ku personi fizik ushtron aktivitetin e saj i është dhënë me huapërdorje pa shpërblim nga shtetësja Ajola Xoxa, në brendësi të zyrave të "Partners Laë" në godinën "Sky Toëer), i kalon një OJF-je si "Harabel", në pronësi faktike të shtetases Ajola Xoxa, një shumë të konsiderueshme me motivacionin *"pagesë fature"*. Ajo çfarë **nuk kuptohet në këtë mes, është çfarë shërbimi mund t'i ofrojë një OJF që merret me organizime eventesh artistike një personi fizik në fushën e avokatisë, për të cilat më pas ky i fundit detyrohet të paguajë një shumë të tillë të hollash.** Sipas organit procedues ky version nuk mund të jetë i besueshëm, fakt ky që përforcohet edhe me tepër nga komunikimet që konstatohen në faqen 670-671-681. Pasi njihet me përshkrimin e bërë në bankë, i cili i referohet një fature me numër dhe datë, **shtetësja Ajola Xoxa reagon duke i thënë financieres se duhej vendosur si "sponsorizim" dhe jo "pagesë fature". Gjithashtu, ajo i thotë se tek Qendra "Harabel"** asnjë sponsor nuk duhet të shënohet si *"pagesë fature"*.

96.1. **Kur shtetësja Greta Domi është pyetur në kuadër të hetimit paraprak, si person që ka dijeni për veprën penale, për arsyet e transferimit të kësaj shume, është përgjigjur në koherencë të plotë me vërejtjen e bërë nga shtetësja Ajola Xoxa për financieren, duke thënë se, për shkak të mirënjohjes njerëzore** që **lidhet me dhënien e ambientit pa qira ku ushtron aktivitetin, i ka kaluar në formë sponsorizimi Qendrës "Harabel" shumën prej 742.378 lekë, pra as 700.000 lekë, as 750.000 lekë dhe as 800.000 lekë.** Në të njëjtat deklarime kjo shtetase shprehet se ka jetuar modestisht, duke patur shumë detyrime familjare qe lidhen me fëmijët, kredi për të paguar etj. Megjithatë, e pyetur për cilin event artistik është bërë ky sponsorizim, shtetësja Greta Domi është shprehur se nuk i kujtohet, pavarësisht se ky rezulton të jetë i vetmi "sponsorizim" i bërë nga kjo shtetase në jetën e saj.

96.2. **Megjithatë, vetëm tre ditë përpara datës së lëshimit faturës, pra, më datë 27.11.2020, për personin fizik Greta Domi, është bërë një kalim bankar nga shoqëria "Fusha" sh.p.k., në vlerën 1.336.284 lekë, me përshkrimin "lik. Fature".** Menjëherë pas kësaj, rreth një javë më vonë, shtetësja Greta Domi tërheq nga kjo llogari "pagesën e saj mujore" prej 120.000 lekë. Po në këtë datë bëhet dhe pagesa në vlerën 113.048 lekë, me përshkrimin "tatim mbi vlerën e shtuar Nëntor 2020". **Pra, rezulton e provuar se nga totali prej 1.336.284 lekë, shtetësja Greta Domi pasi ka hequr "pagesën" e saj mujore dhe pagesën e TVSH, thuajse të gjithë pjesën e mbetur ja ka transferuar Qendrës "Harabel".** Thënë ndryshe, **pasi paguhet nga një shoqëri tregtare si "Fusha" sh.p.k., shoqëri kjo e cila përfiton fonde publike nga Bashkisë Tiranë, shtetësja Greta Domi kalon më pas një pjesë të konsiderueshme të të hollave në llogarinë e një kompanie OJF të zotëruar faktikisht nga shtetësja Ajola Xoxa.**

96.3. **I njëjti mekanizëm është konstatuar edhe për Personin tjetër Fizik, shtetasen Ines Dani, e lidhur ngushtë me shtetasen Ajola Xoxa. Edhe kjo shtetase rezulton që më datë 14.12.2020 ka bërë një "pagesë fature" prej 593.904 lekë në favor të Qendrës "Harabel".** Sipas organit procedues, interesant këtu është fakti se të dy këta persona fizikë, shtetaset Greta Domi dhe Ines Dani, edhe pse entitete të ndryshme tregtare,



SPORTELI.AL

por të provuara si lidhje të ngushta më shtetasen Ajola Xoxa (në fakt thjesht punonjëse të kësaj të fundit), **kanë lëshuar në të njëjtën datë, 30.11.2020, dy fatura në rend kronologjik, 2 dhe 3, dhe më pas, në të njëjtën datë, 14.12.2020 kanë bërë likujdimin e këtyre faturave, që sipas tyre më pas duhet të konsiderohen si "sponsorizime".**

**96.4.** Lidhja e ngushtë, ose thënë më mirë "kontrolli" që shtetësja Ajola Xoxa ka efektivisht mbi veprimtarinë profesionale të këtyre dy Personave Fizikë, provohet nga komunikimet që përmban faqja 709. **Në to flitet për një kontratë që shtetësja Ines Dani, si person fizik, ka lidhur me bashkinë Fier.** Objekti është "Ekspertizë e jashtme për propozim ligjesh". **Për këtë shërbim, Personi Fizik Ines Dani do të paguhej 24.650 Euro.** Në këtë pikë, duket se shtetësja Ines Dani nuk ka asnjë nuk ka asnjë përfshirje në vendimmarrje.

**96.4.1. Konkretisht, financierja Adela Kondakçiu i merr leje shtetases Ajola Xoxa për të proceduar ose jo me faturën që lidhet me këtë kontratë, duke i dërguar më pas në format *pdf* një kopje të aktit.** Nga ana e saj, shtetësja Ajola Xoxa e pyet nëse në kontratë parashikohet e gjithë vlera apo do paguhet në 2 këste. **Pra, rezulton e qartë se personi që vendos për lëshimin e faturës dhe interesohet në vazhdimësi për likujdimin e shumës së të hollave (faqja 724), nuk është personi fizik Ines Dani, siç në fakt duhet të funksionojë, por shtetësja Ajola Xoxa.** Kjo e fundit, referuar faqes 726 te komunikimeve, shqetësohet madje për pagesën e TVSH të pagesës së shtetases Ines Dani nga Bashkisë Fier, duke thënë se **"nuk do që të paguajë kot TVSH". Më tej, në faqen 760-761 të komunikimeve, shtetësja Adela Kondakçiu njofton shtetasen Ajola Xoxa se fatura e Inesit ishte likujduar. Madje, ajo vijon duke i thënë se Inesi donte të kthente një pjesë të lekëve të Ajola në formë CASH. <u>Por, në këtë pikë, shtetësja Ajola Xoxa ndërhyn duke thënë se do fliste vetë me Inesin të nesërmen.</u> Këto komunikime, përforcojnë më tej faktin se këto dy shtetase, Greta Domi dhe Ines Dani, janë thjesht punonjëse të shtetases Ajola Xoxa, dhe regjistrimi i tyre si Persona Fizikë është bërë vetëm me qëllimin e kalimit të fondeve prej entiteteve publike dhe private, në favor të kësaj të fundit.**

97. Më tej, nga komunikimet rezulton një fakt tjetër me interes për çështjen, i ballafaquar ky edhe me dokumentet bankare. **Konkretisht, në faqen 720 të këtyre komunikimeve, shtetësja Ajola Xoxa i kërkon financieres të bëjë një faturë prej 15.000 euro për shoqërinë "Sapientia" sh.p.k. Kujtojmë këtu se, kjo shoqëri zotërohet nga shtetësja Marisa Nito.** Kjo e fundit është bashkëshortja e shtetasit Elman Abule, njohje e afërt e kryetarit të bashkisë Tiranë, shtetasit Erjon Veliaj. Edhe vetë kjo shtetase, rezulton të jetë njohje e afërt e shtetases Ajola Xoxa. Pra, nga shoqëritë e zotëruara nga bashkëshortët Abule-Nito, ku të paktën njëra prej tyre rezulton të jetë përfituese nga Bashkia Tiranë, kalojnë një pjesë e madhe fondesh në favor të "Partners Laë", por, siç rezulton në vijim edhe në favor të shoqërive të tjera të familjarëve të afërt të Ajola Xoxës, por të kontrolluara faktikisht nga kjo e fundit.

97.1. Konkretisht, nga leximi i transaksioneve bankare të shoqërisë "Partners Laë" evidentohet transferta e datës **13.04.2021 nga** shoqëria "Sapientia" në vlerën 15.000 euro, me përshkrim *"likujdim fature nr. 62 datë 26.03.2021" (pjesore)*. Po të kthehemi tek fatura në fjalë, konstatohet se ajo është lëshuar nga "Partners Laë" për vlerën 18.000 euro. **Por me interes për hetimin në këtë rast është përshkrimi i bërë në faturë *"konsulencë ligjore"*. Kjo paraqet interes, pasi po të shihet objekti i aktivitetit të shoqërisë "Sapientia" sh.p.k., konstatohet se "konsulenca ligjore" ofrohet nga vetë kjo shoqëri. Pra, një**

**shoqëri që themelohet për të ofruar ndër të tjera edhe konsulencë ligjore, paguan një**
**shoqëri tjetër me një shumë të konsiderueshem për qëllime *"konsulence ligjore"*. I**
**njëjti mekanizëm ka funksionuar edhe me shoqëritë e tjera të shtetasit Elman Abule,**
**"Rametal", "Ventus", të cilët kanë paguar shuma të konsiderueshme në favor të**
**"Partners Laë" për "konsulencë ligjore".** Sipas organit procedues të gjitha kontratat e
përpiluara nga palët dhe të evidentuara nga kontrolli i ushtruar në zyrën e "Partners Law"
janë akte private, të panoterizuara, duke krijuar në këtë mënyrë dyshimin e arsyeshëm se janë
prodhuar fiktivisht për të justifikuar kalimet bankare të ndodhura.

**98.** Nga komunikimet provohet kontrolli i plotë i shtetases Ajola **Xoxa** mbi shoqërinë
e krijuar nga nëna e saj, shtetësja Valbona Xoxa, "Ava Studio". Forma tregtare e kësaj
shoqërie, ndryshe nga ajo e organizatave fitimprurëse si "Qendra Harabel" është me
përgjegjësi të kufizuar, pra, për të siguruar fitime nga veprimtaria tregtare. Por nga ana tjetër,
edhe kjo shoqëri e krijuar nga një familjar shumë i afërt i shtetases Ajola Xoxa, por që
menaxhohet faktikisht nga kjo e fundit (*siç do të provohet në vijim*), ka për objekt kryesor të
aktivitetit të saj organizimin e eventeve artistike. **Konkretisht, në faqen 764 të
komunikimeve <u>evidentohet fakti se në llogarinë e "Ava Studio" sh.p.k. figuron i
regjistruar numri personal i shtetases Ajola Xoxa</u>. Gjithashtu, financierja Adela
Kondakçiu pyet shtetasen Ajola Xoxa nëse një pagesë duhet të bëhet tek "AVA Studio"
apo jo. (faqe 783). Po kështu, është shtetësja Ajola Xoxa ajo e cila urdhëron financieren
Adela Kondakçiu të bëjë një pagesë për detyrim doganor, për mallra të ardhura në
emër të shtetases Valbona Xoxa (individ).** Vetëm detyrimi doganor në këtë rast rezulton të
jetë **73.340 lekë** dhe do të paguhet nga "Ava Studio" sh.p.k. sipas urdhrit të dhënë nga
shtetësja Ajola Xoxa. Në fakt, blerjet e kryera në emër të "Ava Studio", si person juridik, siç
do të shpjegojmë në vijim, janë të konsiderueshme në numër dhe vlera. **Këto blerje janë
realizuar në faqen online të rrjetit të dyqaneve *Net-a-Porter*, dyqane këto që duket se
nuk kanë ndonjë lidhje me objektin e aktivitetit të shoqërisë. Përkundrazi, sipas organit
procedues ky rrjet dyqanesh luksi tregton veshje, aksesorë, këpucë, çanta, kozmetikë
dhe produkte bukurie dhe është i njohur për zgjedhjen ekskluzive të markave luksoze
dhe stilistëve të njohur botërorë.**

**98.1.** Në platformën online, nga ku rezulton të jenë kryer blerjet nga "Ava Studio"
shpk, mund të gjënden rroba të dizajnerëve *si fustane, xhaketa, bluza dhe kostume, këpucë të
koleksioneve të fundit, përfshirë sandale, çizme dhe atlete, aksesorë luksi si ora, bizhuteri,
syze dielli dhe shalla, çanta dizajnerësh përfshirë ato të markave ikonike si Gucci, Prada dhe
Balenciaga, produkte bukurie si grimi, kujdesi për lëkurën dhe parfumet*. Sipas burimeve të
hapura, ky rrjet dyqanesh *Net-a-Porter* fokusohet në shërbimin *premium*, përfshirë paketim
luksoz dhe transport të shpejtë. Në këto blerje të përmendura më lart, nuk përfshihen ato të
shtetases Valbona Xoxa në emër të saj personal, të cilat janë të konsiderueshme në numër dhe
vlerë gjithashtu dhe do të gjejnë trajtim më poshtë, si edhe ato të kryera nga shtetasi Erald
Ismaili të cilat paraqesin interes të veçantë për hetimin.

**98.2. Gjithashtu, financierja i dërgon shtetases Ajola Xoxa një tabelë ku
përfshihen xhirot e realizuara nga "Partners Laë", "Ava Studio" shpk, "Arts Lab"
shpk (krijuar nga daja i shtetases Ajola Xoxa, Erald Simixhiu) dhe Greta Domi.** Këto
komunikimeve të cilat pasqyrohen në faqen 795 provojnë plotësisht kontrollin e plotë që ka
efektivisht shtetësja Ajola Xoxa mbi këto shoqëri dhe persona fizikë. Ky kontroll efektiv

provohet veçanërisht në lëshimin e faturave nga këto shoqëri dhe persona fizikë. **Në një rast, financierja pyet shtetasen Ajola Xoxa nëse duhet të bëjë një faturë nga shoqëria "Arts Lab" shpk, krijuar nga daja i Ajolës, shtetasi Erald Simixhiu. Ky i fundit, i cili jeton jashtë shtetit, nga komunikimet konstatohet se nuk ka asnjë lloj përfshirje në menaxhimin e kompanisë së krijuar prej tij. (faqe 798). Në lidhje me këtë kërkesë të financieres, shtetësja Ajola Xoxa vendos menjëherë, pra pa bërë ndonjë konsultë me pronarin ligjor të shoqërisë, duke i komunikuar bashkëbisedueses *se faturën duhej ta bënte nga "Arts Lab" dhe jo nga "Harabel". (faqe 799-800).***

**98.3.** Më tej, shtetësja Adela Kondakçiu njofton përsëri shtetasen Ajola Xoxa se një faturë nga "Arts Lab" shpk është bërë, duke i dërguar edhe kontratën njëkohësisht. **Konkretisht, në faqen 805-806 të komunikimeve evidentohet edhe një herë kontrolli i plotë mbi shoqërinë "Arts Lab" shpk nga shtetësja Ajola Xoxa. Kjo e fundit, njoftohet për listën e detajuar për skenografinë e një eventi që duhet të ndodhë më datë 11.10.2022 si dhe akt marrëveshjen mes "Albania Community Assist" dhe "Arts Lab" sh.p.k., sipas së cilës kjo e fundit duhet të përfitojë 890.000 lekë për realizimin e shërbimit "skenografi".** Shtetasi Erald Simixhiu, daja i shtetases Ajola Xoxa, i cili duhet të nënshkruajë edhe kontratën si edhe listën e detajuar, rezulton se nuk përfshihet në asnjë çast në këtë organizim dhe për pasojë në ndonjë vendimmarrje që lidhet me të. **Nga ana tjetër, kompania në fjalë, "Albania Community Assist" mbështetet në këtë event të muajit Tetor 2022 (dhe jo vetëm) nga Bashkia Tiranë. Nga një verifikim i kryer në deklarimet që kryen në organin tatimor, rezulton se shoqëria ACA, me përfaqësuese shtetasen Holta Koçi, pikërisht për projektin "Me Zemër" ka marrë fonde publike nga Bashkisë Tiranë, në masën rreth 5.600.000 lekë.**

**99. Edhe në rastin e një kontrate që duhet të nënshkruhet me kompaninë "Balfin", shtetësja Adela Kondakçiu pyet shtetasen Ajola Xoxa se nga cila kompani e tyre do të lëshojnë faturën për një shumë prej 30.000 euro.** Sipas organit procedues, nuk kuptohet përse këto shtetase diskutojnë mbi opsione në lidhje me shoqëri të ndryshme për lëshimin e një fature, ndërkohë që ky proces duhet të jetë strikt, dhe pa mëdyshje mbi shoqërinë që realisht përmbush shërbimin apo gëzon sponsorizimin, pa lënë shteg për "zgjedhje" *post factum.* (faqe 808). **Në këtë pikë, duket e natyrshme që shtetësja Ajola Xoxa vendos për "zgjedhjet" më të leverdishme për të, por që në fakt provohen të jenë fiktive. Kjo shtetase pyet financieren nëse kanë hapësirë tek "Arts Lab" shpk për të lëshuar këtë faturë. Kjo e fundit i përgjigjet se faturën mund ta lëshojnë për 20.000 euro, se përndryshe duhet të kalojë me TVSH. Edhe vetëm ky fakt sipas organit procedues provon fiktivitetin e gjithë këtij mekanizmi, i cili është krijuar në funksion të injektimit të shumave të të hollave në shoqëritë e menaxhuara nga shtetësja Ajola Xoxa. (faqe 808-809). Ky fiktivitet provohet edhe më tej në faqen 814, ku shtetësja Ajola Xoxa i komunikon me mesazh zanor bashkëbiseduese (pjesë e komunikimeve) që një pjesë të hollash do të faturohen nga "Arts Lab" shpk dhe një pjesë direkt nga Marsela Çibukaj.** Për këtë të fundit, shtetësja Ajola Xoxa i thotë që një pjesë të pagesës do ja kalojë në formë CASH.

**99.1.** Gjithashtu, në faqen 851, financierja i **thotë** shtetases Ajola Xoxa se kanë për të bërë edhe një raportim për Ministrinë e Kulturës nga Qendra "Harabel", për katalog edhe revistë. Këto duhen dorëzuar deri javën e parë të dhjetorit. **Në këtë pikë, financierja e pyet**

SPECTRAL

**nëse Faturat mund t'i bëjë nga "Arts Lab" shpk apo jo.** Pra, megjithëse eventi duket se është organizuar nga Qendra "Harabel", shtetësja Ajola Xoxa merr lirinë të vendosë se nga cila shoqëri duhet të lëshohen faturat, **duke vendosur njëkohësisht për një subjekt tregtar të cilin në fakt nuk e zotëron ligjërisht.**

**100. Të njëjtën gjë bën shtetësja Ajola Xoxa edhe me "Nan" shpk, e cila zotërohet në masën 100% nga Qendra "Harabel" dhe mbi të cilën kjo shtetase ka kontroll faktik.** Mjafton këtu të përmenden komunikimet e ndodhura në faqet 881-882, ku i kërkohet financieres Adela Kondakçiu t'i dërgojë numrin IBAN të "Nan Gallery" tek Banka Intesa Sanpaolo. **Gjithashtu, pyetjes së financieres se nga do paguhet piktori E.B., shtetësja Ajola Xoxa i përgjigjet nga "Nan".** Përveç kësaj, shtetësja Adela Kondakçiu, sipas sa përmendet në faqen 882, i dërgon shtetases Ajola Xoxa pagesat e kryera nga "Nan" shpk. Shitjet e realizuara nga kjo shpk, sipas këtyre komunikimeve, rezultojnë të jenë në masën <u>21.000 euro</u>.

**100.1. Interes për hetimin në këtë rast paraqet fakti se këto blerje tek "Nan" shpk janë kryer nga shtetasi Sokol Kryeziu, i cili rezulton të jetë aksioner i vetëm i shoqërisë "Gerard-A" me NIPT L12407005L, shoqëri kjo që përfiton fonde të konsiderueshme publike nga Bashkisë Tiranë.** <u>Historikun e kësaj shoqërie si edhe ev profesionale të shtetasit Sokol Kryeziu është përshkruar më lart.</u> **Pra, ky shtetas, si individ, ka blerë nga "Nan" shpk disa piktura, të cilat sipas deklarimeve tatimore kapin shifrën e <u>5.037.064 lekë</u> (të ndara në dy fatura, rreth 21.000 Euro dhe rreth 27.000 euro) shifër nga e cila të paktën deri në këtë moment rezulton të jetë paguar vlera prej 21.000 euro, referuar në këtë rast deklarimeve të shtetases Adela Kondakçiu. Sipas të njëjtave deklarime, vlera e cila i është likujduar shtetasit Idlir Koka, piktor, për të gjithë punët e prodhuara prej tij, nga "Nan" shpk ka qenë <u>13.000 euro</u>. Ndërkohë, vlera e shitjes së tyre tek shtetasi Sokol Kryeziu është rreth <u>50.000 euro.</u> Pra, edhe në këtë rast, një tjetër përfitues i madh i fondeve publike nga Bashkia Tiranë, jep shuma monetare në favor të kompanive që kontrollohen efektivisht nga shtetësja Ajola Xoxa, duke zgjedhur si mekanizëm për dhënien e këtyre të hollave blerjen e të gjithë koleksionit të pikturave të shtetasit Idlir Koka, dhe me një diferencë prej 30.000 Euro nga çmimi i blerjes së tyre prej shoqërisë "Nan" shpk.**

**100.2. Nga sa më lart, sipas organit procedues krijohen dyshime të arsyeshme të bazuara në prova se për shkak të përfitimit të fondeve publike nga Bashkia Tiranë prej shtetasit Sokol Kryeziu, sipas burimeve të hapura si Open Procurement, ky i fundit ka kaluar tek "Nan" shpk një shumë prej të paktën 21.000 euro (aq sa rezulton nga këto komunikime).**

101. Megjithatë, nga komunikimet rezulton se shtetësja Ajola Xoxa nuk mjaftohet në marrjen e shumave të të hollave vetëm nëpërmjet "Partners Laë" prej kompanive të tjera, por ajo shfrytëzon për këtë edhe shoqëritë e tjera mbi të cilat provohet të ketë pronësi faktike. Konkretisht, kompania "Gogel" që kalon shuma të konsiderueshme të hollash për "Partners Laë" sh.p.k., kalon edhe fonde të konsiderueshme gjithashtu për kompaninë "Ava Studio" sh.p.k., në pronësi ligjore të nënës së shtetases Ajola Xoxa, por e zotëruar *de facto* nga kjo e fundit. Në total shuma e kaluar në llogari të "Ava Studio" nga "Gogel" shpk është <u>**7.468.692 lekë**</u>. **Në një rast, ndërsa lëshohet një faturë për vlerën <u>15.000 Euro</u> për "Gogel" sh.p.k. nga "Ava Studio", duket i çuditshëm përshkrimi i bërë në të, që sipas udhëzimeve të**

**shtetases Ajola Xoxa, ndërsa flet me shtetasen Adela Kondakçiu (shih faqen 825-826), duhet të jetë "*produksion video*".** Pra, "Gogel" shpk që është një shoqëri e mirëfilltë marketingu, paguan "Ava Studio" shpk, e cila nuk zotëron asnjë kapacitet teknik apo njerëzor për të prodhuar video. **Në të njëjtat komunikime, shtetësja Ajola Xoxa, e pyetur nga financierja si duhet bërë përshkrimi në lëshimin e faturës, përgjigjet "*si herën e kaluar*". Përsëri për kompaninë "Gogel" që zotërohet nga kunati i shtetases Ajola Xoxa, vëllai i kryetarit të bashkisë Tiranë Erion Veliaj, lëshohet një faturë nga kompania "Ava Studio" shpk, për shumën <u>36.000 euro</u>, me përshkrimin "faturim sipas kontratës".** Sipas organit procedues theksohet se kompania "Gogel" rezulton të ketë klient kryesor shoqërinë e telekomunikacionit "One Albania", e cila nga e saj ka përfituar fonde të konsiderueshme nga Bashkia Tiranë duke u shpallur fituese e disa procedurave të prokurimit publik.

**102. Nga komunikimet rezulton e provuar se shtetësja Ajola Xoxa ka kontroll faktik dhe efektiv edhe mbi organizatën OJF Balkan Youth Link Albania, shkurt "BYL-A". (faqja 830-831). Fillimisht, në komunikimet që përmbahen në faqet 837-838, konstatohet që shtetësja Adela Kondakçiu pyet shtetasen Ajola Xoxa nëse dy fatura në adresë të restorant "Gzona" Tiranë, duhet të bëhen ose jo nga kompania "BYL-A". Në përgjigje të pyetjes së financieres, shtetësja Ajola Xoxa e urdhëron këtë të fundit të përgjysmojë faturën e parë dhe ta lëshojë në emër të BYL-A. (faqe 838).** Një komunikim i tillë është provuar nga analizimi i blerjeve të OJF BYL-A, prej ku rezulton se janë lëshuar fatura me vlerë totale 98.475 lekë për shoqërinë "Albanian Food and Hospitality Lab" (restorant Gzona). Gjithashtu, në komunikimet e faqes 867, shtetësja Ajola Xoxa evidentohet se menaxhon edhe listën e punonjësve të organizatës "BYL-A".

**103.** Nga komunikimet e shtetases **Adela Kondakçiu me shtetasen Marisa Nito,** bashkëshortja e shtetasit Elman Abule, provohet se jo vetëm shoqëria "Sapientia" shpk paguan "Partners Laë" për konsulenca ligjore. Të tilla konsulenca kërkon dhe paguan edhe shoqëria tjetër në pronësi të shtetasit Elman Abule, "Ventus" shpk si dhe vetë "Rametal" shpk në pronësi të shtetasit Elman Abule. **Për këto shoqëri, lëshohen nga "Partners Law" shpk nga një faturë tatimore shitje në të njëjtën datë 30.06.2021, për secilën në shumën 12.000 euro. Ajo çfarë është me interes në këtë rast është përshkrimi. Të dyja shoqëritë që zotërohen nga të njëjtët pronarë, kanë kërkuar shërbim dhe paguar 20.000 Euro së bashku për "konsulencë ligjore". Faqe 3.** Pasi lëshohet fatura për shoqërinë **"Ventus" shpk**, kjo e fundit, më datë **30.06.2021,** referuar konfirmimit për debitim llogarie i cili është pjesë e komunikimit dhe është printuar nga organi procedues, paguan për llogari të "Partners Law" shumën prej 12.000 Euro, duke ju referuar një fature me numër **72 datë 30.06.2021**. Pra, likujdimi kryhet në të njëjtën datë me lëshimin e faturës. (Faqe 6). Ndërsa, sipas të njëjtës bisedë, vetë "Rametal" shpk do të paguajë të nesërmen. Faqe 7. Në fakt shoqëria "Rametal" shpk likujdon pjesën e mbetur të faturës nr. 73 datë 30.06.2021, prej 7.000 euro, më datë 22.07.2021, nëpërmjet urdhër xhirimit nr. 010TIR-0226756, duke lënë të kuptohet se në shumën prej 12.000 euro paguar më parë nga "Ventus" shpk, pjesa e tepërt prej 2.000 euro i përkiste detyrimit të përgjithshëm prej 10.000 euro që kishte "Rametal" shpk kundrejt "Partners Laë". Faqe 7.

**103.1.** Përsëri më datë **10.09.2021 shtetësja Adela Kondakçiu i komunikon shtetases Marisa Nito se** ***I ka konfirmuar Ajola për të bërë një faturë në vlerën 15.000€***

***plus tvsh për shoqërinë Rametal.*** **Faqe 9-10**. Nga ana e saj shtetësja Marisa Nito i thotë *po, bëje*. Pas kësaj fatura lëshohet më datë 10.09.2021 për *"konsulencë ligjore"*, për shumën 15.000 euro. Faqe 11. Më datë 10.11.2021. "Rametal" shpk kalon në llogari të "Partners Law" shumën prej 15.000 euro, si likujdim i faturës së datës 10.09.2021. faqe 13.

**103.2.** Më datë **30.12.2021**, **referuar** komunikimeve mes këtyre dy shtetaseve, sipas porosisë së shtetases Ajola Xoxa, lëshohet një faturë tjetër për "Rametal" shpk nga "Partners Laë", për të cilën shtetësja Marisa Nito i thotë *patjetër*, dhe *që do e bëjë të nesërmen*. Faqe 14.

**103.3.** Më datë **25.01.2022**, sipas komunikimeve në faqen 18, **lëshohen dy fatura të tjera për shoqërinë "Rametal" shpk, të cilat në total shkojnë 38.000 euro pa TVSH dhe rreth 44.000 euro bashkë me TVSH.**

**103.4. Më datë 03.02.2022, sipas** komunikimeve në faqen 20, përsëri "Partners Law" lëshon një faturë tjetër për "Rametal" shpk. Ndërsa më datë **04.03.2022**, shtetësja Marisa Nito i komunikon bashkëbiseduese *se i ka shlyer të gjitha pagesat*. Faqe 20.

**103.5.** Megjithatë, "saga" e konsulencave ligjore nuk ndalet, pasi më datë **04.05.2022**, *sipas konfirmimit të shtetases Ajola Xoxa*, shtetësja Adela Kondakçiu lëshon një faturë tjetër për "Rametal" shpk. Edhe në këtë rast, shtetësja Marisa Nito *i jep ok për ta bërë*. Faqe 21.

**103.6. Më datë 01.09.2022, referuar komunikimeve në faqen 30-31, lëshohen përsëri fatura shitje në adresë të shoqërisë "Rametal" shpk, por këtë radhë jo nga "Partners Law", por nga dy shoqëritë e tjera tregtare të cilat kontrollohen faktikisht nga shtetësja Ajola Xoxa, "Ava Studio" 1 faturë dhe "Arts Lab" shpk 2 fatura. Gjithashtu, një faturë në adresë të "Rametal" shpk lëshohet edhe nga personi fizik-shtetësja Greta Domi. Pra, duke parë fluksin e faturave të lëshuara nga "Partners Law" shpk, duket se është ndryshuar strategjia e injektimit të shumave të parave në llogaritë bankare të familjarëve të shtetases Ajola Xoxa, nëpërmjet shoqërive të këtyre të fundit, të kontrolluara në fakt nga kjo shtetase.** Nëse për rastet e tjera pagesat bëhen në favor të "Partners Law" me justifikimin si "konsulenca ligjore", **në rastin e dy shoqërive "Ava Studio" shpk dhe "Arts Lab" shpk këto pagesa nuk kuptohet për çfarë bëhen përsa kohë objekti i aktivitetit tregtar të këtyre shoqërive është organizimi i eventeve artistike.** Jo vetëm kaq, por sipas organit procedues faturë lëshohet dhe nga Personi Fizik Greta Domi, punonjëse *de facto* e shtetases Ajola Xoxa, e cila paradoksalisht ofron shërbim "konsulence ligjore" tek një klient që e mundëson vetë këtë shërbim, **por edhe që deri në atë moment ka paguar për konsulenca ligjore vetë "shefen" e shtetases Greta Domi.** Faqe 30-31.

**103.6.1.** Në lidhje me këto fatura, shtetësja Adela Kondakçiu pyet më datë **07.09.2023** shtetasen Marisa Nito, se *kur do bëhen pagesat e mbetura për "Partners Laë" dhe "Ava Studio"*. Faqe 32.

**103.7. Vetëm nga "Rametal" shpk dhe "Sapientia" shpk, sipas faturave të lëshuara, rakordimeve si dhe dokumenteve bankarë, "Partners Law" si edhe shoqëritë e kontrolluara faktikisht nga shtetësja Ajola Xoxa "Ava Studio" shpk dhe "Arts Lab" shpk, përfshirë këtu edhe personin fizik Greta Domi, kanë arkëtuar një shumë totale prej 30,766,626 lekë.**

**103.8.** Në vijim, sipas komunikimeve të tjera që janë pjesë e fashikullit penal, të zhvilluara mes Adela Kondakçiu dhe Marisa Nitos, në faqen 3 të tyre konstatohet se e para i

dërgon dhe dy fatura të tjera *'sipas bisedës me Ajolën'*. Konkretisht, bëhet fjalë për dy fatura të lëshuara në të njëjtën datë, 30.06.2021, dhe të dyja të lëshuara për shërbime konsulence ligjore të ofruara nga Partners Laë shpk. **Pra, Partners Laë shpk i ofron konsulencë ligjore dhe faturon në të njëjtën ditë për "Rametal" shpk dhe "Ventus" shpk, për secilën prej tyre 12.000 euro.** (Faqe 4). Menjëherë sapo mer faturat, në faqen 6-7 rezulton që shtetësja Marisa Nito i likujdon ato dhe konkretisht: Më datë 30.06.2021 "Ventus" shpk likujdon 12.000 euro për Partners Laë shpk dhe më datë 20.07.2021 "Rametal" likujdon 7000 euro për Partners Law gjithashtu, me shënimin: *likujdim pjesa e mbetur e faturës nr. 73 datë 30.06.2021.* **Ndërkohë në faqen 9 të komunikimeve, Adela Kondakçiu i thotë Marisa Nitos që** ***Ajola i ka konfirmuar që të lëshonte një faturë tjetër prej 15.000 euro për "Rametal" shpk.*** **Marisa Nito i përgjigjet në faqen 10:** ***Po po, të lutem bëje.*** Menjëherë më pas, në faqen 11 Marisa Nito i dërgon faturën elektronike për vlerën 18.000 euro nga Partners Law për "Rametal" shpk dhe i thotë: *Përshëndetje pagesa e faturës.* Adela Kondakçiu i përgjigjet: *Ok faleminderit, por këtu është vetëm fatura e skanuar. Faqe 12.* **Marisa Nito kërkon ndjesë dhe tregohet menjëherë e gatshme t'i dërgojë pagesën e kryer në favor të Partners Laë nga "Rametal" shpk, për vlerën 18.000 euro.** *Faqe 13.*

**103.9.** Në faqen 14 të komunikimeve, Adela Kondakçiu i drejtohet përsëri Marisa Nitos duke i thënë që *po i dërgon një faturë tjetër sipas porosisë së Ajolës.* Marisa Nito tregohet më e gatshme se më parë, pa diskutuar në asnjë moment për çfarë bëhet fjalë. Përgjigja: ***PO PATJETER ADELA NESËR BËJ PAGESËN.*** *Faqe 14.* Më pas, në faqen 15 Adela Kondakçiu i thotë përsëri se po i dërgonte dy fatura që ka bërë për "Rametal" shpk. Marisa i përgjigjet në faqen 17: *Po e dashur mi dërgo. Ajo e para ka ardhur besoj se e kam bërë që kur ma nise.*

**103.10.** Më pas, në faqen 18 Marisa Nito pyet Adela Kondakçiun: ***Adela janë 38 në total?*** Adela Kondakçiu i përgjigjet: *Në total janë 38 pa tvsh. Njëra ka tvsh 6.000 euro, ajo e Partners dhe totali shkon 44 bashkë me tvsh. Faqe 18-19.* Marisa Nito thotë si gjithmonë: Ok

**103.11.** Në faqen 20, Adela Kondakçiu i dërgon edhe një faturë tjetër që ka bërë për "Rametal" shpk. Marisa Nito e njofton se *ka kryer të gjitha pagesat.* Por në faqen 21 Adela Kondakçiu përsëri i thotë që *i ka konfirmuar Ajola për të bërë një faturë për ata, duke e pyetur nëse duhej ta bënte nga Rametal si gjithmonë?* Në përgjigje të pyetjes, Marisa Nito i thotë: *Po, të lutem. Faqe 22.* **Nga këto komunikime rezulton e qartë se faturat lëshohen në mënyrë fiktive dhe sipas "dëshirës" së titullarëve të shoqërive.** Në faqen 24 evidentohet interesimi tashmë i Adela Kondakçiut për *pagesën e faturës që i kishte dërguar më parë.* Marisa Nito i përgjigjet se *do ja tregonte direkt sa të fliste me financën.*

**103.12.** Në faqen 29 përsëri Adela Kondakçiu lëshon fatura për "Rametal" shpk. Por këtë radhë faturat lëshohen nga "Arts Lab" shpk dhe "Ava Studio" shpk, të dyja këto shoqëri në pronësi ligjore të familjarëve të afërt të shtetases Ajola Xoxa, por të kontrolluara faktikisht nga kjo e fundit. Për "Arts Lab" shpk rezultojnë të jenë lëshuar dy fatura, ndërsa një tjetër lëshohet nga Personi Fizik Greta Domi, e cila punon në zyrën e shtetases Ajola Xoxa. *Faqe 31.* **Pra, "Rametal" shpk nuk faturohet vetëm nga Ajola Xoxa nëpërmjet Partners Law shpk, por edhe nga nëna e Ajolës, Valbona Xoxa, si edhe daja i Ajolës, Erald Simixhiu që figurojnë ligjërisht pronarë të dy shpk-ve që në fakt kontrollohen nga shtetësja Ajola Xoxa. Por kjo e fundit nuk mjaftohet me kaq. Për "Rametal" shpk faturon edhe një person fizik në kontrollin e plotë të Ajola Xoxës, shtetësja Greta Domi, e cila në fakt**



SPAK

është e punësuar tek kjo e fundit, por ligjërisht operon si entitet tregtar i pavarur. Nuk kuptohet pse në faqen 32 të komunikimeve, Adela Kondakçiu i prezantohet përsëri Marisa Nitos, duke i kërkuar një konfirmim për pagesat e mbetura ndaj "Partners Lač" shpk dhe "Ava Studio" shpk, dhe se kur do të mbyllen ato.

**104.** Nga komunikimet e shtetases **Adela Kondakçiu me shtetasen Rea Spartaku,** kjo e fundit lidhje farefisnore me shtetasen Ajola Xoxa, rezultojnë të dhëna me interes për hetimin në drejtim të shpenzimeve të kryera nga familjarë të afërt të shtetases Ajola Xoxa. Gjatë këtyre komunikimeve **evidentohen disa pagesa detyrimesh doganore që duhet të bëhen në emër të shtetases Valbona Xoxa, për disa blerje të bëra nga kjo e fundit.** Pagesat doganore, referuar komunikimeve në faqen 3 e në vijim, të cilat kapin vlera të larta si 62.769 lekë dhe 55.000 lekë, të lënë të kuptosh se vlera e blerjeve të kryera nga shtetësja Valbona Xoxa është e konsiderueshme, siç do të provohet në vijim. **Për të gjithë detyrimet doganore, shtetësja Adela Kondakçiu i komunikon bashkëbiseduese se duhet të bëhen nga "Ava Studio" shpk.** **Në të gjitha rastet, shtetësja Adela Kondakçiu i thotë Rea Spartakut që duhet ta konfirmojë më parë me Ajolën.**

**105.** Nga komunikimet e shtetases **Reada Lemnusha me shtetasen Adela Kondakçiu** rezultojnë disa të dhëna me interes për hetimin. Më së pari, duhet sqaruar se shtetësja Reada Lemnusha rezulton të jetë e punësuar tek Qendra "Harabel". Ndërsa prej datës 02.10.2023 është regjistruar si pronar i vetëm përfitues dhe përfaqësuese ligjore e organizatës jo fitimprurëse "BYL-A", e cila siç u përmend më sipër kontrollohet në fakt nga shtetësja Ajola Xoxa. Nga të **gjitha komunikimet rezulton qartazi e provuar se shtetësja Reada Lemnusha nuk ka asnjë rol në vendimmarrjen dhe menaxhimin e OJF "BYL-A".** Në fakt nga bisedat rezulton e provuar lidhja e të gjitha shoqërive (përfshirë këtu OJF-të) më shtetasen Ajola Xoxa. Faqe 11-12, 16, 17, 18. **Edhe kur është rasti për të firmosur një prokurë për autorizimin e shtetases Adela Kondakçiu, duket qartë se shtetasja Reada Lemnusha nuk ka asnjë ide, pasi përgjigjet se nuk e kanë lajmëruar.** Edhe për ndryshimet që duhet të ndodhin në bankë, Reada Lemnusha njoftohet nga Adela Kondakçiu për të shkuar atje dhe për të firmosur ndryshimet. Faqe 25. Në këtë pikë, shihet se Reada Lemnusha, edhe për një veprim të tillë siç është paraqitja në bankë për një veprim që lidhet me OJF-në për të cilën teorikisht duhet të kishte kontrollin, merr leje nga financierja nëse mund ta bëjë të nesërmen veprimin apo jo. Adela madje e udhëzon se ku duhet të paraqitet në lidhje me degën bankare. Faqe 27-28. **Gjithashtu, Adela Kondakçiu e udhëzon Reada Lemnusha që kur të paraqitet në bankë të thotë se vjen nga "BYL-A". Faqe 36.** Më tej, shtetësja Adela Kondakçiu i thotë Reada Lemnushës se "Antea" i ka nisur një faturë të brendshme, por për këtë duhet të vendosi Ajola. *Faqe 58-59-60.*

**106. Për herë të parë, në komunikimet që ndodhen në faqen 64-65-67-68, të dy bashkëbiseduesit flasin për një shoqëri me bazë në Londër, "Frobolous", e cila siç është shtjelluar më lart përfiton fonde publike nga Bashkisë Tiranë, deri tani të verifikuara në vlerën prej 3.000.000 lekë për një event të vetëm.** Fatura për bashkinë Tiranë është lëshuar në muajin Nëntor, datë 16, viti 2023 për vlerën 3.000.000 lekë. Më pas, më datë 16.11.2023, të njëjtën datë, Reada Lemnusha njoftohet nga "Frobolus" me seli ne Angli, se në favor të "NAN" shpk janë kaluar 4.459 euro. **Pas kësaj, rezulton të jenë lëshuar 5 fatura për "Frobolus" sh.p.k. me seli në Shqipëri. Faturat lëshohen nga "NAN" shpk, në**

**kontrollin ligjor të Qendrës "Harabel", OJF-kjo që nga ana e saj kontrollohet plotësisht nga shtetësja Ajola Xoxa. Vlera e faturuar nga "Nan" shpk është <u>960.000 lekë</u>.**

**106.1. Gjithashtu, në të njëjtin muaj, pas përfitimit të fondit nga Bashkisë Tiranë prej "Frobolous", fatura lëshon edhe shoqëria tjetër e zotëruar faktikisht nga shtetësja Ajola Xoxa, konkretisht "AVA Studio" për shumën <u>540.000 lekë</u>, datë 24.11.2023.** Më pas, rezultojnë që janë lëshuar edhe 2 fatura të tjera nga shtetasi Ergys Krisiko, i cili dyshohet t'i ketë prodhuar ato fiktivisht (*shih deklarimet e këtij shtetasi si edhe ato të Adela Kondakçiut*), në shumën <u>1.640.000 lekë</u>. <u>Konkretisht, në datat 23.11.2023 dhe 12.12.2023 përkatësisht për shumat 1.100.000 dhe 540.000 lekë.</u> Kontratat e këtij shtetasi me OJF "Frobolous", me adresë në lagjja nr. 3. Sheshi "Iliria", Kulla EGT, Kt 3, Durrës, për eventin "Tirana's Fashion Night", lidhur më datë 09.11.2023, **diskutohen dhe kalojnë në format *pdf* ndërmjet bashkëbiseduesve, shtetaseve Reada Lemnusha dhe Adela Kondakçiu.** Ky shtetas, nga ana tjetër, nuk merr lekë vetëm nga "Frobolous" por edhe nga Qendra "Harabel", në shumën prej <u>145.000 lekë</u>, me përshkrimin *prodhim skene, datë fature 20.12.2023.* **Pra, në total nga "Frobolous", OJF kjo që rezulton të ketë marrë <u>3.000.000</u> lekë nga Bashkia Tiranë, në favor të shtetases Ajola Xoxa, për shkak të kontrollit faktik mbi shoqëritë e përmendura më sipër, kanë kaluar afërsisht <u>3.000.000 lekë</u>.**

**106.2.** Sipas organit procedues, në lidhje me shoqërinë "NAN" shpk duhet theksuar fakti që është e formës tregtare "shoqëri me përgjegjësi të kufizuar", pra një shoqëri fitimprurëse. Kjo shoqëri, referuar ekstraktit të QKB zotërohet 100% nga organizata jofitimprurëse "Qendra Harabel". Kjo organizatë, siç është përmendur më lart, provohet të jetë në zotërimin faktik të shtetases Ajola Xoxa. Në këtë mënyrë, nga sa më lart provohet se edhe shoqëria me përgjegjësi të kufizuar "NAN", ashtu si "Ava Studio" shpk dhe "Arts Lab" shpk, zotërohet faktikisht nga shtetësja Ajola Xoxa. Këtu nuk duhet lënë pa përmendur dhe publiciteti i bërë në media nga kjo shtetase në lidhje me veprimtaritë artistike të zhvilluara nga "NAN Gallery".

**106.3. Më tej, në faqen 70 të komunikimeve, shtetësja Reada Lemnusha i tregon financieres si do bëhet fatura me kompaninë "Frobolous", <u>duke mos harruar t'i thotë se këtë gjë ja kishte thënë Ajola.</u>** Konkretisht, kjo shtetase i dërgon këto shënime për t'u ndjekur nga financierja: - *Duhet bere nga NAN - FRBL London - Vlera eshte 385 000 (+20 TVSH) pra 462 000 - Pershkrimi: Ideim skenografi. Reada Lemnusha vijon:* ***Jo, me thote Ajola fatura te jete total 462 000 (e kthyer ne euro).***

**106.4. Më datë 12.02.2024, shtetësja Reada Lemnusha njofton financieren se "Frobolous" ka bërë dy pagesa të tjera në favor të "NAN" sh.p.k., në shumën <u>410.000 lekë dhe 50.000 lekë</u>.** *Faqe 111.* Ndërsa më datë 14.02.2024 rezulton se "Frobolous" kalon përsëri një shumë prej <u>500.000 lekë</u> në favor të "NAN" shpk. *Faqe 113.*

**106.5.** Me interes paraqitet komunikimi i kryer në faqen 133, ndërsa Reada Lemnusha e pyet financieren **<u>nëse Frosina (Frobolous) duhet t'i japë 18.000</u>**. Shtetësja Adela Kondakçiu i përgjigjet në faqen pasardhëse se ***"po i bije që ka lënë më shumë Ajola ose është ngatërruar".*** Gjithashtu, financierja pyet Readën ***nëse Ajola i ka thënë ndonjë gjë kur ja dha***, <u>duke lënë të kuptohet se i ka lënë shumën e të hollave</u>. Sepse më pas, shtetësja Adela Kondakçiu shprehet se ***"po ashtu t'i konvertojmë edhe ia japim asaj në lekë vlerën".*** Reada Lemnusha i përgjigjet që <u>*mund t'i thotë direkt Frosinës (Frobolous) t'i japë kusurin, sepse një shumë e tillë është shumë për Exchange.*</u>

**106.6. Në faqet 127-129 të komunikimeve, provohet më tej fakti që "Ava Studio", në pronësi ligjore të shtetases Valbona Xoxa, zotërohet faktikisht nga shtetësja Ajola Xoxa.** Është Reada Lemnusha që njofton financieren se ka për të bërë një kontratë me Pallatin e Brigadave nga shoqëria "AVA Studio". Më pas, po Reada Lemnusha i kërkon financieres të bëjë një faturë tjetër nga "AVA Studio", këtë radhë për një shoqëri të quajtur "Metani" ose person fizik me këtë emër. **<u>Sipas Readës, shtetësja Ajola Xoxa i ka thënë që duhej bërë sot (ditën e komunikimit).</u> Fatura do ishte për shumën prej <u>8.400.000 lekë.</u>**

**106.7.** Në faqen 132 të komunikimeve, del përsëri në skenë emri i shtetasit Ergys Krisiko, i cili paguhet për likujdim fature nr. 33 datë 23.11.2023, një shumë prej <u>860.000 lekë</u> nga "Frobolous". Përsëri, më datë 04.04.2024 shtetasi Ergys Krisiko paguhet për një shumë tjetër prej <u>3.000 euro</u>.

**106.8. Në faqen 143 të komunikimeve, rezulton se financierja i dërgon Readës çertifikatën e NIPT-it të Qendrës "Muza".** Gjithashtu, edhe pse në dukje nuk ka arsye, shtetësja Reada Lemnusha i kërkon financieres faturën e shtetasit Ergys Krisiko të lëshuar në vlerën <u>540.000 lekë</u> në adresë të "Frobolous". <u>Për më tepër, është pikërisht Reada Lemnusha që njoftohet (faqe 146) se i ka mbërritur një faturë e likuiduar për Ergysin.</u> **Pra, është e qartë se marrëdhënia që shtetasi Ergys Krisiko ka me "Frobolous" menaxhohet tërësisht nga shtetaset Reada Lemnusha dhe Adela Kondakçiu. Për pasojë, për gjithë panoramën e përshkruar, sipas organit procedues ka arsye të bazuara në prova se ky shtetas (Ergys Krisiko) kontrollohet plotësisht nga shtetësja Ajola Xoxa përsa i përket fondeve që përfiton nga entitete që sponsorizohen nga Bashkia Tiranë.**

106.9. Në faqen 145 përmendet se "Frobolous" i kalon shoqërisë "AVA Studio", në pronësi faktike të shtetases Ajola Xoxa, një shumë prej <u>540.000 lekë.</u>

107. Nga komunikimet e shtetases **Adela Kondakçiu me shtetasen Linda Kazani,** bashkëshortja e dajës së shtetases Ajola Xoxa, rezultojnë të dhëna me interes për hetimin. **Konkretisht, nga këto komunikime rezulton e qartë se personi që i drejton bashkëshortët Simixhiu-Kazani në themelimin e nje OJF (Eventus) dhe një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar (Arts Lab) është** shtetësja Ajola Xoxa. Faqe 1-2, 6. **Është shtetësja Ajola Xoxa, që nëpërmjet financieres i komunikon edhe degën bankare ku duhet të hapin llogarinë për "Arts Lab" shpk, në pronësi ligjore të shtetasit Erald Simixhiu, daja i shtetases Ajola Xoxa.** ***Faqe 14-15.***

**107.1.** Nga hetimi ka rezultuar se kjo shoqëri menaxhohet dhe zotërohet faktikisht nga shtetësja Ajola Xoxa. **Në lidhje me shoqërinë fitimprurëse "Arts Lab" shpk, emri i shtetasit Erald Simixhiu nuk përmendet në asnjë çast, përveç se kur përfiton ndonjë pagesë si individ, në interpretimet që bën në piano.** Është e qartë se çdo aspekt ligjor dhe financiar i "Arts Lab" shpk mbulohet nga shtetësja Ajola Xoxa.

**107.2.** Megjithatë, edhe nga komunikimet përsa i përket Qendrës "Eventus", në pronësi ligjore të shtetases Linda Kazani, bashkëshortja e dajës së Ajola Xoxës, OJF kjo që ka përfituar në mënyrë të drejtpërdrejtë fonde publike nga Bashkia Tiranë, gjë që do të trajtohet hollësisht në vijim, **konstatohet se shtetësja Linda Kazani as nuk e ka idenë ku ndodhet baza dokumentare. Në faqen 81 rezulton se kjo shtetase as nuk e ka idenë se çeqet e "Eventus" OJF ndodhen në zyrën e shtetases Ajola Xoxa.** Interesant është fakti i pasqyruar në faqen 85-86 të komunikimeve, dokumentuar edhe me dokumentet bankarë të cilat janë administruar në fashikullin penal. **Nga këto komunikime rezulton se shoqëria me**

**përgjegjësi të kufizuar "Arts Lab", pra një shoqëri fitimprurëse, ka marrë nga OJF "Eventus" një shumë prej 70.000 lekë për promocion.** Gjithashtu, shoqëria "Arts Lab" përfiton nga OJF "Eventus" një shumë tjetër prej 300.000 lekë, këtë radhë për *koordinim eventesh dhe vocal coach (trajner zëri, ndërkohë që "Arts Lab" nuk disponon asnjë kapacitet njerëzor dhe teknik të dokumentuar për të).* Më pas, e njëjta OJF i kalon "Arts Lab" shpk një shumë tjetër prej 30.000 lekë për *kostumografi (asnjë kapacitet teknik i dokumentuar).* **Domethënë, një OJF si "Eventus", që është themeluar pikërisht për të organizuar evente artistike, përfituese e fondeve publike nga Bashkia Tiranë, pajton një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar që ka të njëjtin objekt aktiviteti dhe që zotërohet *de jure* nga bashkëshorti i administratorit të OJF, duke i kaluar këtij të fundit shuma monetare.**

**107.3. Në këtë mënyrë, sipas organit procedues bashkëshortët kalojnë nga njëri tek tjetri shuma të hollash. Këto kalime, se bashku me kalime të tjera bankare fondesh, siç do të citohet më pas janë domosdoshmëri praktike dhe ilustrojnë qartë skemën e ideuar dhe të zbatuar në praktikë për injektimin e fondeve publike të bashkisë Tiranë por edhe institucioneve të tjera publike, në llogaritë bankare të familjarëve të afërt të kryetarit të bashkisë, shtetasit Erion Veliaj.** Kjo domosdoshmëri praktike lind nga fakti se ligjërisht një organizatë jo fitimprurëse nuk mund të rezultojë në asnjë rast me fitim. **Për këtë shkak, fondet publike të përfituara nga Bashkia Tiranë, për t'u kanalizuar më pas si fitime për individë të caktuar ose shpk, duhet të transferohen ose drejtpërdrejt tek individët fundorë përfitues, gjë që do të paraqiste rrezik në rastin kur përfituesi fundor duket se është bashkëshortja e kryetarit të bashkisë, ose të përfundojnë tek kjo e fundit nëpërmjet shoqërive me përgjegjësi të kufizuar, të cilat provohen se zotërohen prej saj, siç edhe paraqitet situata në rastin konkret.** Aq i vërtetë është ky fakt sipas organit procedues, saqë shtetësja Linda Kazani as e ka idenë se për të dhe bashkëshortin e saj deklarohen paga tek "Eventus" dhe "Arts Lab" shpk. Por, këto paga, sipas komunikimit të shtetases Adela Kondakçiu në faqen 96, nuk janë kaluar.

**107.4.** Shtetësja Linda Kazani i përgjigjet në faqen 97: *Po nëse ka dokument pagese duhet t'i deklarojmë.* Financierja vijon duke i thënë se *bashkëshortëve u janë kaluar si të ardhura. Vetëm janë bërë deklarimet dhe pagesat e sigurimeve. Faqe 98.*

**107.5.** Mjaft interes paraqet komunikimi në faqen 119-120-121. Shtetësja Adela Kondakçiu pyet shtetësen Linda Kazani: ***Me tha Xhoi qe duhet te bej 2 fatura. Faturat do behen nga Eventus per Avan dhe Harabel? Apo Harabel edhe Ava do ti bejne fatura Eventus?*** **Duke mos patur asnjë ide se për çfarë bëhet fjalë, Linda Kazani i përgjigjet:** ***Te lutem pyete Ajolen per kete Adela. Ajo me tha dicka... Faqe*** **120. Adela Kondakçiu i thotë:** ***dakord.*** Më pas, financierja shprehet: **Ajola me tha qe edhe pagesat e sigurimeve te Eventus do filloime ti kaloime nga llogaria**. *Faqe 120.*

**107.6.** Interes paraqet komunikimi në faqen 121, ku shtetësja Linda Kazani shprehet se ka bërë një punë si *Vocal Coach* për një projekt me liceun artistik dhe duhet të paguhet me honorar si shërbim. Por për këtë shërbim drejtoresha e shkollës i kërkon një faturë shërbimi. **Në këtë moment, shtetësja Linda Kazani, e cila ka bërë një shërbim si Vocal Coach i kërkon financieres që faturën po qe e mundur ta bëjë nga shoqëria "Arts Lab", në pronësi ligjore të shtetasit Erald Simixhiu, por në zotërim faktik të shtetases Ajola Xoxa.** ***Faqe 121.*** Ky komunikim i shtetases Linda Kazani provon që ajo ka bërë një punë si *Vocal Coach* në rastin e projektit me Liceun Artistik, pra për rrjedhojë zotëron një kapacitet



SPECIAL / AL

të tillë profesional. Duke pranuar këtë fakt, nuk kuptohet çfarë nevoje ka patur OJF "Eventus", pra shtetësja Linda Kazani, për të marrë *Vocal Coach* si shërbim nga shoqëria "Arts Lab" në rastin e përshkruar më lart, për të cilën "Eventus" ka paguar në favor të "Arts Lab" shpk shumën prej 300.000 lekë.

**107.7.** E pyetur më pas për vlerën që duhet t'i faturohet liceut artistik nga "Arts Lab" shpk, Linda Kazani përgjigjet 200.000 lekë. *Faqe 123.* Pas kësaj, shtetësja Adela Kondakçiu merr masat për të përgatitur dokumentacionin e nevojshëm. *Faqe 128-129.*

**107.8.** Në faqen 131 të komunikimeve evidentohet fakti se vula e shoqërisë "Arts Lab" ndodhet në zyrën e shtetases Ajola Xoxa. **Pasi kontrata firmoset, financierja i komunikon shtetases Linda Kazani se do ja linte Ajolës ta vulose.** *Faqe 135.*

**107.9.** Në faqen 138 evidentohet fakti se shtetasi **Erald Simixhiu** nuk ka asnjë ide çfarë ndodh me shoqërinë që ka themeluar vetë, "Arts Lab". Në këto komunikimeve, financierja i shkruan shtetases Linda Kazani duke i kërkuar që Eraldi të kalojë tek zyra (duhet të kuptohet zyra e Partners Laë) *sepse duhet të firmosë disa kontrata që u duhen për një projekt. Linda Kazani i përgjigjet se po shkonin atje.*

**107.10.** Më datë **26.12.2023** përmendet në komunikimet mes shtetases Adela Kondakçiu dhe Linda Kazani, për herë të parë një qendër tjetër e emërtuar "MUZA". Konkretisht, në faqen 164 financierja i thotë shtetases Linda Kazani se *kishte folur me Onedën dhe kanë një problem të brendshëm për të sqaruar për procedurat, edhe po presin që ta sqarojnë që të hapn llogarinë e "MUZA".*

**107.11.** Në këtë kuadër, siç hollësisht është sqaruar më lart, Qendra "MUZA" është themeluar nga shtetasi Erald Simixhiu, dajë i shtetases Ajola Xoxa, dhe shtetasi Arben Spartaku, i afërm i shtetases Ajola Xoxa. **Pra, tashmë kemi një OJF të themeluar nga shtetësja Linda Kazani, një tjetër të themeluar nga bashkëshorti i saj Erald Simixhiu, si edhe një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar të themeluar përsëri nga ky i fundit. Dy OJF-të kanë përfituar drejtpërsëdrejti fonde publike nga Bashkia Tiranë, ndërsa shoqëria me përgjegjësi të kufizuar ka përfituar fonde nga të dy OJF-të. Përveç kësaj të fundit (Arts Lab) fonde nga Qendra "Muza" përfiton dhe "Partners Law" shpk. Në rastin konkret është me shumë interes se si janë ndarë fondet publike të marra prej Bashkisë Tiranë nga OJF "Muza". Kjo e fundit, pasi ka përfituar 1.642.748 lekë nga Bashkia Tiranë, i ka kaluar 1.100.000 lekë "Arts Lab" shpk dhe 120.420 lekë "Partners Law" shpk.**

**108.** Nga komunikimet e shtetases **Adela Kondakçiu me shtetasen Xhoi Skënderasi,** punonjëse e zyrës së "Partners Law" më administratore shtetasen Ajola Xoxa, **rezulton se kjo e fundit njofton financieren që OJF BYL-A ka një projekt me Ministrinë e Kulturës.** Këtu bëhet fjalë për periudhën Shkurt 2020. ***Faqe 54.*** Nga komunikimet gjithashtu rezulton e qartë se kartën e OJF "Harabel", në vend që ta disponontë Drejtori ekzekutiv i saj, e përdor shtetësja Xhoi Skënderasi, ndër të tjera për të bërë blerje edhe tek Megatek. Blerja e bërë më pas, një oxhak që funksionon me etanol, i faturohet OJF "Harabel", përkatësisht drejtorit të saj Driant Zeneli. *Faqe 92.* Edhe një prej adresave email të kësaj OJF-je rezulton të jetë joy@harabel.com.al, megjithëse personi i kontaktit të organizatës duhej të ishte Drejtori i saj ekzekutiv Driant Zeneli. *Faqe 173.*

**109.** Në faqen 311 të komunikimeve rezultojnë të dhëna të tjera me interes për hetimin. **Xhoi Skënderasi i dërgon Adela Kondakçiut një foto (screenshot) të një**

**kontrate huapërdorje nënshkruar më datë 01.05.2020, mes shoqërisë "Lani" shpk dhe "Partners Law" shpk.** Nga kontrata rezulton se zyrat në të cilat ushtron aktivitetin "Partners Law", me një sipërfaqe të përgjithshme prej 330 m2, të ndodhura në katin e 10 të godinës "Sky Toëer", Rr. 'Ibrahim Rugova', Tiranë, në pronësi të shoqërisë "Lani" shpk, me përfaqësuese shtetasen Elga Kosta, **i jepen në huapërdorje pa kundërshpërblim, "Partners Law" shpk**, pra **shtetases Ajola Xoxa, për ushtrimin e aktivitetit të saj fitimprurës.**

**109.1. Ballafaquar me këtë komunikim, ndërsa është pyetur gjatë hetimit paraprak në cilësinë e personit që ka dijeni për veprën penale, shtetësja Adela Kondakçiu pohon që kontrata në fjalë pasqyron të dhëna të rreme.** Sipas kësaj shtetase, që ka mbuluar gjatë gjithë kohës detyrën e ekonomistes së "Partners Law" shpk, gjatë gjithë periudhës që kjo shoqëri ka ushtruar aktivitetin e saj tregtar në Godinën "Sky Tower", si atje ku ka qenë më parë, pra në katin e 12 të ndërtesës ashtu edhe ku ndodhet aktualisht, pra në katin e 10 të ndërtesës, **ka paguar në dorë, CASH, qiranë, e cila ka qenë rreth 24.000 Euro në vit, në katin e 12 të godinës.** Më pas, kur **janë zhvendosur në katin e 10 të godinës, Partners Laë ka vijuar të paguajë në CASH pak a shumë të njëjtën shumë. Periudha për të cilën po flasim i përket vitit 2019 deri në 2024. <u>Madje kjo shtetase pohon se ka qenë ajo vetë që ka dorëzuar qiranë në formë CASH dhe dorazi një personi të punësuar pranë "Lani" shpk të quajtur Bethi, arkëtare e kësaj shoqërie.</u>**

**109.2.** Sipas organit procedues, ky variant duket të jetë ai i besueshmi, përsa kohë bëhet fjalë për një sipërfaqe të konsiderueshme, 330 m2, në një nga zonat më të shtrenjta të kryeqytetit, në të cilën ushtron aktivitetin një firmë e organizuar në formë shpk, pra fitimprurëse, e cila rezulton të ketë një volum të konsiderueshëm klientele. Për më tepër, që nga ana e saj, vetë kjo firmë që pretendon të ketë marrë në huapërdorje këtë sipërfaqe prej 330 m2, brenda saj ka dhënë vetë ambiente të tjera në huapërdorje personave fizikë, të cilët edhe ata nga ana e tyre ushtrojnë profesionin e avokatit, dhe të cilët, siç do të shohim në vijim sigurojnë fitime të konsiderueshme, të paktën sipas leximit të dokumenteve bankarë. **Akoma më i besueshëm bëhet ky version i paraqitur nga Adela Kondakçiu, kur merret në konsideratë fakti që vetëm në vitin 2024, sipas deklaruese, pasi personat e interesuar kanë mësuar për regjistrimin e një procedimi penal, për shkak të publikimit në media të disa shkresave të nisura nga organi procedues në adresë të disa intitucioneve publike në vend, rreth muajit Shkurt të këtij viti, menjëherë më pas, rreth muajve Maj ose Qershor 2024 kanë reaguar duke nënshkruar tashmë dy kontrata qiraje.** Konkretisht, sipas deklaruese s bëhet fjalë për një kontratë qiraje nga "Lani" shpk dhe "Partners Laë" dhe një tjetër nga "Lani" shpk dhe "Ava Studio". **Çmimi i përcaktuar në secilën prej kontratave ka qenë 2700 Euro në muaj.** Për këtë, shtetësja Adela Kondakçiu deklaron se janë lëshuar edhe fatura tatimore, një pjesë e të cilave nuk është paguar ende pasi po bëjnë rakordimet, për shkak se kanë bërë pagesa në formë CASH. **Deklaruesja** shpjegon gjithashtu se kontrata e huapërdorjes që është përpiluar më parë duhet të gjëndet në organet tatimore.

110. Në faqen 344-345 të komunikimeve evidentohet tashmë në mënyrë të përsëritur shpërfillja e plotë e drejtorit ekzekutiv *de jure* të OJF "Harabel", ndërsa ky i fundit kërkon që nga OJF në fjalë të bëhej një pagesë. Por shtetësja Xhoi Skënderasi përsërit dhe njëherë atë çfarë është tashmë e njohur, ***se duhet pyetur Ajola dhe se ajo i ka thënë JO.***

**110.1.** Në faqen 361 evidentohet një tjetër fakt interesant, ndërsa për pagesën e një shtetasi të quajtur Adrian Paci, Xhoi Skëndëri thotë se *lekët do të hiqen nga buxheti që kanë parashikuar për Ergysin.* **Këtu bëhet fjalë për shtetasin Ergys Krisiko, mik i shtetases Ajola Xoxa,** i cili rezulton të ketë lëshuar një mori faturash për shërbime të pakryera ndonjëherë për shoqëritë tregtare të familjarëve që kontrollohen indirekt nga kjo e fundit.

**110.2.** Në faqen 853 ajo çfarë paraqet interes në komunikime, të cilat shoqërohen me dy foto (screenshot) të lëvizjeve bankare të shtetases Valbona Xoxa, **janë shpenzimet e kryera nga kjo e fundit me kartën e lëshuar në emër të saj. Në vetëm dy fletë të printuara, nga i gjithë statement i kësaj shtetase, rezultojnë blerje të shumta në numër dhe në vlera të konsiderueshme, të cilat vetëm për periudhën Mars 2021 deri në Maj 2021, pra vetëm 2 muaj, kanë arritur vlerën e <u>17.329 euro.</u> Të gjitha blerjet rezultojnë të jenë kryer në rrjetin e dyqaneve *Net-A- Porter.***

**110.3.** Interes paraqesin komunikimet e datës **12.10.2021 dhe 13.10.2021**, të cilët gjënden në faqen 868 e në vijim. Gjatë komunikimeve, të cilat përmbajnë disa mesazhe vokale të dërguara me Whatsapp nga shtetësja Ajola Xoxa, dëshmohet qartë iniciativa, drejtimi dhe nxitimi i kësaj të fundit për të bërë sa më parë operative shoqërinë me përgjegjësi të kufizuar "Ava Studio", që *de jure* figuron në emër të nënës së saj Valbona Xoxa. Në fakt kjo shoqëri rezulton te jetë regjistruar ligjërisht më datë 05.10.2021.

**110.4.** Për çdo gjë, përfshirë këtu edhe depozitimin e shumës prej 100.000 lekë që do derdhen në formë CASH për hapje llogarie si edhe bankën ku do të hapej kjo llogari, **rezulton e qartë se vendos vetëm shtetësja Ajola Xoxa dhe jo pronarja ligjore Valbona Xoxa.** Edhe për vulën e shoqërisë "Ava Studio" shpk rezulton se merret shtetësja Ajola Xoxa, *e cila nga ana e saj i kërkon Adelës që Xhoi Skënderasi t'ja kujtojë pak.* Sepse, vijon komunikimi, *Ajola mund të dojë t'i bëjë ndonjë sigël. Faqe 894-895.*

**111.** Gjithashtu, me interes është fakti se, **subjekti tregtar "Arts Lab"** shpk, me NIPT M12305006I, **në kredencialet e Portalit** *e-albania* **rezulton të ketë të regjistruar numrin <u>0695444568</u>,** i cili, sipas shënimeve të bëra në foton që është shkëmbyer mes bashkëbiseduesve në faqen 972, **është i regjistruar në emër të shtetases Ajola Xoxa.** Pra, kjo e fundit duket se menaxhon edhe këtë shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, pronar *de jure* i së cilës është daja i saj, shtetasi Erald Simixhiu. Ky i fundit, së bashku me bashkëshorten e tij Linda Kazani, përkatësisht pronar ligjor i "Arts Lab" shpk dhe pronare përfituese e OJF "Eventus", referuar komunikimeve në faqen 974 që i referohen vitit 2021, jetojnë jashtë shtetit, dhe ndoshta në vitin 2022 do të kthehen në Shqipëri përgjithmonë.

**112.** Në faqen 1000 të komunikimeve, shtetësja Adela Kondakçiu i thotë Xhoi Skënderasit se **OJF SHIZI (shoqata për integrimin e zonave të menaxhuara) e kanë bërë me dy firma dhe të gjitha mandatet i firmoste ajo dhe Greta.** Pra, rezulton qartë se edhe kjo shoqatë lidhet me aktivitetin e shtetases Ajola Xoxa. Në faqen 1014 me interes është fakti se dy bashkëbiseduset bisedojnë se kush mund të punësohet tek "Arts Lab" shpk, *duke sugjeruar që shtetësja Adela Kondakçiu mund të jetë psh financiere.* **Pra, duket e qartë se shtetasi Erald Simixhiu, pronari ligjor i shoqërisë nuk ka asnjë vendimmarrje në të, madje as nuk përfshihet në marrjen e ndonjë opinioni siç është rasti konkret rekrutimi i punonjësve, i cili kuptohet që mbetet një proces fiktiv, përsa kohë që Adela Kondakçiu shihet si mundësi për t'u punësuar edhe atje, jo nga personat përgjegjës por nga vetë punonjësit.** Vetë kjo e fundit, para kësaj mundësie të diskutuar, përgjigjet që mund të jetë,

**Thënë ndryshe, dy persona që nuk kanë asnjë funksion ekzekutiv në shoqëri, diskutojnë mbi rekrutimet e njëra tjetrës, thjesht dhe vetëm për të deklaruar punonjës në listë pagesa.**

**112.1.** Gjithashtu, në faqen 1023 del i qartë roli efektiv dhe vendimmarrës i shtetases Ajola Xoxa në administrimin e shoqërisë "Ava Studio" shpk. Nga komunikimet këtë faqe rezulton se *punonjëset kanë bërë aplikimin për kartën e "AVA Studio" shpk, dhe se për këtë kanë folur dhe me Ajolën.*

**112.2.** Më datë 17.12.2021, duket se Xhoi Skënderasi njofton Adela Kondakçiun se një gjyqtar i Gjykatës Tiranë, Dhoma Civile, ka pranuar të regjistrojë Qendrës "Eventus", me pronar përfitues shtetasen Linda Kazani, bashkëshortja e dajës së shtetases Ajola Xoxa. Pra, duket se fijet e një rrjeti të gjerë shoqërish fitimprurëse apo organizata jo fitimprurëse takohen të gjitha tek shtetësja Ajola Xoxa. Në të gjitha këto entitete, kjo shtetase provohet të ketë patur e vetme rol përcaktues në vendimmarrje. Më tej, të dyja këto shtetase janë të angazhuara për regjistrimin e Qendrës Eventus, duke u marrë me dokumentacionin përkatës. Por, këtu përveç këtij fakti, ajo çfarë provon edhe njëherë kontrollin faktik të shtetases Ajola Xoxa, në lidhje me këtë qendër, është komunikimi në faqen 1060. Në këtë komunikim, Xhoi Skënderasi, kur flitet për kontratën e qirasë që duhet për të regjistruar organizatën, shprehet për Adela Kondakçiun: ***këtë kontratën e qirasë të na e thotë Ajola si e duan, se është si me ja dhënë vetes !!!!.*** Është e qartë se, si marrja përsipër e gjithë praktikës së shoqërisë nga punonjëset e shtetases Ajola Xoxa, ashtu edhe kontrata e qirasë që duhet të vendoset nga kjo e fundit, *se në fakt është si me ja dhënë vetes*, provojnë plotësisht se shtetësja Ajola Xoxa është ideatorja, zbatuesja në praktikë dhe menaxhuesja direkte e të gjithë organizatës, që në fillimet e saj.

**112.3.** Në faqen 1070, **Adela Kondakçiu** pyet **Xhoi Skënderasi** nëse i ka thënë gje Ajolës për kontratën e huapërdorjes, por ajo i përgjigjet se duhet të flasin njëherë te tatimet, pastaj t'i thotë detajet. Në vijim, në faqen 1071 Xhoi Skënderasi e njofton bashkëbiseduesen se "*atë të Lindës e bëra*", "*tani po bëj dhe këtë të Eraldit*". Pra, për të dy subjektet, si për OJF dhe Sh.p.k., punonjësja e Ajola Xoxës, shtetësja Xhoi Skënderasi është tërësisht e angazhuar në përfundimin e regjistrimit të tyre në organet përkatëse tatimore. Në këtë pikë, *shtetësja Adela Kondakçiu i sugjeron që të flasë njëherë me Ajolën për kontratën që u duhet për regjistrim*, dhe Xhoi Skënderasi bën një paralelizëm me "Partners Law", duke thënë *"Partners" e ka pa NIPT psh. Faqe 1075. Adela Kondakçiu i kërkon përsëri të sqarohet për kontratën me Ajolën, se punën e vulës e zgjidhin.* Faqe *1075-1076.*

**112.4.** Interes paraqet edhe komunikimi në faqen 1078, në të cilën ndodhet një mesazh zanor i dërguar nga shtetësja Ajola Xoxa. Nuk kuptohet arsyeja qartë në këtë moment, por kjo shtetase i thotë Adela Kondakçiut se: ***"nuk mund ta firmosi mami në asnjë rast, duhet ta firmosi ose ti ose Xhoi dhe i bëjmë prokurë. Thjesht vër një emër tjetër".*** **Është e qartë se shtetësja Ajola Xoxa tregon kujdes kur vjen fjala për nënën e saj dhe, sikurse duket, përfshirjen e saj duke nënshkruar akte në emër të "Ava Studio" shpk, duke e shkarkuar këtë përgjegjësi tek persona të tjerë. Ky kundërshtim i shtetases Ajola Xoxa për të përfshirë nënën e saj në nënshkrimin dokumenteve, shpjegohet pak më poshtë tek komunikimet pjesë e fashikullit penal.** Në faqen 1081 del i qartë shkaku i këtij urdhri të shtetases Ajola Xoxa. **"Ava Studio" shpk, e cila është krijuar në muajin Tetor të vitit 2021 duket se është bërë menjëherë aktive në tregun e promovimit të artit**

SPRETUAR AL

**në Shqipëri.** Ndërmjet bashkëbiseduesve shkëmbehet një foto, nga ku rezulton se palët: *Robert Aliaj dhe Ava Studio kanë draftuar një akt-marrëveshje për realizimin e Festivalit Ndërkombëtar të Filmit "48 Orë". Edicioni i 12-të.* Nga draft-kontrata konstatohet se subjekti "Ava Studio" shpk ka marrë përsipër të mbështesë këtë aktivitet, duke ofruar *shërbimin e katalogut për festivalin.* Për këtë, shtetasi Robert Aliaj ka marrë përsipër t'i paguajë subjektit "AVA Studio" një shumë prej 300.000 lekë. **Në këtë pikë, shtetësja Ajola Xoxa vendos që emri i nënës së saj të mos shfaqet në kontratën që do të nënshkruhet nga palët, por ajo të përfaqësohet nga njëra prej punonjësve të zyrës "Partners Law".** ***Faqe 1081.*** **Në fakt ky vendim i shtetases Ajola Xoxa shpjegohet bindshëm nga Adela Kondakçiu, ndërsa është pyetur nga organi proceduės. Deklaruesja ka shpjeguar se qëllimi ka qenë që të shmangej shfaqja e emrit të nënës së Ajolës në praktikat e aplikimeve që bëheshin pranë Bashkisë Tiranë.**

**112.5.** Në faqen 1082 del edhe njëherë në pah kontrolli fakti që Ajola Xoxa ka mbi OJF "Eventus", ***ndërsa Xhoi Skënderasi thotë se duhet të pyesë Ajolën për vulën.*** Këtu gjithashtu interes paraqet fakti se në momentin që është lëshuar fatura e shërbimit të kryer, nuk ka ekzistuar e bërë kontrata e shërbimit përkatës. Për këtë shkak, Adela Kondakçiu "e mëson" Xhoi Skënderasin duke i thënë ***se data e kontratës duhet të bëhet në datën e faturës.*** Pra, rezulton qartë se të paktën në këtë **rast kontrata është prodhuar pas lëshimit të faturës**, fakt ky që dëshmon për fiktivitetin e gjithë procesit të kryer nga punonjëset e "Partners Law", por edhe që "Ava Studio" kontrollohet plotësisht nga shtetësja Ajola Xoxa. Me interes është se, në asnjë rresht të asnjë komunikimi, dhe organi proceduės rezulton të ketë një sasi shumë të madhe komunikimesh të zhvilluara me palë shtetasen Adela Kondakçiu, **nuk rezulton të përmendet emri i shtetases Valbona Xoxa si personi që menaxhon qoftë edhe një aspekt çfarëdo të shoqërisë që vetë ka krijuar.**

**112.6.** Megjithatë, duket se urdhri i shtetases Ajola Xoxa për të bërë një prokurë në të cilën nëna e saj Valbona Xoxa do autorizonte njërën prej punonjësve të zyrës së vajzës së saj, duket se ndesh me vështirësi teknike që lidhen me regjistrin noterial elektronik. **Ky i fundit në mesa kuptohet nuk lejon prodhimin e akteve në data të mëpasme, duke shmangur në këtë mënyrë fiktivitetin e tyre.** Por edhe për këtë shtetësja Ajola Xoxa duket se ka një zgjidhje, duke **qenë se vendosin ta bëjnë me autorizim të brendshëm të shoqërisë, që më në fund lëshohet në emër të shtetases Xhoi Skënderasi. Faqe *1090-1095.***

**112.7.** Në fakt e gjithë kjo rradhë shoqërish dhe OJF-sh, të cilat konvergojnë të gjitha tek shtetësja Ajola Xoxa dhe për të cilat do të përshkruhen në detaje fondet publike që kanë përfituar, *i ka bërë të ndërgjegjshëm bashkëbiseduesit se gjërat janë komplikuar në mbajtjen e gjithë dokumenteve dhe praktikave përkatëse.* Siç rezulton nga komunikimi i datës 1124, tek folderi i OJF "Harabel" në kompjuterin personal, është futur gabimisht edhe statuti i OJF "Eventus". Pasi pajisen më në fund me NIPT e Qendrës "Eventus", Adela Kondakçiu shfaq gëzimin e saj. Dhe sigurisht, duke parë të gjithë komunikimet e kësaj shtetase në raport me shtetasen Ajola Xoxa, është e qartë se gëzimi nuk lidhet me një detyrë të kërkuar dhe të kryer për shtetasen Linda Kazani, por me shefen e saj direkte Ajola Xoxa, e cila shfaqet gjatë gjithë bisedave tejet kërkuese, skrupuloze por edhe imponuese në kërkesat që lidhen me mbarëvajtjen e këtyre OJF-ve dhe shoqërive, që nga regjistrimi i tyre deri në mbarëvajtjen e aktivitetit dhe faturimin e të hollave. Kjo sjellje e kësaj shtetase në fakt, po të shihen edhe në

mënyrë sipërfaqësore komunikimet, ka krijuar një barrë presioni tek punonjëset, të cilat herë pas here shfaqin pakënaqësi duke përdorur dhe epitete me konotacion pexhorativ.

**112.8.** Tanimë duket si skemë e njohur krijimi dhe angazhimi i menjëhershëm i këtyre OJF-ve dhe shoqërive në tregun artistik të vendit. Edhe në rastin e "Eventus" provohet të ketë funksionuar i njëjti mekanizëm si edhe në rastin e shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar "Ava Studio". "Eventus" rezulton se është krijuar në 01.12.2021, pra, rreth së njëjtës periudhë kohore me "Ava Studio" (05.10.2021) dhe menjëherë më pas, më datë 29.12.2021 shtetaset Xhoi Skënderasi dhe Adela Kondakçiu flasim për *një projekt të Lindës (Kazanit) për të cilin duhen printuar vërtetimet e sigurimeve shoqërore, shëndetësore, llogarisë bankare. Nëse del koha sigurisht*. Faqe 1146. Aq e panjohur është e gjithë situata për shtetasen Linda Kazani, e cila duhej të ishte e përfshirë në çdo hap të ecurisë së OJF-së që vetë ka regjistruar, saqë ajo i mer leje shtetases Adela Kondakçiu për të ardhur pas disa ditësh për llogaritë bankare, për shkak se bashkëshorti i saj Erald Simixhiu është i sëmurë. Pra, në vend që të jetë e interesuar vetë shtetësja Linda Kazani për të përfunduar praktikën për aplikimin në lidhje me projektin që pritet të marrë, është shtetësja Adela Kondakçiu që vijon të interesohet se po u ikën koha. Megjithatë, të paktën shtetësja Linda Kazani, për punët e një OJF-së që e ka të regjistruar si të sajën, tregohet e disponueshme për të kaluar nga zyra pas disa ditësh.

**112.9.** Në faqen 1158-1159-1160 duket se Xhoi Skënderasi flet për një shumë të konsiderueshme të hollash, *të cilat nuk do që t'i mbajë me vete në autobuz dhe për këtë kërkon ndihmën e Adelës*. Madje ajo i kërkon Adelës *që mos bëjnë skena në zyrë dhe t'i thotë kur t'ia japi*.

**112.10.** Në vijim, kuptohet që edhe mbi shoqërinë "Arts Lab" shpk, regjistruar në emër të dajës së shtetases Ajola Xoxa, është kjo e fundit që ka kontrollin faktik. Kur Adela Kondakçiu pyet shtetasen Xhoi Skënderasi nëse e kanë vulën e "Arts Lab", kjo e fundit i përgjigjet *PO*. Po kështu, passcodi i "Arts Lab" shpk, rezulton të jetë emri dhe mbiemri i shtetases Adela Kondakçiu. *Faqe 1183*. **Në fakt, vetë shtetësja Xhoi Skënderasi thotë që *vulën e "Arts Lab" shpk e ka Ajola*. Faqe** 1184. Ndërsa flasin për projektin që OJF "Eventus" ka përfituar, Xhoi Skënderasi thotë që *Ajola ka thënë të bëjnë vetëm depozitimin e dokumenteve, **pasi projektin** dhe **koncertet i ndjek** vetë. Faqe 1224.* **Për të njëjtin projekt, Adela Kondakçiu shprehet** se *i ka shkruar Ajolës që <u>duhet regjistruar në Bashki</u>. Faqe 1231.*

**112.11.** Një moment interesant pasqyrohet në faqen 1333, kur Adela i referon Xhoit *se ka folur me Ajolën për Valbonën, për çështjen e punësimit në Universitet*. Sipas komunikimit përkatës, **Adela Kondakçiu i ka sugjeruar (për shtetasen Valbona Xoxa) të mos figurojë e punësuar meqënëse përfiton pensionin e pleqërisë, por ta kalojnë sikur ofron një shërbim, por Ajola Xoxa e ka kundërshtuar duke i thënë që** *do e leme sic eshte <u>se nuk do behemi ne shembull</u>, **ka shume pensioniste te tille qe punojne**.* Pyetjes së Xhoit *nëse atëherë do e linin tek Universiteti si e punësuar me kohë të plotë*, <u>megjithëse pensioniste në të njëjtën kohë</u>, <u>Adela i përgjigjet PO</u>. **Xhoi shton se ato e bënë detyrën.** *Faqe 1334-1335-1336*. **Në përmbledhje, shtetësja Valbona Xoxa, sipas këtyre komunikimeve rezulton se përfiton pension pleqërie, figuron e punësuar tek Universiteti si edhe supozohet se merr të ardhurat që krijohen nga shoqëria me përgjegjësi të kufizuar "Ava Studio".**

**112.12.** Në faqen 1384 evidentohet fakti që **Qendra "Eventus"** ka përfituar fonde publike nga Bashkia Tiranë. Konkretisht, Xhoi Skënderasi pyet Adela Kondakçium ***nëse faturën që duhet të lëshojnë nga "Eventus" për Bashkinë, duhet ta bëjnë më datë 12?*** Xhoi Skënderasi vijon me komunikimin duke i dërguar Adelës një foto (screenshot) ku shihet se *në listën e punonjësve të "Eventus" shënohen me laps emrat e Xhoi Skënderasit dhe Adela Kondakçiu, përkatësisht si promocion dhe udhëheqëse.* **Në këtë foto duket se bëhet fjalë për financimin e projektit "Dhoma Pranverore" i sponsorizuar nga Bashkia Tiranë.** *Faqe 1385.*

**112.12.1.** Në lidhje me këtë komunikim evidentohen dy fakte më interes për hetimin. ***Së pari,* OJF "Eventus", në pronësi ligjore të një të afërmi të ngushtë të bashkëshortes së kryetarit të Bashkisë Tiranë, por pronësi faktike të shtetases Ajola Xoxa, bashkëshorte e kryetarit të Bashkisë Tiranë Erion Veliaj, ka përfituar fonde publike në mënyrë të drejtpërdrejtë.** ***Së dyti,*** provohet akoma më tej pronësia faktike e shtetases Ajola Xoxa mbi OJF "Eventus". Në asnjë moment, të dy punonjësit që figurojnë të paguara nga shtetësja Ajola Xoxa, **nuk pyesin dhe as japin llogari tek shtetësja Linda Kazani, e cila duket se nuk ka asnjë rol në realizimin e projektit.** Nga ana tjetër, OJF "Eventus" në lidhje me projektin "Dhoma Pranverore" të financuar nga Bashkia Tiranë, duke qenë një organizatë jofitimprurëse, i duhet të shpërndajë më pas fondet e marra nga enti publik, në mënyrë që llogaritë bankare të zerohen. Për këtë, në një rast, Eventus asistohet në "promocion" nga Enejda Muzaka dhe paguan këtë të fundit në shumën 30.000 lekë (referuar faturës dërguar në format pdf gjatë komunikimit) **ndërkohë që vetë punonjësit e saj mbulojnë këtë aspekt organizativ të eventit.** *Faqe 1396.*

**112.13.** Në faqen 1429 provohet edhe njëherë pronësia faktike mbi organizatën "BYL-A" nga shtetësja Ajola Xoxa. Në lidhje me këtë, Adela Kondakçiu i kërkon Xhoi Skënderasit të bëjë një prokurë për në bankë për "BYL-A". Këtu duhet të mbahen në konsideratë edhe **deklarimet e shtetases Ina Goxhaj, e cila ka shpjeguar qartë rolin e saj krejt të parëndësishëm në këtë organizatë dhe se kush kanë qenë në të vërtetë personat që kishin kontrollin real. Aq i vërtetë është ky fakt, sa edhe prokurën që duhet ta paguajë Ina Goxhaj, si drejtoreshë ekzekutive e OJF "BYL-A", e paguan zyra e "Partners Laë", pasi shtetësja Ina Goxhaj *është në pamundësi financiare. Faqe 1445.***

**112.14.** Nga ana tjetër, situata duket kaq kaotike në drejtim të administrimit të njëhershëm të gjithë këtyre shoqërive dhe OJF-ve, saqë ata që janë **përgjegjës** për drejtimin e një prej këtyre të fundit, e gjejnë vetën të angazhuar në drejtim të menaxhimit në lëshimin e faturave të një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar siç është "Ava Studio" shpk, në dokumente në pronësi të shtetases Valbona Xoxa. Në një moment duket se gjërat ngatërrohen aq keq saqë përfituesit e fondeve publike, në këtë rast Qendra "Eventus", e cila përfiton fonde publike nga Bashkia Tiranë për projektin "Broadëay Nights 2022", nis dhe paguan familjarët e ngushtë të pronarit përfitues *de jure*. **Ose thënë ndryshe, shtetësja Ajola Xoxa, pasi përfiton fondet publike nga Bashkia që drejtohet nga bashkëshorti i saj, nis e i ndan ato nëpër familjarë të afërt. Konkretisht, shtetësja Linda Kazani, në cilësinë e pronarit përfitues në masën 100% të kësaj OJF-je, paguan bashkëshortin e saj Erald Simixhiu dhe djalin e saj Emil Simixhiu, secili në shumën 100.000 lekë, për shërbime që në një rast nuk kanë asnjë lidhje me formimin e tyre profesional.** Konkretisht, Emil Simixhiu ofron një shërbim për Qendrën "Eventus" për *Trajner Zëri ose Vocal Coach*, pa patur asnjë

SDYVETJETAL

background profesional për këtë. Ndërsa shtetasi Erald Simixhiu, bashkëshorti i pronarit përfitues Linda Kazani dhe daja i shtetases Ajola Xoxa, paguhet si pianist, që në fakt është profesioni i tij, në ndryshim nga marrja përsipër e menaxhimit të një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar siç është "Arts Lab", që në realitet menaxhohet nga mbesa e tij, shtetësja Ajola Xoxa.

**112.15.** Megjithatë, qendra "Eventus" nuk përfiton fonde publike vetëm nga Bashkia Tiranë. Në faqen 1525 evidentohet fakti se kjo qendër është financuar në shumën <u>400.000 lekë</u> edhe nga Ministria e Kulturës, për realizimin e një projekti të emërtuar "Muzika e Dhomës në bregdet". **Edhe këto fonde publike duket se shpërndahen në adresë të familjarëve të afërt të shtetases Ajola Xoxa. Konkretisht, nga shuma e përgjithshme e financimit, pjesa kryesore e të hollave i kalohet shtetasit Erald Simixhiu, i cili është ofruar të performojë si pianist.** Në këtë rast, vihet re se instrumentistët e tjerë, violinisti, violisti dhe violoncelisti paguhen përkatësisht me <u>70.000</u>, <u>70.000</u> dhe <u>60.000 lekë</u>. **Ndërsa bashkëshorti i Linda Kazanit dhe daja i shtetases Ajola Xoxa paguhet në vlerën 200.000 lekë.**

**112.16.** Edhe eventi "Broadëay Nights" i financuar nga Bashkia Tiranë, i cili organizohet nga "Eventus", i kontrolluar në fakt nga shtetësja Ajola Xoxa, sipas banerit i zhvilluar në datat 20-21 korrik 2022, **duket se i kanalizon fondet publike në drejtim të familjarëve të shtetases të saj**. Konkretisht, pjesë e trupës performuese është shtetasit Erald Simixhiu (daja i shtetases Ajola Xoxa) dhe Linda Kazani (bashkëshortja e këtij të fundit). Në këtë rast, financimi i siguruar nga Bashkia Tiranë është në <u>**vlerën 2.000.000 lekë.**</u>

**112.17.** Më datë **22.09.2022 Adela Kondakçiu njofton Xhoin** se ***lekët e bashkisë për OJF "Eventus" kishin mbërritur. Faqe 1669-1670.*** Pas marrjes së të hollave zhvillohet një komunikim me interes për hetimin mes Xhoi Skënderasit dhe Adela Kondakçiut. ***E para, i kalon me forëard Adela Kondakçiut <u>një mesazh të shtetases Ajola Xoxa</u>.*** **Kjo e fundit e udhëzon si do bëhen pagesat nga "Eventus", fakt ky që provon akoma më tej kontrollin e plotë që kjo shtetase ushtron mbi organizatën.** Por, ky komunikim zbulon dhe një fakt mbi mënyrën sesi shumat e të hollave ndahen. ***Shtetësja Ajola Xoxa i thotë Xhoit*** *që të kujtonte Adelën se për mandatpagesat e shfaqjes "Broadëay Nights" tek Intesa, të gjitha pagesat do të bëheshin nëpërmjet llogarisë bankare,* ***përveç Isakut dhe Emilit. Faqe*** *1673.* Por, Qendra "Eventus" nuk kalon shuma të hollash vetëm tek familjarët si individë. Referuar faturave nr. 53 dhe 54 të vitit 2022, **Qendra "Eventus" paguan "Arts Lab" shpk përkatësisht shumat prej <u>70.000 dhe 300.000 lekë</u>.** Tanimë, "Eventus" nuk shpërblen si *Vocal Coach* shtetasin Emil Simixhiu, pra djalin e Linda Kazanit (pronarit ligjor të "Eventus"), por këtë shërbim i faturohet nga "Arts Lab" shpk, pra nga bashkëshorti i shtetases Linda Kazani (kjo pronare ligjore e "Eventus"), i cili në këtë rast bën *trajnerin të zërit* por jo vetëm, edhe *koordinatorin e eventeve*. Në këtë rast, OJF e bashkëshortes por vetëm në dokumente ligjore, faturohet nga shpk e bashkëshortit, edhe ky i fundit pronar vetëm në dokumente ligjore.

**112.17.1.** Këto kalime shumash të hollash paraprihen nga komunikimet që ndodhen në faqen 1906, ku *Xhoi Skënderasi i thotë Adelës (financieres) se Arts Lab do duhet të lëshojë fatura për eventin e Lindës (Eventus).* Madje Adela pyet Xhoin se ***sa fatura duhet të lëshohen dhe në ca vlerash.*** Faqe 1907. Ky komunikim provon jo vetëm që vendimmarrja nuk është as në dorën e Linda Kazanit për qendrën "Eventus" dhe as të Erald Simixhiut për

"Arts Lab" shpk, (në fakt ky i fundit as përfshihet në asnjë rast për asnjë aspekt të shoqërisë "Arts Lab") **por që faturat e lëshuara janë tërësisht fiktive, edhe për arsyet që më sipër u përmendën.** Këto kalime të hollash duket se i përkasin projektit të titulluar "Zani i Shtojzovalleve", i financuar nga Bashkia Tiranë për organizatën "Eventus", projekt për të cilin Xhoi Skënderasi i dërgon Adelës edhe preventivin për Bashkinë Tiranë. Mënyra si ndahen fondet është provë e qartë e mekanizmit të krijuar. edhe pse në rastin konkret në një shkallë të reduktuar. Në rastin konkret, fondet kalojnë tek *i)* "Arts Lab" shpk (pronar ligjor jo faktik Erald Simixhiu); *ii)* tek Erald Simixhiu, *por këtë radhë jo si përfaqësues i "Arts Lab" shpk, por si individ*; *iii)* tek Emil Simixhiu, që këtë radhë duket se nuk është më *vocal coach* por instrumentist në kitarrë; *iv)* tek Arts Lab përsëri, <u>por këtë radhë si promocion</u> dhe në fund, *v)* tek pagesa e biletave të shtetasit Erald Simixhiu. **Pra, nga <u>1.280.000 lekë</u> të financuara nga Bashkia Tiranë, e drejtuar nga shtetasi Erion Veliaj, rreth <u>600.000 lekë</u>, pra gjysma e tyre përfundojnë për llogari të familjarëve të afërt të shtetases Ajola Xoxa, por edhe në favor të kësaj të fundit**, përsa **kohë provohet se është ajo që menaxhon faktikisht shoqërinë "Arts Lab"** shpk. ***Faqe 1909.***

**112.17.2.** Gjithashtu. në faqen 1926 të komunikimeve evidentohet fakti se Xhoi Skënderasi i thotë Adela Kondakçiut *të mos harrojë të presë një tjetër faturë nga "Arts Lab"*. Këtë radhë duhet *për kostumografi*. Adela nga ana e saj e pyet *<u>nëse duhej bërë atë ditë, dhe se si do e prisnin</u>*. Xhoi i konfirmon se bëhej fjalë gjithnjë për "Zanin e shtojzovalleve". **Pra, faturave të mësipërme të lëshuara nga "Arts Lab", tërësisht fiktive, i shtohet dhe një tjetër, por këtë radhë për kostumografi, për vlerën <u>30.000 lekë</u>.** Pasi më parë rreth <u>600.000 lekë</u> kalojnë nga shuma e përgjithshme prej <u>1.280.000 lekë</u>, në favor të familjarëve të afërt të shtetases Ajola Xoxa dhe vetë asaj, personat në fjalë lëshojnë dhe një faturë tjetër të mbetur, prej <u>30.000 lekë</u>, edhe këtë radhë në favor të "Arts Lab" shpk. *Faqe 1927.* Në fakt, sesi paguhen shtetasit Linda Kazani dhe Erald Simixhiu, bashkëshortë, shpjegohet fare mirë në faqen 1947 të komunikimeve. Me firmën e financieres, Linda Kazanit kalohet një pagesë prej **<u>1.050 Euro dorazi</u>** dhe në dokumentin Mandat pagesë të datës 25.11.2022 shënohet me shkrim dore se *<u>në bankë do kalojnë tek Eraldi 170.000 lekë</u>*. Pagesa prej <u>1.050 Euro</u> e dhënë në dorë dhe pjesa tjetër që do kalohet në bankë lidhen me Mbrëmjen Gala të datës **27.10.2022** të zhvilluar tek Pallati i Brigadave, *ku njëri prej bashkëshortëve ka performuar në kuadër të një kuarteti hargesh*. Pa folur **këtu për** mënyrën e **lëshimit** të këtij dokumenti në **shkelje të** hapur të legjislacionit tatimor **në** Republikën e Shqipërisë **sipas** organit procedues, *ajo që nuk kuptohet është pse palët kanë vendosur ta dokumentojnë këtë kalim të hollash dorazi, përveç se po të mendosh në këtë rast mungesën reciproke të besimit, megjithëse në kushte afërsie gjinore.* ***Faqe 1947.***

**113.** Bashkëhiseduesit nuk flasin vetëm për gjëndjen e Qendrës "Eventus" në komunikimet e tyre. Në faqen 1738, evidentohet fakti se **OJF "BYL-A"** e cila është provuar se kontrollohet nga shtetësja Ajola Xoxa, bën një pagesë për shtetasin **Ergys Krisiko** për menaxher produksioni, në masën <u>140.000 lekë</u>. **Ky i fundit, kur është pyetur në cilësinë e personit që ka dijeni për veprën penale,** *<u>ka shpjeguar se nuk kishte asnjë ide që t'i kishte ofruar ndonjëherë kësaj organizate ndonjë shërbim.</u>* Megjithatë, në komunikimet mes shtetasit Ergys Krisiko, të cilat do të vijojnë më poshtë, dalin më të qarta këto raporte fiktive të krijuara mes këtij shtetasi dhe rrjetit të OJF-ve dhe shoqërive që menaxhohen nga shtetësja Ajola Xoxa. Në të gjithë faturat e lëshuara nga këta persona apo shoqëri të tjera, që ofrojnë

shërbime për OJF-të dhe shpk e shtetases Ajola Xoxa, **është me interes për hetimin fakti se ajo që përcakton përshkrimin e shërbimit është shtetësja Adela Kondakçiu dhe jo ofruesit e shërbimit. Në më shumë se një rast këta të fundit as kanë dijeni në lidhje me faturat që u kërkohet të lëshojnë, por binden pa bërë asnjë pyetje.**

**113.1.** Menaxhimi faktik i OJF "BYL-A" konstatohet edhe në faqen 1779 të komunikimeve, kur Adela Kondakçiu i thotë Xhoit *që Inën (Goxhaj) ta lërë njëherë se ja cojnë më pas kontratën te puna për firmë.* **Dmth, punonjëset e "Partners Lab" shpk përgatisin një kontratën për OJF "BYL-A" dhe shtetësja Ina Goxhaj, e cila duhej të ishte në dijeni të çdo detaji në cilësinë e drejtorit ekzekutiv, nuk ka asnjë ide, por vetëm nënshkruan kur ja japin aktin.**

**113.2.** Nga komunikimet në faqen 1783 evidentohet se OJF "Harabel", në pronësi faktike të shtetases Ajola Xoxa, e cila rezulton të jetë edhe anëtare bordi, **por jo drejtor ekzekutiv dhe jo pronar përfitues,** role këto që mbulohen nga shtetasi Driant Zeneli, organizon një Mbrëmje Gala në Pallatin e Brigadave e cila duket se përmbyll Festivalin e Dancit Bashkëkohor Modern, **ku mbështetës rezultojnë të jetë dhe Bashkia Tiranë, por edhe OJF "BYL-A", edhe kjo në pronësi faktike të shtetases Ajola Xoxa.** Mbështetja e "BYL-A" konsiston në pagimin e një shumë të hollash prej 90.000 lekë për shtetasen Ketrina Braho, këtë radhë si individ. Kontrata e shërbimit në këtë rast është interesante, për shkak se ka për objekt ofrimin e një *shërbimi si koordinatore projekti prej shtetases Ketrina Braho,* në favor të kërkuesit të shërbimit "BYL-A", për të marrë pjesë në festivalin "International Contemporary Dance Festival in Tirana". **Për të qenë më të qartë, nga kontrata e shërbimit rezulton se një OJF si "BYL-A", në kontroll faktik të shtetases Ajola Xoxa, e cila ka përfituar fonde nga Bashkia Tiranë, i kalon një shumë të hollash shtetases Ketrina Braho, e cila nga ana e saj rezulton të jetë punonjëse e "OJF Harabel", në pronësi faktike gjithashtu të shtetases Ajola Xoxa.** Pra, për shkak edhe të kompleksitetit të lëvizjeve të të hollave, OJF "Harabel", që organizon Festivalin e Dancit Bashkëkohor Modern, e kontrolluar nga shtetësja Ajola Xoxa, mbështetet nga "BYL-A" që kontrollohet nga Ajola Xoxa dhe që është përfituese e fondeve publike nga Bashkia Tiranë, duke paguar në këtë rast jo "Harabel" drejtpërdrejt, por nëpërmjet një punonjëse të kësaj organizate (Ketrina Braho). Mekanizmi është i shpjegueshëm, përsa kohë kalimi i lekëve nga një OJF si "BYL-A" tek një OJF tjetër si "Harabel", do të bënte të ishim në gjendjen zero, për shkak se të dy këto organizata janë të detyruara të dalin pa fitim. **Por ndërkohë personat në fjalë kanë gjetur zgjidhjen, duke i kaluar një pjesë të të hollave një individi (Ketrina Braho) i cili rezulton të jetë pjesë historike e Harabel, aq sa njihet edhe si *Keti i Harabelit.* Prej këtej është e thjeshtë të arrish në konkluzionin logjik se e gjithë kontrata e shërbimit e nënshkruar mes palëve është tërësisht fiktive dhe të gjitha përfitimet koordinohen nga një dorë e vetme, shtetësja Ajola Xoxa.**

**113.3.** Në faqen 1799 bashkëbisedueset flasin në fakt për kontrata formale që dihet se janë të tilla. Ato i referohen kontratës së Inës, për të cilën Xhoi thotë *se personi që ja kërkon mos bëjë dhe analizë juridike por* vetëm ekonomike. Kur vjen fjala më pas për pagesat e balerinëve që kanë marrë pjesë në festival, në faqen 1802-1804 **konstatohet se pagesat e tyre bëhen një pjesë në bankë dhe pjesa tjetër në CASH, për shkak se kanë vendosur një çmim i cili është jo real.** Në këtë rast, për të provuar dhe më tej kontrollin që Ajola Xoxa ushtron mbi "BYL-A", shtetësja Xhoi Skënderasi thotë se ***do pyesin Ajolën për pagesat që***

***BYL-A duhet t'i bëjë koreografëve. Faqe 1802-1804.*** Konkretisht, nga komunikimet ka rezultuar se balerini Eno Peçi është paguar 3.000 Euro (pagë e deklaruar) dhe 2.000 Euro në CASH. Pra, gjithsej 5.000 Euro. Gentian Doda është paguar 7.000 Euro + një person të quajtur DINO, nga të cilat 3.000 Euro të deklaruara dhe 4.000 Euro në CASH. Ndërsa Blenardit (shiko shënimet) i janë paguar të gjitha detyrimet në CASH. *Faqe 1813.* Por, pasi mëson këtë, **Adela shprehet se** ***do flasi me Ajolën, pasi nuk ka lekë për të gjithë artistët. Faqe 1817.*** **Në fakt, këto pagesa cash, pse bëhen dhe cili person i bën konkretisht, shpjegohen edhe në deklarimet e dhëna nga shtetësja Adela Kondakiu.**

**113.4.** Gjithashtu, evidentohet nga komunikimet se *tashmë u duhet të ndryshojnë prap kontratat, në lidhje me datat e tyre dhe pagesën.* Kjo, për shkak se kanë marrë pagesa pa kontrata të firmosura. *Faqe 1822.* Në pamundësi për të bërë kontrata nga "BYL-A", Adela Kondakçiu sugjeron që kontrata për dy artistë që kanë fjetur në Hotel Padam të bëhet nga "Harabel". Megjithatë ***edhe për këtë do pyesin Ajolën. Faqe 1839.*** **Në lidhje** me Gentin, Adela thotë që ai do lëshojë një faturë, por ***do duhet të presin Ajolën që t'i thotë nëse duhet ta bëjë nga "BYL-A" apo nga "Harabeli". Faqe 1864.*** Në fakt, më pas ky shtetas, i cili duhet të jetë me mbiemrin Onuzi lëshon një faturë për "BYL-A" në shumën 30.000 lekë, më datë 03.11.2022. *Faqe 1864.* Para se kjo faturë të lëshohej, **Adela thotë që Ajola nuk po i kthen** përgjigje se **nga duhet** bërë **fatura**. *Faqe 1866.*

**113.5.** Edhe në organizimin që "Harabel" ka bërë në TOB, në datat 28-29 tetor, 31 tetor-1 nëntor, 3-4 nëntor, nga komunikimet evidentohet se Bashkia Tiranë është institucion mbështetës. **Po kështu, mbeshtetje ka ofruar edhe "Byl-A".** *Faqe 1874.*

**113.6.** Në faqen 1875 Xhoi Skënderasi pyet kur do ja japin shumën e mbetur prej 2.000 Euro në CASH Eno Peçit, nga shuma totale prej 5.000 euro. *Faqe 1875.* Por Adela i përgjigjet *se ja kishin dhënë dje. Faqe 1878.*

**113.7. Një komunikim që lidhet me shtetasin Valmir Xoxa, i cili rezulton të ketë blerë një automjet nga Ajola Xoxa dhe nëna e saj Valbona Xoxa, gjëndet në faqen 2019. Në fakt kjo kontratë shitje e përmendur më lart tregon qartë sesi ka funksionuar mekanizmi i injektimit të shumave të të hollave në llogari bankare të familjarëve të afërt të shtetases Ajola Xoxa.**

**113.8.** Në faqen 2242 shtetësja Ajola Xoxa përmendet t'i ketë thënë Adelës *që duhet të bëjë një faturë për Driant Zenelin nga shoqëria e nënës saj Valbona Xoxa, "Ava Studio" shpk.* **Pra, "Ava Studio" e kontrolluar plotësisht nga shtetësja Ajola Xoxa, duhet të lëshojë një faturë për "Harabel" OJF që kontrollohet tërësisht nga shtetësja Ajola Xoxa gjithashtu.** Por, Xhoi Skënderasi përgjigjet duke thënë *se problemi qëndron që faturën ja ka lëshuar Driant Zeneli jo nga "Ava Studio", por nga "Arts Lab"*, **një shoqëri tjetër e kontrolluar nga Ajola Xoxa.** *Faqe 2245.* **Por Ajola vendos duke thënë që jo,** ***duhet ta bëjë nga "Ava Studio". Faqe 2246.*** Pas kësaj, Xhoi Skënderasi *i thotë Adelës ok, lë të bëjnë si të duan,* siç duket e lodhur nga gjëndja e krijuar. *Faqe 2246.* Pas lëshimit të faturës nga "Ava Studio" shpk, shtetasi Driant Zeneli i kalon 5.900 Euro kësaj shoqërie, për *post produksion.* **Pra, thënë më qartë, "Ava Studio" shpk, në pronësi ligjore të shtetases Valbona Xoxa, pa asnjë kapacitet teknik, drejtuar** ***de jure*** **nga një shtetase në pension, kryen shërbime për** ***post produksion*** **për shtetasin Driant Zeneli, si individ.** Megjithëse një profesioniste në fushën e artit, pasi është diplomuar dhe ka ushtruar gjatë gjithë jetës së saj profesionin e pianistes, shtetësja Valbona Xoxa angazhohet në një fushë që lidhet me *fazën e fundit të*

SPAK SEKRETARIA

*krijimit të një projekti audioviziv, siç është një film, seria, video muzikore apo reklamë. Në këtë rast duhen sqaruar komponentët kryesorë të post produksionit, për të sqaruar distancën e kësaj shtetase dhe shoqërisë që ka themeluar me këtë proces. Komponentët kryesorë të post-produksionit janë: Montazhi i një video, Efektet vizuale (VFX), Korrigjimi dhe gradimi i ngjyrave, Përpunimi i audios, Shtimi i muzikës, Titujt dhe grafikat.* Nga konsultimi me burime të hapura, sipas organit procedues rezulton se Post-Produksioni është një proces kritik që kërkon kreativitet, përpikmëri dhe bashkëpunim mes një ekipi profesionistësh për të siguruar që projekti të jetë i gatshëm për publikim. Pra, sipas organit procedues është e qartë se një shërbim i tillë i ofruar shtetasit Driant Zeneli, përsa kohë që shtetësja Valbona Xoxa nuk ka asnjë kapacitet, por edhe përsa kohë kjo e fundit nuk provohet të ketë mbledhur rreth vetes ndonjë ekip profesionistësh të fushës, nuk mund të ketë ndodhur realisht. **Nga ana tjetër, duhet theksuar këtu se shtetasi Driant Zeneli është drejtori ekzekutiv i "Harabel" OJF. Pra, shtetasi Driant Zeneli i jep <u>5.900 Euro</u> nënës së shtetases Ajola Xoxa, nëpërmjet shoqërisë "Ava Studio" shpk, e cila kontrollohet tërësisht nga kjo e fundit. Lëshimi i kësaj fature urdhërohet nga shtetësja Ajola Xoxa. Në këtë rast, kjo e fundit vendos që lekët nuk duhet të kalojnë formalisht tek daja i saj Erald Simixhiu, pra "Arts Lab" shpk, prej ku ishte lëshuar fillimisht fatura, por tek nëna e saj, Valbona Xoxa, me shoqërinë "Ava Studio" shpk.** *Faqe 2251.* **Në faqen 2332 evidentohet fakti se vula e qendrës "Eventus" gjëndet në zyrën e shtetases Ajola Xoxa.**

**114.** Edhe nga komunikimet e shtetases **Adela Kondakçiu me shtetasen Anxhela Qunaj,** punonjëse në zyrën e Partners Laë rezulton që është shtetësja Ajola Xoxa e cila përcakton se nga cila kompani do të bëhet pagesa edhe kur bëhet fjalë për një buqetë me lule. Faqe 28. Në vijim, në komunikimet e faqes 36 i thotë (Anxhelës) që për të gjitha pagesat, e mira është të marri konfirmim nga Ajola. Faqe 36. Paraprakisht, në faqen 10 konstatohet një komunikim që paraqet interes për hetimin. Konkretisht, Anxhela Qunaj i drejtohet Adelës duke i thënë: ***Mirmengjes, sot do vij nje preventiv per parketin qe do vendoset tek <u>hyria 11/4</u>, <u>nese e aprovon Ajola do duhet ta bejme pagesen me banke nga NAAN.</u>*** Gjithnjë në lidhje me këtë pasuri, komunikimet vijojnë. Adela i drejtohet Anxhelës duke e pyetur: *<u>Po ajo fatura qe presim per parketin do behet?</u> Faqe 17.* Anxhela i përgjigjet: *<u>Nuk eshte porositur akoma. Sot mund te porositet po ne 11 e marrin punen ato te parketit. Faqe 17.</u>* Komunikimet me këtë objekt zhvillohen edhe në faqen 86, ku Anxhela i referon Adelës një informacion që duket se ka lidhje me pastruesen: *<u>Se ka pastruar vilen dy here edhe 11/4 dy here.</u>* Në faqen 87 konstatohet që Anxhela Qunaj i dërgon Adela Kondakçiut një "Rakordim" në format *excel*, i cili është printuar nga organi procedues. Nga këqyrja e tabelës "Muaji Prill 2024", rezulton se në zërin e titulluar "Partners Laë Arka", më datë 05.04.2024, është bërë përshkrimi: *Materiale ekstra për <u>shtrimin e parketit 11/4</u>. Anxhela.* Gjithashtu, më datë 22.04.2024, është bërë përshkrimi: *150 euro x Nikon që <u>bleu pocat e ndricuesve 11/4</u> (14400 lekë). Ajola (600 lekë kusur i dorëzuar).* Në faqet 89-91 zhvillohen këto komunikime mes Adela Kondakçiut dhe Anxhela Qunaj: Anxhela i shkruan Adelës: ***Se ka pastruar <u>dy here vilen edhe dy here 11/4</u> edhe sot me tha. Po pres edhe 30 min nqs vjen Ajola dhe <u>po i shkruaj nje msg</u>.*** Adela i përgjigjet: ***<u>Degjo prit me mire te vije Ajola ne zyre. Nese nuk vjen sot prit te marten. Mos ia shkruaj me sms gjera te tilla.</u>*** Anxhela kupton dhe i përgjigjet: *Ah okay.*

**114.1.** Në vijim, në faqen 126 konstatohet edhe njëherë sesi Ajola Xoxa disponon në lidhje me faturat që duhet të lëshohen herë nga Ava dhe herë nga Arts Lab. Konkretisht,



SPORTELI.AL

Anxhela i drejtohet Adelës: ***Ajola tha te bejme te njejten gje por me Arts Lab edhe ta firmosi Eraldi.*** Adela i përgjigjet: *Po eshte fatura ne emer te Ava. Është dorëzuar fatura bashkë më kontratat. Faqe 126.* Pas kësaj, duket se Anxhela komunikon me shtetasen Ajola Xoxa dhe kthen këtë përgjigje: ***Thote e vetmja menyre eshte ta ndryshojme dhe kontraten. Faqe 127.*** Adela i përgjigjet në faqen 130: *Ndersa per Jusufin do mbetet per tu sqaruar sepse ai ka bere edhe pagesen e fatures edhe zbesoj qe do pranoje te ndryshojme faturen.* Në faqen 61 konstatohet përsëri që punonjëset ngatërrohen në morinë e madhe të OJF-ve dhe shoqërive që menaxhohen nga një zyrë e vetme, **duke lëshuar gabimisht disa fatura për blerje biletash nga "Harabel". Këtë OJF e ngatërrojnë me OJF tjetër "Muza". Faqe 61.**

115. Disa komunikime të shkurtra janë evidentuar edhe mes **shtetasve Arbër Veliaj dhe Adela Kondakçiu.** Në faqen 1 dhe 2 evidentohet se shtetësja Adela Kondakçiu, pasi i prezantohet si financierja e Ajola Xoxës, i komunikon se kanë prerë një faturë për shoqërinë "Gogel" sh.p.k. në pronësi të shtetasit Arbër Veliaj, vëllai i kryetarit të bashkisë Tiranë Erjon Veliaj, nga shoqëria "Partners Lað" në pronësi të shtetases Ajola Xoxa. Pasi shtetasi Arbër Veliaj i kërkon t'ja dërgojë faturën fillimisht me foto, Adela Kondakçiu i dërgon në screenshot një faturë tatimore shitje nga "Partners Law" shpk për "Gogel" shpk, për ***shërbime konsulence ligjore, në vlerën 2.400.000 lekë.***

116. Nga komunikimet mes **shtetaseve Adela Kondakçiu dhe Ketrina Braho**, rezulton më së pari se kjo e fundit është punonjëse e OJF "Harabel". **Më pas, si edhe në komunikimet e tjera konstatohet se kjo OJF menaxhohet dhe kontrollohet tërësisht nga shtetësja Ajola Xoxa dhe askush tjetër, aq më pas drejtori ekzekutiv i saj shtetasi Driant Zeneli. Është shtetësja Ajola Xoxa që urdhëron kryerjen e çdo pagese që bëhet nga dhe për këtë organizatë.** *Faqe 31.* **Në faqen 41 vërehet qartë se Ajola Xoxa kontrollon gjithashtu edhe organizatën "BYL-A", ndërsa i thotë Ketrina Brahos se "Harabel" dhe "BYL-A" do prezantohen bashkë si organizata simotra, me qëllim rritjen e raportit financiar vjetor.**

116.1. Në faqen 47 ilustrohet raporti i krijuar mes Ajola Xoxës dhe stafit të "Harabel", ndërsa shtetësja Ketrina Braho kërkon me insistim të paguhet për punën e saj dhe Adela Kondakçiu i përgjigjet **se nuk ka akoma konfirmim nga Ajola.** *Faqe 47.* Edhe për përdorimin e kartës së "Harabel", që duhet për të paguar një ambient në *Airbnb*, **Ketrina Braho nuk merr leje nga drejtori ekzekutiv Driant Zeneli, por nga shtetësja Ajola Xoxa.** *Faqe 142.* Në faqet 166-167-168-169-170-171 e në vijim, evidentohen përpjekjet e punonjësve të shtetases Ajola Xoxa për të rritur bilancin e "Harabel". Ndërsa flitet për një faturë për Ambasadën Italiane, Adela pyet *nëse kanë fatura për ta.* **Ketrina Braho i përgjigjet se kanë mandatet që bëjnë vetë dhe se e duan ata për të rritur bilancin, duke i thënë në fund se është me Ajolën dhe se do ja shpjegojë të nesërmen nga afër.** Pasi sqaron se ka patur pagesa që duheshin bërë urgjente, Ketrina Braho i thotë se *ambasada i bie të paguajë sa ata ("Harabel") rimbursim, sa ata dhe veç e veç,* ***por Ajola do që t'ja kalojnë atyre ("Harabelit").*** Kjo, për të dalë në fund të vitit që kanë menaxhuar shumë lekë si Harabel. Problemi që kanë bashkëbisedueset dhe që konfirmon me sa përmendëm më sipër, mënyrën si duhet të funksionojnë OJF-të, është zerimi i llogarive të tyre. Konkretisht, në faqen 172 të komunikimeve, Adela i drejtohet Ketrinës duke i thënë: ***Por duhen barazuar lekët që hyjnë me fatura dalëse.*** **Pra, ky është qëllimi pavarësisht se këto fatura dalëse**

**prodhohen fiktivisht, qëllimi është që në llogaritë e OJF-ve të mos mbesin shuma të hollash.**

**116.2.** Në faqen 197-199, nëpërmjet një mesazhi zanor të dërguar në Whatsapp, **Ajola Xoxa i thotë Adelës që në lidhje me një faturë për Ambasadën Italianë e di Keti, por Adela duhet ta konfirmojë me Ajolën.** Në lidhje me fiktivitetin e personave të rekrutuar për realizimin e projekteve, mjafton të shohësh komunikimet në faqen 207-208, kur Ketrina Braho i thotë Adelës **që kishin një drejtor artistik për projektin e financuar nga Ministria e Kulturës, <u>por ai është emër kot</u>, këtë mund ta bëjë dikush tjetër.** Më pas flasin për një mbledhje fondesh, **por për këtë duhet të pyesin Ajolën.** Kontratën mund ta bëjnë dhe më vonë. *Faqe 211.* Kontrollin mbi financat e "Harabel" nga shtetësja Ajola Xoxa, e provojnë dhe komunikimet në faqen 232, ndërsa **kjo e fundit i thotë Ketrina Brahos që dhomat t'i prenotojë nga karta e "Harabel".** Në faqen 240 evidentohet vështirësia që hasin bashkëbisedueset për të kontaktuar me Ajolën dhe <u>kjo bën të pamundur konfirmimin e pagesës.</u> Por, më në fund *Ajola Xoxa i jep konfirmin për të paguar një person të quajtur Tevz. Faqe 244.*

**116.3.** Në faqen 248 evidentohet fakti se më në fund çështja e lekëve që duhet të arkëtoheshin nga ambasada italiane u zgjidh, **falë ndërhyrjes së Ajolës, e cila kishte dërguar një mesazh. Është** kjo e **fundit dhe që lajmëron Ketrina Brahon se lekët kishin kaluar.**

**116.4.** Në faqen 251-252-253 Adela pyet Ketrinën nëse liston dot disa detyra për shtetasit Olsi Efthimi dhe Fani Zguro. Ketrina i përgjigjet **se duhen për kontratën por edhe se duhet ta konfirmojë më parë me Ajolën. Nga komunikimet rezulton e qartë se zërat plotësohen në mënyrë fiktive. Ky fakt konfirmohet edhe nga deklarimet e shtetëses Ketrina Braho, e pyetur në cilësinë e personit që ka dijeni për veprën penale.** Më poshtë, shtetësja Ketrina Braho *i bën forward Adelën një mesazh të Ajola Xoxës, ndërsa kjo e fundit urdhëron që **Olsi** si arkitekt dhe Eneida si drejtoreshë ekzekutive të faturohen direkt nga "Ava Studio", pra nga shoqëria në pronësi* ligjore *të Valbona Xoxës.* **Pra, rezulton e provuar se "Ava Studio" nuk ka ofruar ndonjë shërbim, por thjesht zgjidhet si subjekt i cili duhet të faturojë fiktivisht për shtetasit e mësipërm, se kështu vendoset nga shtetësja Ajola Xoxa.** *Faqe 263.* **Në gjithë komunikimet në vijim, siç edhe është pranuar nga shtetësja Ketrina Braho në deklarimet e saj, provohet qartë se edhe "Ava Studio" shpk edhe "Harabel" OJF, por edhe "BYL-A" OJF menaxhohen në mënyrë të drejtpërdrejtë dhe janë nën kontrollin e plotë të shtetases Ajola Xoxa.** Në këtë mënaxhim ajo çfarë evidentohet është shpërndarja e faturimeve nga njëra kompani në tjetrën, <u>sipas disponimeve që bën Ajola Xoxa</u>. E thënë ndryshe, edhe sikur të marrim të mirëqenë se një shërbim ofrohet realisht nga "Harabel" apo një subjekt tjetër, **shtetësja Ajola Xoxa urdhëron se nga kush OJF apo shpk duhet të faturohet. Në fakt, nga gjithë kjo përplasje OJF-sh dhe shpk me njëra tjetrën, në shumë raste nuk kuptohet se cili në të vërtetë ofron shërbimin, përsa kohë lëshimi i faturave kushtëzohet nga shtetësja Ajola Xoxa. <u>Lëshimi i faturave fiktive nga "Ava Studio" shpk, "Arts Lab" shpk etj, konfirmohen edhe nga shtetësja Ketrina Braho, ndërsa është pyetur nga hetuesit e BKH-së.</u> Në çdo komunikim mes këtyre shtetaseve referencat janë të qarta për Ajola Xoxën. Asgjë nuk bëhet pa marrë më parë konfirmimin e saj.** Kuptohet pastaj që të gjithë këto subjekte tregtare janë në pronësi ligjore

të të afërmve të saj, **por që në fakt kontrollohen faktikisht nga vetë kjo shtetase.** *Faqe 387 e në vijim, 512-513, faqe 639-647-654.*

**116.5.** Nga komunikimet rezulton **gjithashtu** se vulën e OJF "BYL-A" e mban shtetësja Ketrina Braho, e cila gjithashtu interesohet për shumën vjetore që ka gjeneruar kjo organizatë, pa ditur që ajo duhet të jetë 0 sipas ligjit. *Faqe 659-660.* **Në lidhje me "BYL-A" në, faqen 706 evidentohet fakti se financohet nga KRK (Kongresi Rinor Kombëtar), i cili nga ana e tij financohet në shuma mjaft të konsiderueshme nga Bashkia Tiranë.** Ky fakt dhe kalimet e parave në drejtim të "BYL-A" janë evidentuar në kërkesën e organit procedues. Në faqen 817 evidentohet se OJF "BYL-A" i propozon Ministrisë së Kulturës realizimin e një projekti. E pyetur në lidhje me këtë, deklaruesja Ketrina Braho **pohon se kjo gjë është iniciuar nga shtetësja Ajola Xoxa.**

**116.6.** Gjithashtu, në llogarinë bankare të **"BYL-A"** kalojnë shuma të hollash edhe nga subjekte të tjera private si **"Balfin" dhe "Credins Bank".** *Faqe 835.* Në faqet 873-800 del qartë fiktiviteti i faturave të lëshuara si edhe pagesave të bëra, pjesërisht në bankë dhe pjesërisht në formë CASH.

**116.7.** Në faqen 951 evidentohet fakti se **"Ava Studio" shpk** ka lëshuar një faturë në gjuhën angleze, të nënshkruar nga shtetësja Valbona Xoxa për një kompani të quajtur "Boghosian Foundation", me qendër në Bruksel. Nga përshkrimi i bërë në Faturën nr. 309 duket se shërbimi i ofruar nga shpk në pronësi ligjore të Valbona Xoxës, por në zotërimin faktik të Ajola Xoxës, ka qenë 23 bileta VIP për nje show të emërtuar "Ëinterreise", më datë 28 të muajit tetor, në shumën 1150 euro. Fatura e lëshuar mban datën 19.10.2022. Gjithashtu, në përshkrim bëhet fjalë edhe për 22 bileta të tjera Vip për darkën Gala, faturuar për 1210 Euro.

**116.8. Nga komunikimet gjithashtu rezulton se "Harabel" financohet nga kompania e telekomunikacionit "ONE", e cila përfiton fonde publike nga Bashkia Tiranë. Nga ana tjetër, kjo kompani është kliente, pra paguan për shërbime marketingu kompaninë "Gogel" shpk, në pronësi të shtetasit Arbër Veliaj, vëllai i kryetarit të bashkisë Tiranë Erjon Veliaj.** Faqe 927-928. Ky fakt evidentohet edhe në faqen 968 të komunikimeve, ndërsa shtetësja Ketrina Braho i thotë Adelës se ***mund të bëjnë faturën për "ONE" nga "Harabel" 5.000 Euro*** dhe ***se ata (ONE) kanë bërë një shënim për faturën si e duan.*** Por edhe kompania "ALBTELEKOM", e cila rezulton të jetë bashkuar me "ONE", evidentohet në faqen 971 se ka firmosur me OJF "BYL-A". Për këtë, shtetësja Adela Kondakçiu fillimisht kërkon NIPT e Albtelekom dhe më pas e saktëson *duke thënë se i duhet ai i "ONE Telecommunications". Faqe 975.*

**116.8.1.** Kontrata me "Harabel", sipas fotos së shkëmbyer mes bashkëbiseduseve rezulton të jetë lidhur më datë 27.10.2022 dhe ka për objekt të saj: **Sponsorizimin, dhënien e një kontributi financiar ndaj Përfituesit të Sponsorizimit, nga shoqëria "One Telecommunications", për të mbështetur këtë organizatë jofitimprurëse.** *Faqe 975.* Në faqen 977 shtetësja Ketrina Braho saktëson ***se sponsorizimi nga "ONE telecommunications" bëhet për Harabel, ndërsa ai për "BYL-A" bëhet nga Albtelekom,*** duke shtuar se ***duhet të procedojnë vetëm me faturën prej 5.000 euro nga ONE tek "Harabel", ndërsa për pagesën tjetër do i njoftojnë ata (Albtelekom).*** Në faqen 983 Ketrina njofton Adelën se *tashmë mund të presin dhe faturën e Albtelekom nga "BYL-A", duke shfaqur gëzim për këtë lajm.* E pyetur nga Adela *nëse ata (kompania) ka thënë për ndonjë përshkrim*, Ketrina i përgjigjet, *jo, nuk*

*më thanë përshkrim.* **Edhe nga kjo rezulton e qartë se lekët jepen por as kuptohet përse jepen, përsa kohë vetë punonjëset e përfshirë në detajet e përditshmërisë së këtyre organizatave nuk kanë asnjë ide si ta bëjnë përshkrimin në faturë.** *Faqe 984.*

**116.9.** Në faqen 992-993 evidentohet pamundësia objektive për të menaxhuar këtë mori OJF-sh dhe kompanish fitimprurëse pa bërë gabime. **Në fakt, rezulton se tek Raporti Final i "BYL-A" kanë vendosur gabimisht logon e OJF "Harabel". Vetë shtetësja Ketrina Braho shprehet** ***se janë bërë lëmsh të gjitha.*** Këto komunikime të cilat përmbajnë edhe doza humori, dhe që evidentohen në faqet 993 e vijim, provojnë se tashmë menaxhimi i këtyre kompanive është bërë i vështirë. Konkretisht, pasi i thotë që i janë bërë lëmsh të gjitha, Ketrina Braho thotë: ***Sa herë kam vënë vulën e Harabel kur duhej të vija BYL-A dhe anasjelltas.*** *Edhe këto dokumentat e fundit të Ministrisë së Turizmit i vulosa me BYLEN dhe i printova nga fillimi. Adela i përgjigjet OBOBO.* Por Adela shprehet se *ata të auditit nuk besoj t'i thonë gjë,* ***por ato të KRK PO.*** Faqe 994. Ketrina i përgjigjet *se do i bëjnë prap, nuk kanë ca të bëjnë.* Faqe 995-996. Në këtë pikë, shtetësja Adela Kondakçiu i thotë *mos i përdorin më letrat me kokë dhe Ketrina i thotë ok.* Faqe 996.

**116.10.** Në faqen 997 Ketrina njoftohen nga Adela se lekët e Ministrisë së Turizmit kishin kaluar, duke shtuar se: *të paktën 1 u mbyll.* Gjithashtu, *i kërkon të bëjë të nesërmen ndryshimet te KRK të letrave me kokë që kishin bërë gabim*, në mënyrë që dosja të çohej të premten.

**116.11.** Në faqen 1024 të komunikimeve, duket se shtetësja Ajola Xoxa i ka kërkuar financieres llogarinë bankare të shtetases Linda Kazani, bashkëshortja e shtetasit Erald Simixhiu, daja i Ajola Xoxës.

**116.12.** Në faqen 1035 te komunikimeve rezulton se *Adela njofton Ketrinën që* ***lekët e Ministrisë së Kulturës kanë kaluar tek BYL-A*** *dhe i thotë që të mbyllin pagesat të nesërmen.* **Dorëzimi i lekëve tek shtetësja Ajola Xoxa nga OJF në fjalë provohen nga komunikimet e ndodhura në faqen 1050.** Shtetësja Adela Kondakçiu thotë: *Keti po për ato puantet nuk të ktheu me përgjigje ajo Alisa.* ***Se unë do t'ia dorëzoj çfarë më ka mbetur Ajolës nesër.*** Në fakt, përgjigjja e Alisës nuk pritet gjatë për pagesën e puanteve. Në faqen 1063-1064, ndërsa Ketrina *i thotë që po interesohet për puantet,* **Adela i përgjigjet se është vonë dhe shton: Unë ja dorëzova Ajolës (lekët).** Në faqen 1065 Ketrina e pyet nëse mund t'ja merrte Xhoit (Skënderasi), por Adela i thotë se ajo nuk ka. *Adela shton se duhet të flasë me Ajolën nëse është.* Faqe 1066.

**116.13.** Kontrolli i plotë i shtetases Ajola Xoxa në çdo drejtim që lidhet me funksionimin e OJF-ve në fjalë, duke nisur që nga momenti I aplikimit për projekte në institucionet shtetërore, rezulton edhe nga komunikimet e faqe 1076. **Ketrina Braho i thotë Adelës:** ***Më erdhi njoftimi nga Ajola të aplikojmë te Ministria e Turizmit.*** *Adela i përgjigjet O zot i madh, duke shtuar se edhe Linda (Kazani) po aplikon. Po këtë herë, Adela i thotë Ketrinës se do merren vetë, pasi ato janë të tmerrshme.* Faqe 1077-1078.

**116.14.** Në faqen 1079 **Ketrina njoftohet se Ministria e Kulturës më në fund ka paguar.** Ndërsa në faqen 1079-1080 njoftohet ***se ka paguar edhe ONE të dyja faturat. Tani,*** shprehet Ketrina, ***ka mbetur vetëm KRK.*** *Faqe 1081.*

**116.15. Në faqen 1083 provohet edhe një herë fakti se "BYL-A" menaxhohet drejtpërdrejt nga Ajola Xoxa. Është kjo e fundit që vendos për çdo gjë, përfshirë këtu nëse do aplikojnë nga BYL-A për festivalin apo jo.** Në lidhje me këtë, Adela pyet

Ketrinën: *Ka ndonjë shans të bëni aplikime nga BYL-A për festivalin, apo akoma se keni ndarë?* Ketrina Braho kujtohet dhe i përgjigjet *se akoma nuk kanë aplikuar në asnjë vend.* Faqe1084. Pra, Ketrina Braho që në fakt rezulton e punësuar tek "Harabel", është plotësisht e përfshirë edhe tek "BYL-A". **Komunikimet e zhvilluar për këto OJF në shumës tregojnë shumë për menaxhimin e përbashkët i cili kulmon tek shtetësja Ajola Xoxa, si personi që merret më çdo detaj të ecurisë së tyre.** Ketrina Braho, e pyetur ng Adela shprehet: *Aa po. Nuk kemi aplikuar në asnjë vend akoma.* **Pra, nuk kufizohet vetëm tek "Harabel", por e konsideron edhe "BYL-A" pjesë të natyrshme të gjithë punëve të përditshme të zyrës.** Por, mesa duket edhe kjo gjë duhet të konfirmohet nga shtetësja Ajola Xoxa. Për këtë, pasi thotë *se nuk kanë aplikuar në asnjë vend akoma*, shtetësja Ketrina Braho shprehet: ***Do ia them Ajolës.*** Ajo vijon duke pyetur Adelën: *Është më mire nga BYL-A (për festivalin)?* Faqe 1084. Megjithatë, përsëri në faqen 1085 Ketrina shprehet se: ***do me thotë ajo (Ajola) prapë.*** *Faqe 1086.* **Pra, siç edhe më sipër u përmend, çdo aplikim, çdo kontratë apo çdo lëshim fature konceptohet dhe realizohet duke patur parasysh interesa që lidhen me shpërndarjen e fondeve publike pa rënë në sy të institucioneve publike.**

**116.16.** Më datë 07.03.2023, në faqen 1104, Ketrina Braho njofton Adelën *se KRK (Kongresi Rinor Kombëtar i financuar nga Bashkisë Tiranë) kishte kaluar lekët tek "BYL-A".* **Në asnjë rast, në këto komunikime që lidhen me "BYL-A" nuk përmendet emri i shtetëses Ina Goxhaj, e cila është drejtoreshë ekzekutive e kësaj organizate.**

**116.17.** Në faqen 1109 të komunikimeve, Ketrina Braho shprehet ***se Ajola "po i hap një punë për të cilën nuk është e sigurtë a është e saktë"***. Në fakt kjo shtetase i dërgon disa foto në screenshot për një projekt, që duhet të financohet nga një entitet tjetër, të cilit *Ajola i kërkon që ta japë shumën e plotë, pasi 15% do paguajnë TVSH.*

**116.18.** Në faqen 1136 **"Harabel"**, përfaqësuar nga Ketrina Braho emërtuar në këtë rast si "Përfaqësuese e përgjithshme", **rezulton se nënshkruan një kontratë me Ministrinë e Kulturës për realizimin e një projekti të quajtur "Nga Antikiteti në Artin Bashkëkohor Shqiptar", për të cilin financohet nga ky institucion publik.** Kontrata lidhet më datë 04.05.2023 dhe mban nr. Prot. 2901 dhe emërtohet "Kontratë për mbështetjen financiar të projekteve në fushën e turizmit". E pyetur nga Adela për vlerën, shtetësja Ketrina Braho përgjigjet 30% e 640.000, pra <u>192.000 lekë</u>. Faqe 1137. Në faqen 1138 kuptohet që bëhet fjalë për këstin e parë të pagesës nga Ministria e Kulturës. Për këtë, Qendra "Harabel" lëshon faturën përkatëse e cila dërgohet me screenshot nga Adela tek Ketrina. *Faqe 1140.*

**116.19. Në faqen 1177 del përsëri qartë lëshimi i faturave me përshkrime për persona të cilët nuk janë në realitet pjesë e projekteve.** Konkretisht, Në faqen 1174 Adela Kondakçiu shprehet: <u>*Më thotë Ajola t'i bëjmë një pagesë*</u>. Në këtë rast bëhet fjalë për shtetasin italian Domenico de Chirico (faqe 1173). Por Adela për këtë pagesë kërkon një invoice (faturë). Kur Ketrina Braho *i thotë që po i them (Ajolës)*, Adela i thotë edhe si duhet ta bëjë përshkrimin: <u>"Production/coordination curator for Spa: Re project". Faqe 1176-1177.</u> **Ky komunikim por edhe komunikimi që vjen më pas provon fiktivitetin e faturave të lëshuara përsa i përket zërave në buxhet në raport me atë se çfarë paguhet në realitet. Konkretisht, pasi mer përshkrimin që duhet të bëjë, Ketrina pyet:** ***a është kjo (ky përshkrim) të buxheti?". "se ok se e bëmë, por mos e bëjmë kot". Faqe 1177-1178.*** Se në fakt, i përgjigjet Adela, <u>***koordinatore sikur vumë Ajolën***</u>. Faqe 1178. Ketrina *ja pohon një fakt të tillë.* Në këtë pikë Adela pyet Ketrinën <u>**nëse shtetasi italian është në të vërtetë pjesë**</u>

**e projektit apo jo.** Ketrina Braho i përgjigjet shkurt: **JO.** Faqe 1179. Dhe vetë vijon duke thënë *"se kjo gjëja nuk ekziston"*.

**116.19.1.** Në faqen 1180 Ketrina shprehet se *nuk mund të jetë edhe production edhe coordination ose curator,* **përshkrime këto të referuara nga Ajola për Adelën.** *Të treja këto nuk kanë shanse,* vijon Ketrina. Pra, del qartë fiktiviteti i shërbimeve të ofruara në përshkrimin e bërë në faturën e lëshuar nga shtetasi Domenico de Chirico. **Ky i fundit, në fakt është kuratori i një ekspozite tjetër, e cila është hapur vetëm para dy ditësh nga data e komunikimit mes këtyre shtetaseve (komunikimi datë 02.06.2023). Faqe 1180.** Më pas, në faqen 1181 Adela vijon duke i thënë: ***Ta bëje dicka të përgjithshme invoicen, ta bëjë vetëm kurator. Faqe 1181.*** Në përgjigje Ketrina Braho e thotë qartë se ***ky shtetas nuk ka fare lidhje me projektin Spa:re. faqe 1181.*** Por Adela vazhdon duke thënë: ***dhe përshkrimin e pagesës ia bëj unë si duam ne pastaj. Faqe 1182.*** Ketrina i përgjigjet: ***tani, nëse do e bëjmë për projektin, deklarimin hajde ta gjejmë tamam ca duhet. Faqe 1182. Pra, të duhet invoice si kurator. Faqe 1183.*** Por, Adela i përgjigjet se ***nuk ka më zëra projekti për të paguar nga Harabel. Faqe 1183.*** Në fakt fatura më në fund lëshohet nga shtetasi Domenico de Chirico për shumën për të cilën foli Adela në komunikimet më lart. Bëhet fjalë për 1.000 Euro dhe **përshkrimi është pikërisht ai që i sugjerohet nga Adela dhe Ketrina. Pra, si Kurator i ekspozitës personale "Rear-vieë mirror" të Idlir Kokës. Faqe 1190.** Pra, shtetasi italian, *sipas sugjerimeve të Ajolës* **faturën e lëshon për një event në të cilin nuk ka marrë fare pjesë.**

**116.20.** Në faqen 1211 nis një komunikim që lidhet me projektin që po bëjnë me Ministrinë e Turizmit. Adela pyet *se kur mbaron projekti,* por Ketrina i thotë *që as ka nisur akoma. 1213.* Në lidhje me këtë projekt, Ketrina shprehet **se duhet të përcaktojnë me Ajolën** *kush do të jenë personat dhe kompanitë të cilat do të marrin pagesat që në atë moment. Faqe 1214.* Në këtë faqe përmbahet edhe një screenshot i një mesazhi të shkëmbyer mes Ketrina Brahos dhe një personi të regjistruar në telefon si 'Enkeleda Ministria e Turizmit'. Ketrina i bën një pyetje në *lidhje me raportimet nga pagesat e personave që janë në buxhet.* **Ketrina vijon duke i thënë** ***nëse mund të jenë personat të stafit dhe i deklarojnë si pjesë rroge.*** Personi i cili duket se punon në Ministrinë e Turizmit i përgjigjet: *do pyes dhe do të them.* Më pas, i njëjti person i thotë: *Po, mund të jenë por duhet të sillni një bordero të firmosur dhe vulosur... faqe 1214.* Në lidhje me zërat, Adela i thotë Ketrinës *se do jenë për kurator dhe menaxher produksioni.* **Pra, është e qartë se dhe vendosja e zërave por edhe personat që supozohet do kryejnë shërbimet, të cilët vendosen nga pjesa e stafit të "Harabel", janë fiktive.**

**116.21.** Në faqen 1327 evidentohet një komunikim sipas të cilit, kompania "Gogel" shpk, e cila mbulon marketingun e IQOS, bën një sponsorizim për "BYL-A" në shumën prej 2.000.000 lekë. Ketrina shprehet *se i duhet një faturë nga BYL-A për këta (Gogel). Faqe 1328.* Adela i përgjigjet se *po i thotë edhe Ajola për një faturë që duhet të lëshohet nga BYL-A, duke menduar se është e njëjta.* Faqe 1329. Përshkrimi i faturës duhet të jetë "Sponsorizim për IQOS (për ICDF)". *Faqe 1330.* Por, Adela shprehet se: *ne sikur thamë që do i bëjmë të Harabel meqë s'ka fonde? Faqe 1334.* **Ketrina i thotë se do bëjë dhe Balfin pagesë.** *Faqe 1335.* Në këtë pikë, ***Ajola Xoxa i thotë Ketrinës***, e cila nga ana e saj ja komunikon Adelës në faqen 1336, *se fatura do bëhet nga Eventus për Gogel.* **Është e qartë se dhe "Eventus", OJF e themeluar nga Linda Kazani, bashkëshortja e dajës së Ajola Xoxës, kontrollohet**

tërësisht nga kjo e fundit, përsa kohë vendos që lekët që priten të kalojnë nga kunati i
saj, Arbër Veliaj, nuk do të xhirohen tek "Harabel" apo "BYL-A", për shkak të
veshtirësive teknike, por tek "Eventus" OJF. Për këtë të fundit rezulton qartë se nuk
merret në asnjë çast opinioni i shtetases Linda Kazani. Faqe 1336. Por shtetësja Ajola
Xoxa nuk ndalet vetëm tek përcaktimi i destinacionit të lekëve që priten të vijnë nga kunati i
saj. Në faturë, *Ajola Xoxa i thotë Ketrinës të bëjë përshkrimin: shërbim sipas kontratës.*

**116.22. Financimet nuk mbarojnë me kaq. Në vijim, Ketrina Braho i thotë**
**Adelës:** ***40.000 Euro tek Harabeli nga Fondacioni Mane***. Faqe 1338-1339. Në këtë rast, siç
rezulton nga kontrata e dhurimit e cila lidhet mes Fondacionit "Mane", përfaqësuar nga Erion
Ndrecka dhe Qendrës "Harabel", përfaqësuar nga shtetasi Driant Zeneli, i pari (Dhuruesi) ka
siguruar mbështetjen financiare nëpermjet ngritjes së fondeve dhe Kontratës së Sponsorizimit
të lidhur mes Dhuruesit dhe "Marina Residence" shpk. **Objekt i kontratës është dhurimi në**
**favor të përfituesit i një shume totale prej 40.000 Euro dhe vlera do të mbulojë**
**shpenzimet për Festivalin Ndërkombëtar të Kërcimit Bashkëkohor në Tiranë 2023.**

**116.23.** Në faqen 1344 të komunikimeve, Adela i thotë Ketrinës *të pyesë ata të Gogel*
*nëse e kanë bërë pagesën, se për këtë po e pyet Ajola.* Ketrina i konfirmon se *pagesa është*
*bërë, por te BYL-A dhe i referohet datës 26.09.2023. faqe 1344-1345.*

**116.24.** Edhe njëherë në faqen 1362 të komunikimeve, ndërsa flasin për disa pagesa
biletash për të cilat ka patur përplasje me TOB. Adela thotë se: ***ngelën duke më pyetur***
***njerëzit për gjëra po une s'ia kam haberin fare ca po bëhet.***

**116.25.** Edhe me **shoqërinë "Kontakt" shpk**, Adela vijon duke thënë se: *edhe me*
***Kontaktin sot më marrin për kontratën unë jam në një*** ". *Faqe 1363.* Ketrina i përgjigjet:
*Na e nxiu Opera me Ministrinë, po bëjnë sikur është i tyre festivali. As vende në sallë nuk po*
*na lënë për sponsorat tanë.* ***Ajolën,*** shprehet Ketrina, *nuk e ka parë më të stresuar. Faqe*
*1363-1364-1365.*

**116.26.** Për të ilustruar se si mendohet të shpërndahen fondet publike në OJF e
menaxhuara nga shtetësja Ajola Xoxa, mjafti të shihet komunikimi në faqen 1344. Ketrina
Braho duket se merr një mesazh të cilin ja bën forëard më pas Adela Kondakçiu. Në të
dërgohet një foto në screenshot, që mesa duket i përket një preventivi ku
përshkruhet ndarja e fondit nga Ministria e Kulturës për "Dance Festival" 2023. Fondi i
përgjithshëm duket se është 250.000 euro. Nga ky fond, përveç pagesave që lidhen me artistët
pjesëmarrës apo dhe kompanitë artistike si "La Veronal" dhe ajo e Blenardit (kompani
baleti), **përfshihen edhe 39.380 Euro pagesa për dy OJF që organi procedues ka provuar**
**se kontrollohen plotësisht nga shtetësja Ajola Xoxa.** Konkretisht bëhet fjalë për **"Eventus"**
**OJF** që është regjistruar në emër të bashkëshortes së dajës së shtetases Ajola Xoxa, Linda
Kazani, si edhe **"BYL-A"** që pronar përfitues ka tashmë shtetasen Reada Lemnusha prej
muajit mars 2023. Për OJF-të në fjalë pagesa që do përfitonin është 20.309 Euro ("Eventus")
dhe 19.071 euro ("BYL-A"). **Interesant edhe dhe përshkrimi. "Eventus" do ofronte**
**shërbimin kompozim baleti dhe musical (në asnjë zë nuk ka asnjë kapacitet të tillë) dhe**
**"BYL-A" do të ofronte shërbimin koreografi (asnjë kapacitet për ta realizuar).**

**116.27.** Në faqen 1381 të komunikimeve, kur flitet për pagesat e rrogave tek
"Harabel", Ketrina Braho pohon se *aty ndodhen vetëm 3 vetë, pra si punonjës të organizatës.*
**Ky fakt flet shumë për kapacitetin e OJF-së në aspekt të burimeve njerëzore dhe**

SPYETUR.AL

**rrjedhimisht dhe teknike, duke nënkuptuar kjo gjë qartë se i vetmi avantazh që kanë për sigurimin e fondeve nga institucionet publike është shtetësja Ajola Xoxa.**

**116.28.** Në faqen 1396 të komunikimeve **evidentohet përfshirja direkte e bashkisë Tiranë, në dhënien e fondeve publike në favor të një OJF-je si "BYL-A"**, e provuar që kontrollohet tërësisht nga bashkëshortja e kryetarit të Bashkisë Tiranë Erion Veliaj. **Në këtë faqe, duket se Ketrina ka marrë një mesazh dhe këtë ja dërgon Adela Kondakçiut. Konkretisht, bëhet fjalë për një akt marrëveshje të lidhur mes bashkisë Tiranë, përfaqësuar nga zv kryetari Andi Seferi dhe Qendrës "BYL-A" përfaqësuar nga shtetësja Ina Goxhaj.** Qëllimi i marrëveshjes është realizmi i projektit kulturor "Sonoma" nga La Veronal, që duhet të jetë një kompani artistike. **Sipas kontratës, Bashkia Tiranë financon realizimin e veprimtarisë në vlerën prej <u>5.000.000</u> lekë, sipas urdhrit të zv kryetarit të bashkisë nr. 30697/1 datë 15.09.2023.**

**116.29.** Në një moment, në faqen 1414 të komunikimeve, shtetësja Ketrina Braho shprehet se: *nuk është në rregull shefja jonë (Ajola). Pas festivalit ka marrë përsipër ca projekte nga këto që të mbajnë deri vonë në punë.* Ketrina, në faqen 1416 rendit *një sfilatë tek pallati i brigadave, një koncert të elsa lilës dhe shton se këto gjëra të lodhin, se ajo (Ajola) kërkon qiqra në hell. Faqe 1417.*

**116.30. Në faqen 1426 të komunikimeve edhe njëherë shihet qartë si përzgjidhen OJF-të për të kryer pagesat, jo se vërtet kanë marrë një shërbim por në varësi të kushteve dhe rrethanave të momentit.**

**116.31. Në faqen 1542 të komunikimeve evidentohet edhe një herë fiktiviteti i lëshimit të faturave nga kompanitë që Ajola Xoxa kontrollon.** Adela Kondakçiu i thotë Ketrina Brahos *të printojë pak listën e skenografisë që ta vulosë me "Arts Lab"*. Ketrina i thotë, *po tani.* Pra, është "Arts Lab" shpk këtë radhë, që zotërohet ligjërisht nga daja i shtetases Ajola Xoxa, shtetasi Erald Simixhiu, që duhet të faturojë për një <u>*listë skenografie*</u>, **ose thënë ndryshe për një shërbim që as e ka kryer ndonjëherë. Nga komunikimi shihet qartë që personi i fundit që mund të pyetet në lidhje me këto faturime është shtetasi Erald Simixhiu, i cili në asnjë moment të gjithë këtyre bisedave nuk përmendet të vendos për ndonjë aspekt të jetës së shoqërisë, aq më tepër të ofrojë realisht ndonjë shërbim për lekët që shpk e tij arkëton.** Ky i fundit, me profesion pianist, nuk ka as kapacitetin njerëzor apo teknik për të ofruar një shërbim të tillë (Lista e skenografisë), i cili është *një dokument i detajuar që përmbledh të gjitha elementet e nevojshme për krijimin e hapësirës vizuale dhe mjedisit të një skene në një produksion filmik, teatror, televiziv apo tjetër projekt artistik.* Kjo listë ndihmon ekipin e skenografisë dhe prodhimit për të organizuar dhe realizuar vizionin artistik në mënyrë të saktë dhe efikase. Duke patur parasysh elementët kryesorë që përfshihen në listën e skenografisë, të cilat *janë mobiljet dhe pajisjet, Dekorimet dhe aksesorët, Elementët arkitekturorë, Rekuizitat, Elementët e Ndriçimit, Ngjyrat dhe materialet, Planifikimi i ndërtimit dhe vendosjes*, si edhe rëndësinë e kësaj liste, *e cila siguron që çdo detaj të planifikohet dhe realizohet sipas kërkesave të skenarit dhe vizionit të regjisorit dhe shërben si udhërrëfyes për ekipin e skenografisë, duke ndihmuar në shmangien e gabimeve dhe optimizimin e burimeve*, kuptohet qartë mungesa e kompetencës së këtij shtetasi në ofrimin e këtij shërbimi.

**116.32. Po kështu, edhe shtetësja Valbona Xoxa, pronare *de jure* e "Ava Studio" nuk ka asnjë ide në lidhje me aktivitetin e shoqërisë. Në fakt është shtetësja Ajola Xoxa**

**që menaxhon çdo aspekt të funksionimit të kësaj shpk-je.** Në faqen 1553, Adela Kondakçiu thotë *që fatura nga Ava që do të jetë* <u>*3.000 euro.*</u>

**116.34.** Sa për pagesat e bëra në formë CASH, të shumta në numër, mjafton të përmendesh komunikimin në faqen 1554, ku Ketrina pyet Adelën *nëse ja kishte kaluar Gent Onuzit pagesën në bankë. Adela i përgjigjet: JO. Pagesa do bëhej në CASH.* Edhe përsa i përket pagesave të taxisë, Adela i thotë Ketrinës *që të komunikojë me Speed Taxi se faturën duhet ta lëshojnë për BYL-A, në mënyrë që t'i heqi nga lista. Faqe 1590.*

**116.35.** Në faqen 1594-1595 të komunikimeve, duket se **Ketrinës i mbërrin një mesazh nga një punonjës i Bashkisë Tiranë,** në të cilin pyetet ***se kur do i dorëzojnë dokumentet që mungojnë në fazën e dytë.*** Këtë mesazh Ketrina ja kalon Adelës duke i thënë ***që është nga Bashkia dhe duke e pyetur nëse Ajola kishte firmosur gjë apo jo.*** Adela i përgjigjet: *JO.*

**116.36. Nga komunikimet e faqes 1602 evidentohet për herë të parë fakti se shtetasi Valmir Xoxa, i afërm i Ajola Xoxës, angazhohet në zyrë.** Në fakt, Ergys Krisikon, bashkëbiseduesei e përmendin që ia kishin kaluar si detyrë Valmirit që do e sillte në 3. Po kështu, për Valmirin diskutohet që të marrë një dosje dhe ta cojë në bashki, pasi e di për çfarë bëhet fjalë. *Faqe 1610.* **Pra, konstatohet që shtetasi Valmir Xoxa është afër aktivetit të Ajola Xoxës dhe jep ndihmesën e tij për gjërat që lidhen me aktivitetin e këtyre OJF-ve. Kjo marrëdhenie farefisnore, të cilën shtetësja Ajola Xoxa kur u pyet si person që ka dijeni për veprën penale, pas hezitimit të momentit e përkufizoi si *"jo konfliktuale"*, provohet të jetë e afërt përsa kohë ky shtetas ka qenë aktiv në zyrën e "Partners Laë" shpk dhe përsa kohë, siç pohon vetë shtetësja Ajola Xoxa, kjo e fundit i ka qëndruar pranë në një moment jo të mirë të jetës së tij.** <u>**Evidetohet ky fakt nga organi proceduеs, që të kuptohet konteksti i nënshkrimit të kontratës së shitblerjes të automjet (përmendur më lart), mes Ajola dhe Valbona Xoxës nga një anë dhe kushëririt të tyre Valmir Xoxa nga ana tjetër.**</u> **Kjo kontratë në fakt paraqet mjaft interes për të kuptuar se si injektohen lekët në sistemin bankar, nëpërmjet fryrjes së çmimit të një automjeti relativisht të vjetër në vitprodhim dhe sigurisht kalimit fiktiv të pronësisë.**

**116.37.** Në faqen 1614-1615 konstatohet ***se Ajola urdhëron Ketrinën që balerinin Angjelin Preljocaj ta paguajë nga BYL-A".*** <u>Pra, është e qartë se "BYL-A" paguan për një shërbim që e ka marrë OJF "Harabel", por</u> **shtetësja Ajola Xoxa vendos ndryshe**. Në fakt, Adela pyet ***se nga është invoice,*** dhe Ketrina i përgjigjet <u>***nga Harabel, por ajo do jua kërkonte ta bënin nga BYL-A, sa të mbaronte me Ajolën.***</u>

**116.38.** Në faqen 1621 të komunikimeve, Adela shprehet *se tani për BYL-A presin të paguhet nga Bashkia dhe Kongresi Rinor Kombëtar, gjithsej* <u>*9.000.000 lekë, të ndara*</u> <u>***5.000.000 lekë nga Bashkia** dhe 4.000.000 lekë*</u> *nga* ***KRK e financuar përsëri nga Bashki.*** Kjo organizatë, siç u citua më sipër ka marrë një fond mjaft të konsiderueshëm nga Bashkia Tiranë. Lidhja me këtë të fundit bëhet edhe nëpërmjet punësimeve të bëra pranë "Gogel", kompani në pronësi të shtetasit Arbër Veliaj, vëllai i shtetasit Erion Veliaj, kryetar i bashkisë Tiranë. **Pra, thënë ndryshe, një OJF si "BYL-A" e kontrolluar tërësisht nga Ajola Xoxa, përfiton fonde publike drejtpërsedrejti nga Bashkia Tiranë dhe po ashtu përfiton fonde të tjera nga një OJF e cila financohet nga Bashkia Tiranë. Nga ana tjetër, "Harabel" e financuar nga Ministria e Kulturës dhe Turizmit, e kontrolluar tërësisht nga Ajola Xoxa, bën pagesa në favor të "Ava Studio" shpk, në pronësi ligjore të nënës së saj**

**Valbona Xoxa, duke marrë shërbime nga kjo e fundit.** Kjo evidentohet edhe në raportin e auditit që ndodhet në faqen 1634. **Pra, paratë të cilat financohen nga taksapaguesit kanalizohen nëpërmjet Ministrisë së Kulturës tek një OJF e zotëruar plotësisht nga Ajola Xoxa, e cila nga ana e saj, për të zeruar llogaritë e OJF-së (realizimin e shpenzimeve në masën 100%), siç ligji e kërkon, shpërndan një pjesë të tyre tek shoqëria me përgjegjësi të kufizuar e themeluar nga nëna e saj Valbona Xoxa, por e kontrolluar plotësisht dhe efektivisht nga vetë shtetësja Ajola Xoxa.**

**116.39.** Nga raporti i auditimit i përmendur më sipër, konstatohet se zërat kanë qenë dhe Ekspozita 1 dhe Ekspozita 2, të cilat janë financuar së bashku në masën 370.000 plus 270.000 lekë, pra 640.000 lekë. **Kjo është shuma totale e financuar nga Ministria.** Por, në faqen 1664 të komunikimeve, **shtetësja Ketrina Braho, duke pranuar** *që pagesat janë bërë, thotë që vetëm ekspozita nuk është bërë, duke mos dhënë as foto për këtë*. Gjithashtu, në faqet 1683-1684 të komunikimeve, ***konstatohet se janë lëshuar fatura të cilat nuk përkojnë me datën e aktivitetit, por me nje periudhë më të vonë.*** Për këtë, bashkëbiseduesët thonë *që audituesit nuk duhej të kishin shënuar periudhën e aktivitetit.* **Në fakt, në faqen 1685 Ketrina Braho thotë** *që do ndërronte faqen e periudhës, se Ministria e kërkonte në Nëntor.*

**116.40.** Nga komunikimet e faqes 1704-1705 konstatohet se shtetësja Ketrina Braho po pregatitet të largohet nga "Harabel". Adela i thotë gjithashtu se *i duhet të flasë me Ajolën për të ditur se deri kur do paguhet për muajin Dhjetor, që të dijë fiks çfarë date të plotësojë.* Në komunikimet që vijojnë në faqet 1737 e në vijim, bashkëbiseduesët *shprehin pakënaqësitë e tyrë për mënyrën si shtetësja Ajola Xoxa po menaxhon punët në zyrë, kur bie fjala për OJF-të dhe shpk-të që kontrollon.* Ato thonë madje që: "*kanë lajthit fare në atë zyrë*". Dhe në këtë pikë bëjnë krahasimin me zyra të tjera si funksionojnë, konkretisht për një kompani të quajtur "Vatra", në të cilën duket se ka filluar punë Ketrina Braho. Në një moment, në faqen 1748 Adela i thotë Ketrinës: *shpëtove (që u largua).* Ketrina i thotë gjithashtu *se punën e Adelës nuk e di askush, por do e ndiejnë kur të largohet. Faqe 1755.* Në faqen 1769 të komunikimeve, **Adela Kondakçiu njofton Ketrina Brahon *se lekët kaluan, si nga Bashkia Tiranë ashtu edhe nga Ministria e Turizmit.*** Me interes paraqitet edhe një komunikim në faqen 1801. Ketrina Braho thotë që i ka telefonuar Anisa e ASLV për ta pyetur *në lidhje me faturat që do presin për ata.* Paraprakisht duhet theksuar se ASLV ishte në pritje të disa fondeve që duhet t'i kaloheshin nga TKOB. **Adela, *e cila nuk ka asnjë ide për çfarë behet fjalë***, i përgjigjet: ***Pse, do bëjmë fatura ne?*** *Faqe 1802.* Nga ana tjetër, Ketrina i përgjigjet se i ka thënë Anisës: *I thashë që do ta sqarosh ti pasi ta kesh konfirmuar me Ajolën si do procedohet. Faqe 1802.* **Është i qartë nga komunikimi fakti që "Harabel" në rastin konkret nuk ka kryer asnjë shërbim për kompaninë ASLV, përsa kohë kjo kërkesë lë të habitur financieren së cilës i duhet të flasë me shtetasen Ajola Xoxa për të proceduar. Pra, do jetë Ajola Xoxa e cila do të vendosë çfarë duhet faturuar në mënyrë që lekët nga ASLV të kalojnë.**

**116.41.** Ketrina thotë *që atyre (ASLV) i ka kaluar një shumë e madhe të hollash, faqe 1803*, Adela Kondakçiu **nxjerr në pah atë që karakterizon thuajse të gjithë mekanizmin e krijuar dhe vënë në funksionim nga shtetësja Ajola Xoxa nëpërmjet OJF-ve dhe shpk-ve që kontrollohen prej saj.** Në faqen 1803 të komunikimeve, në lidhje me lekët që ka marrë ASLV-ja, dhe për të cilat i kërkohet të lëshojë fatura Harabel, Adela pyet me naivitet

por duke zbuluar një të vërtetë të pakundërshtueshme sipas organit procedues: ***Kanë për të mbajtur gjë ata?*** **Pra, nga komunikimi rezulton se në rastin konkret për ASLV është në diskutim edhe nëse do mbajnë ndonjë gjë nga shuma e mësipërme, apo do japin vetëm një pjesë për OJF-të e kontrolluara nga Ajola Xoxa.** Në fakt, shtetësja Ketrina Braho në faqen 1806 i përgjigjet: *Po.* **Në këtë rast lihet të kuptohet se në rastin konkret do mbajnë pasi kanë bërë shumë shpenzime.**

**116.42.** Në faqen 1815 të komunikimeve, Adela kërkon një konfirmim nga **"Rametal" shpk** për një transport që kanë paguar. Në faqen 1817, Ketrina i dërgon Adelës një faturë të lëshuar për "Rametal" shpk nga një shoqëri tregtare me bazë në Spanjë, Barcelonë, ku përshkruhet se "Rametal" duhet t'i paguajë kësaj shoqërie të huaj një shumë prej <u>8.326 Euro</u> për një transport të realizuar me destinacion Shqipërinë. Nga përshkrimi i faturës duket se bëhet fjalë për një event. Tek referenca duket se bëhet fjalë për "Sonoma", i përmendur pak më lart. **Pra, rezulton që shoqëria "Rametal" shpk ka financuar të paktën më këtë shumë transporti realizimin e shfaqjes "Sonoma", të financuar gjithashtu edhe nga Bashkia Tiranë me <u>5.000.000 lekë për OJF "BYL-A"</u> në zotërimin faktik të shtetases Ajola Xoxa.**

**116.43.** Në faqen 1822 Ketrina ndërsa pyet Adelën *nëse po bëhet gati të largohet, i thotë që rëndësi ka të ikësh nga ai ambient toksik.* Adela i përgjigjet se ***Ajola i ka thënë mosmirënjohëse, por të shohin si do shkojë.*** *Faqe 1824.* Ndërsa Ketrina Braho i përgjigjet: ***naaa, turppp.*** *Faqe 1824.* Adela vijon diskutimin duke i thënë se *isha gati ta mbyllte, porse* ***nuk i interesonte për momentin të prishte marrëdhenien se dihet si funksionojnë gjërat në këtë vend.*** *Faqe 1826.* Ketrina i përgjigjet që ***<u>nuk duhet të ndikohet nga fjalët e saj (Ajolës)</u>*** *Faqe 1826.* Më tej, Ketrina shton: ***<u>pasi ajo është manipuluese dhe do vetëm t'i dalë e saja.</u>*** *Faqe 1827.* Adela i përgjigjet: *Po po dihet ajo. Faqe 1827.* Ketrina i përgjigjet: ***<u>Aman se nuk e kanë të gjatë me gjerat që kanë dalë e do dalin</u>.*** *Faqe 1827. Ndaj po bëhet agresive dhe ajo. Faqe 1828.* Por Adela ja kthen: ***Por edhe asaj nuk i intereson ti prish me mua se e para ska ku gjen <u>e dyta kam kaluar shumë gjëra aty.</u>*** *Faqe 1828.* Ketrina i përgjigjet: *Po ndaj u habita që trajton ashtu. Shumë turp. Faqe 1828-1829.*

**117.** Megjithatë, për të kuptuar plotësisht si është idcuar dhe si është zbatuar në praktikë skema e përfitimeve të paligjshme nga bashkëshortja e kryetarit të bashkisë Tiranë, Erion Veliaj, shtetësja Ajola Xoxa si edhe si janë injektuar këto përfitime të paligjshme në sistemin bankar, me përfitues fundor familjen e kryetarit të Bashkisë Tiranë, **duhet të ndiqen me kujdes komunikimet mes shtetëses <u>Adela Kondakçiu dhe Ines Dani</u>.**

**117.1.** Kjo e fundit (Ines Dani) rezulton të ushtrojë aktivitet privat në fushën e avokatisë, e regjistruar si Person Fizik. Ajo çfarë është interesante dhe duhet sqaruar fillimisht, është fakti se kjo shtetase ushtron këtë aktivitet në zyrat e "Partners Law" shpk, në pronësi të shtetases Ajola Xoxa, pra, praktikisht kjo e fundit i ka vënë në dispozicion një sipërfaqe të ambientit ku vetë zhvillon aktivitetin që i përket **"Partners Laë" shpk**. Deri këtu situata duket thuajse normale, por gjërat nisin e komplikohen kur konstatohet se ky ambient i vënë në dispozicion të shtetases Ines Dani, në ndërtesën Sky Tower, e cila ndodhet në një nga zonat më të shtrenjta të kryeqytetit, **i është dhënë kësaj të fundit në huapërdorje, pa asnjë kundërshpërblim. Për të gjetur arsyen e kësaj marrëdhënie duhen parë pikërisht komunikimet e përmendura më sipër por edhe dokumentet bankarë dhe ato të tatimeve të cilat i përkasin personit fizik Ines Dani.**

**117.2.** Konkretisht, në faqen 21 të komunikimeve duket se nis një bisedë relativisht e shtrirë në kohë që ka lidhje me faturimet e personit fizik Ines Dani. Kjo e fundit, i kërkon Adelës më datë 20.05.2019: ***Unë kam nevojë patjetër për një faturim.*** Pra, një person fizik që supozohet të ushtrojë aktivitetin në mënyrë të pavarur dhe të disponojë për lëshimin e faturave për shërbimet e ofruara, i kërkon financieres së shtetases Ajola Xoxa, pronarja e zyrës ku ushtron aktivitetin personi fizik, të faturohet patjetër. Ines Dani vijon duke i thënë: ***Sepse jam sh keq me deklarimin e të ardhurave. Faqe 21.*** Në faqen 22 Ines Dani vijon: ***Më dalin shumë shpenzime dhe asnjë e ardhur. Kam kredinë, kartat e kreditit dhe sigurisht ushqehem ndërkohë. Nuk po i justifikoj dot. TË LUTEM THUAJI AJOLËS. Do t'i them edhe unë por ti mbase ke kontakt më shpejt për gjëra të tilla.*** **Pra, personi fizik që ushtron aktivitetin në ambientin e poseduar nga Ajola Xoxa, pa kundërshpërblim, pret që kjo e fundit t'i faturojë më tepër për shkak të mungesës së të ardhurave të deklaruara.** Më tej, në faqen 23, Adela i thotë: *Ok, të flas kur të takohem me të. Sepse, nuk është se keni fatura për të bërë sipas dijenisë time.* **Sipas organit procedues është e qartë se fatura për shërbime reale nuk kanë, por duhen prodhuar fatura fiktive në mënyrë që të ardhurat të rriten për të justifikuar shpenzimet e kryera.** Ines Dani i përgjigjet: ***Nuk di ç'të them. Unë jam në një situatë të vështirë. Faqe 23-24.*** Ines Dani vijon: ***SE MUA PO MË DEL ASHIQARE FSHEHJE TË ARDHURASH…kur unë i kam këto të ardhura. Kam shumë merak. Se mbi të gjithë, vë në rrezik bashkëshortin tim që është në punë shteti.*** **Pra, rezulton e qartë se të ardhurat të cilat janë marrë për shkak të klientëve të siguruar nga shtetësja Ajola Xoxa, nuk janë përfituar realisht nga personi fizik Ines Dani, përsa kohë vetë kjo shtetase pohon se të ardhurat i ka por nuk i disponon në llogaritë e saj në mënyrë që të justifikonte më pas shpenzimet. Dyshimet se këto të ardhura janë marrë dhe më pas janë shpërndarë sipas disponimit të shtetases Ajola Xoxa, provohet me komunikimet që vijojnë si edhe dokumentet e lëvizjeve bankare të administruara në fashikullin penal.**

**117.3.** Adela i përgjigjet në faqen 25: *Të them të drejtën se kam idenë. Ju duhet t'i kishit diskutuar para hapjes së NIPT it këto. Gjithsesi nëse duhet mbase mund të gjejmë një zgjidhje.* **Pra, Adela i drejtohet duke i thënë se para hapjes së NIPT it këto gjëra duhej të diskutoheshin. Është e qartë se një person fizik nuk ka nevojën të diskutojë më askënd për faturime që duhet të bëhen për të justifikuar shpenzimet që pasojnë. Konteksti në këtë rast është i qartë. Diskutimet në rastin konkret duhej të bëheshin mes personit fizik Ines Dani dhe personit që realisht menaxhon llogarinë e personit fizik, shtetases Ajola Xoxa.** Kjo rezulton e qartë në faqen 26, ndërsa Adela i thotë: ***Të flas me Ajolën.*** Ines Dani vijon duke thënë: ***Po pra, por u mendua që do faturohej më shumë nga unë. Pra, unë do kishu të ardhura. Jo kshu. Hapje NIPT i dhe asnjë faturim.*** **Këto komunikime nuk lënë më shteg për dyshime se hapja e NIPT it të shtetases Ines Dani, si person fizik, është ideuar nga shtetësja Ajola Xoxa. Arsyet dalin qartë në komunikimet që pasojnë.**

**117.4.** Në faqen 27 Ines Dani, në vijim të komunikimeve të faqes 26 shprehet: ***Kjo është lemeri. Ne e kemi folur bashkë sa do ishte mesatarisht xhiroja dhe të ardhurat. Kanë kaluar 5 muaj dhe asgjë. Sa herë kemi nevojë të flasim??? KUPTOHET QË KJO S'TË TAKON TY. PO FLAS PËR ZYRËN.*** **Pra, Ines Dani ka diskutuar paraprakisht hapjes së NIPT it të saj si person fizik, sa do ishte xhiro vjetore dhe sa të ardhurat. Ky "pakt"**



SPKTEFE.AL

**duket se nuk është respektuar.** Toni që i drejtohet financieres kur e pyet *sa herë duhet të*
*flasim* provon zhgënjimin e saj nga situata e krijuar, e cila, siç thotë ajo *nuk i takon*
*financieres, por zyrës*. Në **rastin konkret, më shumë se në çdo rast tjetër të funksionimit**
**të zyrave private tregtare,** është **e qartë** se **personi që kontrollon çdo detaj të**
**funksionimit të aktivitetit është shtetësja Ajola Xoxa. Kështu që është mjaft e qartë**
**referenca e bërë nga shtetësja Ines Dani dhe identikimi i "fajtorit" nga ana e saj.**

117.5. Megjithatë, në faqen 28 kuptohet qartë se kush vendos për faturimet.
Konkretisht, Adela Kondakçiu i përgjigjet: ***Ne kemi folur bashkë për xhiro minimale***
***maksimale. Jo për vlera faturimesh me sa mbaj mend. GJITHSESI TË FLAS ME***
***AJOLËN SE FATURIMET I CAKTON AJO.*** **Pra, rezulton e qartë se është shtetësja**
**Ajola Xoxa që cakton faturimet, çka ngjan absurde për aktivitetin e një personi fizik në**
**dukje të pavarur.** Në lidhje me këtë Ines Dani shprehet në faqen 29: ***Kemi folur sa mund të***
***shkojë NIPT i im. Unë për këtë të kam pyetur se kjo më ka interesuar që të dija ca do***
***ndodhte me shpenzimet e mia.*** Adela Kondakçiu i përgjigjet në faqet 28-29-30: ***Po pra. Sa***
***mund të shkojë limiti. SIPAS INTERESIT TË ZYRËS.*** Ines Dani i përgjigjet: ***Ok, por të***
***lutem sa më shpejt. Se po filluan të më kërkojnë shpenzime, vari lesht pastaj.*** Faqja 31 e
komunikimeve paraqet interes të veçantë gjithashtu. Adela, duke vijuar bisedën e përshkruar
më lart, i thotë Ines Danit: ***POR SE SA FATUROHET REALISHT E PËRCAKTON***
***DIKUSH TJETËR.*** Ines Dani i përgjigjet: ***Po pra. Por jo Zero. E kam ZERO fare. Kupton?***
***NUK MË THA NJERI QË DO RRINTE ZERO FARE.*** Në faqen 32 Adela i thekson përsëri
atë që tashmë dihet: ***DO TA DISKUTOJMË ME AJOLËN SE NUK VENDOS UNË.*** Ines
Dani i përgjigjet: ***Edhe unë do e flas. Por të lutem fole edhe ti. Më mirëkupto. UNË E DI***
***KUSH E VENDOS. Por si financierja e zyrës po ta parashtroj edhe ty që të flasësh për këtë***
***situatë.*** Adela i përgjigjet në faqen 33: ***Sapo të kem mundësi do flas me të.***

**117.6.** Në faqen 36-37 të komunikimeve duket se më në fund Adela Kondakçiu arrin
të flas me shtetasen Ajola Xoxa në lidhje me situatën e bërë prezent nga Ines Dani. Adela i
thotë Ines Danit: ***Për ty kam folur me Ajolën të martën dhe më tha do flas vetë me Inesin.***
Ines Dani i përgjigjet: ***Unë fola me Ajolën. Ta tha gjë për mua? Fola sot.*** Adela i përgjigjet:
***Sot jo. Se kishte punë dhe u largua s'u takuam dot.*** Por Ines Dani i shpjegon ***se çfarë i ka***
***thënë Ajola*** (faqja 37): ***MË THA QË DO FATUROJMË PAGËN TIME TË PLOTË.*** **Pra,**
**rezulton që shtetësja Ajola Xoxa vendos se çfarë do faturohet për personin fizik Ines**
**Dani, duke iu referuar pagës së plotë. Pra, një personi fizik i cili supozohet duhet të**
**gjenerojë të ardhura nga ushtrimi i aktiviteti për të cilin është regjistruar, në mënyrë të**
**pavarur, i përcaktohet sa do jetë ky faturim nga dikush tjetër, dhe për më tepër vlera e**
**faturimit i referohet një page të plotë mujore. <u>Pra, rezulton e qartë se në fakt shtetësja</u>**
**<u>Ines Dani është e punësuar tek Ajola Xoxa dhe në asnjë rast nuk ushtron në mënyrë të</u>**
**<u>pavarur aktivitetin e avokatisë, si person fizik, për të cilin dhe është regjistruar në</u>**
**<u>organin tatimor.</u>** Është fakt i njohur që për periudhën që një përson është i deklaruar si
person fizik ai nuk ka pagë, por për të paguhen vetëm sigurimet për pagën minimale. Në
lidhje me këtë vendimmarrje të Ajola Xoxës, Ines Dani shprehet në faqen 38: *Ska problem.*
Adela i thotë: *A ok.* Ines Dani i kërkon më pas: *Thjesht mos ta lëmë në harresë.* Pikërisht për
këtë pagë e cila do deklarohet si faturim, shtetësja Ines Dani e pyet Adelën në faqen 60 të
komunikimeve, ndërsa i thotë: ***Për kuriozitet të të pyes, a është hedhur paga e marsit?*** Adela
i përgjigjet në faqen 61: ***Jo nuk ka kaluar paga e Marsit, dhe s'di çfarë të them sepse nuk***

***MË KA KTHYER ASNJË PËRGJIGJE AJOLA.*** **Edhe nga këto komunikime rezulton e provuar se në fakt shtetësja Ines Dani është e punësuar tek Ajola Xoxa dhe pret si kompensim për punën që bën pagën mujore. Pra, nuk janë të ardhurat e gjeneruara nga personi fizik por paga mujore që jepet nga shtetësja Ajola Xoxa, ajo çfarë përfitohet në realitet nga shtetësja Ines Dani.**

117.7. Në faqen 64 Ines Dani vijon: ***Më thuaj çfarë do të thotë Ajola për pagën të lutem.*** Kuptohet që komunikimi i referohet pagës së muajit Mars 2020. Në faqen 65 të komunikimeve Adela i thotë: ***PJESA E MBETUR DO TË JEPET NGA AJOLA CASH, SE KUR NUK E DI SE S'KAM INFORMACION.*** Mesa duket në këtë rast për pjesën e mbetur të pagesës për lejen e lindjes që i takon shtetases Ines Dani. Në faqen 66-67-68 Ines Dani pyet: *Sa i bie të jetë pjesa e mbetur?? Se u bëmë lëmsh me këtë lejen time. Spo dimë ca do marrim.* Adela e sqaron më poshtë: *150.000 lekë duhet të kenë kaluar ose do kalojnë nga sigurimet.* ***100.000 ti kam dhënë unë. DHE 350.000 KA PËR TË DHËNË AJOLA.*** *600.000 lekë në total.* Në faqen 85 Ines Dani i kërkon sërish Adelës të flasë me Ajolën për lejen e lindjes dhe pagën. Ines Dani shqetësohet se *do kalojë koha, do mblidhen shumë detyrime dhe nuk dihet pastaj se kur do të përfundojë likuidimi.* Adela i përgjigjet në faqen 86: ***Do tia kujtoj edhe një herë se janë të gjitha pagesat për tu bërë, pa merak.*** Përsëri në faqen 86 Ines Dani i thotë Adelës: *Leja e lindjes nga siguracionet nuk ka kaluar akoma.* ***Fole gjë me Ajolën për pjesën tjetër?*** Adela i përgjigjet në faqen 87: ***Ajolës i kam shkruajtur por smë ka kthyer përgjigje fare.*** *Mbase do të ishte më mirë ti shkruaje vetë.* **Pra, personi fizik Ines Dani insiston vazhdimisht që të flasë me Ajolën në mënyrë që kjo e fundit t'i bëjë pagesat e premtuara për pjesën e mbetur.** Kjo, në një kohë që personi fizik i regjistruar në organin tatimor edhe pagesat për leje lindje duhet t'i përfitojë për shkak të punës së vet dhe pagimit të sigurimeve mbi pagën e deklaruar, dhe jo nga persona të tjerë që ligjërisht nuk kanë lidhje me subjektin privat.

**117.8.** Përsëri në faqen 88 Ines Dani i drejtohet Adelës: *Adela si je: Kemi ndonjë të re nga pagat* ***se nuk kam patur ende mundësi të flas me Ajolën?*** Në faqen 89-90 Adela i përgjigjet: *Unë kam kaluar një pjesë të pagave,* ***të premten ia kam kujtuar përsëri pagesën tënde Ajolës. Por nuk më ka dhënë, më tha do ti japim CASH përsëri, vetëm kaq.*** *Po ashtu shkruaji që të kalosh një ditë te zyra sepse ajo aty është gati çdo ditë.* ***Dhe ajo do të ta japë pagesën sepse une nuk kam gjëndje në arkë.***

**117.9.** Në faqen 93 Adela Kondakçiu i komunikon Ines Danit disa të dhëna me interes për një aspekt tjetër të hetimit, që ka lidhje me OJF "Harabel". Konkretisht: Adela Kondakçiu i thotë: *Ines duhet të bësh edhe për Harabel për njërën nga certifikatën e zyrës 10/1. Se mos harron.* Ines Dani i përgjigjet: *ok.* Në faqen 94 i dërgon një foto të marrë nga një faqe e hapur në kompjuterin personal nga *ku rezulton se ka përpiluar një kontratë huapërdorimi "Partners" - "Harabel" (shiko pjesën e sipërme të fotos).* Sipas nenit 2 të Kontratës rezulton *se Huadhënësi (Partners Laë) shpk i jep në përdorim për zyra Huamarrësit një ambient 164 m2 (apartamenti 10/1) që ndodhet në ambientin e përshkruar. Kontrata ka një afat nga 01.06.2020 deri më 30.04.2021.* **Pra, "Harabel" OJF në këtë rast, duket se ka marrë në përdorim, pa pagesë, për përiudhën 2020-2021, një ambient që ndodhet brenda zyrave që nga ana e saj ka marrë *de jure* në përdorim "Partners Laë" shpk, me pronar shtetasen Ajola Xoxa.** Në komunikimet e faqes 99 konstatohet se *Adela i dërgon shtetases Ines Dani një foto që i korrespondon një fature të lëshuar nga Ines Dani person fizik në*

*konsulencë ligjore* *adresë të Lulëzim Skera si individ, më datë 25.09.2020.* Përshkrimi është **Pra, aq sa është paga mujore që është përcaktuar** *dhe vlera e faturuar është 120.000 lekë.* **në formë faturimi për nga shtetësja Ajola Xoxa për t'ju dhënë personit fizik Ines Dani,** Në faqen 99 rezulton përsëri i qartë fakti **subjekte të tjerë, siç edhe paraqitet rasti konkret.** **merr paga nga shtetësja Ajola Xoxa,** që Ines Dani, zyrtarisht person fizik i regjistruar, **nga aktiviteti i saj** **në fakt për të ardhurat që gjenerohen** **duke mos pyetur asnjëherë** *pagat që më* **tregtar.**

**117.10.** Në faqen 99 Ines Dani pyet: *Adela, deri çfarë muaji i kishim ato* *Duhet të jetë deri në nëntor.* Adela i përgjigjet në faqen 100: *hodhe? Mban mend gjë?* Më datë 08.10.2020, në *Gjithsesi merr një statement se më duhet edhe mua dhe ta shohim.* *Ines Dani njofton se në llogarinë saj si person fizik janë kaluar për* komunikimet e faqes 102, **Pra, shuma fikse mujore e** *shërbime konsulence ligjore një shumë prej 120.000 lekë.* **si shërbime konsulence** **përcaktuar nga Ajola Xoxa për t'u paguar në formë faturimesh** **ligjore.**

**117.11. Në faqen 112 evidentohet sërish prodhimi i faturave në emër të shtetases dhe për të cilat Ines Dani, për shërbime që nuk rezultojnë të jenë kryer nga kjo e fundit, subjektet tregtarë që kërkojnë duket qartë se nuk asnjë dijeni. Jo vetëm kaq, rezultojnë të lidhur ngushtë me shërbimin, pra ata që paguajnë të hollat, në këtë rast** Konkretisht, në faqen 112 shtetësja Adela **interesa financiarë më bashkinë Tiranë.** **Pra, Ines** *tjetër nga ty sot.* Kondakçiu njofton shtetësen Ines Dani: *Kam bërë edhe një faturë* **subjektit të cilit ja ka ofruar dhe** **Dani nuk ka asnjë ide për shërbimin që ka ofruar,** **personi i parë që përmend këtë faturë** **sigurisht për faturën që** është lëshuar. Kjo, sepse **në asnjë moment** **dhe e njofton për lëshimin e saj është Adela Kondakçiu, pa ju kërkuar** Në vijim, në faqen 113 Adela i dërgon Ines Dani *me foto* **kjo gjë nga shtetësja Ines Dani.** **për faturën nr. 15 datë 26.11.2020,** *një faturë tatimore shitje.* **Konkretisht bëhet** fjalë **për subjektin** **lëshuar nga personi fizik Ines Dani, në cilësinë e shitësit të shërbimit. Nga fatura rezulton se Ines** **tregtar "FUSHA"** shpk, **në cilësinë e blerësit të shërbimit.** **në vlerën <u>9.000 euro</u>** **Dani ka faturuar "FUSHA" shpk për shërbime konsulencë ligjore** **llogaritet në vlerën** **që me kursin e kohës 1 euro=123 lekë,** *ok.* **<u>+ TVSH, gjithsej 10.800 euro,</u>** Ines Dani pasi njihet me faturën i thotë Adelës vetëm: **rreth <u>1.328.400 lekë (me TVSH).</u>** **Ines Dani kujtohet të kërkojë diçka që paraqet** **Por në këtë pikë, gjithnjë në faqen 113,** **për faturime fiktive** **provon xhirimin e parave** **shumë interes për hetimin,** përsa kohë **në llogarinë e saj si person fizik,** dhe **nga subjekte tregtarë të lidhur me bashkinë Tiranë** **të paligjshme** **mekanizmin e kalimit të këtyre përfitimeve** përsa kohë nga ana tjetër, **shfaq** **të destinacionit të të hollave,** **nëpër llogaritë bankare deri në mbylljen e plotë të ciklit** **të kujt përfundojnë ato.** **duke nxjerrë në pah mjaft qartë se në favor**

Ines Dani pasi njihet me faturën i thotë Adelës: *Amun na bëj*

**117.11.1.** Konkretisht, *<u>që të di sa janë të miat dhe sa jo.</u> Faqe 113.* *një tabelë për hyrjet dhe daljet nga llogaria ime,* Në faqen 115 Adela Kondakçiu mban premtimin Adela i përgjigjet në faqen 14: *Po do ta bëj.* E sqaron pas dërgimit të fotos së tabelës: *Ines kjo* dhe i dërgon Ines Danit tabelën e kërkuar. *nëse ke tërhequr në nëntor duhet zbritur* *ka qenë gjëndja deri në fund të tetorit me tërheqjet,* Nga tabela e derguar tek shtetësja Ines Dani *nga vlera e mbetur dmth kjo vlera <u>357.319 lekë.</u>* rezulton se totali në llogarinë e shtetases Ines Dani është <u>965.149 lekë</u>, të cilat përbëhen nga gjendja ekzistuese e llogarisë, pagat e Inesit (maj-nëntor) (ndërkohë që është person fizik).

Tërheqjet e bëra nga Inesi, në muajt Qershor Tetor, sipas tabelës janë 607.930 lekë dhe pjesa
e mbetur për t'u terhequr është 357.219 lekë.

**117.11.2. Për të sqaruar paqartësitë e organit procedues në lidhje me këtë tabelë,**
**dhe në thelb me përgjigjen e pyetjes se sa realisht përfiton shtetësja Ines Dani nga puna**
**e saj si avokate e licensuar si përson fizik, ka menduar vetë kjo shtetase në**
**komunikimet e faqes 117.** Ines Dani pasi njihet me tabelën pyet Adela Kondakçiun: ***357***
***janë të miat?*** Adela Kondakçiu **i** përgjigjet në faqen 118: ***Po.*** Por, shtetësja **Ines Dani** pas
saktësimit se sa para ishin të saj dhe sa jo, i drejtohet Adelës duke i thënë në faqen 133:
***ADELA, DO E FLAS EDHE ME AJOLËN, POR PARAPRAKISHT, NËSE DO JU***
***DUHET TË TËRHIQNI LEKË NGA LLOGARIA PF (PERSON FIZIK) IME, MË***
***THUAJ MUA MË PËRPARA QË TË TI JAP UNË DHE MOS TI TËRHEQESH TI NGA***
***LLOGARIA. (KONFIDENCIALE KJO*** ☺***).*** **Pra, më se pari është e qartë se në llogarinë**
**e personit fizik Ines Dani nuk është vetëm titullari i saj që disponon, por edhe Ajola**
**Xoxa. Jo vetëm kaq, por ky komunikim provon faktin që të ardhurat e gjeneruara** ***de***
***jure*** **nga personi fizik Ines Dani, në një mënyrë ose një tjetër, në rastin konkret**
**nëpërmjet tërheqjeve në llogari, merren nga shtetësja Ajola Xoxa.** Në lidhje me këtë
kërkesë, Adela Kondakçiu i thotë Ines Dani ***se këtë radhë pagesa, siç i kishte thënë Ajola, do***
***të kalohej ndryshe. Konkretisht:*** **Në faqen 134, në përgjigje të kërkesës së Ines Dani për**
**të mos bërë tërheqje nga llogaria e saj si person fizik,** Adela Kondakçiu i thotë: ***PAGESA***
***ME KA THËNË AJOLA QË DO KALOJË ME TRANSFERTË TE HARABEL NË FAKT.***
Sa është thënë në këtë komunikim provohet me xhirimet bankare të evidentuar në statement e
llogarisë së OJF "Harabel". **Pra, në rastin konkret,** ***sipas*** **udhëzimeve të Ajola Xoxës lekët**
**nuk do të merren direkt nga** ***llogaria*** **e personit fizik Ines Dani, në formë CASH, por do**
**të kalohen me** ***transfertë*** **bankare në një OJF të kontrolluar plotësisht nga shtetësja**
**Ajola Xoxa. Një gjë e tillë në** ***fakt*** **edhe ka ndodhur dhe është e njëjtë me mekanizmin e**
**përdorur edhe nga personi tjetër fizik që ushtron aktivitetin e avokatisë në zyrat e**
**"Partners Laë", shtetësja Greta Domi.** Ines Dani ka vetëm një përgjigje: *Ok.*

**117.12.** Në faqen 135 Adela Kondakçiu vijon diskutim në lidhje me këtë ide të
Ajolës, duke i thënë Ines Danit: ***INES MUND TË KALOJMË 4.000 EURO PLUS TVSH***
***TE HARABEL KËTË DHE PJESËN TJETËR VITIN TJETËR.*** **Thënë ndryshe, shuma e**
**të hollave që në rastin konkret kalohet nga "FUSHA" shpk tek personi fizik Ines Dani,**
**për shërbime konsulence ligjore, me urdhër të Ajola Xoxës kalohet më pas pjesërisht**
**tek organizata "Harabel". Sipas organit procedues i gjithë mekanizmi që përmendet më**
**lart, i cili nis që nga subjekti tregtar "Fusha" shpk, i lidhur ngushtë me interesa**
**financiarë me Bashkinë Tiranë, vijon me kalimin e një sasie të hollash, rreth 2.600.000**
**lekë, të ndara mes personave fizikë Ines Dani dhe Greta Domi, në llogaritë e tyre**
**bankare, dhe kalimi nga këto të fundit tek destinacioni fundor që rezulton të jetë**
**shtetësja Ajola Xoxa, sipas udhëzimeve të qarta të lëshuara nga kjo e fundit, si**
**nëpërmjet tërheqjeve në CASH ashtu edhe nëpërmjet transfertave në OJF të e**
**kontrolluara nga vetë kjo shtetase, dëshmon qartë dhe plotësisht të gjithë rrugën e**
**ndjekur për pastrimin dhe injektimin në sistemin bankar të përfitimeve të paligjshme të**
**siguruara nga bashkëshortja e kryetarit të bashkisë Tiranë, Erion Veliaj, shtetësja**

SPYETI.AL

**Ajola Xoxa, për shkak të veprimeve dhe mosveprimeve që lidhen me funksionin zyrtar të bashkëshortit të saj.**

117.13. Në faqen 155 del edhe njëherë qartë mekanizmi i kalimit të fondeve nga një përson fizik tek tjetri, i cili bëhet me qëllim fshehjen e origjinës së paligjshme të tyre. **Këtë radhë, fondet kalohen nga Ines Dani tek shtetësja Greta Domi, një tjetër person fizik që ushtron aktivitetin në zyrat e Partners Laë shpk, në pronësi të shtetases Ajola Xoxa**. Kjo, sepse personi fizik Ines Dani po përgatitet të largohet nga zyrat e "Partners Laë" shpk. Konkretisht, Adela i thotë shtetases Ines Dani: ***Sipas bisedës që kam bërë me Ajolën, pagesa jote do të ishte 50.000 lekë për muajin shkurt dhe diferencën e fondit do ta kalojmë tek Greta.*** Ines Dani i përgjigjet: *Ok. Super.* Në faqen 156 Adela Kondakçiu i shpjegon Ines Danit ***se kishte tërhequr më tepër sesa duhej nga llogaria e saj. Konkretisht:*** Adela: ***Tani ti kishe tërhequr tepër në dhjetor 42.780 lekë, ke tërhequr në shkurt 46.000 lekë dhe ke për të tërhequr akoma 61.220 lekë.*** Ines Dani i thotë: *Ok.* **Pra, del dhe njëherë qartë se mbi llogarinë e personit fizik Ines Dani, disponon financierja e shtetases Ajola Xoxa, e cila i thotë edhe kur ajo (Ines Dani) tërheq me tepër se duhet dhe se sa i kanë mbetur për të tërhequr.** Adela Kondakçiu nuk mjaftohet me kaq, por i thotë edhe ***se sa duhet të kalojnë në llogarinë e personit fizik Greta Domi.*** Konkretisht, Adela i thotë Ines Danit në faqen 157: ***Do mbash gjëndje për pagesat e sigurimeve dhe tatimit të qirasë për muajin shkurt dhe*** ***<u>i bije te Greta do kalojnë 228.000 lekë.</u>*** Më tej, në faqen 157 Adela pyet Ines Danin: *Ti do mbash NIPT in hapur apo do ta pezullosh në vazhdimësi?* Ines Dani i përgjigjet: *Do ta mbaj për momentin.*

**117.14.** Në faqen 164 të komunikimeve nis një bisedë më mjaft interes për hetimin gjithashtu. Konkretisht: Adela Kondakçiu i drejtohet Ines Danit: ***Ines ajo më tha që datën do vendosësh atë datë kur ke dorëzuar "Laë Proposal". Për përshkrimin e faturës duhet të sqarojë project manageri. Më ka dërguar NIPTin e Bashkisë që ta bëj faturën.*** Në rastin konkret bëhet fjalë për një kontratë shërbimi të lidhur mes Bashkisë Fier dhe Ines Danit, për **<u>ekspertizë të jashtme në propozim legjislacioni</u>**. **Pra, Ines Dani merr përsipër të ofrojë ekspertizë ligjore për ndryshime apo draftime ligjesh. Pagesa e rënë dakord mes palëve për këtë shërbim është <u>24.650 Euro</u> dhe kontrata duket se është lidhur më datë <u>19.12.2019</u>. Nga komunikimet që do të vijojnë rezulton e provuar se Ines Dani nuk ka asnjë dijeni për kontratën dhe sigurisht nuk do të jetë as përfituese e të hollave që do të paguhen për shërbimin që ka marrë përsipër të kryejë.** Konkretisht, në faqen 166, në përgjigje të bisedës së Adelës, Ines Dani thotë: ***TË THEM TË DREJTËN DETAJET NUK I DI. LIDHUR ME AGRONIN. Se ai e ka depozituar.*** Pas kësaj nisin përpjekjet e Adela Kondakçiut për të përfunduar praktikën me qëllim final kalimin e të hollave. **Interesi i treguar rezulton i qartë vetëm nga financierja Adela Kondakçiu dhe sigurisht jo për përfitim vetjak të saj. Ndërsa Ines Dani, e cila në rastin konkret duhet të përfitojë një shumë të konsiderueshme të hollash, i thotë të merret me Agronin dhe që ai t'i japi edhe numrin e projekt manager, për të cilin është e qartë se Ines Dani nuk ka asnjë kontakt. Më tej, në faqen 167, del qartë si është hartuar dhe nënshkruar kontrata, në padijeni të plotë të shtetases Ines Dani. Kjo e fundit thotë:** ***<u>ME KUPTO. UNE VETËM EMRIN KAM ATY. NUK DI DETAJET.</u>*** Adela e pyet në faqen 168: ***Po kontratë ke firmosur ti?*** Ines Dani i përgjigjet: ***Ja ta dërgoj.*** Adela, pasi ka folur me Agronin në lidhje me këtë pagesë që duhet të bëhet nga Bashkia Fier, i drejtohet Ines Danit: ***Ines unë fola me këtë Agronin dhe***

*më tha që duhet fatura më datë dhjetori, që i bije duhet të modifikojmë të gjitha deklarimet dhe të paguajmë edhe TVSH për atë vlerën.* **Në këtë pikë, shtetësja Adela Kondakçiu thërret në skenë atë që duket se është iniciatorja dhe personi që ka siguruar në të vërtetë kontratën me Bashkinë Fier.** Ajola thotë: ***TË SQAROHEM EDHE NJË HERË ME AJOLËN?*** Ines Dani natyrshëm i përgjigjet: ***PO. UNE NUK KAM CA TË BEJ.*** **Pra, personi fizik që duhet të përfitojë të hollat e konsiderueshme nga Bashkia Fier, nuk shfaq interes në lidhje me këtë, duke thënë qartë që ajo veç firmën ka vënë dhe *se duhet folur me Ajolën pasi ajo nuk ka ca të bëjë.***

**117.14.1.** Edhe kur Adela e pyet në lidhje me vlerën finale, *nëse ajo është 24.650 euro. (faqja 171), Ines Dani i përgjigjet:* ***PO, BESOJ.*** Adela, në të njëjtën faqe vijon duke e pyetur: ***Ti nuk ke firmosur kontratë?*** Ndërsa Ines Dani në faqen 172 i përgjigjet: ***une di që e kam firmosur para ca muajsh. ose më saktë 1 vit fare. ISHA ME LEJE LINDJE KUR FIRMOSA SHPEJT E SHPEJT POSHË SHPISË.*** Kur Adela e pyet nëse kanë kopje, Ines Dani i përgjigjet në faqen 173: ***JO, UNE JO.*** Nga i gjithë komunikimi por edhe ai që do pasojë provohet qartë se fondet publike të cilat do të jepen (siç rezultojnë më pas të jenë dhënë) nga Bashkia Fier, në formë shërbimi për konsulencë ligjore, **jané siguruar nëpërmjet ndikimit të ushtruar nga shtetësja Ajola Xoxa tek autoritetet e bashkisë Fier, dhe kjo e fundit është përfituese fundore e tyre, siç do të provohet në vijim.**

**117.15.** Duke iu rikthyer lëvizjeve në llogarinë e personit fizik Ines Dani, kjo e fundit, në faqen 174 i thotë Adela Kondakçiut, praktikisht duke i dhënë llogari: *Unë tërhoqa 40.000 të reja nga llogaria. Kisha aq në gjëndje.*

**117.16.** Më datë 04.05.2021, në faqen 179 të komunikimeve, Adela i thotë Ines Danit: ***Po duhet marrë edhe një statement për pagesën e Fierit nëse ka kaluar. Agroni tha që në prill do të mbyllej.***

**117.17.** Më datë 06.05.2021, në faqen 180 të komunikimeve, duket se Ines Dani ka bërë aplikim për pezullim të aktivitetit të saj si person fizik, por nuk di nëse i është aprovuar. Në fakt nuk i është aprovuar se, *sipas njoftimit të Adelës, ka detyrime tatimore të papaguara.*

**117.18.** Më datë 15.06.2021, në faqen 200 të komunikimeve, Adela njofton Ines Danin **se pagesa nga Bashkia Fier kishte kaluar një ditë më parë.** Në këtë pikë, biseda bëhet interesante. Adela pyet Ines Danin: ***Keni rënë dakord si do tërhiqen fondet apo ta diskutoj unë?*** **Kuptohet qartë se tërheqja e këtyre fondeve, të cilat supozohet të jenë të personit fizik Ines Dani, pra në thelb të shtetases Ines Dani, duhet të diskutohet paraprakisht me persona të tjerë.** Adela thotë që mund të diskutonte dhe ajo. **Në këtë rast, si edhe në rastet e tjera, është e qartë se personi i vetëm me të cilin mund të diskutonte diçka të tillë, për shuma të tilla, është shtetësja Ajola Xoxa.** Ines Dani në faqen 201, për fondet që supozohet të ishin të saj për shkak të shërbimit të ofruar në kontratë, i thotë: ***DISKUTOJE.*** Adela i përgjigjet: OK.

**117.18.1.** Pikërisht në këtë periudhë, në faqen 204, Adela i dërgon Ines Danit ~~një faturë të thjeshtë tatimore e cila duket se është lëshuar fiktivisht rreth dy javë para kalimit të fondeve nga Bashkia Fier.~~ **Një përfundim i tillë arrihet duke parë formën e faturës, e cila mund të lëshohet në çdo moment në vitin 2021 por të deklarohet brenda vitit, për shkak të mungesës së sistemit online në kohë reale. Gjithashtu, në rend kronologjik tek komunikimet e administruara, fatura i është dërguar shtetases Ines Dani pas kalimit të fondeve nga Bashkia Fier dhe jo më parë. E thënë më thjesht, fatura është lëshuar më**

__parë për të shmangur dyshimin se menjëherë me kalimin e fondeve nga Bashkia Fier në__
__favor të Ines Danit, kjo e fundit ka kërkuar shërbime të cilat do të paguheshin në favor__
__të personit fizik Greta Domi.__ Nga ana tjetër, përshkrimi i faturës është një element tjetër me
interes për hetimin. **Në këtë rast, një person fizik si Greta Domi, në fushën e avokatisë, i**
**ofron shërbime konsulence ligjore një personi tjetër fizik në të njëjtën fushë,** shtetases
**Ines Dani, e cila "ka qëllnar" që në të njëjtën periudhë kohore të ketë përfituar një**
**shumë të konsiderueshme nga Bashkia Fier. Fatura në fjalë mban numrin 6 dhe është**
**lëshuar për konsulencë ligjore për vlerën __1.234.000 lekë.__** Pasi Adela i dërgon faturën, i
thotë: *Fatura e Gretës (faqe 204)*. Ines Dani i përgjigjet: *Ok*. Paqartësia e Ines Danit në
ndarjen e të hollave tregohet edhe në faqen 221 të komunikimeve, ndërsa Adela i thotë që ka
një gjëndje kreditore të tatimet në vlerën 46.703 lekë, dmth që shteti duhet t'i japë lekë Inesit.
Në lidhje me këtë, Ines Dani pyet: ***Janë të miat apo tuajat?***

**118.** Me mjaft interes për hetimin, me qëllim për të kuptuar si financohen shoqëritë
me përgjegjësi të kufizuar të krijuara nga familjarë të afërt të shtetases Ajola Xoxa, por të
kontrolluara faktikisht nga kjo e fundit, jane edhe komunikimet mes shtetases Adela
**Kondakçiu dhe një personi tjetër, emri i të cilit në aparatin celular të kësaj shtetase**
**është regjistruar "Financa Rametal".**

**118.1.** Konkretisht, në faqen 1 kjo shtetase që duket se eshtë e seksit femër, i shkruan
Adela Kondakçiut duke i thënë se është ekonomistja e Marisës. **Në këtë rast bëhet fjalë për**
**shtetasen Marisa Nito, bashkëshortja e shtetasit Elman Abule, pronar i "Rametal"**
**shpk.** Në faqen 2 ekonomistja e "Rametal" shpk njofton Adelën *se do bëjë një kalim 20*
*(duket se bëhet fjalë për shumë të hollash) në ditën e komunikimit, pra më datë 15.11.2022.*
Për këtë kalim, kjo shtetase pyet *se cilën nga faturat do ishte më mirë të mbyllte.* Adela i
përgjigjet: ***Të lutem nëse mund të bësh një faturë që është nga Greta Domi Person Fizik***
***dhe pjesën tjetër pastaj te Arts Lab.*** Ekonomistja i përgjigjet: *në rregull.* **Sipas organit**
**procedues është e qartë se faturat janë lëshuar nga personi fizik Greta Domi në mënyrë**
**krejt fiktive, duke patur në konsideratë këtu edhe mënyrën si funksionin këta persona**
**fizikë pranë zyrës së shtetases Ajola Xoxa, por edhe përsa kohë vetë ekonomistja e**
**"Rametal" shpk nuk ka asnjë ide për këtë fakt, duke thënë vetëm dakord.** Kjo provohet
edhe më tej nga komunikimet e datës 09.01.2023, në faqen 6, ku ekonomistja e "Rametal"
shpk, i lejon vetes të mendojë për shpërndarjen e të hollave mes shoqërive që kontrollohen
nga Ajola Xoxa. Konkretisht, ekonomistja e "Rametal" shpk, në faqen 6 i komunikon Adela
Kondakçiut: ***Do bëj një likujdim sot prej 20.000 (duket se është në monedhën euro). Cilën***
***nga shoqëritë të mbyll? MENDOVA 12 AVA STUDIO DHE 8 NGA ARTS LAB. Është ok?***
***DHE PASTAJ NA MBETET 25 NGA ARTS LAB.*** **Pra, rezulton e qartë se shpk në fjalë**
**kanë faturuar për shërbime të pakryera ndonjëherë, përsa kohë nuk kanë çfarë të**
**ofrojnë duke patur parasysh objektin e aktivitetit të tyre në raport me një shoqëri që**
**operon në fushën e aluminit si "Rametal" shpk, por edhe shoqëritë e tjera që zotërohen**
**nga bashkëshortët Elman Abule dhe Marisa Nito.**

**118.2. Vetë komunikimet e ekonomistes së "Rametal" shpk, e cila vendos si do**
**shpërndahen fondet, __pra rëndësi ka që të shpërndahen dhe jo se kujt i shpërndahen,__**
**provon më tej fiktivitetin e pagesave që kryhen për shërbime të supozuara të ofruara**
**nga shpk e kontrolluara nga shtetësja Ajola Xoxa.** Mbahet në konsideratë këtu edhe
njëherë se, "Ava Studio" është themeluar nga shtetësja Valbona Xoxa dhe "Arts Lab" shpk

SPVETUET.AL

nga shtetasi Erald Simixhiu, përkatësisht nëna dhe daja i shtetases Ajola Xoxa. Të dyja shoqëritë kanë karakter fitimprurës. Adela, në lidhje me këtë bisedë i thotë në faqen 7: ***Po më mirë të mbyllni*** ***<u>Ava një herë.</u>*** Ekonomistja i përgjigjet: *Në rregull*. Por pagesat nga "Rametal" shpk vijojnë: Në faqen 9 Adela *i kërkon ekonomistes të konfirmojë pagesat që kane mbetur për t'u bërë nga Rametal*. Përgjigja e dërguar në faqen 11 është: ***Ndjesë për vonesën por kam qenë e zënë dje, Detyrimi i Rametalit: Partners=25.200 euro. Ava Studio=18000 euro.*** ***<u>Është edhe dicka e hapur me kompaninë Jedas por nuk jam shumë e qartë.</u>*** Pra, "Rametal" shpk i detyrohet ende "Partners Laë" shpk të shtetases Ajola Xoxa <u>25.200 Euro</u> dhe "Ava Studio" shpk të Valbona Xoxa, nënës së Ajola Xoxa, kontrolluar *de facto* nga kjo e fundit, një shumë prej <u>18.000 euro</u>. **Por, ekonomistja njofton financieren e shtetases Ajola Xoxa që ka dhe dicka të hapur (supozohet një pagesë) me kompaninë Jedas**, e cila shfaqet për herë të parë në komunikimet. Madje ajo shton: ***nuk jam shumë e*** *qartë*. ***<u>Është bisedë ndërmjet shefave</u>***. <u>Këto komunikime që dëshmojnë mënyrën e financimit të shtetases Ajola Xoxa tek të dy shoqëritë e menaxhuara prej saj, prej një subjekti tregtar pronari i të cilit rezulton i lidhur ngushtë me bashkinë Tiranë, si për shkak të njohjes personale me kryetarin e saj Erion Veliaj ashtu edhe me përfitime të lidhura me bashkinë që ky shtetas drejton, hedhin edhe pikëpyetje në lidhje me një shoqëri tjetër, të emërtuar Jedas, për të cilën ekonomistja e "Rametal" shpk jep llogari që ka disa pagesa të palikuiduara tek financierja e shtetases Ajola Xoxa, Adela Kondakçiu.</u> Adela nga ana e saj, në faqen 12 i kthen përgjigjen: ***Jemi në rregull për Rametal.*** ***<u>PËR JEDAS KAM FOLUR ME SHEFEN SKA PROBLEM</u>*****. Duke patur në konsideratë se "shefja" e Adelës, referuar të gjitha komunikimeve nga organi procedues, është shtetësja Ajola Xoxa, duket se ekziston dyshimi që edhe shoqëria "Jedas", ka lidhje me këtë të fundit.**

**118.3.** Më tej, ekonomistja e "Rametal" shpk i thotë Adelës në faqen 13: ***Sapo mora një konfirmim nga shefi. Javën e ardhshme do procedojme me një pagesë prej 30.000 (supozohet në monedhën Euro).*** Në faqen 15 Adela i kërkon të konfirmojë *nëse është bërë ndonjë pagesë.* Ekonomistja i përgjigjet në faqen 16: ***Brenda ditës së premte do mbyllim të gjitha faturat sipas konfirmimit*** ***<u>me shefat.</u>*** Në fakt, në faqen 18 të komunikimeve ekonomistja e "Rametal" shpk i dërgon Adelës dy pagesa të kryera më datë 20.09.2023. Konkretisht bëhet fjalë për pagesën e bërë për "Partners Law" shpk në shumën prej <u>37.200 Euro,</u> për likuidim të faturave nr. 3/2023, 4/2023, 17/2023. Pagesa tjetër bëhet për "Ava Studio" në shumën <u>18.000 euro</u>, për likujdim të faturës 2/2023. Por, pasi e falënderon, Adela Kondakçiu i kujton *se janë dhe disa fatura që janë lëshuar për shoqërinë "Sapienta" dhe që duhej të fliste një herë për pagesat e tyre. Faqe 19.* **Paraprakisht sipas organit procedues duhet sqaruar se, shoqëria "Sapientia" e formës tregtare me përgjegjësi të kufizuar, është themeluar dhe përfaqësohet nga shtetësja Marisa Nito, bashkëshorte e shtetasit Elman Abule, i cili zotëron shoqërinë "Rametal" shpk, që ka kryer pagesat e përmendura më sipër.** <u>Por pagesat mesa kuptohet nga komunikimet dhe siç rezulton dhe nga dokumentet bankarë, nuk bëhen veç nga shoqëria "Rametal" shpk në favor të</u> bashkëshortës së kryetarit të bashkisë por edhe vjehrrës së këtij të fundit, por edhe nga shoqëria tjetër e bashkëshortes së pronarit të Rametal, "Sapienta", shtetësja Marisa Nito. **Me interes për hetimin këtu është fakti se kjo shoqëri, pra "Sapienta" ka për objekt të aktivitetit të saj tregtar edhe ofrimin e shërbimeve për konsulencë ligjore. Duke patur këtë kapacitet ekspertize, kjo shoqëri e krijuar për të ofruar shërbime konsulence**

**ligjore paguan shifra të konsiderueshme në favor të një shoqërie tjetër që ka për objekt të njejtën fushë aktiviteti, atë të shërbimeve ligjore, pra "Partners Laë" shpk. Pa përmendur këtu që do të ishte më e arsyeshme dhe e besueshme që edhe "Rametal" shpk, në pronësi të Elman Abules të shfrytëzonte ekspertizën ligjore të shoqërisë "Sapientia" shpk, në pronësi të bashkëshortes së tij Marisa Nito. Shfrytëzimi i një mundësie të tillë me siguri do rezultonte në fund edhe në uljen e shpenzimeve "astronomike" të treguara më poshtë, të bëra nga "Rametal" dhe "Sapientia" shpk në vetëm 2 vite, vetëm për konsulenca ligjore.**

**118.4.** Në vijim, në faqen 20, ekonomistja e "Rametal" shpk i thotë *se për Sapientën do të ketë konfirmimin javën e ardhshme, por në këtë pikë i kërkon një "nder"*. Ekonomistja i kërkon Adela Kondakçiut në faqen 20: ***Por të lutem faturën e fundit të datës 07.09 mundeni ta bëni me Rametal? Meqë akoma nuk është mbyllur muaji.*** **Pra, rezulton qartë që edhe nëse do pranojmë që ka patur vërtet një shërbim nga shoqëritë e kontrolluara nga Ajola Xoxa, në rastin konkret nga "Partners Law" shpk, ky shërbim nuk ka qenë ofruar për "Rametal" shpk, por duket për një nga shoqëritë e tjera të kontrolluara nga bashkëshortët Elman Abule dhe Marisa Nito.** Pasi e saktëson për cilën faturë bëhet fjalë, dmth atë të lëshuar nga Partners, *Adela shprehet dakord për ta bërë për Rametal. Faqe 21.* Kjo rezulton akoma më qartë në faqen 22, kur Adela i thotë: ***FATURËN E MODIFIKOVA***. Më pas i kërkon edhe *likujdimin e një fature nga Sapienta në vlerën 3.000 Euro, e cila ka mbetur nga vitet e kaluara.* Ekonomistja ja konfirmon vlerën e vjetër prej 3.000 Euro dhe i thotë: *dhe 12 këtë vit.* Duke iu referuar faturës që është bërë ditën e sotme (datë 21.09.2023) për "Rametal" shpk, *pasi i ka kërkuar ta modifikojë atë. Faqe 24.* Në faqen 26, ekonomistja interesohet *nëse ka akoma fatura të paprera për "Rametal" shpk dhe Adela i përgjigjet në faqen 27 se ajo nuk ka asnjë faturë për të prerë.* Ekonomistja i përgjigjet: *Qartë.* Megjithatë, Adela i përgjigjet se ***do flasi njëherë me shefen, se nuk e di nëse e kanë diskutuar.*** Pas kësaj, ekonomistja i kërkon një kartelë dhe ajo nga ana e "Rametal" shpk po bën gati të tyren. *Faqe 28.* **Pra, rezulton e qartë se vetë "Rametal" shpk interesohet nëse ka pagesa të tjera për të bërë në favor të shoqërive të shtetases Ajola Xoxa.**

**118.5.** Në vijim, ekonomistja e Rametal i dërgon kartelën me detyrimet e "Rametal" shpk, ku përfshihen pagesat dhe faturimet. **Ky komunikim që gjendet në faqen 30 ka në përmbajtje të tij tabelën përkatëse nga ku rezultojnë të dhëna me interes për hetimin.** Konkretisht, nga këqyrja e tabelës rezulton se "Rametal" shpk, **gjatë periudhës 2021-2023, ka marrë faturime nga "Partners Laë" shpk, "Ava Studio" shpk dhe Greta Domi PF një shumë të përgjithshme prej 191.800 euro**. Nga kjo shumë, nga e njëjta tabelë rezulton se janë paguar nga "Rametal" shpk, për "Partners Laë" shpk, "Ava Studio" shpk dhe Greta Domi PF, **pra për shtetasen Ajola Xoxa, 179.800 euro**. Detyrimi i mbetur i "Rametal" shpk ndaj "Partners Laë" shpk është shënuar të jetë: 12.000 euro. Nuk mbaron me kaq. **Përsëri në këtë tabelë shfaqet shoqëria "Jedas" për detyrimet ndaj së cilës nuk kuptohet pse duhet të njoftohet financierja e Ajola Xoxës.** Për këtë shoqëri, konstatohet se, detyrimi i mbetur i "Rametal" shpk për vitet 2021-2023 është **60.000 euro**. Ky detyrim, sipas shënimit të bërë është në CASH. Në këtë pikë duhet patur në konsideratë biseda e bërë më lart mes dy bashkebiseduesve, sipas së cilës për **"Jedas" do bisedojnë "shefat"**, si edhe përgjigjen e dhënë më pas nga Adela Kondakçiu se për **Jedas ka folur me shefen** dhe nuk ka asnjë problem, **për të krijuar dyshimin e arsyeshëm sipas organit procedues se detyrimi prej**

**60.000 euro, i shënuar si CASH ndaj shoqërisë "Jedas" do t'i likujdohet në këtë formë shtetases Ajola Xoxa.**

**118.6.** Megjithatë, detyrimet dhe pagesat e shoqërive të kontrolluara nga Elman Abule dhe bashkëshortja e tij Marisa Nito, duket se nuk përfundojnë me kaq. Në fund të tabelës janë përshkruar edhe detyrimet që shoqëria "Sapientia" shpk ka ndaj "Partners Laë" shpk dhe "Ava Studio" shpk, të cilat kapin shifrën e 30.000 euro, nga të cilat 18.000 Euro për "Partners Laë" (viti 2021) dhe 12.000 Euro për "Ava Studio" shpk (viti 2023). Nga këto detyrime duket se janë likujduar 3.000 Euro për "Partners Laë" dhe 12.000 Euro për "Ava Studio" shpk, duke bërë që detyrimi i mbetur për të dyja shoqëritë të jetë në vlerën 15.000 Euro. Në fund, sipas kësaj tabele detyrimi i mbetur ndaj këtyre shoqërive është 87.000 euro, ndërsa pagesat e bëra në favor të tyre, duke hequr këtu pagesën cash për "Jedas" shpk, kap shifrën e 194.000 Euro në vetëm 2 vite. **Pra, në total shoqëritë e kontrolluara nga Ajola Xoxa, sipas kësaj tabele, përfitojnë nga shoqëritë e kontrolluara nga shtetasi Elman Abule shumën prej 281.000 Euro në vetëm tre vjet.** Shërbimet e ofruara kundrejt kësaj pagese janë për konsulencë ligjore.

**118.6.1.** Pas njihet me këtë kartelë, Adela Kondakçiu i kërkon në faqen 32 *të konfirmojë nëse pagesat janë mbyllur.* Përgjigja nga ekonomistja është negative. *Akoma nuk janë mbyllur.* Por kjo shtetase i thotë se *do komunikojë me shefat dhe besoj do i mbyllë të hënën e javës qe vjen maksimumi.* Në faqen 35 përsëri Adela Kondakçiu pyet ekonomisten e "Rametal" shpk *nëse pagesat janë mbyllur, por ajo i kërkon ndjesë dhe i thotë që do t'i procesojë javës tjetër.* Në fakt, javën pasardhëse, më datë 24.10.2023, në faqen 36 të komunikimeve Adela njoftohet nga ekonomistja se *është procesuar fatura e mbetur e Rametal.* Në lidhje me këtë, ekonomistja i *dërgon kalimin bankar i cili mban datën 23.10.2023, sipas të cilit Rametal shpk i kalon Partners Laë shpk edhe 12.000 euro të tjera, për likujdim faturash 25/22023 datë 21.09.2023.* Në këtë pikë konstatohet se detyrimi i "Rametal" shpk ndaj "Partners Law" është i mbyllur, duke bërë që detyrimi i mbetur të jetë tashmë 75.000 Euro. Megjithatë, në faqen 37 Adela e pyet *nëse janë bërë pagesat e Sapientia shpk, por ekonomistja i thotë që për ato nuk ka akoma një datë, por do ta njoftojë.* Adela insiston për pagesat që duhet të bëhen nga "Sapienta" shpk, në faqen 38 te komunikimeve. Ekonomistja e "Rametal" shpk i përgjigjet *në faqen 39 se do t'i procesonte po atë ditë* (30.10.2023). Ekonomistja *i kërkon njëkohesisht edhe një kopje të faturës së vjetër prej 3.000 euro, e mbetur papaguar nga viti 2021.* Fatura së cilës i referohet mban numrin 62 datë 26.03.2021. Fatura që i dërgohet nga Adela Kondakçiu ka të bëjë me detyrimin që "Sapientia" shpk ka ndaj "Partners Laë" shpk për shumën e përgjithshme prej 18.000 euro, nga e cila është likujduar 15.000euro dhe mbeten 3.000 euro, që ekonomistja kërkon ta likujdojë në këtë moment. **Fatura në fjalë, e cila ndodhet në faqen 40 dëshmon sa u tha më sipër. Pra, një shoqëri si "Sapientia" shpk, e krijuar ndër të tjera edhe për ofrim konsulence ligjore, paguan një shumë të konsiderueshme të hollash tek një shoqëri "konkurrente" si "Parners Laë" shpk, për të njëjtin shërbim që e disponon vetë.**

**118.7.** Më datë 30.10.2023, siç edhe dokumentohet nga komunikimet në faqen 42, "Sapientia" shpk shlyen dhe detyrimin e mbetur ndaj "Ava Studio" shpk, për likujdim fature nr. 258/2023, në masën 12.000 euro. Kjo e fundit është themeluar nga nëna e shtetases Ajola Xoxa, Valbona Xoxa, por në fakt kontrollohet plotësisht nga e para. Pas kësaj, në faqen 43 ekonomistja i dërgon *edhe dokumentin bankar që provon likujdim prej 3.000 euro të mbetur*

*pa paguar për shoqërinë "Partners Laë" shpk.* **Tashmë, detyrimi i "Rametal" shpk dhe "Sapientia" shpk ndaj shoqërive të kontrolluara faktikisht nga Ajola Xoxa është likujduar i plotë, pa përfshirë këtu shoqërinë "Jedas" shpk, për të cilën detyrimi në CASH është 60.000 Euro dhe për të cilin shtetësja Ajola Xoxa ka thënë se janë në rregull dhe nuk ka problem.** Në lidhje me këtë të fundit, ekonomistja e "Rametal" shpk, duke përforcuar edhe më tej dyshimet për një kontroll të mundshëm të shoqërisë "Jedas" nga shtetësja Ajola Xoxa, shprehet sa vijon në faqen 43: ***PASTAJ NA MBETET AJO 60-CJA QË ËSHTË KTHIM CASH. POR MESA DI UNE DO E DISKUTOJNE EDHE NJEHERE SI DO TA MBYLLIN (DO BEHEN FATURA APO JO).*** Adela Kondakçiu i përgjigjet në faqen 44: ***Ok, në rregull. Kur të vendosin i bëjmë.***

**118.8.** Në faqen 46 nis një tjetër bisedë me interes për hetimin. Ekonomistja i nis Adela Kondakçiut *disa foto që duket se kanë lidhje në përmbajtje të tyre me dy kontratë qiraje të lidhura mes "Rametal" shpk dhe TKOB.* Konkretisht, sipas njërës kontratë, "Rametal" shpk merr përsipër të japë me qira, pra të përfitojë të ardhura nga TKOB nëpërmjet qirasë në këtë rast, një seri artikujsh të përcaktuar në aneks, për baletin "Preljocaj". Po kështu, në kontratën tjetër "Rametal" shpk i jep me qira TKOB një seri artikujsh skenikë, këtë radhë për eventin "Sonoma", i përmendur më lart kur folëm për financimet e marra nga "BYL-A" prej Bashkisë Tiranë dhe KRK-së. Shumat e qirasë për rastin e baletit "Preljocaj" janë <u>1.213.380 lekë</u> dhe për "Sonoma" <u>1.868.220 lekë.</u> Këto shuma është rënë dakord të kalohen në llogarinë bankare të "Rametal" shpk me përfaqësues shtetasin Elman Abule, i cili ka nënshkruar dhe kontratat, me transfertën përkatëse bankare. Në këtë moment, Adela Kondakçiu, në faqen 52 i thotë bashkëbiseduese: ***Për pjesën e rakordimit bashkë do flas me shefen.*** Ekonomistja i përgjigjet: *Po pa merak. Këtë e zgjidhim.* **Deri në këtë moment, edhe pse është e qartë se "Rametal" shpk financon në mënyrë jo të drejtpërdrejtë eventet artistike të organizuara nga OJF-të e shtetases Ajola Xoxa, sipas organit procedues nuk kuptohet pse këto kontrata qiraje janë objekt diskutimi mes dy financiereve.** Më pas, në lidhje me këtë nis të kuptohet diçka, kur Adela Kondakçiu në faqen 55 ***i kërkon ekonomistes të dijë sa është diferenca për t'u faturuar nga ata (kuptohet nga OJF që organizon eventin).*** Ekonomistja i përgjigjet: ***<u>8326.25 (euro)</u> është pagesa që kemi bërë ne për La Veronal.*** Adela i thotë se *sipas llogarive të saj i bie një vlerë prej <u>2.016.000 lekë me tvsh</u> dhe kërkon konfirmim për këtë.* Pasi merr kohë, ekonomistja i përgjigjet në faqen 57 se: *Totali i faturës të TOB është <u>36.436 euro,</u> prej së cilës duhet të zbriten <u>8326 euro</u> pagesa për La Veronal dhe <u>6072 euro TVSH.</u> Në përfundim vlera është <u>22.037 euro.</u>* Adela i përgjigjet në faqen 5859 se *ajo nuk i ka vlerat totale, por ka një konfirmim nga Keti (Ketrina Braho-Harabel) vetëm vlerën <u>28.800 euro</u> e cila duhet të mbulohet nga Rametal shpk.* **Interesant në këtë pikë është fakti se kjo vlerë që duhet të mbulohet nga "Rametal" shpk, pra duhet të faturohet nga një prej OJF-ve ose shoqërive të Ajola Xoxës (sic më poshtë do tregojmë) është <u>pak a shumë</u> *(sic shprehet në vijim ekonomistja e Rametal)* <u>*me vlerën e faturave të lëshuara nga Rametal për TOB.*</u>**

**118.8.1.** Në faqen 59 të komunikimeve Ekonomistja i dërgon dy fatura të prodhuara nga "Rametal" shpk për Teatrin e Operas, për vlerën <u>1.456.056 lekë dhe 2.241.864 lekë.</u> Në faqen 61 Adela Kondakçiu i thotë që, *në mënyrë që edhe Rametal mos paguajë tvsh, faturat të mos bëhen tani në dhjetor.* Ekonomistja i përgjigjet në faqen 62: *Më mire për ne me TVSH.* Në vijim Adela Kondakçiu e pyet në faqen 63: ***<u>Po përshkrimet në fatura si doni që t'i</u>***

*bëjmë?* Ekonomistja i kthen: ***KA NDONJË HAPESIRË TË NA I BËNI NGA HARABEL FATURAT?*** Adela i përgjigjet po në faqen 63: ***NËSE E BËJMË NGA HARABEL I BIJE QË DO E BËJMË SPONSORIZIM. ËSHTË DHE PA TVSH NË FAKT (faqe 64).*** **Pra, nga këto komunikime më së paku rezulton e qartë se faturat që lëshohen nga OJF e shtetases Ajola Xoxa janë fiktive në shërbimet që supozohet të kenë ofruar. Në këtë rast, nga Rametal shpk kërkohet që një OJF të lëshojë faturë për një shpk si "Rametal" shpk, por kjo duket e pamundur objektivisht, pasi një organizatë jofitimprurëse mund të përfitojë vetëm sponsorizime nga subjekte të tjera private. Akoma më qartë del qëllimi i bashkëbiseduesve për të prodhuar fatura të cilat nuk pasqyrojnë realisht shërbimin e kërkuar dhe të ofruar, por shërbejnë vetëm për të kaluar shumën e të hollave tek llogaria bankare e "Partners Laë".** Konkretisht, në faqen 64, ekonomistja i përgjigjet Adela Kondakçiut: ***Shiko, nëse ju pret puna e bëjmë pas pushimeve. Në të kundërt bëje nga PARTNERS. CA TË THEM. Se nuk e di as unë tani.*** Adela vijon duke e pyetur: ***Po të bëjmë faturë qira për pajisje nga një shpk? Jo Partners dmth faqe 65-66.*** **Edhe nga kjo rezulton e qartë se faturat që do të lëshohen në emër të "Rametal" shpk, nga OJF-të e kontrolluara nga shtetësja Ajola Xoxa, janë tërësisht fiktive.** Ekonomistja i përgjigjet: ***Po edhe ashtu mirë është.*** *faqe 66.*

**118.8.2.** Në vijim kujtohet dhe shton: *Po i bie që edhe kontratën që bëm për Preljocaj duhet ta bëjmë me këtë shpk që do na bëni faturën. Se nuk lidhen pastaj. Faqe 66.* Adela Kondakçiu i thotë që me *Preljocaj kanë bërë transport.* Ekonomistja i thotë *edhe pajisje* dhe shton: ***SE IDEJA ËSHTË QË NE KEMI NJË KONTRATË ME PRELJOCAJ POR SKEMI FATURË. DHE PËR ATË JEMI ZBULUAR. Faqe 68.*** Në këtë moment, Adela Kondakçiu e pyet ***nëse këtë kontratë e kanë dorëzuar diku, por ekonomistja e Rametal i përgjigjet: Deri tani jo. Vetëm noterja e ka. Faqe 68.*** Në faqen 69 Adela Kondakçiu i drejtohet ekonomistes duke i thënë: ***Doja të njoftoja që po bëj këtë faturën për Rametal sot për diferencat e TOB. Faturën do e bëj nga Partners Laë edhe do të jetë me TVSH. Faqe 70. Pra, më në fund vendosin se nga do lëshohet fatura dhe shoqëria është "Partners Laë" shpk e shtetases Ajola Xoxa.*** Ekonomistja i përgjigjet: *Në rregull. Faqe 71.* Adela Kondakçiu i dërgon vlerën: *22.000 euro plus tvsh. Faqe 71.* Përgjigja është: *ok. Faqe 72.* Në faqen 72, Adela Kondakçiu i kërkon ekonomistes *të konfirmojë nëse është bërë pagesa e faturës për Partners.* Ekonomistja i përgjigjet në faqen 73 se *akoma nuk e kanë mbyllur dhe do e njoftojë sapo të procesohet.*

**119.** Nga komunikimet që i përkasin **grupit të krijuar mes punonjësve dhe shtetases Ajola Xoxa,** rezultojnë disa të dhëna me interes për hetimin. Konkretisht, nga këqyrja e tyre rezulton se Ajola Xoxa i drejtohet të gjithëve në grup: ***Grupi ne sot hapim kete expon, ora 7 pm, ish vila Vodafone ne Bllok.*** *Eshte vertet super super dhe artistet jane realisht teper te mire! Mundohuni te vini ne oren 7, se ka edhe nje performance.* **Komunikimi që i përket datës 21.07.2021 dëshmon faktin se të paktën që prej këtij viti, vila në zonën e ish bllokut, e cila do të detajohet në vijim, është në përdorim të shtetases Ajola Xoxa nëpërmjet organizatës jofitimprurëse "Harabel".**

**119.1. Në faqen 256 të komunikimeve rezulton që është Ajola Xoxa ajo që ka lënë porosi dhe inicion themelimin e "Ava Studio", shoqëri në pronësi ligjore të nënës së saj Valbona Xoxa, por e kontrolluar faktikisht nga Ajola Xoxa.** Porosia jepet në grup, për punonjëset Xhoi Skënderasi dhe Greta Domi, nëpërmjet një mesazhi zanor të regjistruar nga

vetë shtetësja Ajola Xoxa. Nëpërmjet tij *kjo shtetase thotë që ka lënë porosi për themelimin e Ava Studio dhe se kush duhet ta ndjekë.* Gjithashtu, në të njëjtin mesazh, *Ajola Xoxa flet për një projekt propozim për Ministrinë e Kulturës, që supozohet të bëhet nga një prej OJF-ve që ajo kontrollon.*

**120.** Interes për hetimin paraqesin edhe komunikimet e zhvilluara mes shtetaseve **Greta Domi dhe Adela Kondakçiu. Nga aktet e administruara rezulton se shtetësja Greta Domi është e regjistruar si person fizik, për të ushtruar profesionin e avokatit, me zyrë në ambientet e marra në përdorim nga shtetësja Ajola Xoxa. Siç edhe u provua në rastin e personit Ines Dani, edhe për shtetasen Greta Domi situata paraqitet identike.**

**120.1.** Në faqen 6 të komunikimeve, Greta Domi i thotë Adela Kondakçiut se *kur të shkonte në bankë ka merak mos i bëjnë pyetje në lidhje me xhiron vjetore, pasi nuk mer vesh nga këto gjera.* Greta gjithashtu pyet Adela Kondakçiun ***se ku duhet ta hapë llogarinë.*** Faqe 7-8. Në faqen 12 Adela Kondakçiu ***<u>shprehet se është Ajola ajo që i thotë për faturimet.</u>*** **Edhe Greta Domi, ashtu si edhe Ines Dani, megjithëse është person fizik që supozohet të ushtrojë aktivitetin për llogari të vet, pyet Adela Kondakçiun nëse pagat kanë kaluar.** ***Faqe 14.*** Adela Kondakçiu i përgjigjet: ***Jo, akoma nuk kanë kaluar. PO PRES TË MË KONFIRMOJË AJOLA. Faqe 15.***

**120.2.** Në faqen 38 të komunikimeve, Adela Kondakçiu i dërgon një përmbledhje nga **<u>ku rezulton se Greta Domi paguhet me rrogë nga Ajola Xoxa.</u>** Konkretisht, Adela Kondakçiu i thotë: *Në lidhje me kalimin që është bërë te NIPTI: një vlerë prej <u>148.908</u> lekë do të paguajmë muajin tjetër si tvsh, ndërsa diferencën do ta mbash për pagën. Diferenca i bije 744.540 lekë, ose 6.000 euro që dmth PAGAT PËR MUAJIT: MAJ, QERSHOR, KORRIK, GUSHT, SHTATOR DHE TETOR (6 MUAJ).* Pas kësaj, **duket se Greta Domi i mer leje për të tërhequr këtë shumë.** Faqe 38. Adela Kondakçiu i përgjigjet: *Po deshe silli dhe ti jap cdo muaj nga 1000. Faqe 38. Por janë të tuaj dmth. Faqe 39.* Greta Domi pyet: ***JANË TË MIAT ATO TË GJITHA?? Faqe 39.*** **Adela Kondakçiu i jep leje personit fizik, që supozohet të jetë pronar i të ardhurave që vetë gjeneron, për të bërë ç'të dojë me lekët.** ***Faqe 40.*** Greta Domi vijon duke i thënë ***se nuk po e kuptonte situatën.*** Faqe 40. **Nga këto komunikime rezulton e njëjta situatë identike si edhe me shtetasen Ines Dani. Shuma që duhet të mbahet nga personi fizik është e barabartë me pagat e caktuara nga shtetësja Ajola Xoxa. Pjesa tjetër nuk i takon ta marrë. Kjo është e qartë përsa kohë vetë personi fizik, në rastin konkret Greta Domi, nuk ka idenë çfarë mund të marrë dhe çfarë të lërë në llogarinë e saj të biznesit.** Adela përsëri i pohon ***se lekët janë të vetat.*** Faqe 41.

**120.3.** Në faqen 44 të komunikimeve, Greta tregon kuriozitet për mënyrën si i janë dhënë lekët dhe pyet: ***PO PSE NA I DHATË KSHU? KOT PËR KURIOZITET DMTH.*** Adela Kondakçiu i përgjigjet: ***<u>URDHËR NGA LART</u>. Faqe 45.*** Greta Domi nuk e diskuton më, duke thënë: ***ok.*** Por Adela Kondakçiu vazhdon duke i thënë: ***Po meqë Inesi nguli këmbë që e donte me faturë. <u>Dhe s'mund të bëheshin dot fatura nga Partners.</u> U gjet kjo mundësi.*** Faqe 45-46. <u>Në këtë rast, duhen patur parasysh edhe komunikimet e përshkruara më lart mes shtetases Adela Kondakçiu dhe Ines Dani, në lidhje me ankesat që kjo e fundit kishte për mosfaturimin e mjaftueshëm sipas bisedave që kishte bërë me Ajolën para se të regjistrohej si person fizik.</u> Greta Domi i përgjigjet në faqen 47: ***Une se dija fare këtë histori dmth.***

**120.4. Fiktiviteti i faturave të lëshuara nga kompani të ndryshme të kontrolluara faktikisht nga shtetësja Ajola Xoxa, provohet edhe në komunikimet e faqes 48-49.** Adela

Kondakçiu i thotë Greta Domit: ***<u>Greta më tha Ajola që duhet të bëjmë një faturë për dikë të quajtur Ladi.</u>*** *Që ta marrësh ti në tel dhe ta pyesësh për të dhënat e kompanisë,* ***<u>NË EMËR TË CILËS KOMPANI E DO.</u>*** Greta e pyet: ***<u>TA PYES NË EMËR TË CILËS KOMPANI DO TË FATUROJMË?</u>*** Faqe 49. Adela Kondakçiu i përgjigjet: ***po.*** Në faqen 54 konstatohet se bëhet fjalë për shtetasin **Vladimir Avrami**, ortak në shoqërinë "Salus Konstruksion" shpk. Në faqen 57, ndërsa flitet për disa kontrata shërbimi për të cilat Greta Domi *pyet nëse duhen bërë me tvsh apo jo*, Adela Kondakçiu i përgjigjet: ***Nëse nuk janë bërë duhet konfirmim nga Ajola/Ilda. Bëhet fjalë për datën 06.07.2020.*** <u>Nga komunikimet e këqyrura më parë, duket se personi që e thërrasin Ilda është Klotilda Bushka, e cila është zgjedhur deputete e Kuvendit të Shqipërisë në vitin 2017.</u>

**120.5.** Në faqen 65, që i korrespondon komunikimeve të datës 15.07.2020, Adela Kondakçiu i dërgon Greta Domit një konfirmim pagese nga shtetasi Vladimir Avrami për **"Partners Laë" shpk.** Përshkrimi paraqet interes duke qenë se vendoset: **financim ortaku.** Shuma e paguar është <u>12.000 euro.</u> **Adela Kondakçiu shqetësohet për përshkrimin dhe e diskuton me Greta Domin. Kjo e fundit pasi e sheh, thotë "*po ca financim ortaku*".** Faqe 66. Madje Adela Kondakçiu vijon duke thënë *që fatura nuk është bërë as në emër të Salus, por prej individit, Vladimir Avrami.* Faqe 67. ***Greta Domi nuk kupton pse është bërë kështu fatura.*** Në faqen 72 Adela Kondakçiu njofton Greta Domin *se i ka kthyer lekët shtetasit Vladimir Avrami, por ai mund ta bëjë përsëri nga llogaria personale nëse do.* ***<u>Vetëm se në këtë rast duhet të thotë që po e bën pagesën për faturën e Salus.</u>*** Greta Domi i thotë: *ok.*

**120.5.1.** Më datë 15.12.2020, faqe 97, Greta Domi i dërgon Adela Kondakçiut një pagesë të kryer nga shtetasi Vladimir Avrami për "Partners Law" shpk, për vlerën <u>24.000 euro</u>. Këtë radhë përshkrimi i bërë në faturë është: Pagesë fature nr. 52 datë 25.11.2020 për llogari të Salus Konstruksion shpk si Ortak.

**121.** Gjatë komunikimeve të shtetases **Adela Kondakçiu dhe Fjoralba Zeko**, kjo e fundit punonjëse e "Partners Law" shpk, **përveç shumë bisedave të cilat provojnë kontrollin e plotë të Ajola Xoxës mbi veprimtarinë e Harabel, pa marrë në asnjë rast miratim nga ndonjë mbledhje bordi e kësaj organizate ku edhe bën pjesë, konstatohet edhe përfshirja e Ajola Xoxës që në fillesat e shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar "Nan", themeluar nga shtetasi Driant Zeneli.** Ky i fundit, i pyetur në cilësinë e personit që ka dijeni për veprën penale, ka shpjeguar se idea për të themeluar "Nan" ka qenë e shtetases Ajola Xoxa, edhe pse donte të merrte pjesë në një aktivitet jashtë vendit, për të cilin ishte nevoja e themelimit të një shpk-je. **Edhe emrin "Nan", ka shpjeguar ky shtetas, i është vënë shoqërisë nga Ajola Xoxa.** Duke iu rikthyer komunikimeve që lidhen me këtë shoqëri, në faqet 461-462 rezulton se këto deklarime të shtetasit Driant Zeneli gjejnë mbështetje të plotë. Shtetësja Fjoralba Zeko i thotë Adela Kondakçiut: ***<u>Më thotë Ajola</u> lidhur me hapjen e llogarisë për shoqërinë Nan Gallery shpk. Drianti duhet të jetë fizikisht?*** Adela Kondakçiu i përgjigjet: ***Po. Nuk bëhet pa administratorin.*** *Faqe 462.*

~~**121.1. Në faqen 467-468 provohet edhe një herë se OJF "BYL-A" trajtohet nga**~~ **punonjësit e shtetases Ajola Xoxa, dhe për pasojë kontrollohet nga kjo e fundit.** Fjoralba Zeko, në përgjigje të kërkesës së Adela Kondakçiu, i dërgon kësaj të fundit themeluesit e OJF-së në fjalë. Gjithashtu, në faqen 470 rezulton edhe një tjetër moment që provon menaxhimin e kësaj OJF nga punonjësit e Ajola Xoxës, ndërsa **Adela Kondakçiu i dërgon Fjoralba Zekos një draft të kontratës që lidhet mes Bashkisë Tiranë dhe "BYL-A"**

**përfaqësuar nga shtetësja Ina Goxhaj. Objekt i kontratës është realizimi i projektit kulturor "Sonoma" nga La Veronal. Është e qartë se personi i vetëm që nuk përfshihet në asnjë diskutim në lidhje me realizimin e këtij projekti dhe rrjedhimisht në lidhje me menaxhimin e punëve të organizatës "BYL-A", është Ina Goxhaj, me detyrë drejtore ekzekutive, siç në fakt duhej të ishte.**

**121.2.** Komunikimi në lidhje me "BYL-A" vijon edhe në faqen 497-498, ku *Adela Kondakçiu i kërkon Fjoralbës statutin e ri të BYL-A për në bankë.* Adela Kondakçiu e pyet Fjoralbën *nëse e ka ajo dhe kjo e fundit i përgjigjet që dosja e organizatës në fjalë është te tavolina e saj e punës.*

**121.3.** Edhe në lidhje me organizatën tjetër jofitimprurëse të emërtuar **"MUZA"**, Adela Kondakçiu dhe Fjoralba Zeko diskutojnë *me qëllim që kjo e fundit të shkojë dhe të marrë certifikatën.* Faqe 533. Edhe këtë dokument, Adela Kondakçiu e kërkon për hapjen e llogarisë bankare të organizatës në fjalë. Faqe 536. **Në faqen 537 Fjoralba Zeko i dërgon Adela Kondakçiut NIPT in e Qendrës MUZA dhe madje dhe passëordin e saj. Nga komunikimet që vijojnë deri në faqen 562 kuptohet qartë që zanafilla, regjistrimi si edhe kompletimi i gjithë praktikës, deri te hapja e llogarisë bankare në lidhje me këtë organizatë, kryhet nga punonjëset e shtetases Ajola Xoxa.**

**121.4.** Më datë 01.05.2020, sic rezulton në komunikimet në faqen 748, "Partners Law" shpk, e përfaqësuar nga shtetësja Ajola Xoxa lidh një kontratë huapërdorje me shtetasen Ines Dani, në cilësinë e Personit Fizik pajisur me NIPT L82201009O. Objekt i kontratës është dhënia e një ambienti me sipërfaqe 6 m2 për Personin Fizik Ines Dani, ambient ky që ndodhet në zyrën me sipërfaqe të përgjithshme prej 330 m2, të marrë gjithashtu në huapërdorje nga "Partners Laë" shpk. Kohëzgjatja e kontratës është nga 01.06.2020 deri më 30.04.2021.

**121.5.** Nga komunikimet e zhvilluara mes shtetases **Adela Kondakçiu dhe Ina Goxhaj** jepet një **panoramë mjaft e qartë sesi në të vërtetë kanë funksionuar organizatat e krijuara dhe të kontrolluara faktikisht nga shtetësja Ajola Xoxa, por edhe persona të tjerë të identifikuar gjatë procesit hetimor.** Shtetësja Ina Goxhaj figuron të jetë drejtoreshë ekzekutive e organizatës jofitimprurëse "BYL-A". Për herë të parë në komunikimet e këtyre dy shtetaseve përmendet një tjetër OJF, SHIZI, e cila i referohet në emërtim Shoqatës për Integrimin e Zonave Informale. **Duket se zyra e shtetases Ajola Xoxa ka lidhje me këtë organizatë.** ***Faqe 4.*** Në faqen 68 personat nisin të flasin për një shtetase që ato vetë e thërrasin *"Ilda"*, e cila nuk ka qenë e mundur të takohej pasi është larguar për në SHBA. Në vijim, faqe 70 **konstatohet se Ina Goxhaj nuk mer dot asnjë vendim, megjithëse drejtore ekzekutive e kompanisë.** Ina Goxhaj në fakt shprehet *se për deklarimet e 3 mujorit (të pagave) duhet të flasin me Ildën.* Në faqen 73 Ina Goxhaj pyet përseri Adela Kondakçiun *nëse kishte folur me I (Ilda).* Në faqen 76 përsëri përmendet Ilda. Ina Goxhaj shprehet: *Ti po të shikosh I në zyrë, shkoji dhe sqarohu.*Pra, pritet që personi i quajtur Ilda të shkojë në zyrën e Ajola Xoxës. Në faqen 92 konstatohet që më në fund *Ilda vjen dhe se ka shansin ta kapë nëse është afër zyrës.* Në faqen 103 Ina Goxhaj pyet nëse "BYL-A" që është inaktive mund të jetë partnere në projektin bashkë me "Harabel". Në faqen 104 konstatohet që shtetësja Xhoi Skenderasi, e cila punon pranë "Partners Law" i ka dërguar disa dokumente të cilat duhen për "BYL-A". Në këtë pikë, në faqen 105 Adela Kondakçiu sqaron *se BYL-A është akoma aktive.* Në faqen 110 evidentohen vështirësitë ekonomike që kalon Ina Goxhaj, e cila kërkon pagesë



SPDI JETAL

papunësie gjatë periudhës së koronavirusit. **Ky fakt evidentohet nga organi procedues për të kuptuar më mirë në vijim se çfarë kontrollin real ka kjo shtetase mbi OJF "BYL-A" por edhe të ardhurat që merr nga ajo.** Adela Kondakçiu i përgjigjet në faqen 111: *Ti figuron e punësuar te BYL-A akoma, se di vitin tjetër pasi të kalojë pasive mbase edhe mundesh, por sbesoj që bëhet gjë për këtë vit.* Pra, përveç se nuk di asnjë nëse figuron e punësuar të "BYL-A" apo jo, Ina Goxhaj "njoftohet" nga persona të tjerë, siç është në rastin konkret Adela Kondakçiu, *që vitin tjetër do kalojë pasive*.

**121.6. Në faqen 142 gjëndet një moment me interes për hetimin përsa i përket funksionimit të organizatës, por edhe pafuqisë se Ina Goxhaj për të marrë vendime në lidhje me të.** Në këtë rast, Ina Goxhaj i drejtohet Adela Kondakçiu ***me një pyetje konfidenciale (tekstualisht) në lidhje me lekët që kishin mbetur te BYL-A dhe cfarë do të ndodhte nëse do i tërhiqte, a e justifikonin dot si veprim?*** Adela Kondakçiu e mëson: ***E mira do ishte mos të bëje tërheqje sepse nuk kemi fatura për ta justifikuar, por mund ta kalosh si pagë e prapambetur te llogaria jote direkt.*** Në faqen 161 mesa kuptohet, *bashkëbisedueset shfaqin pakënaqësi ndaj shtetases Ajola Xoxa.* Ina Goxhaj shprehet: *Hiqja vizën. Boll ke duruar. Sikur jemi zare të tyre.*

**121.7.** Në këtë periudhë, pra rreth muajit Dhjetor 2021, nga komunikimet konstatohet se për "BYL-A" nuk po interesohet më njeri, as çfarë po bëhet dhe as çfarë do bëhet. Dhe korrekte, sipas Ina Goxhaj ***do ishte që ato të paguheshin se kanë bërë punën.*** Pra, provohet se të paktën në këtë periudhë, siç do të tregohet në vijim, nuk shfaqet ndonjë interes i veçantë për organizatën nga ana e pronarëve realë të saj. **Por nga ana tjetër, fakti që Ina Goxhaj dhe Adela Kondakçiu presin të paguhen për punën që kanë bërë, provon dhe një herë se vendimmarrjet në lidhje me këtë organizatë merren nga persona të tjerë, të cilët do të dalin qartë nga komunikimet në vijim. Organi procedues i referohet togfjalëshit "pronarë realë" pasi ka rezultuar se Ina Goxhaj dhe Adela Kondakçiu në komunikimet e tyre përmendin termin "shefet" dhe jo "shefja".** Konkretisht: në faqen 234 Adela Kondakçiu e pyet: *Edhe një gjë të fundit, kur të rihapet i bije do paguajmë sigurimet për ty që nga maji apo* ***DO E DISKUTOJME ME SHEFET?*** Ina Goxhaj përgjigjet në faqen 235-236: ***ME SHEFET. Se tani nuk do rri urtë më jo. Do kapem. Do ja kërkoj një për një. Në mos le të më heqin.*** **Pra, duket qartë se janë "shefet" që kanë fjalën e fundit në lidhje me sigurimet shoqërore të drejtores ekzekutive të "BYL-A" Ina Goxhaj.**

**121.8.** Në faqen 253 Ina Goxhaj i thotë Adelës se *do shkojë pastaj Ildën dhe do i thotë për pagesat e tyre që lidhen me BYL-A.* Ina Goxhaj: ***Super do bëjmë luftë. S'ka më. Faqe 254.*** Adela Kondakçiu i përgjigjet se *po të dojë shkojnë të dyja që të flasin.* Faqe 255. Ina Goxhaj: ***Do ja theml. Me shpatë në dorë.*** Faqe 256. **Pra, nga këto komunikime rezulton se Adela Kondakçiu dhe Ina Goxhaj nuk paguhen për punën e tyre që kanë bërë përsa i përket "BYL-A" OJF. Meqënëse duhej të ishte Ina Goxhaj që merr vendimet në lidhje me këtë organizatë, është e natyrshme që nga këto komunikime të arrihet në konkluzionin se vendimet i marrin persona të tjerë.**

**121.9. Në faqen 257 nis një bisedë me interes që zgjat për shumë kohë, dhe që nëpërmjet së cilës organi procedues ka kuptuar si funksionon në të vërtetë një OJF si "BYL-A", e cila përfiton fonde publike nga institucione të ndryshme, përfshirë këtu edhe Bashkinë Tiranë.** Në faqen 257 Ina Goxhaj merr një porosi nga Anxhela Qunaj, punonjëse e Ajola Xoxës. Konkretisht: *Ina, dërgoni dhe një përmbledhje raporti narrativ të*

*ndërmjetëm bashkë me atë financiar.* Ina Goxhaj sqaron Adelën *se sms i është dërguar nga Anxhela.* Adela Kondakçiu i përgjigjet: *Atë financiar? Atë që dërguam financiar i bije, po duhet të bëjmë përmbledhëse se ca kemi për të paguar me 15.000 USD?* Ina Goxhaj i përgjigjet në faqen 257: *Në lidhje me ato aktivitetet dhe se çfarë kemi "paguar" por që janë vënë në buxhet.* **Është e qartë se bëhet fjalë për një aktivitet i cili do financohet në dollarë amerikanë, dhe si do të shihet në vijim, është financuar nga Ambasada e Shteteve të Bashkuara të Amerikës në Tiranë. Gjithashtu sipas organit procedues është e qartë, se nisur edhe nga thonjzat e përdorura tek fjala "paguar", ka patur pagesa fiktive. Kjo ka rezultuar si nga komunikimet që pasojnë ashtu edhe nga deklarimet e shtetases Ina Goxhaj, por edhe provat e siguruara nga burime të hapura.**

**121.10.** Në vijim, në muajin prill të vitit 2022 Ina Goxhaj fillon punë tek Avokati i Popullit dhe për këtë njofton Adela Kondakçiun. *Faqe 263.* Në faqen 264 kuptohet që dollarët e përmendur më sipër, financohen nga Ambasada Amerikanë në Tiranë. Më datë 29.04.2022, Adela Kondakçiu njofton se kanë kaluar <u>14.940 USD</u>. *Faqe 319.* Në faqen 325 përmendet prap "Ilda", ndërsa Adela Kondakçiu pyet Inën *nëse ka folur me Ejonën apo Ildën.* Në vijim, në faqen 330 Adela thotë *do ishte mirë të takonte Ildën se Ejona nuk bën punë.* Këtë gjë ja konfirmon edhe Ina Goxhaj, kur i thotë: *Do ishte shumë mirë ta takoje Ildën dhe e mbyllje këtë punë.* **Në faqen 350 Adela Kondakçiu për herë të parë shfaq shqetësim për realizimin e projektit të financuar nga Ambasada Amerikane. Komunikimi i mëposhtëm në të njëjtën faqe tregon që të paktën deri më datë 30.05.2022 nuk është realizuar asnjë aktivitet, duke patur parasysh që shtrirja në kohë e aktivitetit i përket periudhës janar-korrik 2022.** Adela Kondakçiu thotë: *Por kam nje shqetesim qe eshte realizimi i projektit sepse AMBASADA DO DOJE DISA FOTO GJERA APO JO?* **Ky komunikim tregon qartë se të paktën deri në këtë datë nuk është bërë asgjë nga projekti i financuar na Ambasada në fjalë.** Kjo duket edhe më qartë në komunikimet që pasojnë.

**121.10.1.** Adela Kondakçiu në faqen 351 thotë: ***<u>QE TE BENIN EDHE NDONJE GJE NGA ATO QE DUAN ATA MOS TE DALIM KEQ.</u>*** **Pra, rezulton se nuk kanë bërë asgjë të paktën deri në fund të muajit Maj 2022.** Ina Goxhaj i thotë: *Prandaj dua të takoj Ejonën. Që të më sigurojë fotot. Faqe 352.* Adela Kondakçiu vijon: *Se do na lënë pastaj keto dhe do mbesim keq. SE DO NA LËNË ZBULUAR PASTAJ. SIA KAM BESEN. Faqe 353-354.* **Pra, drejtori ekzekutiv i organizatës kërkon të takojë një person tjetër në mënyrë që të sigurojë fotot e nevojshme që provojnë zhvillimin e projektit të financuar nga Ambasada Amerikane në Tiranë.** Adela vijon: *Unë do përpiqem të takoj pak Ildën, do ti shkruaj nje nga keto dite se kur do kaloje ne zyre. Faqe 354.* Ina Goxhaj i përgjigjet: ***SE KAM HALL SE NE FUND DO THOTE EJONA, PLOTESO ÇEKUN DHE I MARRIN LEKET DHE NE MBETEMI PA GJE FARE.*** **Pra, jo vetëm që nuk ka asnjë vendimmarrje, por Ina Goxhaj urdhërohet të plotësojë në fund çekun për pagesat, të cilët siç rezulton nga këto komunikime janë shumica fiktive.** Përsëri Ina Goxhaj thotë që *nuk do arrijë dot të flasi me Ildën se do që edhe ta takojë.* Ina shprehet: *Unë them të kalojmë të paktën rrogat tona. Pastaj të bëjnë ctë duan. Faqe 355.*

**121.11.** Adela në faqen 356 i sugjeron: ***Per mendimin tim thuaji qe te jape fotot para cfaredo veprimi qe mund te bejne me leke. SEPSE PERGJEGJESIA DO TE MBESE TY SI DREJTORESHE PROJEKTI. Edhe ne rastin me te keq do duhet te kthesh leket mbrapsht. Faqe 357.*** Përsëri në faqen 364, Ina Goxhaj i thotë bashkëbiseduese se ***<u>edhe</u>***

***buxheti nuk është bërë/nga ajo por nga Greta**, dhe se prandaj Ilda duhet ta ndajë këtë muhabet.* **Në faqen 365 konstatohen përpjekjet për të gjetur fatura fiktive në lidhje me projektin në fjalë, në rastin konkret për Web posterat.** Pastaj Adela i thotë: ***TANI BESOJ JU EDHE DO BENI NDONJE GJE NGA KETO APO JO. DMTH REALISHT. Faqe 366.*** Ina Goxhaj i përgjigjet: *Ne, baner duhet te bejme dhe **BESOJ SE DO BEHET MBYLLJA ME AKTIVITETIN.*** **Pra, provohet se për këtë projekt këto shtetase planifikojnë të lëshojnë fatura fiktive për punë të pakryera, por duke menduar gjithashtu që edhe të bëjnë ndonjë punë "realisht".** Në këtë pikë, Adela i sugjeron që të organizojë takim me gjimnazet, *por ato edhe atë javë janë të hapura dhe nëse duhet bërë ndonjë gjë bëhet tani, se në fund të majit e mbyllin.* Faqe 367. Përsëri në faqen 369 Adela i thotë Inës *se do i shkruaje Ildës nesër që në mëngjes.* **Të paktën deri më datë 02.06.2022, siç rezulton nga komunikimet, nuk është pregatitur raporti për Ambasadën në mënyrë që të justifikohen fondet e përfituara.** Në lidhje me këtë, bashkëbiseduese͏t mendojnë që t'ja lënë dikujt tjetër. Adela Kondakçiu thotë që ***do ja lërë kushërirës së saj që të merret me raportin.*** Faqe 383. Gjithashtu, Adela vijon: ***Edhe pjesën e faturave e rregullojmë bashkë besoj. Do paguajmë edhe kostot e komisioneve për të kthyer lekët. Edhe do lëmë nam me ambasadën. Faqe 384-385.***

**121.12.** Në faqen 386 Ina Goxhaj i thotë: ***TANI SE DUHEN TË BËHEN AKTIVITETE.* Ky komunikim provon që të paktën deri në 02.06.2022 nuk ka patur asnjë aktivitet të zhvilluar. *Faqe 386.*** Duke qenë se për zhvillimin e akvitetit me nxënësit e gjimnazeve duhen mësues, Ina Goxhaj pyet Adelën *nëse kushërira e saj është mësuese, por ajo i përgjigjet që nuk është porse shoqëron një fëmijë me autizëm në shkollë. Faqe 389.*

**121.13.** Më datë 03.06.2022, në komunikimet e faqes 390 Ina Goxhaj thotë që i duhen nxënës nga shkollat e mesme. **Fiktiviteti i faturave që duhet të lëshohen për shërbime të pakryera ndonjëherë rezulton edhe në faqen 404. Ina Goxhaj i dërgon Adela Kondakçiut disa biseda të një shtetasi të quajtur Altin Bushka.** Konkretisht, Ina Goxhaj në faqen 404 i dërgon këtë mesazh Adela Kondakçiut: Altin Bushka: *Per internetin duhet te bejme nje kontrate. Me dergo NIPT, dhe per cfare periudhe duhet fatura.* Altin Bushka: *Ëebsite dhe mirembajtje e bej nga personi fizik pa problem.* Altin Bushka: *Apo duhen fatura dore?* Adela Kondakçiu i përgjigjet: ***PO CFARE KONTRATE SEPSE ATY SDO KETE VERTET INTERNET. Faqe 404.*** **Në faqen 420 vijon komunikimi në lidhje me faturimet fiktive që do i bëhen Ambasadës.** Konkretisht, Adela Kondakçiu shprehet: ***Edhe kam marre bllokun e cekut, sic folem me Greten ate dite do bejme 1 cek per Fredin ne vleren 57.120 leke dhe nje do ta bej une per te njejten vlere per ekspert pregatitjesh manualesh. Duhet të bëjmë ndonjë tjetër?*** Ndërsa në faqe 421 Adela i kërkon Inës *passëordin e faqes së e-albania të BYL-A, për të shkarkuar faturat që ka bërë,* Ina Goxhaj i përgjigjet se atë *e ka një punonjëse e zyrës së Ajola Xoxës, Greta, në sirtarin e parë të kompjuteri.* **Pra, qartazi rezulton se të gjitha detajet që lidhen me "BYL-A" OJF gjënden në zyrën e shtetases Ajola Xoxa, dhe se Ina Goxhaj figuron si drejtore ekzekutive vetëm në aktet ligjore të organizatës.**

**121.13.1.** Në faqen 459 vijon diskutimi për internetin i cili duhet të ofrohet si shërbim gjatë zhvillimit të projektit, pra në periudhën shkurt-qërshor ose korrik 2022. Konkretisht, Adela Kondakçiu shprehet: ***Ndersa internetin sdi ca te them, vetem te bejme nje kontrate me Selcomin per periudhen e aktivitetit dhe vleren qe kemi ne buxhet i bije. Dhe pastaj e***

*rregullon ai (Altin Bushka) si te nderpritet kontrata.* Adela shton në vijim se interneti është 5 muaj. **Pra, kjo kohëzgjatje kohore i korrespondon periudhës gjatë së cilës supozohet të zhvillohen aktivitetet e financuara nga Ambasada e SHBA në Tiranë.** ***Faqe 460.*** Ina Goxhaj e pyet se çfarë duhet t'i shkruajë dhe t'i thotë kompanisë së internetit apo shtetasit Altin Bushka. Në komunikim nuk specifikohet. Adela Kondakçiu i përgjigjet: ***Na duhet nje fature interneti per 5 muaj, vlera totale e buxhetit 28.000 leke. Periudha Shkurt-Qershor 2022. Për BYL-A. Faqe 461-462.*** **Pra, më thjesht, më datë <u>16.06.2022</u>, financierja e Ajola Xoxës i sugjeron Ina Goxhajt që t'i thotë kompanisë së internetit apo titullarit të saj, që mendohet të jetë Altin Bushka, se i duhet një kontratë për shërbim interneti që fillon efektet nga muaji Shkurt dhe mbaron në muajin Qershor 2022. Në këtë rast provohet qartë se kontrata që do të nënshkruhet për "BYL-A" për ofrimin e internetit dhe që në fakt është parashikuar si shpenzim në tabelën e shpenzimeve për projektin Model Nato, për <u>vlerën 250 euro</u>, do jetë tërësisht fiktive.**

**121.14.** Rezulton nga komunikimet në faqen 493 se këta shtetas arrijnë të organizojnë një takim me 60 nxënës dhe pjesën e stafit diku te 7 persona. Aktiviteti, për të cilin diskutohet më datë 22.06.2022, do të zhvillohet të premten dhe të shtunën, pra më datë 24-25 qershor 2022. Nga faqja 505 e në vijim del në pah e gjithë skema sesi në lidhje me këtë event të financuar nga Ambasada e SHBA lëshohen fatura fiktive.

**121.15.** Gjithashtu, në faqen 650-651 provohet **se është Ajola Xoxa ajo që ndan buxhetin e "BYL-A" dhe që jep ok për kalimin e pagës së Ina Goxhaj.** Konkretisht, Adela Kondakçiu shprehet në faqen 650-651: *Tani varet si e do ndajë buxhetin. SE AKOMA NUK I KA NDARË AJOLA.* Ina Goxhaj i përgjigjet: *MOOOS SHEFJA.* **Por Adela vazhdon duke nxjerrë në pah diçka me interes, që lidhet me mënyrën si Ajola Xoxa ka operuar edhe në raste të tjera, specifikisht me një projekt me Bashkinë Tiranë.** Konkretisht, Adela Kondakçiu për të bërë një paralelizëm për mënyrën e operimit në lidhje me ndarjen e buxhetit, shprehet: ***GJITHESESI NGA KETO PROJEKTET QE KA BERE EVENTUS ME BASHKINE E KANE PATUR KUSHT QE NUK PAGUANIN STAF TE ORGANIZATES. DHE SE DI DMTH SI DO BEJNE PER KETE. Faqe 652.*** **Pra, përsa kohë që vendimmarrja supozohet të jetë e ngjashme me një projekt të realizuar nga "Eventus" (OJF e Linda Kazanit por që faktikisht menaxhohet nga Ajola Xoxa) financuar nga Bashkia Tiranë, dhe përsa kohë që për "BYL-A" shtetësja Ajola Xoxa do të vendosë si do ndahet buxheti, sipas organit procedues arrihet në konkluzionin logjik në lidhje me kontrollin faktik të shtetases Ajola Xoxa edhe mbi Qendrën "Eventus", bazohet në prova dhe fakte.**

**121.16.** Me shumë interes shfaqet komunikimi që ndodhet në faqen 658. Konkretisht, Ina Goxhaj shprehet në faqen 657-658 në lidhje me një person që ka takuar në Bashkinë Tiranë: ***Dje e di si me tha ai cuni. Te Bashkisë. THA KETO SI MERRNI JU. THA EUU KUSH I MERR KETO LEKET. JU VINI DHE FIRMOSNI KAQ.*** Adela e pyet në faqen 658: ***Ju te organizates apo ju punonjesit e kishte ai?*** Ina Goxhaj i përgjigjet: ***OJF. Faqe 659.*** Ina Goxhaj vijon: *JANE TE MEDHENJ ATA QE I MARRIN. Faqe 658.* Adela Kondakçiu i përgjigjet: <u>*AMAN SE JANE NGATERRUAR ME SHUME GJERA*</u>. *Faqe 659.* Ina Goxhaj vijon në faqen 670 duke i referuar çfarë kishte thënë personi që kishte takuar në bashki: <u>***DMTH I MERR AJO PER JU.***</u>

**121.17.** Ina vijon duke i thënë Adelës: ***Ti je në pozitë. E Kuptoj***. Faqe 660. Nga sa më
lart, rezulton e qartë se lekët e financimeve, përfshirë këtu ato të bashkisë nuk administrohen
dhe për më tepër të shkojnë në formën e ndonjë përfitimi tek personat që *de jure* menaxhojnë
OJF-të, por tek persona të tjerë. Adela Kondakçiu vijon: ***Këto do shpenzojnë shumë shumë
lekë. Dhe ishalla po i mbulojnë të paktën nja 60-70% me këto sponsorat. Faqe 661.*** Ina
Goxhaj i përgjigjet: ***TMERR KËTU ËSHTË TEATËR***. Faqe 661. ***ME VJEN PËR TË
VJELLË PLERAT. TURP. Faqe 662.***

**121.18.** Në faqen 663 flitet për pjesën tjetër të fondit që pritet nga Ambasada, por kjo
e fundit pret raportet narrative dhe financiare. Adela Kondakçiu i komunikon Inës në faqen
672, e cila duket në padijeni të plotë se, *ata të zyrës kanë bërë disa kontrata për zërat e
buxhetit dhe i kërkon të jetë dhe ajo, por nuk eshte vendosur fiks se si do procedohet me
pagesat sepse do diskutohet nje moment te dyte*. **Pra, rezulton që kontratat të cilat duhej të
parapranin zhvillimin e aktivitetit bëhen më pas dhe se akoma nuk është vendosur si
procedohet me pagesat, duke lënë qartazi të kuptohet se vendimi për këtë u takon
personave të tjerë dhe ai merret *post factum*.**

**121.19.** Adela Kondakçiu, në faqen 673 shpjegon se *janë bërë mbledhje për këtë gjë,
por ajo nuk di gjë fare sepse nuk ka qenë. Dhe për aq e ka informuar Xhoi*. Ina i përgjigjet:
***Kuptoj kuptoj. As e vë në dyshim.*** **Pra, Ina Goxhaj nuk ka asnjë rol në vendimmarrje. As
në mbledhjet që zhvillohen dhe që kanë për objekt aktivitetin e "BYL-A" ajo nuk
thirret. Vendimet për këtë organizatë i marrin të tjerët, përsa kohë që edhe Xhoi
Skenderasi, punonjëse e Ajola Xoxës, ka më tepër dijeni rreth çështjeve që diskutohen
në mbledhje.**

**121.20.** Në faqen 688 të komunikimeve, është dërguar një Raport Federal Financiar
në gjuhën angleze, sipas të cilit periudha e aktivitetit për të cilin është akorduar dhe granti
nga Ambasada është **04.01.2022 deri më 31.07.2022. Pra, gjatë gjithë kësaj periudhe,
kundrejt grantit të dhënë nga Ambasada prej 18.000 USD supozohet të ishin kryer
aktivitete, nga të cilat në fakt është zhvilluar veç një prej tyre, ai i 24 qershorit 2022.** Në
lidhje me këtë, Adela Kondakçiu në faqen 691 shprehet se *datën e raportit e ka bërë nga 1
prilli deri më 31 korrik, duke lënë të kuptohet se aktivitetet e kryera i përkasin kësaj periudhe
kohore*. Përsëri del në pah fakti që Ina Goxhaj nuk ka asnjë disponim mbi vulën e "BYL-A",
sipas komunikimit të faqes 692. ***Ajo shprehet që vulën e ka Keti (Ketrina Braho).***

**121.21. Në faqen 702 bashkëbisedueset zbulojnë në fakt se si funksionon me
fondet pas kalimit të tyre në llogarinë e OJF-ve, të paktën në rastin konkret të "BYL-
A".** Në faqen 700 Ina Goxhaj pyet *nëse kanë ndonjë të re nga ndërmarrja*. Në faqen 701
Adela Kondakçiu i përgjigjet: ***Ne duhet të bëjmë kalimet sot.*** **Pra, fondet që janë marrë
duhet të kalohen tek personat që do paguhen.** Adela vijon: *dhe do të kaloj edhe ty një
pagesë. Faqe 701*. Ina Goxhaj ironizon duke thënë: ***Uaaa me këtë lajm dmth. U këputa fare.***
*Faqe 701-702*. Këtu komunikimi bëhet interesant dhe përkon me konkluzionet që organi
procedues ka arritur në lidhje me një pjesë të mekanizmit që dyshohet se është përdorur nga
shtetasit nën hetim, për të përfituar në fund shuma të hollash, të cilat burojnë nga financimet e
sponsorëve për rastin e OJF-ve në menaxhim të shtetases Ajola Xoxa. Konkretisht, në
përgjigje të sa më lart, Adela Kondakçiu shprehet: ***AKOMA SE DI A DO TI KTHEJME A
JO KETO FONDE DMTH, GJITHESESI TI JE RAST I VECANTE DHE DO TA
DISKUTOJ ME AJOLEN. Faqe 702***. Këtu Ina Goxhaj, pra Drejtorja ekzekutive e "BYL-

A", e shqetësuar pyet: ***MOS ME THUAJ QE DO JUA JAP*****. Faqe 703.** Pastaj pyet: ***Pse rast***
***i veçantë unë?*** Adela Kondakçiu i përgjigjet: ***MUNDESIA ESHTE QE DO NA QUHEN SI***
***PAGA.*** *Faqe 704.* Kësaj Ina Goxhaj i përgjigjet: *Sepse ska kuptim Adela eshte jo logjike.*
***EDHE PSE NUK PO INVESTOJ MJAFTON QE PO JU BINDEM. QE PO FIRMOS***
***DHE TI E DI QE NESER PASNESER UNE NE FUND PERGJIGJEM PER FIRME***
*Faqe 705-706.* Adela i jep të drejtë duke shtuar: ***Ne qe jemi staf sikur kane thene qe do na***
***quhet page.*** *Faqe 705.* Adela shprehet në faqen 706 se: ***Por Ajola nuk e dinte qe Byla ska***
***projekte. Dhe nuk paguan stafin.*** Pas kësaj, Ina Goxhaj e pyet: ***Te lutem sa i bie te kem une.***
*Faqe 707.* Adela ja kthen: ***Dmth rast i vecante nuk je vetem ti.*** **Nga sa më lart, kuptohet**
**qartë se pagesat vendosen nga Ajola Xoxa dhe ato bëhen në bazë të konsideratës nëse**
**personi është apo jo "rast i veçantë".**

**121.22.** Ina Goxhaj vijon: ***Pagë minimale.*** *Faqe 707.* Në faqen 708 Adela i thotë:
***Jam dhe unë. Se ne të dyja duhet të paguhemi nga BYL-A. Pagesa është rreth 26.000 lekë***
***se do mbahen komisionet.*** Ina Goxhaj, edhe pse drejtor ekzekutiv i "BYL-A", e pyet në
faqen 712: ***Por të dyja do hidhen apo vetëm një?*** Adela i përgjigjet që *do hidhen vec e vec.*
Ina vijon: *Të na hidhen dhe ato të ambasadës dhe ta flejmë mendjen. Te mbyllim vrimat.*
*Faqe 713.* Përsëri në faqen 715 Ina Goxhaj shprehet për gjëndjen e saj jo të mirë ekonomike.
*Faqe 715.* **Në faqen 750 nga komunikimet duket se shtetësja Ajola Xoxa aktivizohet**
**përsëri për festivalin e dancit bashkëkohor,** për arsye se **Adela Kondakçiu njofton Inën**
**se po bëjnë një kontratë me Ministrinë e Kulturës për festivalin përsëri. Pra, nuk është**
**Ina Goxhaj ajo që njofton financieren, por anasjelltas.** Kontrata do të jetë për
sponsorizim. *Faqe 750.* Ina Goxhaj i përgjigjet se *bëhet fjalë për atë të djeshmen që kishte të*
*bënte me buxhetin qe KISHTE cuar dje. Faqe 751.* Adela ja konfirmon në faqen 512 dhe
shton se *që është aprovuar ja kishte thënë* ***Keti (Ketrina Braho).*** **Dmth, Ina Goxhaj si**
**drejtoreshë ekzekutive e "BYL-A" njoftohet se është miratuar një projekt me**
**Ministrinë e Kulturës nga punonjëse të Ajola Xoxës.** Adela shton në të njëjtën faqe se
*kontrata po bëhet gati dhe se është shumë urgjente.* Ina Goxhaj i përgjigjet në faqen 753: *Une*
*nuk shkeputem dot. Mbas pune vij dhe e firmos. Por gjate orarit veshtire sepse neqese leviz i*
*bie ta zvendesoj sa ore mungoj.* ***Dhe vijon ta pyesë nëse pret puna deri të hënën. O sot o s'ka***
***duhet?*** Këtu Adela i sugjeron të njëjtën metodë siç e kanë përdorur më parë me OJF tjetër që
menaxhohet në fakt nga shtetësja Ajola Xoxa: ***Atehere mbase mund ta bejne me nje***
***prokure per nje person qe ta firmose ne emrin tend si bejne keto te Harabeli.*** *Faqe 755.*
Vetëm në këtë rast duket se Ina Goxhaj bën kujdes, duke thënë: ***Prokure mund te behet e***
***posaçme vetem ne lidhje me kete projekt. Që ta shoh pls. Që të di cfarë firmos.*** Faqe 756.
Por nevoja për prokurën duket se nuk është më. Në komunikimet në faqen 757, Adela njofton
Inën: ***Degjo ska nevoje per prokure. Te henen do jete gati kontrata dhe do e marrim dorazi***
***që ta firmosesh ti dhe tia kthejme perseri. A eshte ok keshtu?*** Ina Goxhaj shprehet *dakord.*
**Pra, kontrata dorëzohet te Ina Goxhaj në fund dhe vetëm për t'u firmosur nga kjo e**
**fundit.**

**121.23. Në faqen 762, "BYL-A" duket se sponsorizohet edhe nga Albtelekom dhe**
**Ina Goxhaj nuk di asgjë.** Në fakt për këtë e njofton Adela e cila i thotë që do i sjelli dhe një
kontratë të kësaj kompanie për sponsorizim. Kur Ina Goxhaj i thotë *se ka firmosur një të tillë,*
Adela i përgjigjet negativisht. Faqe 763. Adela vijon: *Ke firmosur Credins dhe QTU. Faqe*
*764.* Në faqen 771 Ina Goxhaj thotë *se do takonte Ildën, se kjo (Ejona Isufaj) kot bën si shefe.*

Adela i jep porosi në faqen 772: *Mundohu te mbrosh punen tende. Dhe thuaji qe kemi bere*
*shume pagesa etj et. Sepse do mundohen te ulin dhe te kerkojne leket.* **EDHE NDERKOHE**
***DO SHOHIM EDHE RAPORTIN TA BEJME PER PAGESAT REALE.*** *Faqe 773.* Ina
vijon duke u shprehur: ***Plerat. Ste lënë rehat.*** Adela Goxhaj i thotë: ***AMAN PO MBETEN***
***EDHE PER 3-4 MIJE DOLLAR QE MBETEN ATY O INA.*** *Sdi ca të them. Jam pa fjalë.*
*Faqe 775-776.* Ina thotë që këtë <u>ja kishte thënë Eraldi</u>: *O shoqe do kujtohen. Prite ndonjë*
*ditë. Sa të ulët. Plera.* Adela i përgjigjet: ***Ku i shpëton gjë këtyre.*** *Faqe 778.* Ina vazhdon: *Se*
*acarohem shumë. Faqe 779.* Përsëri Ina: ***<u>Kur do ngopen</u>.*** *Faqe 780.* Në këtë pikë, pasi e
porosit që të shkojë e qeshur në takimin me Ildën, Adela i thotë se *kanë info për ata (shefat).*
Konkretisht, Adela i thotë Inës: ***Dhe shpjegoji qe disa info i ke ti dhe disa une. Si të***
***mbrohesh ti më mbron edhe mua.*** *Faqe 781-782.* Ina i përgjigjet *që do ja thotë.* Adela
vazhdon në faqen 783: ***Se do na lënë pa lekë.*** Ina parashikon çfarë do i thonë për lekët e
projektit me Ambasadën Amerikane dhe thotë saktësisht: ***Ato do thone ato leket i duan ato te***
***USA. Faqe 784.*** Adela i përgjigjet: ***A jo moj. <u>Po sikur skishte kosto ky projekti</u>. Si skaluan***
***këto lekët ti kishim marrë dhe të bënin si të donin. Faqe 786.*** Ina Goxhaj i përgjigjet: ***AJO***
***MË THA MENAXHOJI VETË TANI THOTË CU BË.*** *Faqe 786.* Akoma më interesant
bëhet komunikimi që vijon në faqen **788**, kur Adela thotë: ***<u>SE LEKET QE NA KALUAN</u>***
***<u>EDHE NE NGA KRK ME SHUME MUNDESI DO NA I KERKOJNE</u>.*** **Pra, Adela**
**Kondakçiu shprehet hapur se lekët që i kanë kaluar nga projekti i financuar nga**
**Kongresi Rinor Kombëtar, i cili nga ana e tij financohet me shuma mjaft të**
**konsiderueshme nga Bashkia Tiranë, rrezikojnë t'i kalojnë përfituesve të vërtetë**
**fundorë, pra atyre që menaxhojnë në fakt OJF objekt hetimi.** Ina Goxhaj qesh me sa më
lart. Faqe 788. Nisur dhe nga kjo, Ina Goxhaj thotë: ***Une nuk duhet te ha presionin kupton.***
***<u>MOS ME THOTE MI JEP MUA ATO TE KRK</u>. Faqe 789.*** Adela i kujton më pas që duhet
të paguajë tatim për dypunësimin dhe për këtë thotë se: *Ia kam thene Ketit dhe* ***me ka thene***
***ta diskutoj me Ajolen.*** *Faqe 792.*

**121.24.** Pas takimit që mendohet të ketë ndodhur me shtetasen Klotilda Bushka, Ina
Goxhaj shprehet në faqen 795: ***Dje takimi ishte shume formal Ajo Donte Info Vetem Si***
***Shkoji Dhe Si U Organizua.*** Në faqen 810 rezulton se Adela është pyetur nga një punonjës i
Ambasadës *nëse kanë patur sponsor të tjerë.* Adela i kishte thënë *jo.* Ina Goxhaj i përgjigjet:
***Jo jo sjemi Ajola tek kjo pjesë.*** *Faqe 812.*

**121.25.** Nga komunikimet e faqes 841-844 rezulton se organizata **"SHIZI"** është e
lidhur me shtetasen Klotilda Bushka. Ina Goxhaj i dërgon një mesazh Adelës ku shprehet se:
*Une te kuptoj shume mire. Por heren e fundit kur fola i thashe Gretes cdo besh me Shizin pse*
*nuk ve ne djeni Ilden sepse eshte Adela per te paguar. J a kam thene kete. Dha ka thene une*
*dua ta le fare. Dhe pastaj pyeta per kete te BYLA. Faqe 841.* Adela i përgjigjet ndër të tjera
në faqen 842: ***Se nese une i them Ildes ti e di si behen gjerat pastaj.*** *Dhe sdua te shkojme ne*
*ekstreme per asnje.* **Të gjitha komunikimet që ndodhen në faqet në vijim lidhen me**
**dyshimet që ka Adela Kondakçiu dhe Ina Goxhaj në lidhje me dy shtetas, Greta**
**Kokalari dhe Erald Ismaili, të cilët mendohet të ketë marrë një shumë të**
**konsiderueshme të hollash nga projekti me Ambasadën Amerikane dhe nuk i**
**justifikojnë dot me shpenzime. Për këtë shkak, të dyja bashkëbisedueset janë të**
**shqetësuara si do raportojnë tek shtetësja Klotidla Bushka për këtë.**

**121.26.** Nga komunikimet shihet gjithashtu se veprimet financiare tek "BYL-A" ndërthuren me ato të organizatës tjetër "SHIZI". *Faqe 845*. Duke dyshuar për shuma të marra prej Greta Kokalarit dhe Erald Ismailit (bashkëshortë) të cilat nuk justifikohen, Adela shprehet: ***Ne mund ta verifikojme shume lehte kete te hotel Dajtit se shkojme nje dite atje edhe pyesim nje person te finances a manaxhimit, po shpresoj mos ta bejne veten Eraldi dhe Greta. Faqe 845.*** Adela vijon: ***AMAN SE SJEMI VETEM NE, EDHE NE DO RAPORTOJME DIKU***. Faqe 847. Adela shprehet në faqen 848: ***Ne i thirrem qe te merrnin edhe ata dicka, se mund te kishim marre njerez te jashtem fare komplet. Aman se kam 10 vjet qe punoj me kompani eventesh i njoh mire gjerat.*** Në faqen 849 Adela thotë që ***do i thërrasi dhe njëherë por pastaj do flasi me Ildën për situatën.*** Ndërsa Ina Goxhaj thotë që Adela do marrë për këto 6 muaj pagesë, ***dhe për këtë le të thotë ca të dojë Ilda.*** Adela Kondakçiu i përgjigjet: ***UNE DO TI THEM VETE ILDES SEPSE UNE KAM MBAJTUR 3 NIPTE EDHE TE ALTINIT ME KETE PAGESE QE MARR. DHE DUKE JU LUTUR PER LEKET SIKUR PO LYPJA. Faqe 852.***

**121.26.** Në faqen 853 Adela Kondakçiu i kalon Ina Goxhajt një informacion që kërkon të mbetet konfidencial. Sipas një foto screenshot të dërguar nga Adela në drejtim të Inës, rezulton *se shtetësja Klotilda Ferati (Bushka) i ka dërguar një email (supozohet Adelës)* ku i thotë: <u>*jo më duhet si vërtetim për bankë se do marrim një kredi për shtëpi.*</u> Ina Goxhaj i përgjigjet: ***Uaau dhe Adela shton: Prandaj qenka kujtuar për shoqatat. Faqe 855.*** Ina vijon: ***Uaaa. Pa fjalë.*** Faqe 856. Adela ja kthen në faqen 856: *Edhe ne duhet të jemi të sakta. Që mos të kemi probleme*. Faqe 857. **Fiktiviteti i faturave dhe pagesave të kryera evidentohet në të gjitha komunikimet që pasojnë, faqet 893 e në vijim. Nga to kuptohet qartë përpjekja për të kamufluar pagesa ekspertësh për ekspertizë të pakryer ndonjëherë, por që realisht kanë shkuar në favor të personave të tjerë. Nga i gjithë projekti i Ambasadës Amerikane financuar me <u>18.000 euro</u>, konstatohet se të vetmet shpenzimet reale mund të kenë qenë pagesat prej 6.600 lekë për person në darkën e organizuar në Hotel Dajti. Duke patur parasysh dhe numrin 70 të personave, mund të arrihet lehtë në konkluzionin se diferenca e mbetur nga shuma prej 18.000 USD është mjaft e konsiderueshme.**

**121.27.** Përsëri në faqen 927 Ina Goxhaj shprehet se *është e shqetësuar për raportimin tek Ilda*: ***Dhe tek kjo pjesa kam hall se mos thote Ilda projekti ka mbaruar dhe pse ke marre pagesa.*** Në këtë komunikim intensiv, në faqen 931 Adela Kondakçiu thotë: ***LEQE BUXHETET KANE QENE GJITHE KOHES TE FRYRA.*** Në faqen 933 Ina shprehet: ***Epo keto leket qe mund ti marrim ne gjate vitit i mernin ne xhep Ejona dhe tj.*** Adela ja kthen: ***Dmth ato me 3-4 paga dhe ju me zero.*** Faqe 935. **Nga komunikimi kuptohet që të paktën përsa i përket zhvillimit të projektit me Ambasadën Amerikane në Tiranë, personat që realisht kontrollojnë "BYL-A" kanë qenë shtetaset Klotilda Bushka dhe Ejona Isufaj, tek të cilat Ina Goxhaj thotë se duhet raportuar. Roli i shtetases Ajola Xoxa del në pah pas përfundimit të këtij projekti, pra në gjysmën e dytë të vitit 2022, kohë kur "BYL-A" angazhohet në projektin e Festivalit ndërkombëtar të Dancit bashkëkohor.**

**121.28.** Por megjithatë, edhe gjatë kësaj periudhe, Adela Kondakçiu shprehet ***se i ka thënë Ajolës që ta hiqte nga BYL-A dhe SHIZI, se nuk do të merret me to. Ajola i ka thënë se do fliste me Ildën dhe do i kthente një përgjigje. Faqe 969.*** **Qëllimi për të prodhuar**

**fatura fiktive në mënyrë që të justifikoheshin shpenzimet në lidhje me projektin e financuar nga Ambasada e SHBA provohet edhe nga komunikimi i faqes 996-997,** ku Adela shprehet: ***Te provojme ti kerkojme nje oferte tjeter (hotelit). Per nje aktivitet gjasme ne disa data qe ska fluks njerezish. Faqe 996-997.*** Në faqen 107 të komunikimeve Adela *shprehet e keqardhur që dy organizatat "BYL-A" dhe "SHIZI" janë lënë pas dore*: ***Po gjynah se keto jane shoqata me cv dhe kane mundesi me njohjet e ketyre shefeve.*** Por Ina Goxhaj shton: ***PO KUSH TE LE TE PUNOSH DUAN DHE NE FUND TI MARRIN ATO QE KE PER RISK TI MARESH VETE. JA KUR TE KUJTOHET ILDA PER LEKET E KESAJ TE BASHKISE. TE THOTE MI JEP MUA. Faqe 1006-1007.*** Adela nga ana tjetër shprehet e shqetësuar: ***KETO EDHE NEVE QE NA KALUAN RREZIK DO NA I KERKOJNE, POR UNE PO PRES QE TE FLAS VECMAS ME AJOLEN KUR TI JAP LISTEN E LEKEVE QE KA MARRE STAFI. Faqe** 1007.* **Ina Goxhaj i përgjigjet: *Po po ka shume mundesi*.** *Faqe 1009.* Në faqen 11 Ina Goxhaj përdor një epitet në përgjigje të pretendimit të Adelës së punën e saj nuk e vlerësojnë: ***Vampirë janë përfundimisht.***

**121.29. Në faqen 1035 paraqet interes komunikimi në lidhje me pagesat e ekspertëve.** Adela i thotë ***se mbase po fut hundët më shumë sesa i takon, por a i kanë paguar ekspërtët më përpara.*** Përveç një personi të quajtur Fredi. Përgjigja e Inës është: **ATEHERE NE I KEMI PAGUAR DHE JUA KEMI MARRE PERSERI VLEREN. Sepse kanë qenë si Fredi. DMTH QË I KEMI PAS TË NJOHUR DHE JUA KEMI KËRKUAR. DHE ATO KANË FIGURUAR TË PAGUARA, SI EKSPERTË NË THONJZA. Faqe 1035-1036.** Adela këmbëngul: ***PO REALITET DMTH. APO SKENI PAGUAR ASNJË***. Faqe 1037. **Ina Goxhaj ja konfirmon indirekt që nuk janë bërë pagesa reale,** duke i thënë: ***Ne që kemi marrë pagesat. Dhe ndonjë si Ejona psh. (pra, nuk ka patur pagesa reale të tjera).*** Faqe 1037-1038. Pas kësaj, Adela Kondakçiu thotë: ***AHA DMTH EDHE KETYRE MOS TJU RREJE MENDJA KOT QE DO MARRIN ME SHUME SE LEKET QE KANE MARRE LART E POSHTE.*** Faqe 1038. Ina Goxhaj i përgjigjet: ***KESHTU KA FUNKSIONUAR GJITHMONE. DHE GJITHMONË SI EKSPERTË KANË MARRË TË NJOHURIT TANË. FAREFISI MOTRAT E GRETES MOTRA E ERALDIT. DHE KËTO (LEKËT) JANË KTHYER MBRAPSHT.*** Faqe 1038-1039. Adela akoma këmbëngul: ***DMTH JAM ME RREGULL QE E KAM BERE QE ATA DUHET TE KTHEJNE LEKET.*** Faqe 1039. Ina Goxhaj përgjigjet: ***ME RREGULL 3 PO ASHTU I BIE.*** Kur Ina Goxhaj pyet Adelën nëse nuk e ka ditur këtë, ajo i përgjigjet: ***Une vetem ca kam nenkuptuar. Se keshtu drejtperdrejt sme ka thene njeri dmth. Faqe 1040-1041.*** Ina i përgjigjet: ***Ja ta thashë unë.***

**121.30.** Në lidhje me lekët e Ambasadës, në faqen 1092 Ina Goxhaj shprehet: ***I bie qe kur te vije shuma duhet ta bej dhe me dije Ilden plus dhe tja dorezojme raportin. Dmth të bëhen pagesat tona.*** Ina Goxhaj e pyet më pas për një pagesë: ***Po Ajola te ka thene per ate pagesen qe eshte hedh si rroge dhe per tj qe pritet?*** Adela Kondakçiu i përgjigjet: ***Edhe sot ia kujtuam cfare do behet me keto pagesat. Faqe 1094.*** **Përsëri në faqen 1096 evidentohet shqetësimi që kanë bashkëbiseduese për të raportuar tek Ilda, që mendohet të jetë shtetësja Klotilda Bushka.** Adela i thotë Inës: *Ilda ishte dje po nuk e arrita, sepse ne momentin qe do ta gjej do ti them edhe per shizin edhe per leket qe kemi kaluar te greta edhe sna kane thene nga i kane cuar.*

**121.31.** Më datë 24.11.2022, në faqen 1113 të komunikimeve, Adela Kondakçiu i thotë Inës se **lekët e Ambasadës kishin kaluar. Këtu fillojnë diskutimet për pagesat që duhet të kalohen si paga, dhe fakti që këto duhen raportuar tek Ilda.** Në faqen 1160 Adela i kërkon Inës ***të firmosë ca akte se do mbyllin një projekt të Ministria e Kulturës.*** **Bëhet fjalë për periudhën Korrik 2022. Pra, projekti me Ambasadën Amerikane ka përfunduar.**

**121.32.** Në faqen 1164 Ina Goxhaj i kërkon Adelës *të marrë disa lekë që kanë hyrë në llogarinë e "BYL-A" prej Ambasadës Amerikane*. Bëhet fjalë për një shumë prej 1 milion (tekstualisht) dhe <u>*për të cilën Ina thotë që do t'i shtojë përsëri kur t'ja kërkojë Ilda.*</u> Për këtë, **Ina i kërkon Adelës që të mbetet mes tyre**. Faqe 1165. Në faqen 1198 ***Ina Goxhaj pyet Adelën sa lekë duhet t'i japi I?*** (përdor inicialet). Adela e pyet: ***Nga totali i projektit thua?*** Faqe 1199. Ina i thotë: ***Nga keto te fundit se kete me tha ath kur e kam takuar. Sa mbeten nga projekti?. Faqe 1200.*** Adela i përgjigjet: ***Po sikur ishin 2.000$ ne llogari dhe leket e Gretes.*** Faqe 1200. Ina përsëri në faqen 1201 shfaqet e shqetësuar: *Une mendoj qe te takohemi ndonje dite bashke, kam hall se* ***tek une do perplaset ajo per leket*** *e atyre me te fut ne stres kot.* Adela vijon: ***O Ina edhe ne mund te marrim leket edhe te themi jane shpenzuar, po ku jane shpenzuar?*** Faqe 1210. Në komunikimet e faqes 1226 rezulton se **Ina Goxhaj pyet për çfarë festivali bëhet fjalë, se nuk po kupton gjë**. Mesa kuptohet, bëhet fjalë për festivalin e dancit bashkëkohor, i cili është bërë dhe më parë me "BYL-A". Adela i thot në faqen 1227, *se nuk e di a do e bëjnë me BYL-A më.* **Ajo çfarë kuptohet nga kjo mori OJF-sh është se kjo i lejon ideuesit e tyre që të manovrojnë për aplikime dhe më pas për xhirime fondesh sipas nevojave të momentit. Pra, duket se dhe vetë drejtori ekzekutiv nuk e ka idenë për çfarë bëhet fjalë dhe nëse do e bëjnë festivalin përsëri me "BYL-A".** <u>**Ky vendim merret nga shtetësja Ajola Xoxa në këtë rast.**</u> Madje Ina Goxhaj thotë në faqen 1227: *Aman më mirë jo.* Adela i thotë në lidhje me këtë në faqen 1228: ***GJITHESESI AJOLA KA QENE VJET SHUME E INTERESUAR ME BYL-A VJET MBASE MERRET AJO NESE DO KETE KOHE DMTH.*** ***Ndersa per Shizin se di ca do behet dmth.***

**121.33.** Ina Goxhaj duket se ka shqetësim tjetër, përsa kohë nuk është ajo pronari real i organizatës "BYL-A" dhe vendimet për të i marrin të tjerët: *Kuptoj Une dua qe mos me penalizoje puna e statusit. Faqe 1229.* Ina Goxhaj, ndërsa i thotë Adelës se *punon kot nuk mer gjë* shton në faqen 12309: ***SE VETËM PËR SIGURIMET SJA VLEN QË TË RREZIKOJ.*** Përsëri në faqen 1232-1233 Ina Goxhaj shpreh shqetësimin se *ca do i thotë Ilda kur ta takojë,* në lidhje *me lekët e kaluara nga Ambasada Amerikane.* Adela i thotë se në *llogari ka akoma 2.000 USD të paprekura. Faqe 1233.* Nga komunikimet që pasojnë deri në faqen 1259 rezulton qartë se *shqetësimi kryesor i bashkëbiseduesve është raportimi te Ilda dhe ndarja e lekëve që kanë mbetur në llogari.* Megjithatë, shqetësim tjetër duket se është dhe ***gjetja e personave që do faturohen fiktivisht, të cilët duhet të jenë njohje që të garantojnë mosmarrjen apo kthimin e lekëve.***

**121.34.** Në faqen 1259 Ina Goxhaj, duke ju referuar një bisede me Greta Kokalarin, personi që është marrë me shkruarjen e projektit më Ambasadën Amerikane dhe bashkëshortja e shtetasit Erald Ismaili, edhe ky i angazhuar me këtë projekt por edhe person i afërt me shtetasen Ajola Xoxa (siç do të shohim më pas). shprehet: <u>***THA NUK KEMI KU TI GJEJME NJERZIT PER MARRJEN E FIRMAVE POR DUA TA MBYLL THA SE DHE STRES E KAM.***</u> Në lidhje me këtë Ina Goxhaj thotë: <u>***Mesa kuptova une ata asgje nuk***</u>

***kishin bere as per te mbledhur firmat sepse me nje nga ato qe eshte ne asamble Eraldi nuk ka muhabet dhe sipas saj kete gje ia beri me dije I.. dhe ajo i kishte thene zgjidhe hajde kur ta kesh mbyllur si pune.*** *Faqe 1261.* Në faqen 1270, ndërsa flasin për mbylljen e llogarisë së "BYL-A", Adela Kondakçiu thotë: ***DO BËHEN ME AJOLËN MBYLLJET. Se ajo ska punë me festivalin*** ***dmth (Ilda).*** **Pra, nga momenti që "BYL-A" bëhet pjesë e organizmit të Festivalit ndërkombëtar të Dancit bashkëkohor, duket se për menaxhimin e saj pyetet shtetësja Ajola Xoxa, dhe jo më Klotilda Bushka.**

**121.35.** Në faqen 1282 paraqet interes komunikimi që ka lidhje me **Kongresin Rinor Kombëtar, i cili shpjegon dhe rolin e Ajola Xoxës në menaxhimin e "BYL-A".** Më datë 07.02.2023, Adela i thotë Inës: ***Ne po presim keto dite edhe ato te Krk qe te bejme mbyljet EDHE TE VENDOSE AJOLA CA DO BEHET ME LEKET.*** Në fakt, nga Kongresi Rinor Kombëtar, rezulton se "BYL-A" pret të marrë një financim prej 4.000.000 lekë, **të cilat së bashku me shumën prej 5.000.000 lekë të dhënë nga Bashkia Tiranë, kapin vlerën e 9.000.000 lekë. Këtu duhet theksuar që vetë KRK është financuar me një shumë mjaft të konsiderueshme nga Bashkia Tiranë, për organizimin e këtij festivali.**

**121.36.** Faturimet fiktive për projektin e Ambasadës Amerikane vijojnë të diskutohen edhe në faqen 1314, ndërsa Ina Goxhaj i thotë Adelës që ***disa shpenzime t'i fusë si të bëra për transport ose në fotokopje materialesh.*** Por nga ana tjetër, ***taksitë rezultojnë të jenë faturuar dhe nuk shtojnë dot gjë tek pjesa e transportit.*** *Faqe 1328.* Në faqen 1316 Ina Goxhaj thotë *që Greta I kishte thënë se kishte në plan të takonte I... (mendohet të jetë Ilda) që t'i thotë të mbyllë SHIZIN.* Greta, sipas Inës në faqen 1316 të komunikimeve, *ka thënë që do i jepte dhe rrogën Adelës dhe pjesën tjetër asaj (mendohet Ildës), se për vetë nuk kishte marrë pagesë.* Kur e ka pyetur Gretën sa lekë ishin në llogarinë e SHIZIT, ajo sipas Inës i është përgjigjur: *10 milion. Faqe 1316.* Adela Kondakçiu *habitet, duke shtuar se kur ishin bërë aq shumë në atë llogari.* Faqe 1317. Përsëri në faqen 1319 Ina përsërit atë që mendohet t'ja ketë thënë Greta Kokalari: ***Ajo tha adeles do i jap aq sa i takon. Dhe pjesën tj asaj (mendohet Ildës).***

**121.37.** Në faqen 1348 të komunikimeve rezulton që Ina i dërgon këtë mesazh Adela Kondakçiut: *Miremengjesi Adela si keni qene me shendet mire? Do te shkruaja dje por ishte vone.* ***Takova Greten dje me Eraldin.*** *Dhe i thashe per shumen qe nuk eshte pak por jane shume.* ***Ajo tha qe une nuk dua qe te merej vesh qe i kam marre ato lek, dhe justifikoji tek Hoteli dhe ndonje zyshe qe eshte paguar. Sepse I...kur tja dorezosh nuk do ti doje me fature thjesht zera si shpenzime ose futi tek ekspertet pervec çekut i keni dhene dhe lek cash.*** *Ti i thashe kete e thoje me pare se skishe pse ta mbaje te fshehet qe shiko se i morem ne dhe nuk kishim pse te kerkonim fatura, ajo eshte goxha shume jo pak. Dhe neser pasneser ajo mua dhe Adeles do i kerkoje llogarri.* ***Tha pa merak se tek Shizi ka goxha dhe nuk do i beje pershtypje si shume aq sa kane mbetur.*** *Se do shkoj une ta takoj keto dite dhe do ja them tha, se dhe Adelen do ta takoj.*

**121.38.** Në faqen 1354 komunikimet mes Ina Goxhaj dhe Adela Kondakçiut, me referencë tek Greta Kokalari për faturimet e fryra vijojnë: ***Une i thashe me Adelen kam fol hapur sepse keshtu e lame te treja qe cdo gje do e themi shpenzime reale dhe jo ato reale.*** *Te ishte ashtu i ndanim ne 3 ate shume dhe binim ne konsensus.* ***Dhe i thashe dhe kete shume ishin ato faturat e materialeve ia kishin futur kot se gjithmone i kemi marre me cmime te tj.*** *Tha po dhe hoteli ishte shume,* ***leket e hotelit su morren vesh i thashe. Se di tha sa pagoji***

***Eraldi cash, Eraldi ka paguar dhe mandat atyre si ka marre.*** Ndërsa për lekët e "SHIZI", Ina i referon bisedën e bërë me Gretën Adelës: ***Per leket e Shizit ajo tha qe duhet te flas me I.. qe si do e rregulloje punen e bankes qe te terhiqen ato lek se per mom sbehet asnji veprim. Faqe 1356.***

**121.39.** Më datë 22.02.2023, në faqen 1357 të komunikimeve rezulton që *Ina Goxhaj ishte nga zyra (e "Partners Laë") pasi e kishte kërkuar Xhoi (Skënderasi) për një projekt të bashkisë.* **Pra, punonjësja e Ajola Xoxës i kërkon Ina Goxhajt, drejtore ekzekutive e "BYL-A" të shkojë tek zyrat e Ajola Xoxës për një projekt që lidh këtë organizatë me Bashkinë Tiranë.** Në faqen që vijon, 1358, Ina Goxhaj shprehet *se ka dëgjuar që duan ta heqin nga OJF (BYL-A).* Adela në lidhje me këtë i përgjigjet: ***MOJ SME KA THENE GJE AJOLA ME. QE VJET QE U CUDIT PSE NUK KISHTE PROJEKTE DHE THA DO FLAS ME ILDEN. Por nuk e di të them të drejtën për ndryshime. Faqe 1359.*** **Pra, rezulton e qartë se "BYL-A" mund t'i jetë nënshtruar një menaxhimi të përbashkët nga shtetaset Ajola Xoxa dhe Klotilda Bushka. E para e çuditur për mungesën e projekteve thotë që do e flasë me Ildën. Nga komunikimet gjithashtu del e qartë se kush vendos për ndryshime që mund të ndodhin në OJF.** Në faqen 1360 Adela pyet: ***Po cfare projekti qenka ky i Bashkise se ato thane sdo e bejme nga Byla.*** *Se po diskutonte bashkëshortja e dajës së Ajolës. Se deri sa isha une ishte per jo qe nuk do aplikonte byla. Faqe 1363.* **Adela Kondakçiu e thotë qartë që për aplikimet për projekte, ky i rastit konkret në bashkinë Tiranë, vendimi merret nga Ajola Xoxa.**

**121.40. Në faqen 1364-1365 del edhe njëherë në pah mekanizmi i marrjes dhe kthimit të lekëve tek shtetësja Ajola Xoxa.** Ina Goxhaj thotë: ***SE AJOLA I KISHTE THENE XHOIT, QE LEKET DO HIDHEN TEK INA DHE DO I KTHEJË. Faqe 1364-1365.*** Ina vijon në faqen 1366: ***Ishte ideja qe ti lek sdo maresh. TERHEQJET DO I SJELLESH TEK NE.*** Adela ja kthen: ***Aman. Se ne punuam 1 vit me aplikime. Ik ketej e ik andej. E s'morëm asnjë lek nga kjo. Ka filluar të bëhet pak e rëndë puna në fakt. Faqe 1367-1368.*** Ina Goxhaj i përgjigjet: ***Na kanë acaruar.*** Faqe 1369. ***Në një anë më mirë të venë një tj. Ato nuk dua të ngrihesh dhe kjo është vërtetuar me kohë. Faqe 1369.***

**121.41. Në faqen 1380-1381-1382 kuptohet edhe një herë qartë mënyra si këto OJF funksionojnë**: Konkretisht, Adela i shkruan Inës: ***Tani une po mendohem ne fakt dhe mund te bej nje kalim te vetja per keto muajt qe po kalojne Janar-Shkurt dhe po merrem me Byl-A. Se nga bashkëshortja dajes sbehet fjale te nxjerri asnje leke per shpenzime. Se ketu po su kujtove per vete skujtohet njeri per ty. Se nga bashkëshortja dajes sbehet fjale te nxjerri asnje leke per shpenzime.*** Ina Goxhaj i përgjigjet: ***Po ajo u be e qarte kete na tha dhe Xhoi qe asgje nuk do preket.*** Në faqen 1399 rezulton se Xhoi Skënderasi i ka shkruar Inës *duke e pyetur për projektin.* Ina Goxhaj thotë: ***Se e kanë merak mos jua marrim lekët. SE DIREKT DUHET T'I THEM KUR TI HEDHIN.*** Adela e pyet: ***Po ca do hedhin kur s'kanë firmosur kontratën. Skemi bërë as faturë. Faqe 1401-1402.*** Ina Goxhaj duket se e ka pyetur Xhoin se ***kush duhet ta lajmërojë për lekët, që ajo më pas të lajmërojë atë. Faqe 1403.*** Xhoi Skënderasi i është përgjigjur: ***Thjesht do të vije email.*** Ina thotë që *as e ka idenë fare.* Faqe 1404.

**121.42.** Përsëri Ina Goxhaj është e shqetësuar për raportimin te Ilda. Ajo madje thotë: *Mendoj qe po te shkoj ta sqaroj per punen e atyre lekeve dhe tja japim ato qe keni aty...ti si thua? Se e kam stres kete pjesen ... Sidomos ate shumen e Gretes spo di.* Faqe 1405. Por Ina

nga ana tjetër shprehet se: ***Kam hallin se thote i keni marre dhe sme jepni shpjegim. Janë shumë për të justifikuar.*** Faqe 1406. Ina përsëri shpreh ***përshtypjen e saj se A (duhet të jetë Ajola Xoxa) do e heqi atë nga "BYL-A"***. faqe 1409. Por Adela e qetëson duke i thënë: ***Besoj qe do ti duhet dikush ketu per menaxhimin se do bejne projekte.*** Faqe 1410. Adela shton në faqen 1411-1412: ***Nuk po marrim vesh ca bejne. POR NE DO E HAME SI PERFUNDIM. LLAFE PO, LEKE JO.*** Ina shprehet: ***Ato e kanë vendosur të dyja atë punë. I me A.*** faqe 1413. **Kuptohet qartë që i referohet shtetases Klotilda Bushka dhe Ajola Xoxa.** Në faqen 1423 Adela i thotë Inës: ***Paska ditelindjen sot Ilda. Biseda është bërë më datë 11.04.2023.*** **Nga këqyrja e regjistrit të gjëndjes civile rezulton që shtetësja Klotilda Bushka ka lindur më datë 11.04.1979.** Ina thotë në faqen 1430 *që do shkojë për ta uruar:* ***Une do shkoj si per ta uruar. Dhe e sigurt qe do pyese edhe per leket as e ve ne dyshim.*** Përsëri në faqen 1434 Ina Goxhaj pyet Adelën *nëse ka marrë vesh gjë që do e heqin.* Adela i përgjigjet: ***NUK ËSHTË DISKUTUAR.*** Kjo dëshmon edhe njëherë se kush i merr në të vërtetë vendimet në lidhje me **"BYL-A"**.

**121.43.** Më në fund, në faqen 1447 duket se Ina Goxhaj *ka takuar Ildën*, dhe referon tek Adela: ***Mirembrema Adela si je ti mire? Une shkova ne zyre e takova Ilden shume pak, sepse do levizte. Dhe nuk e permendi fare pjesen e projektit Thjesht ishte ne qejf. Asgje e re me pak fjale. Takimi ishte paqësor dhe asgjë nuk u fol. Faqe 1450.*** Adela i përgjigjet: ***Ishalla kanë harruar. Besoj mendërisht dhe ajo e ka fshirë BYL-A.*** faqe 1450. Në këtë rast, Adela i referohet Klotilda Bushkës. Ina Goxhaj i përgjigjet: *Hahaha thua vallë.* Faqe 1451. Por Adela shton: ***POR IA KANË KALUAR NJËRA TJETRËS.*** Faqe 1451. **Nga këto komunikime rezulton e qartë se menaxhimi faktik i "BYL-A" ka kaluar sa nga shtetësja Klotilda Bushka tek Ajola Xoxa.**

**121.44. Në faqen 1472 rezulton akoma më qartë sesi funksionon shtetësja Ajola Xoxa në menaxhimin e OJF-ve të kontrolluara prej saj *de facto*.** Konkretisht: Adela Kondakçiu i shkruan Ina Goxhajt: ***Do te kaloje gjate javes pagesen e dyte nga KRK-ja. Sepse kane qene 2 paga te llogaritura edhe vetem njera te ka kaluar. AJOLA NE FAKT KA THENE QE DUHET TE KTHESH TE DYJA PAGESAT, POR I KAM THENE QE NJEREN DUHET TA MBASH PER TATIMIN E DYPUNESIMIT.*** Ina Goxhaj pyet: ***Nga projekti i Bashkise?*** Adela Kondakçiu i përgjigjet: ***PO. Festivali. Faqe 1473-1474.*** **Pra, rezulton mjaft e qartë mënyra e funksionimit të OJF "BYL-A" në rastin konkret. Pasi kalojnë pagesat për personat që duhet të paguhen, si jemi në rastin e shtetases Ina Goxhaj si drejtore ekzekutive, Ajola Xoxa urdhëron që pagesat duhet të kthehen. Akoma më peshë merr ky fakt kur bëhet fjalë për një projekt të financuar nga Bashkia Tiranë, e cila drejtohet nga bashkëshorti i Ajola Xoxës, shtetasi Erion Veliaj. Thënë ndryshe, financimet e bashkisë Tiranë për "BYL-A" në rastin konkret, përfundojnë tek bashkëshortja e tij, pra në familjen e kryetarit të bashkisë, nëpërmjet pagesave fiktive të cilat më pas kthehen mbrapsht.** Por shpresa e Inës është që mos i mbahet edhe pagesa e dytë, **për të cilën Adela i ka thënë Ajolës se i duhet për të paguar (Ina) tatimin e dypunësimit.** Në këtë rast, Ina Goxhaj thotë në faqen 1475: ***Po pra e di qe ti ja ke thene Ajoles sepse me ke vene ne dieni dhe ath me sa mbaj mend une ajo kohe me pare kete gje Ajoles sepse me ke vene ne dieni dhe ath me sa mbaj mend une ajo ka thene ok mos gaboj*** ..Ina vijon duke ju referuar Xhoi Skënderasit: ***DHE PER PROJEKTIN QE DO FITONTE KETE HERE THA XHOI QE NUK DO MARESH ASNJI PAGESE, SIC I KISHTE THENE AJOLA. Por per kete te festivalit nuk me tha gje***

*Xhoi.* Adela i përgjigjet: ***Per kete te festivalit nuk ka qene e sqaruar Xhoi si do veprohej.*** Faqe 1477. Ina e mbyll duke thënë: ***Po mire fundja <u>po ti kerkojne ia jap</u> kur te me hidhet rruga e Majit. <u>Po i kerkuan.</u>*** Faqe 1478. Në faqen 1483 Ina pyet Adelën *nëse ka ardhur të "BYL-A" shuma e dytë e projektit.* Adela i përgjigjet që *ka ardhur që në mars pjesa e dytë.* **Duket që Ina Goxhaj nuk ka asnjë njoftim që lekët kanë kaluar në llogarinë e OJF që formalisht drejton.** Pasi njoftohet se pagesa ka kaluar te Banka Credins, Ina Goxhaj i thotë në faqen 1487: ***Sh mire thanks. <u>PASTAJ DO I JAP PO TI KËRKOJNË. QE MOS TE VE DHE TY NË POZITË.</u>***

**121.45.** Në faqen 1490 Ina Goxhaj përsëri përmend shtetasen Klotilda Busha, të cilën e kishte takuar ***por nuk i kishte thënë asnjë në lidhje me organizatën "BYL-A" përsa i përket projektit me Ambasadën Amerikane.*** Për disa pagesa qe duhet të bëhen për Adelën dhe për të cilat kjo e fundit i kërkon si do bëhet të bisedohet me Ildën, Ina Goxhaj i thotë: *I bie qe Ilden ta bej me dije mbas zgjedhjeve* ***por kam hallin se mos thote mi jep mua ato qe kane mbetur. Eshte thike me dy presa.*** *Faqe 1494.* Ina shton: ***Por nderkohe dhe duhet ta dije qe kane kaluar se thote pse sme vure ne dijeni. Faqe 1495.*** Adela vijon duke thënë: ***Degjo*** *se une do flas edhe me Ajolen pas dates ne qershor.* Faqe 1496. ***Nderkohe Ildes mund tia thuash vete, edhe te lutem thuaji qe kam per te marre edhe une pagesen prandaj ta shkruajta vleren.*** Faqe 1497.

**121.46.** Në faqen 1517 evidentohet Ina që tregon për një bisedë të bërë me shtetasen Klotilda Bushka për OJF "BYL-A". Kjo e fundit duket se i ka thënë: ***Skemi vendosur gjë (për BYL-A). faqe 1519.*** Këtë gjë, Inës ja kishtë thënë dhe Xhoi. Faqe 1519. Sipas Adelës siç ka shprehur në faqen 1521, *Ilda i ka harruar fare ato (mendohet se bëhet fjalë për lekët që kanë ardhur për "BYL-A" nga projekti me Ambasadën Amerikane).*

**121.47.** Në lidhje me lekët e mbetura te llogaria e SHIZI, **Adela është çuditur si kanë kaluar lekët pa bërë gjë organizata.** Ina Goxhaj përgjigjet se **nuk e ka idenë, por si aktivitete janë deklaruar por nuk kupton sesi kanë bërë për faturat e shpenzimeve.** Faqe 1538. Në faqen 1543 Ina Goxhaj thotë *se e ka ndërruar passëordin e BYL-A pasi po e kërkonin në lidhje me dy projekte.* Adela e pyet *se kush po e kërkonte*, dhe Ina i përgjigjet: ***Keti dhe Rea.*** Pas kësaj, Ina Goxhaj i bën me dije Adelës një mesazh që ka marrë: ***<u>Me ka lajmeruar Ajola</u> qe per nje projekt propozim qe po bejme nga Byla (jo i njejti si Ketrin) na duhet dhe vendimi i gjykates nga ana juaj qe je e padenuar.*** *Faqe 1544. Brenda mundesive nese e ben dot aplikimin sot se ajo do 2-3 dite te dale dhe e kam me pak urgjence prej deadline. Faqe 1544.* **Pra, rezulton e qartë se aplikimet që bëhen nga "BYL-A" pranë institucioneve publike të cilat japin fonde, urdhërohen nga Ajola Xoxa.**

**121.48.** Në faqen 1556 konstatohet që Ina Goxhaj njofton Adelën *se ka dhënë dorëheqjen nga "BYL-A".* Ajo shprehet: ***Më në fund do shpëtoj.*** Faqe 1557. Adela nga ana e saj i thotë në faqen 1557: ***Me mire qe e hoqe se po ngarkohet pak gjendja.*** Në lidhje me një pagesë që Ina do t'ja kalojë Adelës dorazi, kjo e fundit i përgjigjet: ***Jo ska gje se une do flas me Ajolen tani se ca do bejne se ka vajtur cik si shume puna. Faqe 1561.*** Në faqen 1584 Ina Goxhaj i thotë me shaka Adelës nëse si ish drejtoreshë ekzekutive e "BYL-A" i takon ndonjë biletë për shfaqjen Ëorkshop nga Ballet Preljocaj, që mbahet në TOB më datë 26.09.2023. **Duke i thënë që i ka përmendur dhe Erion Veliaj, duke e thirrur këtë të fundit si "Lali Eri", Ina Goxhaj i nis Adelës një faqe instagrami të këtij të fundit, duke i thënë të qeshë pak. <u>Në fakt, nga faqja e instagramit të shtetasit Erion Veliaj duket që ky i fundit</u>**

**reklamon shfaqjen e mësipërme, duke shtuar se ajo mbështetet nga OJF: Harabel Contemporary, D18 Paris, BYL-A, të cilat menaxhohen në fakt nga bashkëshortja e tij, shtetësja Ajola Xoxa**. Madje edhe kur diskutohet mes shtetaseve Adela Kondakçiu dhe Ina Goxhaj në lidhje me një konflikt të lindur mes "Harabel" dhe TKOB për shitjen e biletave, kjo e fundit shprehet ***"e rregullon lali Eri"***.

**122.** Faturimet fiktive rezultojnë të qarta edhe nga komunikimet e zhvilluara mes shtetases **Adela Kondakçiu dhe Ergys Krisiko**. Ky i fundit rezulton të jetë profesionist i lirë në fushën e artit, me profil skulptor. **Nga deklarimet e dhëna para hetuesve të BKH-së, rezulton të jetë në marrëdhenie miqësore me shtetases Ajola Xoxa.** Ajo çfarë vihet re jo vetëm tek komunikimet mes këtyre shtetasve por edhe në të tjerat ku Adela Kondakçiu është e përfshirë, **është fakti që shtetasi Ergys Krisiko faturohet thuajse në të gjitha aktivitetet e zhvilluara nga OJF-të e menaxhuara nga Ajola Xoxa.** Që në krye të herës, faqja 2 e komunikimeve, financierja Adela Kondakçiu i prezantohet Ergys Krisikos siç bën edhe me të tjerët, **pra si ekonomistja e Ajola Xoxa.** Me interes në faqen 2 të komunikimeve është fakti *që Adelës i duhen 2 fatura*, jo **Ergysit, i cili duhet të jetë i interesuar të paguhet për punën** e bërë. Konkretisht, Adela i thotë Ergysit: ***NE NA DUHET TE NA PRISNI 2 FATURA ME DATEN E SOTME.*** Ergysi, siç edhe bën gjatë gjithë kohës së komunikimeve, i përgjigjet menjëherë: ***PO, PATJETËR.*** Faqe 3. Adela i thotë: ***Po ju dërgoj të dhënat.*** **Në faqen 4 evidentohet fiktiviteti i faturës që pritet të lëshohet. Kjo, sepse nuk është Ergys Krisiko i cili bën përshkrimin e faturës, siç duhet të jetë, por Adela Kondakçiu. Kjo e fundit nuk mjaftohet me kaq, por përcakton dhe vlerën.** Adela: ***Fatura e pare: Pershkrimi: Prodhim muri Vlera: 236.000 leke Fatura e dyte: Pershkrimi: Prodhim shiriti metalik me ndricim led Vlera: 133.000 leke. Faqe 4.*** këtë rast faturimi bëhet nga "BYL-A". Adela i dërgon të dhënat e kësaj OJF-je: ***Nipt: K41828009E Emri: Byl-A. Më pas i përcakton dhe datën kur duhet lëshuar fatura. Faqe 4-5.*** Ergys Krisiko në orën 12:33 datë 03.11.2022 i thotë: *Ok. Patjetër*. Faqe 5. Në orën 4:09 datë 03.11.2022 i dërgon faturën e kërkuar nga Adela Kondakçiu, sipas së cilës "BYL-A" paguan Ergys Krisikon *për Prodhim Muri, shumën prej 236.000 lekë*.

**122.1. I pyetur në lidhje me OJF "BYL-A", në cilësinë e personit që ka dijeni për veprën penale, shtetasi Ergys Krisiko shprehet se nuk ka dijeni për këtë organizatë.**

**122.2.** Në të njëjtën datë, shtetasi Ergys Krisiko i dërgon një tjetër faturë Adela Kondakçiut, këtë radhë për *Prodhim shiriti metalik me ndricim LED, për vlerën 133.000 lekë*. Përsëri fatura lëshohet për "BYL-A". Faqe 6. Në faqen 7 të komunikimeve, Adela Kondakçiu i prezantohet përsëri Ergys Krisikos, por këtë radhë jo ekonomistja e Ajola Xoxës por e Qendrës "Harabel". Me interes në komunikimet e faqes që vijon, 8, është se Adela Kondakçiu i thotë Ergysit se *ka për të bërë një pagesë për të në vlerën 2900 euro, sipas konfirmimit të Ajolës, dhe jo e kundërta*. **Pra, nuk është Ergys Krisiko që mer iniciativën për të kërkuar pagesën.** Adela Kondakçiu shton në lidhje me këtë: ***Po te dergoj niptin per te bere faturen dhe PERSHKRIMIN QE DUHET NE FATURE. Qendra "Harabel" Nipt: L81509451A.*** Këtë radhë përshkrimi duhet të jetë: *Production payment for the SPA:RE public art installation/Pagese per prodhimin e instalacionit artistik. Faqe 9.* Ergysi i përgjigjet si përherë: *Ok. Patjetër*. Por për shkak se nuk ka asnjë ide në lidhje me pagesën që supozohet të marrë, i drejtohet me një pyetje: ***2900€ me tvsh apo pa tvsh. Faqe 9.*** Adela Kondakçiu i kërkon ta bëjë me TVSH, pra 3480 euro në total. *Faqe 11.* Ajo çfarë është e

çuditshme sipas organit procedues është shpejtësia që kërkon Adela të paguajë Ergysin, ndërsa i thotë në faqen 12: ***Te lutem nese mund ta besh sa me shpejt qe te bejme edhe pagesen sot.*** Ergys Krisiko si përherë i thotë: ***Po. TANI DIREKT***. Faqe 12. Dhe në fakt, menjëherë më pas, vetëm 9 minuta nga komunikimi me Adelën, Ergysi lëshon një tjetër faturë, tashmë për "Harabel" për *Prodhim Instalacioni Artistik, për vlerën 3480 euro*. Adela i konfirmon në faqen 13 se *pagesën do e bëjë në të njëjtën ditë*. Në faqen 16 Adela i kërkon Ergysit t'***i kalojë një shumë prej 150.000 lekë, por këtë radhë si individ dhe jo person fizik***. Në lidhje me këtë i thotë ***që do i bëjnë një kontratë dhe do i kalojnë në llogari personale 127.500 lekë. Gjithashtu, i thotë se kontrata i duhet si individ.*** Këtë radhë faturimi nuk bëhet as për "Harabel" dhe as për "BYL-A", por për "Ava Studio" shpk, në pronësi figjore të Valbona Xoxa, nëna e shtetases Ajola Xoxa. Në faqen 18, Adela i dërgon Ergysit të dhënat e shoqërisë në fjalë: *M12212012O Ava Studio shpk.*

**122.3. Komunikimi që pason në faqen 19 provon edhe një herë mënyrën e lëshimit të faturave të cilat qartazi duken fiktive.** Adela Kondakçiu i thotë Ergys Krisikos në lidhje me faturën që duhet të lëshohet për "Ava Studio" shpk: ***PERSHKRIMI NESE MUND TA BENI: Materiale skenografike.*** Ergys Krisiko i përgjigjet: *Po*. Në lidhje me kontratën, konstatohet një fakt tjetër me interes për hetimin. Adela i thotë Ergysit: ***Kontraten do e bejne gati vajzat dhe do tju thone qe te kaloni nga java per firme***. Faqe 19. **Pra, është e qartë se deri në momentin që Ergys Krisikos i kërkohet të lëshohet një faturë për "Ava Studio" shpk, me një përshkrim të orientuar (*NESE MUND TA BENI*) nga financierja e Ajola Xoxës, nuk ka patur një kontratë të shkruar. Kjo do duhet të prodhohet më vonë dhe Ergysi duket se nuk do ketë ndonjë dijeni për detajet e saj, por veç duhet të kalojë për firmë më pas. Sigurisht që kontrata në këtë rast do duhet të bëhet më datë përpara lëshimit të faturës për "Ava Studio" shpk.** Ergys Krisiko përgjigjet: *Në rregull. Faleminderit.* **I pyetur në lidhje me "Ava Studio" shpk, Ergys Krisiko shprehet se nuk ka dijeni në lidhje me këtë shoqëri.**

**122.4.** Në vijim, në faqen 23, rezulton se Adelës i duhet të mbyllë rakordimin me Ergys Krisikon. Për këtë i thotë: ***Nderkohe ne lidhje me faturen qe duhet te leshoni qe te mbyllim rakordimin. Sipas llogarise time fatura del 55.400 leke plus tvsh. NESE ESHTE OK BEJENI EDHE FATUREN PER AVA STUDIO SIPAS TE DHENAVE DHE PERSHKRIMIT QE JU KAM NISUR ME SIPER.*** Në fakt, menjëherë më pas Ergys Krisiko lëshon një faturë për "Ava Studio" shpk, *për Materiale Skenografike, për vlerën 66.480 lekë.* **Pra, është Adela Kondakçiu që orienton Ergys Krisikon të bëjë edhe këtë faturë për "Ava Studio" shpk, sipas të dhënave dhe përshkrimi që ka nisur. Me pak fjalë, Ergys Krisiko orientohet për kë do të lëshoje fatura, megjithëse nuk ka ofruar shërbim për organizatat apo shoqëritë në fjalë, si edhe orientohet të bëjë përshkrimin që duhet në të gjitha faturat që lëshon. Edhe në lidhje me këtë rast, kontrata duket se është firmosur pas lëshimit të faturës**. Konkretisht, fatura nga Ergys Krisiko për "Ava Studio" shpk lëshohet më datë 11.10.2023. ndërsa kontrata nuk është nënshkruar të paktën deri në këtë moment. Kjo, sepse, menjëherë sapo Ergys Krisiko lëshon faturën dhe ja dërgon në format pdf Adela Kondakçiut, kjo e fundit në faqen 26 i thotë: ***NESE MUND TE KALOSH NESER QE TA FIRMOSESH KONTRATEN.*** Ergysi i përgjigjet: ***Do kaloj patjetër.*** **Megjithatë duket se nuk e ka firmosur kontratën as më datë 12.10.2023, pra, dy ditë pas lëshimit të faturës prej tij.** Kjo, nisur nga kërkesa që i bën Adela Kondakçiu në

këtë datë, ndodhur në faqen 27. Edhe më datë 13.10.2023 rezulton që Ergys Krisiko nuk e ka firmosur ende kontratën, sipas komunikimit në faqen 30. Për këtë Adela Kondakçiu i lutet, *se duhet të bëjë dorëzimet.* Faqe 30.

**122.5.** Në faqen 33, që i korrespondon datës 17.10.2023, është përsëri Adela Kondakçiu që i lutet Ergys Krisikos të bëjë një faturë tjetër. **Pra, financierja e Ajola Xoxës i lutet ofruesit të shërbimit që t'i paguajë paratë pas lëshimit të faturës.** Komunikimi në lidhje me këtë: ***TE LUTEM DO ME BESH EDHE NJE FATURE TJETER. ESHTË PËR PRODHIMIN E SKENOGRAFISË.*** Adela vijon: ***Po te coj te dhenat, POR ME DUHET FATURA SOT PATJETER.*** Faqe 33. **Praktikisht, Adela Kondakçiu i thotë Ergys Krisikos që duhet ta paguajë patjetër.** Këtë radhë Adela i rikthehet "BYL-A" dhe i dërgon të dhënat e saj si edhe përshkrimin që i duhet: ***Nipt: K41828009E Emri: Byl-A PERSHKRIMI ME DUHET: prodhim skenografie Te shenimet e fatures: PRODHIM STRUKTURE DRURI SONOMA NGA LA VERONAL DATE 5 DHE 6 TETOR. Faqe 34.*** Në lidhje me vlerën, Adela i shkruan: ***Vlera me ka konfirmuar Keti dhe eshte 294'000 leke pa tvsh.*** **Ergys Krisiko si gjithmonë thotë PO. Thotë PO për organizatën "BYL-A", edhe pse nuk ka asnjë ide në lidhje me të, thotë PO për përshkrimin e sugjeruar nga Adela, edhe pse duhet ta vendosë vetë atë përsa kohë është ai që ofron shërbimin dhe jo dikush tjetër, thotë PO për shënimet që duhet të bëjë në faturë, edhe pse duhet të jetë ai vetë që ka të qartë çfarë ka prodhuar, si edhe thotë PO për vlerën e cila i konfirmohet nga të tjerët.**

**122.5.1.** Në këtë rast Ergys Krisiko nuk tregohet aq i shpejtë si herët e tjera në lëshimin e faturës. **Në faqen 35 evidentohet se në vend të ishte i interesuar Ergysi për lëshimin e saj dhe për rrjedhojë pagesën që do të kryhet, eshtë Adela Kondakçiu e cila i kujton nëse e bëri faturën apo jo.** Ergysi i përgjigjet *JO* këtë radhë. Adela vijon t'i lutet *që duhet ta bëjë atë ditë.* **Për herë të parë Ergys Krisiko i përgjigjet: JA TË FLAS ME FINANCIERIN. Faqe 36. Nga sa më lart, vec faktit që Ergys Krisiko orientohet gjithë kohës nga financierja e Ajola Xoxës për faturat që do lëshojë, për kë do i lëshojë dhe si do i përshkruajë ato, evidentohet edhe që vetë Ergys Krisiko paska një financier të tij. Në këtë mënyrë, duket krejt e pakuptimtë që kërkesa për lëshimin e faturave nuk vjen nga financieri i tij, por anasjelltas. Po ashtu, nuk bën kuptim që përshkrimin që duhet të bëjë në fatura ja orienton financierja e Ajola Xoxës, përsa kohë ofruesi i shërbimit mund ta diskutojë këtë me financierin dhe të lëshojë një faturë sipas punës që ka kryer dhe për organizatën apo subjektet e tjera tregtare për të cilën e ka kryer.**

**122.6.** Në vijim, në faqen 37 konstatohet se Ergys Krisiko e lëshon përsëri faturën, këtë radhë duke iu rikthyer "BYL-A". Fatura lëshohet më datë 17.10.2023, me përshkrimin sic i është kërkuar nga Adela: *PRODHIM SKENOGRAFIE. Vlera 352.800 lekë.* **Edhe për këtë faturë të lëshuar më datë 17.10.2023, duket se kontrata, siç është zakoni tashmë, firmoset më pas, fakt tjetër ky që dëshmon për fiktivitetin e gjithë faturimeve të bëra nga ky shtetas.** Konkretisht, në faqen 38 Adela Kondakçiu i thotë Ergysit: *Ergys pershendetje!* ***TE LUTEM DO NA DUHET TE FIRMOSESH NJE KONTRATE PER KETE FATUREN E FUNDIT.*** Ergysi si gjithmonë përgjigjet: *Po. Patjeter.* Të paktën deri më datë 23.10.2023 rezulton se Ergys Krisiko nuk shkon tek zyrat e "Partners Laë" për nënshkrimin e kontratës. Adela i thotë në këtë datë: ***Doja te kujtoja per firmosjen e kontrates.***

**122.7. Më datë 23.11 2023, faqja 40 e komunikimeve, del akoma më e qartë e gjithë skema që përdoret për lëshimin e faturave fiktive nga shtetasi Ergys Krisiko për OJF-të e Ajola Xoxës.** Në këtë datë, Adela Kondakçiu e thotë hapur që fatura **i duhet** dhe jo që duhet prerë: <u>*NA DUHET NJE FATURE NE VLEREN 1.100.000 LEKE NE TOTAL. Faqe 40.*</u> **Pra, këtë radhë ajo çfarë përcakton lëshimin e faturën dhe arsyen për nevojën e saj, nuk është më përshkrimi apo detaje të tjera, por vlera e saj, për të cilën duket qartë se Ergys Krisiko nuk ka as më të voglën ide.** Adela Kondakçiu i thotë që **NA DUHET NJË FATURË ME VLERËN 1.100.000 LEKË**. <u>Thënë ndryshe, 1.100.000 lekë duhet të dalin si shpenzim nga llogaritë e një organizate tjetër, por këtë radhë jo nga radhët e atyre të Ajola Xoxës</u>. **Organizata quhet "Frobolous" dhe veprimet e kryera prej saj në kalimin e fondeve në favor të subjekteve dhe personave të afërt të shtetases Ajola Xoxa, siç është rasti i shtetasit Ergys Krisiko, kanë rezultuar me interes për hetimin.** Në kushtet kur Adela Kondakçiu, si financierja e Ajola Xoxës, nuk rezulton të ketë asnjë lidhje me "Frobolous", dhe për më tepër nuk ka pse të shfaqë interesim për kalimin e lekëve nga "Frobolous" tek shtetasi Ergys Krisiko, i cili nuk ka asnjë ide mbi këtë organizatë, siç edhe ka pohuar ndërsa është pyetur në cilësinë e personit që ka dijeni për veprën penale, **lind dyshimi i arsyeshëm se kalimi i kërkuar i lekëve në rastin konkret ka për qëllim përfundimtar përfitimin e tyre prej shtetases Ajola Xoxa.**

122.7.1. Konkretisht, në faqen 41 rezulton se Adela Kondakçiu i dërgon si gjithmonë Ergys Krisikos përshkrimin që duhet të bëhet për faturën, duke i thënë: ***PERSHKRIMI I FATURES <u>DUHET</u>: Skenografi.*** Akoma më me interes shfaqet komunikimi që pason në faqen 41, ndërsa Adela i thotë: ***Kjo do zbritet nga totali i pageses qe kemi per te dhene per projektin Dali.*** Ergys Krisiko i thotë ***ok.*** **Pra, nëse shërbimi i ofruar nga Ergys Krisiko për "Frobolous" është real, lekët e paguara për të nuk ka arsye të zbriten nga asnjë pagesë tjetër, siç i bën me dije Adela Kondakçiu.** Më tej, Ergys Krisiko tregon në faqen 42 se ***nuk ka asnjë ide për faturën që duhet të lëshojë dhe për kë duhet ta lëshojë.*** Ai pyet: <u>***ME CFARË TË DHËNASH.***</u> Adela i dërgon certifikatën e regjistrimit të personit të tatueshëm "Frobolous", me adresë kryesore: *Lagjja nr. 3, Sheshi Iliria, Kulla EGT, Kati 3, Durrës, pajisur me NIPT M22214702R. OJF në fjalë rezulton të jetë pajisur me NIPT më datë 14.10.2022.* Adela i thotë në faqen 43: *Këto janë të dhënat.* Ergys Krisiko nuk bën asnjë pyetje, por thotë: *Ok. Faleminderit.* Menjëherë më pas, ky shtetas lëshon faturën për "Frobolous", e cila mban datën 23.11.2023, <u>me përshkrimin që bëhet sipas kërkesës së Adelës: *SKENOGRAFI.*</u> **VLERA E VENDOSUR NË FATURË ËSHTË AJO E KËRKUAR NGA ADELA KONDAKÇIU: <u>1.100.000 LEKË.</u>**

**122.8.** Më datë 12.12.2023, pra, vetëm pak ditë pas lëshimit të faturës së parë për "Frobolous", Adela Kondakçiu i kërkon Ergys Krisikos *lëshimin e një fature tjetër.* Në faqen 46, Adela i dërgon si gjithmonë dhe përshkrimin që <u>duhet të bëjë</u>, duke i thënë: ***PERSHKRIMI <u>DO JETE</u>: Koncept Kreativ dhe vlera do jete 540.000 leke ne total bashke me tvsh-ne.*** Ergys Krisiko i përgjigjet: ***Po, patjetër.*** Menjëherë më pas lëshon faturën që i kërkohet pa bërë asnjë pyetje apo diskutim rreth saj. Fatura është lëshuar në të njëjtën datë me kërkesën e bërë, pra 12.12.2023 dhe <u>përmban përshkrimin e njëjtë me atë të kërkesës së bërë nga Adela Kondakçiu:</u> ***KONCEPT KREATIV.*** **Vlera e faturës është 540.000 lekë, përsëri sipër orientimit të Adelës.**

**123.** Komunikimet e zhvilluara mes **shtetases Adela Kondakçiu dhe Frosina Bollo** paraqesin interes për të kuptuar marrëdhënien e krijuar mes subjekteve të kontrolluara nga **Ajola Xoxa dhe OJF "Frobolous"**. Gjithashtu, nga këto komunikime rezulton edhe njëherë e qartë se subjektet e përmendura gjatë gjithë kërkesës kontrollohen faktikisht nga shtetësja Ajola Xoxa. Konkretisht, në faqen 2 të komunikimeve Adela i prezantohet Frosina Bollo si *"ekonomistja e Ajolës"*, dhe i kërkon të rakordojnë pagesat e faturave të projektit. Ndërsa Frosina i thotë që i ka mbetur vetëm një faturë e papaguar, Adela i përgjigje duke i thënë se asaj i dalin tre të tilla. Faqe 3. Pasi Frosina i kërkon cilat janë, Adela i përgjigjet: *Jane dy fatura te Ergysit dhe nje fature Ava Studio. Faqe 4.*

**123.1.** Frosina Bollo i përgjigjet se "Ava studio" ishte anulluar si faturë, dhe fatura e Ergysit ishte paguar një në fillim, por Adela i përgjigjet se fatura e "Ava Studio" nuk ishte anulluar dhe vijon: *Per dy faturat me vlere 540.000 leke <u>do rakordohemi edhe nje here me Ajolen qe eshte fatura e Ergysit edhe Ava Studio</u>.* ***Faqe 4-5.*** Në faqen 6 të komunikimeve, **Frosina Bollo i dërgon Adelës një tabelë *excel* në të cilën përmbahen disa të dhëna. Konkretisht, bëhet fjalë për një Situacion për Bashkinë Tiranë, për projektin "Tirana Fashion Night", i cili është aprovuar nga Bashkia. Në tabelë ndodhen disa zëra, të cilat në total kapin vlerën e <u>2,068,500 lekë</u>.** Pasi ia dërgon, Frosina i thotë: *Këtë kam unë. Faqe 6.* Adela Kondakçiu i thotë që fatura prej <u>1.100.000 lekë</u> duhej të ishte paguar dhe Frosina ja kthen që vetëm atë ka papaguar. Faqe 6-7. Madje, ajo i thotë: *Ajo eshte paguar ne fillim nga llogaria ime ta derg. Faqe 7.* Adela Kondakçiu i përgjigjet: *Po e kam ate pagesen, <u>edhe ia kemi referuar Ajoles edhe po presim prej saj te na konfirmoje nese eshte e njejta</u>. Faqe 8*. **Pra, për një faturë që rezulton të jetë lëshuar nga shtetasi Ergys Krisiko për "Frobolous" (shih dhe komunikimet me Ergys Krisikon), Adela Kondakçiu i thotë pronares së "Frobolous" se ja kanë referuar Ajolës dhe presin konfirmimin e kësaj të fundit. Edhe në këtë rast rezulton e qartë se është shtetësja Ajola Xoxa që kontrollon personin fizik Ergys Krisiko, për faturimet që ai duhet të bëjë kur bëhet fjalë për OJF-të që marrin fonde publike nga Bashkia Tiranë, siç është rasti konkret. Në fakt, personi i fundit që pyetet për lëshimin e kësaj fature është Ergys Krisiko, të cilit siç rezulton dhe nga komunikimet ku ai është palë, vetëm në fund i kërkohet të lëshojë faturën për shumën prej 1.100.000 lekë. Nga ana tjetër, vetë ky shtetas i pyetur si person që ka dijeni për veprën penale është shprehur se nuk ka dijeni rreth OJF-së "Frobolous".**

**123.2.** Në faqen 8 të komunikimeve, **Frosina Bollo i dërgon Adela Kondakçiut një faturë të lëshuar nga "Nan Gallery" shpk për "Frobolous" ltd, për <u>vlerën 4,437 euro ose 461,936 lekë</u>.** Fatura lëshohet nga "Nan Gallery" shpk për "*ideim skenografie*" dhe mban datën 14.11.2023. Frosina Bollo, pasi dërgon faturën më sipër, shton: *Kjo është. <u>Fiks me ate vlere qe korespondon me ergysin.</u> Faqe 8-9.* **Këtu është e qartë se vlera është e rëndësishme për t'u arkëtuar, dhe jo nga cila shoqëri do arkëtohet. Pra, pavarësisht kush e ofron në të vërtetë shërbimin, duhet që vlera të faturohet dhe ajo të përkojë me një nga zërat. Në këtë rast, kjo vlerë korrespondon me "Ergysin", por lëshohet si faturim nga "Nan Gallery" shpk.** Adela Kondakçiu i përgjigjet: *<u>Te lutem pagesen e fatures se Ergysit me vlere 1.1 milion nese mund ta mbyllni.</u>* ***Faturat me vlere 540.000 leke jane 2 per koncept kreativ <u>nje nga Ava edhe nje nga Ergysi</u>.*** *Faqe 9.* **Sipas organit procedues, ajo çfarë nuk kuptohet në pamje të parë, është pse Adela Kondakçiu, ekonomistja e Ajola Xoxës, interesohet vazhdimisht për pagesën e faturës së lëshuar nga shtetasi Ergys**

**Krisiko, i cili supozohet të jetë një subjekt tregtar tërësisht i pavarur dhe si i tillë është i pari i interesuar për të marrë pagesën për punën e bërë. Por, kjo është lehtësisht e shpjegueshme nëse shihet në kontekstin e gjithë bisedave të zhvilluara, të cilat të krijojnë bindjen e plotë se, përveç ojf-ve, shpk-ve dhe personave fizikë të tjerë, edhe ky subjekt tregtar (person fizik) është në kontrollin e plotë të Ajola Xoxës, kur bëhet fjalë "për ofrimin e shërbimeve" tek OJF të caktuara, të cilat kanë përfituar fonde publike prej Bashkisë Tiranë.**

**123.3.** Në faqen 10 Adela i lutet Frosinës: *Te lutem paguaj kete* ***edhe per dy faturat e tjera do flas edhe nje here me Ajolen.*** Çfarë vjen më pas dëshmon për mënyrën e funksionimit të marrëdhënies së vendosur mes Frosina Bollos dhe Ajola Xoxës, në rastin e marrjes së fondeve publike nga bashkia Tiranë. Pasi Adela i kërkon të paguajë dhe atë faturë, pasi për dy të tjerat do flasi me Ajolën, Frosina i përgjigjet: ***Ok dhe kete do e paguaj me pi se mka shkuar pertej buxhetit qe eshte aprovuar nga bashkia. Jam 15 milion minus. Faqe 11.*** **Pra, është e qartë se lekët duhen paguar patjetër, pasi kështu i kërkohet nga financierja e shtetases Ajola Xoxa. Frosina Bollo i përgjigjet se nuk do jepte më lekë se ishte kapërceyer buxheti. Në rast se shërbimet do ishin ofruar në të vërtetë, kuptohet që ky diskutim nuk do të ndiqte këtë rrjedhë, siç ka ndodhur me bashkëbisedueset. Thënë më thjesht, Frosina Bollo i thotë Adela Kondakçiut që po jap më tepër lekë sesa po marr nga Bashkia. Adela i përgjigjet se do flasi me Ajolën për dy faturat e tjera, duke nënkuptuar që edhe mund të hiqen nga pagesat.** Adela Kondakçiu i përgjigjet: *Kjo ka qene pjese e buxhetit te bashkise ne fakt. Faqe 11.* **Pra, Adela Kondakçiu nuk i thotë që lekët duhen paguar se shërbimi është kryer, porse i tillë është konceptuar buxheti dhe në këtë formë duhen nxjerrë si shpenzime nga OJF 'Frobolous', për të kaluar tek subjektet që vendosen nga Ajola Xoxa. Lejen për të mos paguar dy faturat e tjera duhet ta marrë veç nga Ajola Xoxa.**

**123.4.** Adela më poshtë, në faqen 12, i sqaron se çfarë kanë hequr për ta vendosur në faturën e "Ava Studio". Konkretisht: *Edhe kemi hequr dy pagesat e vajzave Rea Spartaku edhe Arba Topalli qe te kalonim te fatura e Ava Studio.* Frosina Bollo i përgjigjet në faqen 12: ***Ka qene por e kam parapaguar une.*** ***Para se te levrohej buxheti.*** *Plus kam paguar pallat brigade. Dhe 11.000 euro modelet.* Në faqen 14-15 Frosina Bollo vijon bisedën, duke treguar pagesat që ka bërë, mesa duket për të ndërgjegjësuar edhe bashkëbisedusen në lidhje me kërkesat e kësaj të fundit. Konkretisht, Frosina shkruan: *Eshte kjo ajo qe sheh 540,000 all. 60,000 all jan paggesat e vajzave dhe nuk me rendonin ato. Po faturat e depozituara ne bashki dhe te firmosura dhe nga ju jane keto qe kam derg dhe e fundit eshte kjo 11 mn e ergysit.* ***T gjitha tkonfirmuara me rean.*** Adela Kondakçiu i përgjigjet: ***Ok, do flas me Ajolen.*** Faqe 15.

**123.5.** Më datë 03.04.2024, faqja 20, Frosina Bollo i dërgon Adela Kondakçiut një Formular Urdhër Transferte me referencë: 009P-AB-0484, ku evidentohet se: *"Frobolous" ka paguar në favor të klientit përfitues, Ergys Krisiko, një shumë prej* 860,000 lekë. *Përshkrimi i bërë është: Likujdim fature nr. 33 datë 23.11.2023. Urdhri është firmosur nga shtetësja Frosina Bollo dhe pagesa është bërë në Credins Bank.* Në faqen 20 përsëri, datë 03.04.2024, rezulton se Frosina Bollo i dërgon Adela Kondakçiut një pagesë tjetër me klient përfitues Ergys Krisikon, për shumën 3,095 Euro, e paguar nga "Frobolous". Përshkrimi i bërë në faturë është: *Pagesë nga Frobolous 380, Faturë Tregtare-Skenografia.* Në faqen 22

përsëri Adela Kondakçiu i thotë që do e kontaktojë për pjesën e mbetur pa paguar, nëpërmjet Reas. Por Frosina i përgjigjet: ***ok, per ate qe diskutuam se nga ana ime kjo ishte pagesa e fundit qe kishte mbetur per tu bere.*** Përsëri në faqen 25, Adela Kondakçiu i kërkon të flasin në telefon për një diferencë te pagesat e faturave.

**124.** Me mjaft interes konstatohet të jenë dhe bisedat e zhvilluara mes **shtetases Adela Kondakçiu dhe Ilirjana Basha**. Kjo e fundit rezulton të jetë përfaqësuesja e shoqatës "Bash Art", organizato jofitimprurëse. Që në nisje, siç bën zakonisht, Adela Kondakçiu i prezantohet si ekonomistja e shtetases Ajola Xoxa. Faqja 2. Më datë 24.03.2023, faqja 8, konstatohet që "Bash Art" i lëshon një faturë Qendrës "Harabel" në vlerën 285,700 lekë, për ofrimin e shërbimit të: Pagesë FemFest-Instalacion vepër arti publik. **Për të kuptuar si faturohen fiktivisht nga "Bash Art", Ojf-të dhe shpk-të e kontrolluara nga shtetësja Ajola Xoxa, mjafton të ndjekësh bisedat sa poshtë vijon:**

**124.1.** Në faqet 10-11 të komunikimeve rezulton që duhen bërë disa kontrata, dokumentet e të cilave duhet të përgatiten nga Iliriana Basha. Kjo e fundit, pasi Adela Kondakçiu i thotë që do i dërgonte të dhënat për kontratat, i përgjigjet: *Po bëj gati dokumentat. Po me duhen niptet e Lindes e Eraldit Status: Dhe ekstraktet eqkb.* Adela i përgjigjet: ***<u>Do bëhen vetëm me 1 nipt</u>***. Faqe 11. **Pra, pavarësisht se sa subjekte kanë marrë shërbimin (nëse e kanë marrë atë) pagesat do bëhen vetëm me 1 NIPT.** Më tej, Ilirjana Basha e pyet: *<u>Si me nje nipt. Atehere duhet bere me nje emer. Se nga shoqata ne shoqate nuk pranon bashkia</u>. Faqe 12.* Në përgjigje, Adela i dërgon ekstraktin e nxjerrë nga QKB për "Arts Lab" shpk, në pronësi ligjore të shtetasit Erald Simixhiu (daja i Ajola Xoxës), duke i thënë *Kjo është shpk në emër të Eraldit.* Faqe 13. Ilirjana Basha i thotë: *Po kjo për Eraldin është ok.* Faqe 13. Adela Kondakçiu: ***<u>Te kjo do behen te 3-ja faturat. Edhe kontratat do behen me kete</u>**. Faqe 14.* Ilirjana Basha: ***Nuke di ça te them. Se kam hall nuk e pranon bashkia.*** *A mund te pyesesh dike ne bashki. Se mua sme ka pranuar nipt shoqate. Nga basharti te ahoqate tjeter. Faqe 14-15.* Adela Kondakçiu (faqe 16): *Po kjo nuk eshte shoqate. Eshte shpk.* Ilirjana Basha: *<u>Po eshte ok per Eraldin. Se e ka emrin</u>.* Faqe 16. **Duket qartë që shërbimet që supozohet të jenë kryer nga "Bash Art" nuk janë ofruar për "Arts Lab" shpk, përsa kohë vetë Ilirjana Basha dyshon nëse kjo është ok për Eraldin, meqë ai figuron si pronar i shoqërisë.** Adela Kondakçiu shton: *<u>Te kjo do behet dhe per Linden. Dmth te Arts Lab</u>. Faqe 17.* Ilirjana Basha vijon duke e pyetur: ***<u>Të dyja faturat ketu?</u>*** *Faqe 18.* Adela Kondakçiu i përgjigjet: *Po. Linda më ka nisur 3 fatura në fakt. Faqe 18.* Por Ilirjana Basha përsëri dyshon nëse bashkia do e pranojë këtë zgjidhje: ***<u>E dini ju qe e pranojne kete ne bashki?</u> Faqe 19.***

**124.2. Çfarë vijon më pas është prova sesi funksionojnë këto subjekte kur bëhet fjalë për përshkrimin e zërave, të cilat duken qartë se plotësohen në mënyrë fiktive.** Konkretisht, Adela Kondakçiu dërgon një mesazh me disa zëra (faqe 19): *Vocal coach 300.000 Korepetitor 300.000 Promotion 200.000.* Pasi mer këtë mesazh, Ilirjana Basha i përgjigjet (faqja 19): *<u>Jo promocion kam nipt promocion.</u>* **Është e qartë se Adela Kondakçiu kërkon të faturojë "Bash Art" nga "Arts Lab" shpk, për një shërbim që kjo e fundit as e ka kryer ndonjëherë, por që duhet për të arkëtuar një shumë prej 200.000 lekë. Kjo të bën të kuptosh që edhe shërbimet e tjera të listuara, si Vocal Coach dhe Korepetitor mund të mos jenë kryer nga ky subjekt tregtar. Në këtë rast, është vetë Ilirjana Basha e "Bash Art" që i thotë se promocionin e mbulon vetë ajo dhe nuk mund**

**të duket sikur ka pajtur dikë tjetër për ta kryer, se nuk do ishte e besueshme.** Dhe në fakt, në lidhje me këtë zë, Ilirjana Basha i kërkon ta heqë duke i thënë: ***Jo promocion kam nipt promocioni. Tjeter.*** *Faqe 19.* **Pra, Adela Kondakçiut i kërkohet të fusë një zë tjetër në faturë, pavarësisht nëse ai shërbim është ofruar ndonjëherë apo jo.** Adela Kondakçiu i përgjigjet: ***Ne bashki nuk kemi patur probleme nese 1 furnitor bente disa fatura.*** *Faqe 20.* **Më poshtë, provohet fakti që në bashki janë bërë disa projekte, të cilat kanë patur si përfitues subjektet e kontrolluara nga shtetësja Ajola Xoxa.** Në lidhje me këtë, Adela Kondakçiu i thotë Ilirjana Bashës: ***Pa merak sepse kemi bere disa projekte keto vitet e fundit. Edhe nuk na kame hapur probleme.*** *Faqe 20-21.* Pasi Ilirjana Basha bindet, në faqen 22 rezulton Adela Kondakçiu i dërgon NIPT e "Arts Lab" shpk dhe shton: *Nderkohe do me thoni se me cfare date duhen bere faturat. Nese mund te behen qe sot/neser apo i doni daten e eventit? Faqe* **23.** Ilirjana Basha i përgjigjet në faqen 24: *Jo duhet data e eventit.*

**125.** Në komunikimet e **shtetases Adela Kondakçiu me shtetasin Jusuf Beshiri** rezulton edhe njëherë e qartë se subjektet tregtare të përmendura më lart kontrollohen faktikisht nga shtetësja Ajola Xoxa. Po ashtu, rezulton e qartë përpjekja për të korresponduar faturat me zërat në projekte, duke vendosur edhe zëra fiktivë. Konkretisht, në faqen 2 të komunikimeve Adela i thotë se po i dërgon faturën e prerë nga "Ava Studio" shpk. Pasi e falenderon në faqen 3, Jusuf Beshiri i thotë: ***Ajola me tha 100.000 pasi mua do me mbahet TVSH nga Bashia automatikisht për dhe ne projekt kam shkruar 100.000 sipas asaj qe me tha Ajola kur bëra projektin.*** ***Dhe fatura duhet të korrespondoj me zërin në projekt.*** Adela Kondakçiu i përgjigjet në faqen 4: *Do flas perseri se mbase ka ndonje ngaterrese.* Në faqen 4 të komunikimeve ndodhen 2 mesazhe zanore të dërguara nga shtetasi Jusuf Beshiri në drejtim të Adela Kondakçiut. Në mesazhin e parë Jusuf Beshiri thotë: *Përshëndetje,...mua më thanë shëno një zë 100.000 për skenografinë, duke përmbledhur...* Adela i thotë se do flasë dhe do i kthejë një përgjigje. *Faqe 5.* Dhe në fakt pas këtij komunikimi fatura ndryshon. Adela i thotë: *Po e bej perseri faturen. Do ta bejme ne total 100.000 leke. Faqe 5.* Në faqen 8 rezulton se dërgohet fatura e ndryshuar tashmë, nga ku rezulton *se "Ava Studio" shpk ka ofruar shërbime "Skenografi koncerti barok" për Blerësin Jusuf Beshiri. Pra, ky i fundit duhet të paguajë për këtë shërbim shumën prej 100.000 lekë.* **Por sipas organit procedues, duket se ka një problem me lëshimin e faturës më datë 03.04.2024. Kjo datë nuk u korrespondon këtyre shtetasve me zhvillimin e eventit. Zgjidhja mesa duket në këtë rast sugjerohet nga shtetasi Jusuf Beshiri, i cili i dërgon Adelës një Formular për t'u plotësuar. Nga Formulari i dërguar kuptohet se justifikimi për faturën e lëshuar me vonesë nga "Ava Studio" do të jetë vonesa në kohë e procesit të fiskalizimit. Në këtë mënyrë, Jusuf Beshiri dhe "Ava Studio" justifikojnë moskorrespondimin në kohë të faturës me eventin e organizuar. Kjo, bën të qartë faktin se gjatë eventit ose menjëherë pas tij nuk është lëshuar ndonjë faturë me këtë zë, duke bërë të lindin dyshime për ofrimin real të shërbimit nga "Ava Studdio", dhe kur mendohet për ta bërë më në fund, në mënyrë që "Ava Studio" të arkëtonte shumën e të hollave, i vetmi justifikim që mendohet nga këta shtetas është vonesa në fiskalizim, duke e dokumentuar këtë me një procesverbal të mbajtur mes tyre.**

**125.1.** Adela Kondakçiu e përpilon procesverbalin dhe ja dërgon mbrapsht duke e pyetur nëse është ok kështu. Nga dokumenti rezulton se bëhet fjalë për projektin "Portreti i femrës në barok". Procesverbali mbahet më datë 03.04.2024 dhe ka lidhje me faturën nr. 10

të lëshuar nga Ava Studio me NIPT M12212012O, për Jusuf Beshirin me nr. Personal G61217026G, për projektin kulturor "Portreti i femrës në barok". **Sipas këtij procesverbali, Mbyllja e projektit është bër më datë 11.03.2024, por fatura është prerë më datë 03.04.2024 për shkak të vonesës në kohë të procesit të fiskalizimit. Pra, nga sa më lart del e qartë që është Ajola Xoxa personi që kontrollon "Ava Studio" dhe në asnjë rast nëna e saj Valbona Xoxa.** Për më tepër, që në faqen 16 Adela Kondakçiu shprehet: *Une e kam firmosur,* ***IA KAM LENE AJOLES PER VULEN. SAPO TA VULOSE DO TJU NJOFTOJ.*** Jusuf Beshiri përgjigjet: ***Thuaj Ajoles që dhe pagesë është kryer****. Faqe 17.* Më poshtë, ky shtetas i dërgon faturën e likujduar për "Ava Studio" shpk në vlerën 100.000 lekë, me përshkrimin: Likujdim fature nr. 10 datë 03.04.2024.

**125.2.** Më në fund, në faqen 19 nënshkruhet procesverbali që justifikon vonesën në lëshimin e faturës. Për "Ava Studio" dokumenti firmoset nga Adela Kondakçiu dhe shoqërohet me vulën e "Ava Studio". Në lidhje me këtë, në faqen 19, Jusuf Beshiri dërgon një mesazh zanor, duke i thënë se vula nuk duhet të vendoset mbi firmë, pasi kjo e fundit nuk duket mirë. *Për këtë, Jusuf Beshiri i lutet Adelës që t'i thotë Ajolës se procesverbali duhej bërë përsëri dhe ajo duhet ta vulosë (pasi vulën e mban Ajola).* Kur vjen puna për kontratën që lidhet me këtë faturë, Adela Kondakçiu përsëri përmend emrin e Ajola Xoxës: *Draftin e kontrates kush e ka qe ta printoje? Une kam levizur nga zyra, por mund tia jape Anxhela per vule Ajoles edhe te henen e firmos. Faqe 20.* Por, Jusuf Beshiri i përgjigjet se i duhet vetëm procesverbali i cili flet për vonesën e faturës. *Faqe 21.*

- ***Lidhur me dhënien e përfitimit të parregullt shtetasit Erion Veliaj nga shoqëria "Kontakt" shpk.***

**126.** Nga aktet e administruara rezulton se me vendim të prokurorit "Për marrjen e akteve", datë 09.01.2025, në fashikullin penal, nëpërmjet procesverbalit për marrjen e akteve nga një procedim tjetër, specifikisht ai i numërtuar 287/1 i vitit 2024, **janë administruar disa akte të cilat provojnë se shtetasi Fatmir Bektashi ka porositur prerjen e biletave të avionit për bashkëshortët Veliaj-Xoxa, për një udhëtim në Roterdam, Hollandë. Gjithashtu, nga të njëjtat rezulton se i njëjti shtetasi ka porositur një dhomë (Double-suitë ekzekutive) në Hotel Marriott për qëndrim të bashkëshorteve Veliaj-Xoxa.** Konkretisht, rezulton se më datë 24.11.2016 "Alb-atlas" Travel Agency, i dërgon email shtetasit Fatmir Bektashi pas porosisë së këtij të fundit, ku e njofton se totali i çmimit të biletave të udhëtimit për shtetasit Erion Veliaj dhe Ajola Xoxa është **2688 Euro.** Itinerari i udhëtimit ka qenë: Vajtja (biznes) Tiranë – Romë, Romë – Amsterdam dhe Kthimi (biznes) Amsterdam – Vienë, Vienë – Tiranë. Akomodimi i shtetasve Erion Veliaj dhe Ajola Xoxa është prenotuar pranë Hotel "Marriot" me adresë: Ëeena 686 Rotterdam (Nl), 3012 Cn Netherlands. Prenotimi është bërë për datën 03.12.2016 – 04.12.2016 (1 natë qëndrimi), në dhomën tip 1 Double – Suite Executive. Nga emaili i dërguar me datë 25.11.2016 nga "Alb-atlas" Travel Agency, në adresën elektronike të shtetasit Fatmir Bektashi, **rezulton se çmimi për 1 Double – Suite Executive është 677 Euro.**

**126.1.** Gjithashtu, me procesverbalin për këqyrjen e të dhënave nga sistemi TIMS, datë 09.01.2025, rezulton se: i) Më datë 03.12.2016, ora 05:31 në Pikën Kufitare Rinas, shtetasi **Erion Veliaj** ka dalë nga Shqipëria me linjën e udhëtimit ALITALIA - AZ 510/507

ROME; **ii)** Më datë 03.12.2016, ora 04:56 në Pikën Kufitare Rinas, shtetasi **Fatmir Bektashi** ka dalë nga Shqipëria me linjën e udhëtimit ALITALIA - AZ 510/507 ROME; **iii)** Më datë 05.12.2016, ora 01:06 në Pikën Kufitare Rinas, shtetasi **Erion Veliaj** ka hyrë në Shqipëri me linjën e udhëtimit AUSTRIAN AIRLINES - OS 849/850 VIENA: **iv)** Më datë 05.12.2016, ora 01:08 në Pikën Kufitare Rinas, shtetasi **Fatmir Bektashi** ka hyrë në Shqipëri me linjën e udhëtimit AUSTRIAN AIRLINES - OS 849/850 VIENA; **v)** Nga këqyrja nuk rezulton se shtetësja Ajola Xoxa ka udhëtuar në këto data, megjithëse biletat dhe rezervimi i hotelit është bërë dhe për këtë të fundit.

**126.2.** Gjithashtu, nga sistemi *C@tx* që administrohet nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, në rubrikën "Dokumenta" është i ngarkuar Raporti i Kontrollit i mbajtur nga Inspektorët e Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, për **subjektin "Kontakt" shpk,** më administrator shtetasin **Fatmir Bektashi.** Nga këqyrja e dokumentuar me procesverbalin përkatës, rezulton se ky subjekt tregtar ka deklaruar lejet e ndërtimit të siguruara nga Bashkia Tiranë, sipas tabelës sa vijon:

| Nr | Objektet | Nr. i lejes së ndërtimit | Afat fillimi Leje ndërtimi | Afat përfundimi Leje ndërtimi | Investitori | Ndërtuesi |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 1 | Kontakt Shpk Marga 1/ "Godinë banimi dhe shërbimi 6, 8, 9 dhe 11 kat dhe 1 kat parkim nëntokë Jordan Misja te burgu | Nr. B-6729/6, datë 09.08.2020 | 27.09.2020 | 27.09.2024 | Kontakt | Kontakt |
| 2 | Kontakt Shpk Marga 2/ "Godinë banimi dhe shërbimi 9 kat me 1 kat parkim nëntokë, në pronë të shoqërisë "KONTAKT" sh.p.k" Rruga Petrela | Nr. A-14429/6, datë 06.10.2021 | 10.11.2021 | 10.11.2025 | Kontakt | Kontakt |
| 3 | Kontakt Shpk USL/ "Godinë banimi 5, 7, 10 dhe 11 kat me 2 kat parkim nëntokë dhe godinë banimi 7, 9, 10 dhe 11 kat me 2 kat parkim nëntokë si dhe kopësht 2 rr Frosina Plaku kat me mur rrethues, | Nr. A-26619/7, datë 27.02.2020 | 09.03.2020 | 09.03.2024 | Kontakt | Kontakt |
| 4 | Kontakt Shpk Siri 2/ "Godinë banimi dhe shërbimi 6, 7 dhe 10 kat, me 1 kat parkim nëntokë" në pronë të shoqërisë "KONTAKT" sh.p.k. rruga Ramazan Bogdani | Nr. B-14994/6, datë 30.11.2021. | 20.12.2021 | 20.12.2025 | Kontakt | Kontakt |
| 5 | Kontakt Shpk Mangalem 21/ Kompleksi Mangalem 21, me struktura banimi dhe sherbimesh 3+9 kat, me 1,2 kat parkim nentoke, ne prone te familjes Kadia rruga Mihal Grameno. | Nr. A-25138/7, date 14.12.2018 | 21.12.2018 | 21.02.2029 | Kontakt | Kontakt |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 6 | Kontakt Shpk Kaimi/ "Kompleks me godina banimi 7 kat me 1 kat parkim nëntokë, në pronë të Astrit Kaimi, Silvana Shima, Jetmira Kaimi, "rruga Pasho Hysa" | Nr. B-18629/4, datë 05.10.2022 | 11.11.2022 | 11.11.2032 | Kontakt | Kontakt |

**126.3.** Nga procesverbali për këqyrje/marrjen e dokumenteve të dorëzuara nga shtetasi Fatmir Bektashi, administrator i shoqërisë "Kontakt shpk", administruar në fashikullin penal, rezulton se shoqëria "Kontakt" shpk, ka marrë nga Bashkia Tiranë një "Certifikatë Përdorimi të Pjesshëm" me nr. B-5112/4 e datës 06.05.2020, të lëshuar. Akti në fjalë është lëshuar për certifikimin e objekteve 1,2,3,4,5, fazë e parë, pjesë e strukturës së "Kompleksit Mangalem 21, me strukturë banimi dhe shërbimesh në 3+9 kat, me 1 dhe 2 kat parkim nëntokë". Kjo, në zbatim të lejes të miratuar me vendimin e kryetarit të bashkisë shtetasit Erion Veliaj, me nr. A-25138/7, datë 14.12.2018, zbardhur me leje ndërtimi me nr. A-25138/9, datë 21.12.2018, me vendimin e kryetarit të bashkisë me Tiranë me nr. A-4974/5 datë 02.05.2019, për miratimin e lejes së ndërtimit për "Punime që kryhen në ndryshimin të projektit dhe lejes së miratuar me vendimin nr. A-25138/7, datë 14.12.2018, të kryetarit të Bashkisë Tiranë", fletë 1 (një).

**126.4.** I pyetur në datë **09.01.2025**, si person që ka dijeni për veprën penale, **shtetasi Fatmir Bektashi,** ndër të tjera shpjegon se: **[...]**

> Është pronar dhe administrator i shoqërisë "Kontakt" shpk. Në lidhje me sponsorizimet e shoqërisë Kontakt për organizatën "BYL-A", deklaruesi ka shpjeguar *se nuk i mban mend ato, pavarësisht se tregon që është ai personi që merr vendimet financiare dhe me sponsorizimet merret po vetë personalisht.* I pyetur konkretisht në lidhje me sponsorizimin e festivalit të parë ICDF (International Contemporary Dance Festival), deklaruesi shprehet *se është takuar me një shtetas anglez, emrin e të cilit nuk e di dhe nuk e di çfarë përfaqson.* Përsa i përket sponsorizimit të festivalit të dytë ICDF në vitin 2023, *nuk i kujtohet ndonjë gjë konkrete.* Deklaruesi shprehet se me shtetasen Ajola Xoxa nuk njihet personalisht, si dhe me të apo familjarë të saj nuk ka patur kontakte për këto evente.
>
> Pasi është njohur dhe pyetur në lidhje me disa dokumente të kompanisë turistike Alb-atlas, *ku evidentohet se janë paguar biletat e avionit për shtetasin Erjon Veliaj dhe Ajola Xoxa si edhe rezervuar një dhomë hoteli (Suite Executive) në emër të këtyre shtetasve,* deklaruesi është përgjigjur tekstualisht **"çuditem si paskam lënë gjurmë në *lidhje me pagesat e biletave të avionit dhe të hoteleve që kam bërë për Erjon Veliaj dhe Ajola Xoxa.*"** Në lidhje me këtë, deklaruesi ka shpjeguar *se udhëtimi është bërë përpara se të bëhej projekti "Mangalem 21" dhe se të dilte leja e ndërtimit të tij. Arsyeja e udhëtimit lidhet me një takim me kompaninë arkitekturore OMA në Rotterdam, dhe* ***kompania Kontakt i kishte kërkuar Erion Veliajt që të ishte në takim me qëllim që të njihej me projektin dhe ta miratonte atë. Për këtë arsye, tregon se ka paguar edhe biletat.***

Deklaruesi shpjegon se *janë akomoduar në hotel Marriot dhe të gjitha shpenzimet janë mbuluar nga shoqëria Kontakt Shpk.* Deklaruesi shpjegon gjithashtu *se me shtetasin Erion Veliaj është takuar vetëm në darkën përmbyllëse, të organizuar me përfaqësuesit e kompanisë OMA.* Shtetasen Ajola Xoxa nuk e ka parë gjatë udhëtimit. Deklaron se nuk ka paguar udhëtimet të tjera të shtetasit Erjon Veliaj apo Ajola Xoxa, dhe ***rasti në fjalë lidhet për interesin që kishte Fatmir Bektashi për realizimin e projektit Mangalem 21.*** Deklaruesi shpjegon se për këtë projekt kanë udhëtuar edhe punonjës të Bashkisë Tiranë, për takimin në Rotterdam, shpenzime këto të paguara nga Kontakt Shpk. Në fund, deklaruesi shprehet se leja për ndërtimin e kompleksit Mangalem 21 është miratuar në vitin 2018, ndërsa në vitin 2022 nga Bashkia Tiranë është marrë leja e përdorimit. **[...]**

**126.5.** Gjatë deklarimit të dhënë nga shtetësja **Adela Kondakçiu më datë 07.01.2025,** në cilësinë e personit që ka dijeni për veprën penale, në lidhje me *sponsorizimet* e bëra nga shoqëria "Kontakt" shpk tek "Byl-A" OJF, deklaruesja shpjegon se shoqëria Kontakt ka bërë dy të tilla, por herën e parë ka paguar direkt Tim Neeman për festivalin ICDF edicioni i parë në vitin 2022. Ndërsa për edicionin e dytë, në vitin 2023 është paguar "Byl-A", ***gjithmonë me konfirmim të Ajolës.*** Më pas është folur me ekonomisten e "Kontakt" shpk për kontratën dhe faturën, shtetasen Eralda Ikonomi. Në lidhje me këtë, është vendosur ***që kontrata duhej të ishte marrëveshje bashkëpunimi dhe jo kontratë sponsorizimi.***

**126.5.1.** Gjithashtu, gjatë kominikimit me whatsapp me shtetasen Katrina lidhur me shoqërinë "Kontakt" shpk, Adela Kondakçiu vijon duke thënë se: ***edhe me Kontaktin sot më marrin për kontratën unë jam në ujër***". *Faqe 1363.* Ketrina i përgjigjet: *Na e nxin Opera me Ministrinë, po bëjnë sikur është i tyre festivali. As vende në sallë nuk po na lënë për sponsorat tanë.* ***Ajolën,*** shprehet Ketrina, *nuk e ka parë më të stresuar. Faqe 1363-1364-1365.*

**126.6. Sa më sipër, konstatohet se si prerja e biletave dhe pagesa për dhomën e hotelit përmendur më lart, ashtu edhe sponsorizimi për "BYL-A" OJF, e kontrolluar nga shtetësja Ajola Xoxa, ka ndodhur gjatë periudhës që i paraprin lëshimit të lejes së ndërtimit por edhe gjatë procesit së çertifikimit për përdorim të objektit. Gjithashtu, nga deklarimet e shtetasit Fatmir Bektashi rezulton se kompania Kontakt i kishte kërkuar Erion Veliajt që të ishte në takim me qëllim që të njihej me projektin <u>dhe ta miratonte atë.</u> Për këtë arsye, tregon se ka paguar edhe biletat si dhe hotelin. Pra, rasti në fjalë lidhet për interesin që kishte Fatmir Bektashi për realizimin e projektit Mangalem 21, i cili duhej miratuar nga kryetari i Bashkisë Tiranë z. Erion Veliaj. Ky i fundit nuk e ka deklaruar këtë fakt në ILDKPKI.**

***- Lidhur me deklarimet e marra në kuadër të hetimit paraprak.***

**127.** Konkretisht, në datë **17.12.2024** ka dhënë deklarim **shtetasi Driant Zeneli,** në cilësinë e personit që ka dijeni për veprën penale, duke shpjeguar ndër të tjera: [...]

Ky shtetas fillimisht ka shpjeguar se përpara se të paraqitej në Prokurorinë e Posaçme, një ditë para *(16.12.2014)* është takuar me shtetasen Ajola Xoxa dhe 2 avokatë. Takimi është zhvilluar në një zyrë avokatie pranë Cioccolatini. Në këtë takim,

deklaruesi shpjegon tregon se shtetësja Ajola Xoxa është munduar ta qetësojë, duke i thënë se Harabeli dhe Nan-i janë në rregull.

Gjatë deklarimit të tij, shtetasi Driant Zeneli ka treguar se emrin *Qendra "Harabel"* e ka vendosur bashkë me Ajolën. Drianti shpjegon se si drejtor ekzekutiv, nuk është marrë me organizimin e qendrës, por e ka shfrytëzuar këtë post për ta patur pjesë të shtuar të jetëshkrimit të tij. Ka shpjeguar se gjatë "punës së tij" ka ftuar artistë dhe kuratorë të artit bashkëkohor, pa patur ndonjë rol tjetër në këtë organizatë. **Deklaruesi ka shpjeguar se nuk ka qenë personi që është marrë me fondet, me dokumentat ligjorë, me gjetjet e sponsorave, me menaxhimin e pagesave për qendrën Harabel, sepse për këto gjëra vendoste shtetësja Ajola Xoxa.**

I pyetur për adresën zyrtare të Qendrës Harabel, shtetasi Driant Zeneli ka shpjeguar se nuk e dinte që aty ishte një shtëpi banimi. Këtë gjë e ka kuptuar ditën kur ai ka qenë prezent gjatë kontrollit të ushtruar nga hetuesit. Ky shtetas shpjegon se prej vitit 2020 nuk kishte qenë në atë ambient, prej kohës kur Ajola vendosi që zyrat e Qendrës Harabel të kalonin në Sky Toëer, me qëllim që gjithë zyrat të ishin bashkë duke qenë se aty ndodhej edhe Partners Laë. Në lidhje me adresën zyrtare të qendrës Harabel, deklaruesi shpjegon se paguhet një qira, pasi kështu vendosi Ajola, duke qenë se ajo vetë i menaxhonte financat. Po kështu, ai ka treguar se nuk e di kush është pronari përfitues i qendrës Harabel.

Në lidhje me pyetjen nëse ka përdorur fondet e qendrës Harabel për të mbuluar shpenzimet personale, deklaruesi është përgjigjur negativisht duke treguar se ka paguar gjithmonë nga xhepi i vet. Gjithashtu, i pyetur në lidhje me një pagesë prej 115 euro, shtetasi Driant Zeneli ka pohuar se i duhej konfirmim pasi për fondet vendoste Ajola dhe ekonomistja Adela.

Ky shtetas shpjegon se edhe kartat bankare të Nan Gallery apo qendrës Harabel, nuk i përdorte ai apo t'i mbante. Edhe në lidhje me çeqet e paplotësuara, të nënshkruara prej tij, deklaruesi shprehet se këtë ja kishte kërkuar Adela me Ajolën, duke qenë se ai nuk qëndronte në Shqipëri. Kështu që, nuk ka informacion mbi pagesat që mund të jenë kryer.

I pyetur në lidhje me marrëdhënien tregtare me shoqëritë Arts Lab dhe Ava Studio, shtetasi Driant Zeneli ka shpjeguar se Ava Studio është në pronësi të Valbona Xoxës. Kjo shoqëri, shpjegon deklaruesi, nuk i ka ofruar asnjë shërbim, por thjesht i është thënë të firmosë për ta paguar. Po kështu, sqaron se Arts Lab e ka Erald Simixhiu, daja i Ajolës. Shpjegon se Eraldin apo punonjës të Arts Lab nuk i ka parë asnjëherë duke dhënë ndonjë shërbim për qendrën Harabel. Deklaruesi shprehet se kontaktet me të mbaheshin nga Xhoi (Skënderasi).

Në lidhje me shërbimet që supozohet të jenë ofruar nga Ava Studio, deklaruesi shprehet se mban mend një episod në lidhje me një video që duhej realizuar nga Ava Studio, por që në fakt është realizuar nga shtetasi Johan Kosta. Ky i fundit ka marrë për këtë shërbim të ofruar një pagesë cash 2,000 euro, vlerë kjo e paguar nga Drianti pasi e kishte marrë nga Xhoi Skënderasi. Po kështu, ai tregon se e njeh shtetasin Olsi



SPAK.AL / SPYE.AL

Efthimi, për të cilin tregon se është shok me Ajola Xoxën, e që ka marrë pagesa pasi e ka parë në zërat e buxhetit.

Në lidhje me marrëdhënien ekonomike ndërmjet Qendrës Harabel dhe Partnes Laë, deklaruesi shprehet se kjo e fundit i ka ofruar shërbimin në lidhje me gjyqin e vitit 2018, në lidhje me logon e qendrës Harabel.

Po kështu, ka shpjeguar se vetë si individ ka marrë një fond në Bashkinë Tiranë, vlerë 500,000 lekë, aplikim në të cilin e ka ndihmuar Xhoi Skënderasi. Për këtë projekt, tregon se fotografimin e ka bërë Johan Kosta. **Më pas, duke qenë se kishte nevojë për të justifikuar shpenzimet, Xhoi i ka sugjeruar që Ava Studio të lëshonte faturë tatimore, por që në fakt në këtë rast nuk ka ofruar asnjë shërbim.**

Shtetasi Driant Zeneli është pyetur në lidhje me organizimin e mbrëmjes së kërcimit ndërkombëtar, për të cilën tregon se Ajola me Ketin janë marrë me organizimin. Deklaruesi shprehet se ai vetë ka marrë pjesë vetëm në natën finale, si i ftuar me ftesë, por nuk ka dijeni nëse hyrja ka qenë me bileta.

Po kështu, ky shtetas tregon se në dijeninë e tij Qendra Harabel përveç shërbimit të organizmit të eventeve, nuk merret me diçka tjetër. I pyetur në lidhje me kurset e artit që janë deklaruar në vlerë 7,413,197 lekë, shtetasi Driant Zeneli shprehet se nuk ka asnjë dijeni. Deklaruesi vijon duke thënë se të tilla kurse janë zhvilluar vetëm gjatë periudhës së pandemisë, dhe mendon se Qendra Harabel ka marrë rreth 12.000 Euro nga këto kurse.

I pyetur në lidhje me shtetasin Ilir Koka, deklaruesi shprehet se është shok i Ajolës dhe është piktor. Ai shprehet se nuk ka asnjë informacion që qendra Harabel të ketë blerë piktura të këtij shtetasi. Në lidhje me shtetasin Sokol Kryeziu, deklaruesi shprehet se nuk e njeh.

**Shtetasi Driant Zeneli ka shpjeguar se si individ apo nëpërmjet qendrës Harabel, nuk ka përfituar apo t'i jenë dhuruar vlera monetare në formë mirënjohje nga shtetas të ndryshëm.** Pasi është është pyetur konkretisht për shtetasen Greta Domi, të cilën tregon se e njeh, deklaruesi shprehet se nuk ka dijeni që kjo e fundit të ketë bërë dhuratë vlera monetare tek Qendra "Harabel". Të njëjtën gjë, deklaruesi pohon edhe për shtetasen Ines Dani. Në vijim, i pyetur nëse qendra Harabel ka ofruar ndonjëherë shërbim kundrejt Ines Dani apo Greta Domi, shtetasi Driant Zeneli ka shpjeguar se nuk ka asnjë ide se çfarë shërbimi mund t'i ketë ofruar Harabeli si organizatë që merren me art, kundrejt dy avokatëve.

**Në lidhje me "Nan" shpk, deklaruesi ka shpjeguar se për një kohë të shkurtër ka qenë pronar i vetëm i kësaj shoqërie. Idea e krijimit të "Nan" shpk, sipas sa shpjegon vetë deklaruesi, ka qenë e shtetases Ajola Xoxa dhe vetë ajo e ka vendosur atë (*Driantin*) si ortak.** Shtetësja Ajola Xoxa i ka thënë se për të marrë pjesë në panaire arti, duhej të krijohej një shoqëri e re dhe emrin e vendosi vetë Ajola duke e quajtur "Nan Gallery" Shpk. Deklaruesi shprehet se Ajola e ka pyetur ç'mendim kishte për emrin, dhe ai i ka thënë se i pëlqen. **Në lidhje me transferimin e kuotave të "Nan" shpk tek qendra Harabel, deklaruesi shprehet se ka qenë**



SPYET.AL

**vendim i Ajolës, e cila caktoi Daniela Vuksanin si administratore të kësaj shpk-je.**

Gjatë deklarimit të tij, shtetasi Driant Zeneli ka dhënë shpjegime edhe në lidhje me vilën e cila është në përdorim nga Nan Gallery Shpk. Pët këtë, deklaruesi tregon se ka marrë dijeni nga Ajola se këtë Vilë do ta merrnin si huamarrje nga Vienna Insurance Group, nga një shtetas i quajtur Genti, të cilin e ka parë disa herë në ambientet e Sky Toëer dhe takohej me Ajolën në zyrën e saj.

Shtetasi Drian Zeneli shprehet se ai asnjëherë nuk ka patur lidhje me Qendrën Harabel apo Nan Gallery Shpk. Gjithmonë, shpjegon deklaruesi, i është thënë nga Ajola dhe Adela për financimet që vinin tek kjo qendër. Ai shprehet se për çdo projekt apo aplikim, Adela me Ajolën i kërkonin të firmoste. Deklaruesi shprehet se i ka pyetur nëse çdo gjë ishte në rregull, dhe ato i thonin "po", madje se gjërat verifikoheshin. Kjo ka ndodhur edhe kur kanë aplikuar për fonde jashtë Shqipërisë.

Po kështu, i pyetur nëse ka dijeni për pasuri të shtetases Ajola Xoxa në zonën e Qerretit, shtetasi Driant Zeneli ka deklaruar se në vitin 2018 ai së bashku me shoferin e Ajolës kanë shkuar në zonën e Qerretit për të dërguar një mobilje/objekt për Ajolën, por vetë nuk është futur në banesë dhe nuk mund ta përshkruajë. Po kështu, tregon se Ajola e ka ftuar disa herë që të shkonte me djalin e tij për pushime në Qerret, por nuk ka shkuar. **[...]**

**127.1.** Sa më sipër, nga deklarimet e këtij shtetasi rezultojnë fakte me interes për hetimin, të cilat shkurtimisht konsistojnë në: **i)** Padijeninë totale të shtetasit Driant Zeneli në lidhje me menaxhimin financiar dhe aspekte të tjera organizative të organizatës "Harabel", në të cilën është Drejtor Ekzekutiv. Siç edhe provohet nga komunikimet me shtetasen Adela Kondakçiu, por edhe nga këto deklarime, është shtetësja Ajola Xoxa ajo që merr të gjitha vendimet për "Harabel" dhe "Nan" shpk. Në asnjë rast nuk rezulton që shtetasi Driant Zeneli të jetë pyetur apo të ketë marrë vendime në lidhje me aspektin financiar dhe organizativ të organizatës; **ii)** Gjithashtu, nga deklarimet rezultuan të dhëna me interes për hetimin në lidhje me pasurinë e paluajtshme të llojit vilë, ndodhur në Qerret Kavajë, për të cilën shtetasi Driant Zeneli u shpreh se kishte dijeni që i përket shtetases Ajola Xoxa.

**128.** E pyetur në datë **12.12.2024** si person që ka dijeni për veprën penale, **shtetësja Adela Kondakçiu**, me profesion ekonomiste, ka shpjeguar shumë detaje që paraqesin mjaft interes për hetimin. Kjo shtetase ndër të tjera ka deklaruar se: **[...]**

Për paraqitjen e saj në Prokurorinë e Posaçme, ndër të tjerë ka patur dijeni Ajola Xoxa dhe avokati i saj. Përpara ardhjes së saj në prokurori, ka zhvilluar tre takime, të martën një herë, të mërkurën dy herë, ku prezent kanë qenë Ajola Xoxa dhe avokatët e saj. Këto takime janë zhvilluar në një zyrë pranë Cioccolatini.

Gjatë deklarimit të saj, Adela shpjegon se Ajola dhe avokatët i kanë sugjeruar që të ishte konçize në përgjigje, të thoshte *"s'mbaj mend"* si dhe të merrte kohë për përgjigje. Në takimet e zhvilluara me Ajolën dhe avokatët, tregon se ata e kanë pyetur se çfarë kishte ndodhur gjatë kontrollit si dhe janë interesuar në lidhje me përmbajtjen e telefonit. Adela shpjegon se edhe herën e parë kur i është sekuestruar telefoni, Ajola

e ka marrë në pyetje në lidhje me komunikimet që kishte Adela në telefon, ku kjo e fundit mban mend t'i ketë printuar disa screenshot-e Ajolës, mbi mesazhet e zhvilluara ndërmjet tyre. Ajola e ka pyetur *se pse i ke ruajtur me screenshot bisedat*, si dhe *i ka propozuar që të rikuperonte bisedat dhe foto me qëllim që Ajola t'i lexonte*, por Adela tregon se nuk ka pranuar. Gjithashtu, tregon se në takimin e ditës së mërkurë *(11.12) rreth orës 19:00*, ku prezent ka qenë avokati, Ajola dhe një djalë tjetër me emrin Alban, *i kanë kërkuar të qëndronte e qetë, të merrte kohë për tu përgjigjur, si dhe i kanë thënë që të mbante shënim për çfarë do e pyesnin, e pas deklarimit t'i njoftonte e të shkonte të takohej me ta.*

Deklaruesja më tej shpjegon se me Ajola Xoxën njihet prej vitit 2014, në një kohë kur punonte për një agjensi reklamash të quajtur "*Pikcreative*", e që kishte si pronarë shtetasit Briken Rrozhani, Alban Fejzaj, Ardit Koleci dhe Glon Bakalli. Ka shpjeguar se disa prej këtyre shtetasve kanë themeluar dhe një studio ligjore me emrin The Partners Shpk. Mban mend se pronarë kanë qenë Alban Fejzaj, Briken Rrozhani dhe një avokat që quhej Ilir, Ajola Xoxa dhe Amantia Peza, por që këta dy të fundit nuk figuronin nëpër dokumenta. Zyrtarisht në dokumentacione shfaqeshin 2 ortakë, por shpenzimet ndaheshin ndërmjet Albanit, Ajolës, Brikenit dhe Amantias. Shpjegon se mes pronarëve të The Partners Shpk ka patur një mosmarrëveshje, duke sjellë që Ajola të largohej dhe u zhvendos në katin e 12, Pallati Sky Toëer. Mosmarrëveshja e ndodhur përkon me momentin kur Ajola i kërkon Adelës që të mbajë bilancet e Personit Fizik të saj.

Në maj të vitit 2018, Adela shpjegon se nisi të punonte për Ajola Xoxën, pas takimit që ka patur me të në zyrat e Sky Toëer, ku detyra e saj ishte që të mbante katër biznese, *Ajola Xoxa PF, qendra Harabel, Benussi, dhe Eris Consulting*, shoqëri të cilat menaxhoheshin dhe organizoheshin nga Ajola Xoxa. Deklaruesja shpjegon se pasi ka filluar të punojë për të, ka kuptuar që aty ndodheshin dhe kompani të tjera që duheshin mbajtur nga ana e saj si ekonomiste. Kompanitë ishin *Klotilda Ferhati PF, Altin Bushka PF, Fatmir Ferhati PF, SHIZ, BYL-A*,.., por shpjegon se nuk ishin të gjitha aktive.

Kjo shtetase ka sqaruar se niptet e *BYL-A, SHIZ dhe Altin Bushka PF*, menaxhoheshin nga *Klotilda Ferhati*, të paktën nga periudha prill-maj 2018. Në lidhje me organizatën BYL-A, deklaruesja shprehet se ka qenë pasive, por pasi mori një projekt nga Ambasada Amerikane, u aktivizua si organiztë dhe Klotilda e ka njoftuar që fondet duhet të fliste me shtetasen Ina Goxhaj. Në korrik të vitit 2022, pasi u mbyll projekti i Ambasadës Amerikane, deklaruesja shprehet se të gjitha veprimet e saj (*Adelës*) dhe të Inës në lidhje me menaxhimin e BYL-ës dhe projektit 18,000 dollarë, do të raportoheshin te Klotilda. Raportimet te Klotilda Ferhati, tregon se kanë ndodhur të paktën deri në korrik të vitit 2022.

Në vijim, deklaruesja shpjegon se pas korrikut të vitit 2022, BYL-A mori një fond nga Kongresi Rinor Kombëtar, për organizimin e Festivalit Mbarëkombëtar, projekt në të cilin është angazhuar Ketrin Braho që në atë kohë punonte te qendra Harabel, ***por projekti i BYL-A është menaxhuar i gjithi nga Ajola Xoxa, e cila vendoste se çfarë***

***do të bëhej me fondet, kush do të paguhej, si do të paguhej.*** Deklaruesja ka shpjeguar se ***në lidhje me projektet e BYL-A, pagesat për ekspertët apo punonjësit e angazhuar, si dhe kontratat që lidheshin, shpesh bëheshin fiktivisht.*** Shpjegon se qendra BYL-A, ka si adresë zyrtare një apartament të Klodilda Bushkës, por që në fakt zyrat i ka te Sky Toëer, kati 10-të. Tregon se nuk ka dijeni nëse paguhet qira për këtë ambjent.

Në lidhje me shoqërinë Ava Studio, shtetasja Adela Kondakçiu, sqaron se krijimi i kësaj shoqërie ka lindur për të faturuar "shërbime" në lidhje me projektet artistike privatisht dhe me kurset e pianos që bënte nëna e Ajolës. Shtetësja Adela Kondakçiu shpjegon *se menaxhimi i shoqërisë, rakordime, apo orientimet i jepte dhe vendoste gjithmonë Ajola Xoxa*. Klientët e shoqërisë nuk i mban mend, por ka qenë në dijeni se *një pjesë e faturimeve bëhej për OJF-të që ishin në menaxhim të Ajolës, duke përmendur këtu Qendrën Harabel*.
E pyetur në lidhje me dy klientë të shoqërisë Ava Studio, më konkretisht Qendra Muza dhe Frobolous, deklaruesja ka shpjeguar se *faturat e lëshuara për qendrën Muza janë anulluar për shkak se Ajola kërkoi që të njëjtat fatura të lëshoheshin te kompania ArtsLab*. Në lidhje me sfilatën e Frobolous, Ajola dhe Reada Lemnusha janë marrë me eventin. Për një pjesë të skenografisë, duhej të paguhej edhe AVA Studio, për të cilën Ajola ka thënë të lëshohet fatura tatimore kundrejt Frobolous, por vetë ajo nuk e di shërbimin e ofruar. **Deklaruesja shprehet** *se se fondet e këtij* ***projekti vinin nga <u>Bashkia Tiranë</u>, dhe Ajola ka përcaktuar se si do të shpërndahej fondi, cilat kompani do të faturonin bashkë me vlerën e tyre.***

Në lidhje klientët kryesorë të shoqërisë Ava Studio Shpk, **deklaruesja ka shpjeguar se faturat e lëshuara kundrejt ASLV Shpk, Qendra Harabel, BYL-A, Qendra Eventus, Frobolous, Driant Zeneli indivId,** <u>*kanë qenë të gjitha fiktive, me qëllim justifikimin e zërave për buxhetin e projekteve të tyre*</u>. **Faturat të cilat janë lëshuar në emër të Qendra Harabel,** ***janë fiktive për shkak se duheshin justifikuar zërat e buxheteve për eventet e ndryshme.*** **Në lidhje me klientët e tjerë të shoqërisë AvaStudio, shtetësja Adela Kondakçiu shpjegon** ***se nuk ka parë të jetë ofruar ndonjë shërbim,*** pra nuk ka dijeni për këtë gjë, *por vlerat e faturave tatimore të lëshuara kundrejt tyre, i janë dhënë nga Ajola Xoxa, e cila po kështu i ka thënë që të lëshonte faturën tatimore sepse kishte dhënë shërbim.* ***Karta bankare e Ava Studio Shpk, është mbajtur gjithmonë nga Ajola, e cila bënte edhe blerje online, e që më pas janë zhdoganuar me emrin e Ava Studio.***

Deklaruesja vijon në shpjegimet e saj rreth Qendrës Muza, e cila është themeluar nga familjarë të shtetases Ajola Xoxa. Në lidhje me një projekt të fituar në vlerë 16,000,000 lekë të vjetra, menaxhimi është bërë nga shtetësja Linda Kazani, bashkëshortja e dajës së Ajolës. Deklaruesja shpjegon se, duke qenë se ka mbajtur kontabilitetin, ka bërë pagesa, si psh Pagesë për Partners Laë Shpk, për shkak se Ajola i ka thënë se ka bërë dokumentacionin e themelimit dhe aplikimit në gjykatë. Gjithashtu, pagesë në vlerë 500,000 lekë është bërë te ArtsLab, *vlerë e cila është tërhequr cash, duke i thënë se ka shërbyer për pagesa me lekë në dorë*. Fatura janë

bërë edhe me kompaninë Ava Studio, por që janë anulluar. **Adela Kondakçiu shprehet se, sipas gjykimit të saj,** ***shtetësja Ajola Xoxa nuk donte që këto fatura fatimore të evidentoheshin në rakordimet me Bashkinë Tiranë.***

**Deklaruesja ka shpjeguar se njeh përfaqësues të kompanisë Palushi Shpk, i cili ka sponsorizuar me nga 25,000 Euro** ***(dy herë në total)*** qendrën **BYL-A dhe qendrën MUZA.** Njëra vlerë është për sponsorizimin për festivalin e Dancit, ndërsa vlera tjetër 25,000 euro do të ishte për eventet e qendrës Eventus. **Deklaruesja ka** ***shpjeguar se Ajola i ka treguar se si duhen prerë faturat tatimore, vlerën, dhe nga cila organizatë.***

Deklaruesja vijon duke shpjeguar se është njoftuar nga avokatët Zeko (Fjoralba) dhe Xhoi Skënderasi që do të hapej një kompani e re me emrin **ArtsLab Shpk.** Ka shpjeguar *se orientimet për këtë shoqëri i merrte nga Linda Kazani dhe Ajola Xoxa.* **Deklaruesja shpjegon se** ***kjo shoqëri realisht nuk ofron asnjë shërbim, pavarësisht se lëshon fatura tatimore shitje, të cilat kryesisht janë fiktive. Vlerat e faturave i jepte dhe i konfirmonte Ajola Xoxa.*** Në lidhje me faturimin e Partners Lab shpk në vlerë 800,000 lekë, *Adela shpjegon se vlera është dhënë nga Ajola, vlerë e cila lidhet me hapjen e shoqërisë ArtsLab.*

Deklaruesja shpjegon se BYL-A dhe ArtsLab kanë lëshuar fatura tatimore për kompaninë JEDAS ose Doma Co Shpk. **Fillimisht Albana Koçollari** ***(të cilës i mban kontabilitetin e firmës ANK) i ka thënë që kjo kompani dëshiron të sponsorizojë*** ***kompanitë e Ajolës.*** **Shpjegon se** *koha kur është lëshuar fatura tatimore, përkon me kohën kur kompania Jedas kishte marrë leje ndërtimi në Bashkinë Tiranë. Me Ajolën është konfirmuar vlera e faturës, si dhe nga ku do të lëshohej fatura.* **Deklaruesja ka shpjeguar se Adela Koçollari ka marrë fonde për rindërtimin, për shkollën Sami Frashëri, projekti dhe rivlerësimi për dëmet e shkaktuara. Po kështu tregon se është përfshirë edhe në një projekt te Qyteti Studenti.**

Në lidhje me Qendrën Eventus, e cila ka marrë fonde nga Bashkia Tiranë dhe Ministria e Kulturës, deklaruesja shprehet se është e paqartë se kush kishte rol vendimmarrës në këtë Qendër, për shkak se kur pyeste Ajolën në lidhje me këtë Qendër i thoshte që të fliste me Lindën (Kazani), ndërsa kur komunikonte me Lindën, kjo e fundit i thoshte që duhet të fliste edhe me Ajolën.

Në lidhje me Qendrën Harabel, deklaruesja shprehet se kjo organizatë në të vërtetë zyrat i ka në në katin 10-të, Sky Tower, *por në lidhje me qiranë që paguan për adresën e afishuar (Rr. Brigada VIII), ka vendosur Ajola Xoxa.* Deklaruesja tregon se i ka sugjeruar Ajolës që të sistemohen adresat sipas aktivitetit real, *por ajo i ka thënë që do qëndrojë ashtu siç janë.* Shtetasja Adela Kondakçiu ka shpjeguar se Driant Zeneli nuk ka patur asnjë rol vendimmarje te qendra Harabel.

E pyetur në lidhje me çeqet bosh me nënshkrimin e Driant Zenelit të gjetura gjatë kontrollit, deklaruesja ka shpjeguar se *Ajola Xoxa i kishte thënë që t'i linte gati. Kartat bankare të Nan Gallery Shpk e ka mbajtur që në momentin e parë Ajola,*

ndërsa kartën bankare të qendrës *Harabel e mbante Adela, për shkak se i duhej për aktivitetin.*

Gjatë deklarimit të saj, Adela Kondakçiu ka shpjeguar se ka njohje me Greta Domin, e cila ndjek çështje ligjore të zyrës Partners Laë Shpk, por edhe të OJF-ve nëse do të kishin ndonjë çështje. Shpjegon se Greta Domit si person fizik, vetë Adela i mban kontabilitetin dhe i bën deklarimet. **Pasi është njohur me një faturë të lëshuar nga Greta Domi me blerës Fusha Shpk, *<u>deklaruesja shpjegon se Ajola Xoxa e ka vendosur vlerën e faturimit</u>*. Kjo shtetase shpjegon se *çdo faturë që është lëshuar nga Greta Domi tek subjektet tregtare të tjera apo OJF, është kërkuar dhe vendosur nga ana e Ajolës*. Deklaruesja shpjegon se *Greta për të gjithë shërbimet e saj kishte tarifë mujore/fee, në vlerë 120,000 lekë të reja.***

Deklaruesja shpjegon se faturat tatimore të lëshuara nga AvaStudio Shpk dhe/ose Partners Laë, për blerësit Sapienta, Rametal dhe Ventus, *<u>diskutoheshin dhe konfirmoheshin vetëm me Ajola Xoxën.</u> Çdo bisedë që e ka bërë me persona të tretë, e që bisedohet për këto shoqëri, e ka konfirmuar me Ajolën.*

Në lidhje me shoqërinë Partners Laë Shpk, deklaruesja shpjegon se kanë marrë në përdorim një sipërfaqe prej 330 m2 nga shoqëria Lani Shpk, me administrator Egla Kosta, për zhvillimin e aktivitetit të firmës. Fillimisht mes tyre ka patur një marrëveshje verbale për huapërdorje, e që më vonë është konkretizuar me marrëveshje me shkrim. **Deklaruesja ka shpjeguar *<u>se qiraja qoftë në katin e dymbëdhjetë apo në katin e dhjetë, është paguar cash, nga viti 2019 deri në vitin 2024, vlerë 24,000 euro e cila paguhej kryesisht çdo fillim viti</u>*.** Më pas, në *<u>maj-qershor 2024</u>*, janë bërë kontrata qiraje ndërmjet Lani Shpk dhe Partners Laë, si dhe ndërmjet Ava Studio dhe Lani Shpk. Kontrata pavarësisht se janë përpiluar në vitin 2024, mbajnë datën 1 janar 2023. Janë lëshuar dhe fatura tatimore por që nuk janë paguar për shkak të rakordimeve që po bëhen për pagesat cash.

Në lidhje me shtetasin Erald Ismaili, deklaruesja ka treguar se *<u>si staf kanë paguar cash zhdoganimet e Eraldit me urdhër apo me kërkesë të Ajolës</u>. <u>Lekët për pagesat e doganave i jepte gjithmonë Ajola</u>. Nga paketimi ka konstatuar se ishin marka të shtrenjta të rrobave.*

E pyetur në lidhje me pasuri të paluajtshme në emër të shtetases Ajola Xoxa, specifikisht në zonën e Qerretit, Kavajë, shtetësja Adela Kondakçiu ka shpjeguar se nga Xhoi (Skënderasi) apo persona të tjerë në zyrë ka dëgjuar që Olsi Efthimi, arkitekt, po punonte për arredimin e një vile në Qerret, dhe për këtë qëndronte në zyrë me Ajolën duke diskutuar rreth kësaj. **[...]**

**128.1.** Sa më sipër, nga deklarimet e kësaj shtetaseje rezultojnë fakte me interes për hetimin, të cilat shkurtimisht konsistojnë në: **i)** Shtetësja Ajola Xoxa ka kontaktuar personat e thirrur në organin procedues para paraqitjes së tyre, dhe i ka orientuar në lidhje me çfarë do deklarojnë para hetuesve; **ii)** Të gjitha kompanitë e përmendura në këtë kërkesë, por edhe të tjera, mbaheshin nga ana financiare nga një ekonomiste e vetme, në rastin konkret Adela Kondakçiu, financierja e shtetases Ajola Xoxa; **iii)** Në lidhje me projektin e muajit Korrik

2022, të organizuar nga "BYL-A", rezulton që kjo e fundit ka marrë fonde publike nga bashkia Tiranë dhe Kongresi Rinor Kombëtar, i financuar gjithashtu nga bashkia Tiranë. I gjithë ky projekt, që nga aplikimi për të, dhe deri në arkëtimin e të hollave, është menaxhuar nga shtetësja Ajola Xoxa; **iv)** Ava Studio shpk, shoqëri në pronësi ligjore të Valbona Xoxës, është ide e shtetases Ajola Xoxa, e cila është marrë me themelimin e saj dhe çdo aspekt të përditshmërisë, përshirë këtu lëshimin e faturave. Një pjesë e faturave të lëshuara nga Ava Studio shpk lëshohej për OJF-të e kontrolluara faktikisht nga shtetësja Ajola Xoxa. Një pjesë tjetër lëshohej për shoqëri të tjera me përgjegjësi të kufizuar, të kontrolluara faktikisht nga Ajola Xoxa, siç është Arts Lab shpk. Ava Studio shpk ka lëshuar fatura fiktive, për shërbime të pakryera ndonjëherë prej saj, për subjekte tregtare, por edhe për Harabel, BYL-A, Eventus, Frobolous dhe shtetasin Driant Zeneli. Të gjitha faturat e lëshuara nga Ava Studio shpk urdhërohen nga shtetësja Ajola Xoxa. Ka qenë shtetësja Ajola Xoxa që vendoste për faturat që Ava Studio lëshonte për Rametal shpk dhe shoqëritë e tjera që zotërohen nga shtetasi Elman Abule dhe Marisa Nito Vetë Ava Studio rezulton se nuk ofron ndonjë shërbim, për mungesë kapacitetesh njerëzore ose teknike. Karta e Ava Studio shpk mbahet nga shtetësja Ajola Xoxa, e cila ka bërë blerje online, të cilat më pas janë zhdoganuar në emër të shoqërisë në fjalë; v) Organizata Frobolous është financuar nga bashkia Tiranë dhe më pas, ka qenë shtetësja Ajola Xoxa e cila ka përcaktuar sesi këto fonde do të ndaheshin në kompanitë e menaxhuara prej saj. Në fakt fondet publike të dhëna nga Bashkia Tiranë, me firmën e titullarit të institucionit, janë kaluar më pas në subjektet e kontrolluar nga shtetësja Ajola Xoxa: vi) Çeqet e paplotësuara të gjetura gjatë kontrollit të ushtruar, të cilat janë firmosur nga shtetasi Driant Zeneli (drejtor ekzekutiv i Harabel), rezulton se janë porositur nga shtetësja Ajola Xoxa; **vii)** Ajola Xoxa vendoste edhe në lidhje me faturimet që duhet të bëheshin për Personin Fizik Greta Domi, e cila në të vërtetë ishte e punësuar pranë "Partners Laë" me një pagë mujore rreth 120.000 lekë; **viii)** Zyrat e "Partners Law" shpk nuk kane qenë ndonjëherë në realitet të dhëna në përdorim pa shpërblim, por rezulton se për to janë paguar shuma të konsiderueshme të hollash në formë cash, në vlerën 24.000 Euro në vit. Kontrata [illegible] jonoteriale e qirasë për "Partners Laë", e cila i nis efektet nga vitit 2023, në fakt rezulton se është bërë vetëm në vitin 2024, pasi është mësuar për hetimet e nisura; **ix)** Të gjitha shumat e lekëve për pagesat e doganave për artikujt e blerë online, i jepte shtetësja Ajola Xoxa dhe zhdoganimet i bënte shtetasi Erald Ismaili, me urdhër të kësaj të fundit; x) Rezulton gjithashtu se vila në zonën e Qerretit, Kavajë, njihet prej punonjësve të shtetases Ajola Xoxa, e cila duket se ka shfrytëzuar arkitektin Olsi Efthimi për arredimin e saj.

**129.** Gjithashtu, pyetur në datë **07.01.2025**, në cilësinë e personit që ka dijeni për veprën penale, në lidhje me zhdoganimet e kryera nga shtetasi Erald Ismaili, **shtetësja Adela Kondakçiu,** konfirmon se këto procedura kanë ndodhur. Për këtë, deklaruesja ndër të tjera shpjegon se: **[...]**

> Eraldi ose Xhoi i kishin dërguar Adelës kartën e identitetit të Eraldit për të bërë pagesat e doganës në emër të Erald Ismailit, **gjithmonë sipas direktivave të Ajolës**. Adela Kondakçiu shprehet se ka bërë pagesat e doganës pranë bankave të nivelit të dytë, në emër të Erald Ismailit. Por, jo vetëm Adela, por edhe Xhoi Skënderasi kanë kryer pagesa, dhe paratë për zhdoganime gjithmonë u jepeshin nga Ajola.

Në lidhje me blerjet e realizuara online te dyqanet Net-A-Porter, të deklaruara nga Ava Studio, shtetësja Adela Kondakçiu deklaron se ***blerjet i ka bërë Ajola me kartën e Ava Studio shpk***. Ajola i kishte thënë Adelës *se ato ishin rroba që i kanë përdorur këngëtarët për videoklipe.*

Pyetjes se nga cilat llogari bankare janë bërë këto blerje, shtetësja Adela Kondakçiu *nuk ka mundur t'i japë përgjigje me saktësi, por ka menduar se blerjet janë bërë nga llogaria personale e Ajolës ose nga llogaritë e familjarëve si të mamasë ose të gjyshes, ndoshta edhe të Valmirit*. Deklaruesja nuk mendon se ka patur karta krediti në emër të stafit, të vajzave, *por më shumë mendon se ka pasur ndonjë kartë në emër të gjyshes.*

Në lidhje me emailin a.marku@thepartners.al, Adela Kondakçiu përgjigjet se ky ishte një e-mail që e përdorte Ajola. Adela kujton *se Ajola kishte bërë disa blerje nga faqet online brenda vendit, ku blerjet arrinin nga 2000-3000 Euro për blerje, pra rreth 50.000 Euro blerje janë bërë në emër të Adela Marku, të cilën Adela mendon se nuk është një person real*.

E pyetur nëse janë kryer zhdoganime me këtë emër, pra Adela Marku, kjo shtetase deklaron *se nuk ka pasur zhdoganime me këtë emër për shkak se ishte një emër fiktiv sipas saj dhe në rastin e zhdoganimit kërkohet një numër identifikimi.*

Në lidhje me blerjet online dhe porositë e dorëzuara tek zyrat e Sky Tower ose të zhdoganuara në emër të shtetasit Erald Ismailit, shtetësja Adela Kondakçiu deklaron ***se asnjë tjetër në zyrë nuk bënte blerje online dhe se të gjitha zhdoganimet që janë bërë në emër të Eraldit janë blerje të Ajolës në dijeninë e Adelës***. Në vijim deklaron se nuk di të ketë patur karta të tjera të personave të tjerë. Siç ka thënë dhe më parë, ajo ka qenë e mendimit që gjithmonë pagesat bëheshin nga llogaritë e familjarëve, ndoshta të nënës, gjyshes ose babait.

Në lidhje me faturat e Ergys Krisikos të lëshuara për "Frobolous" OJF në vlerën 1,100,000 lekë, shtetësja Adela Kondakçiu shpjegon *se ato nuk kanë qenë reale për këtë event*. ***Këto fatura nuk kanë patur asnjë lidhje me këtë event, por janë dhënë parapagim për disa evente të tjera që realisht nuk u bënë.*** **Lekët, sipas deklarueses,** ***i ishin thënë nga Ajola që do të ktheheshin mbrapsht***. Shumë pagesa të artistëve ose të shërbimeve të ndryshme bëheshin në dorë nga Ajola Xoxa duke lënë në bankë paratë që futeshin nga institucionet publike.

Në lidhje me një faturë të lëshuar nga "Ava Studio" shpk, me përshkrimin "Koncept Kreativ", kjo shtetase deklaron *se ajo është bërë fiktivisht*. ***Lekët i janë dhënë Frosinës (Bollo) nga Reada dhe më pas ajo ka bërë shlyerjen e kësaj fature.*** ~~Deklaruesja shprehet *se u vendos nga Ajola Xoxa që kjo faturë nuk do depozitohej*~~ ***në Bashki*** **(për shkak se "Ava Studio" lidhet me emrin e Valbona Xoxa) dhe më pas u depozitua një faturë nga Ergys Krisiko në vlerën 540,000 lekë me përshkrimin "Koncept Kreativ".**

E pyetur nëse organizata "Harabel" ofronte shërbimin e *kurseve të artit*, shtetësja Adela Kondakçiu deklaron *se kurse arti janë zhvilluar në ambientet e zyrave në Sky*

SPYETJE.AL

*Toeer, të cilat janë përdorur si hapësira për mësimdhënie pasdite.* **Instruktore e këtyre** *kurseve ka qenë Eni Zeneli, e cila është bashkëshortja e Driant Zenelit.* Ndihmëse në këto kurse ka qenë një vajzë me emrin Anxhela, e cila kishte rolin e asistentes gjatë zhvillimit të kurseve. *Këto kurse janë mbajtur për një periudhë prej rreth një viti deri në një vit e gjysmë, ku pjesëmarrësit merrnin mësime të ndryshme artistike. Sa i përket pagesave, ato janë mbledhur nga Anxhela Muça, e cila më pas i linte tek tavolina për të bërë faturat përkatëse.* Pagesat kryesisht janë bërë në lekë, *me shumë pak raste të pagesave në euro.* Paralelisht, *Ajola Xoxa ka dhënë euro herë pas here në shuma prej 10,000 ose 20,000 Euro*, duke thënë që *të presin fatura për shkak se prindërit e fëmijëve i kishin dhënë parapagim për disa muaj për kurset e artit*.

Në lidhje me dy fatura të lëshuara për **"Fusha" shpk në Nëntor 2020**, nga subjektet Ines Dani dhe Greta Domi, shtetase këto që më pas kanë kryer dy *sponsorizime* për Qendrën "Harabel", deklaruesja shpjegon ***se këto deklarime të gjitha janë bërë nga Adela. Faturat i vendoste Ajola Xoxa, se ku do bëheshin dhe vlera e tyre***. Nuk ka informacion se çfarë shërbimi është bërë apo nëse është bërë realisht shërbimi. **Deklaruesja kujton *se Ajola ka thënë që nga fondi i ardhur nga Fusha do të kalohej një pjesë tek Harabel.***

Në lidhje me *sponsorizimet* e bëra nga shoqëria "Kontakt" shpk tek "Byl-A" OJF. deklaruesja shpjegon se shoqëria Kontakt ka bërë dy të tilla, por herën e parë ka paguar direkt Tim Neëman për festivalin ICDF edicioni i parë në vitin 2022. Ndërsa për edicionin e dytë, në vitin 2023 është paguar "Byl-A", *gjithmonë me konfirmim të Ajolës*. Më pas është folur me ekonomisten e "Kontakt" shpk për kontratën dhe faturën, shtetasen Eralda Ikonomi. Në lidhje me këtë, është vendosur ***që kontrata duhej të ishte marrëveshje bashkëpunimi dhe jo kontratë sponsorizimi***.

Në lidhje me vlerat monetare të gjetura gjatë kontrollit të ambienteve të shoqërisë "Partners Law" shpk, deklaruesja shpjegon se ka mësuar për këtë fakt nga Greta, por nuk ka dijeni për vlerën e saktë. **Deklaruesja shton se nuk është çuditur për shkak se Ajola i ka dhënë gjithmonë vlera në *cash* për të bërë pagesa të ndryshme. Shpesh herë i jepte edhe kartëmonedha prej 500 euro, të cilat ishin të dëmtuara, të mykura, dhe ka pasur probleme për përdorimin apo për konvertimin e tyre në lekë.**

**129.1.** Detajet në lidhje me faturat dhe menaxhimin e parave janë shumë të rëndësishme për të kuptuar mënyrën sesi janë administruar financat për këto kurse dhe si janë dokumentuar transaksionet përfundimtare në llogaritë e subjekteve që menaxhohen nga Ajola. Gjithashtu, shpjegimet se kurset e zhvilluara për një periudhë kohe prej rreth 1 vit e gjysëm, duket se konfirmohen edhe nga deklarimet e shtetasit Driant Zeneli. **Në lidhje me këtë, nga këqyrja e pjesshme e të dhënave të ekspertimit të telefonit celular të shtetasit Driant Zeneli, sekuestruar me vendim të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, perveçse rezulton e provuar se është Ajola Xoxa personi që vendos për aspektin financiar të "Harabel", konstatohet gjithashtu se një pjesë e faturave për këto kurse arti janë lëshuar fiktivisht, duke ngritur dyshime**

**sipas organit procedues se edhe në këtë rast jemi para një skeme të pastrimit të produkteve të veprës penale. Konkretisht:**

**Në datë 28.10.2020**
Ora 10:59 PM, **Driant Zeneli:** "*Shoqe me konfermon qe kursi per femijet kushton 80 mij lek ne muaj? Ta fillojm tani nentorin siç duhet*", "*Pastaj Olsi e kush do ti nuk do paguaj*", "*Po te pakten te fillojm*";
Ora 11:03 PM, **Ajola Xoxa:** "*Do merret Adela me pagesat, pa merak fare, **qe mos te besh ti biseda lekesh**... **Ideja eshte qe cdo seance kushton 1 mije leke te reja**. **Dmth 8 mije ne muaj nese vijne 4 here**. Pastaj kush do paguan 6 muaj bashke*", "*Olsi nuk paguan*", "*As Erioni*", "*As Ilda*", "*Me Marisen dhe Besen une kam folur*";
Ora 11:03 PM, **Driant Zeneli:** "*Po po siç e kemi bisedu*", "*Shume dakord*";
Ora 11:03 PM, Ajola Xoxa: "*Pagesat tamam te rregullta do t'i nisim ne janar*", "*Po po*";
Ora 11:04 PM, **Driant Zeneli:** "*Plus jane dy vajzat e ish Prokurores*", "*Ah jo tani?*", "*Se i thojn Nentor + Dhjetor*";
Ora 11:05 PM, **Ajola Xoxa:** ***"Tani do presim disa fatura gjasme per te rritur xhiron e Harabelit per 2020";***
Ora 11:05 PM, **Driant Zeneli:** "*Ti e din*";
Ora 11:06 PM, **Ajola Xoxa:** ***"Pra une Beses dhe Marises i kam thene qe do paguajne sa te duan per kete vit, por ama faturat do t'i presim sikur te kishin paguar 48'000 leke", "Pra gjasme si per 6 muaj", "Njesoj edhe per te tjeret";***
Ora 11:06 PM, **Driant Zeneli:** "*Super*";
Ora 11:06 PM, Ajola Xoxa: ***"Por kjo eshte thjesht per te rritur xhiron";***
Ora 11:07 PM, Ajola Xoxa: ***"Ia kam shpjeguar qe ajo do presi 6 fatura nga 48'000 leke secila, por nuk dua t'i jap shume sqarime Adeles", "Dmth ty po ta them tamam", "Adela do presi faturat" (Fq 5542-5552).***

**129.2. Gjithashtu, sa më lart përforcon edhe njëherë argumentat e organit procedues në lidhje me mungesën e transparencës përsa i përket deklarimeve periodike vjetore që shtetësja nën hetim Ajola Xoxa duhej të bënte para ILDKPI, në lidhje me angazhimin e saj mjaft aktiv në këtë qendër, veçanërisht angazhimin që lidhet me aspektin financiar të organizatës. Kujtojmë këtu, se vetëm nga këto kurse arti, "Harabel" ka faturuar rreth 7,000,000 lekë. Faturat, siç provohet në rastin e OJF "Frobolous", lëshohen fiktivisht dhe të paktën në një rast, ato ktheheshin përsëri mbrapsht tek shtetësja Ajola Xoxa, e cila më parë i kishte dhënë lekë *cash* për kryerjen e tyre. Shtetësja Ajola Xoxa ka disponuar për kalimin e fondeve nga personat fizikë tek llogaria bankare e "Harabel", në formë sponsorizimi, por që gabimisht është shkruar "likuidim fature" nga urdhërueset e xhirimit bankar. Shtetësja Ajola Xoxa ka disponuar gjithmonë para në monedhën Euro, të prerjeve të mëdha, të cilat rezulton se mbaheshin për një kohë të gjatë prej saj.**

**130.** I pyetur në datë **27.12.2024** si person që ka dijeni për veprën penale, **shtetasi Erald Ismaili,** me profesion jurist dhe inxhinier agrar, ndër të tjera ka shpjeguar se: **[...]**

Ë shtë i angazhuar me qendrën BYL-A, në cilësinë e drejtorit ekzekutiv për vitet 2011-2016 e më pas anëtar bordi. Ky shtetas ka shpjeguar se si drejtor ekzekutiv është zëvendësuar me Ina Goxhaj, e cila u propozua nga Klotilda Bushka.

Deklaruesi shprehet se BYL-A e ka selinë e ka në Komunën e Parisit, në një apartament të Klotildës, por që ai nuk kam qenë asnjëherë atje. Shpjegon se Drejtoresha aktuale, që sot quhet Rea, në dijeninë e tij rri te zyrat në Sky Toëer, në të njëjtin ambient ku ndodhet Partners. Deklaruesi shpjegon se vendimi i bordit për zëvendësimin e Ina Goxhaj me Rean, është marrë në ambientet e shoqërisë Partners, në katin e 10 te Sky Toëer. Po kështu, ka sqaruar se vulën e organizatës e mbante Adela Kondakciu.

Deklaruesi ka dhënë shpjegime në lidhje me projektin e fituar nga BYL-a me Ambasadën Amerikane. Fondi toal ka qenë 18 mijë dollarë dhe projekti do implementohej vetëm në Tiranë. Projekti zgjati 6-7 muaj, janar 2022 deri në korrik 2022. Shpjegon se për këtë projekt është zhvilluar vetëm një takim në Dajti Park, me rreth 60 pjesëmarrës. Sqaron se organizimi ka qenë me fjetje, por vetë ai nuk është akomoduar në ato ambiente. Nuk mban mend në lidhje me faturat e paguara nga BYL-A; nuk mban mend nëse ai apo bashkëshortja e tij Greta Kokalari të kenë përfituar vlera monetare nga ky projekt. Shpjegon se *për këtë projekt raportohej te Klotilda (Bushka), duke qenë se ajo ishte person kyç në organizatë*. Shpjegon se Klotilda nuk kishte asnjë rol "me letra", por kishte autoritet te BYL-A.

Gjatë deklarimit të tij, shtetasi Erald Ismaili pranon se në projektin e Ambasadës Amerikane *ka patur fatura dhe pagesa fiktive*, *<u>siç është edhe rasti i lidhjes së internetit me kompaninë Selcom.</u>*

Në lidhje me organizatën BYL-A, ai tregon se është akoma anëtar me letra, dhe paraqitet kur e thërrasin. Njoftimet i ka pas marrë nga Xhoi Skënderasi, dhe së fundmi është njoftuar nga një vajzë emri i së cilës nuk i kujtohet, por di që është punonjëse e Ajola Xoxës. ***Në dijeninë e tij, BYL-A menaxhohet nga Ajola, por për këtë nuk është shumë i sigurt.***

I pyetur në lidhje me shoqërinë **Eris Consulting Shpk**, deklaruesi ka shpjeguar se adresa ka qenë te shtëpia e tij, ***por në fakt zyra operonte në Sky Toëer***. Deklaruesi ka shpjeguar se ***<u>realisht ka qenë i punësuar te Ajola dhe kompania s'ka qenë e tij</u>***. Ideja e krijimit të kompanisë Eris Consulting, sipas deklaruesit, i është servirur nga shtetësja Ajola Xoxa. Për këtë gjë ai paguhej me pagë 55,000 lekë dhe një pjesë tjetër e merrte në cash si formë honorari. Deklaruesi shpjegon se punonjësit e deklaruar në listëpagesën e *Eris Consulting* janë të referuar nga shtetësja Ajola Xoxa dhe ata qëndronin në katin e 12, te Sky Toëer, te zyrat e The Partners. Kjo shtetase, sipas deklaruesit, i zgjidhte punonjësit me të cilët do të punonte.

*I pyetur për klientët si Sombrero, Alfa Cement, Euron Energy, Star Nrg, Favina 1, deklaruesi ka shpjeguar se gjendeshin nga shtetësja Ajola Xoxa.* ***<u>Deklaruesi ka shpjeguar gjithashtu se lekët që vinin nga Klientët, ia kalonte shtetases Ajola Xoxa me transfertë bankare</u>***. Edhe në momentin kur u mbyll *Eris Consulting*, ***<u>deklaruesi</u>***

***shpjegon se i ka kthyer pjesën e lekëve në formë cash, aq lekë sa ka qenë gjendje në bankë dhe në arkë.***

Të njëjtën gjë, deklaruesi shpjegon edhe për Personin Fizik Erald Ismaili, me emër tregtar Partners, emër i vendosur nga vetë shtetësja Ajola Xoxa. Më pas deklaruesi jep detaje mbi mekanizmin se si vepronin, ku klientët gjendeshin nga Ajola Xoxa, dhe për ta lëshoheshin faturat sipas kërkesës së kësaj të fundit. ***Klientët pasi paguanin, njoftohej Ajola Xoxa dhe financierja, e më pas Ajola faturonte Erald Ismailin. Për këtë gjë, Eraldi shpjegon se merrte rrogë.***

Gjatë deklarimit të tij, shtetasi Erald Ismaili ka treguar që bën një jetë modeste, me të ardhura familjare rreth 2,400,000 lekë në vit si dhe nuk disponon automjet për shkak se makina është shpenzim i madh për të. I pyetur nëse kishte blerë ndonjëherë rroba të markave si Louis Vuitton apo Prada, shtetasi Erald Ismaili e mohon një gjë të tillë. I ballafaquar me faktin se *për vitet 2016 deri në vitin 2021, në emër të tij janë paguar produkte të cilat janë zhdoganuar me 130 praktika doganore, në vlerë 55,414,409 lekë, pa përfshirë pagesat doganore (Tvsh etj..)*, deklaruesi është shprehur i habitur dhe *ka sqaruar se këto blerje nuk janë bërë nga ana e tij, por nga shtetësja Ajola Xoxa*. Deklaruesi kujton se i ka dhënë Ajolës njëherë kartën e identitetit, pasi e kërkonte posta, por nuk ka dijeni se si është përdorur. [...]

**130.1.** Sa më sipër, nga deklarimet e këtij shtetasi rezultojnë fakte me interes për hetimin, të cilat shkurtimisht konsistojnë në: **i)** Menaxhimi i organizatës BYL-A edhe sot bëhet nga Ajola Xoxa, pasi edhe drejtoresha aktuale e kësj organizate qëndron tek zyrat e Partners Law, të Ajola Xoxës, ndërsa vula mbahej nga Adela Kondakçiu; **ii)** Projektet, siç është rasti i financimit nga Ambasada e SHBA në Tiranë, rezultojnë të zhvilluara vetëm pjesërisht dhe për justifikimin e shpenzimeve prodhoheshin fatura fiktive; **iii)** Eris Consulting" shpk, e cila rezulton të jetë themeluar nga Erald Ismaili, në fakt është krijuar nga shtetësja Ajola Xoxa. Kjo kompani, ashtu si edhe të tjerat të krijuara dhe menaxhuara nga kjo shtetase, ka shërbyer për të kaluar shuma të hollash tek përfituesi fundor, që është Ajola Xoxa. Erald Ismaili është paguar me pagë fikse plus disa honorare, gjë që dëshmon natyrën e vërtetë të marrëdhenies me shtetasen Ajola Xoxa. Edhe zyrat ku ka ushtruar aktivitetin kjo shoqëri, rezultojnë të jenë tek Partners Law shpk; **iv)** Lekët që kalonin tek kjo shoqëri, pas klientëve që gjente Ajola Xoxa, kalonin tek kjo e fundit me transfertë bankare ose në formë cash, në momentin që kjo shoqëri u mbyll dhe shumat e të hollave u tërhoqën nga shtetasi Erald Ismaili. Faturat lëshoheshin nga kjo shoqëri sipas kërkesës së shtetases Ajola Xoxa. Pasi paguanin klientët, njoftohej shtetësja Ajola Xoxa dhe financierja Adela Kondakçiu; **v)** Shtetasi Erald Ismaili nuk ka asnjë mundësi financiare për të bërë blerje online të veshjeve dhe sendeve të tjera personale, si make up etj, në një vlerë të përgjithshme prej rreth 65,000,000 lekë në harkun kohor të rreth 4 viteve (bashkë me TVSH). Ky shtetas shpjegon se këto blerje janë bërë nga shtetësja Ajola Xoxa.

**131.** E pyetur në datë **20.12.2024** si person që ka dijeni për veprën penale, **shtetësja Ines Dani,** me profesion avokate, ndër të tjera ka shpjeguar se: [...]

Shtetësja Klotilda Bushka i ka propozuar në vitin 2016 që të punonte në një zyrë me të dhe me shtetasen Ajola Xoxa, në ndërtesën Sky Toër. Deklaruesja është shprehur



SPAK

se ka qenë e punësuar deri në vitin 2018 tek Klotilda (*nuk e di nëse ka qenë PF apo person Juridik)*, dhe më pas ka hapur personin e saj fizik, duke rënë dakord me Ajolën dhe Klotildën që përpos bashkëpunimit, ajo *(Inesi)* të kishte dhe klientët e saj.

Deklaruesja ka sqaruar *se për hapjen e personit fizik, nuk ka patur asistencë, e ka hapur vetë*. Ekonomiste ka patur Adela Kondakciun, të cilën e gjeti në zyrat e Sky Tower, dhe për shërbimin që i jepte Adela, *Inesi shpjegon se nuk e paguante, madje edhe sot që është larguar vetë nga Sky Tower, nuk i jep pagesë Adelës*. Në lidhje me personin e saj fizik, shpjegon se si seli kryesore ka patur zyrat në Sky Tower, në të cilat shfrytëzonte një hapësirë pa pagesë me një kontratë huapërdoje, të cilën nuk e disponon. Deklaruesja ka shpjeguar se nuk e mban mend nëse ka patur apo jo kasë fiskale. Gjithashtu, ka sqaruar se posti i saj i punës ishte përballë me zyrën e Ajola Xoxës.

E pyetur për klientët e saj, e **më konkretisht Fusha Shpk, deklaruesja ka shpjeguar** se ***ia kanë gjetur, por se kush nuk e mban mend***. Në lidhje me vlerën e arkëtuar nga Fusha Shpk, shpjegon se është rreth 13,000 euro, *për një konsultim që i ka dhënë në fillim të vitit 2020*. Deklaruesja ka shpjeguar ***se nuk ka patur komunikime me përfaqësues të Fusha Shpk, por që letrat e tyre i ka gjetur mbi tavolinë***. Në lidhje me çmimin për këtë klient, deklaruesja shprehet se ka biseduar me Greta Domin.

Po kështu, deklaruesja ka shpjeguar *se ka lëshuar fatura mujore edhe kundrejt Ajola Xoxës apo Partners Law, për konsulencë ligjore për subjekte të ndryshme, emrat dhe dosjet nuk i mban mend*. *Vlerën totale të faturuar nuk e mban mend, por çmimet i bisedonte me Ajolën*.

Deklaruesja ka shpjeguar se ka pranuar fatura nga shitësi Greta Domi Pf, në vlerë 230,000-250,000, për të cilat shtetësja Ines Dani shpjegon se nuk e di se çfarë ka bërë Greta me to. E pyetur për qëllimin e transfertës me përfitues Greta Domi Pf, në vlerë 1,234,000 lekë, deklaruesja ka treguar *se nuk e di për çfarë shërbimi është ofruar, por bëhet fjalë për konsulencën dhe bashkëpunimin që kanë patur bashkë*.

Deklaruesja ka shpjeguar *se në jetën e saj ka bërë vetëm një sponsorizim, në vlerë 550,000 lekë, të cilat ia ka kaluar Qendrës Harabel*. Burimi i kësaj shume ka qenë nga të ardhurat si profesioniste. *Ka shpjeguar se Ajola ishte e angazhuar në Qendrën Harabel*. Shpjegon se *Harabeli nuk kishte shumë kohë që ishte krijuar, dhe duke qenë se ishte një angazhim i përzemërt i Ajolës, pa e ditur nëse e kishte në pronësi apo jo, Inesi e ka mbështetur në shenjë mirënjohje. Eventin që ka sponsorizuar, deklaruesja shprehet se nuk e mban mend*. Për qendrën Harabel ka shpjeguar se nuk e di ku i ka zyrat, por në katin ku ndodhej Partners Laë, ka patur edhe vajza të qendrës Harabel. Ambjenti i Partners komunikonte me një ambejnt tjetër, që ishte sallë e madhe dhe aty qëndronin vajzat e qendrës Harabel. Deklaruesja shpjegon se shtetasin Driant Zeneli e njeh si artist, janë njohur te zyrat e përbashkëta, por nuk e di se në çfarë cilësie qëndronte aty.

E pyetur nëse ka përfituar ndonjëherë fonde nga ndonjë Bashki, deklaruesja ka sqaruar *se ka aplikuar dhe ka fituar një fond në Bashkinë Fier, në vlerë 30 milionë*

*lekë vjetra. Aplikimin për projekt beson se e ka bërë vetë, dhe është njoftuar për këtë thirrje nga një kërkim rastësor. Me fondin e fituar, shpjegon se i ka mbajtur për vete dhe i ka shfrytëzuar për të paguar një kredi që e kishte me bashkëjetuesin e saj që quhet Sazan Gorishova. Personin e kontaktit në këtë projekt nuk e mban mend se kush ka qenë.*

Deklaruesja është pyetur edhe në lidhje me shtetasen Linda Kazani, për të cilën tregon se e njeh dhe ka një çështje civile me të. Këtë çështje ia ka dhënë Ajola. Deklaruesja ka sqaruar se nuk i njeh shtetasit Rea Lemnusha apo Erald Simixhiu, po kështu nuk i njeh shoqëritë Arts Lab, Frobolous, qendra Eventus, Ava Studio, Gogel. **[...]**

**131.1.** Sipas organit procedues në pë rmbledhje të deklarimeve të bëra nga shtetësja Ines Dani, rezulton se ato janë tërësisht të pavërteta, veçanërisht nëse ballafaqohen me komunikimet që kjo shtetase ka patur më shtetasen Adela Kondakçiu. Kjo për këto arsye: **së pari,** rezulton tërësisht i pavërtetë pretendimi se personi fizik Ines Dani ka qenë ide e vetë kësaj shtetase. Nga komunikimet rezulton e qartë se ka qenë Ajola Xoxa që ja ka kërkuar këtë, si edhe ka qenë Ajola Xoxa që i ka thënë si do faturohej dhe sa. **Së dyti,** deklarimet në lidhje me sponsorimin e bërë në favor të Harabel janë tërësisht të pavërteta gjithashtu. Kjo del qartë si nga përshkrimi i bërë në depozitimin e lekëve në bankë, por sidomos nga komunikimet e zhvilluara me shtetasen Adela Kondakçiu, si edhe ato me shtetasen Ajola Xoxa. Këto komunikime përgënjeshtrojnë gjithashtu edhe shtetasen Ajola Xoxa. **Së treti,** Gjithashtu të pavërteta rezultojnë këto deklarime edhe me pagesën e bërë nga Fusha shpk, përsa kohë komunikimet provojnë se klientët gjënden nga shtetësja Ajola Xoxa dhe vendos ajo sa dhe si do faturohen. **Së katë rti,** të pavërteta rezultojnë edhe deklarimet që lidhen me pagesat që ka bërë për personin tjetër fizik Greta Domi. Kjo, si nga komunikimet ashtu edhe nga deklarimet e shtetases Adela Kondakçiu. Në fakt, xhirimi i të hollave nga një person fizik tek tjetri, kur ndërkohë të dy këta persona fizikë ushtrojnë aktivitetin tek zyrat e shtetases Ajola Xoxa, dëshmon edhe njëherë për mekanizmin e konceptuar me qëllim pastrimin e produkteve të veprës penale. **Së pesti,** deklarimet e shtetases Ines Dani janë tërësisht të pavërteta kur bëhet fjalë për pagesën e bërë nga Bashkia Fier. Nga komunikimet, por edhe lëvizjet bankare të administruara në fashikull, del e qartë se Ines Dani nuk ka asnje ide mbi kontratën e firmosur "shpejt e shpejt" poshtë banesës së saj gjatë kohës që ishte shtatzënë. Kjo shtetase nuk ka asnjë informacion kur bëhet pagesa dhe as ndonjë detaj tjetër që lidhet me projektin që supozohet të ketë zhvilluar. Në fund, nga komunikimet dhe lëvizjet bankare del e qartë se ku përfundojnë të hollat pasi kalojnë nga bashkia Fier tek personi fizik Ines Dani. Kjo e fundit mban vetëm pagat që i janë caktuar më parë nga shtetësja Ajola Xoxa, ndërsa pjesën tjetër e kalon tek personi tjetër fizik Greta Domi, para se vetë të largohej nga zyrat e Partners Lab. Në këto komunikime rezulton i qartë edhe mekanizmi i kthimit të lekëve në cash, pas pagesës së tyre nga klientët.

**132.** E pyetur në datë **20.12.2024** si person që ka dijeni për veprën penale, **shtetësja Ketrina Braho**, e cila ka qenë e punësuar si koordinatore eventesh pranë Qendrës Harabel, për vitet 2019 – dhjetor 2023, ndër të tjera ka shpjeguar se: **[...]**

Fillimisht se përpara se të vinte në Prokurorinë e Posaçme ishte takuar rastësisht me shtetasen Adela Kondakçiu, të cilës i ka thënë se ishte thërritur pranë SPAK. Po

kështu, në nisje të deklarimit të saj, shtetases Ajola Xoxa i referohet vetvetiu me emrin "*shefe*".

Deklaruesja ka shpjeguar se intervistën e parë te qendra Harabel e ka bërë me Driant Zenelin dhe me Ajola Xoxën, intervistë e zhvilluar në katin 12 ose 13 te Sky Tower. Është pyetur në lidhje me organizimin e zyrave në katin e 10 te Sky Tower, për të cilën tregon se ato ishin të organizuara në dy hapësira. Njëra hapësirë me pamje nga kompleksi Taivan ishte vendi ku ndodheshin zyrat e qendrës Harabel, ndërsa hapësira tjetër me pamje nga rruga Ibrahim Rugova shfrytëzohej për kompaninë Partners Lac. *Pra, nga deklarimi i saj evidentohet fakti se qendra Harabel ka ushtruar aktivitet në zyrat pranë Sky Toëer, prej vitit 2019.*

Deklaruesja shpjegon fillimisht se urdhrat apo vendimet për qendrën Harabel deri në vitin 2021 merreshin nga Drianti dhe Ajola, ndërsa pas këtij viti Ajola ishtë më prezente dhe i përcillte vendimet për qendrën. *Deklaruesja pohon se "shefi" i qendrës Harabel ishte Ajola Xoxa.* Për pagën, Ketrina Braho tregon se merrte në fillim 50.000 lekë, por me kalimin e viteve kjo ka ndryshuar. Deklaruesja shton se ka shpjeguar se ka biseduar me Adelën (Kondakçiu) për çështjen e pagës dhe *në dijeninë e saj ishte Ajola Xoxa ajo që vendoste për rrogat*. Deklaruesja Pasi është njohur me disa komunikime që lidheshin me pagat, deklaruesja ka shpjeguar se pagat e punonjësve të qendrës Harabel në vitin 2020. ka patur raste që vonoheshin shpesh. ***dhe se Adela konfirmimin për pagat e Harabelit i merrte nga Ajola Xoxa.***

Është pyetur në lidhje me organizimin e qendrës Harabel, për të cilën deklaruesja shpjegon se është pjesë e anëtarëve të bordit. Shpjegon gjithashtu se Xhoi Skënderasi i ka dhënë një letër për të firmosur, duke i thënë që do të ishte anëtare bordi. E ka pyetur pse *kjo gjë bëhet pa e pyetur, por Xhoi i ka thënë vetëm firmos se nuk është asgjë, nuk do hedhësh firma.* Atë ditë, në të njëjtën kohë, deklaruesja shpjegon se i erdhi e njëjta letër edhe shtetases Rozi Paci, *e cila bëri të njëjtën gjë, e firmosi.* Në atë kohë, deklaruesja shpjegon se Xhoi ishte avokate e The Partners, kompani e Ajolës. Pra, Xhoi punonte për Ajolën. Pasi është larguar nga puna, deklaruesja shpjegon se është njoftuar më vonë nga Fjoralba Zeko që ishte hequr si anëtare bordi, rreth marsit të vitit 2024. Ka sqaruar se nga anëtarët e tjerë të bordit njeh vetëm Rozi Pacin, të tjetër nuk e di se kush janë, dhe në dijeninë e saj, nuk ka marrë asnjë vendim si anëtare bordi.

E pyetur në lidhje me kompaninë Nan Gallery, deklaruesja shpjegon se është kompani e Harabelit, *por që nuk ka dijeni se është shoqëri me përgjegjësi të kufizuar*. Ka sqaruar se nuk e di kush është pronari i saj, *por mban mend se Ajola i ka thënë që do hapin Nan Gallery, e do ta përdornin për ekspozita*. Më pas, e ballafaquar me dokumentin ku paraqitet pranimi i dhurimit të Nan Gallery nga Qendra Harabel, deklaruesja pranon se *nënshkrimi është bërë nga ana e saj, por dokumentin po e lexon sot për herë të parë*.

Këtë dokument, sipas deklarueses mban mend se e ka sjellë Xhoi, nuk e ka diskutuar me të, thjesht ka firmosur, ***pasi për pranimin e dhurimit të Nan Gallery nga Qendra Harabel vendimi është marrë nga Ajola Xoxa***. Po kështu, deklaruesja tregon *se*

*shtetësja Ajola Xoxa ka vendosur që ajo (Ketrina) të merrte prokurë të posaçme nga Driant Zeneli, për të vepruar për llogari të qendrës Harabel.*

Deklaruesja shpjegon gjithashtu se gjatë angazhimit të saj te qendra Harabel, shumica e projekteve janë shkruar nga ana e saj. Po kështu, kjo shtetase tregon se ka shkruar projekte edhe për BYL-A, *organizatë në të cilën shpjegon se Ajola ishte e angazhuar,* ***madje të gjitha vendimmarrjet e BYL-A kalonin nga Ajola***. Është pyetur dhe ka shpjeguar se vetë ajo (*Ketrina*) ka shkruar projekt propozimin nga BYL-A, drejtuar Ministrisë së Kluturës, datë propozimi 15.09.2022. ***Projekt propozimi është bërë pas kërkesës së Ajolës***, *e cila i ka thënë që do të bëhet ky projekt propozim*. Po kështu, shpjegon se ***gjithmonë nga Ajola vendosej për të aplikuar në projekte, në cilin institucion, dhe se nga cila ojf, përshembull nga Byla apo nga Harabeli***. Madje, deklaruesja shpjegon se ***edhe personat apo kompanitë që do të paguheshin për projekte, përcaktoheshin nga Ajola Xoxa.***

Në lidhje me financimin e Bashkisë Tiranë për eventin Sonoma La Veronal, ne vlerë 5,000,000 lekë, deklaruesja Ketrina Braho shpjegon se aplikimi është bërë nga BYL-A, *iniciatori i këtij aplikimi ka qenë Ajola Xoxa, e cila i ka thënë që të bënte shkrimin e të dërgonte letrat e aplikimit, gjë e cila Ketrina tregon se e bëri.*

Deklaruesja ka pranuar se ka patur raste kur kanë bërë punësime apo rekrutime fiktive në lidhje me projektet e organizuara nga qendra Harabel. Një i tillë është për festivalin e Zabelit, organizuar nga Harabeli, ***ku kishin shënuar kot emrin e drejtorit artistik, emri i tij nuk i kujtohet.***

E pyetur në lidhje me rolin e shtetasve Greta Domi dhe Fjoralba Zeko në Qendrën Harabel, deklaruesja tregon se i njeh si punonjëse të Partners, avokate. E pyetur edhe për shtetasin Olsi Efthimi, deklaruesja tregon se është arkitekt dhe e ka ndihmuar shpesh qendrën Harabel. Olsi nuk kishte post pune, por ishte si ekspert i jashtëm. E pyetur në lidhje me shtetasin me emrin Valmir (Xoxa), deklaruesja shpjegon se ky shtetas është kushëri i Ajolës dhe atë e mbante kjo e fundit në punë, në katin e dhjetë në Sky Tower.

E pyetur në lidhje me shtetasen Valbona Xoxa, deklaruesja tregon se është nëna e Ajolës dhe ka një kompani me emrin Ava Studio Shpk, ***por që në fakt menaxhohej nga Ajola***. Deklaruesja shpjegon se gjatë viteve që ka punuar te Harabeli, *vetëm një herë e ka parë Valbonën në zyrat e Sky Toëer*. Ka shpjeguar gjithashtu se ajo vetë (deklaruesja) ***është angazhuar me BYL-A dhe me Ava Studio, pasi kështu i ka thënë Ajola***.

Deklaruesja vijon duke shpjeguar se *Ava Studio shpk nuk ofronte shërbime reale, të gjitha faturat e lëshuara prej saj janë fiktive*. E pyetur mbi projektin e Ministrisë së Kulturës, ku Ava Studio ka lëshuar faturë tatimore 500,000 lekë për prodhimin e 100 katalogjeve, shtetësja Ketrina Braho pohon *se këto katalogje nuk janë prodhuar nga Ava Studio, sepse kjo shoqëri nuk e ofron këtë shërbim.*

E pyetur mbi kompaninë Arts Lab shpk, pas ballafaqimit me disa komunikime të zhvilluara mes saj dhe Adela Kondakciut (*fq 647*), deklaruesja tregon se *biseda bën*

SPORTELI.AL

*fjalë për kalimin e disa fondeve te kompania Arts Lab, por që ajo nuk e di se kush është pronari i saj.* Këto veprime i ka bërë me orientimin e marrë nga Ajola Xoxa.

E pyetur mbi organizatën Konkresi Rinor Kombëtar, për të cilin tregon *se Ajola i ka thënë se është një institucion i varur nga Kryeministria*, deklaruesja shprehet se *mban mend që kanë aplikuar nga BYL-A për një projekt te KRK, në lidhje me festivalin edicioni i parë.*

Në lidhje me pasuritë e paluajtshme të zotëruara nga shtetësja Ajola Xoxa, deklaruesja është shprehur se në dijeninë e saj shtetësja Ajola Xoxa ka një shtëpi në atë zonë, pasi vetë Ajola i ka thënë se djali qëndron në plazh me nënën e saj. [...]

**132.1.** Sa më sipër sipas organit procedues nga deklarimet e kësaj shtetase rezultojnë fakte me interes për hetimin, të cilat shkurtimisht konsistojnë në: **i)** Të gjitha vendimet për organizatën Harabel merreshin vetëm nga shtetësja Ajola Xoxa, e cila vendoste edhe në lidhje me rrogat që duhet të ndaheshin; **ii)** Vendimmarrja për hapjen e NAN shpk ka qenë e shtetases Ajola Xoxa. Gjithashtu, i kësaj shtetase ka qenë edhe vendimi për të dhuruar "Nan" shpk tek organizata "Harabel"; **iii)** Të gjitha vendimmarrjet e BYL-A kalonin nga shtetësja Ajola Xoxa, përfshirë këtu projektet për të cilat duhej të aplikonin si edhe ku duhej të aplikonin; Ministri e Kulturës apo Bashki Tiranë. Në lidhje me këtë të fundit, iniciativa për të aplikuar organizata BYL-A pranë Bashkisë Tiranë, për të siguruar një financim prej 5.000.000 lekë, ka qenë e shtetases Ajola Xoxa. Kjo e fundit i ka thënë Ketrina Brahos të bënte gati letrat e aplikimit; **iv)** Në lidhje me rekrutimet e bëra nga Harabel gjatë zhvillimit të aktiviteteve, konstatohet se shumë prej tyre kanë qenë fiktive; **v)** Shtetasi Valmir Xoxa ishte i punësuar nga Ajola Xoxa. Kjo hedh poshtë deklarimet e kësaj të fundit në lidhje me marrëdhënien e tyre jokonfliktuale, dhe përforcon akoma më tepër dyshimin se kontrata e shitblerjes së automjetit është tërësisht fiktive dhe se pagesa e bërë për mjetin është në fakt integrim në sistemin bankar i të hollave që burojnë nga përfitimet e parregullta për shkak të funksionit të kryetarit të bashkisë Tiranë; **vi)** Ava Studio menaxhohet nga shtetësja Ajola Xoxa dhe jo nëna e saj Valbona Xoxa. Të gjitha faturat që lëshoheshin nga kjo shoqëri kanë fiktive, dhe për këtë deklaruesja sjell si shembull rastin e 100 katalogjeve të prodhuara me porosi të Ministrisë së Kulturës; **vii)** Arts Lab shpk kontrollohet plotësisht nga shtetësja Ajola Xoxa, e cila disponon për kalimin e fondeve tek kjo shoqëri; **viii)** Deklaruesja ka dijeni për vilën në Qerret të shtetases Ajola Xoxa, pasi vetë kjo e fundit i ka thënë e djali qëndronte në plazh me nënën e saj.

**133.** E pyetur në datë **18.12.2024** si person që ka dijeni për veprën penale, **shtetasja Reada Lemnusha** ndër të tjera ka shpjeguar se:

Ka qenë e punësuar pranë qendrës Harabel si koordinatore projektesh e punësuar si Drejtoreshë Ekzekutive pranë qendrës BYL-A dhe e punësuar pranë RTSH-së, ku ka një program në radio, si dhe e punësuar pranë organizatës Qendra Multidisiplinary Arts si koordinatore projektesh.

Kjo shtetase shpjegon se Drejtoreshë pranë qendrës BYL-A është bërë nga Ina Goxhaj, e cila e spikati në Festivalin e Dancit Kontemporan. Ky festival është organizuar nga qendra Harabel dhe një organizatë tjetër franceze. *Festivali ka qenë*

SPAK.AL

*me ftesa ose me bileta, të cilat janë shitur nga Harabeli, por nuk është e bindur për këtë gjë.*

Pavarësisht se është Drejtoreshë ekzekutive e BYL-A, deklaruesja shprehet *se nuk e di se kush apo sa veta janë në bordin e organizatës.* Në lidhje me kartat bankare të qendës BYL-A ku është drejtorshë, *deklaruesja shpjegon se nuk e di nëse ka apo kush i ka, si dhe tregon se nuk ka bërë asnjëherë veprime pranë bankave.* Kjo shtetase sqaron se *nuk është ajo personi përgjegjës apo vendimmarrës për organizatën BYL-A, sepse kur është bërë drejtoreshë, i ka dhënë prokurë të posaçme Adelës dhe nuk di asgjë se çfarë është bërë me BYL-A, të paktën nga ana financiare.* Deklaruesja ka shpjeguar se *angazhimi i saj si drejtoreshë te BYL-A, ka qenë zero.* Ajo shton se *prokurën nuk e ka lexuar, por me kërkesë të Adelës ka shkuar te noterja te Sky Toëer, për ta firmosur si dokument.*

Në lidhje me dokumentet e BYL-A, deklaruesja shpjegon se i ka te zyra e saj, që ndodhet në ambientet e Harabel, Sky Tower. Këto dokumenta i ka gjetur aty. Pavarësisht se ajo rri në pjesën ku ndodhet Partners Law, shpjegon se i konsideron si të Harabel të gjitha ambjentet. Harabeli si qendër është e *Ajolës dhe Driantit*, pasi Reada Lëmnusha shprehet se ka punuar me të dy. Drianti ka punuar me të për pjesën artisitike dhe kanë patur bashkëpunim. *Ndërsa për pjesën organizative e qendrës, Reada Lemnusha shpjegon se vendoste dhe merrej Ajola Xoxa.*

Deklaruesja shpjegon se pagën e saj te qendra Harabel dhe te Byla, e kalonte nga financa Adela Kondakçiu. Për këtë, deklaruesja shpjegon se Adelën nuk e ka të punësuar te BYL-A, por e ka gjetur aty dhe nuk është marrë me këtë gjë.

Adresën zyrtare të BYL-A, deklaruesja shpjegon *se nuk e dinte ku ndodhet*, të paktën deri në ditën kur është ushtruar kontroll nga policia gjyqësore, adresë të cilën e ka lexuar te Nipti. *Në këto zyra nuk ka qenë asnjëherë dhe nuk i di kush i ka.*

Në lidhje me shitjet e realizuara nga BYL-A për subjekte apo organizata të tjera si Kontakt Shpk, Bashkia Tiranë, Kongresi Rinor Kombëtar, Gogël etj, në vlerën 31, 521, 286 lekë, deklaruesja shprehet se ***nuk ka dijeni fare për anën financiare, dhe nuk e di si janë realizuar këto shitje.*** **Gjithashtu, kjo shtetas deklaron se nuk e njeh shtetasin Erald Ismaili *(anëtar bordi BYL-A).***

E pyetur në lidhje me angazhimin e saj me qendrën Frobolous, për të cilën tregon se është organizatë që e ka Frosina, deklaruesja shpjegon se ndihma që ka dhënë konsiston në organizimin e sfilatës te Pallati i Prigadave. **Në dijeninë e saj, *fondet ishin marrë nga Bashkia Tiranë.*** Deklaruesja vetë, sipas shpjegimeve të saj, tregon se është marrë me ndriçimin kryesisht. Në këtë event, sipas deklarueses ka patur rol Ergys Krisiko, i cili ka bërë podium skenografie, që kushton rreth 3-4 mijë euro. Gjithashtu, deklaruesja shton se kontribut ka dhënë dhe "Nan" shpk, duke bërë disa lule me letër, të punuara me dorë nga gocat e Harabelit. Vlerën e luleve, deklaruesja shpjegon se nuk e di. Po kështu, deklaruesja shprehet *se nuk ka dijeni mbi rolin e kompanisë Ava Studio, si dhe shpjegon që për herë të parë për këtë kompani ka*

> *dëgjuar gjatë sfilatës.* Reada Lëmnusha shpjegon se në rastet kur është marrë me Ava Studio shpk, *e ka bërë pasi ia ka kërkuar Ajola.*
>
> E pyetur në lidhjen me qendrën Muza, për të cilën tregon se nuk ka dëgjuar më parë *(pavarësisht se sipas dokumentacionit rezulton të jetë arkëtare),* deklaruesja shprehet se është pjesë e një grupi pune në Whatsapp, quajtur Harabeli Team, ku administrator grupi është Ajola Xoxa dhe ajo e organizonte punën. [...]

**133.1.** Sa më sipër sipas organit procedues nga deklarimet e kësaj shtetase rezultojnë fakte me interes për hetimin, të cilat shkurtimisht konsistojnë në: **i)** OJF-të e përmendura më lart rezultojnë të kenë patur të punësuar të njëjtët shtetas, të cilët janë të lidhur me shtetasen Ajola Xoxa; **ii)** Deklarimet në lidhje me zgjedhjen e saj si drejtoreshë ekzekutive e BYL-A nga shtetësja Ina Goxhaj, e cila ka mbuluar këtë rol më parë, janë të pavërteta pasi bien në kundërshtim me të gjitha komunikimet e shtetases Adela Kondakçiu me Ina Goxhaj, si edhe me deklarimet e kësaj të fundit të dhëna para organit procedues. Nga këto akte rezulton e provuar se Ina Goxhaj nuk ka asnjë vendimmarrje në lidhje me organizatën BYL-A dhe emërimi i saj si drejtoreshë ekzekutive është tërësisht fiktiv; **iii)** E njëjta praktikë vijon dhe me Reada Lemnushën. Fiktiviteti i emërimit të saj provohet me faktin që kjo shtetase as e ka idenë cilët janë anëtarët e bordit të BYL-A. Në lidhje me ecurinë e organizatës, ajo vetë deklaron se ka lëshuar një prokurë për Adela Kondakçiun (siç është praktikë e zakonshme në këto OJF), të cilën e ka firmosur pa e lexuar. Reada Lemnusha nuk është personi përgjegjës për organizatën dhe nuk ka asnjë vendimmarrje në lidhje me të. Angazhimi i kësaj shtetase ka qenë 0. Deri ditën që është ushtruar kontrolli në zbatim të vendimit të Gjykatës, Reada Lemnusha nuk dinte as adresën e organizatës, dokumentet e së cilës ndodheshin në zyrat e Partners Laë të Ajola Xoxës. Kjo shtetase nuk ka asnje ide cili është shtetasi Erald Ismaili, anëtar bordi i BYL-A; **iv)** Reada Lemnusha nuk ka asnjë dijeni për shitjet në vlerën rreth <u>31,521,000 lekë</u> të bëra nga organizata BYL-A, drejtoreshë ekzekutive e së cilës figuron.

**134.** I pyetur në datë **17.12.2024** si person që ka dijeni për veprën penale, **shtetasi Ergys Krisiko,** i cili është me profesion skulptor instalativ, ka shpjeguar ndër të tjera se: [...]

> Punon si pedagog. Gjithashtu, ky shtetas shpjegon se është i angazhuar edhe në aktivitet privat, i regjistuar si person fizik por edhe bashkëpronar në një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, me shtetasin Armand Metani. Deklaruesi ka sqaruar se *për personin fizik apo juridik, ka të punësuar ekonomistë, të cilët lëshojnë fatura tatimore pas kërkesës që bën ai vetë.* Pra, sipas deklaruesit, ai njofton ekonomistët për vlerën, shërbimin dhe blerësin. Më pas ekonomistët bëjnë veprimin manual të lëshimit të faturës tatimore.
>
> Deklaruesi shprehet se *ka njohje me shtetasen Ajola Xoxa, si dhe ka patur bashkëpunime me të nëpërmjet qendrës Harabel.* Për shërbimet që i ka bërë, deklaruesi shprehet se *nuk ka marrë më shumë se tetë milionë lekë të vjetra.*
>
> I pyetur nëse e njeh shtetasen Adela Kondakciu, deklaruesi tregon se mund ta njohë si fytyrë, *si emër nuk e njeh dhe nuk e di që është ekonomistja e Ajola Xoxës.* Më pas, ai deklaron se para dy-tre vitesh është kontaktuar nga Adela e cila i ka thënë që është ekonomistja e Ajola Xoxës.

I pyetur nëse i ka ofruar shërbim organizatës BYL-A, deklaruesi shprehet ***se nuk e mban mend këtë organizatë si dhe nuk i ka ofruar asnjë shërbim.*** Pasi është ballafaquar me disa komunikime të zhvilluara ndërmjet tij dhe shtetases Adela Kondakciu, të cilat bëjnë fjalë për lëshimin e faturave me blerës BYL-A, shtetasi Ergys Krisiko *ka kërkuar kohë që të shohë dokumentat, pasi nuk i kujtohen faturat apo instalacionet që ka bërë për BYL-A.*

Në vijim të deklarimit, pavarësisht se është ballafaquar me komunikimet telefonike të zhvilluara ndërmjet tij dhe Adela Kondakciut, *për lëshimin e faturave me blerës të ndryshëm sipas kërkesave të Adelës*, shtetasi Ergys Krisiko *është shprehur se nuk i mban mend dhe kërkon kohë që të njihet me to.*

Shtetasi Ergys Krisiko ka deklaruar *se nuk e njeh kompaninë Ava Studio, organizatën Frobolous, dhe se nuk ka bërë shërbime për këto subjekte*, pasi është ballafaquar me provat e siguruara nga organi procedues në lidhje me lëshimin e faturave kundrejt këtyre blerësve.

Deklaruesi është shprehur se në fillim të nëntorit 2024 ka fituar një konkurs nga Bashkia Tiranë, ku do të realizojë një instalacion, me elementë metalikë, strukturë njerëzore, në vlerë 63 milionë lekë të vjetra. Aplikimi për projektin është bërë nga EB Invest. **[...]**

**134.1.** Sa më sipër sipas organit procedues nga deklarimet e këtij shtetasi rezultojnë fakte me interes për hetimin, të cilat shkurtimisht konsistojnë në: **i)** Megjithëse ky shtetas ka të punësuar ekonomistë në subjektet e tij si Person Fizik dhe Person Juridik, përsëri përpilimi, përshkrimi, vendosja e vlerës dhe lëshimi i faturave bëhet sipas udhëzimeve të shkruara në Ëhatsapp nga Adela Kondakçiu, financierja e Ajola Xoxës, sipas porosive të kësaj të fundit. Në asnjë rast të vetëm gjatë komunikimeve mes Adela Kondakçiut dhe Ergys Krisikos, ky i fundit nuk kërkon të paguhet për "shërbimet" që supozohet të ketë kryer, por përkundrazi, çuditërisht në të gjitha rastet lëshimi i faturave kërkohet me urgjencë nga Adela Kondakçiu, pra financierja e Ajola Xoxës. Thënë ndryshe, nuk është shitësi që këmbëngul për të lëshuar faturën dhe marrë lekët që "i takojnë", por blerësi që këmbëngul për lëshimin e faturave dhe bërjen e pagesave për "shërbimet" që supozohet se ka marrë; **ii)** Njohja e tij me Ajola Xoxën, me të cilën ka marrëdhënie miqësore, e ka shtyrë të bashkëpunojë me Qendrën Harabel. Ergys Krisiko nuk ka dijeni rreth asnjë OJF apo shpk tjetër, për të cilat ka lëshuar fatura për shërbime që supozohet të jenë kryer. I pyetur specifikisht për shpk si Ava Studio etj, ai shprehet se nuk ka dijeni rreth tyre dhe nuk ka ofruar shërbime për to. Pra, faturat e lëshuara për këto subjekte provohet të jenë tërësisht fiktive. Vetë Ergys Krisiko shprehet se për shërbimet e tij për Harabel, nuk ka përfituar më shumë se rreth 800.000 lekë.

**135.** E pyetur në datë **13.12.2024**, si person që ka dijeni për veprën penale, **shtetësja** ~~**Greta Domi**, me profesion avokate, ndër të tjera deklaron se: [...]~~

Në shkurt të vitit 2020 ka regjistruar personin e saj fizik, ku si adresë ushtrim aktiviteti ka shënuar adresën e shtëpisë së saj. Kjo shtetase tregon se pasi kishte hapur personin fizik, ka marrë një ofertë nga Ajola Xoxa për të punuar me të (*njohje e vjetër 2009-2012*), dhe kanë rënë dakort që përpos punës për Ajolën, Greta mund të

vazhdonte të punonte me klientët e saj. Shërbimi që do t'i ofronte Ajolës te kompania e saj Partners Law, lidhej me konsulencat apo përfaqësimit në çështje gjyqësore/administrative. Në fillim të deklarimit të saj, kjo shtetase shpjegon se ka lidhur një kontratë huapërdorje të lidhur me Partners Laë, për përdorimin e 6 m2, pa pagesë, me qëllim ushtrimin e aktivitetit. Deklaruesja shpjegon se në të njëjtin ambient/zyrë ndodhet dhe posti i juristes së Partners Laë, Fjoralba Zeko. Këto dy poste pune, janë në të njëjtin vend, përballë zyrës së Ajola Xoxës.

Deklaruesja shpjegon se hapësirën 6 m2 në Sky Tower e shfrytëzon pa pagesë, për shkak se me të ardhurat i ka minimale dhe nuk e përballon dot qiranë në këtë godinë. Kjo hapësirë i është dhënë në këmbim të disa shërbimeve që lidhen me disa konsulenca për disa klientë të Partners Law. Deklaruesja ka konfirmuar se adresa e saj e punës është në pallatin Sky Tower, rruga Ibrahim Rugova, kati i 10/4. Kontabiliteti i saj mbahen nga Adela Kondakciu, që në momentin kur ka themeluar personin fizik, si dhe për këtë shërbim ajo nuk paguan asnjë vlerë, pasi e merr falas. Shpjegon se përdorën postën elektonike gdomi@thepartners.al dhe ka edhe adresë personale gretabungo@yahoo.com. E pyetur pse domain i saj është "thepartners.al" duke qenë se vetë ajo ofron shërbim si person fizik, deklaruesja është përgjigjur se i është bërë dhuratë dhe e përdor kur komunikon me klientët e Partners Law.

Në lidhje me marrëdhënien financiare për shërbimin e ofruar për Partners Law, Greta Domi tregon *se kishin rënë dakort me Ajolën për shërbimin e saj të konsulencës dhe përfaqësimit në procese gjyqësore për Partners Laë, ku për këtë shërbim do të lëshohej fatura tatimore. Mesatarisht të ardhurat që merrte nga Partners Law, deklaron se ishin rreth 120,000 lekë në muaj.*

Ajo tregon se *për llogari të Ajola Xoxës ka dhënë shërbim për vitet 2022-2023 për klientin Rametal, të cilit i ofronte konsulencë, përgatitje kontrata shitje, kontrata qiraje, leasing etj.* Kontaktin e mbante me Marisën (Nito), ndërsa pagesën e merrte 1 herë në gjashtë muaj. Shumën monetare të përfituar e ka përdorur për shpenzime personale. Deklaruesja shpjegon se Rametali ka qenë klient i Ajolës, dhe këtë klient e ka marrë nga ajo vetë. Shpjegon *se ka bërë rakordime financiare me Marisën, pasi ajo punonte si administratore e Rametalit, si dhe kujton që kanë patur dhe një kontratë bashkëpunimi.*

Deklarueses i është bërë e ditur nga hetuesit se, nga kompania Rametal ka përfituar 20,000 euro, por ajo ka deklaruar *se kjo gjë nuk ka ndodhur*. Për këtë, *është ballafaquar më pas me transaksionet bankare të datës 17.05.2022 dhe 16.11.2022, për të cilat tregon se është tarifë shërbimi dhe e ka përdorur për të jetuar.*

Po kështu, deklaruesja jep detaje edhe në lidhje me një klient tjetër për vitin 2020, Fusha Shpk, për të cilin deklaron se ka lëshuar fatura tatimore sipas pagesave në bankë rreth 13 milionë lekë të vjetra. Pasi është ballafaquar me transaksionin e datës 27.11.2020 në vlerë 1,336,284 nga Fusha Shpk, deklaruesja tregon *se ka kaluar shumë kohë dhe nuk e mban mend, por i ka dhënë konsulencë për një pronë në jug.*

SPECIAL.AL

Deklaruesja shpjegon *se një klient tjetër tregon se ka qenë BYL-A*, diskutimet në lidhje me çmimet i ka bërë me Ina Goxhaj dhe për ta ka përpiluar kontratat, ka dhënë konsulencë, vendime asambleje sipas kërkesave të parashtruara nga Ina. Kjo shtetase jep detaje në lidhje me klientin Lad Avrami, për të cilin tregon *se ajo ka ndjekur procesin për lejen e legalizimit, por që nuk e ka faturuar për shërbim pasi ishte klient i Partners Law.*

E pyetur në lidhje me *qendrën Harabel, deklaruesja tregon se është i Ajolës*, ka bërë disa kontrata për të, si dhe ka ndjekur procedurën për zëvendësimin në gjykatë të anëtarëve të bordit. Tregon *se ka transferuar një herë shumën rreth 4-6 mijë euro në llogarinë e qendrës Harabel, në shenjë mirënjohje duke qenë se i kishin dhënë një post pune për të punuar, dhe se ndihej në siklet për këtë gjë*. Shpjegon se *këtë vlerë nuk ia ka dërguar kompanisë Partners Law, se kështu vendosi vetë, pasi Harabeli ishte i Ajolës. Vlera ka kaluar në formë sponsorizimi, por nuk e mban mend eventin që ka sponsorizuar.*

Më pas, deklaruesja është ballafaquar me faturën tatimore Nr. 2 datë 30.11.2020, nga Qendra Harabel, blerës Greta Domi PF, e cila është likujduar në datë 14.12.2020 në vlerë 742.380 lekë, *për të cilën tregon se është sponsorizimi për këtë qendër, por eventin e sponsorizuar nuk e di.*

E pyetur nëse ka ndonjë kontratë të lidhur ndërmjet shoqërisë Kontakt Shpk me të ose me Partners Law, deklaruesja shpjegon *se nuk e mban mend*. Kujton se ka bërë një draft dokumenti por nuk i di përmbajtjen. Deklaruesja shpjegon se *e di që ka një bashkëpunim ndërmjet Kontakt Shpk dhe qendrës Harabel, por nuk e di vlerën dhe eventin.*

E pyetur për qendrën Muza, deklaruesja tregon se *nuk është marrë me themelimin e saj*. Me këtë qendër tregon *se është marrë Fjoralba Zeko*. Në dijeninë e saj janë tre anëtarë dhe një nga anëtarët e bordit është Rea Spartaku, por nuk është e sigurt.

E pyetur në lidhje me *ndonjë kontratë qiraje, apo pagesë qiraje për vilën në ish-bllok, ku ndodhet galeria e Nan Gallery*, deklaruesja shprehet *se nuk ka dijeni*. Për shoqërinë Nan Gallery di që *administratore është Daniela Luksani, e cila ka zëvendësuar Driant Zeneli*. Në dijeninë e saj, *Ajola Xoxa ka lidhje me Nan-in, si artëdashëse që është*. Shpjegon se *e di që Nan-in e ka Harabeli, dhe Harabeli është i Ajolës, rrjedhimisht Nan-i është i Ajolës*. Me shtetasin Driant Zeneli nuk ka asnjë marrëdhënie por di që është drejtor i Harabelit.

E pyetur në lidhje me marrëdhënien ndërmjet BYL-A dhe shtetases Ajola Xoxa, deklaruesja ka treguar *se ekziston një lidhje ndërmjet tyre por nuk e di se çfarë konkretisht*. Ka sqaruar sërish se në lidhje me tarifimin e BYL-A, nga ana e saj është biseduar me Ina Goxhaj. Shpjegon se nuk i di se kush janë anëtarë të bordit dhe nuk e di se ku ndodhen zyrat e kësaj organizate.

Gjithashtu kjo shtetase është pyetur dhe ka shpjeguar *se kompania Arts Lab merret me evente dhe e ka Erald Simixhiu, i cili është daja i Ajolës*. Ndërsa për Eventus-in

*tregon se është qendër, por nuk e mban mend kush e ka.* Për këto subjekte, Greta Domi tregon se ka përgatitur edhe vendime asambleje.

E pyetur në lidhje me shtetasin Olsi Efthimi, deklaruesja tregon se nuk e njeh personalisht, por është përshëndetur me të kur vinte te zyrat e Partners Laë. për të takuar Ajolën. Tregon se nuk kishte post pune, por qëndronte në zyrën e saj.

E pyetur *nëse ka dashur të mbyllë aktivitetin tregtar gjatë kohës që ka qenë me leje lindje, ajo tregon se këtë gjë nuk e mban mend fare.*

Deklaruesja ka shpjeguar se nuk ka marrë asnjëherë vlera cash nga Ajola Xoxa, nga kompania Partners Laë, punonjës të tjerë të kompanisë apo dhe nga klientë të Partnes Laë. Ndërsa nga Ines Dani, tregon *se ka marrë për shkak se i ndjek tre procese gjyqësore.*

**135.1.** Sipas organit procedues në pë rmbledhje të deklarimeve të bëra nga shtetësja **Greta Domi**, rezulton se ato janë tërësisht të pavërteta, veçanërisht nëse ballafaqohen me komunikimet që kjo shtetase ka patur më shtetasen Adela Kondakçiu si edhe dokumentet që lidhen me lëvizjen e të hollave, të administruara në fashikullin penal. Kjo për këto arsye: **së pari**, deklarimet në lidhje me sponsorimin e bërë në favor të Harabel janë tërësisht të pavërteta gjithashtu. Këtu duhet theksuar se kjo shtetase, ashtu si edhe Ines Dani ka përdorur të njëjtin justifikim kur bëhet fjalë për këtë "dhurim". **Së dyti**, gjithashtu të pavërteta rezultojnë këto deklarime edhe me pagesën e bërë nga Fusha shpk. përsa kohë vëtë kjo shtetase nuk mban mend në çfarë ka konsistuar saktësisht shërbimi i ofruar prej saj, dhe përsa kohë që komunikimet provojnë se klientët gjënden nga shtetësja Ajola Xoxa dhe vendos ajo sa dhe si do faturohen.

**136.** E pyetur në datë **13.12.2024** si person që ka dijeni për veprën penale, **shtetësja Ina Goxhaj**, ish-drejtoreshë ekzekutive e qendrës BYL-A, e cila ndër të tjera ka deklaruar: [...]

Pas njoftimit për t'u paraqitur në Prokurorinë e Posaçme ka realizuar disa takime me shtetasen Klotilda Bushka, Ajola Xoxa, apo edhe me disa avokatë.

Takimi i parë është zhvilluar me shtetasen Klotilda Bushka (*të cilën e ka kushërirë*) në datë **10.12.2024**, në banesën e prindërve të Klotildës që ndodhet pranë Shkollës së Kuqe. Ka shpjeguar se në këtë takim i ka treguar Klotildës që e kanë thërritur në prokurori, dhe Klotilda *e ka urdhëruar që të mohonte gjithçka* gjatë pyetjes së saj.

Takimi i dytë është zhvilluar pasdite në datë **11.12.2024**, në ambientet e një zyre avokatie, *ku pikë kontakti për këtë takim ka shërbyer shtetasi Erald Ismaili i cili e ka telefonuar vetë shtetasen Ina Goxhaj.* Në takim ka gjetur Klotilda Bushkën, dhe një djalë tjetër të cilin nuk e di kush është. Fillimisht, ka biseduar me Klotildën, për të cilën sqaron *se ajo e mësonte se çfarë duhej të thoshte, gjërat që do të mohoheshin në mënyrë kategorike.* Klotilda i ka treguar Inës *se gjatë deklarimit duhej të thoshte që ajo (Ina) ishte nismëtare e projektit të dancit, por është marrë Harabeli me organizimin.* Shqetësimi tjetër i Klotildës lidhej ***me adresën e selisë së BYL-A, që s'duhet të dihte që ishte shtëpia e saj.***

Po kështu, deklaruesja shpjegon *se Klotilda i ka dhënë një dokument i cili shërbente për ndryshimin e adresës së qendrës BYL-A dhe i ka sugjeruar Inës që të deklarojë që ka qenë neglizhencë e saj mosndryshimi i adresës.* **Në këtë takim, është bashkuar edhe Ajola Xoxa, e cila i ka kërkuar Inës që t'ia dorëzonte telefonin dhe më pas e ka kontrolluar atë në lidhje me bisedat që kishte.**

Ina Goxhaj ka deklaruar se nuk ka dashur që t'i jepte telefonin e saj të markës Samsung A35, por është ndjerë e detyruar nga Ajola Xoxa. Deklaruesja shpjegon *se Ajola Xoxa ka lexuar komunikimet e zhvilluara ndërmjet saj (Inës) dhe Adela Kondakçiut, apo e dhe me Ketrina Brahon dhe ishte e shqetësuar, por Ina deklaron se personalisht nuk u ndie në faj pasi mesazhet ishin një e vërtetë e madhe.*

Deklaruesja shpjegon *se Ajola, Klotilda dhe avokati morën vendimin që ajo (Ina) të mos paraqitej në Prokurorinë e Posaçme.* Deklaruesja shton se Ajola Xoxa më pas i ka sjellë një telefon të ri të markës Iphone 12 dhe i ka thënë se telefonin e saj Samsung A35 do ta asgjesonin.

Po kështu, deklaruesja shprehet *se avokatët ishin të shqetësuar pasi në Prokurori ishte paraqitur dhe Adela Kondakçiu. Duke nisur nga zgjatja e deklarimeve të kësaj shtetase, ata ishin në merak mos Adela kishte folur para hetuesve.*

Deklaruesja shprehet *se është larguar nga ky takim, për të vijuar takimin me Klotildën në banesën e prindërve të saj.* Po kështu, shpjegon *se Klotilda i ka thënë se nuk duhej të përmendte emrin e Ajolës apo të tregonte se si kishin funksionuar gjërat.* Shpjegon se Klotilda i ka kthyer telefonin Samsung A35, me qëllim që të kopjonte të dhënat e nevojshme dhe t'ia kthente sërish për asgjesim. Ina Goxhaj shpjegon se edhe në fakt kështu ka ndodhur. Në datë **12.12.2024**, kjo shtetase deklaron se i ka dhënë Klotildës telefonin Samsung A35 me qëllim asgjesimin e tij. Shpjegon se sipas udhëzimeve të avokatit, Ajolës dhe Klotildës, ka lajmëruar oficerët se nuk mund të paraqitej në prokurori për arsye shëndetësore.

Takimi tjetër është zhvilluar në datë **14.12.2024**, ditën e shtunë, në të njëjta ambiente. Shpjegon *se në takim ishte Klotilda, Ajola dhe Avokati dhe ata dukeshin të shqetësuar se nuk kishin patur kontakte me Adelën, e cila një ditë më parë kishte qenë në Prokurori.* Gjatë takimit, deklaruesja shpjegon *se i është thënë që duhet të bënte rezistencë dhe të mos tregonte realitetin e situatës.* Kjo shtetase deklaron *se i kanë kërkuar që të mohonte çdo gjë në lidhje me Ajolën dhe Bylën etj.*

Po kështu, Ina Goxhaj sqaron se gjatë këtij takimi *i kanë bërë presion duke i thënë se në momentin që Ajola do të shkonte në deklarim, ajo do ta merrte vesh se çfarë kishte thënë Ina.* I kanë thënë, *që ata do e merrnin vesh se çfarë do të deklaronte dhe do rridhte informacioni, pasi kishin njerëz brenda Prokurorisë, dhe se do njiheshin me deklarimin e saj.*

**Edhe Greta Domi, shpjegon deklaruesja ishte mësuar nga ata se çfarë duhej të deklaronte, dhe pas deklarimit i kishte njoftuar mbi ecurinë.** Në përfundim të takimin, i kanë kërkuar që pas deklarimit të saj, në orën 18:30 të paraqitej te zyrat e avokatit për të diskutuar për çfarë ishte pyetur.

Gjatë deklarimit të saj, kjo shtetase ka shpjeguar *se ajo është bërë drejtoreshë ekzekutive e qendrës BYL-A, pas rekomandimit të Klotilda Bushkës, e që më pas bordi i BYL-A në atë kohë e miratoi.* Shpjegon *se organizata në vitet 2019-2021 ka qenë jo-aktive, për t'u riaktivizuar sërish dhe ajo ka mbajtur postin e drejtoreshës deri në vitin 2023, kur u zëvendësua nga një vajzë me emrin Rea, të cilën e ka njohur në zyrat e qendrës Harabel.* Shpjegon *se është marrë vendimi që Rea të bëhej drejtoreshë, por nuk e di se kush e ka vendosur.*

Ka shpjeguar se në momentin kur ka nisur angazhimin e saj te BYL-A, nuk kishte një zyrë fikse. *Selia zyrtare e organizatës nuk ka qenë zyrë, ka qenë apartamenti i Klotildës. Puna e BYL-A pas vitit 2016 organizohej te zyrat e Partners, ku në këtë kompani Ina Goxhaj tregon se ka qenë e punësuar si sekretare, koordinuese zyre, dhe e kishte postin te recepsioni, por njëkohësisht bënte punë edhe për BYL-A.* Nuk paguhej për punën si sekretare e The Partners, pasi pagën e merrte nga BYL-A. Tregon se në vitin 2017 ajo u largua nga The Partners pasi u zëvendësua nga një vajzë tjetër, e ka qëndruar dy vite pa punë, pavarësisht se ishte Drejtoreshë Ekzekutive e BYL-A, nuk merrte asnjë pagesë.

Deklaruesja shpjegon se Ejona Isufaj i ka thënë për të aplikuar për një projekt te ambasada amerikane, "Model Nato". Sqaron *se ka kontaktuar me Erald Ismailin dhe Greta Kokalarin, e cila kishte bërë dhe shkrimin e projektit.* Shpjegon se pjesa dokumentare e letrave është bërë nga Greta Kokalari, *ndërsa financiere ishte Adela.* Ina Goxhaj shpjegon *se takimi final për këtë projekt është bërë te Hotel Dajti*, dhe shpjegon *se gjatë gjithë kohës Ina duhej të merrte konsultime me Ejonën ssi dhe ku do të zhvillohej projekti.*

Për këtë projekt, Ina Goxhaj tregon *se ka patur disa shqetësime, qoftë për realizimin e saj pasi ishin vonuar, por edhe në lidhje me raportimin te Klotilda për përdorimin e fondeve (pavarësisht se Klotilda nuk ishte marrë me këtë projekt apo t'i ketë kërkuar rakordime), shqetësim të cilin e ndante me Adelën.*

Po kështu, deklaruesja pohon *se gjatë zbatimit të këtij projekti ka patur pagesa fiktive, në rastet kur ekspertët ishin të njohur të organizatorëve, merrnin pagesa e më pas i kthenin në formë cash, vlera të cila merreshin nga Klotilda, Ajola dhe në disa raste Ejona.* Për këtë projekt, ka shpjeguar *se ka patur kontakte me Altin Bushkën, bashkëshortin e Klotildës, në lidhje me faturën për shërbimin e internetit që duhej ta regjistronte thjesht si zë shpenzimesh.*

Në lidhje me BYL-A, pas vitit 2022 dhe pas projektit të ambasadës amerikane, Ina Goxhaj *tregon se nga mënyra se si rodhën ngjarjet, ka kuptuar që BYL-A ishte e Ajolës.* E pyetur *për vendimet që merreshin te BYL-A pas vitit 2022, shpjegon se nuk vareshin nga ana saj.* Tregon se *ishte nënkuptuar që ishte tjetër person për vendimmarrjen.* Sqaron se *ajo quhet Ajola Xoxa, por me të nuk ka komunikuar drejtpërdrejtë, por nëpërmjet Adelës apo vajzave të tjera të Harabelit, të cilat i sillnin dokumentat për nënshkrim.* Ina Goxhaj tregon *se kishte vetëm emrin si drejtuese por pa asnjë rol.*

Ka shpjeguar edhe projektin tjetër për kërcimin ndërkombëtar, ku është angazhuar BYL-A. Tregon *se është kontaktuar nga Xhoi Skënderasi, punonjëse e Partners, e cila i ka thënë se duhej të firmoste, si të gjitha rastet kur i është marrë firma*. Tregon *se këtë projekt nuk e njeh fare, nuk është marrë me pagesat, por ka firmosur sa herë që i është thënë*. Ka sqaruar *se ka nënshkruar edhe çeqe të bardha, që më vonë plotësohej shuma nga Adela*.

Po kështu, pasi është ballafaquar me disa komunikime të zhvilluara ndërmjet saj dhe Adela Kondakciut (fq 1270), rreth mbylljes së llogarisë së Byla *dhe se rakordimi duhej të bëhej me Ajolën*, deklaruesja shpjegon ***se e ka kuptuar që BYL-A ishte e Ajolës dhe se rakordimet duhet të bëheshin me të***, pavarësisht se ajo tregon që nënshkruante duke qenë *se "kështu ishte organizuar gjëja"*.

Në lidhje me furnitorët e BYL-A, apo sponsorizimet që janë marrë nga Kontakt Shpk, Bashkia e Tiranës, Shoqata Konkresi Rinor Kombëtar, QTU, Ministria e Kulturës, Palushi, Gogel, Jedas, Banka Credins, Albtelecom, *ajo shpjegon se nuk ka dijeni pasi nuk ka qenë në brendësi të gjërave, por kishte emrin dhe nënshkruante kur i kërkohej.* **E pyetur konkretisht për *fondet e marra pranë Bashkisë Tiranë apo institucioneve të tjera, tregon se ato siguroheshin prej Ajola Xoxës, për shkak të ndikimit apo njohjeve që kishte.***

E pyetur në lidhje me rolin e shtetases Ajola Xoxa te organizata BYL-A, deklaruesja ka treguar *se në projektin e Kërcimit ndërkombëtar, ishte Ajola drejtuese artistike.* Komunikimet me të për këtë projekt dhe jo vetëm, *Ajola nuk i bënte drejtpërdrejt, por nëpërmjet Adelës, goçave të tjera të Harabelit apo Partners Laë si, Xhoi apo Keti, të cilat i jepnin dokumentat gati vetëm për ti firmosur.*

Deklaruesja ka shpjeguar se ka marrë pjesë si e ftuar në dy shfaqje te Teatri i Operës dhe Baletit, të cilat lidheshin me projektin festivalit ndërkombëtar të kërcimit bashkëkohor, *të fituar nga BYL-A dhe që organizoheshin nga Harabeli*. Hyrja për në këto shfaqje ka qenë me ftesa dhe me bileta, *por me çdo gjë merrej Harabeli*. Në këtë projekt, kontaktin me balerinët e ka patur Keti (*Ketrina Braho)* ndërsa për pagesën tregon se *në dijeninë e saj janë paguar nga BYL-A, pasi mban mend që ka nënshkruar disa marrëveshje të bëra gati nga Greta Domi.*

*E pyetur nëse ka depozituar vlera monetare në llogari bankare të shtetases Ajola Xoxa, deklaruesja ka shpjeguar se ka bërë disa derdhje në kohën kur ka qenë te zyrat e Partners, por nuk e di arsyen e depozitimit dhe se vlerat ia jepte Ajola për të bërë këtë veprim. Po kështu, tregon se nga postierët ka marrë pako për Ajolën.*

E pyetur për prezencën e shtetasit Driant Zeneli në ambjentet e punës në katin e 10 apo 12, te Sky Toëer, Ina Goxhaj deklaron se e ka takuar shumë rrallë.

E pyetur në lidhje me punonjësen Adela Kondakciu, shtetasja Ina Goxhaj tregon se atë e ka gjetur të punësuar pranë kompanisë Partners. Tregon se Adela i ka thënë se e ka marrë në punë Ajola dhe aty mban disa biznese për çështjet financiare. E pyetur në

lidhje me shtetasen Greta Domi tregon se nuk ka marrëdhënie me të, por e ka parë të Partners. Nuk ka dijeni nëse ka ndonjë kontratë ndërmjet Greta Domi dhe BYL-A.

Deklaruesja shprehet *se nuk ka dijeni për kompanitë Ava Studio, Arts Lab, Gogël, qendra Eventus, si dhe shpjegon se nuk i njeh shtetasit. Erald Simixhiu, Linda Kazani.* Shpjegon se *Valbona Xoxën e njeh dhe e ka takuar një herë në kohën kur ajo punonte në recepsion.* Tregon se ka njohje të vjetër me shtetasin Erald Ismaili, por nuk ka informacion që ai të ketë ndonjë kompani si dhe nuk ka dijeni se kush ka qenë pronar i kompanisë Eris Consulting.

Në vijim të deklarimit, e pyetur në lidhje me komunikimet e zhvilluara me Adelën për kalimin e fondeve nga KRK te BYL-A, nga ku rezulton *se është njoftuar nga Adela se po pret vendimmarjen e Ajolës se çfarë do të bëhej me lekët*, shtetasja Ina Goxhaj ka deklaruar *se pas projektit të ambasadës amerikane, është Ajola personi që vendoste për pagesat, apo çdo gjë financiare që lidhej me BYL-A.*

Në mbyllje të deklarimit të saj, shtetësja Ina Goxhaj ka bërë një përmbledhje të angazhimit të saj te organizata BYL-A pas vitit 2022, duke treguar *se ka vepruar siç i është kërkuar, jo në mënyrë të drejtëpërdrejtë nga Ajola Xoxa, por nga njerëz të afërt me të, pjesë e stafit të saj.* Thekson *se ka firmosur sa herë që i është kërkuar, pa qenë asnjëherë vendimmarrëse mbi aktivitetin e organizatës.* [...]

**136.1.** Sa më sipër sipas organit procedues nga deklarimet e kësaj shtetase rezultojnë fakte me interes për hetimin, të cilat shkurtimisht konsistojnë në: **i)** Deklaruesit e thirrur pranë organit procedues kontaktohen nga shtetësja Ajola Xoxa, e cila i orienton për mënyrën si do japin deklarimet. Deklaruesve gjithashtu u merren sende të cilat mund të përmbajnë komunikime dhe prova të tjera që lidhen me veprën penale në brendësi të tyre (aparat celular), për t'i zëvendësuar me sendin e ri; **ii)** Shtetësja Ina Goxhaj, në cilësinë e drejtoreshës ekzekutive të BYL-A nuk ka asnjë vendimmarrje në këtë organizatë jofitimprurëse, për më tepër të natyrës financiare. Kjo organizatë është menaxhuar në çdo aspekt të saj gjithmonë nga njerëz të lidhur me Ajola Xoxën, si edhe nga vetë kjo e fundit.

**136.2. Deklarimet e shtetases Ina Goxhaj përputhen plotësisht me pamjet filmike të siguruara nga kamerat e sigurisë së ambientit.** Kështu, në lidhje me deklarimet e kësaj shtetase për kontaktet që ka marrë me shtetasen Ajola Xoxa, por edhe me shtetas të tjerë, nga këqyrja e pamjeve filmike, sipas procesverbalit të datës 17.12.2024, të administruar në fashikullin penal, rezulton se: Në një pallat të ndodhur në zonën e ish Bllokut, vijnë/dalin nga pallati shtetasit: *1) Ajola Xoxa, vjen dhe ngjitet në pallat ora reale 16:26; 2) Klotilda Bushka, vjen dhe ngjitet në pallat në ora reale 16:38 dhe del jashtë në ora 17:18; 3) Ina Goxhaj, vjen dhe ngjitet në pallat në ora reale 18:00; 4) Klotilda Bushka, vjen dhe ngjitet në pallat nga shkallët në ora 18:59.*

**136.2.1.** Në vijim, shtetasit më sipër të cilët u futen në pallat dhe ngjiten me ashensor (*veç shtetases Klotilda Bushka e cila ngjitet nga shkallët*), konstatohen të zbresin nga ashensori po këta shtetas, veç e veç, përkatësisht në momente të ndryshme: *1) Ora reale 19:49, zbret dhe del jashtë Ina Goxhaj; 2) Ora reale 20:07, zbret dhe del jashtë Ajola Xoxa; 3) Ora reale 20:10, zbret dhe del jashtë Klotilda Bushka.*



SPYRETAL.AL

**136.2.2.** Gjithashtu, deklarimet e kësaj shtetase në lidhje me ndërrimin e aparatit të saj celular, konstatohet se mbështeten edhe nga rezultatet e përftuara nga shkresa Nr. FRS/3056/IB datë 26.12.2024, e ardhur pranë organit procedues nga shoqëria Vodafone Sh.a. Prej kësaj kompanie telefonike, është administruar informacioni se numri telefonik +355696152417 është i regjistruar në emrin e shtetases Ina Goxhaj, me Nr. personal I85524116P, e datëlindjes 24.05.1988, për të cilën është plotësuar edhe formulari i përdoruesit të shërbimeve për komunikimet elektronike. Bashkëlidhur këtij formulari gjendet dhe një kopje e Letërnjoftimit në emër të shtetases Ina Goxhaj, me Nr. Personal I85524116P, lëshuar në datë 06.05.2009. Po kështu, kompania telefonike ka vënë në dispozicion thirrjet telefonike/sms, ku pasqyrohen numrat që kanë telefonuar apo janë telefonuar nga shtetasja Ina Goxhaj, për periudhën 01.12.2023 deri në 18.12.2024, së bashku me IMEI-n identifikues të bashkëbiseduesve.

**136.2.3.** Nga materiali i analizuar për thirrjet dalëse, evidentohet se prej datës 01.12.2023 dhe deri në datë 10.12.2024 ora 20:07, ky numër telefonik është përdorur në aparatin celular me IMEI 356835259288980. Telefonata e fundit dalëse ka qenë në orën 20:07, me kohëzgjatje 10 sekonda, kundrejt numrit celular 0695528178. Fluksi hyrës i fundit rezulton të jetë sms nga Vodafone në orën 22:51 të datës 10.12.2024. Në vijim, pasqyrohet se për numrin telefonik +355696152417, nga data 11.12.2024 ora 8:35 deri në 12.12.2024 ora 11:35, shfaqet një aparat telefonik me Nr. IMEI 358934999288980. Kjo përkon me deklarimet e kësaj shtetase në lidhje me përdorimin për pak orë të një aparati tjetër, i cili duhet të jetë i nënës së saj.

**136.2.4.** Më pas, nga materiali i analizuar për fluksett dalëse, evidentohet se prej datës 13.12.2024 ora 02:38 dhe deri në datë 18.12.2024 ora 14:19, numri telefonik i shtetases Ina Goxhaj është përdorur në aparatin me IMEI 357014745814170. Fluksi i parë hyrës për këtë IMEI është në datë 13.12.2024, ora 02:36, në formën e mesazhit, ndërsa fluksi i fundit hyrës është në datë 18.12.2024, ora 17:44, në formën e mesazhit. Këto të dhëna përkojnë me deklarimet e shtetases Ina Goxhaj përsa i përket ndërrimit të aparatit të saj celular. **Në konkluzion, provohet fakti se deri në datë 10.12.2024 Ina Goxhaj ka patur një aparat telefonik me Imei 356835259288980 dhe prej datës 13.12.2024, shtetësja Ina Goxhaj ka ndërruar aparatin telefonik me IMEI 357014745814170. Nga burime të hapura rezulton që numrat IMEI të cilët fillojnë me 35 i përkasin aparateve telefonikë të markës Iphone. Edhe kjo e dhënë përkon me deklarimet e shtetases në fjalë, që lidhen me ndërrimin e telefonit të saj celular të markës Samsung, me një aparat të markës Iphone.**

**137.** E pyetur përsëri më datë **17.01.2025** si person që ka dijeni për veprën penale, **shtetësja Ina Goxhaj** ndër të tjera shpjegon se: **[…]**

> Është kontaktuar përsëri nga shtetësja Klotilda Busha, ditën e martë, më datë 14.01.2025.
>
> Deklaruesja shpjegon *se ndërsa ka qenë në zyrë duke punuar, tek Avokati i Popullit, rreth orës 14.30 është lajmëruar nga shoferi i institucionit, një shtetas i quajtur Tasim, se e kërkonte dikush nga jashtë*. Më pas, shoferi *i ka thënë që të shkonte tek zyra e Avokates së Popullit*. Deklaruesja shpjegon *se kur është futur brenda në zyrë, ka gjetur aty Avokaten e Popullit Erinda Ballanca, si dhe shtetasen Klotilda Bushka*.

Deklaruesja shpjegon *se në momentin e parë u përshëndeta me të dyja, më pas, shtetësja Klotilda Bushka i ka shkelur syrin, gjest të cilin ajo (deklaruesja) e ka kuptuar si një sinjalizim për të mos treguar se çfarë në kishte ndodhur gjatë muajit Dhjetor dhe takimet që kishte patur.*

Pas disa bisedave për tema personale, deklaruesja shpjegon *se shtetësja Erinda Ballanca është larguar nga zyra dhe ka mbetur vetëm me Klotilda Bushkën.* Kjo e fundit ka nisur ta pyesë nëse ishte më mirë dhe a ishte qetësuar nga situata e krijuar muajin e kaluar. Gjithashtu, Klotilda Bushka e ka pyetur *nëse kishte ndonjë shqetësim nga Spak-u, duke e pyetur nëse ishte thirrur përsëri.* Deklaruesja i është përgjigjur *se nuk ka patur asnjë lloj shqetësimi dhe është shumë e qetë.*

Në vijim, deklaruesja shpjegon *se Klotilda Bushka i ka thënë se kishte një merak me deklarimet në ILDKPKI që ajo vetë po bënte, duke iu referuar faturës që kishte në dosjen e saj të lëshuar nga bashkëshorti i saj Altin Bushka, për aktivitetin NATO 2022 dhe e ka pyetur se kush ka qënë në dijeni për këtë faturë.* Deklaruesja i ka thënë se *për këtë faturë kishte folur vetëm me Greta Kokalarin dhe më pas po ajo i kishte shkruar Altinit duke i thënë se duhet të bënte një faturë.*

Deklaruesja shprehet se, *meraku i Klotildës ishte nëse kjo bisedë mbi faturën në fjalë ishte bërë apo jo me Adela Kondakçiun, siç edhe në të vërtetë ka ndodhur.* Megjithatë, *deklaruesja e ka mohuar një gjë të tillë.*

Në një moment, deklaruesja shpjegon *se Klotilda Bushka u shpreh duke thënë se "Adela na ka sjellë shumë pasoja dhe është një person negativ me të cilin kemi bashkëpunuar".* Në lidhje me këtë, deklaruesja shpjegon *se Klotilda e ka porositur disa herë gjatë bisedës që të mos fliste me Adelën dhe të mos kishte asnjë lloj komunikimi me të.* Madje, Klotilda Bushka i ka thënë *që të mos kishte komunikim as me familjarët e saj (deklaruesës) lidhur me takimin e zhvilluar atë ditë me atë (Klotildën).*

Më pas, deklaruesja shpjegon *se Klotilda Bushka i ka thënë që do ta merrte në telefon avokatja për ta pyetur si ishte, pasi kishte shumë merak për gjendjen e saj.* Gjithashtu, Klotilda Bushka i ka *thënë se Romina mund ta merrte në telefon, në lidhje me një prokurë që do të lëshonte ajo (deklaruesja) dhe do ta nënshkruante.* Nëse do thirrej përsëri në Spak, *Klotilda Bushka i ka thënë se do të përfaqësohej me një avokat. Deklaruesja është shprehur dakord për të nënshkruar prokurën që i është propozuar.*

Deklaruesja shpjegon se *Klotilda i ka thënë "mos ki merak, për çfarëdolloj gjëje, do na kesh ne. Dhe të lutem mos fol me njeri në telefon".* Që mos fliste në telefon në lidhje me ngjarjen, deklaruesja shpjegon *se shtetësja Klotilda Bushka ja ka kërkuar disa herë.*

Më pas, deklaruesja *shpjegon se shtetësja Klotilda Bushka i ka thënë që nëse do e thërrisnin përsëri në Spak, ajo nuk duhej të tregonte sesi Klotilda ia kishte marrë telefonin.* Klotilda Bushka, shpjegon deklaruesja, *e ka udhëzuar që nëse do të pyetej organi procedues lidhur me telefonin, duhej të deklaronte se telefonin aktual (atë që i*

*ka dhënë shtetësja Ajola Xoxa) e kishte prej vitesh në shtëpinë e saj dhe thjesht e ka vënë në përdorim kohët e fundit.*

Në fund, deklaruesja shprehet se teksa po përshëndetej me Klotildën, *kjo e fundit i ka thënë "për çfarëdolloj gjëje që të duhet, qoftë edhe për lekë, na thuaj".* [...]

**137.1. Në përmbledhje të deklarimeve të bëra nga shtetësja Ina Goxhaj, rezulton se kjo e fundit është kontaktuar përsëri nga shtetësja Klotilda Bushka. Klotinda Bushka e udhëzon sesi duhet të sillet nëse thirret të deklarojë para organit procedues. Gjithashtu, shtetësja Klotilda Bushka i kërkon të mos tregojë që më herët i ka marrë telefonin celular dhe i kanë dhënë një të ri (dhënë nga Ajola Xoxa), duke e udhëzuar të thotë që telefonin e ri e ka patur në banesë (referoju deklarimeve të mëparshme të Ina Goxhaj si edhe përgjigjes të kompanisë telefonike në lidhje me ndërrimin e numrit IMEI).**

**138.** E pyetur në datë **23.12.2024** si person që ka dijeni për veprën penale, **shtetësja Ajola Xoxa** ndër të tjera ka shpjeguar se: [...]

Ka dhënë shërbimin si juriste qoftë si e punësuar ashtu edhe nëpërmjet personit fizik. Si person fizik, deklaruesja shprehet se ka qëndruar në Sky Tower, në katin e 12, në një ambient që babai i saj e kishte në përdorim, por që nuk e di mënyrën se si e kishte marrë. Punonjësit që ka patur gjatë vitit 2018, nuk i mban mend. Më pas, në shkurt të vitit 2019 shpjegon se ka hapur zyrën Partners Laë, administratore dhe pronare e vetme, me adresë në Sky Tower, në katin e 12, në të njëjtin ambient që kishte babai i saj në përdorim. *Për shfrytëzimin e hapësirës ka lidhur një kontratë huapërdorje me kompaninë Lani Shpk.*

Në vitin 2021, deklaruesja tregon se e zhvendosi aktivitetin në katin e 10, po në ndërtesën Sky Tower, ku *sërish lidhi një kontratë huapërdorje, e cila ka qenë në fuqi deri në vitin 2022*, kur janë dakortësuar me pronarët e pasurisë duke lidhur një kontratë jonoteriale për shumën 2,700 euro. Deklaruesja shpjegon se kjo vlerë paguhet nga Partners Law, por gjithashtu për hapësirën ngjitur paguhen 2,700 Euro nga kompania e nënës së saj Ava Studio. Shpjegon se këto dy hapësira komunikojnë me njëra tjetrën, me një derë xhami në mes. E pyetur mbi arsyet pse ndryshoi marrëveshja nga huapërdorje në kontratë qiraje, deklaruesja tregon se nuk e di.

Deklaruesja ka shpjeguar se shoqëria Partners Law ka të punësuar Fjoralba Zeko, Anxhela Qunaj, por ambienti përdoret edhe nga Adela Kondakciu që është ekonomiste e jashtme; nga Greta Domi si avokate Person Fizik si dhe janë në bisedime edhe me një person tjetër.

Deklaruesja ka shpjeguar se Greta Domi PF nuk paguan qira, si dhe paguhet nga ana e Partners Law me një pagesë mujore. Shpjegon se Greta Domi PF mban edhe klientë të vegjël të cilët i ka raste personale. Gjatë deklarimit ka shpjeguar se Greta Domi PF ka marrëdhënie të pavarur me një klient të Partners Law. *Klienti quhet Rametal.* Shpjegon se bashkëshortja e Elman Bule (*pronarit të Rametal*) quhet Marisa, e cila nga ana e saj ka një shoqëri që quhet Sapientia, dhe jep konsulencë ligjore. Tregon se kësaj shoqërie, nga ana tjetër Partners Law i ofron konsulencë ligjore. Në lidhje me

Elman Bulen, shpjegon se të paktën për kompanitë Rametal dhe Ventus, shoqëria Partners Law ofron konsulencë ligjore. Deklaruesja shpjegon se nuk di që Greta Domi apo Ines Dani, *të kenë bërë ndonjë sponsorizim për ndonjë OJF që ajo është e përfshirë.*

Shtetësja Ajola Xoxa është pyetur në lidhje me një transaksion me vlerë 24.000 Euro ndërmjet Salus Konstruksion dhe Partners Law. Për këtë gjë ka shpjeguar se është ofruar një shërbim te ASHK që ka zgjatur shumë në lidhje me pronë të paligjshëm të palegalizuar. *Nuk e di nëse prona ishte e shtetasit Vladimir Avrami, apo e kompanisë, por faturimin e kanë bërë te Salus Konstruksion.*

Ajola Xoxa ka shpjeguar gjithashtu se Greta Domi që është avokate, ka vepruar si person i besuar në Partners Law. Shpjegon se kjo ka ndodhur për shkak se ekziston një interpretim, që në një moment të caktuar një kompani të veprojë një person i besuar. E pyetur se pse regjistrimi i personit të besuar është bërë në vitin 2021, me vendim të vitit 2019, *deklaruesja shpjegon se nuk e mban mend mirë.* Gjithashtu, deklaruesja nuk jep shpjegime *se pse vendimmarrja bëhet gjithmonë nga ajo vetë, pavarësisht se Greta Domi ishte personi i besuar i shoqërisë Partners Law.*

Deklaruesja sqaron se në vitin 2018 është themeluar qendra Harabel, nga ajo vetë, një vajzë tjetër me emrin Iris, ndërsa anëtarin tjetër nuk e kujton se kush është. Shpjegon se vendimi për themelimin e qendrës e ka marrë bashkë me shtetasin Driant Zeneli, të cilin e njihte prej vitit 2016. Zyrat në momentin e themelimit kanë qenë në rrugën "Brigada e VIII", në një pasuri që është në emrin e saj. *Qiraja ka qenë 1.000 Euro në muaj, deri në mesin e vitit 2024,* duke qenë se Stafi i qendrës Harabel qëndronte në Sky Tower. Adresa zyrtare e qendrës Harabel është përdorur në disa raste për akomodimin disa artistëve dhe kuratorëve. Deklaruesja ka shpjeguar se ka gjeneruar të ardhura nga qiraja prej vitit 2022, në një kohë që Stafi i qendrës Harabel punonte te Sky Toëer dhe shfyrtëzonte hapësirën pa pagesë.

Deklaruesja shpjegon se vendimmarrja që Drianti të bëhej drejtor ekzekutiv ka qenë e të dyve. Shpjegon se ai konsultohej me të dhe me Iris, për qendrën në lidhje me veprimtarinë e saj, artistët, kuratorët. *Por gjithmonë, edhe pse konsultohej me ata, ishte vetë Drianti personi që ishte vendimmarrës.* Deklaruesja ka shpjeguar se Drianti prej vitit 2022, filloi të angazhohej jashtë vendit, *dhe stafi filloi t'i referohej asaj, pavarësisht se vendimet i merrte Drianti.* Kur Drianti ishte i pranishëm, *ai ishte i pari, Ajola ishte e dyta. Kur ai nuk ishte në zyrë,* Ajola Xoxa shpjegon *se stafi pyeste atë, por asnjë vendim nuk merrej pa Driantin.*

E pyetur mbi ndryshimin e anëtarëve të bordit të Qendrës Harabel, deklaruesja ka shpjeguar "*nuk e mbaj mend*". Aktualisht e ka të paqartë se kush është anëtar bordi, sepse janë në një proces të ndërrimit të anëtarëve të bordit. Kjo shtetase shpjegon se qëllimi është që Drianti të kalojë kryetar bordi, ndërsa ajo të kalojë drejtoreshë ekzekutive.

Deklaruesja ka sqaruar se Qendra Harabel ka marrë sponsorizime nga Bashkimi Europian, përmes programit Creative Europe, sponsorizime nga Abi Bank për disa

projekte, sponsorizime nga Ambasada të ndryshme, Ministria e Kulturës dhe Ministria e Turizmit. E pyetur në lidhje me kompaninë Jedas ose Doma&Co, deklaruesja shprehet *se nuk i kujton asgjë*.

Në vijim, deklaruesja sqaron se për të marrë pjesë në organizime të huaja, për të bërë ekspozita të arteve vizuale, lindi nevoja për krijimin e një subjekti tregtar. *Kështu lindi ideja që patën bashkë me Driantin për themelimin e subjektit Nan Gallery Shpk.* Deklaruesja sqaron se themelimi u bë nga shtetasi Driant Zeneli.

Në lidhje me vilën në zonën e ish-bllokut, që është përdorimin nga Nan Gallery, deklaruesja shprehet se shfrytëzimi i saj është bërë pa shpërblim, me kontratë huapërdorje. Në këmbim të shfrytëzimit pa pagesë të një vile të ndodhur në një zonë mjaft të shtrenjtë të kryeqytetit, deklaruesja shpjegon se është kujdesur që nëpërmjet Qendrës Harabel, emri i Vienna Insurance Group të përmendet në çdo event. *Kundërshpërlimi është marketingu që ne i japim*, shpjegon deklaruesja.

E pyetur për kartat bankare të Harabelit, deklaruesja shpjegon se mbaheshin nga Adela Kondakciu, ndërsa të Nan Gallery, *nuk ka dijeni*. E pyetur në lidhje me vendimmarrjen financiare, se kush vendoste për faturimet apo me pagesat te qendra Harabel, shtetasja Ajola Xoxa shprehet se *nuk e di, dhe i duhet të shohë një rast konkret për të dhënë përgjigje*.

Deklaruesja në vijim ka shpjeguar se pas ndarjes nga jeta të babait të saj, ajo ka biseduar më nënën, Valbonën, për të hapur një kompani *me qëllim që të bënte kurse piano dhe evente të tjera*. Kjo kompani quhet Ava Studio. Pronare e kompanisë është nëna e saj Valbona Xoxa, të cilën deklaruesja shprehet *se e ndihmon*.

Në lidhje me këtë shoqëri, deklaruesja shprehet se vendimmarrjen e ka nëna e saj, por që konsultohet edhe me të. AVA Studio i ka zyrat te Sky Tower, në të njëjtin kat ku ndodhet edhe Partners Laë, por nga ana ku rrinë anëtarët e Harabelit. Në lidhje me marrëdhënien tregtare ndërmjet Ava Studio dhe Rametal Shpk, deklaruesja shpjegon se *në dijeninë e saj Ava Studio është kontraktuar për të bërë një prezantim vizual për kompaninë Rametal, dhe një dokumentar për këtë kompani*. Deklaruesja shprehet se *në pamundësi për ta ofruar vetë këtë shërbim, Ava Studio ka kontaktuar kompaninë Nilor dhe shtetasin Ols Abazi*, të cilët, *sipas dijenisë së deklarueses, nëna e saj i njeh*.

Po kështu, për marrëdhënien tregtare me kompaninë Sapienta, deklaruesja shpjegon se Ava Studio *është kontraktuar për të bërë websiten e kompanisë, i cili ka qenë në proces, si dhe një reklamë*. Për kompaninë Sombrero, deklaruesja shpjegon se *në dijeninë e saj kjo kompani ka bërë një database, website si dhe janë duke realizuar një dokumentar, shërbime të ofruara nga kompania e nënës së saj, Ava Studio shpk*.

Deklaruesja shpjegon gjithashtu se Ava Studio ka ofruar shërbim edhe për qendrën Harabel, *por nuk e mban mend se çfarë*.

Shtetasja Ajola Xoxa shprehet se <u>*nuk ka dijeni sa punonjës ka patur kompania Ava Studio*</u>, por në dijeninë e saj *shërbimet i ofronte me kontraktim*. Deklaruesja shpjegon se ka patur raste, kur ajo (*deklaruesja*) *bën regji ose konceptim vizual me kërkesë të*



SPVETUEM.AL

*klientit të Avës,* *dhe faturimi për klientin bëhet nga Ava Studio Shpk. Deklaruesja shprehet se për shërbim nuk merr pagesë.*

Deklaruesja shpjegon se Qendra Eventus është krijuar nga Linda Kazani *(bashkëshortja e dajës Erald Simixhiu).* Dokumentacioni për themelimin e e kësaj qendre është bërë nga Partners Laë. Ka shpjeguar se nuk njeh asnjë anëtar apo drejtor ekzekutiv të kësaj qendre. Ka sqaruar se daja i saj, Erald Simixhiu, ka themeluar një kompani me emrin Arts Lab, dokumentacioni i së cilës beson se është bërë nga Partnes Law. *Shpjegon se nuk ka asnjë rol vendimmarës në këtë shoqëri, por ofron konsulencë nëpërmjet Partners Law. Ka shpjeguar se nuk ka dijeni çfarë shërbimi ka ofruar kundrejt Rametal Shpk, qendrave Eventus dhe Harabel.*

**Në lidhje me qendrën BYL-A, deklaruesja shpjegon se përpara shumë vitesh ka qenë eksperte e jashtme. Nuk e di se nga kush është themeluar,** por mban mend se Klotilda Bushka në një periudhë ka qenë anëtare e kësaj organizate. Shpjegon *se vetë ajo (Ajola Xoxa) në këtë qendër nuk ka asnjë rol vendimmarrës, nuk e di si është e organizuar dhe nuk e di kush e ka vendimmarrjen.* Deklaruesja shpjegon *se është rithirrur nga BYL-A, në vitin 2022 kur është zhvilluar Festivali i Kërcimit Bashkëkolor, ku është përfshirë si drejtoreshë në aspektin artistik të Festivalit.* Deklaruesja shpjegon se idea për zhvillimin e këtij festivali ka qenë e shtetases Ina Goxhaj.

Në lidhje me këtë të fundit, deklaruesja sqaron *se ka qenë recepsioniste për të, por nuk e di nëse te personi fizik apo juridik.* Gjithashtu, deklaruesja nuk ka dijeni nëse ka qenë me pagesë apo internship. Deklaruesja shprehet se ka marrë dijeni që aktualisht drejtor ekzekutiv i qendrës BYL-A është shtetësja Reada Lemnusha, dhe në lidhje me vulën e BYL-A e cila u gjet në ambientet e Partners Law, shpjegon se [illegible] ka patur Reada.

Në lidhje me qendrën Muza, deklaruesja tregon se dokumentacioni për themelim është bërë nga Partners Law. *Vetë ajo nuk e di se çfarë përfaqëson si qendër, pasi me këtë merret Greta Domi. Anëtaret e kësaj qendre nuk i di se kush janë.*

Për qendrën Frobolous, deklaruesja shpjegon se e di që e ka Frosina, shoqe e Reada Lemnusha dhe kanë bashkëpunuar në lidhje me një event për prezantimin e stilistëve të rinj shqiptar. Ky event është mbajtur te Pallati i Brigadave. *Deklaruesja ka shpjeguar se nuk ka dijeni se nga kush financohej kjo sfilatë*. Gjithashtu, *ajo nuk mban mend tarifën që u kanë faturuar*, por di që Nan Gallery është marrë me pjesën vizuale + video, ndihmuar nga punonjësit e Qendrës Harabelit, duke qenë se Nan Gallery zotërohet nga kjo qendër.

Deklaruesja ka dhënë sqarime edhe në lidhje me një transaksion me blerës djalin e xhaxhait, shtetasin Valmir Xoxa. Për këtë shtetas, fillimisht deklaruesja shprehet se ai ka qenë i angazhuar në zyrën Partners Laë, dhe ai e ndihmonte Ajolën për një libër. E pyetur në lidhje me marrëdhenien mes tyre, deklaruesja është shprehur se ajo e ka marrë pranë zyrës së saj, por edhe i ka qëndruar afër në një moment vështirësie këtij shtetasi. Marrëdhenien mes tyre, deklaruesja e ka përkufizuar si *jokonfliktuale*. E

pyetur për shitjen e automjetit tip benz në vlerë 23,000 euro, deklaruesja shprehet *se nuk e mban mend pavarësisht se u njoh me kontratën e shitjes*. Po kështu, shpjegon se nuk ka dijeni se çfarë ka bërë Valmiri me automjetin e shitur nga Ajola dhe nëna e saj.

Në lidhje me vilën e ndodhur në zonën e Qerretit, Kavajë, deklaruesja ka shpjeguar se prindërit e saj kanë patur një apartament në këtë zonë. Më pas kanë bërë në vitet 2017-2018 një kontratë shkëmbimi me kompaninë Agi Kons, për një një vilë, duke shtuar edhe një pagesë. Shkëmbimi u realizua, ndërsa apartamenti nuk e di nëse është regjistruar në emër të Agi Kons. Sqaron se vila është e njëjtë me atë që është ushtruar kontroll nga policia gjyqësore. Çmimin shtesë për vilën nuk e di, si dhe nuk e di nëse kontrata e shkëmbimit ka qenë noteriale apo jo. Tregon se këtë vilë e përdor, por më shumë qëndron nëna e saj me djalin në këtë ambient. Me shpenzimet e vilës sqaron se merret nëna e saj. Tarifat e mirëmbajtjes, shpjegon se paguhen nga nëna e saj, shtetësja Valbona Xoxa.

E pyetur në lidhje me vlerat cash të gjetura gjatë kontrollit në zyrat e Partners Law, konkretisht në kasafortën e saj, deklaruesja ka sqaruar se shtetasi Genti Sula ka dashur të blejë apartamentin që ndodhet në rrugën Brigada e 8. Në lidhje me këtë, deklaruesja sqaron se Genti Sula ka insistuar dhe i ka dhënë shumën e gjetur nga ana jonë, e cila ka qenë formë kapari, me qëllim që Ajola Xoxa të mos angazhohej për të gjetur një blerës tjetër. Për këtë, palët kanë përpiluar dhe një kontratë private, vetëm një ditë para vendimit të Gjykatës për ushtrimin e kontrollit dhe dy ditë para ekzekutimit të këtij vendimi. Deklaruesja, megjithëse ka pohuar marrëdhenien e tyre miqësore, ka shpjeguar se ka qenë vetë shtetasi Genti Sula që ka insistuar për t'i dhënë të holiat, me "merakun" që banesa mos i shitej dikujt tjetër. Në momentin e dorëzimit të vlerave monetare, deklaruesja shpjegon se nuk ka patur asnjë dëshmitar. **[...]**

**138.1.** Në përmbledhje të deklarimeve të shtetases Ajola Xoxa, sipas organit procedues ajo që mund të theksohet është paraqitja nga kjo shtetase e rrethanave të ndryshme nga ato që rezultojnë nga provat e administruara në fashikull. Këto deklarime bien në kundërshtim me deklarimet e shtetasve të tjerë të pyetur deri në këtë moment si persona që kanë dijeni për veprën penale, dokumentet bankarë të administruar në fashikull si edhe komunikimet mes shtetases Adela Kondakçiu dhe shtetasve të tjerë, përfshirë këtu edhe shtetasen Ajola Xoxa, të administruara edhe këto në fashikull. Kjo për këto arsye:

**138.1.1. Së pari,** deklarimet e shtetases Ajola Xoxa se zyrat ku ushtron aktivitetin "Partners Law" janë marrë në huapërdorje pa shpërblim për një periudhe kohe relativisht të gjatë, bien në kundërshtim me deklarimet e shtetases Adela Kondakçiu. Po ashtu, ato nuk duken të besueshme duke patur në konsideratë pozicionin mjaft të favorshëm ku këto zyra ndodhen, si edhe vlerën e lartë të tregut në një nga zonat më të kuotuara të kryeqytetit. Gjithashtu, akoma më pas i besueshëm duket ky pretendim nëse do merret në konsideratë fakti se Ajola Xoxa, jo vetëm që qëndron pa qira në një sipërfaqe prej 330 m2, ku rezulton se ushtron një aktivitet mjaft fitimprurës, por edhe faturon me shifra të konsiderueshme vetë personat që i kanë bërë "nderin", për konsulenca ligjore. Për më tepër, që nuk kuptohet pse deri në vitin 2023 (sipas pretendimeve të shtetases Ajola Xoxa) ambientet shfrytëzoheshin pa pagesë, ndërsa në këtë vit pagesa e qirasë u vendos të bëhej 2.700 Euro në muaj për Partners

Laë dhe 2.700 Euro në muaj për Ava Studio. Këtu duken të besueshme deklaratat e shtetases Adela Kondakçiu në lidhje me prodhimin e një kontrate qiraje jonoteriale fiktive vetëm në vitin 2024, duke e paraqitur këtë akt sikur i kishte nisur efektet në vitin 2023. Kujtojmë këtu se gjatë vitit 2024, u mësua nga kjo shtetase për nisjen e një hetimi për shkak të daljes së informacionit në media.

**138.1.2. Së dyti,** padijenia e shtetases Ajola Xoxa në lidhje me kalimet e të hollave nga personat fizikë Greta Domi dhe Ines Dani, në favor të "Harabel" në formë sponsorizimi si shenjë mirënjohje, bie në kundërshtim të plotë me sa ka rezultuar nga komunikimet e zhvilluar mes kësaj shtetase dhe Adela Kondakçiut. Nga biseda rezulton se kur Ajola Xoxa mëson që dy personat fizikë kishin depozituar secila një sasi të hollash për "Harabel" me përshkrimin "likuidim fature", i tërheq vëmendjen Adela Kondakçiut duke i thënë se duhej shënuar "sponsorizim". Por tashmë ishte vonë dhe përshkrimi mbeti ai i pari. Dhe mesa duket kjo "vërejtje" e shtetases Ajola Xoxa është "korrigjuar" nga shtetaset Ines Dani dhe Greta Domi, të cilat të pyeta nga organi procedues shprehen se i kanë dhënë të hollat si sponsorizim, në shenjë mirënjohje për Ajolën.

**138.1.3. Së treti,** në një moment të caktuar, Ajola Xoxa e konsultuar edhe me persona të tjerë, duket se bëhet e ndërgjegjshme se mund të ndodhej para ndonjë konflikti të mundshëm interesi përsa i takon aktivitetit të saj. Për këtë, ajo cakton një person të besuar Person Fizik Greta Domi, por në asnjë rast kjo e fundit nuk merr vendime për "Partners Law" shpk.

**138.1.4. Së katërti,** deklarimet se të gjitha vendimet në Harabel merreshin nga shtetasi Driant Zeneli, bien në kundërshtim të plotë nga deklaratat e këtij të fundit, ato të shtetases Adela Kondakçiu si edhe komunikimet e kësaj të fundit me shtetasen Ajola Xoxa, por edhe bashkëbisedues të tjerë. Ajola Xoxa, në këto komunikime urdhëron ndër të tjera që për financat e Harabel do të pyetej vetëm ajo. As edhe një kafe nuk do të dilte pa e konfirmuar ajo. Përveç kësaj, në të gjitha komunikimet rezulton mëse e qartë se Harabel ka vetëm një drejtues dhe përfitues, dhe ajo është vetëm shtetësja Ajola Xoxa.

**138.1.5. Së pesti,** deklarimet se ideja për krijimin e "Nan" shpk ishte e saj dhe e Driantit, bien në kundërshtim të plotë me deklarimet e këtij të fundit, ku ndër të tjera shpjegon se ideja ishte vetëm e Ajolës. Dhe kjo është e besueshme jo vetëm nga komunikimet që disponojmë, por edhe se shtetasi Driant Zeneli e argumentoi pse Ajola Xoxa e themeloi këtë shoqëri. Madje dhe emrin e shoqërisë, rezulton ta ketë zgjedhur shtetësja Ajola Xoxa.

**138.1.6. Së gjashti,** deklarimet se Ava Studio shpk është hapur nga nëna e saj për kurse piano dhe evente të tjera, dhe se është nëna e saj Valbona Xoxa që merr të gjitha vendimet në lidhje me shoqërinë, bien në kundërshtim me deklarimet e shtetases Adela Kondakçiu etj, por më së pari më gjithë komunikimet e administruara në fashikull, nga të cilat nuk rezulton qoftë edhe një e dhënë e vetme që të përfshijë shtetasen Valbona Xoxa në krijimin, menaxhimin dhe arkëtimin e fitimeve nga kjo kompani. Të gjitha faturat që lëshohen nga Ava Studio, për shoqëri të cilave nuk u ka ofruar kurrë ndonjë shërbim dhe të cilat janë në një mënyrë ose një tjetër lidhje e shtetases Ajola Xoxa, konfirmohen vetëm nga kjo e fundit dhe askush tjetër. Këtu duhet mbajtur në konsideratë fakti se Ava Studio faturon edhe për Harabel, shoqëri kjo që provohet se menaxhohet tërësisht nga Ajola Xoxa.

**138.1.7. Së shtati,** deklarimet se nuk njeh as drejtorin ekzekutiv të Qendrës Eventus dhe se nuk asnjë rol në shoqërinë Arts Lab, janë tërësisht të pavërteta dhe bien në

SPAK / DYETJET.AL

kundërshtim jo vetëm me deklarimet e shtetases Adela Kondakçiu por me të gjitha komunikimet e administruara në fashikull. Personi që vendos se si do faturohet, kur dhe ku nga këto kompani është vetëm shtetësja Ajola Xoxa. Gjithashtu, padijenia rreth lëshimit të faturave nga Arts Lab për Rametal shpk, rezulton të jetë tërësisht e pavërtetë, përsa kohë nga komunikimet mes Adela Kondakçiut dhe financieres së Rametal, por edhe ato mes Adela Kondakçiut dhe Ajola Xoxës, del e qartë se personi i vetëm që pyetet për lëshimin e faturave nga Arts Lab, Ava Studio, etj është vetëm shtetësja Ajola Xoxa.

**138.1.8. Së teti,** deklarimet se tek OJF BYL-A, Ajola Xoxa është thirrur vetëm në vitin 2022, për organizmin e Festivalit ndërkombëtar të dancit bashkëkohor, dhe ka punuar si drejtoreshë artistike, janë tërësisht të pavërteta, gjithnjë duke patur në konsideratë jo vetëm deklarimet e shtetases Adela Kondakçiu, si edhe komunikimet e kësaj të fundit në Whatsapp, por edhe deklarimet e shtetases Ina Goxhaj. Aq më pak janë të besueshme këto deklarime kur thuhet nga shtetësja Ajola Xoxa se, në projekt është thirrur nga shtetësja Ina Goxhaj, e cila më parë kishte punuar si Recepsioniste pranë zyrave të saj.

**138.1.9. Së nënti,** deklarimet për padijeni rreth qendrës MUZA si edhe sfilatën e organizuar nga "Frobolous", e financuar nga bashkia Tiranë, bien në kundërshtim të plotë me deklarimet e shtetases Adela Kondakçiu si edhe komunikimet e administruara në fashikull të kësaj të fundit.

**138.1.10. Së dhjeti,** deklarimet rreth një kontrate shitblerje automjeti, ku çmimi i vendosur ka qenë 23.000 euro, rezultojnë tërësisht të pabesueshme. Ajola Xoxa shprehet se nuk ka dijeni për kontratën, edhe pasi njihet me të dhe pranon që firma është e saj. Nga kontrata duket se kjo shtetase ka "përfituar" nga kushëriri i saj, shtetasi Valmir Xoxa, të cilin e ka punësuar në zyrat e saj si edhe i ka qëndruar pranë në momente vështirësie në jetë. Këtij shtetasi, Ajola Xoxa dhe nëna e saj i kanë "shitur" në vitin 2022 një mjet të blerë nga babai i saj rreth 7 vjet më parë, për çmimin prej 7.000 euro. Pra, automjeti, referuar kontratës është shitur 16.000 Euro më tepër sesa është blerë rreth 6 vjet më parë. Jo vetëm kaq, por shtetasi Valmir Xoxa, nga i cili duket sikur kanë "përfituar" shtetaset Ajola Xoxa dhe Valbona Xoxa, ka derdhur CASH në llogarinë e kësaj të fundit shumën prej 23.000 euro. Është i qartë fakti se kontrata në fjalë është tërësisht fiktive, dhe nisur nga mënyra si shtetësja Ajola Xoxa ka vepruar në lidhje me OJF-të dhe shoqëritë që kontrollon, dilet në përfundimin logjik të bazuar në prova se shuma në CASH e injektuar në sistemin bankar prej shtetasit Valmir Xoxa, është siguruar nëpërmjet përfitimeve të parregullta që kanë buruar prej funksionit të shtetasit Erion Veliaj.

**138.1.11. Së njëmbëdhjeti,** deklarimet e kësaj shtetase në lidhje me vilën e ndodhur në Qerret, Kavajë, bien në kundërshtim të plotë me rrethanat e faktit si edhe deklarimet e shtetasve të tjerë, të cilët kanë dijeni për këtë vilë. Ajola Xoxa bën deklarime të pavërteta kur shprehet se me shpenzimet e mirëmbajtjes së vilës merret vetëm nëna e saj, kur në fakt, nga kontrolli i ushtruar më vendim të Gjykatës së Posaçme, janë gjetur dhe sekuestruar në cilësinë e provës materiale, blloqe me shënime që dyshohet të jenë të shtetases Ajola Xoxa, në lidhje me elementë të veçantë të vilës. Gjithashtu, në këtë banesë janë gjetur shënime që dyshohet të jenë të shtetases Valbona Xoxa, e cila shkruan se sipas porosisë së Ajolës ka bërë një sërë pagesash që lidhen me mirëmbajtjen e vilës. Po ashtu, në vilë janë gjetur tabela pagesash si psh ato që lidhen me mirëmbajtjen e pishinës, në krye të të cilave është vendosur emri "Ajola". Pa përmendur këtu dhomën që pranohet nga vetë deklaruesja që është e djalit të



SPAK.AL

saj, si edhe garderobën e këtij të fundit së bashku me lojrat. Në vilë gjithashtu janë gjetur veshje të cilat duket se më shumë se me shtetasen Valbona Xoxa, kanë lidhje me vajzën e kësaj te fundit. Këtu duhet theksuar edhe sa ka rezultuar nga deklarimet e administratorit të kompleksit, i cili ka shpjeguar se ka parë vazhdimisht të frekuentojë vilën, shtetasen Ajola Xoxa. Nga ana tjetër, këto deklarime duken të pabesueshme kur konstatohet se, edhe në këtë rast ashtu si edhe në rastet e tjera, kontrata e shkëmbimit e pretenduar nga Ajola Xoxa, mes prindërve të saj dhe AGIKONS shpk, e vitit 2017, është jo e përpiluar para noterit, edhe pse ka patur objekt shkëmbimin e pasurive. Theksojmë këtu se, një kontratë shkëmbimi pasurish të paluajtshme krijon efekte të njëjta me një kontratë shitblerje apo dhurimi, përsa i përket kalimit të pronësisë, pra, si e tillë ajo regjistrohet në ASHK, por vetëm nëse përpilohet dhe nënshkruhet para një noteri.

**138.1.12. Së dymbëdhjeti,** në lidhje me sasinë e të hollave të cilat janë gjetur dhe sekuestruar në cilësinë e provës materiale, në kasafortën e Partners Law, deklarimet e shtetases Ajola Xoxa janë të pavërteta. Sipas organit procedues ato bien në kundërshtim me reagimet e para të kësaj shtetase gjatë momentit të kontrollit, ndërsa i ka thënë hetuesve të BKH-së se paratë e gjetura buronin nga trashëgimia e babait, më pas se ato ishin të shtëpisë. Më vonë, ndërsa ka ankimuar në gjykatë sekuestron e kësaj sasie të hollash, shtetësja Ajola Xoxa ka paraqitur një kontratë kapari, si gjithnjë jonoteriale, të prodhuar vetëm një ditë para vendimit të gjykatës, sipas së cilës shtetasi Gentian Sula i jepte këtë sasi të hollash si kapar, në mënyrë që të blinte apartamentin e saj në Rr. "Brigata VIII". Megjithëse marrëdhenien me këtë shtetas Ajola Xoxa e ka përkufizuar si një marrëdhënie mjaft të mirë dhe të shtrirë prapa në kohë, duke thënë se kanë besim reciprok të njëri tjetri; megjithëse ky shtetas rezulton të ketë bërë shumë sponsorizime për aktivitetet artistike që kjo shtetase organizonte, përfshirë këtu edhe lënien e vilës në zonën e ish bllokut në huarpërdorje pa shpërblim, përsëri mes palëve të paktën në dukje "ka ekzistuar mosbesimi". Shtetësja Ajola Xoxa, kur është pyetur pse, ndërkohë që kishte një miqësi të konsoliduar me shtetasin Gentian Sula, nga ky i fundit i është lënë një kapar në cash për blerjen e apartamentit, për të garantuar në këtë mënyrë që sendi mos i shitej dikujt tjetër, ajo nuk ka dhënë ndonjë shpjegim bindës, përveç se që lënia e të hollave (prerje 500 Euro) ishte bërë me insistimin e tij. Këtu duhet theksuar edhe njëherë fakti se kontrata e kaparit, e cila për nga forma duhej të ishte noteriale, nuk është përpiluar si e tillë, por vetëm si akt privat, i cili është tërësisht i pabesueshëm për arsyet që renditen.

**139.** I pyetur në datë 26.12.2024 si person që ka dijeni për veprën penale, **shtetasi Erion Veliaj** më së shumti është përgjigjur "*nuk e di*" dhe "*nuk kam dijeni*". Ky shtetas ndër të tjera ka deklaruar se: [...]

> Ka pasuri sipas deklaratës të bërë në ILDKPIK, dhe se nuk ka pasuri të tjera të padeklaruara. I pyetur për qendrën Harabel, shpjegon *se ka dijeni që është një platformë e artit dhe e kulturës, por nuk shpjegon rolin e bashkëshortes së tij në këtë organizatë*. Deklaruesi shprehet *se nuk e di si është e organizuar, nuk ka interes se kush janë anëtarë të bordit apo nga kush është themeluar, kjo qendër*. Gjithashtu, ai shprehet *se nuk ka dijeni se ku e ushtron aktivitetin kjo qendër*.
>
> I pyetur në lidhje me të ardhurat e siguruara nga bashkëshortja e tij, shtetësja Ajola Xoxa, nëpërmjet qendrës Harabel, deklaruesi shprehet *se nuk ka interes se nuk ka*



SPAK-DEBUG: PYETJET.AL

*qenë pas lekut.* Ky shtetas gjithashtu shpjegon se *nuk ka dijeni që prona në emër të bashkëshortes së tij i është dhënë me qira qendrës Harabel.*

Deklaruesi është pyetur edhe në lidhje me organizatën BYL-A, për të cilën tregon *se në vitin 2003-2004 e mban mend si organizatë, pasi kanë patur një koalicion organizatash, dhe në vitin 2003 ai është angazhuar me protestat që organizoheshin nga MJAFT.* Aktualisht, sipas deklaruesit, *nuk ka dijeni si është e organizuar apo kush është drejtor ekzekutiv i kësaj organizate.*

Gjithashtu, ky shtetas edhe pse ka nënshkruar urdhrat përkatës të shpenzimeve, shprehet se *nuk ka dijeni që BYL-A të jetë financuar nga Bashkia Tiranë*, por sqaron se Këshilli Bashkiak është një institucion i pavaruar nga Kryetari i Bashkisë. Këshilli Bashkiak zgjedh një komision me disa anëtarë, të cilët janë personalitete dhe vlerësojnë projektet dhe miratojnë financimet. Pas miratimit të financimit, Bashkia respekton vendimin e tyre, dhe nënshkrimi bëhet nga nënshkryetari i bashkisë, pikërisht për të shmanguar konflikte me shumëllojshmërinë e njerëzve që njeh kryetari i bashkisë.

Në lidhje me vilën në zonën e Qerretit, Kavajë, deklaruesi shprehet se *atje ndodhet një shtëpi e prindërve të Ajolës, të cilën e përdorin ata për pushimet e verës.* Në këtë shtëpi *lë edhe djalin e tij për pushime, dhe në këtë pasuri mund të shkojë 3-4 herë në vit.* Për këtë pasuri, shtetasi Erion Veliaj *sqaron se nuk ka bërë pagesa mirëmbajtje apo pagesa t tjera personalisht, por nuk përjashton faktin që bashkëshortja e tij të ketë ndihmuar nënën e saj për të bërë ndonjë pagesë.* Deklaruesi shprehet ***se kjo pasuri është shitur nga Gent Sula, të cilin e njeh prej mbi 10 vitesh, e me të ka marrëdhënie shoqërore.*** Në lidhje me çmimet e paguara për shtëpinë në Qerret apo në Kodrën e Diellit ku jeton, shtetasi Erjon Veliaj shprehet *se nuk ka dijeni.*

Deklaruesi ka sqaruar njohjen me shtetasin Gentjan Sula, aksioner me disa kuota në kompaninë e sigurimeve Intersig. Deklaruesi shprehet *se njohja me të është sporadike, dhe rrjedh nga e ëma.* Ky shtetas shpjegon se, *së fundmi ka marrë dijeni nga burime të hapura që Intersig Vienna Insurance Group, i lidhur me Gent Sulën, të njohur për mbështetjen ndaj artit, ka dhënë për Nan Gallery, pa kundërshpërblim, vilën, ndërtesën te blloku.*

I pyetur në lidhje me organizatën BYL-A, deklaruesi shprehet se nuk ka dijeni që ajo ka marrë fonde nga Kongresi Rinor Kombëtar. Deklaruesin shprehet se nuk ka dijeni cilët janë personat që kanë themeluar KRK-në, por mban mend se ka takuar Drejtoreshën, Dafinën, për shkak të angazhimit të organizatës dhe funksionit të tij si Kryetar Bashkie.

I pyetur nëse ka njohje me shtetasin Driant Zeneli (*drejtor ekzekutiv i qendrës Harabel*), deklaruesi është shprehur *se e njeh sporadikisht dhe e di që merret me artin.*

I pyetur në lidhje me shtetasin Ergys Krisiko dhe nëse ky i fundit paguhet nga OJF apo shoqëri që lidhen me familjarë të tij, deklaruesi përgjigjet se Ergysin e njeh si



SPY:ETUE:AL

artist, pasi ka bërë disa instalacione në zonën e Pazarit të Ri. Në lidhje me pagesat, deklaruesi shpjegon *se nuk e ka idenë fare.*

I pyetur për marrëdhënien apo njohjen e tij me shtetasin Elman Abule apo bashkëshorten e tij Marisa Nito, deklaruesi shprehet se kjo e fundit është shoqja e Ajolës. **Me Elman Abulen deklaruesi shprehet** ***se nuk ka kontakte së fundmi, por e njeh, nuk ka miqësi të afërt me të.*** **Marrëdhënia me Elman Abulen, sipas deklaruesit,** ***ka qenë në distancë.*** Deklaruesi gjithashtu sqaron *se ka qëlluar që të jetë në të njëjtin avion me të për në Londër, por ai (deklaruesi) ishte për vizitë zyrtare dhe se nuk ka qenë udhëtim i përbashkët.*

I pyetur nëse ka dijeni që shtetasi **Elman Abule** nëpërmjet shoqërive që zotëron, brenda tre vitesh ka transferuar rreth 200,000 euro për konsulencë ligjore apo shërbime të tjera kompanive Partners Law, Ava Studio, Greta Domi PF, deklaruesi *shprehet se nuk e di një fakt të tillë.* Në lidhje me lejen e ndërtimit të marrë nga një shoqëri që zotërohet nga shtetasi Elman Abule, deklaruesi shprehet *se nuk ka dijeni sepse lejet e ndërtimit janë një e drejtë jo konkurruese që u takon me ligj të gjithë atyre që kanë pronë për të zhvilluar dhe respektojnë rregullat e urbanistikës.*

Në lidhje me vlerat monetare të gjetura gjatë kontrollit të ambienteve të shoqërisë Partners Laë Shpk, deklaruesi ka shpjeguar *se nuk ka dijeni për detaje*, por di *që bashkëshortja një nga pronat e familjes donte ta shiste.* Deklaruesi shprehet gjithashtu *se nuk kishte dijeni pse mbaheshin cash por i qëndron asaj që ka deklaruar shtetësja Ajola Xoxa ndërsa është pyetur nga organi procedues.* I ballafaquar me faktin se prerja e kartmonedhave të sekuestruara në cilësinë e provës materiale, ishte 500 euro, deklaruesi *është përgjigjur se nuk ka dijeni në lidhje me të.*

I pyetur nëse ka udhëtuar ndonjëherë me shtetasin Klodian Allajbeu në drejtim të Kinës, deklaruesi shprehet *se nuk e mban mend si dhe i duhet të verifikojë se kush i ka mbuluar shpenzimet për këtë udhëtim.*

I pyetur për plotësimin e deklaratave të pasurisë pranë ILDKPIK, deklaruesi ka shpjeguar se *vetë ai merr asistencë nga zyra juridike pranë Bashkisë, ndërsa Ajola e plotëson vetë deklaratën e saj.* Deklaruesi shprehet *se nuk i kanë diskutuar nddonjëherë çështjet për deklarim, pasi secili bën të vetën.* Nga ILDKPIK, deklaruesi shpjegon *se nuk është thirrur asnjëherë për ndonjë kontroll, ndërsa për bashkëshorten nuk ka dijeni dhe tregon se duhet ta pyesë për këtë gjë.*

Po kështu, i pyetur në lidhje me transaksionet ndërmjet Fusha Shpk – Ines Dani PF apo Greta Domi PF, të cilat kalojnë më pas shuma të hollash te qendra Harabel, në formë sponsorizimi, deklaruesi shprehet *se nuk ka dijeni dhe se kryetari i bashkisë nuk është në komision të projekteve publike që mund të ketë fituar Fusha Shpk.* **[...]**

**139.1.** Sipas organit procedues nga deklarimet e shtetasit shtetasit Erion Veliaj ajo çfarë bie më tepër në sy janë pretendimet e tij për padijeni rreth aktivitetit të bashkëshortes së tij Ajola Xoxa, veçanërisht atij që lidhet me organizatat, shpk-të dhe personat fizikë të kontrolluara prej saj. Deklaruesi shprehet se nuk ka asnjë dijeni në lidhje me shumat e të hollave që xhirohen në këto kompani, pasi nuk ka asnjë interes për lekët. Ai gjithashtu nuk ka



SPIKTIMETHE.AL

asnjë shpjegim në lidhje me rolin e bashkëshortes së tij tek organizata Harabel. **Këto deklarimi bien në kundërshtim me provat e tjera të administruara. Kjo për këto arsye:**

**139.1. Së pari, këto deklarime kundërshtohen fillimisht nga rezultatet e përftuara nga këqyrja e faqes online të Instagram të shtetasit Erion Veliaj.** Nga procesverbali i këqyrjes datë 21.01.2025, i përpiluar nga Hetuesi i Byrosë Kombëtare të Hetimit (BKH), rezulton se në rrjetin social "Instagram", tek adresa "Erion Veliaj", evidentohet një postim i bërë nga ky i fundit më datë 20 Shtator 2023. Ky postim lidhet me eventin që do të organizohet më datën 23.09.2023-22.10.2023, "International Contemporary Dance Festival". Në **këtë postim, publikohet se "Harabel Contemporary", D18 Paris, BYL-A në bashkëpunim me Teatrin Kombëtar të Operës dhe Baletit (por edhe me mbështetjen e Bashkisë Tiranë) organizojnë edicionin e dytë të festivalit nën drejtimin artistik të koreografit të mirënjohur me origjinë shqitpare, Angelin Preljocaj".** Në vijim **të tekstit publikohet edhe kalendari i shfaqjeve. Postimi përmban në total 8 fotografi/reklama/postera, njëra pas tjetrës.**

**139.2. Së dyti,** nga procesverbali i këqyrjes së pjesshme të datës 22.01.2025 në lidhje me të dhënat e përftuara nga telefoni celular i shtetasit Driant Zeneli, administruar në fashikullin penal, ka rezultuar në përmbledhje se, **shtetasi Erion Veliaj interesohet për ecurinë e aktivitetit të OJF-ve të kontrolluara nga bashkëshortja e tij, specifikisht në rastin konkret të "Harabel", fakt ky që bie ndesh me deklarimet e shtetasit nën hetim për padijeni të plotë rreth angazhimeve të bashkëshortës së tij.** Konkretisht, nga këqyrja rezulton se më datë 02.11.2021 shtetasit Driant Zeneli dhe Ajola Xoxa komunikojnë rreth një shtetasi të huaj, të quajtur Jesus Hernandez, me profesion arkitekt. Nga biseda e zhvilluar kuptohet që shtetasi Erion Veliaj jo vetëm ka dijeni rreth aktivitetit të "Harabel" por edhe e promovon atë. Nga biseda konstatohet se shtetasi Jesus Hernandez ka patur një takim me kryetarin e Bashkisë Tiranë, Erion Veliaj, dhe ky i fundit i ka folur për "Harabel". Konkretisht, më datë 02.11.2021 është zhvilluar biseda sa vijon: *Ora 6:55 Pm,* ***Driant Zeneli:*** *"Jesus po ben dy projekte nje ne Shkoder dhe tjetri ne Gjirokaster. Ai kerkon sponsor" "Thjesht te parapri ate qe me tha". Ora 6:57 Pm,* ***Ajola Xoxa:*** *"Jesus ka ardhur sepse ka 1 projekt ne Gjirokaster dhe disa ne Tirane". Ora 6:57 Pm,* ***Ajola Xoxa: "Sot kishte takim ne Bashki me Erin".*** *Ora 6:57 Pm, Ajola Xoxa:* ***"Eri i kishte folur per Harabel".*** *Ora 6:57 Pm,* ***Ajola Xoxa:*** *"Ai i kishte thene se eshte takuar me ty, por jo me mua". Ora 6:57 Pm,* ***Ajola Xoxa:*** *"Dhe do të me takoje bashke me gruan, se punojne te dy". Ora 6:58 Pm, Ajola Xoxa: "Sa per kortezi". Ora 7:02 Pm, Driant Zeneli: "Po po ai me shkoi para disa javesh po nuk me tha per Harabel. Donte te me takonte nese mund te marre pjese une ose Anri Sala ose Adriani tek ekspozita qe duan te bejn ne muzeumin e ri te Gjirokastres ne Kala". Ora 7:02 Pm, Driant Zeneli:* ***Dërgohet dokumenti*** *077428e3-a266-453a-a662-dd77bf19daae.jpg.* ***I cili është screenshot i bisedës me kontaktin Jesus Hernandez ku bisedojnë për një takim në lidhje me disa projekte kulturore në Shqipëri.*** *Ora 7:03 Pm, Driant Zeneli: "Sa per korrektesi ky eshte mesazhi qe me shkroi para disa ditesh". (fq.7213-7216).* **Në lidhje me shtetasin Jesus Hernandez provohet se, pikërisht në datën që shtetësja Ajola Xoxa i referon bashkëbiseduesit se është takuar me bashkëshortin e saj Erion Veliaj, ky shtetas ka qenë në** ***territorin*** **shqiptar. Konkretisht, referuar procesverbalit të këqyrjes së sistemit** ***Tims*****, në rubrikën "Hyrje" konstatohet se shtetasi Jesus Hernandez ka hyrë në Shqipëri me Nr. dokumenti XDD799845-ES. Data e hyrjes**



SPEKTER.AL

**01.11.2021 14:51. Linja Austrian Airlines-OS 847/848 Viena. Kalimi kufitar: Komisariati i Policisë Rinas. Ndërsa, në rubrikën "Daljet" konstatohet se ky shtetas ka dalë nga Shqipëria me Nr. dokumenti XDD799845-ES. Data e daljes 03.11.2021 13:38. Linja Air Serbia-Beograd 212-213. Kalimi kufitar: Komisariati i Policisë Rinas.**

**139.3. Së treti,** një provë tjetër që shtetasi Erion Veliaj është aktiv përsa i përket ecurisë dhe promovimit të OJF-së në fjalë, rezulton të jetë përftuar nga komunikimet e datës 21.04.2022, mes shtetases Ajola Xoxa dhe Driant Zeneli. Nga këto komunikime konstatohet se në Itali, supozohet Venezia (Lido), ka ndodhur një takim ku i pranishëm ka qenë edhe kryetari i bashkisë Tiranë, bashkëshortja e tij dhe disa shtetas të tjerë të huaj përfshirë këtu një shtetas italian të quajtur Casamonti. Ky i fundit, sipas shtetases Ajola Xoxa, ka folur në lidhje me "Harabel" dhe bashkëpunime të mundshme të kësaj organizate. Gjithashtu, nga të njëjtat komunikime konstatohet se shtetasit Erion Veliaj dhe Driant Zeneli kanë një marrëdhënie e cila lidhet me aktivitetin e këtij të fundit tek "Harabel". **Shtetasi Erion Veliaj evidentohet qartë se jo vetëm që ka dijeni për aktivitetet e kryera nga bashkëshortja e tij, në fushën e organizimeve me natyrë artistike, por edhe ndihmon në forma konkrete kur i kërkohet nga kjo e fundit. Nga komunikimet rezulton një rast, ku shtetësja Ajola Xoxa i ka kërkuar ndihmë për vënien në dispozicion të një hapësire publike në lidhje me një aktivitet që do të zhvillonte shtetasi Kushtrim Juniku. Konkretisht:** *Në datë 29.11.2018 Ora 02:55 PM,* ***Driant Zeneli:*** *"<u>Shoqe arrite me fol me Erin per punen e Kushtrimit?</u>"* ***(Fq 2000).*** *Në datë 03.12.2018. Ora 08:19 PM,* ***Driant Zeneli:*** *"Shoqe me.mori Kushtrimi me tel toshi. Ke noj info kur dhe tek kush mund te shkojn Kushtrimi te prezantojn projketin? Se ditet po i afrohen ai ka ndermend per 29/30&31". Ora 08:56 PM, Ajola Xoxa:* ***"<u>Eri dje ka ardhur sepse ka qene jashte</u>", "Dhe kemi qene vetem me vizita dje", "<u>Ja sot sa ta takoj e pyes</u>" (Fq 2007).*** *Në datë* ***05.12.2018.*** *Ora 12:34 PM,* ***Driant Zeneli:*** *"Ciao Shoqe more gje vesh ku te shkoi Kushtrimi?" Ora 01:25 PM,* ***Ajola Xoxa: "<u>Po pres Erin te me thote</u>",*** *"Se perimisht kane edhe disa aktivitete te tjera ne ato lokacione". Ora 01:46 PM,* ***Driant Zeneli:*** *"Ah ok please sa po te kesh njoftim me.thuaj". Ora 02:01 PM,* ***Ajola Xoxa: "<u>Ok tha Eri do zgjidhim gjitheka tjeter</u>", "Me jep nje kontakt", "Qe ta pasoj", "<u>Se i pelqen shume shume ideja se ia dergova ta shihte tamam</u>".*** *Ora 02:01 PM,* ***Driant Zeneli:*** *Dërgohet kontakti i shtetasit Kushtrim Juniku me numër telefoni Phone: Mobile +355 67 276 9831* ***(Fq 2008-2010).*** **Në lidhje me shtetasin Kushtrim Juniku, nga këto akte konstatohet se ka përfituar fonde nga Agjencia e Mbrojtjes së Konsumatorit pranë Bashkisë Tiranë, nëpërmjet shoqërisë së tij "KUJU Studio" me NIPT L71310015L, më datë 22.12.2018, periudhë kjo e cila korrespondon me bisedën e treguar më lart. Vlera e përfituar është 4,296,000 lekë, sipas faturës nr. 27 datë 22.12.2018.**

**139.4. Së katërti,** nga deklarimet rezultuan edhe disa fakte të cilat lidhen me dijeninë rreth organizatës BYL-A, me të cilën lidhja shkon pas në vitë, në kohën që Erion Veliaj aktivizohej tek organizata "Mjaft". Megjithëse e njeh këtë organizatë, përsëri deklaruesi mohon të ketë dijeni rreth financimeve të "BYL-A" nga Bashkia që drejton, megjithëse është vetë ky shtetas që ka shpërndarë fondet publike duke firmosur urdhrat e shpenzimit përkatës.

**139.5. Së pesti,** edhe në lidhje me vilën e ndodhur në Qerret, Kavajë, nga Erion Veliaj pohohet frekuentimi i saj, megjithëse justifikimi që përdoret është për të vizituar djalin që qëndronte atje. Por nga ana tjetër, në kundërshtim me provat e administruara në fashikull, Erion Veliaj shprehet se nuk ka bërë ndonjëherë ndonjë pagesë mirëmbajtje të vilës apo

vilave (përfshirë këtu atë që figuron në emër të vëllait të tij Arbër Veliaj). Ky pretendim bie në kundërshtim të plotë me sa është përftuar nga librat e shitjes së "S&D Invest", të administruara në fashikullin penal, ku rezultojnë pagesa mirëmbajtje të kryera drejtpërdrejt nga shtetasi Erion Veliaj, për vilën në fjalë. Gjithashtu, qelizat e telefonit celular të këtij shtetasi sugjerojnë frekuentime të shpeshta në këtë zonë, gjë që bën të pabesueshme pretendimet në lidhje me vizitat sporadike të tij.

**139.6. Së gjashti,** akoma më i pabesueshëm është pretendimi se, megjithëse ka miqësi prej rreth 10 vitesh me shtetasin Gentian Sula, nuk ka asnjë dijeni rreth çmimeve për apartamentet e shitura nga ky shtetas tek Kodra e Diellit (vendi ku deklaruesi jeton aktualisht) si edhe vlerën që pretendohet të jetë shtuar në shkëmbimin e pasurive në Qerret. Për më tepër, që shtetasi Gentian Sula është një përfituesit më të mëdhenj të fondeve publike që administrohen nga Bashkia Tiranë, e drejtuar nga shtetasi Erion Veliaj.

**140.** Gjithashtu, në cilësinë e personit që ka dijeni për veprën penale është pyetur dhe **shtetasi Gentian Sula,** më datë 06.01.2025. Ky shtetas ndër të tjera deklaron se: [...]

> Zotëron disa kompani në Shqipëri dhe jashtë vendit, të cilat operojnë në fushën e ndërtimit dhe të zhvillimit, si *Agi Kons Shpk, S&D Invest Sh.a, Astrit Development etj.*
>
> Ky shtetas ka shpjeguar se shtetasin Erjon Veliaj e ka njohur si dhëndrin e Arben Xoxës, ku me këtë të fundit kishte njohje të hershme personale por edhe për shkak të punës. Ka shpjeguar se shtetasi Arben Xoxa dhe bashkëshortja Valbona Xoxa, *në vitet 2009-2010*, kanë blerë një banesë në rezidencën "Kodra e Diellit", *për të cilën mendon se ka lidhur një kontratë sipërmarrje.* Dorëzimi i objektit *është bërë në vitin 2012-2013*, ndërsa *për kontratën e blerjes tregon se mund të jetë bërë më vonë por nuk është i sigurt për këtë gjë.*
>
> Deklaruesi shpjegon se përpos këtij objekti, Arben Xoxa bleu dhe një banesë tjetër në Kodrën e Diellit, të cilën e përdorte vetë. Kohën e blerjes nuk e përcakton dot. Në vijim, në lidhje me pasuritë tregon se në vitet *2008-2009*, Arben Xoxa dhe Valbona Xoxa kanë blerë një apartament në Resortin Marea, Qerret. Apartamenti ishte 120 m2 dhe kushtonte 85,000 euro, pagesa të cilat kanë mbaruar në vitin 2013.
>
> Deklaruesi shpjegon se për këtë apartament është lidhur një kontratë e cila është nënshkruar nga Arben dhe Valbona Xoxa. Shpjegon se në vitin 2017-2018, këta shtetas e kanë këmbyer apartamentin me një vilë brenda resortit, *<u>me një pagesë shtesë prej 30,000 euro, pagesë e cila deri sot nuk është paguar.</u>*
>
> Gjithashtu, deklaruesi shpjegon *se nuk ka marrë qira nga kjo vilë, prej vitit 2017-2018, edhe pse nuk është paguar asnjë pjesë e shumës prej 30,000 euro.* Shpjegon *<u>se vila është përdorur nga Arben, Valbona, Ajola Xoxa dhe djali i saj.</u>* Tregon se për ambjentin paguhen tarifa mirëmbajtje, të cilat mendon *se janë paguar nga Valbona Xoxa.*
>
> Gjithashtu, deklaruesi shpjegon se kjo vilë është e pozicionuar një rrjesht më poshtë se vila e Arbër Veliaj, dhe këto dy vila ndahen nga një rrugicë këmbësorësh. Shpjegon *<u>se arsyeja që kjo vilë rezulton ende në emër të Agi Kons Shpk, lidhet me detyrimin e</u>*

> *papaguar prej 30,000 euro, ku sipas tij nuk është paguar për shkak të pamundësisë së tyre dhe për pakënaqësitë që kanë patur në lidhje me punimet.* Ka shpjeguar *se në zonën e Qerretit, kompleksi Marea, shërbimi i internetit kabllor ofrohet nga kompani Selcom, kompani në të cilën ka 70% të kuotave ndërsa 30% të kuotave i zotëron Altin Bushka.* Ka shpjeguar *se nuk ka dijeni që kompania Selcom të ketë dhënë shërbim interneti për ndonjë projekt të Ambasadës Amerikane.* [...]

**140.1.** Sa më sipër sipas organit procedues nga deklarimet e këtij shtetasi rezultojnë fakte me interes për hetimin, të cilat shkurtimisht konsistojnë në: i) për vilën në zonën e Qerretit nuk ka ndonjë kontratë noteriale shkëmbimi të përpiluar mes AGI KONS dhe shtetasve Valbona Xoxa dhe Arben Xoxa. Këta shtetas, po t'i referohemi deklarimeve, edhe sot e kësaj dite nuk kanë paguar detyrimin prej 30,000 Euro, duke mos dorëzuar madje as edhe një këst tek shitësi, megjithëse kanë patur mundësi financiare gjatë gjithë këtyre viteve. Për më tepër, Valbona Xoxa dhe i ndjeri Arben Xoxa, nuk kanë paguar asnjë moment, që prej vitit 2017-2018, ndonjë qira për shfrytëzimin e ambienteve të kësaj vile, për likuidimin e së cilës nuk kanë paguar asnjë shumë të hollash; **ii)** Kjo situatë juridike nuk është rregulluar as pas vitit 2020, kohë në të cilën është legalizuar dhe regjistruar vila në pronësi të AGI KONS. Pra, që prej 2020, çertifikata e pronësisë vijon të jetë në emër të AGI KONS shpk. Gjithashtu, prindërit e shtetases Ajola Xoxa nuk kanë pasur mungesë të ardhurash duke u nisur nga nga pasuria që ka trashëguar kjo e fundit pas vdekjes të të ndjerit Arben Xoxa; **iii)** Për të gjithë sipërfaqen e shtuar, pra nga një apartament prej 120 m2 në një vilë prej rreth 190 m2 dhe 494 m2 truall përfshirë këtu edhe një pishinë, vlera shtesë që Valbona Xoxa dhe Arben Xoxa duhej të paguanin, sipas deklaruesit është vetëm 30,000 euro. Dhe kjo akoma e palikuiduar; **iv)** Nga deklarimi i shtetasit Gentian Sulës duke se ky nuk ka asnjë pretendim mbi vilën edhe pse figuron në emër të shoqërisë në pronësi të tij; **v)** Administrimin e pronave të ndërtuara nga AGI KONS, përfshirë këtu dhe vilat në Qerret, e bën shoqëria tjetër në pronësi të Gentian Sulës, S&D Invest. Ky administrim ka nisur që me ndërtimin e objekteve. Ketu duhej patur në konsideratë momenti kohor kur shtetasi Erion Veliaj fillon e paguan tarifën e mirëmbajtjes, viti 2020, që përkon me blerjen e vilës tjetër nga vëllai i tij Arbër Veliaj.

**141.** E pyetur në datë **08.01.2025**, si person që ka dijeni për veprën penale, **shtetësja Marisa Nito** ndër të tjera deklaron se: [...]

> Para se të paraqitej në Prokurorinë e Posaçme ka kontaktuar nëpërmjet telefonit edhe me shtetasen Ajola Xoxa, por biseda nuk ka patur objekt thirrjen në organin procedues.
>
> Deklaruesja ka shpjeguar se është juriste e kualifikuar, me eksperiencë dhe se studimet i ka **përfunduar në Itali, Romë, Universiteti "La Sapienza"**. Si e tillë, ajo shprehet se ofron ndihmë të kualifikuar ligjore për kompanitë e bashkëshortit të saj, Elman Abule, në lidhje me problematikat ligjore, administrative dhe civile.
>
> Deklaruesja shpjegon se, për shkak se e ndien veten të dobët në pjesën e prezantimit të shoqërisë së saj, ka kontaktuar me kompaninë "Ava Studio" shpk, të shtetases Valbona Xoxa, të cilën e njeh për shkak të miqësisë që ka me vajzën e saj, Ajola Xoxa. Kësaj kompanie, deklaruesja shprehet se i ka besuar pjesën e CV, kartëvizitave, fletëpalosjeve etj, për një prezantim sa më të mirë. Për këto problematika, deklaruesja

shpjegon se ka biseduar me një vajzë nga kompania, së cilës nuk ja mban mend emrin.
**Deklaruesja shprehet se kanë rënë dakord për çmimin e shërbimit, idenë e prezantimit etj si edhe ka likujduar kompaninë "Ava Studio" para se të kryhej shërbimi. Megjithatë, ende sot e kësaj dite, ky shërbim nuk është marrë, për shkak se deklaruesja nuk ka qenë aktive nisur nga gjendja shëndetësore e saj, megjithëse kompania e saj ka vijuar aktivitetin tregtar. Në lidhje me të hollat që ka paguar, deklaruesja shprehet se nuk i janë kthyer mbrapsht nga "Ava Studio", për shkak se ajo pret që një ditë ta marrë shërbimin.**

E pyetur nëse ka qenë ndonjë te zyrat e "Ava Studio" shpk, deklaruesja shprehet se nuk kishte qenë dhe nuk i dinte se ku janë.

Deklaruesja pohon se ka qenë ajo që ka ndjekur gjithë aspektin juridik të shoqërisë së bashkëshortit të saj Elman Abule, "Rametal" shpk, pasi ka qenë juriste nga viti 2010-2019. Më pas, deklaruesja është larguar për të hapur kompaninë e saj që është një zyrë ligjore, duke ofruar shërbime konsulence në këtë fushë. Për këto shërbime që i ofron kompanisë së bashkëshortit të saj, deklaruesja shprehet se lëshon një faturë mujore prej 1.000 euro, të cilat nuk i paguhen rregullisht.

Në lidhje me kompaninë "Arts Lab" deklaruesja shprehet se është e dajës së Ajola Xoxës, por nuk ka asnjë marrëdhenie tregtare me të. **Përsa i përket "Rametal" shpk, deklaruesja shprehet se ka sponsorizuar dy evente të "Arts Lab". Këtë fakt e di pasi ka biseduar me bashkëshortin e saj dhe vendimmarrja ka qenë e tij.**

Në lidhje me Greta Domin, deklaruesja shprehet se e njeh pasi punon në zyrën e Ajola Xoxës. Me këtë shtetase ka kryer disa shërbime juridike, të cilat nuk i mban mend mirë të gjitha. Në lidhje me arsyen e marrjes ndihmë nga kjo shtetase, ndërsa vetë ka një studio ligjore dhe është e kualifikuar, deklaruesja shprehet se ndoshta nuk ka patur atë kapacitet juridik për konsulencat që ka patur nevojë ato momente.

Në lidhje me shërbimet që kërkoheshin nga "Partners Law" për "Rametal" shpk, deklaruesja shprehet se për shkak të afërsisë fizike të zyrave, ajo shkonte herë pas here për t'u konsultuar me Ajola Xoxën në lidhje me problematikat që kompanitë e bashkëshortit të saj kishin. E pyetur në lidhje me vlerën e paguar nga bashkëshorti i saj për "Partners Laë", deklaruesja shprehet se nuk e di.

Në lidhje me shoqërinë e saj "Sapientia" shpk, deklaruesja shprehet se ka kërkuar shërbimet e Ajola Xoxës për aplikimin për një leje për ndërtimi e një Eulike. Herën e parë aplikimin e ka bërë vetë deklaruesja, por ka dështuar. Aplikimin e dytë e ka bërë me ndihmën e Ajola Xoxës dhe këtë rast ka arritur ta marrë licensën që kërkonte. Kjo, pasi Ajola Xoxa e njihte ligjin e fushës në mënyrë perfekte.

E pyetur në lidhje me çmimin e dakordësuar, deklaruesja shprehet se nuk e mban mend, por i kujtohet që "Sapientia" ka faturuar "Ventus" shpk (kompani e shtetasit Elman Abule) dhe "Partners Law" ka faturuar "Sapientia" për konsulencën e dhënë.

E pyetur nëse shërbimi i dhënë për aplikimin e kryer nga shtetësja Ajola Xoxa është dokumentuar, deklaruesja shprehet JO, nuk ka dokumente të shkruara. Kjo, pasi ajo

> personalisht ka vajtur dhe është konsultuar për bërjen e dokumenteve pasi kërkonte të merrte eksperiencë nga Ajola në këtë fushë.
>
> E pyetur në lidhje me marrëdhënien që ka me shtetasen Ajola Xoxa, deklaruesja shprehet se e ka shumë shoqe dhe mendon se dhe ajo e ka shumë shoqe gjithashtu. Në dijeninë e saj, deklaruesja shprehet se të gjitha detyrimet ndaj shtetases Ajola Xoxa përsa i takon "Sapentia" dhe "Ventus" janë likujduar.
>
> E pyetur në lidhje me shoqërinë "Jedas" ose "Doma & Co", deklaruesja shprehet se nuk e njeh.
>
> E pyetur në lidhje me blerjet online që kryen mesatarisht gjatë një viti, për nevoja të saj personale, deklaruesja shprehet se ato nuk kalojnë shifrën e 2-3.000 euro në vit. [...]

**141.1.** Sipas organit procedues, në përmbledhje të deklarimeve të shtetases Marisa Nito, rezulton se pjesa më e madhe e tyre nuk mbështetet në rrethanat e faktit duke rënë në kundërshtim me rezultatet e deritanishme të hetimit paraprak. Paraprakisht, deklaruesja konfirmoi edhe njëherë faktin që shtetësja Ajola Xoxa kontakton me personat e thirrur nga organi procedues. Edhe pse e kualifikuar në profesionin e saj duke përfunduar studimet në një nga universitetet më të mira të Europës, deklaruesja shprehet se i është dashur asistenca e padokumentuar e shtetases Ajola Xoxa, në fushën ligjore, dhe jo vetëm e saj, por edhe e personave fizikë që qëndrojnë në zyrën e saj. Deklaruesja konfirmon shpërndarjen e faturimeve jo sipas kërkuesit dhe ofertuesit real të shërbimit, por sipas modaliteteve të tjera që nuk kanë lidhje me situatën reale. "Sponsorizimi" i "Arts Lab" shpk, i pretenduar nga deklaruesja, në fakt nuk ka ndodhur përsa kohë kjo shoqëri e nënës së Ajola Xoxës, është tregtare fitimprurëse, por edhe përsa kohë nga faturat e lëshuara rezulton se për "Rametal" shpk është ofruar shërbim produksion video etj.

**142.** I pyetur në datë **09.01.2025**, si person që ka dijeni për veprën penale, **shtetasi Elman Abule**, bashkëshorti i shtetases Marisa Nito si dhe pronar i disa kompanive si Rametal Shpk, Ventus Shpk, Fidalba Shpk, shpjegon ndër të tjera se: **[...]**

> Bashkëshortja e tij ka qenë e punësuar si juriste pranë shoqërisë Rametal në vitet 2011-2019, e më pas ka hapur një shoqëri tregtare me emrin Sapientia Shpk, ku ofron të njëjtin shërbim juridik (konsulencë ligjore).
>
> Në lidhje me marrëdhënien tregtare Rametal-Sapientia, deklaruesi shprehet se nuk kanë një tarifë fikse për shërbimin e ofruar nga bashkëshortja e tij. Ky shtetas shpjegon se për kompaninë e tij "Rametal", kohët e fundit të gjitha shërbimet juridike mbulohen nga Marisa.
>
> Ekonomiste e shoqërisë Rametal, por edhe e shoqërive të tjera të tij, Elman Abule deklaron se është Xheni Çeno, por njëkohësisht ka edhe ekonomistë te jashtëm, dy shoqëric "G&A" dhe "RSM". Deklaruesi shpjegon se Xheni Çeno merret me kryerjen e pagesave, regjistrimin e tyre në sistemin kontabël dhe tatimor. **Ndërkohë, shpjegon se për vendimmarrje të mëdha financiare, për pagesat e faturave në vlera të mëdha vendos vetë ai, ndërkohë që për pagesa të vogla i lë një buxhet të caktuar ekonomistes me qëllim kryerjen e pagesave.**

Deklaruesi shprehet *se me shtetasen Ajola Xoxa njihet sepse, kjo e fundit me bashkëshorten e tij janë shoqe të ngushta.* Tregon *se 4-5 vitet e fundit ka patur marrëdhënie tregtare me Ajolën, pasi ajo i ka ofruar shërbime ligjore kompanive të tij.* Për këto shërbime, *tregon se ka biseduar me Ajolën në prezencë të Marisës.* Shërbimet ligjore *i merrte për rastet kur Marisa nuk merrte përgjegjësi, për çështje të mëdha.* I pyetur në lidhje me një shërbim konkret ku evidentohet shërbimi i Ajola Xoxës, *sqaron së është rasti kur ajo ka dhënë konsulencë për blerjen e një prone që ka kushtuar 1 milion euro.* Për këtë shërbim *nuk e mban mend pagesën*, por tregon *se ka ofruar konsulencë në hartimin e kontratës së shit-blerjes së pronës dhe janë draftuar disa kontrata duke qenë se historia e pronës ka qenë e gjatë.* I pyetur *nëse konsultimet janë dokumentuar, pra, nëse ka patur dokumenta të shkruara*, deklaruesi shprehet *se për këtë gjë duhet të pyetet Marisa.*

I pyetur për të gjitha faturat e lëshuara nga Partners Law, ku blerës shfaqet kompania Rametal Shpk, Elman Abule ka shpjeguar *se këto fatura bëjnë fjalë për pronën e blerë nga shoqëria Rametal, nëpërmjet shoqërisë Alfemet, proces i cili ka nisur që në vitin 2015 dhe ka përfunduar në vitin 2022.* Shpjegon *se faturimet e vitit 2023, për të cilat pyetet, lidhen me përpilimin e kontratave të shitblerjes që ishin bërë nga e para, dhe ka qenë rast i komplikuar.* Për këtë pronë, ai tregon *se është faturuar edhe nga Greta Domi, e cila është avokate pranë zyrës së Partners Law, por që me të nuk njihet dhe nuk ka marrëdhënie shoqërore.*

I pyetur mbi dokumentimin e konsulencës së dhënë nga Partners Law për vitet 2021-2023, për takime, emaile, procesverbale apo akte të tjera, shtetasi Elman Abule ka treguar *se nuk e mban mend dhe i duhet të konsultohet me dokumentet.* Ky shtetas ka shpjeguar *se me Ajolën ka patur takime të përgjithshme, ku ndër të tjera ka diskutuar edhe për çështjet e tij që ndiqeshin nga ajo.* Sqaron se di që zyrat e Ajolës janë te Pallati Sky Tower, por *nuk ka qenë asnjëherë në ato zyra dhe nuk e di katin.* Çmimet me kompaninë Partners Law deklaron se janë negociuar nga Marisa Nito (*bashkëshortja*).

I pyetur në lidhje me shtetasen Valbona Xoxa, apo me marrëdhëniet tregtare me të, *deklaruesi ka shpjeguar se ajo është nëna e Ajolës dhe është pianiste. Ka treguar se ai i ka kërkuar Marisës që të merret me publicitetin e shoqërisë Rametal, dhe Marisa i ka thënë se Valbona Xoxa ka disa njerëz që e bëjnë këtë punë shumë mirë.* Elman Abule tregon *se kishte vendosur që të rifreskonte web-siten, të bënte kartëvizita, të bënte imazh për kompaninë.* Për kompaninë e Valbonës, deklaruesi shpjegon *se nuk e di se si quhet.* Tregon *se për këtë gjë nuk është takuar me Valbonën dhe se për çmimin ka negociuar Marisa.* Është pyetur për faturat tatimore ndërmjet Rametal dhe kompanisë së Valbona Xoxa, dhe deklaron se *janë për shkak të shërbimit që kishte kërkuar, produkti i së cilës nuk është marrë ende.* **I pyetur mbi arsyet pse nuk është marrë shërbimi për faturat në total 38,000 euro, deklaruesi ka shpjeguar** ***se Marisa ishte marrë me këtë çështje por ka patur probleme shëndetësore dhe është lënë pas dore, pavarësisht se shoqëria Rametal e ka vazhduar aktivitetin e saj.***

I pyetur për kompaninë Arts Lab, Elman Abule ka deklaruar *se në dijeninë e tij pronar është një kushëri i Ajolës, emrin e të cilit nuk e kujton.* **Sqaron** *se zyrat nuk i di se ku janë.* Shpjegon se *nuk ka marrë ndonjëherë shërbim nga Arts Lab, por i ka financuar (sponsorizuar) dy shfaqje, llojin dhe vlerën e së cilës nuk e di por i është kërkuar nga Marisa dhe ajo është marrë me këtë gjë.*

Është pyetur në lidhje me shërbimin që i ka ofruar Teatrit të Operas dhe Baletit, dhe shpjegon *se do të zhvillohej një shfaqe artistike dhe Rametal ka mbuluar logjistikën.* ***Shfaqjen nuk e di kush e organizonte.*** Tregon *se është organizuar me urgjencë pasi kështu ia ka kërkuar Marisa, e cila kishte biseduar me Ajolën.* Ka sqaruar *se pagesat e marra nuk i mban mend dhe nuk e di se çfarë ka ndodhur me shumën e arkëtuar.*

Deklaruesi shpjegon se *me Bashkinë Tiranë* ***ka marrë*** *një leje* ***ndërtimi*** *me anë të* ***shoqërisë Fidalba, sipas së cilës do të ndërtojë një pallat në zonën e Kombinatit.*** Shpjegon *se Leja është zbardhur por punimet nuk kanë nisur akoma për shkak të problematikave që ka me banorët e zonës.*

I pyetur për pagesat e realizuara nga shoqëria e tij Ventus me përfitues Partners Law, deklaruesi shpjegon *se janë pagesa për konsulencën për marrjen e liçensës për veprimtari prodhuese energjie nga ERA, projekt që do të zhvillej në Pukë.*

**I pyetur për marrëdhënien me shtetasin Erion Veliaj, deklaruesi ka shpjeguar** *se e konsideron shok dhe në gjykimin e tij, mendon se edhe Erioni e konsideron shok.* **Sqaron** *se bashkëshortet e tyre janë shoqe me njëra tjetrën.* **Po kështu, ka treguar** *se me shtetasin Erion Veliaj ka bërë disa udhëtime jashtë vendit, si në Tokio, Itali, Angli, Hollandë, Ukrainë.* Në lidhje me këto udhëtime deklaruesi ka dhënë edhe detaje, duke shpjeguar *se udhëtimi për në Tokio është bërë para vitit 2020, kanë qëndruar 4-5 ditë.* **Deklaruesi shpjegon** *se kanë udhëtuar të katërt, pra, Erioni, ai vetë dhe bashkëshortet e tyre.* Udhëtimi është bërë në itinerarin Tiranë-Stamboll-Tokio. Shpjegon se *secili ka paguar shpenzimet e tij.* Elmani Abule mohon t'i ketë paguar ndonjë gjë Erionit. Gjithashtu, deklaruesi shprehet se *nuk mban mend nëse nga Tirana në Stamboll kanë udhëtuar së bashku me bashkëshortët Veliaj-Xoxa, por di me siguri që nga Stambolli për në Tokio kanë qenë në të njëjtin avion.*

**Në lidhje me udhëtimin në Kiev, deklaruesi** ***sqaron se shtetasi Erion Veliaj do të zhvillonte një takim me kryetarin e Bashkisë së Kievit, dhe në këtë udhëtim shpjegon se shkoi edhe ai për qejf.*** Deklaruesi shpjegon *se nuk ka marrë pjesë në takimet e zhvilluara nga Erioni në Kiev.* Shpjegon gjithashtu *se kanë qëndruar në të njëjtin hotel në Kiev.* Shpenzimet e tij, Elman Abule tregon *se i ka mbuluar vetë, ndërsa për Erionin nuk ka dijeni pasi ai ishte me vizitë zyrtare.* **[…]**

**142.1.** Sipas organit procedues, në përmbledhje të deklarimeve të këtij shtetasi, rezulton se pjesa më e madhe e tyre nuk mbështetet në rrethanat e faktit dhe bien ndesh, si me aktet e administruara në fashikull ashtu edhe me deklarimet e shtetases Marisa Nito, bashkëshortja e deklaruesit. Deklaruesi pretendon për shumë episode që lidhen me aktivitetin tregtar të "Rametal" shpk se nuk ka dijeni ose nuk i mban mend, për shkak se me to është marrë Marisa. Ndërkohë që kjo e fundit, në deklarimet e saj, kur binte fjala për kompaninë

SPYETUET.AL

"Rametal" shpjegonte se duhej të pyetej bashkëshorti i saj, pasi ai është administratori. Deklaruesi edhe pse pranon fillimisht që shërbimet ligjore mbuloheshin për "Rametal" nga bashkëshortja e tij, ripozicionohet më pas në deklarimet e tij duke thënë që për gjëra "të mëdha" ai kërkonte ndihmën e Ajola Xoxës. Kjo ndihmë, sipas deklaruesit, jepej nëpërmjet konsultimeve që Ajola bënte me Marisën. Në kundërshtim me aktet e administruara në fashikull, deklaruesi shprehet se ka sponsorizuar në dy evente kompaninë "Arts Lab" të cilën e njeh që i përket një kushëriri të Ajola Xoxës (në fakt daja i kësaj të fundit). Nga dokumentet e administruara, rezulton që në fakt kompania në fjalë e ka faturuar "Rametal" shpk për shërbimë të kërkuara nga kjo e fundit. Kjo, të paktën sipas përshkrimit të bërë në faturat përkatëse. Deklaruesi nuk ka dijeni si kanë kaluar lekët e përfituara nga TKOB, si pagesë qiraje për "Rametal", në llogarinë bankare të "Partners Law" shpk. Deklaruesi shprehet se ka udhëtuar në shumë raste jashtë shtetit me kryetarin e Bashkisë Tiranë, si vetëm me të ashtu edhe me bashkëshortet respektive. Një udhëtim turistik i bërë në Tokio, Japoni, sipas deklaruesit, është paguar secili më vete. Të gjitha shpenzimet që lidhen me avionin dhe qëndrimin në hotel për një periudhë prej 4-5 ditësh të shtetasit Erion Veliaj dhe Ajola Xoxa, janë paguar prej tyre, dhe deklaruesi sqaron se ai ka paguar vetëm shpenzimet e tij dhe të bashkëshortes. Në lidhje me udhëtimin në Kiev, Ukrainë, deklaruesi pohon se ka shkuar atje "për qejf", së bashku me kryetarin e bashkisë i cili ishte për një vizitë zyrtare. Të dy kanë qëndruar në të njëjtin hotel dhe sipas deklaruesit, shpenzimet kanë qenë të ndara.

**143.** I pyetur në datë **09.01.2025** si person që ka dijeni për veprën penale, **shtetasi Gentian Sula** ndër të tjera ka shpjeguar se: **[...]**

> Ndër vite ka ushtruar aktivitetin e tij profesional kryesisht në sektorin e sigurimeve dhe biznesit, duke mbajtur pozita të ndryshme menaxheriale dhe pronësore. Ai ka filluar karrierën e tij pranë kompanisë Intersig Vienna Insurance Group, një shoqëri e krijuar nga prindërit e tij. Fillimisht, ka shërbyer si Drejtor Marketingu dhe aktualisht ushtron funksionin e anëtarit të bordit, duke pasur një rol strategjik në drejtimin e saj.
>
> Gjithashtu deklaruesi shpjegon *se është i lidhur me disa shoqëri të tjera të cilat operojnë nën ombrellën e "Noa Holding". Ky grup përfshin kompani si Noa Control, e cila bashkëpunon me shoqërinë ndërkombëtare gjermane Dekra në fushën e kontrolleve dhe inspektimeve teknike; Noa Inspekt, që administron një koncesion për matësit e karburantëve nga Ministria e Financave; si dhe shoqëri të tjera si Zip Cloud, Kiss FM, Noa Energy Trade, dhe Sole 24, të cilat operojnë në sektorë të ndryshëm, përfshirë tregtinë e energjisë dhe mediat.* Ai ka qenë gjithashtu aksioner në Century 21, ndërsa aktualisht është përfshirë në Era Real Estate, duke vazhduar angazhimin e tij në sektorin e pasurive të paluajtshme.
>
> Lidhur me pasuritë e paluajtshme, shtetasi Gentian Sula deklaron *se zotëron një apartament dhe është bashkëpronar i një vilë së bashku me bashkëjetuesen e tij dhe familjarët e saj.* Ai sqaron se kjo pronë, përpara se të bëhej edhe ai bashkëpronar, ka shërbyer për qiradhënie, duke përfshirë përdorimin nga kompani si Vodafone Albania. Sipas tij, nuk disponon të dhëna konkrete lidhur me vlerën e qirave të mëparshme, *por në vlerësimin aktual, kjo pronë mund të prodhojë një të ardhur mujore prej 5,000 deri në 6,000 euro.*

SPRETUAR.AL

Në lidhje me njohjen me shtetasen Ajola Xoxa, veprimtaritë kulturore dhe sponsorizimet, shtetasi Gentian Sula deklaron se ka njohur shtetasen Ajola Xoxa që prej vitit 2010, përmes bashkëjetueses së tij, Besiana Antoni. Ai deklaron *se sponsorizimet janë bërë nga shoqëria Intersig Vienna Insurance Group. Janë bërë me transferta bankare. Mban mend që sponsorimet kanë qenë në vlerën 1,400,000 lekë për Qendrën Harabel ndërsa për Nan Gallery është dhënë ndërtesa pra Vila në rrugën Ibrahim Rrugova. Ambienti i brendshëm i kësaj vile i është dhënë Nan Gallery pasi ka biseduar drejtpërdrejtë me Ajolën dhe i ka ofruar që ti vë në dispozicion këtë ambient për aktivitete artistike sociale pra që nuk kanë për qëllim përfitimin.* VIG është grupi lider në Europën Qendrore dhe Lindore dhe promovon shumë artin dhe aktivitetet sociale. Godina ku është VIG në Austri ka në Galeri shumë të famshme dhe orientimi i këtij grupi ka qenë gjithmonë i orientuar për sponsorizime për artin. ***Kjo vilë ka qenë e rrënuar pra në gjendje të keqe strukturale dhe unë ja dhashë Nan Gallery për të promovuar artin dhe në këmbim të reklamimit të logos.***

Shtetasi Gentian Sula shton se, *përpara përdorimit të kësaj vile nga Nan Gallery, ai ka kryer vetëm riparimin e çatisë, ndërsa pjesa tjetër e mirëmbajtjes dhe përshtatjes së ambienteve është realizuar nga vetë Nan Gallery.* Sipas tij, ndërhyrjet kanë qenë kryesisht kozmetike, jo strukturore, si lyerja dhe disa përmirësime të tjera të vogla. *Di që për rreth tre vjet e kanë mirëmbajtur godinën përfaqësuesit e Nan Gallery.* Ai shprehet i gatshëm të vërë në dispozicion kontratën midis Nan Gallery dhe Vienna Insurance Group, ku janë përcaktuar kushtet e bashkëpunimit dhe përdorimit të pronës.

Në vijim, deklaron se lidhur me punimet *(riparimet e çatisë) në pronën e tij të përdorur nga Nan Gallery*, nuk e mban mend se kë ka kontraktuar për kryerjen e tyre. Lidhur me marrëdhënien e tij me ish-administratorin e Nan Gallery, shtetasin Orianl Zeneli, ai deklaron *se e njeh vetëm nga larg, ndërsa marrëdhëniet e punës janë mbajtur nga stafi i tij. Për administratorin aktual të Nan Gallery, ai shprehet se nuk e njeh.*

Shtetasi Gentian Sula sqaron *se kontrata e lidhur me Nan Gallery Shpk nuk është noterizuar, pasi nuk është praktikë e tij që të kryejë kontrata me noter.* Ai pohon *se qëllimi i dhënies së pronës shtetases Ajola Xoxa ka qenë për organizimin e eventeve artistike.* Sa i përket kohës kur kjo pronë është dhënë për përdorim, ai deklaron *se nuk e mban mend vitin e saktë, por duhet të ketë qenë në vitin 2021 ose 2022.* Megjithëse prona është përdorur për organizimin e eventeve, *ai shprehet se nuk ka qenë i pranishëm në asnjë prej tyre.*

Lidhur me pronat, shtetasi Gentian Sula deklaron se hera e fundit kur ka blerë një pronë të paluajtshme ka qenë në nëntor të vitit 2024. Transaksioni është realizuar përmes bankës dhe është finalizuar me një kontratë të noterizuar. Kjo pronë më pas i është kaluar motrës së tij.

**Në lidhje me shumën prej 115,000 Euro të gjetur në ambientet e shoqërisë Partners Law Shpk, shtetasi Gentian Sula deklaron *se kjo shumë i është dhënë si kapar shtetases Ajola Xoxa. Ai sqaron se kartëmonedhat kanë qenë kryesisht euro***

SPAK

*(specifikisht prerje 500 euro), por kanë përfshirë edhe dollarë. Shumat monetare ai i ka mbajtur në shtëpi, të tërhequra nga banka ndër vite dhe nga këmbimi valutor pranë pikës "Flamuri" te Libri Universitar. Ai pohon se kishte më shumë se dy vjet që i mbante këto shuma. Për sa i përket bankave ku ka depozituar apo tërhequr para, shtetasi Sula përmend Credins Bank, OTP Bank, dhe Intesa San Paolo Bank, llogaria e kësaj të fundit jo më aktive.*

Kur iu prezantua një dokumentacion (distinë që shërben për lidhjen e parasë) me vulën sipër saj të Union Bank, deklaruesi *mohoi lidhjen me këtë dokument, duke sqaruar se nuk ka kryer tërheqje pranë kësaj banke.* Lidhur me pyetjen nëse ka pasur raste të këmbimeve valutore me destinë, *ai konfirmon se mund të ketë qenë rasti në fjalë.*

Shtetasi Gentian Sula sqaron *se gjatë dorëzimit të shumës monetare në 4 dhjetor, ai ka qenë i vetëm në takim me shtetasen Ajola Xoxa dhe për këtë arsye nuk ka pasur ndonjë person të tretë prezent. Ai shpjegon se kishte planifikuar ta formalizonte procesin me noter, por për shkak të udhëtimit të planifikuar jashtë vendit, nuk kishte kohë ta realizonte.*

Lidhur me nxitimin për dorëzimin e shumës, ai *deklaron se kjo ishte për shkak të planit të shtetases Ajola Xoxa për të blerë zyra dhe për t'u zhvendosur në ambiente të tjera. Shumat monetare, të futura në një qese, janë dorëzuar në zyrën e saj. Gjithashtu sqaron se nuk ka bërë blerje të tjera cash në vlerë të konsiderueshme.*

Përsa i përket kontratës së kaparit ndërmjet tij dhe shtetases Xoxa, në të cilën është përcaktuar shuma prej 220,000 euro, shtetasi Gentian Sula sqaron *se kontrata kushtëzohej nga procesi i rivlerësimit, për të cilin ata prisnin daljen e një ligji përkatës.* Ai deklaron se situata nuk e favorizonte vazhdimin e marrëdhënies dhe *se kohët e fundit i ka kërkuar shtetases Ajola Xoxa të revokojë kontratën.*

Lidhur me prokurimet e realizuara pranë Bashkisë Tiranë, shtetasi Gentian Sula deklaron *se kompania Noa Control, ku ai është pronar, ka marrë pjesë në një tender të hapur, të ndjekur nga administratori i tij Kledia Stefani. Ai sqaron se Noa Control ka zotëruar 35% të tenderit, ndërsa 65% i është zotëruar nga kompania MSCertification. Tenderi, me një vlerë të përgjithshme prej 530,000 euro, është lidhur me autoritetin kontraktor Bashkia Tiranë më datë 31 janar 2023. Nuk mban mend nëse kjo shoqëri ka patur kontrata me institucione të tjera në varësi të Bashkisë Tiranë.* **[...]**

**143.** Sipas organit procedues, në përmbledhje të deklarimeve të bëra nga shtetasi **Gentian Skënder Sula,** rezulton se pjesa më e madhe e tyre nuk mbështeten në rrethanat e faktit të dokumentuara nga aktet e administruara në fashikullin penal. Një pjesë tjetër e tyre provojnë marrëdhënien e krijuar mes këtij shtetasi dhe shtetases Ajola Xoxa, kur bëhet fjalë për dhënien pa shpërblim të një vile. Deklaruesi shprehet se ka qenë ai që i ka propozuar Ajola Xoxës të marrë në përdorim një vilë, pa paguar qira për shfrytëzimin e saj për interesa të artit. Megjithëse deklaruesi shprehet se kompania e sigurimeve ku ai është aksioner është promovuese e artit, konstatohet se në rastin e vilës, ky objekt nuk i përket kompanisë por disa

individëve në cilësinë e bashkëpronarëve. Këta të fundit para dhënies në përdorim të vilës e kishin dhënë atë me qira, nga ku përfitonin shuma të konsiderueshme. Kjo, edhe për shkak të pozicionit mjaft të mirë të ndërtesës, në një nga zonat me të shtrenjta të kryeqytetit. Këta individë, mes të cilëve dhe bashkëshortja e shtetasit Gentian Sula, kanë dhënë dakordësinë, sipas deklaruesit, pa asnjë akt të shkruar për të dhënë në huapërdorje pa kundërshpërblim objektin në fjalë. Pas kontrolleve të ushtruar nga Prokuroria e Posaçme, kjo e drejtë e dhënë gojarisht, është revokuar me një akt të shkruar.

**143.1.** Gjithashtu, sipas organit procedues në lidhje me dhënien e të hollave për qëllime kapari, me një akt privat (jo noterial) të përpiluar vetëm një ditë para vendimit të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për kontrollin e ambienteve, të paraqitur pranë kësaj gjykate gjatë seancës për heqjen e sekuestros, konstatohet se duke marrë në konsideratë prerjen e kartmonedhave euro (prerja 500) dhe përzierjen e tyre me kartmonedha të ndryshme, si USD etj, si edhe duke patur parasysh marrëdhënien mes këtyre shtetasve, ngrihen dyshime të arsyeshme të bazuara në prova se ato (të hollat) nuk i përkasin vlerës të ndonjë kontrate shitblerje, por kanë qenë në posedim të shtetases Ajola Xoxa kohë më parë. **Këtu duhet të kihet në konsideratë dhe fakti që Ajola Xoxa në momentin e parë të kontrollit i ka thënë hetuesve se shumat e parave vinin nga trashëgimia e babait.** Në fund, deklaruesi pohon të këtë përfituar fonde publike nga Bashkia Tiranë, por si bashkim operatorësh me një shoqëri tjetër.

**144.** I pyetur më datë **16.01.2025** si person që ka dijeni për veprën penale, **shtetasi Armand Manahasa**, shpjegon ndër të tjera se: [...]

> Nga muaji Shkurt i vitit 2019 deri në Nëntor të vitit 2021 ka qenë i punësuar si shofer personal i shtetases Ajola Xoxa. Këtë shtetase e njeh nëpërmjet babait të saj Arben Xoxa, i cili ka vdekur në muajin Shkurt të vitit 2019.
>
> Shtetasi Armand Manahasa ka shpjeguar *se e ka shoqëruar shtetasen Ajola Xoxa, përveç shtëpisë së saj tek "Kodra e Diellit" dhe zyrat në "Sky Tower"*, ***edhe në fshatin Qerret, tek një vilë brenda kompleksit "Marea"***. Deklaruesi shprehet *se ka filluar të shoqërojë shtetasen Ajola Xoxa dhe nënën e saj në Qerret, tek kompleksi në fjalë, në periudhën 2019-2020*. Gjithashtu, në disa raste *ka shoqëruar dhe pastruesen e saj që quhej Ela*. Deklaruesi shprehet *se shpesh ka transportuar në vilën brenda kompleksit edhe sende personale shtëpiake si edhe rroba të ndryshme.*
>
> I pyetur *nëse ka shoqëruar ndonjëherë shtetasin Arben Xoxa tek vila në Qerret*, deklaruesi shprehet ***se nuk ka qenë asnjëherë atje me këtë shtetas dhe as nuk e ka dëgjuar ndonjëherë të përmendej kjo vilë prej shtetasit Arben Xoxa.***
>
> I pyetur rreth një mesazhi të shkëmbyer me shtetasin Olsi Efthimi më datë 16.07.2020, *ku i drejtohet duke e pyetur "Do shkoni në Qerret sot?", të cilit Olsi Efthimi i përgjigjet "Jo nuk do shkojmë se ka ditëlindjen"*, deklaruesi shprehet se komunikimi është bërë me këtë shtetas *pasi ai shoqërohej herë pas here me Ajola Xoxën, dhe në dijëninë e tij shkonte (Olsi Efthimi) tek vila në Qerret, pasi merrej me arredimin e saj, me punë dhe aspekte të tjera.*
>
> I pyetur nëse kishte qenë në ambientet e brendshme të banesës së shtetases Ajola Xoxa, deklaruesi shprehet se nuk ka qenë asnjëherë. Deklaruesi ka shtuar *se banesa*

ndodhej në katin e dytë të banimit, ndërsa në katin tjetër sipër katit të banimit ku banonte Ajola, ajo po kryente punime të cilat ndiqeshin nga shtetasi Olsi Efthimi.

Në lidhje me sa më lart, është proceduar me këqyrjen e aparatit celular të shtetasit Armand Manahasa, i sekuestruar në zbatim të vendimit të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar nr. 56 datë 15.01.2025. Nga këqyrja e dokumentuar me procesverbalin e datës 17.01.2025 rezulton ndër të tjera se në aparatin celular të këtij shtetasi është i regjistruar numri i telefonit **+355672020124,** i cili përdoret nga shtetësja Ajola Xoxa. Me këtë numër, rezulton që shtetasi Armand Manahasa ka patur biseda, të cilat fillojnë me datë 26 gen 2021 (26.01.2021), ndërsa komunikimi i fundit është realizuar me datë 6 ott 2023 (06.10.2023).

Nga këqyrja konstatohen komunikime të ndryshme te realizuara me mesazhe të shkruar dhe zanore. Në aplikacionin të WhatsApp konstatohet se gjënden komunikime që i përkasin datës 1 nov 2021 (01.11.2021). Konkretishtt, **numri +355672020124 (Ajola Xoxa), i dërgon Armand Manahasës mesazh zanor me kohëzgjatjë 0:10 sekonda në orën 11:49.** Mesazhi ka përmbajtjen sa vijon: ***"Mandi kur ti sjellësh varëset, rri lëri këtu te dera, është dhe Ela këtu te shpia. Ndërkohë po vjen Olsi që të inspektojë punimet lart, kështu që do hypi edhe unë lart e do zbres me Olsin, kshuqë vazhdo ti pa merak."***. Shtetasi Armand Manahasa në orën 11:49, përgjigjet me mesazh të shkruar ***"Ok"***.

Me datë 11 nov 2021 (11.11.2021), konstatohet që numri **+355672020124, i** dërgon Armand Manahasës, mesazh skeda kontaktesh (numra kontaktesh) me tekst Juxhini Agikons Marea e altri 3 contatti. Klikohet te shigjeta në të djathtë të skedës ku më pas na shfaqen 4 (katër) kontakte, ku pasi klikojmë mbi emrat na shfaqen numrat sa vijon:

1. ***Juxhini Agikons Marea me numër +355684016555***
2. *Dinepi Dyqan Bllok (Madi, Majli) me numër +355672003578*
3. *Franka Anima me numër +355693282560*
4. *Shpetim Baca me numër +355694570803*

Më pas në të njëjtin aplikacion konstatohen dhe këqyren bisedat e zhvilluara me kontaktin e regjistruar me emrin **"Olsi Eftimi"**, me numër telefoni **+35569204662б.** Këtij të fundit, më datë 16 lug 2020 (16.07.2020), shtetasi Armand Manahasa i dërgon mesazhe të shkruara në orën 10:51, me përmbajtjen sa vijon:

*Olsi Pershendetje!*
*Do shkoni ne Qerret sot ?*
*Po me pyesin shoqet e Ajoles*
*Do dali zdo dali*
*Se duan ti bejne nje surprize*

Kontakti "Olsi Eftimi" i përgjigjet me mesazh të shkruar në orën 10:52, me përmbajtjen sa vijon:

*Pershendetje! Jo nuk do shkojme se ka ditelindjen*
*Po me tha Xhoi*

**144.1.** Sipas organit procedues në përmbledhje të deklarimeve të shtetasit Armand Manahasa, rezulton edhe njëherë se vila e ndodhur në Qerret, kompleksi "Marea Resort" është në pronësinë faktike të familjes Veliaj-Xoxa. Nga këto deklarime rezulton se edhe pse ka qenë shofer i shtetasit të ndjerë Arben Xoxa, Armand Manahasa nuk ka qenë kurrë në vilën e Qerretit para vitit 2019. Kujtojmë këtu se nga shtetasit nën hetim pretendohet se kjo vilë është blerë në vitin 2017 nga prindërit e shtetases Ajola Xoxa. Për herë të parë, shpjegon deklaruesi, në vilë është shkuar në vitin 2019-2020. Po ashtu, Armand Manahasa nuk ka dëgjuar asnjëherë të flitet për këtë vilë nga shtetasi i ndjerë Arben Xoxa.

**141.1.1.** Gjithashtu, shtetasi Olsi Efthimi nga këto deklarime, por edhe nga të dhëna të tjera, duket se është personi që ka ndjekur punimet për arredimin por edhe ndërtim të më shumë se një pasurie të paluajtshme që dyshohet se zotërohen nga bashkëshortët Veliaj Xoxa. **Ky shtetas rezulton të ketë shkuar në vilën e Qerretit për t'u marrë me arredimin e saj. Nga këqyrja e realizuar në telefonin celular të shtetasit Ergys Krisiko, rezulton qartë se jo vetëm** oborri i vilës, por edhe ambientet e brendshme të saj nuk kanë përfunduar akoma, të paktën deri në vitin 2020. Po ashtu, ky shtetas rezulton se ka ndjekur edhe punimet e ndërtimit në katin e tretë të ndërtesës të ndodhur tek "Kodra e Diellit", ku bashkëshortët Veliaj-Xoxa jetojnë aktualisht. Kjo rezulton si nga deklarimet e shtetasit Armand Manahasa, por edhe nga një mesazh zanor i dërguar nga Ajola Xoxa në drejtim të shtetasit Armand Manahasa, i gjendur në telefonin e këtij të fundit, sekuestruar me vendim të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar. Në këtë mesazh, shtetësja Ajola Xoxa përmend qartë që punimet në katin "sipër" po inspektoheshin nga shtetasi Olsi Efthimi. **Periudha në të cilën ky mesazh zanor është dërguar, viti 2021, përkon me informacionet e dala në median online në lidhje me një ndërtim që po kryhej mbi banesën e kryetarit të Bashkisë Tiranë, ndërtim ky mendohej të ishte pa lejen e autoriteteve kompetente.**

**142.** I pyetur më datë **16.01.2025** si person që ka dijeni për veprën penale, shtetasi **Valmir Xoxa** jep të dhëna me mjaft interes për hetimin, edhe pse pjesa tjetër e tyre nuk mbështetet në asnjë rrethanë të faktit. Ky shtetas është kushëri i Ajola Xoxës, konkretisht djali i xhaxhait të saj. Ky shtetas ndër të tjera deklaron se: **[...]**

> *I vetmi punësim zyrtar është ai i pedagogut pranë Akademisë së Arteve, ku merr një pagë neto prej rreth 92,000 lekë.* Të ardhura të tjera lidhen me organizimin e kurseve të stretching, tenisi, të cilat nuk janë të dokumentuara me kontrata, sigurime shoqërore, derdhje bankare etj. Gjithashtu, ***ky shtetas është i punësuar në bandën frymore të Bashkisë Tiranë, ku paguhet me 20,000 lekë në muaj.***
>
> Deklaruesi shprehet *se nuk kanë harxhuar asnjë lek së bashku me bashkëshorten e tij për të jetuar për një kohë të gjatë, pasi shpenzimet e tyre si familje i kishte marrë persipër vjehrra e tij. Ata vetë nuk kanë shpenzuar për ushqim dhe për asgjë tjetër, pasi duhej të kursenin lekët. Vjehrra e deklaruesit blinte rrobat e së bijës vetëm, ndërsa Valmiri blinte të vetat. Çdo gjë tjetër përballohej nga vjehrra.*
>
> Deklaruesi jep një informacion shumë të rëndësishëm për organin procedues, *ndërsa shprehet se ka blerë kundrejt rreth 140.000 euro pjesën takuese të pronësisë të shtetaseve Ajola Xoxa dhe Valbona Xoxa (trashëgimtarët Arben Xoxa) në dy vila dhe truallin mbi to, në një zonë të ndodhur tek 'Shkolla e Kuqe' Tiranë*. Sipas deklaruesit,



SPOSTIME.AL

*ai do të futej në katin e tretë të njërës prej vilave.* **Pas blerjes së këtyre pjesëve takuese, deklaruesi shprehet** ***se këto dy ndërtesa janë prishur dhe sipërfaqja e truallit është dhënë për ndërtim një firme ndërtimi,*** e cila *supozohet se ka marrë lejen e ndërtimit pranë Bashkisë Tiranë.* Në këtë mënyrë, ***me shitjen e këtyre pjesëve takuese, shtetaset Ajola Xoxa dhe Valbona Xoxa dalin nga bashkëpronësia e tyre mbi truallin dhe humbasin çdo të drejtë për të përfituar më pas nga ndërtimi i pallatit.***

I pyetur në lidhje me sa ka përfituar nga dhënia e pjesës së tij të bashkëpronësisë për firmën ndërtuese, ***shtetasi Valmir Xoxa ndryshon disa herë version, por në fund përgjigjet se do të përfitojë një apartament 60 m2, një dyqan 70 m2 dhe një post parkimi.***

I pyetur *në lidhje me ndërtuesin me të cilin ka lidhur kontratën, konfigurimin e ambienteve që do të përfitonte, deklaruesi shprehet nuk ka asnjë ide dhe shton se as ka shkuar tek pallati që tashmë duket se ka përfunduar*. Kjo, sepse sipas deklaruesit, *nuk ka asnjë interes tek këto prona, pasi mendonte të ribashkohej me ish bashkëshorten.*

Deklaruesi shton se, ***në të njëjtën periudhë (rreth vitit 2020) që ka blerë këtë pasuri nga Ajola Xoxa dhe Valbona Xoxa, me lekët cash të kursyera në familje, së bashku me bashkëshorten e tij, dhe ajo gjithashtu e punësuar pranë Akademisë së Arteve, ka kërkuar dhe ka përfituar një kredi të butë pranë Bashkisë Tiranë, në shumën prej rreth 40.000 euro, me qëllim strehimin e tij familjar.***

Më pas, me këtë kredi, deklaruesi shprehet *se ka blerë një apartament tek e njëjta ndërtesë ku edhe do të përfitojë objektet e tjera të cilat do të shkëmbehen me pasurinë e blerë nga shtetaset Ajola Xoxa dhe Valbona Xoxa.*

I pyetur në lidhje *me blerjen e mjetit C Class 220, i vitit 2010, i blerë fillimisht nga shtetasi Arben Xoxa për cmimin prej 7.000 euro, dhe më pas, i shitur tek Valmir Xoxa nga Ajola dhe Valbona Xoxa, kundrejt cmimit 23.000 euro në vitin 2022,* ***deklaruesi është shprehur se çmimin e kishte caktuar ai vetë, për arsye sentimentale*** por edhe *për faktin se mjeti ishte në gjëndje mjaft të mirë, duke e cilësuar "super mjet".* Këtë mjet, deklaruesi shprehet se e *ka përdorur para se ta blinte për 2 vjet dhe gjëndja teknike ishte shumë e mirë.*

Megjithëse e ka blerë mjetin për 23.000 euro, deklaruesi shprehet *se Ajola Xoxa kishte dashur t'ja shiste poshtë çmimit aktual të pronës, por ai ka insistuar që ta blinte me çmimin e mësipërm.*

I pyetur *në lidhje me mënyrën e likujdimit të mjetit, në formë bankare apo cash, deklaruesi është përgjigjur se nuk e mbante mend.* **Ndërsa në lidhje me burimin e këtyre të ardhurave,** ***deklaruesi është përgjigjur se edhe ato kanë qenë kursime të tij.*** Gjithashtu, deklaruesi shprehet *se blerja e mjetit është bërë në kohë pas marrjes së kredisë së butë në Bashkinë e Tiranës.*

I pyetur më pas *në lidhje me shitjen e mjetit (rezulton të jetë shitur vetëm rreth 6 muaj më pas nga shtetasi Valmir Xoxa), deklaruesi është përgjigjur se nuk e mbante mend*

*kur e kishte shitur, por "super mjeti" i bëri një defekt në motor për shkak të gjendjes së mospërdorimit (më parë ishte shprehur se e kishte përdorur për rreth 2 vjet para se ta blinte).* Deklaruesi shprehet se *çmimi i shitjes ishte rreth 11.000 eur (pra, më pak se gjysma e çmimit të blerjes).* Në lidhje me këtë, deklaruesi shprehet *se arsyet që e kishin çuar të blinte mjetin me një çmim të atillë ishin zbehur për shkak të problemeve financiare (nga 2020 deri në vitin 2022 deklaruesi shprehet se ka ka patur gjendje cash kursime rreth 160.000 euro), por edhe sepse mjeti pësoi defekt dhe donte të paktën të ruante gjysmën e parave që e kishte blerë atë.*

Më poshtë, *në përmbledhje deklaruesi ka konfirmuar se ka patur 140.000 euro të kursyera në cash, me të cilat ka blerë pasurinë (deklaruesi e quan apartament në katin e tretë të njërës prej vilave) nga Valbona Xoxa dhe Ajola Xoxa. Në të njëjtën periudhë ka marrë kredinë e butë nga Bashkia Tiranë prej rreth 40-45.000 euro, me të cilën ka porositur një apartament tjetër. Gjithashtu, deklaruesi konfirmon se ka patur edhe 23.000 euro të tjera në cash, si kursime familjare, me të cilat ka blerë automjetin Mercedes Benz nga Ajola Xoxa dhe Valbona Xoxa.*

**I pyetur** *sa kursime ka patur në euro dhe sa në lekë, deklaruesi përgjigjet se nuk e mbante mend.* **Deklaruesi gjithashtu** *nuk mban mend se kur ka qenë momenti kohor që ka patur vlerën më të madhe të parave cash në banesë.* **Megjithatë, sipas deklaruesit, në kohën kur ra tërmeti, në vitin 2019,** *bashkëshortja e tij ka marrë dy jastekë të vegjël brenda të cilëve ndodheshin paratë por edhe materialet përbërëse të jastekëve dhe kanë dalë me urgjencë nga banesa.*

**I pyetur** *nëse e dinte sa lekë ndodheshin brenda jastekëve, deklaruesi shprehet se nuk e dinte pasi nuk e kishte pyetur bashkëshorten.* **Duke lëvizur në vende të ndryshme gjatë ditëve të pastërmetit,** *deklaruesi shprehet se me vete kishin dhe jastekët me paratë brenda tyre.*

Deklaruesi ka konfirmuar gjithashtu *se tek pallati që po ndërtohet tek "Shkolla e Kuqe" shtetësia Ajola Xoxa dhe Valbona Xoxa nuk kanë marrë asnjë pasuri dhe tashmë përfituesi në truallin e dhënë për ndërtim do të ishte vetëm ai.* Gjithashtu, deklaruesi konfirmon faktin se *në të njëjtin objekt ka porositur edhe apartamentin tjetër, të cilin e ka blerë me kredinë e butë të dhënë nga Bashkia Tiranë.*

I pyetur në lidhje me shtetasin Olsi Efthimi, deklaruesi shprehet *se e njeh vetëm si tifoz tenisi. Ai mohon ta ketë parë ndonjëherë tek zyrat e "Partners Law". [...]*

**142.1.** Sipas organit procedues në përmbledhje të deklarime më lart, të dhënat e dobishme të cilat lidhen me hetimin konsistojnë në informacion për ndërtimin e një godine, mbi truallin ku dikur ka qenë bashkëpronare shtetësja Ajola Xoxa. Kjo e fundit, se bashku me nënën e saj Valbona Xoxa, aktualisht duket se nuk kanë më pjesë në pallatin që pritet të përfundojë, pasi bashkëpronësinë e tyre mbi truallin ja kanë shitur shtetasit Valmir Xoxa. Rrethanat e paraqitura nga shtetasi Valmir Xoxa në lidhje me këtë situatë, nuk janë të besueshme, nisur nga analiza e tyre në raport me faktet e paraqitura më lart. Konkretisht, ky shtetas duket se nuk ka asnjë mundësi ekonomike për të harxhuar një shumë të konsiderueshme të hollash (rreth 140.000 euro sipas deklarimeve të tij). Pretendimet e tij se i ka kursyer nuk kanë asnjë bazë faktike, përsa kohë të vetmet burime të ardhurash për këtë

shtetas dhe familjen e tij, provohet të jenë rrogat mujore të bashkëshortëve në Akademinë e Arteve. Aq më pak janë të besueshme këto pretendime nëse shihen deklarimet e këtij shtetasi në lidhje me mbajtjen e parave në jastëk në banesë, mungesën totale të shpenzimeve në familje për shkak se ato mbulonte vjehrra e tij, si edhe nevojën për të marrë një kredi me kushte lehtësuese.

**142.1.1.** Gjithashtu, sipas organit procedues, në të njëjtën periudhë që ky shtetas supozohet se disponontë në banesë rreth 140.000 euro kursime cash, ka aplikuar dhe ka përfituar një kredi të butë për strehim nga Bashkia Tiranë, për rreth 40.000 euro. Me këto të holla, në vend të siguronte menjëherë një strehim për vete dhe familjen e tij, deklaruesi porosit një apartament tjetër, në të njëjtën ndërtesë e cila po ndërtohet mbi truallin në bashkëpronësi të tij. Edhe sot e kësaj dite, Valmir Xoxa nuk ka hyrë në apartamentin për të cilin ka përfituar një kredi të butë nga Bashkia Tiranë, pasi objekti është ende i papërfunduar plotësisht.

**142.1.2.** Gjithashtu, sipas organit procedues pasi shpenzon rreth 140.000 euro për të blerë pjesën e bashkëpronësisë së Ajola Xoxës dhe Valbona Xoxës, deklaruesi blen nga këto të fundit, në vitin 2022, pra pas shumë pak kohe, edhe një automjet të përdorur për rreth 12 vjet, kundrejt çmimit prej 23.000 euro. Ky automjet është blerë në vitin 2016 në shumën rreth 7.000 euro nga shtetasi i ndjerë Arben Xoxa. Edhe në lidhje me këto të holla, të cilat janë derdhur cash në sistemin bankar, Valmir Xoxa shprehet se i ka kursyer dhe i ka mbajtur në banesë. Më pas, të njëjtin automjet, pas rreth 6 muaj Valmir Xoxa e shet me gjysmën e çmimit një shtetasi të quajtur Tosun Qela. Ky i fundit, vetëm pak ditë pas daljes në mediat online të shkresave të Prokurorisë së Posaçme ku evidentohej nisja e hetimeve për këtë procedim penal, pra në muajin Shkurt 2024, e shet të njëjtin automjet për çmimin rreth 2.300.000 lekë. **Pra të gjitha këto lëvizje që lidhjen me shitblerjen e automjetit sa më lart, janë fiktive dhe në funksion të futjes (injektimit) në sistemin bankar të shumës prej 23.000 euro, e cila ka kaluar në favor të shtetases Valbona Xoxa.**

**142.1.3.** Gjithashtu, sipas organit procedues duket i pabesueshëm fakti i pretenduar se kundrejt shumës prej rreth 140.000 euro, shtetaset Ajola Xoxa dhe Valbona Xoxa kanë shitur pjesën e tyre të bashkëpronësisë, duke hequr në këtë mënyrë dorë nga pasuritë që do të prodhoheshin nga ndërtimi i një objekti të ri, në një zonë të preferuar të Tiranës. Këtu duhet mbajtur në konsideratë pamundësia financiare e shtetasit Valmir Xoxa për të kursyer këtë shumë të hollash, që po të mblidhen me shumën tjetër prej 23.000 euro, kapin vlerën e rreth 160.000 euro, gjithnjë referuar deklarimeve të këtij shtetasi.

**143.** I pyetur më datë **20.01.2025** në cilësinë e personit që ka dijeni për veprën penale, **shtetasi Olsi Efthimi** shpjegon ndër të tjera se: **[...]**

*Ushtron profesionin e arkitektit dhe bën pjesë si ortak në shoqërinë tregtare "Atelier 4" shpk, me administrator shtetasin Alban Efthimi.* Gjithashtu, është ortak *edhe në një shoqëri ndërtimi të quajtur "Texas Development" shpk, e cila po ndërton aktualisht në disa kantiere, të specifikuara në procesverbal.*

*Në lidhje me shtetasen Ajola Xoxa, deklaruesi shprehet se e njeh dhe e ka shumë shoqe.* Ai *e përkufizon marrëdhenien me të si korrekte, të pastër dhe të rregullt.* Gjithashtu, deklaruesi konfirmon *se ka hyrje-dalje familjare me bashkëshortët Veliaj-*

*Xoxa, duke konfirmuar edhe banesën e tyre në zonën "Kodra e Dielli 1", tek trekëndëshi, në katin e 2.*

Gjithashtu, deklaruesi shprehet *se ka qenë tek shtëpia e prindërve të Ajolës në Qerret, në kompleksin "Marea Resort".* Deklaruesi tregon *se në këtë vilë ka qenë 4-5 herë dhe i është kërkuar nga Ajola të shkonte atje në vitin 2020-2021 për të bërë konsulta mbi lagështirën që ishte konstatuar në vilë.* Deklaruesi shprehet se e ka këshilluar që të bëhej hidroizolimi nga fillimi.

I pyetur ***nëse ka ndjekur punime të tjera në lidhje me vilën,*** *deklaruesi shprehet se mund të ketë dhënë ide që lidhen me gjelbërimin e ambientit jashtë saj.* Deklaruesi shprehet *se ai vetë nuk ka ndonjë banesë në Qerret.*

Gjithashtu, **deklaruesi** shprehet se ***në vitet 2020-2021 ka inspektuar gjithashtu apartamentin ku jetonte çifti Veliaj Xoxa,*** *sepse edhe* ***ai kishte lagështirë.*** **Për këtë** qëllim, ***gjatë inspektimit ka vënë re se mbi hyrjen e Ajolës kishte një apartament dhe tualete.*** *Deklaruesi shprehet se në këto vite kati i tretë i objektit ishte i banueshëm.*

I pyetur *në lidhje me hyrje-daljet në familjen Veliaj-Xoxa, deklaruesi shprehet se me to ai kupton kontaktet që ka patur në rastin e disa vdekjeve që kanë ndodhur tek njerëzit e afërt të tyre gjatë këtyre viteve, ndërsa ka shkuar për ngushëllim.*

Në lidhje me shtetasin Ergys Krisiko, deklaruesi *shprehet se e ka shumë shok.* Ndërsa me shtetasin Erion Veliaj, *deklaruesi shprehet se nuk ka shoqëri.*

Deklaruesi *është ballafaquar me një foto të nxjerrë nga komunikimet e tij me shtetasin Ergys Krisiko*, të gjendura në aparatin celular të këtij të fundit, të sekuestruar me vendim të prokurorit më datë 17.12.2024. **Nga foto** ***rezulton një sallon i një objekti.*** **Pasi është njohur me këtë foto,** *deklaruesi shprehet se i përket vilës së Qerretit dhe nuk i kujtohet pse ja kishte dërguar Ergysit.*

Megjithatë, në vijim të komunikimit me shtetasin Ergys Krisiko, kur është pyetur nga ky i fundit *se ku e kishte gjetur këtë foto*, deklaruesi i *është përgjigjur "në internet".* I pyetur në lidhje me këtë, *shtetasi Olsi Efthimi shprehet se nuk e mbante mend pse ja kishte dhënë atë përgjigje.*

Më pas, nga të njëjtat komunikime ***deklaruesi është ballafaquar me foto (4 të tilla) të cilat*** *i ka identifikuar si ambienti i jashtëm i vilës në Qerret*. Në lidhje me këto foto, ai shprehet se *nuk e di pse ja ka dërguar shtetasit Ergys Krisiko.*

Fotot ku pasqyrohet ambienti i jashtëm i vilës, specifikisht oborri i saj ku ndodhet edhe pishina, ***i referohen datës 09.07.2020*** dhe dëshmojnë faktin ***që punimet në këtë ambient ishin akoma të papërfunduara*****.** Pasi mer këto foto, shtetasi Ergys Krisiko shprehet *"keni bërë një gjë super". Deklaruesi, i pyetur në lidhje me këtë shprehet se nuk i kujtohet.*

Më tej, ***në lidhje me punimet që po kryheshin në oborrin e vilës,*** **nga komunikimet** rezulton se Ergys Krisiko i ka thënë deklaruesit: *"kjo do të thotë koncept arkitekturor. Të jetosh natyrën dhe brenda si të jesh jashtë".* Edhe për këtë komunikim, *deklaruesi shprehet se nuk i kujtohet por ndoshta mund të ketë bërë konceptim të oborrit, mund*

*të ketë dhënë ndonjë ide*. I pyetur *rreth vitit kur e ka vënë në zbatim këtë projekt, deklaruesi është shprehur "rreth vitit 2020"*. I pyetur kush ua kërkoi këtë koncept për oborrin e vilës, *deklaruesi shprehet se ja ka kërkuar Agi Kons.*

Deklaruesi konfirmon *se është anëtar i bordit të Harabel dhe se ka shkuar disa herë tek zyrat e kësaj organizate tek "Sky Tower"*. Gjithashtu, deklaruesi pohon se *mund të ketë dhënë ndonjë konsultë për ndonjë ngjyrë që i përket arredimit të zyrës.*

Deklaruesi konfirmon faktin *se tek "Shkolla e Kuqe", në një pasuri ku është bashkëpronar dhe fisi Xoxa, ka zhvilluar një projekt me studion e tij "Atelier 4". Bëhet fjalë për një rezidencë banimi (pallat).* I pyetur kush i ka kërkuar të bënte këtë projekt, *deklaruesi i referohet vëllait të tij, shtetasit Alban Efthimi si personi që ka dijeni për këtë fakt.* Deklaruesi konfirmon *që ka qenë studio e tij që ka bërë aplikimin në Bashki për lejen e ndërtimit.* Në lidhje *me shtetasin Valmir Xoxa, i cili bleu pjesën e bashkëpronësisë së Valbona dhe Ajola Xoxës, deklaruesi shprehet se e ka njohur tek Akademia e Arteve si edhe e ka parë tek zyrat e Harabel.*

**143.1.** Sipas organit procedues në përmbledhje të deklarimeve të shtetasit Olsi Efthimi shumica e thënieve të këtij shtetasi nuk mbështetet në rrethanat e faktit. Megjithatë, nga këto deklarime rezultuan disa rrethana të rëndësishme për hetimin, të cilat përforcojnë dyshimet e organit procedues në lidhje me përfitimin e paligjshëm të pasurisë së paluajtshme të ndodhur në Qerret, nga bashkëshortët Veliaj-Xoxa. Konkretisht, në kundërshtim me deklarimet e dhëna nga shtetësja Ajola Xoxa, deklaruesi jep të dhëna të cilat janë në harmoni të plotë me provat e grumbulluara deri në tani në fashikullin penal. Këto prova kanë të bëjnë me pagesat e kryera për mirëmbajtje nga shtetasi Erion Veliaj, të cilat i referohen vitit 2020, deklarimet e shtetasit Armand Manahasa, komunikimet e administruara mes deklaruesit dhe shtetasit Ergys Krisiko. **Të dhënat e deklaruesit për frekuentimin e vilës i referohen vitit 2020-2021.**

**143.1.1.** Nga këto të dhëna, por edhe nga fotot e siguruara nga komunikimet mes shtetasit Ergys Krisiko dhe Olsi Efthimi, provohet plotësisht që të paktën deri në korrik të vitit 2020, punimet në vilë nuk kanë përfunduar ende. Referuar procesverbalit për këqyrjen e pjesshme të të dhënave të aktit të ekspertimit Nr. 12, datë 16.01.2025, të marra nga aparati celular i shtetasit Ergys Krisiko, pjesë e fashikullit penal, rezulton se ky i fundit ka patur komunikime në aplikacionin Whatsapp, vibër, telegram, të cilat përmbajnë edhe foto si edhe dokumente të tjera. Aparati sekuestruar shtetasit Ergys Krisiko është i markës "Samsung model S24 Ultra (SM-S928B/DS)", me me numër IMEI 1: 355731676762017, në të cilin ndodhet numri telefonik +355692070877. Pra, asnjë rrethanë fakti nuk të çon në konkluzionin se vila në fjalë është frekuentuar nga secili prej personave që janë në dijeni të ekzistencës së saj, para vitit 2020. Dhe në fakt, ky është viti kur shtetasi Erion Veliaj fillon të paguajë tarifat e mirëmbajtjes për vilat (këtu përfshihet edhe vila që ligjërisht figuron në emër të vëllait të tij Arbër Veliaj), por edhe viti që Arbër Veliaj blen vilën e tij në këtë kompleks të ndodhur në Qerret.

**143.1.2. Gjithashtu, sipas organit procedues është interesant fakti se edhe pse ndan shumë detaje të përditshmërisë se tij me shtetasin Ergys Krisiko, kur ky i fundit e pyet për prejardhjen e fotove të vilës, deklaruesi i përgjigjet se i ka marrë nga interneti.**

**Pra, është e qartë se ekzistenca e vilës nuk duhej të shfaqej tek persona të tjerë, edhe pse ata janë miq të afërt të deklaruesit por edhe shtetases Ajola Xoxa. Është gjithashtu e qartë se angazhimi i deklaruesit nuk kufizohet vetëm në dhënien e ideve, por ai ka ideuar konceptin arkitekturor të paktën për pjesën e jashtme të vilës, dhe më pas e ka zbatuar atë. Këtu referojuni fotove të administruara në fashikull, ku duken qartë punëtorët që punojnë në pjesën e jashtme të objektit, të fotografuar nga deklaruesi i cili rezulton se ndjek punimet nga afër. Nga këqyrja përftohen edhe rezultate të tjera të cilat provojnë se marrëdhënia me vilën në fjalë ka nisur vetëm në vitin 2020, kur ajo duket që është në rikonstruksion e sipër. Po ashtu, nga komunikimet mes këtyre shtetasve rezulton e qartë se ka qenë shtetasi Olsi Efthimi i cili ka ndjekur punimet edhe të zyrave të "Partners Law", për të cilat duket se ka patur edhe shpenzime të padeklaruara ndonjëherë.**

**143.1.3.** Gjithashtu, referuar procesverbalit të këqyrjes së pjesshme të të dhënave të ekspertimit të aparatit celular të shtetasit Driant Zeneli, në përmbledhje të komunikimeve rezulton se vila në fjalë zotërohet faktikisht nga bashkëshortët Veliaj-Xoxa. Ky konkluzion arrihet nisur edhe nga komunikimet e shtetasit Driant Zeneli me Ajola Xoxa, nga ku evidentohet qartë frekuenca e shpeshtë e kësaj të fundit, por edhe bashkëshortit të saj në këtë pronë. Konkretisht: **Më datë 01.08.2021** ora 7:52 pm. shtetasi Driant Zeneli i shkruan Ajola Xoxës: - *A të ka marrë malli për Qerretin? - Ne erdhem sot. (faqe 6766).* **Ajola Xoxa** i përgjigjet: *<u>Ajo aty në fund është shtëpia jonë</u>. (faqe 6766).* **Ndërkohë dy bashkëbiseduesit kanë shkëmbyer një foto nga ku rezulton se Ajola Xoxa i referohet banesës së saj duke thënë "*ajo aty në fund është shtëpia jonë*". *Nga foto, në pjesën ballore të saj në fund, duket qartë që bëhet fjalë për vilën objekt hetimi.***

**143.1.4. Më tej, në faqen 8515, që i korrespondon datës 22.06.2024, rezulton një fakt me mjaft interes për hetimin dhe për provueshmërinë e pronësisë faktike të vilës nga bashkëshortët Veliaj- Xoxa. Konkretisht: Më datë 22.06.2024, ora 12:51 pm,** Driant Zeneli i shkruan Ajola Xoxës: - *Të hënën herët në mëngjes nisemi. Ajola Xoxa përgjigjet: E lëmë kur të vish më mirë takohemi. **Se më duhet të mbyll disa punë tani dhe <u>ndërkohë Eri ka shkuar në Qerret dhe s'ka marrë celësin</u>.*** **Përveç sa më lart, nga komunikimet të cilat janë administruar në fashikull me procesverbal këqyrje përkatës, konstatohet qartë se vila në Qerret frekuentohet shpesh dhe përgjatë viteve nga bashkëshortet Veliaj-Xoxa.**

**143.1.5.** Nga ana tjetër, deklaruesi pohon se projekti tek "Shkolla e Kuqe" lidhet me një truall në bashkëpronësi të fisit Xoxa. Kuptohet qartë se padijenia e deklaruesit se kush ka kontaktuar për të kryer këtë projekt është tërësisht e pabesueshme, përsa kohë që marrëdhëniet e tij me shtetasen Ajola Xoxa (siç edhe pohon vetë deklaruesi), por edhe siç rezulton nga rrethana të tjera të evidentuara në fashikull, janë mjaft të afërta.

**144.** Në datë **14.01.2025,** ndërsa Hetuesit e Prokurorisë së Posaçme kane zbatuar vendimin e Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar Nr. 56 datë 14.01.2025, kanë marrë deklarime nga **shtetasi Daniel Garunja** (*Nr. Personal I80515074D*), jurist pranë kompanisë "Lani" Shpk, në cilësinë e personit që ka dijeni për veprën penale. Ky shtetas ka qenë prezent gjatë kontrollit të ambienteve me Nr. 11/4, në godinën Sky Toëer, dhe në lidhje me këtë ambient, ka shpjeguar se nuk ka patur informacion se ka qënë i zënë. Gjithashtu, ky shtetas nuk kishte dijeni se ishte dhënë në përdorim tek dikush tjetër. Në dijeninë e tij ka qënë magazine e Lani shpk. Deklaruesi ka

shpjeguar se nga komunikimi që ka patur me shtetasin Mirton Lika (*një nga ortakët e Sky Toëer*), ka mësuar se nuk ka asnjë kontratë qiraje apo kontratë tjetër për lëshimin e këtij ambienti në përdorim. Deklaruesi është pyetur gjithashtu në lidhje me veprimet hetimore të datës 13.01.2025, ku nga oficerët e SPAK, në zbatim të vendimit të prokurorit janë këqyrur dhe administruar kontratat e lidhura ndërmjet shoqërisë Lani shpk dhe shoqërive Partners in Laë, Ava Studio dhe Qendra Harabel, por nuk ka vënë në dispozicion asnjë kontratë për ambientin me Nr. 11/4. Në lidhje me këtë, deklaruesi shpjegon se nga ana e shoqërisë Lani Shpk nuk ka asnjë akt për dhënien në përdorim apo me qira të zyrës 11/4. Gjithashtu, deklaruesi shprehet se nuk ka informacion pse nuk ka kontratë, pasi nuk është vendimmarja e tij, duke shtuar se vendimi është marrë nga Mirton Lika (*ortaku*).

**144.1. Në përmbledhje të deklarimeve të këtij shtetasi, rezulton se ambienti nr. 11/4, siç u provua edhe nga kontrolli i kryer me vendim të Gjykatës së Posaçme, përdorej nga shtetësja Ajola Xoxa. Në lidhje me këtë ambient i cili nuk është deklaruar ndonjëherë në Deklaratën e Interesave Privatë pranë ILDKPKI nga shtetësja Ajola Xoxa, duket se nuk ka ndonjë akt të shkruar i cili të provojë natyrën e dhënies në përdorim.**

**145.** Në datë **14.01.2025**, ndërsa Hetuesit e Prokurorisë së Posaçme kane zbatuar vendimin e Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar me Nr. 56 datë 14.01.2025, është pyetur gjithashtu edhe **shtetësja Anxhela Qunaj**. Kjo shtetase ndër të tjera ka deklaruar se: **[...]**

> Punon si asistente zyre pranë shoqërisë "Partners Laë" Shpk. Shtetasja Anxhela Qunaj është personi i cili ka sjellë çelësat e ambjentit me Nr. 11/4 Sky Tower, objekt kontrolli sipas vendimit të Gjykatës së Posacme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar.
>
> Në lidhje me këtë, deklaruesja shpjegon se në momentin që ka filluar punë nga Ajola i janë dhënë disa çelësa të ambienteve të Partners, të Harabelit dhe disa çelësa të tjerë, ku ndër to ishin edhe të ambientit me Nr. 11/4. Deklaruesja shpjegon se Ajola i ka thënë se ky ambient përdoret si magazinë. Akses në këtë ambient ka patur ajo (*Anxhela*), Ajola Xoxa dhe daja i saj që quhet Erald Simixhiu.
>
> Deklaruesja shpjegon se ky ambient është përdorur edhe nga punonjës të qendrës Harabel për të sjellë materialet në ato ambiente. Për këtë ambient, në dijeninë e saj paguhet qira, por vetë nuk ka parë kontratë të lidhur apo që të ketë bërë vetë ndonjë pagesë. Në vijim, deklaruesja shpjegon se ambienti me Nr. 11/4, në muajin Prill të vitit 2024 është lyer dhe në të është shtruar parketi i ri.
>
> **Gjithashtu, deklaruesja shprehet se shtetësja Ajola Xoxa zotëron pasuri të paluajtshme në zonën e Qerretit, shtëpi plazhi, dhe këtë gjë e ka kuptuar nga bisedat në ambientin e punës.**
>
> Deklaruesja është pyetur edhe në lidhje me pikturat e gjetura në hyrjen me Nr. 11/4, Sky Tower, për të cilat tregon se kanë ngelur nga ekspozitat e zhvilluara nga Nan Gallery. Ajo shpjegon se në këtë ambient ka dy dhoma me piktura. Në njërën dhomë, ku gjenden pikturat e mbetura nga ekspozita e Nan Gallery, ajo (*Anxhela*) kishte celësin e derës. Ndërsa në dhomën e dytë djathtas nga dera kryesore, çelësin e ka



SPAK.GOV.AL

patur vetëm Ajola, dhe një pjesë e pikturave janë të ekspozitave, ndërsa pjesa tjetër mund të jetë blerë nga Ajola, pra, janë personale të saj. Sipas deklarueses, pikturat variojnë në çmime nga 600 deri në 5 mijë euro. Në fund, deklaruesja shton se të gjithë punonjësit e dinin që ekzistonte kjo magazinë, dhe Ajola rrallëherë ngjitej, pasi nëse i duhej ndonjë gjë u thoshte punonjësve që të shkonin. **[...]**

145.1. Në përmbledhje të deklarimeve të shtetases Anxhela Qunaj, rezulton se ambienti nr. 11/4, siç u provua edhe nga kontrolli i kryer me vendim të Gjykatës së Posaçme, përdorej nga shtetësja Ajola Xoxa. Në lidhje me këtë ambient i cili nuk është deklaruar ndonjëherë në Deklaratën e Interesave Private pranë ILDKPKI nga shtetësja Ajola Xoxa, duket se nuk ka ndonjë akt të shkruar i cili të provojë natyrën e dhënies në përdorim. Në këtë ambient janë bërë investime, të cilat lidhen ndër të tjera edhe me vendosjen e një parketi të ri. Ky fakt rezulton edhe nga komunikimet e administruara në fashikull me shtetasen Adela Kondakçiu. **Gjithashtu, shtetësja Anxhela Qunaj konfirmon edhe njëherë zotërimin nga shtetësja Ajola Xoxa të pasurisë së paluajtshme të llojit Vilë, të ndodhur në Qerret. Kjo shtetase shprehet se këtë e ka dëgjuar nga punonjëset e zyrës.**

146. Mbështetur në faktet e mësipërme, Prokuroria e Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar ka paraqitur kërkesën me objekt: **1.** Të caktohet ndaj personit nën hetim **Erion Veliaj**, masa e sigurimit *"arrest në burg"* e parashikuar nga neni 238 i K.Pr.Penale, si person i dyshuar për kryerjen e veprës penale të *"Korrupsioni pasiv i funksionarëve të lartë shtetërorë ose i të zgjedhurve vendorë"*, kryer në bashkëpunim (9 herë), parashikuar nga neni 260 e 25 i Kodit Penal dhe *"Pastrimi i produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale"*, kryer në bashkëpunim dhe më shumë se një herë, parashikuar nga neni 287/2 i Kodit Penal. **2.** Të caktohet ndaj personit nën hetim **Ajola Xoxa** masa e sigurimit personal me karakter shtrëngues ***"Arresti në shtëpi"***, parashikuar nga neni 237 i Kodit të Procedurës Penale, si person i dyshuar për kryerjen e veprës penale të *"Korrupsioni pasiv i funksionarëve të lartë shtetërorë ose i të zgjedhurve vendorë"*, kryer në bashkëpunim (9 herë), parashikuar nga neni 260 e 25 i Kodit Penal, *"Pastrimi i produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale"*, kryer në bashkëpunim më shumë se një herë, parashikuar nga neni 287/2 i Kodit Penal, *"Refuzimi për deklarimin, mosdeklarimi, fshehja ose deklarimi i rremë i pasurive, interesave private të personave të zgjedhur dhe nëpunësve publikë ose i çdo personi tjetër që ka detyrimin ligjor për deklarim"*, parashikuar nga neni 257/a/2 i Kodit Penal. **3.** Të caktohet ndaj personit nën hetim **Elman Abule** masa e sigurimit personal me karakter shtrëngues ***"arrest në burg"***, parashikuar nga neni 234 i Kodit të Procedurës Penale, si person i dyshuar për kryerjen e veprës penale të ***"Pastrimi i produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale"***, kryer në bashkëpunim dhe më shumë se një herë, parashikuar nga neni 287/2 i Kodit Penal. **4.** Të caktohet ndaj personit nën hetim **Gentjan Sulaj** masa e sigurimit personal me karakter shtrëngues *"Detyrimi për t'u paraqitur në policinë gjyqësore"*, parashikuar nga neni 234 i Kodit të Procedurës Penale, si person i dyshuar për kryerjen e veprës penale të *"Korrupsioni aktiv i funksionarëve të lartë shtetërorë ose të zgjedhurve vendorë"*, parashikuar nga neni 245 i Kodit Penal. **5.** Të caktohet ndaj personit nën hetim **Meriman Palushi** masa e sigurimit personal me karakter shtrëngues *"Detyrimi për t'u paraqitur në policinë gjyqësore"*, parashikuar nga neni 234 i Kodit të Procedurës Penale, si person i dyshuar për kryerjen e veprës penale të *"Korrupsioni aktiv i*

*funksionarëve të lartë shtetërorë ose të zgjedhurve vendorë*", parashikuar nga neni 245 i Kodit Penal. **6.** Të caktohet ndaj personit nën hetim **Fatmir Bektashi** masa e sigurimit personal me karakter shtrëngues "*Detyrimi për t'u paraqitur në policinë gjyqësore*", parashikuar nga neni 234 i Kodit të Procedurës Penale, si person i dyshuar për kryerjen e veprës penale të "*Korrupsioni aktiv i funksionarëve të lartë shtetërorë ose të zgjedhurve vendorë*", parashikuar nga neni 245 i Kodit Penal. **7.** Të caktohet ndaj personit nën hetim **Sokol Kryeziu** masa e sigurimit personal me karakter shtrëngues "*Detyrimi për t'u paraqitur në policinë gjyqësore*", parashikuar nga neni 234 i Kodit të Procedurës Penale, si person i dyshuar për kryerjen e veprës penale të "*Korrupsioni aktiv i funksionarëve të lartë shtetërorë ose të zgjedhurve vendorë*", parashikuar nga neni 245 i Kodit Penal. **8.** Të caktohet ndaj personit nën hetim **Shkëlqim Fusha** masa e sigurimit personal me karakter shtrëngues "*Detyrimi për t'u paraqitur në policinë gjyqësore*", parashikuar nga neni 234 i Kodit të Procedurës Penale, si person i dyshuar për kryerjen e veprës penale të "*Korrupsioni aktiv i funksionarëve të lartë shtetërorë ose të zgjedhurve vendorë*", parashikuar nga neni 245 i Kodit Penal.

**146.1. Lidhur me ekzistencën e dyshimit të arsyeshëm** të bazuar në prova, në kërkesën e saj Prokuroria e Posaçme thekson se shtetasi **Erion Veliaj**, me detyrë Kryetar i Bashkisë Tiranë, ka konsumuar elementët e veprës penale të "*Korrupsioni pasiv i funksionarëve të lartë shtetërorë ose i të zgjedhurve vendorë*", kryer në bashkëpunim, parashikuar nga neni 260 e 25 i Kodit Penal (9 herë) dhe "*Pastrimi i produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale*", kryer në bashkëpunim më shumë se një herë, parashikuar nga neni 287/2 i Kodit Penal, duke përmbushur në këtë mënyrë njërin kusht të vendosur nga ligjvënësi referuar nenit 228/1 të Kodit të Procedurës Penale, në lidhje me caktimin e masave të sigurimit personal. Gjithashtu, nga aktet e administruara konstatohet se përmbushet dhe kushti i dytë i të njëjtit nen, për shkak se për këtë shtetas nuk rezulton të ketë ndonjë shkak padënueshmërie nga ato që lidhen me shuarjen e veprës penale për shkaqe parashkrimi apo shfuqizim të dispozitës përkatëse, referuar parashikimeve të pikës 2 të nenit 228 të Kodit të Procedurës Penale.

**146.2. Lidhur me ekzistencën e dyshimit të arsyeshëm** të bazuar në prova, në kërkesën e saj Prokuroria e Posaçme thekson se për shtetasen **Ajola Xoxa** arrihet në konkluzionin se ekzistojnë dyshime të arsyeshme të bazuara në prova, se ka konsumuar elementët e veprës penale të "*Korrupsioni pasiv i personave që ushtrojnë funksione publike*", kryer në bashkëpunim me subjektin e posaçëm, parashikuar nga neni 260 e 25 i Kodit Penal (9 herë), "*Pastrimi i produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale*", kryer në bashkëpunim më shumë se një herë, parashikuar nga neni 287/2 i Kodit Penal dhe "*Refuzimi për deklarimin, mosdeklarimi, fshehja ose deklarimi i rremë i pasurive, interesave private të personave të zgjedhur dhe nëpunësve publikë ose i çdo personi tjetër që ka detyrimin ligjor për deklarim*", parashikuar nga neni 257/a/2 i Kodit Penal, duke përmbushur në këtë mënyrë njërin kusht të vendosur nga ligjvënësi referuar nenit 228/1 të Kodit të Procedurës Penale, në lidhje me caktimin e masave të sigurimit personal. Gjithashtu, nga aktet e administruara konstatohet se përmbushet dhe kushti i dytë i të njëjtit nen, për shkak se për këtë shtetase nuk rezulton të ketë ndonjë shkak padënueshmërie nga ato që lidhen me shuarjen e veprës penale

për shkaqe parashkrimi apo shfuqizim të dispozitës përkatëse, referuar parashikimeve të pikës 2 të këtij neni.

**146.2.1.** Në rastin konkret, sipas Prokurorisë së Posaçme **shtetasit nën hetim Erion Veliaj dhe Ajola Xoxa** dyshohet se kanë kryer në bashkëpunim veprime aktive të kundërligjshme të cilat konsistojnë pikërisht në marrjen e përfitimeve të parregullta të paktën në 9 episode të veçanta, në formë shumash monetare por edhe pasurish të paluajtshme nga shtetas apo subjekte tregtarë të cilët kanë patur interesa të drejtpërdrejta financiare në bashkinë Tiranë. Nga të dhënat konkrete të grumbulluara deri në këtë fazë të hetimit paraprak, ekziston dyshimi i arsyeshëm i bazuar në prova se roli i shtetasit nën hetim Erion Veliaj ka qenë determinant, në çdo veprim fundor që lidhet specifikisht me pagesat e bëra në adresë të shoqërive të cilat më pas kanë kaluar shuma të hollash në favor të bashkëshortes së tij, shtetases Ajola Xoxa, por edhe drejtpërdrejt në favor të OJF-ve të kontrolluara faktikisht nga kjo shtetase, të cilat më pas i kanë kanalizuar këto të holla tek shoqëritë me përgjegjësi të kufizuara apo persona fizikë si edhe individë, të kontrolluar plotësisht nga shtetësja nën hetim. Kjo e fundit ka zbatuar në praktikë dhe përditshmëri të gjithë këtë skemë korruptive, me qëllimin kriminal të përfitimit të parregullt që buron nga funksioni i bashkëshortit të saj.

**146.2.2.** Është e qartë se në themel të ***anës objektive të kësaj figure të veprës penale***, duhet të ekzistojnë veprime që konsistojnë në shkëmbime të kundërligjshme dhe të ndërsjella, gjatë të cilave veprimet ose mosveprimet e të zgjedhurit vendor dhe personit të lidhur me të, materializohen në kërkimin ose marrjen e një përfitimi për vete ose për persona të tjerë, apo pranimin e një oferte, nga një subjekt i jashtëm, i cili afron, siç janë rastet konkrete, përfitimin e paligjshëm. Në situatën ku ndodhemi, rezulton që veprimet e kundërligjshme të shtetasve nën hetim në drejtim të marrjes së përfitimeve të parregullta nuk janë konturuar vetëm brenda episodeve konkrete sipas kuptimit klasik që dispozita penale i jep konsumimit të elementëve të saj. Veprimet objektive të kundërligjshme të këtyre shtetasve, të shtrira gjatë në kohë, përtej episodeve konkrete të evidentuara dhe të faktuara nga organi procedues, duket se përbëjnë një *modus operandi* për realizimin e një qëllimi kriminal, atë të përfitimit të parregullt që buron nga veprimet ose mosveprimet që lidhen me funksionin e kryetarit të Bashkisë Tiranë.

**146.2.3.** Ky qëllim kriminal i shtetasve nën hetim sipas Prokurorisë së Posaçme është realizuar nëpërmjet një skeme të mirëmenduar korruptive e cila kulmon në fakte përmbyllëse të kësaj natyre të cilat deri më tani materializohen në të paktën 9 episode konkrete (*5 prej të cilave janë pjesë e kësaj kërkese*). Në mënyrë të përmbledhur këto episode konsistojnë në:

1) Marrjen e përfitimit të parregullt (pasuri e paluajtshme) nga shtetasit nën hetim **Erion Veliaj** (i zgjedhuri vendor) dhe bashkëshortja e tij shtetësja **Ajola Xoxa**, për të kryer veprime të cilat lidhen me funksionin publik, në favor të shtetasit **Gentian Sula**, ky i fundit përfaqësues i subjektit tregtar **"Agi Kons" shpk.** Ky subjekt tregtar, nëpërmjet përfaqësuesit të tij, rezulton se gjatë periudhës që provohet të ketë dhënë përfitimin e parregullt tek shtetasit nën hetim, ka lidhur kontratë me Bashkinë Tiranë me objekt "*Ndërtimi i Shkollës 9 vjeçare "Qazim Turdiu"*", sipas Kontratës me të njëjtin objekt, me nr. Prot. 25117/39 datë 29.09.2020, me vlerë të përgjithshme 362,713,599 lekë (pa TVSH). Gjithashtu, në të njëjtën periudhë (08.06.2020), i njëjti subjekt ka përfituar Leje ndërtimi nr. Prot. A-47/8 për ndërtimin e "Godina banimi dhe shërbimesh 1, 2, 3,

4 dhe 5 kat…" në pronë të Gentjan Sula etj dhe shoqërisë "Agi Kons" shpk. Afati kohor i lejes së ndërtimit është 36 muaj. Leja është nënshkruar nga kryetari i Bashkisë Tiranë, shtetasi Erion Veliaj;

2) Marrjen e përfitimit të parregullt (financim biletash udhëtimi jashtë vendit dhe qëndrim në hotel, si edhe sponsorizime për OJF) nga shtetasi nën hetim **Erion Veliaj** (i zgjedhuri vendor) dhe bashkëshortja e tij shtetësja Ajola Xoxa, për të kryer veprime të cilat lidhen me funksionin publik, në favor të shtetasit **Fatmir Bektashi**, ky i fundit përfaqësues i subjektit **tregtar "Kontakt" shpk**. Dhënia e këtyre përfitimeve të parregullta i paraprin një projekti ndërtimi që ky subjekt tregtar planifikonte të kryente në qytetin e Tiranës. Gjithashtu, këto përfitime të parregullta vijojnë në periudhën e marrjes së lejes së përdorimit për të njëjtin objekt, në formë sponsorizimi për një nga OJF-të e kontrolluara nga shtetësja **Ajola Xoxa;**

3) Marrjen e përfitimit të parregullt (**dhënie të hollash nëpërmjet kryerjes së blerjeve** fiktive) prej një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar të kontrolluar nga shtetësja Ajola Xoxa, për të kryer veprime të cilat lidhen me funksionin publik, në favor të shtetasit **Sokol Kryeziu,** ky i fundit përfaqësues i subjektit tregtar **"Gerard-A" shpk**. Dhënia e këtyre përfitimeve të parregullta përkon në kohë me dhënien e lejes ndërtimi nr. S-11181/8 prot. datë 14.06.2023, për ndërtimin e objektit *"Godinë hotelerie studentore 2 kat me 2 kat pjesërisht nëntokë dhe 2 kat nëntokë dhe mur rrethues"*, në pronësi të tij. Afati kohor i lejes është 48 muaj. Pra, edhe aktualisht marrëdhënia me Bashkinë Tiranë vijon. Leja e ndërtimit është firmosur nga kryetari i Bashkisë Tiranë, shtetasi Erion Veliaj më datë 27.06.2023;

4) Marrjen e përfitimeve të parregullta (dhënie të hollash në formë financimesh fiktive për organizim festivali artistik) nga OJF të kontrolluara nga shtetësja Ajola Xoxa, për të kryer veprime të cilat lidhen me funksionin publik, në favor të shtetasit **Meriman Palushi, ky i fundit përfaqësues i subjektit tregtar "Palushi" shpk.** Dhënia e këtyre përfitimeve të parregullta dy OJF-ve të ndryshme (BYL-A, Eventus), në të njëjtën ditë (06.09.2023) përkon me periudhën në të cilën është dhënë Leja e ndërtimit nr. Prot. A-19418/8 prot., dt. 19.07.2023, e nënshkruar nga kryetari i bashkisë Tiranë, Erion Veliaj me afat kohor 60 muaj, zhvillues dhe ndërtues "Palushi" shpk, me NUIS K12202004R, me objekt ndërtimi *"Banesë individuale 2 kat me 1 kat nëntokë dhe mur rrethues"*. Gjithashtu, edhe në lidhje me Lejen e ndërtimit nr. A14369/9, dt. 05.11.2019, të nënshkruar nga kryetari i bashkisë Tiranë, Erion Veliaj, me objekt ndërtimi i *"Godinë Banimi dhe shërbimi me 8 kat, me 2 kat parkimi nëntokë"*, konstatohet se marrëdhënia me këtë institucion vijon (ndërtimi është objekt kontrolli nga Bashkia Tiranë), për shkak se afati i kësaj leje është 48 muaj;

5) Marrjen e përfitimeve të parregullta (dhënie të hollash në formë likuidim faturash për shërbime konsulence ligjore fiktive) nga persona fizikë të punësuar *de facto* dhe kontrolluar nga shtetësja Ajola Xoxa, për të kryer veprime të cilat lidhen me funksionin publik, në favor të shtetasit **Shkëlqim Fusha, ky i fundit përfaqësues i subjektit tregtar "Fusha" shpk.** Dhënia e këtyre përfitimeve të parregullta në të njëjtën ditë (26.11.2020) për llogari të dy personave fizikë, përkon me marrjen nga "Fusha" shpk nga Bashkia Tiranë, të Lejes së Ndërtimit Nr. Prot. I-8789/8, dt. 23.11.2020, "Banesë individuale 1 kat, me mur rrethues" ndodhur në Yrshek, Tiranë,

Afati i lejes 27 muaj. Leja e ndërtimit është nënshkruar nga kryetari i Bashkisë Tiranë, shtetasi Erion Veliaj. Gjithashtu, kjo përkon me peridhën gjatë së cilës "Fusha" sh.p.k të shqyrtimit të kërkesë bërë pranë Bashkisë Tiranë më datë 09.11.2020 për likujdimin e garancisë së punimeve që rrjedhë nga zbatimi i punimeve në objektin *"Rikualifikimi urban i sheshit Skënderbej" Faza II"*, në vlerën 58. 732, 731 lekë.

**Ndërsa në lidhje me përfitimet e parregullta të siguruara nëpërmjet OJF-ve, të cilave u është atribuuar vepra penale në regjistrin përkatës në Prokurorinë e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, por të cilat nuk janë objekt i kësaj kërkese, sipas Prokurorisë së Posaçme rezulton se episodet konkrete për të cilat deri në këtë moment ka dyshime të arsyeshme të bazuara në prova, lidhen me:**

6) Marrjen e përfitimit të parregullt (në formë sponsorizimi për evente artistike) nëpërmjet OJF Qendra "Eventus", me drejtor ekzekutiv shtetasen Linda Kazani (bashkëshortja e dajës së shtetases Ajola Xoxa), për të kryer veprime të cilat lidhen me funksionin publik. Këto përfitime të parregullta të dhëna me firmën e kryetarit të Bashkisë Tiranë, shtetasit nën hetim Erion Veliaj, kanë kaluar me transferta bankare nga kjo OJF në shoqëritë me përgjegjësi të kufizuara të kontrolluara *de facto* dhe *de jure* nga shtetësja Ajola Xoxa, **dhe rrjedhimisht me përfitues fundorë bashkëshortët Veliaj-Xoxa;**
7) Marrjen e përfitimit të parregullt (në formë sponsorizimi për evente artistike) nëpërmjet **OJF Qendra "Muza"**, me drejtor ekzekutiv shtetasen Alketa Spartaku (kushërirë e shtetases Ajola Xoxa), pronarë përfitues Erald Simixhiu (daja i shtetases Ajola Xoxa), Arben Spartaku (kushëri i shtetases Ajola Xoxa) dhe Rea Spartaku (kushërirë e shtetases Ajola Xoxa), për të kryer veprime të cilat lidhen me funksionin publik. Këto përfitime të parregullta të dhëna me firmën e kryetarit të Bashkisë Tiranë, shtetasit nën hetim Erion Veliaj, kanë kaluar me transferta bankare nga kjo OJF në shoqëritë me përgjegjësi të kufizuar të kontrolluara *de facto* dhe *de jure* nga shtetësja Ajola Xoxa, **dhe rrjedhimisht me përfitues fundorë bashkëshortët Veliaj-Xoxa;**
8) Marrjen e përfitimit të parregullt (në formë sponsorizimi për evente artistike) nëpërmjet OJF Qendra "Frobolous", me drejtor ekzekutiv shtetasen Frosina Bollo, për të kryer veprime të cilat lidhen me funksionin publik. Këto përfitime të parregullta të dhëna me firmën e kryetarit të Bashkisë Tiranë, shtetasit nën hetim Erion Veliaj, kanë kaluar me transferta bankare nga kjo OJF në shoqëritë me përgjegjësi të kufizuar si edhe persona fizikë të kontrolluar *de facto* nga shtetësja Ajola Xoxa, dhe **rrjedhimisht me përfitues fundorë bashkëshortët Veliaj-Xoxa;**
9) Marrjen e përfitimit të parregullt (në formë sponsorizimi për evente artistike) nëpërmjet OJF "BYL-A", me drejtor ekzekutiv shtetasen Reada Lemnusha, për të kryer veprime të cilat lidhen me funksionin publik. Këto përfitime të parregullta të dhëna me firmën e kryetarit të Bashkisë Tiranë, shtetasit nën hetim Erion Veliaj, kanë kaluar me transferta bankare nga kjo OJF në shoqëritë me përgjegjësi të kufizuar si edhe persona fizikë të kontrolluar *de facto* dhe *de jure* nga shtetësja Ajola Xoxa, dhe **rrjedhimisht me përfitues fundorë bashkëshortët Veliaj-Xoxa.**

SPYETJET.AL

**146.2.3.1.** Pra, sipas Prokurorisë së Posaçme është e qartë se kjo skemë ka patur në bazë të saj jo vetëm krijimin e një numri të konsiderueshëm OJF-sh dhe shoqërish tregtare dhe shfrytëzimin e tyre, por edhe marrjen e përfitimeve të parregullta nga subjekte tregtarë që operojnë në mënyrë të pavarur në treg. Këto entitete (OJF dhe shpk) të lidhura me shtetasen Ajola Xoxa ka rezultuar se përfitonin fonde publike, drejtpërdrejt ose tërthorazi, fonde këto që në forma të ndryshme më pas përfundonin në pasurimin e shtetasve nën hetim dhe familjarëve të tyre. Të gjitha këto përfitime të parregullta, përfshirë këtu edhe pasurinë e paluajtshme të ndodhur në Qerret, Kavajë, rezulton se në analizë të fundit kanë hyrë si pasuri në familjen e kryetarit të bashkisë Tiranë, shtetasit Erion Veliaj dhe bashkëshortes së tij, të cilët janë në regjimin pasuror të bashkësisë ligjore.

**146.2.3.2.** Sipas analizës literale dhe sistematike të nenit 260 të Kodit Penal, kërkimi apo <u>marrja e përfitimit material të paligjshëm</u> apo, pranimi i një oferte a premtimi, mund të bëhet si *"përpara"*, *"gjatë"* apo dhe *"pas"* ushtrimit të funksionit nga ana e të zgjedhurit vendor. Kjo për faktin se, shprehja e përdorur nga norma në fjalë *"për të kryer apo mos kryer një veprim që lidhet me lidhet......"*, tregon në fakt qëllimin e sjelljes penale, pra atë <u>marries</u> të përfitimit material të parregullt, duke treguar mjetin dhe qëllimin, po jo domosdoshmërisht identifikimin e çastit se kur duhet të kryhet akti kriminal në raport me veprimin e ushtrimit të funksionit të të zgjedhurit vendor. Tërësia e veprimeve apo mosveprimeve që ai në bashkëpunim me personin e lidhur kryen, duhet të plotësojnë kushtin që veprimi a mosveprimi të lidhet detyrimisht me detyrën apo funksionin që ai kryen, dhe që të ekzistojë cilësia e tij si i zgjedhur vendor në çastin e realizimit të sjelljes kriminale si *"përpara"*, *"gjatë"* apo *"pas"* ushtrimit të funksionit. **Megjithatë, në rastet objekt hetimi të Prokurorisë së Posaçme, evidentohet qartë se momentet kohore të dhënies së të hollave por edhe të pasurisë së paluajtshme nga përfaqësuesit e subjekteve tregtarë, lidhen me momentet e marrjes së përfitimeve nga Bashkia Tiranë, si në formë leje ndërtimi ashtu edhe në fonde publike.** Për shkak se shtetasi nën hetim Erion Veliaj e ka kryer veprën penale në bashkëpunim me një subjekt të përgjithshëm, siç është në rastin konkret bashkëshortja e tij, shtetësja Ajola Xoxa, dhe sa kohë që vetë shtetasi Erion Veliaj është subjekt i posaçëm sipas nenit 260 të Kodit Penal, bazuar edhe në përfundimet unifikuese të diktuara nga vendimi unifikues i Gjykatës së Lartë nr. 1/2002 atëherë sipas Prokurorisë së Posaçme shtetësja nën hetim Ajola Xoxa duhet të përgjigjet sipas nenit 260 e 25 të Kodit Penal.

**146.2.4.** Ndërsa në lidhje me **<u>anën objektive të veprës penale</u> të parashikuar nga neni 287 paragrafi 2 i Kodit Penal**, për të cilën dyshohet të jenë autorët shtetasit Erion Veliaj dhe Ajola Xoxa, dispozita kërkon që mes produktit të veprës penale (*vepra penale e parashikuara nga 260 i Kodit Penal*) nga njëra anë dhe veprës penale të pastrimit të këtij produkti (*vepra penale e rrjedhur*), duhet të ekzistojë gjithmonë lidhje shkakësore ekskluzive dhe e domosdoshme (*condicio sine qua non*). Në rastin konkret, ky kusht është plotësisht i përmbushur, përsa kohë produkti (*të hollat e përfituara në mënyrë të parregullt si edhe pasuria e paluajtshme*) ka rrjedhur nga veprime objektive të kundërligjshme, të dënueshme penalisht, siç janë ato të parashikuara në nenin 260 të Kodit Penal. Pra, mes veprimeve objektive të personave të dyshuar **Erion Veliaj dhe Ajola Xoxa**, si autorë të dyshuar të veprës penale të parashikuar nga neni 260 i Kodit Penal, dhe veprimeve që pasojnë nga të njëjtët shtetas, të kryera në bashkëpunim më shumë se një herë, të cilat synojnë më pas pastrimin e produktit që buron nga vepra penale, qartazi ekziston një lidhje shkakësore.



SPEKTRUM.AL

**146.2.4.1.** Gjithashtu, sipas Prokurorisë së Posaçme me veprimet e tyre të kundërligjshme, të kryera në bashkëpunim dhe më shumë se një herë, të cilat konsistojnë në integrimin në sistemin bankar të shumave monetare të siguruara si përfitime të parregullta, por edhe të fshehjes ose mbulimit të natyrës së vërtetë së pasurisë, në kushtet kur këto pasuri dihet se janë produkte të veprës penale sipas nenit 260 të ligjit material, shtetasit e dyshuar kanë përmbushur elementët e parashikuar në gërmat *a)* dhe *b)* të dispozitës, forma objektive këto të kryerjes se veprës penale sipas nenit 287 të Kodit Penal, kryer në bashkëpunim sipas paragrafit të dytë. **Qëllimi kriminal i shtetasve nën hetim për integrimin në sistemin bankar të shumave monetare të cilat janë rezultat i përfitimeve të parregullta, do të ishte i pamundur të përmbushej pa rolin përcaktues të subjekteve të tjera tregtare, shpk dhe OJF, të identifikuar deri tani në regjistrin e njoftimit të veprave penale. OJF-të "Harabel", "Eventus", "Muza" dhe "BYL-A", të kontrolluara plotësisht nga shtetësja nën hetim Ajola Xoxa, deri në këtë fazë të hetimit paraprak dyshohet të kenë kryer veprime konkrete të kundërligjshme në drejtim të pastrimit të produkteve të veprës penale, nëpërmjet transferimit të pasurisë me qëllim fshehjen ose mbulimin e origjinës së paligjshme të saj, duke ditur se këto pasuri janë produkt i veprës penale sipas nenit 260 të Kodit Penal. Në këtë këndvështrim, OJF-të "Eventus", "Muza" dhe "BYL-A", por edhe OJF "Frobolous", dyshohet të kenë kryer veprime aktive të kundërligjshme të cilat përmbajnë elementë të veprës penale të parashikuar nga neni 245 i Kodit Penal. Deri në këtë moment, përtej episodeve të evidentuara të cilat lidhen me këto subjekte, është arritur në konkluzionin se emrat tregtarë të këtyre OJF-ve duhen regjistruar në regjistrin e njoftimit të veprave penale dhe hetimet për to duhet të vijojnë.**

**146.2.4.2.** Po kështu, ky qëllim kriminal për pastrimin e produkteve të veprës penale, që i referohet rastit të kalimit të të hollave nga shoqëritë e administruara **nga shtetasi Elman Abule** dhe familjarë të tij, do të ishte i pamundur të realizohej pa bashkëpunimin e këtij të fundit në kryerjen e veprimeve të kundërligjshme të cilat kanë kulmuar në pagesat e bëra për shoqëritë tregtare si edhe personat fizikë të kontrolluar nga shtetësja Ajola Xoxa. Komunikimet e zhvilluara mes shtetases ***Adela Kondakçiu dhe financieres së shoqërisë "Rametal" shpk***, të përfaqësuar nga shtetasi nën hetim Elman Abule, por *edhe shtetases Adela Kondakçiu dhe Marisa Nilo* (bashkëshortja e shtetasit Elman Abule), të cilat përfshijnë si lëshimin e faturave tërësisht fiktive ashtu edhe pagesat e bëra për "Partners Laë" shpk, menjëherë sapo "Rametal" shpk është likuiduar nga Ministria e Kulturës, krijojnë dyshimin e arsyeshëm të bazuar në prova se qëllimi i këtyre transfertave bankare ka qenë "injektimi" në llogaritë e entiteteve tregtare të kontrolluara nga shtetësja Ajola Xoxa, të shumave monetare që janë produkt i veprimtarisë kriminale.

**146.2.5.** Sipas Prokurorisë së Posaçme në lidhje me ***anën objektive të veprës penale*** **të parashikuar nga neni 257/a/2 i Kodit Penal**, për të cilën dyshohet të jetë autore shtetësja nën hetim **Ajola Xoxa**, konstatohet se ajo kryhet në disa forma. Sipas paragrafit të parë kjo vepër konsumohet nëpërmjet *i)* refuzimit për deklarim ose *ii)* nëpërmjet mosdeklarimit të pasurisë së personave të zgjedhur ose nëpunësve publikë sipas ligjit. Sipas paragrafit të dytë të këtij neni, vepra quhet e konsumuar kur subjekti i deklarimit apo personi i lidhur me të, kryejnë *i)* fshehje të pasurisë apo bëjnë *ii)* deklarim të rremë të pasurisë. Në këtë rast, konstatohet se ekzistojnë dyshime të arsyeshme të bazuara në prova se nuk ka deklaruar.

duke fshehur, angazhimin e saj çdo lloj veprimtarie që krijon të ardhura, përfshirë çdo lloj të ardhure, të krijuar nga kjo veprimtari ose ky angazhim, sipas detyrimeve që burojnë nga ligjit nr. 9049 datë 10.04.2023, *neni 4 gërma "g" i tij*. Këto angazhime të kësaj shtetase, lidhen specifikisht me pjesëmarrjen e saj në bordin e Qendrës "Harabel", qendër kjo që provohet të ketë gjeneruar të ardhura, siç më lart u argumentua, dhe njëkohësisht pronare (Qendra "Harabel") e shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar "Nan Gallery" shpk, e cila është një subjekt tregtar me natyrë fitimprurëse. Fshehja e këtyre fakteve nga shtetësja nën hetim, ka pamundësuar organet ligjzbatuese për të patur një panoramë të plotë dhe të qartë përsa i përket jo vetëm pjesëmarrjes së kësaj shtetase në borde organizatash, që nga ana e tyre zotërojnë shpk, por çfarë është më e rëndësishme, ka pamundësuar "*konstatimin*" dhe "*gjurmimin*" e një sasie të konsiderueshme të hollash, të cilat kanë qarkulluar nëpërmjet këtyre subjekteve të kontrolluara faktikisht nga shtetësja nën hetim. Pikërisht, mungesa e plotë e kësaj transparence ka lejuar më pas edhe funksionimin e një skeme kaq të organizuar të lëvizjes së të hollave nga dhe nëpërmjet këtyre OJF-ve dhe shpk-ve.

**146.3. Lidhur me ekzistencën e dyshimit të arsyeshëm** të bazuar në prova, në kërkesën e saj Prokuroria e Posaçme thekson se për subjektet të cilët dyshohet të kenë dhënë përfitime të parregullta në këmbim të veprimeve që lidhen me funksionin e kryetarit të Bashkisë Tiranë, shtetasit Erion Veliaj, por edhe shoqërive të cilat kanë bashkëpunuar në pastrimin e produkteve të veprës penale, organi procedues deri në këtë fazë të hetimit paraprak ka siguruar prova të cilat të çojnë tek dyshimi i arsyeshëm se: **i) shtetasi Gentjan Sula,** në cilësinë e aksionerit në masën 100% të "Agikons" shpk (deri më datë 10.12.2024), më NIPT K21622001M, ka kryer veçmas veprime të cilat përmbajnë elementë të veprës penale të "*Korrupsioni aktiv i funksionarëve të lartë shtetërore ose të zgjedhurve vendorë*", parashikuar nga neni 245 i Kodit Penal; **ii) shtetasi Sokol Kryeziu,** në cilësinë e administratorit të shoqërisë **"Gerard-A" shpk**, më NIPT L12407005L, ka kryer veçmas veprime të cilat përmbajnë elementë të veprës penale të "*Korrupsioni aktiv i funksionarëve të lartë shtetërore ose të zgjedhurve vendorë*", parashikuar nga neni 245 i Kodit Penal; **iii) Shtetasi Meriman Palushi,** në cilësinë e administratorit të shoqërisë **"Palushi" shpk**, më NIPT K12202004R, ka kryer veçmas veprime të cilat përmbajnë elementë të veprës penale të "*Korrupsioni aktiv i funksionarëve të lartë shtetërore ose të zgjedhurve vendorë*", parashikuar nga neni 245 i Kodit Penal; **iv) Shtetasi Fatmir Bektashi**, në cilësinë e administratorit dhe aksionerit të vetëm të **"Kontakt" shpk**, me NIPT J92108006V, ka kryer veçmas veprime të cilat përmbajnë elementë të veprës penale të "*Korrupsioni aktiv i funksionarëve të lartë shtetërore ose të zgjedhurve vendorë*", parashikuar nga neni 245 i Kodit Penal; **v) Shtetasi Shkëlqim Fusha**, në cilësinë e administratorit dhe aksionerit të vetëm të **"Fusha" shpk**, me NIPT J61922018S, ka kryer veçmas veprime të cilat përmbajnë elementë të veprës penale të "*Korrupsioni aktiv i funksionarëve të lartë shtetërore ose të zgjedhurve vendorë*", parashikuar nga neni 245 i Kodit Penal; **vi) Ndërsa shtetasi Elman Abule,** në cilësinë e administratorit të **"Rametal" shpk**, me NIPT L41517502C, ka kryer në bashkëpunim më shumë se një herë, veprime të cilat përmbajnë elementë të veprës penale të "*Pastrimi i produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale*", parashikuar nga neni 287/2 i Kodit Penal. Edhe në lidhje me këta shtetas, rezulton se ekziston dyshimi i arsyeshëm i bazuar në prova se kanë konsumuar veçmas elementët e veprës penale të parashikuar nga neni 245 dhe elementët e parashikuar nga neni 287/2 i Kodit Penal, duke përmbushur në këtë



SPAK.AL

mënyrë njërin kusht të vendosur nga ligjvënësi referuar nenit 228/1 të Kodit të Procedurës Penale, në lidhje me caktimin e masave të sigurimit personal. Gjithashtu, nga aktet e administruara konstatohet se përmbushet dhe kushti i dytë i të njëjtit nen, për shkak se për të pesë këta shtetas nuk rezulton të ketë ndonjë shkak padënueshmërie nga ato që lidhen me shuarjen e veprës penale për shkaqe parashkrimi apo shfuqizim të dispozitës përkatëse, referuar parashikimeve të pikës 2 të nenit 228 të Kodit të Procedurës Penale.

**146.3.1.** Sipas Prokurorisë së Posaçme në lidhje me <u>**anën objektive të veprës penale**</u> **sipas nenit 245 të ligjit material penal, konstatohet** se ajo konsumohet nëpërmjet kryerjes së veprimeve të paligjshme të cilat konsistojnë në premtim, propozim ose dhënie, të çdo lloj përfitimi të parregullt ose të një premtimi të tillë, për të kryer ose moskryer një veprim që lidhet me detyrën a funksionin e të zgjedhurit vendor.

**146.3.2.** Në rastin konkret, **shtetasi nën hetim Gentjan Sula,** dyshohet se ka kryer veprime aktive të kundërligjshme të cilat konsistojnë pikërisht në dhënien e përfitimeve të parregullta, në formë pasurish të paluajtshme tek i zgjedhuri vendor, kryetari i Bashkisë Tiranë, shtetasi Erion Veliaj, për të kryer ky i fundit veprime që lidhen me funksionin e tij.

**146.3.3. Shtetasi nën hetim Fatmir Bektashi,** dyshohet se ka kryer veprime aktive të kundërligjshme të cilat konsistojnë në dhënien e përfitimeve të parregullta, në formë sponsorizime tek OJF-të e kontrolluara nga shtetësja Ajola Xoxa, bashkëshortja e të zgjedhurit vendor, kryetarit të Bashkisë Tiranë, shtetasi Erion Veliaj, për të kryer ky i fundit veprime që lidhen me funksionin e tij. Gjithashtu, ky shtetas dyshohet se ka financuar bileta udhëtimi jashtë shtetit si edhe qëndrimet në hotele, jo vetëm për kryetarin e Bashkisë Tiranë, shtetasin Erion Veliaj, por edhe për bashkëshorten e tij, shtetasen Ajola Xoxa. Këto financime, në formë dhuratash, rezulton se i paraprijnë një projekti ndërtimi që shtetasi nën hetim planifikonte të kryente në qytetin e Tiranë, që më pas ka rezultuar se ka përfunduar. Më pas, periudha e marrjes së lejes së përdorimit për këtë objekt, rezulton që përkon me dhënien e një shume të hollash, në formë "sponsorizimi" për organizata e kontrolluara nga bashkëshortja e kryetarit të Bashkisë Tiranë, shtetësja Ajola Xoxa.

**146.3.4. Shtetasi nën hetim Sokol Kryeziu,** dyshohet se ka kryer veprime aktive të kundërligjshme të cilat konsistojnë në dhënien e përfitimeve të parregullta, në formë blerje të sendeve nga shoqëritë me përgjegjësi të kufizuar të kontrolluara nga bashkëshortja e të zgjedhurit vendor, kryetarit të Bashkisë Tiranë, shtetasi Erion Veliaj, për të kryer ky i fundit veprime që lidhen me funksionin e tij.

**146.3.5. Shtetasi nën hetim Meriman Palushi,** dyshohet se ka kryer veprime aktive të kundërligjshme të cilat konsistojnë në dhënien e përfitimeve të parregullta, në formë financimesh tek OJF-të e kontrolluara nga shtetësja Ajola Xoxa, bashkëshortja e të zgjedhurit vendor, kryetarit të Bashkisë Tiranë, shtetasi Erion Veliaj, për të kryer ky i fundit veprime që lidhen me funksionin e tij.

**146.3.6. Shtetasi nën hetim Shkëlqim Fusha,** dyshohet se ka kryer veprime aktive të kundërligjshme të cilat konsistojnë në dhënien e përfitimeve të parregullta, në formë likuidime faturash për shërbime të pakryera ndonjëherë, tek personat fizikë të kontrolluar nga shtetësja Ajola Xoxa, bashkëshortja e të zgjedhurit vendor, kryetarit të Bashkisë Tiranë, shtetasi Erion Veliaj, për të kryer ky i fundit veprime që lidhen me funksionin e tij.

**146.3.7. Të gjithë shtetasit e cituar më lart, nëpërmjet shoqërive të tyre tregtare kanë siguruar nga Bashkia Tiranë në mënyrë të vazhdueshme fonde publike si edhe leje**

SPDVETJA.AL

**ndërtimi, të cilat janë miratuar me firmën e kryetarit të Bashkisë Tiranë, shtetasit Erion Veliaj. Më pas, pjesë të këtyre fondeve apo dhe pasuri të paluajtshme janë dhënë si përfitime të parregullta me qëllim kryerjen e veprimeve që lidhen me funksionin e kryetarit të Bashkisë Tiranë, shtetasit Erion Veliaj. Ky i fundit dhe familjarë të afërt të tij janë përfitues të drejtpërdrejtë të këtyre përfitimeve të parregullta, përfshirë këtu edhe pasurinë e paluajtshme të ndodhur në Qerret, Kavajë.**

**146.4. Përsa i përket kritereve për caktimin e masës së sigurimit,** sipas Prokurorisë së Posaçme, në rastin e titullarit të Bashkisë Tiranë, shtetasit Erion Veliaj, por edhe të bashkëshortes së tij, shtetases Ajola Xoxa, rreziku i marrjes ose vërtetësisë së provës, bazuar kjo në tërësinë e rrethanave të faktit është real dhe i vazhdueshëm, nëse shtetasit nën hetim vijojnë të mos i nënshtrohen kufizimeve të lirisë nga ato që Kushtetuta e Republikës dhe ligji procedural penal parashikon. Kjo kërkesë argumentohet me qëllimin e Prokurorisë së Posaçme për të shmangur sa më shumë të jetë e mundur pengimin, ngadalësimin apo dhe devijimin në mënyrë të parregullt të procesit të të provuarit dhe vërtetimin e rrethanave të faktit të lidhura këto me procedimin penal në fjalë. Në këtë kuptim, duke patur në konsideratë ambientin ku shtetasit nën hetim jetojnë, funksionin publik që ushtron shtetasi Erion Veliaj, njohjet e shumta, lidhjet e siguruara dhe ndikimi mjaft i fortë që buron nga ushtrimi i këtij funksioni, rëndësia e të cilit shtohet në mënyrë eksponenciale nisur nga territori që mbulon dhe fondet publike që administron Bashkia Tiranë, si Bashkia me e madhe në vend, duke vlerësuar sjelljen e shfaqur nga vetë shtetasi nën hetim Erion Veliaj ndërsa dërgon mesazhe me natyrë të fortë intimiduese në drejtim të hetuesve të BKH-së, të cilëve u kërkon hapur të ndalojnë me thirrjen e bashkëshortes së tij për të dhënë deklarime, pranisë së një prej vartësve të kryetarit të Bashkisë Tiranë gjatë takimeve të zhvilluara nga bashkëshortja e këtij të fundit me personat e thirrur nga organi procedues, si edhe gjatë kontrollit të ushtruar nga hetuesit e BKH-së, si edhe duke patur në konsideratë sjelljen e shtetases Ajola Xoxa veçanërisht pas kontrolleve të ushtruara sipas vendimit të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, organi procedues ka arritur në përfundimin se ekziston rreziku real që disa prova të mos merren apo të merren në një formë të "*helmuar*".

**146.4.1.** Ky rrezik është provuar të jetë i prekshëm gjatë gjithë hetimit paraprak deri në këtë moment, sidomos në raport me personat që janë thirrur për të bërë deklarime pranë organit procedues, por edhe me sjelljen që kanë shfaqur shtetasit nën hetim gjatë kësaj periudhe. Në kushtet kur shtetasi nën hetim Erion Veliaj provohet të ketë dërguar mesazhe të shkruara në adresë të hetuesve të Byrosë Kombëtare të Hetimit, mesazhe këto që duket se kanë synimin të intimidojnë këta zyrtarë gjatë kryerjes së detyrës së tyre, mund të imagjinohet lehtë më pas sesi ky shtetas mund të sillet me dëshmitarët potencialë në këtë proces, pra me provat që kërkohet të merren nga organi procedues. Gjithashtu, prania e punonjësve të rëndësishëm të bashkisë Tiranë, vartës të drejtpërdrejtë të shtetasit Erion Veliaj, si gjatë kontakteve që shtetësja Ajola Xoxa ka patur me personat e thirrur për të dhënë deklarime në Prokurorinë e Posaçme, ashtu edhe gjatë momenteve të kontrollit në zyrat e "Partners Lač" shpk, dëshmon synimin për të vënë në rrezik marrjen e provave, por nga ana tjetër edhe miksimin e funksioneve publike me ato private të titullarit të bashkisë, duke i kërkuar personave që varen prej tij të kenë kontakte të paautorizuara me hetues në kryerje e sipër të detyrës. Nga ana tjetër, duke qenë se pjesa kryesore e hetimit penal është përqendruar në aktivitetet që lidhen me Bashkinë Tiranë, është e qartë se mundësia për të rrezikuar

marrjen e provave të nevojshme nga zyrat e këtij institucioni është e prekshme, përsa kohë që nga vetë natyra e tij hierarkike persona të varur në funksionet e tyre mund të intimidohen nga shtetasi nën hetim.

**146.4.2.** Siç më sipër u përmend, Prokuroria e Posaçme në momentin procedural ku ndodhemi disponon prova të pakundërshtueshme se shumica e deklaruesve të thirrur nga ana jonë janë kontaktuar para dhe pas seancave të marrjes në pyetje nga shtetasit nën hetim, specifikisht bashkëshortja e kryetarit të bashkisë Tiranë. Akoma më e rëndë paraqitet kjo situatë po të kemi në konsideratë dyshimet për kryerjen e veprimeve të cilat pengojnë zbulimin e së vërtetës. Një pjesë e madhe e deklaruesve ka pohuar se janë kontaktuar nga shtetësja Ajola Xoxa dhe madje janë thirrur prej saj, duke i dhënë orientime si duhet të sillen para organit procedues. Akoma më e rëndë paraqitet situata kur bëhet fjalë për shtetasen Ina Goxhaj, e cila është treguar mjaft e qartë në lidhje me takimet e zhvilluara para se të paraqitej në Prokurorinë e Posaçme, çfarë e ka orientuar shtetësja Ajola Xoxa dhe Klotilda Bushka, si edhe faktin që ka takuar shtetasen Ajola Xoxa dhe Klotilda Bushka pasi ka dalë nga Prokuroria e Posaçme, sipas orarit të lënë nga këto të fundit. Ky takim është dokumentuar nga grupet e vëzhgimit të hetuesve të BKH-së. Për më tepër, nisur nga deklarimet e shtetases Ina Goxhaj, kësaj të fundit i është kërkuar telefoni, i cili në fakt i është marrë, për t'ju zëvendësuar me një tjetër nga shtetësja Ajola Xoxa. Po, ashtu sipas të njëjtave deklarime, të cilat do të jenë objekt hetimi përgjatë hetimit paraprak, ka dyshime se aparati telefonik celular i kësaj shtetase është asgjësuar me ndihmën e shtetases Klotilda Bushka, në shtëpinë e prindërve të kësaj të fundit. E pyetur në lidhje me këto kontakte për persona që nuk janë pjesë e stafit të "Partners Laë" shpk, shtetësja Ajola Xoxa i mohoi në mënyrë kategorike.

**146.4.3.** Po kështu, referuar gërmës *b)* të nenit 228, pika 3, organi procedues vlerëson se në interes të zhvillimit të hetimeve dhe të garantimit të vendosjes së shtetasve nën hetim në dispozicion të nevojave të organit procedues, **do të ishte parandalimi i rrezikut të ikjes për këta të fundit.** Për të argumentuar këtë rrezik duhen përmendur jo vetëm lëvizjet e shumta jashtë vendit të kryetarit të Bashkisë Tiranë dhe të bashkëshortes së tij, mundësitë e tyre të pakufizuara financiare dhe si mjetet që duket se kanë në dispozicion, por më së pari rëndësia e fakteve dhe sanksionet e veprave penale për të cilat këta shtetas dyshohet të jenë autorë. Ky arsyetim vlen edhe për shtetasin nën hetim Elman Abule. Nga këtej, mund të arrihet në përfundimin logjik ligjor, në formën e mundësisë së arsyeshme, mbi mundësinë reale të ikjes, nëse nuk ndërhyhet për të caktuar një masë shtrënguese për këta shtetas. Këtu duhen përmendur masat e dënimit për veprat penale në ngarkim të shtetasit Erion Veliaj. *Neni 260 i Kodit Penal parashikon **dënimin me burgim nga katër deri në dymbëdhjetë vjet**. Neni 287 pgf 2 i Kodit Penal parashikon **dënimin me burgim nga shtatë gjer në pesëmbëdhjetë vjet**,* për të dy shtetasit nën hetim, por edhe për shtetasin tjetër nën hetim Elman Abule. Dhe sanksioni që lidhet me nenin 257/a pgf 2 të Kodit Penal, parashikon ***dënimin me gjobë ose me burgim deri në tre vjet.***

**146.4.4.** Në lidhje me gërmën *c)* të pikës 3 të nenit 228 të Kodit të Procedurës Penale, Prokuroria e Posaçme në kërkesën e saj analizon personalitetin e shtetasve nën hetim, edhe natyrën, llojin, mjetet, kohën dhe vendin e kryerjes se veprës penale, por edhe llojin dhe shkakun e pasojave të ardhura nga kryerja e saj, llojin dhe shkallën e fajësisë, por edhe sjelljen e autorëve të dyshuar pas momentit të marrjes dijeni se ndaj tyre kishte nisur një procedim. Këto rrethana së bashku me vlerësimin e personalitetit të shtetasve nën hetim nuk



SPAK

konsiderohen domosdoshmërisht kumulative, por gjithsesi duhen parë në harmoni me qëllimin e ligjvënësit në përcaktimin e kushteve dhe kritereve për vendosjen e një mase me karakter shtrëngues. Më së pari në lidhje me personalitetin e shtetasve nën hetim konstatohet se nga ana e tyre deri në këtë fazë të hetimeve nuk është shfaqur asnjë pendesë për veprimet e kryera në shkelje të ligjit. Ndërsa janë pyetur nga organi procedues, në kundërshtim me të gjitha provat evidente, këta shtetas kanë mohuar çdo përgjegjësi në lidhje me veprimet e kryera. Argumentat e tyre për mungesë përgjegjësie për shkak të të drejtave të tyre kushtetuese për të zhvilluar lirshëm aktivitete ekonomike, pa u kufizuar për kryerjen e tyre nga asnjë ligj apo akt nënligjor, apo dhe për mungesë dijenie si dhe mungesë memorie, në rastet kur janë ballafaquar me prova të qarta, dëshmon më së paku për një qasje aspak bashkëpunuese me organin procedues dhe nga ana tjetër tregon potencialin e përsëritjes së veprimeve të tyre në kundërshtim me ligjin. Por jo vetëm. Këta shtetas, gjatë kësaj faze kanë kryer veprime të cilat fillojnë më kontaktimin e deklaruesve të thirrur nga organi procedues, dhe përfundojnë me orientimin e këtyre të fundit se çfarë duhet të deklarojnë para këtij organi. Çfarë bën më të rëndë këtë situatë, është dyshimi i bazuar se këta shtetas mund të kenë tentuar të prishin provat, të cilat lidhen me sende të zotëruara më parë nga shtetas të përmendur më lart. Nga ana tjetër, sjellja e shtetasit nën hetim Erion Veliaj, kur bëhet fjalë për komunikimin e përdorur me hetuesit e BKH-së dhe "kurajon" e shfaqur nga ky shtetas për t'i lënë të shkruara mesazhet e tij intimiduese në adresë të organit procedues, dëshmon qartë për personalitetin e këtij të fundit.

**146.4.5.** Por çfarë paraqitet më e rëndësishme në çmim të Prokurorisë së Posaçme, është fakti që mekanizmi që këta shtetas kanë ideuar, vënë në funksion dhe zbatuar për një kohë të gjatë, duket i veshtirë të ndalet edhe prej vetë tyre. Sa më tepër që këta shtetas vijojnë të qëndrojnë të lirë aq më i madh është rreziku që ata të kryejnë krime të rënda, të të njëjtit lloj më ato për të cilat procedohen. Sipas Prokurorisë së Posaçme, gjatë gjithë kësaj periudhe të hetimit paraprak, por edhe së fundmi, përfitimet e parregullta të titullarit të Bashkisë Tiranë, të marra drejtpërdrejt apo tërthorazi, për vete por edhe për familjarët e afërt të tij, për kryerjen e veprimeve që lidhen me funksionin e tij, kanë vijuar pa u ndalur. Në këtë kuptim, nga hetimi deri në këtë fazë konstatohet se veprimet që i përkasin pastrimit të produkteve të veprës penale që lidhet me nenin 260 të Kodit Penal, nga shtetasi Erion Veliaj, për shkak edhe të mekanizmit të ngritur përgjatë gjithë këtyre viteve, të kryera në bashkëpunim dhe më shumë se një herë me bashkëshorten e tij Ajola Xoxa, kanë vijuar edhe për arsyen se një skemë e tillë, për shkak të kompleksitetit që paraqet, është objektivisht e vështirë të pushojë së ekzistuari përsa kohë që subjektet tregtare vijojnë e marrin financime apo përfitime të tjera nga Bashkia Tiranë, për të cilat në një formë ose një tjetër i duhet të jenë "mirënjohës" titullarit të këtij institucioni. Pra, mënyra si është vepruar për kryerjen e veprave penale, mjetet e përdorura, vijimësia në kryerjen e shkeljeve ligjore edhe pas marrjes dijeni për to, bashkëpunimi dhe kryerja më shumë se një herë si rrethanë cilësuese përsa i përket veprës penale të parashikuar nga neni 287/2 i Kodit Penal, shpërfillja e plotë prej titullarit të Bashkisë Tiranë ndaj fondeve publike të cilat për shkak të veprimeve të tij kanë përfunduar në llogaritë bankare të bashkëshortes së tij dhe organizatave e shoqërive që ajo efektivisht kontrollon, dhe rrjedhimisht në pasurimin personal të tij, vlerat e larta monetare të cilat dyshohet se janë përfituar nga bashkëshortët Veliaj-Xoxa, sugjeron edhe më tepër se personat

nën hetim rrezikojnë realisht për të kryer krime njësoj të rënda me ato për të cilat po procedohen.

**146.4.6.** Përsa i përket shtetasit Elman Abule, nga hetimi deri në këtë fazë ka rezultuar se veprimet e kundërligjshme të tij, të cilat lidhen me pastrimin e produkteve të veprës penale, kanë zgjatur në kohë dhe kanë sjellë si pasojë "justifikimin" e shumave të konsiderueshme monetare të cilat më pas kanë hyrë si përfitim pasuror në bashkësinë ligjore të shtetasve Veliaj-Xoxa.

**146.4.7.** Nga ana tjetër, në referim të nenit 229 të Kodit të Procedurës Penale "*Kriteret për caktimin e masave të sigurimit personal*", Prokuroria e Posaçme në kërkesën e saj për caktimin e masave me karakter shtrëngues për këta shtetas, thekson se duhet patur në konsideratë përshtatshmëria e tyre me shkallën e nevojave të sigurimit, rëndësinë e fakteve dhe sanksionet që parashikohen për veprat penale konkrete. Dispozitat penale për të cilat këta shtetas dyshohet të jenë autorë, parashikojnë dënime mjaft të rënda, duke paraqitur kësisoj një rrezikshmëri shoqërore mjaft të lartë të shtetasve nën hetim. Në këtë rast, rrezikshmëria e autorëve lidhet edhe me rrezikshmërinë e veprave penale dhe gjykata duhet të mbajë në konsideratë faktin se veprimtaria kriminale, të paktën në rastin e parashikuar nga neni 287 i Kodit Penal, është kryer në bashkëpunim dhe më shumë se një herë, dhe nga konsumimi i saj pasojat e ardhura janë të rënda. Një fakt i tillë shton dukshëm rrezikshmërinë e personave, autorë të dyshuar të veprave penale.

**146.5.** Për shkaqet e lartpërmendura, Prokuroria e Posaçme arsyeton se për shtetasin nën hetim Erion Veliaj dhe Elman Abule është me vend të vendoset nga Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar një masë sigurimi personal me karakter shtrëngues, e cila, në funksion të përmbushjes së qëllimit të organit procedues në lidhje me hetimin dhe gjykimin më pas të çështjes penale, vlerëson se duhet të jetë ajo "*Arresti në burg*", parashikuar nga neni 238 i Kodit të Procedurës Penale, si masa më e përshtatshme në raport me masat e tjera të parashikuara në ligjin procedural penal.

**146.5.1.** Ndërsa në lidhje me shtetasen nën hetim Ajola Xoxa, i vetmi shkak për të mos kërkuar të njëjtën masë sigurimi me karakter shtrëngues, siç organi procedues emon, lidhet me të qënit nënë i një fëmije të mitur, interesat më të larta të të cilit kanë qenë në fokus të argumentave të parashtruara në këtë kërkesë. Këtu duhet patur në konsideratë fakti që shtetësja nën hetim dyshohet të jetë autore veprash që paraqesin rrezikshmëri të lartë shoqërore. Gjithashtu, gjykata duhet të marrë në konsideratë edhe faktin që i gjithë mekanizmi i pastrimit të produkteve të veprës penale është ideuar, por çfarë është më e rëndësishme zbatuar në praktikë në përditshmëri, pikërisht nga shtetësja nën hetim Ajola Xoxa, e cila ka në asnjë rast nuk është shfaqur e dyzuar në marrjen ose jo të përfitimeve të parregullta. Më pas, kjo shtetase nuk ka shfaqur në asnjë moment shenja të ndonjë reflektimi pas ballafaqimit me provat, por, siç edhe ka vepruar në kryerjen e veprimeve të kundërligjshme (këtu duhet të mbahen në konsideratë komunikimet e përmendura më lart) është treguar edhe në këtë fazë konseguente në vijimësinë e sjelljes së saj në shkelje të ligjit. Gjithashtu, kjo shtetase në dy raste i është shmangur ballafaqimit me organin procedues, edhe pse i thirrur prej tij. Nga ana tjetër, nevoja për praninë fizike të nënës **Ajola Xoxa** pranë djalit të saj të mitur, është e vetmja rrethanë që e detyron organin procedues për të kërkuar një masë sigurimi personal të ndryshme nga ajo e parashikuar nga neni 238 i Kodit të Procedurës Penale. "*Arresti në shtëpi*", parashikuar nga neni 237 i Kodit të Procedurës Penale.

**146.5.2.** Në lidhje me shtetasit nën hetim **Gentjan Sula, Fatmir Bektashi, Shkëlqim Fusha, Meriman Palushi dhe Sokol Kryeziu,** Prokuroria e Posaçme çmon se masa më e përshtatshme në raport me veprën penale që dyshohet të kenë kryer secili veçmas, do të ishte ajo e parashikuar nga neni 234 i Kodit të Procedurës Penale. Këtu kemi parasysh disa elementë, të cilat lidhen veçanërisht me rrezikshmërinë relative që ligjvënësi i ka veshur veprës penale të parashikuar nga neni 245 i ligjit material. Nga ana tjetër, duhen patur edhe në konsideratë faktorë të tjerë, të cilët lidhen pikërisht me sanksionin që ligjvënësi ka parashikuar për këtë vepër, duke reduktuar në këtë mënyrë motivimin e këtyre shtetasve për t'u larguar nga vendi në mënyrë që t'i shmangen hetimit penal. Një arsye tjetër që organi procedues çmon se zvogëlon mundësinë e largimit të këtyre shtetasve jashtë vendit, lidhet me aktivitetin e tyre tregtar që zhvillohet më së shumti në territorin shqiptar dhe domosdoshmëria e ndjekjes nga afër të tij. Në këto kushte, për Prokurorinë e Posaçme do të ishte e pranueshme të caktohej një masë sigurimi më e butë në raport me masat e tjera të karakterit shtrëngues të parashikuar në ligjit procedural penal.

## III. Vlerësimi i Gjykatës.

### 1. Lidhur me kërkesën për caktimin e masës së sigurimit.

**147.** Masa e sigurimit ka karakter taksativ, që do të thotë se, mund të caktohen vetëm ato që ligji i parashikon si të tilla. Ato kanë karakter gjyqësor, pasi artikulohen konkretisht vetëm nëpërmjet një vendimi gjyqësor. Kjo cilësi e masave passjell karakterin e tyre diskrecional dhe vlerësues, pasi Gjykata nëpërmjet hulumtimit mbi aktet që serviren nga palët dhe mbi ligjin në fuqi do të arrijë të bëjë një analizë dhe të konkludojë mbi caktimin e masës konkrete. Cdo masë sigurimi ka si karakteristikë disponibilitetin e përhershëm të prokurorit, si organi që inicion rishtazi kërkesën dhe si organi që ka vlerësimin ekskluziv mbi nevojën maksimale të procedimit mbi masën që zgjedh të kërkojë, dhe vlerësimin e pasuar nga vendimmarrja e gjykatës. Gjithashtu, ato kanë karakter të jashtëzakonshëm, pasi caktimi i tyre nuk është aksesor i përhershëm i procedimit penal dhe si rrjedhim caktimi i tyre nuk është rregull, por një përjashtim nga rregulli. Kështu, Kodi i Procedurës Penale ka parashikuar në Titullin V të emërtuar nenin 232 ka parashikuar llojet e masave të sigurimit. Masat e sigurimit personal shtrëngues konsistojnë në shmangien e disponimit mbi veten dhe trupin pasi prek drejtëpërdrejtë lirinë personale të individit (habeas corpus ad subiciendum).

**148.** Për të vlerësuar kërkesën e prokurorit, Gjykata ka për detyrë funksionale të shqyrtojë të gjitha rrethanat, në favor ose kundër ekzistencës së një interesi publik, që përligj një përjashtim nga parimi i respektimit të lirisë së individit, duke pasur parasysh prezumimin e pafajësisë dhe paraqitjen e tij në argumentimin e vendimit të dhënë[17]. Për të normuar këtë hapësirë vlerësimi të gjykatës Kodi i Procedurës Penale ka parashikuar kushtet e përgjithshme që duhet të ekzistojnë në një rast konkret, në mënyrë që caktimi i një mase sigurimi dhe kufizimi i lirisë themelore të qytetarit të jetë kushtetutshmërisht i bazuar. Kështu, neni 228 parashikon se *"1. Askush nuk mund t'u nënshtrohet masave të sigurimit personal në qoftëse në ngarkim të tij nuk ekziston një dyshim i arsyeshëm, i bazuar në prova. 2. Asnjë masë nuk mund të zbatohet kur ka shkaqe padënueshmërie ose të shuajres së veprës*

[17] Shiko paragrafin 84 të Vendimit të Gjykatës Europiane të të Drejtave të Njeriut *Tomasi kundër Francës*, dt. 27.08.1993.

*penale. 3. Masat e sigurimit personal vendosen: a) kur ekzistojnë shkaqe të rëndësishme që vënë në rrezik marrjen e provës; b) kur i pandehuri është larguar ose ekziston rreziku që ai të largohet; c) kur për shkak të rrethanave të faktit dhe personalitetit të të pandehurit ka rrezik që ai të kryejë krime të rënda ose të të njëjtit lloj me atë për të cilin procedohet.".* Nga përmbajtja e kësaj dispozite rezulton se masa e sigurimit mund të caktohet vetëm në rast se: **i)** ekziston dyshimi i arsyeshëm, i bazuar në prova; **ii)** ekziston vepra penale (vepra nuk është shuar); **iii)** ekzistenca e kushteve të dënueshmërisë sipas të drejtës penale.[18] Gjykata çmon të analizojë secilin prej këtyre kushteve për të evidentuar nëse plotësohen ato në rastin objekt gjykimi.

**149. <u>Në lidhje me ekzistencën e *"dyshimin e arsyeshëm"*</u>**, Gjykata sjell në vemendje se standarti i dyshimit të arsyeshëm presupozon ekzistencën e atyre elementëve të mjaftueshëm juridikë dhe të rrethanave të faktit që i krijojnë bindje gjykatës në drejtim të mundësisë që personi nën hetim të ketë kryer veprën penale. **Dyshimi i bazuar në prova nuk kërkon që ai të jetë ezaurues, domosdoshmërisht një drejtimesh, pra në drejtim të fajësisë. Pavarësisht prej këtij dyshimi të arsyeshëm bazuar në prova se i gjykuari ka kryer veprën penale, në përfundim të gjykimit të themelit mund të rezultojë e të vërtetohet si fajësia, ashtu edhe pafajësia e të pandehurit.[19] Nga ana tjetër, ekzistenca e dyshimit të arsyeshëm bazuar në prova në ngarkim së të gjykuarit (fumus commissi delicti) është vetëm kushti fillestar, paraprak për zbatimin e masës së sigurimit, që normalisht për të qëndruar kjo e fundit nevojitet që dyshimi të qëndrojë i palëkundur në vijimsi.** Gjykata thekson se, ekzistenca e dyshimit të bazuar, se personi i arrestuar ka kryer një krim, përbën kusht sine qua non për rregullshmërinë e mbajtjes në paraburgim, por, në kalimin e një kohe të caktuar, ai nuk është më i mjaftueshëm. Atëherë Gjykata duhet të përcaktojë nëse organet e ndjekjes penale kanë argumente të tjera të bazuara për të përligjur vazhdimin e heqjes së lirisë[20], përndryshe do të mbetej e hapur mundësia e ndryshimit të masës apo e përshtatjes së saj me zhvillimet e mëtejshme të hetimit.

**149.1.** Gjykata sjell në vemendje gjithashtu se, standarti i të provuarit në këtë lloj seancë (dyshim i arsyeshëm i bazuar në prova) është krejt i ndryshëm me standartin e të provuarit në një gjykim penal themeli (tej çdo dyshimi të arsyeshëm). Kështu, në rastin e caktimit të masave të sigurimit, gjykata nuk mund të bëjë analizën e provave, por duhet të respektojë rigorozisht kërkesën e nenit 228 të Kodit të Procedurës Penale, sipas të cilit askush nuk mund t'i nënshtrohet masave të sigurimit personal në qoftë se në ngarkim të tij nuk ekziston një dyshim i arsyeshëm i bazuar në prova. Është e kuptueshme që, brenda afatit që duhet t'i paraqitet nga prokurori gjykatës kërkesa për caktimin e masës së sigurimit personal ndaj një personi, provat e marra janë në fazën fillestare por është e domosdoshme që, për të vendosur masën e sigurimit, ato të jenë të mjaftueshme për të pasur një dyshim të arsyeshëm për kryerjen e veprës penale prej tij. Në këtë aspekt, baza kryesore është ekzistenca e veprës penale me të gjithë elementët e saj pra, ekzistenca e faktit kriminal pa të cilin, nuk mund të

---

[18] Shiko vendimin Nr. 22, datë 25.06.2015 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë.
[19] Shiko Vendimin Unifikues të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë Nr. 7, dt. 14.10.2011, faqe 8.
[20] Shiko paragrafin 84 të Vendimit të Gjykatës Europiane të të Drejtave të Njeriut *Tomasi kundër Francës*, dt. 27.08.1993.



SPYETUET.AL

diskutohet për caktim mase sigurimi.[21] Gjykata Europiane e të Drejtave të Njeriut, në disa prej vendimeve të saj në interpretim të togfjalëshit "dyshimi i arsyeshëm", është shprehur se: ***"Dyshimi i arsyeshëm parashikon ekzistencën e provave të besueshme, të cilat mund ta bindin vëzhguesin e paanshëm se një person i caktuar mund të ketë kryer veprën penale, për të cilën dyshohet"*** (shih çështjet e Ciulla kundër Italisë, Murray kundër Mbretërisë së Bashkuar). Gjithashtu ajo ka mbajtur qëndrimin se: "dyshimi i arsyeshëm", që të përbëjë standard të ligjshëm për heqjen e lirisë, duhet të jetë i bazuar në prova, pasi mungesa e tyre do të sillte cënimin e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut (shih çështjen Fox, Cempbell dhe Hartley kundër Mbretërisë së Bashkuar).[22]

**149.2.** Duke u rikthyer në çështjen objekt gjykimi, Gjykata çmon se përpara se të konkludoj nëse ekzistojnë dyshime të arsyeshme të bazuara në prova konkrete se personat nën hetim, ka konsumuar veprat penale "*Korrupsioni aktiv i funksionarëve të lartë shtetërorë ose i të zgjedhurve vendorë*", të parashikuar nga neni 245 Kodit Penal, "*Korrupsioni pasiv i funksionarëve të lartë shtetërorë ose i të zgjedhurve vendorë*", kryer në bashkëpunim (9 herë), parashikuar nga neni 260 e 25 i Kodit Penal, "*Refuzimi për deklarimin, mosdeklarimi, fshehja ose deklarimi i rremë i pasurive, interesave private të personave të zgjedhur dhe nëpunësve publikë ose i çdo personi tjetër që ka detyrimin ligjor për deklarim*", parashikuar nga neni 257/a/2 i Kodit Penal, si dhe "*Pastrimi i produkteve të veprës penale apo i veprimtarisë kriminale*" të parashikuara nga neni 287, e kryer në rrethanën cilësuese "*në bashkëpunim*" dhe "*më shumë se një herë*" sipas nenit 287, paragrafi (2) i Kodit Penal, duhet të analizojë elementët e këtyre veprave penale.

**A. Lidhur me figurën e veprës penale *"Korrupsioni aktiv i funksionarëve të lartë shtetërorë ose i të zgjedhurve vendorë"*.**

**150.** Duke u kthyer në çështjen objekt gjykimi, prokuroria i ka atribuar personave nën hetim **Gentjan Sula, Fatmir Bektashi, Shkëlqim Fusha, Meriman Palushi dhe Sokol Kryeziu** faktin se ka dyshime të arsyeshme se kanë konsumuar elementët e figurës së veprës penale "*Korrupsioni aktiv i funksionarëve të lartë shtetërorë ose i të zgjedhurve vendorë*", të parashikuar nga neni 245 i Kodit Penal. Në këtë dispozitë parashikohet shprehimisht se: "*Premtimi, propozimi ose* ***dhënia****, drejtpërdrejt ose* ***tërthorazi****, i çfarëdo përfitimi të parregullt, funksionarëve të lartë shtetërorë ose të të zgjedhurve vendorë,* ***për vete ose për persona të tjerë*** *për të kryer ose mos kryer një veprim, që lidhet me detyrën a funksionin e tij, dënohen me burgim nga një deri në pesë vjet.*".

**151. Në lidhje me objektin e veprës penale, *"Korrupsioni aktiv i funksionarëve të lartë shtetërorë ose i të zgjedhurve vendorë"*.** Vepra penale për të cilën akuzohet i pandehuri është parashikuar nga Kodi Penal në Pjesën e posacme të tij, në Kreun VII, Seksioni I të titulluar "*Vepra penale kundër veprimtarisë shtetërore të kryera nga shtetasit*". Sipas nenit 245 të Kodit Penal rezulton se, ligjvënësi ka parashikuar një mbrojtje të posaçme, për një marrëdhënie juridike të rëndësishme, siç është ajo e vendosur nga shteti për të siguruar funksionimin normal dhe autoritetin e institucioneve shtetërore, si dhe interesave të ligjshme

[21] Shiko Vendimin e Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë me Nr.141 i Regj. Themeltar, Nr.112 i Vendimit, dt. 26.09.2005, faqe 3.
[22] Shiko vendimin Nr. 22, datë 25.06.2015 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë.

të personave fizikë apo, juridikë. Cenimi i kësaj marrëdhënieje nga shtetasit përbën krim dhe passjell përgjegjësi penale. Qëllimi i mbrojtjes së marrëdhënies juridike në fjalë, nga shkelja e normës penale është ruajtja e ushtrimit të ligjshëm të funksioneve publike në sistemin e drejtësisë, ruajtja e besimit që individët kanë tek funksionarët që ushtrojnë detyra publike, në përputhje me parimin e ligjshmërisë dhe besnikërisë së ushtrimit të detyrës publike, duke i shërbyer me përpikëri vetëm interesave publike, në mënyrë të paanshme dhe objektive.[23] Në bazë të nenit 107/1 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, nëpunësit publikë (dhe jo vetëm ata civilë) zbatojnë ligjin dhe janë në shërbim të popullit. Prandaj, edhe ushtrimi i detyrës publike duhet të udhëhiqet vetëm nga respektimi i ligjit dhe shërbimi ndaj interesave publike, dhe jo i atyre interesave të tjera private të shkëmbimit që nuk duhet të mbivendosen apo të dalin mbi ndjekjen e interesave publike.

**152. Në lidhje me anën objektive *(actus rea)* të figurës së veprës penale *"Korrupsioni aktiv i funksionarëve të lartë shtetërorë ose i të zgjedhurve vendorë"*.** Gjykata thekson se ajo është element i domosdoshëm për përgjegjësinë penale, sepse nëse nuk ka veprim ose mosveprim të dënueshëm nuk ka vepër penale. Askush nuk mund të dënohet për mendimet apo idetë e tij. Pra, ana objektive paraqet sulmin kriminal të shqyrtuar nga ana e tij e jashtme, nga pikëpamja e zhvillimit gradual dhe konsekuent të ngjarjeve dhe fenomeneve, të cilat fillojnë të vihen në lëvizje me kryerjen nga subjekti i veprimit ose mosveprimit dhe përfundojnë me ardhjen e një rezultati të caktuar kriminal. Nga teoria e së drejtës penale dhe praktika gjyqësore rezulton se, element të anës objektive të figurës së veprës penale janë: *i) veprimi ose mosveprimi* i kundërligjshëm; *ii) mënyra e kryerjes së veprës penale*, me të cilën kuptohet renditja e veprave, metodat e përdorura, karakteri kronologjik dhe specifika e lëvizjeve që bën personi për kryerjen e veprës penale. Mënyra e kryerjes së veprës penale lidhet ngushtësisht me mjetet e përdorura nga personi për realizimin e saj; dhe *iii) Koha, vendi dhe ambjenti i kryerjes së veprës penale*, me të cilën kuptohet grumbullimi dhe tërësia i kushteve konkrete, në të cilat kryhet veprimi ose mosveprimi kriminal, në të cilat zhvillohet lidhja shkakësore[24] dhe vjen rezultati (pasoja) kriminale. Këto kushte ekzistojnë objektivisht dhe pavarësisht nga vullneti i subjektit i veprës penale.

**152.1.** Në kuptim të nenit 245 të Kodit Penal, vepra penale kryhet nga ana objektive nëpërmjet premtimit, propozimit ose dhënies, drejtpërdrejt ose tërthorazi, i çfarëdo përfitimi të parregullt, funksionarëve të lartë shtetërorë ose të të zgjedhurve vendorë, për vete ose për persona të tjerë për të kryer ose mos kryer një veprim, që lidhet me detyrën ose funksionin e tij. Gjykata çmon të sqarojë se kush do të konsiderohen *"funksionarëve të lartë shtetërorë"*.

---

[23] Shiko vendimin Nr. 139, datë 22.11.2017 i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë.

[24] Shiko vendimin Nr. 06, datë 01.02.2017 i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, ku parashikohet shprehimisht se: *"Bazuar në parimin latin "Nullum crimen, nulla poena sine causa" (Nuk ka krim, nuk ka dënim pa shkak), lidhja shkakësore, si një nga tre elementët e domosdoshëm të anës objektive të figurës së veprës penale e parashikuar në nenin 13 të K.Penal, vendos kushtin për ekzistencën e përgjegjësisë penale. Si e tillë ajo mund të përfytyrohet si një segment me dy skaje me pikë nistore shkakun, veprimin apo mosveprimin e kundraligjshëm dhe pikë fundore pasojën. Lidhja shkakësore shpreh pikërisht marrëdhënien që krijohet mes këtyre dy elementëve. E thënë ndryshe, lidhja shkakësore mund të kuptohet si marrëdhënia e varësisë që ekziston mes veprimit ose mosveprimit dhe pasojës përfundimtare të ardhur në një ngjarje konkrete, çka do të thotë se ekzistenca e pasojës shoqërisht të rrezikshme duhet të jetë rezultat i drejtpërdrejtë i veprimeve të të pandehurit dhe se po të mos ekzistonin veprimet konkrete të kryera prej tij të fundit, nuk do të ekzistonte as pasoja. Ashtu si edhe çdo element tjetër i veprës penale, lidhja shkakësore duhet të provohet. Pra, nëçdo gjykim duhet të evidentohet lidhja mes veprimit apo mosveprimit dhe pasojës së ardhur në çështjen konkrete objekt gjykimi, në mënyrë që vepra penale e parashikuar nga ligji të konsiderohet e kryer nga autori i veprimit apo mosveprimit."*.

Për t'i dhënë përgjigje kësaj pyetje, Gjykata çmon t'i referohet Ligjit Nr. 9584, datë 17.7.2006 "PËR PAGAT, SHPËRBLIMET DHE STRUKTURAT E INSTITUCIONEVE TË PAVARURA KUSHTETUESE DHE TË INSTITUCIONEVE TË TJERA TË PAVARURA, TË KRIJUARA ME LIGJ". Kështu, në nenin 2 të këtij Ligji parashikohet shprehimisht se: ***"1. "Institucione kushtetuese dhe institucione të tjera të pavarura, të krijuara me ligj"*** *janë: Institucioni i Presidentit, Kuvendi, Avokati i Popullit, Gjykata Kushtetuese, Kontrolli i Lartë të Shtetit, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, Komisioni i Shërbimit Civil, Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive, Autoriteti i Konkurrencës, Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare, Enti Rregullator i Telekomunikacionit, Enti Rregullator i Energjisë, Entit Rregullator i Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Largimit e Përpunimit të Ujërave të Ndotura, Këshilli i Lartë i Drejtësisë dhe Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit.* ***2. "Funksionarë të lartë"*** *janë titullarët e institucioneve që bëjnë pjesë në fushën e veprimit të këtij ligji, të cilët mund të jenë* ***funksionarë politikë ose të tjerë të emëruar,*** *anëtarët e organeve drejtuese të tipit kolegjial të institucioneve kushtetuese dhe institucioneve të tjera të pavarura, të krijuara me ligj,* ***si dhe funksione të përmendura shprehimisht në ligjet përkatëse."***. Gjithashtu, Gjykata çmon që t'i referohet Ligjit Nr. 95/2016 "PËR ORGANIZIMIN DHE FUNKSIONIMIN E INSTITUCIONEVE PËR TË LUFTUAR KORRUPSIONIN DHE KRIMIN E ORGANIZUAR", i ndryshuar. Kështu, në nenin 3 pika 2 të këtij Ligji nën titullin **"Përkufizimet"** parashikohet shprehimisht se: *"Në këtë ligj termat e mëposhtëm kanë këto kuptime: ....2.* ***"Drejtues të institucioneve shtetërore qendrore ose të pavarura"*** *nënkupton Drejtorin e Policisë së Shtetit, Shefin e Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura, Inspektorin e Përgjithshëm të Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave, Guvernatorin e Bankës Qendrore të Shqipërisë, Kryetarin e Kontrollit të Lartë të Shtetit, Kryetarin e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve dhe Drejtorin e Shërbimit Informativ Shtetëror."*.

**152.2.** Gjykata çmon se në respektim të parimit të ligjshmërisë që lidhet me cilësimin juridik të faktit penal duhet të sqarohet kuptimi i termave të përmendura në këtë dispozitë ***"Premtimi"*** – i referohet situatës së dhënies së ryshfetit nga premtuesi pas veprimit që duhet të ndërmarrin funksionarët e lartë shtetërorë ose të zgjedhurit vendorë. ***"Propozimi"*** – i referohet situatës kur propozuesi shfaq gatishmërinë e tij për të dhënë ryshfetin në çdo moment. ***"Dhënia"*** – i referohet situatës kur dhuruesi e ka transferuar përfitimin e parregullt drejt funksionarëve të lartë shtetërorë ose të të zgjedhurve vendorë. ***"Tërthorazi"*** nënkupton rastet kur transaksioni mund të realizohet edhe me anë të ndërmjetësve, pavarësisht faktit nëse përfituesi ose pranuesi i përfitimit të parregullt mund të jetë funksionari i lartë shtetëror ose i zgjedhuri vendor. ***"Për vete ose për persona të tjerë"*** nënkupton rastin kur përfitues është vetë personi subjekt i veprës penale të korrupsionit pasiv, ndërsa ***"persona të tjerë"*** përfshin rastet kur përfitimi i parregullt jo domosdoshmërisht i jepet personalisht funksionarit të lartë shtetëror ose i zgjedhuri vendor, sepse përfitimi i parregullt mund t'i jepet p.sh. të afërmit ose të njohurit të zytrit.

**152.2.1.** Gjykata çmon të theksoj se që të konsumohet vepra penale e korrupsionit aktiv i funksionarëve të lartë shtetërorë ose të të zgjedhurve vendorë, duhet që i pandehuri të kryejë veprën penale me veprime aktive të kundërligjshm nëpërmjet premtimit, propozimit ose dhënies drejtpërdrejtë ose tërthorazi, ***"çdo lloj përfitimi të parregullt"*** **si: para apo përfitime të tjera jo materiale, si dhe krijimi i favorizimeve, përfitimi i shërbimeve apo**

**privilegjeve të parregullta**, funksionarit të lartë shtetëror ose të zgjedhurit vendor, për vete ose për persona të tjerë për të kryer ose mos kryer një veprim, që lidhet me detyrën ose funksionin e tij. Sikundër mund të vërehet, në themel të anës objektive të kësaj figure të veprës penale, parashikohet **<u>një shkëmbim i kundërligjshëm dhe i ndërsjellë</u>**, në të cilën veprimet ose mosveprimet e funksionarit të lartë shtetëror ose të zgjedhurit vendor konsistojnë në kërkimin e premtimit ose marrjen e një përfitimi për vete ose për të tjerë, apo pranimin e një oferte, me ato të një subjekti të jashtëm, i cili nga ana e tij premton ose ofron një përfitim të paligjshëm.[25] Gjithashtu, vepra penale e korrupsionit aktiv i funksionarëve të lartë shtetërorë ose të të zgjedhurve vendorë, realizohet, si në rastin kur përfitimi i padrejtë lidhet me një veprim a mosveprim me qëllim për të mos e kryer funksionin publik siç duhej, ashtu edhe në rastin kur përfitimi i padrejtë lidhet me një veprim a mosveprim me qëllim për ta kryer, *"në dukje"* siç duhet funksionin publik apo detyrën në fjalë. Vepra penale e korrupsionit aktiv, konsiderohet e kryer qe nga çasti i premtimit, propozimit ose dhënies drejtpërdrejtë ose tërthorazi, *"çdo lloj përfitimi të parregullt"* funksionarit publik. Kësisoj, vepra penale do të quhet e konsumuar edhe pa u realizuar konkretisht një shkëmbim parash apo shpërblim në përfitime të tjera mes dy palëve, pasi mjafton që të arrihet një marrëveshje (*pactum sceleris*) në formë premtimi për përfitime të parregullta të dyanshme, edhe pa marrjen e kontaktit të drejtpërdrejtë mes palëve, mjafton që funksionari të ketë dijeni rreth saj dhe marrëveshja korruptive mund të bazohet edhe nga fakte përmbyllëse.[26]Gjykata vlerëson se *"parregullsi e përfitimit"* do të thotë që ai nuk është ligjshëm dhe i detyrueshëm, sipas normave të së drejtës dhe se funksionari nuk ka as të drejtën, as tagrin, as detyrimin për ta marrë atë. Kësisoj, Gjykata vlerëson se mund të merret dhënia e një përfitimi material apo pranimi i një premtimi të parregullt, në mënyrë të shprehur, të heshtur, në mënyrë të drejtpërdrejtë apo edhe të tërthortë, por gjithnjë nëse ekziston dijenia që marrja apo pranimi është në korrelacion më dhënien apo premtimin e një të treti.[27]

152.2.2. Gjykata çmon se është fakt i njohur që procesi i çmuarjes së provave është proces i ndërlikuar dhe kompleks, pasi përbërës të tij janë komponentë sa juridiko-faktikë, aq edhe të brendshëm, psikologjikë, nga të cilët duhet të udhëhiqet dhe nga i cili ndikohet trupi gjykues në formimin e bindjes së brendshme, pas shqyrtimit prej tij, në tërësi, të provave të administruara gjatë gjykimit, prova këto që doemos duhet të jenë marrë në zbatim të kërkesave të nenit 151 të K.Pr.Penale. Në nenin 152 të K.Pr.Penal nën titullin **"Çmuarja e provave"** parashikohet shprehimisht se: *"1. Asnjë provë nuk ka vlerë të paracaktuar nga ligji. Gjykata, pas shqyrtimit të provave në tërësi, çmon vërtetësinë dhe fuqinë provuese të tyre, duke argumentuar arsyet ku është mbështetur për të krijuar bindjen e saj."*,[28]ndërsa në

---

[25] Shiko vendimin Nr. 216, datë 16.12.2015 i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë.
[26] Po aty.
[27] Shiko vendimin Nr. 139, datë 22.11.2017 i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë.
[28]Shiko Vendimin Nr. 31, datë 31.01.2013 i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, ku thuhte se *"Kodi i Procedurës Penale në nenin 149 ka dhënë nocionin e provës duke përcaktuar se: "Provat janë njoftimet mbi faktet dhe rrethanat që lidhen me veprën penale, që merren prej burimeve të parashikuara në ligjin procedural penal, në përputhje me rregullat e caktuara prej tij dhe që shërbejnë për të vërtetuar kryerjen ose jo të veprës penale, pasojat e ardhura prej saj, fajësinë ose pafajësinë e të pandehurit dhe shkallën e përgjegjësisë". Ndërkohë që në nenin 152/2 të K.Pr.Penale është përcaktuar se "...2. Ekzistenca e një fakti nuk mund të nxirret nga indiciet përveçse këto janë të rëndësishme, të sakta dhe në përputhje me njëra-tjetrën ". Ndërkohë që ligjvënësi ka dhënë definicionin përsa i përket se çfarë është provë në kuptimin procedural kuptimin e indicjes si mjet procedural provueshmërie e jep teoria e së drejtës procedurale penale. Indicja është një pjesë e provës*

nenin 380 të K.Pr.Penale nën titullin **"Provat që mund të përdoren për të marrë vendimin"** parashikohet shprehimisht se: *"1. Për të marrë vendimin gjykata nuk mund të përdorë prova të tjera veç atyre që janë marrë ose janë verifikuar në shqyrtimin gjyqësor.* ".Nga përmbajtja e këtyre dispozitave rezulton se çdo provë vlerësohet në unitet me provat e tjera që do të thotë se asnjë provë nuk ka vlerë të paracaktuar, në të kundër nuk do të kishim çmuarje të provave. Pra, çmuarja e provave përbëhet prej veprimeve të Gjykatës për përcaktimin e vërtetësisë dhe mjaftueshmërisë së provave. **Vërtetësia e provave** është përcaktimi i saktësisë së fakteve provuese domethënë arritja në përfundimin nëse një provë i përgjigjet ose jo së vërtetës. **Mjaftueshmëria e provave** është përcaktimi që bëhet se bashkësia dhe tërësia e tyre lejon nxjerrjen e përfundimit të vërtetë për ekzistencën e faktit për të cilin ato (prova) janë mbledhur. Në qoftë se në bazë të provave të mbledhura është e pamundur arritja e një përfundimi të tillë, kjo gjë tregon se provat nuk janë të mjaftueshme.Në nenin 152 të K.Pr.Penale është sanksionuar parimi i çmuarjes së lirë të provave.Provat shqyrohen sipas bindjes së brendshme duket zbatuar metodën dialektike gjëtë vlerësimit të provave, sipas kësaj metode vërtetësinë e provave duhet ta shikojmë në lidhje të përgjithshme dhe varësi reciproke me provat e tjera dhe me faktet e çështjes, pra duhet ta shikojmë në mënyrë të gjithëanshme. **Me bindje të brendshme,** kuptojmë atë ndjenjë që formohet tek organi procedues në bazë të ndijimeve të përshtyojeve të tij për drejtësinë e përfundimeve të arritura për saktësisnë dhe mjaftueshmërinë e provave. Bindja e brendshme formohet nga shqyrtimi i të gjitha rrethanave të çështjes në tërësinë e tyre. Kjo kërkesë e ligjit ka për qëllim që të detyrojë Gjykatën që para se ajo të arrijë në përfundimin e saj, lidhur me vlerësimin e provave, të marrë në shqyrtim jo vetëm njërën anë të provës që bën fjalë për vërtetësinë e saj, por dhe anën e kundërt që e ve në dyshim ose e mohon këtë vërtetësi, që **gjykat të mbështetet jo vetëm te një provë, por në disa të tilla**, që duke i vlerësuar në tërësinë e tyre të lejojnë jo nxjerrjen e një përfundimi hipotetik por një të vetëm dhe të pakundërshtueshëm.[29]

**152.3.** Gjithashtu, Gjykata çmon se ekzistenca e një fakti mund të nxirret nga indicjet kurr këto janë të rëndësishme, të sakta dhe në përputhje me njëra-tjetrën. Duke u rikthyer në rastin konkret, Gjykata çmon se ekzistojnë dyshime të arsyeshme të bazuara në prova se personat nën hetim **Gentjan Sula, Fatmir Bektashi, Shkëlqim Fusha, Meriman Palushi dhe Sokol Kryeziu** i kanë konsumuar nga ana objektive figurën e veprës penale "*Korrupsioni aktiv i funksionarëve të lartë shtetërorë ose i të zgjedhurve vendorë*", të parashikuar nga neni 245 i Kodit Penal.

**152.3.1.** Në kuadrin e luftës kundër korrupsionit dhe pastrimit të produkteve të veprës penale, pas viteve '90 janë ndërmarrë një sërë masash me karakter ligjor, institucional dhe sensibilizues. Këtij qëllimi i ka shërbyer ratifikimi nga shteti shqiptar i një tërësie instrumentesh ndërkombëtare ku është parashikuar përgjegjësia penale e personave juridik, si: i) Konventa penale për korrupsionin, ratifikuar me Ligjin Nr. 8778, datë 26.04.2001, ii)

---

*(probatio simplena) e cila nuk mund ta provojë në mënyrë të plotë një fakt por në mënyrë të përafërt. Gjykata vlerëson sedallimi midis provës dhe indicjes qëndron në atë që: nëse e para vërteton në mënyrë të drejtpërdrejtë ekzistencën ose jo të një fakti, e dyta është një rrethanë nga e cila mund të arrihet në një deduksion të logjikshëm, një konkluzion i përafërt mbi ekzistencën ose jo të një fakti.".*

[29]Shiko "E Drejta Procedurale Civile I", Ribotimi i katërt, Prishtinë 2004, autori Prof.Dr.Faik Brestovci, faqe 249-250.

Konventa e Kombeve të Bashkuara Kundër Korrupsionit, ratifikuar me Ligjin Nr. 9492, datë 13.03.2006; **iii)** Konventa e Këshillit të Europës "Për pastrimin, kërkimin, kapjen dhe konfiskimin e produkteve të krimit dhe për financimin e terrorizmit", ratifikuar me Ligjin Nr. 9646, datë 27.11.2006. Në nenin 10 të kësaj Konvente nën titullin **"Përgjegjësia e personave juridikë"** parashikohet shprehimisht se: ***"1. Çdo Palë do të miratojë masa legjislative dhe masa të tjera sipas nevojës, për të siguruar që një person juridik mund të konsiderohet përgjegjës për veprën penale*** *të pastrimit të parave të përcaktuar sipas kësaj Konvente,* ***të kryer për qëllim përfitimi nga një person fizik, duke vepruar individualisht ose si pjesë e një organi të personit juridik që ka një pozicion drejtues brenda këtij personi juridik, bazuar në:*** *a) një prokurë nga personi juridik; b) një autoritet që merr vendime në emër të personit juridik; dhe c) një autoritet që ushtron kontroll brenda personit juridik.* ***2.*** *Përveç rasteve që janë parashikuar në paragrafin 1,* ***çdo Palë do të marrë masat e nevojshme për të siguruar që një person juridik të mund të konsiderohet përgjegjës, kur mungesa e mbikëqyrjes ose kontrollit nga një person fizik referuar në paragrafin 1, ka bërë të mundur kryerjen e veprës penale*** *të përcaktuar sipas paragrafit 1,* ***për përfitim të atij personi juridik nga një person fizik që vepron nën autoritetin e tij. 3. Kjo përgjegjësi e përcaktuar në këtë nen nuk do të përjashtojë procedimet penale kundër personave fizikë që kanë kryer, nxitur apo ndihmuar në kryerjen e veprave penale*** *referuar në paragrafin 1. 4. Çdo Palë do të sigurojë që personat juridikë që përgjigjen në përputhje me këtë do të jenë objekt i sanksioneve ligjore efektive, proporcionale, penale ose jopenale, duke përfshirë dhe sanksionet financiare, me qëllim dhënien fund të veprimtarisë antiligjore."*.

**152.3.2.** Konventa e së drejtës penale të Këshillit të Evropës për korrupsionin e kufizon përgjegjësinë tek vepra penale ***"të kryera për llogari të personit juridik"***. Sipas këtij koncepti, akti duhet të jetë kryer në emër apo për përfitim të kompanisë, por kompania në fjalë mund të mos ketë përfituar domosdoshmërisht nga ky akt. P.sh. Një punonjës negocion një kontratë me zyrtarë të qeverisë dhe gjatë negociatave u ofron një ryshfet nëse kompania fiton kontratën. Kompania nuk e di nëse ky ryshfet ka qenë vendimtar apo jo në lidhjen e kontratës. Megjithatë, ryshfeti jepet me qëllim përfitimin e kompanisë, edhe në rast se kompania nuk ka dashur në fund të fitojë këtë kontratë. Formulimi i Konventës së të drejtës penale të Këshillit të Evropës për korrupsionin ndjek këtë qasje, duke e përcaktuar përgjegjësinë për aktet e kryera për **"përfitim"** të kompanisë. Megjithatë, raporti shpjegues i referohet edhe konceptit të ***"interesit të përgjithshëm"***, duke u shprehur ***"se vepra penale duhet të jetë kryer për përfitim ose për llogari të personit juridik."***. *(Komenti 86, Raport Shpjegues).* Në këtë kriter, akti duhet të jetë kryer për interes të kompanisë ose në emër të kompanisë, por personi juridik mund të mos ketë përfituar domosdoshmërish prej tij.

**152.3.3.** Mbështetur në aktet ndërkombëtare në legjislacionin penal është parashikuar përgjegjësi penale e personave juridike edhe në Republikën e Shqipërisë. Kështu, në nenin 45 të Kodit Penal nën titullin **"Zbatimi i ligjit penal ndaj personave juridikë"** parashikohet shprehimisht se: ***"Personat juridikë,*** *me përjashtim të institucioneve shtetërore,* ***përgjigjen penalisht për vepra penale,*** *të kryera* ***në emër*** *ose* ***në dobi të tyre nga organet dhe përfaqësuesit e tyre.*** *Njësitë e qeverisjes vendore përgjigjen penalisht vetëm për veprime të kryera gjatë ushtrimit të veprimtarisë së tyre, të cilat mund të ushtrohen nëpërmjet delegimit të shërbimeve publike.* ***Përgjegjësia penale e personave juridikë nuk përjashton atë të***

***personave fizikë, të cilët kanë kryer ose janë bashkëpunëtorë në kryerjen e të njëjtave vepra penale.*** *Veprat penale dhe masat ndëshkuese përkatëse, që zbatohen ndaj personave juridikë, si dhe procedura për vendosjen dhe ekzekutimin e tyre rregullohen me ligj të veçantë.".* Më tej përgjegjësia penale e personave juridik është rregulluar me Ligjin Nr. 9754, datë 14.06.2007 "Për përgjegjësinë penale të personave juridik". Kështu, në nenin 3 të këtij ligji nën titullin **"Përgjegjësia e personit juridik për kryerjen e veprës penale"** parashikohet shprehimisht se: *"Personi juridik ka përgjegjësi për vepra penale të kryera: a)* ***në emër ose në dobi të tij, nga organet dhe përfaqësuesit e tij;*** *b) në emër ose në dobi të tij, nga një person, që është nën autoritetin e personit që përfaqëson, drejton dhe administron personin juridik;* ***c) në emër ose në dobi të tij, për shkak të mungesës së kontrollit apo të mbikëqyries nga personi që drejton, përfaqëson dhe administron personin juridik."***, ndërsa në nenin 4 të këtij ligji nën titullin **"Organe dhe përfaqësues që veprojnë në emër ose në dobi të personit juridik"** parashikohet shprehimisht se: *"Në kuptim të nenit 3 shkronja "a" të këtij ligji,* ***organ dhe përfaqësues i personit juridik, që vepron në emër ose në dobi të personit juridik, është çdo person fizik, i cili, sipas ligjit ose akteve të personit juridik, është ngarkuar për përfaqësimin, drejtimin, administrimin*** *ose kontrollin e fushës së veprimtarisë* ***së personit juridik dhe të strukturave të tij.***". Gjykata çmon se mungesa e kontrollit apo mbikëqyrjes se personit juridik që shoqërohen me kryejen e një vepre penale mund të sjellë përgjegjësi penale si për personin juridik ashtu dhe personin/at fizik që sipas ligjit ose akteve të personit juridik, është ngarkuar për përfaqësimin, drejtimin, administrimin ose kontrollin e fushës së veprimtarisë së personit juridik dhe të strukturave të tij.

**152.3.3.** Rrethi i personave fizikë që mund të sjellin përgjegjësi penale për personin juridik mund të klasifikohen në tre kategori: **i) Kategoria e parë**: personat fizik që drejtojnë, administrojnë apo përfaqësojnë personin juridik. (Administratorët e shoqërive, anëtarët e asamblesë së përgjithëshme, anëtarët e këshillit të administrimit, anëtarët e këshillit mbikëqyrës); **ii) Kategoria e dytë**: personat fizikë që veprojnë nën autoritetin e personit që drejton dhe administron personin juridik, ose nënpunësit. Nuk përfshihet çdo punonjës, por duhet që këta persona fizikë të kenë një pushtet domethënës në ushtrimin e veprimtarisë së përditëshme të personit juridik. (Për shembull: inxhinierët e ndërtimit, supërvizorët, menaxherët operacional, juristët e shoqërisë tregtare, financierët etj.); dhe **iii) Kategoria e tretë**: personat fizikë të cilët nuk janë pjesë e strukturave të brendëshme të personit juridik, por që janë të lidhur me personin juridik me një nga mënyrat e parashikuara nga Kodi Civil (që ka një prokurë përfaqësimi).

**152.3.4.** Kusht i domosdoshëm që personi juridik të mbajë përgjegjësi penale është që vepra penale të jetë kryer "në emër" ose "në dobi" të personit juridik. Shprehja *"në emër"*. Që të gjejë zbatim shprehja në emër, duhet që vepra penale të kryhet nga një kategori e caktuar subjektesh (persona fizikë) të cilët veprojnë pranë personit juridik si dhe për interesat ekskluzive të tij, dhe jo për interesa personale. *"Në dobi"*. Kuptohet përfitimi që do të vijë nga kryerja e veprës penale për personin juridik. Përfitimi mund të jetë ekonomik, por jo vetëm. Dobia apo përfitimi duhet të verifikohet pasi të jetë kryer vepra penale, pasi vetëm atëherë do jetë plotësisht i matshëm. Shprehja ***"në dobi"*** të personit juridik do të thotë se i gjithë rezultati ekonomik dhe juridik i veprimit që kryhet, i përket personit të përfaqësuar, pavarësisht nga fakti se cilat janë mjetet e shpenzuara për këtë qëllim. Pra, nga sa më sipër do të kuptohet se pavarësisht se një nga subjektet fizikë të përmendura më lart, nuk po vepron në

emër të personit juridik, nëse vërtetohet se vepra penale është kryer në mënyrë që personi juridik të realizonte një përfitim prej saj, i cili mund të jetë ekonomik ose jo, personi juridik do të mbajë përgjegjësi penale. Përveç përfitimit monetar që mund të realizojë një person juridik, i cili mund të jetë edhe më i përgjithshëm, nuk përjashtohet edhe mundësia që vepra penale të kryhet në mënyrë që personi juridik të mund të përfitojë ndonjë të drejtë. P.sh marrja e një licence, marrja pjesë në një tender publik, etj.

*I) Lidhur me dhënien e përfitimit të parregullt "vilës" nga personi nën hetim Gentjan Sula personave nën hetim Erion Veliaj e Ajola Xoxa.*

**152.4.** Nga analiza e provave dhe fakteve të cituara në paragrafët 24, 25, 26, 27, 28, 29, 29.1, 29.2, 29.3, 29.3.1, 29.3.2, 29.4, 29.5, 30, 30.1, 31, 31.1, 32, 32.1, 32.2, 32.3, 32.4, 32.5, 32.6, 32.7, 32.8, 32.9, 32.10, 33, 34, 35, 35.1, 35.2, 35.3, 35.4, 35.5, 35.6, 35.7, 35.8, 35.8.1, 35.8.2, 35.8.3, 36, 37, 37.1. 38, 35.8.1, 35.8.1, 35.8.3, 36, 37, 37.1, 38, 38.1, 39, 40, 41, 42, 42.1, 43, 43.1, 43.2, 43.3, 43.3.1, 44, 44.1, 45, 46, 47, 47.1, 47.2 dhe 48 të këtij vendimi të para në unitet me njëra tjetrën, Gjykata çmon se ekziston dyshimi i arsyeshëm se shoqëria "Agi Kons" shpk me pronar 100% të kuotave personin nën hetim Gentjan Sula[30] i ka dhënë shtetasve Ajola Xoxa dhe Erion Veliaj në cilësinë e kryetarit të Bashkisë Tiranë si përfitim të parregullt, konkretisht <u>një vilë në Marea Resort, në Qerret, Kavajë me numër pasurie 1/647, Vol 29, faqe 103, Z.K. 3101</u>, për shkak të detyrës së këtij të fundit si titullar i Autoritetit Kontraktor në procedurat e prokurimit dhe koncesionit që ka përfituar kjo shoqëri, si dhe në cilësinë e autoritetit përgjegjës për dhënien e lejeve të zhvillimit, ndërtimit dhe lejeve të përdorimit.

**152.4.1** Referuar procesverbalit të këqyrjes së pjesshme të të dhënave të ekspertimit të aparatit celular të shtetasit <u>Driant Zeneli</u>, në përmbledhje të komunikimeve rezulton se vila në fjalë zotërohet faktikisht nga bashkëshortët Veliaj-Xoxa. Ky konkluzion arrihet nisur edhe nga komunikimet e shtetasit Driant Zeneli me Ajola Xoxa, nga ku evidentohet qartë frekuenca e shpeshtë e kësaj të fundit, por edhe bashkëshortit të saj në këtë pronë. Konkretisht: Më datë 01.08.2021 ora 7:52 pm, shtetasi Driant Zeneli i shkruan Ajola Xoxës: -*A të ka marrë malli për <u>Qerretin</u>? -Ne erdhëm sot. (faqe 6766).* Ajola Xoxa i përgjigjet: ***<u>Ajo aty në fund është shtëpia jonë</u>. (faqe 6766).*** Ndërkohë dy bashkëbiseduesit kanë shkëmbyer një foto nga ku rezulton se Ajola Xoxa i referohet banesës së saj duke thënë ***"ajo aty në fund është shtëpia jonë"***. Nga foto, në pjesën ballore të saj në fund, duket qartë që bëhet fjalë për vilën objekt hetimi.

**152.4.2.** Më tej, në faqen 8515, që i korrespondon datës 22.06.2024, rezulton një fakt me mjaft interes për hetimin dhe për provueshmërinë e pronësisë faktike të vilës nga bashkëshortët Veliaj- Xoxa. **Konkretisht: Më datë 22.06.2024, ora 12:51 pm,** Driant Zeneli i shkruan Ajola Xoxës: -*Të hënën herët në mëngjes nisemi.* Ajola Xoxa përgjigjet: *E lëmë kur*

---

[30] Në lidhje me subjektin "AGI KONS" u këqyr ekstrakti historik i regjistrimit tregtar për të dhënat e këtij subjekti në faqen e internetit të "Qendrës Kombëtare të Biznesit" nga ku u morën këto të dhëna: ***Numri Unik i Identifikimit të Biznesit** – K21622001M. **Data e Regjistrimit** – 24/02/2002. **Data e Themelimit** – 04/02/2002.* **Zyra Qëndrore e shoqërisë në Shqipëri** – Tiranë, Farkë Kodra e Diellit, Kompleks Hotelerie me struktura 2.3 dhe 5 kate, me dy kate nën tok, Nr. Pasurie 51/256. **Objekti i aktivitetit** - Veprimtari ne fushen e ndertimit te pergjithshem. **Ortakët – Gentjan Sula, me vlerë kapitali 1.501.000.000,00 me nr të pjesëve 1,00 dhe përqindje 100,00**

*të vish më mirë takohemi.* ***Se më duhet të mbyll disa punë tani dhe ndërkohë Eri ka shkuar në Oerret dhe s'ka marrë celësin.*** Pra, nga përmbajtja e këtij komunikimi çelsat e vilës 4 disponoheen nga çifti Veliaj – Xoxa.

**152.4.3** Pra, nga analiza e provave konstatohet se për Vilën 4 A dhe 6 A, shtetasi Erion Veliaj paguan periodikisht një kuotë, në dukje tarifë administrimi, pagesë kjo që duket se nis nga muaji Gusht i vitit 2020 dhe përfundon në 31.05.2021. Vila e emërtuar në atë kohë në 4A i korrespondon objektit me numër aktual pasurie 1/647, Vol 29, faqe 103, ZK. 3101, në pronësi të subjektit tregtar "Agi Kons" shpk, objekt në të cilin është ushtruar kontroll në zbatim të vendimit të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, Nr. 698, datë 05.12.2024. Nga ana tjetër, periudha në fjalë (Gusht 2020) përkon me lidhjen e kontratës së lidhur mes "Agi Kons" dhe Bashkisë Tiranë, me objekt ndërtimin e Shkollës 9 vjeçare "Qazim Turdiu", me nr. Prot. 25117/39 datë 29.09.2020. Vlera e përgjithshme e kontratës është 362.713.599 lekë (pa TVSH). Të gjitha faktet të para në unitetin e tyre provojnë dyshimin e arsyeshëm të bazuar në prova se kjo është vilë e fshehur e shtetasve Erion Veliaj dhe Ajola Xoxa dhe nuk është deklaruar në ILDKPKI pasi është rezultat i një përfitimi të parregullt që i është dhënë nga shtetasi Gentjan Sula në cilësinë e pronarit të subjektit tregtar "Agi Kons" shpk, shtetasit Erion Veliaj për shkak të detyrës së tij si Kryetar i Bashkisë Tiranë. Nga vitit 2016 e në vijim subjekti që ka dhënë përfitimin e parregullt ka përfituar procedura prokurimi dhe konçesioni në vlera të kosiderueshme nga fondet e Bashkisë Tiranë. Gjithashtu, shumica e Kontratave të Sipërmarrjes nuk kanë përfunduar efektet e saj përfshirë dhe kontratën e konçesionit. Disa nga procedurat e prokurimit janë përfituar pothuajse aq sa ka qenë fondi limit duke u skualifikuar të të gjithë operatorët konkurrues përveç fituesit "Agi Kons" shpk. Gjithashtu, nga vetë deklarimi i personit nën hetim Gentjan Sula duket se ai nuk ka asnjë pretendim mbi zotërimin e vilës.

*2) Lidhur me dhënien e përfitimit të parregullt shtetasit Erion Veliaj nga shoqëria "Kontakt" shpk.*

**153.** Nga aktet e administruara rezulton se me vendim të prokurorit "Për marrjen e akteve", datë 09.01.2025, në fashikullin penal, nëpërmjet procesverbalit për marrjen e akteve nga një procedim tjetër, specifikisht ai i numërtuar 287/1 i vitit 2024, **janë administruar** disa **akte të cilat provojnë se shtetasi Fatmir Bektashi ka porositur prerjen e biletave të avionit për bashkëshortët Veliaj-Xoxa, për një udhëtim në Roterdam, Hollandë. Gjithashtu, nga të njëjtat rezulton se i njëjti shtetasi ka porositur një dhomë (Double-suitë ekzekutive) në Hotel Marriott për qëndrim të bashkëshorteve Veliaj-Xoxa.** Konkretisht, rezulton se më datë 24.11.2016 "Alb-atlas" Travel Agency, i dërgon email shtetasit Fatmir Bektashi pas porosisë së këtij të fundit, ku e njofton se totali i çmimit të biletave të udhëtimit për shtetasit Erion Veliaj dhe Ajola Xoxa është **2688 Euro**. Itinerari i udhëtimit ka qenë: Vajtja (biznes) Tiranë – Romë, Romë – Amsterdam dhe Kthimi (biznes) Amsterdam – Vienë, Vienë – Tiranë. Akomodimi i shtetasve Erion Veliaj dhe Ajola Xoxa është prenotuar pranë Hotel "Marriot" me adresë: Ëeena 686 Rotterdam (Nl), 3012 Cn Netherlands. Prenotimi është bërë për datën 03.12.2016 – 04.12.2016 (1 natë qëndrimi), në dhomën tip 1 Double – Suite Executive. Nga emaili i dërguar me datë 25.11.2016 nga "Alb-

SPYETJE AL

atlas" Travel Agency, në adresën elektronike të shtetasit Fatmir Bektashi, **rezulton se çmimi për 1 Double – Suite Executive është 677 Euro.**

**153.1.** Gjithashtu, me procesverbalin për këqyrjen e të dhënave nga sistemi TIMS, datë 09.01.2025, rezulton se: **i)** Më datë 03.12.2016, ora 05:31 në Pikën Kufitare Rinas, shtetasi **Erion Veliaj** ka dalë nga Shqipëria me linjën e udhëtimit ALITALIA – AZ 510/507 ROME; **ii)** Më datë 03.12.2016, ora 04:56 në Pikën Kufitare Rinas, shtetasi **Fatmir Bektashi** ka dalë nga Shqipëria me linjën e udhëtimit ALITALIA - AZ 510/507 ROME; **iii)** Më datë 05.12.2016, ora 01:06 në Pikën Kufitare Rinas, shtetasi **Erion Veliaj** ka hyrë në Shqipëri me linjën e udhëtimit AUSTRIAN AIRLINES - OS 849/850 VIENA; **iv)** Më datë 05.12.2016, ora 01:08 në Pikën Kufitare Rinas, shtetasi **Fatmir Bektashi** ka hyrë në Shqipëri me linjën e udhëtimit AUSTRIAN AIRLINES - OS 849/850 VIENA; **v)** Nga këqyrja nuk rezulton se shtetësja Ajola Xoxa ka udhëtuar në këto data, megjithëse biletat dhe rezervimi i hotelit është bërë dhe për këtë të fundit.

**153.2.** Gjithashtu, nga sistemi *C@ts* që administrohet nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, në rubrikën "Dokumenta" është i ngarkuar Raporti i Kontrollit i mbajtur nga Inspektorët e Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, për **subjektin "Kontakt" shpk**, më administrator shtetasin **Fatmir Bektashi**. Nga këqyrja e dokumentuar me procesverbalin përkatës, rezulton se ky subjekt tregtar ka deklaruar lejet e ndërtimit të siguruara nga Bashkia Tiranë, sipas tabelës sa vijon:

| Nr | Objektet | Nr. I lejes së ndërtimit | Afat fillimi Leje ndërtimi | Afat përfundimi Leje ndërtimi | Investitor | Ndërtues |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 1 | Kontakt Shpk Marga 1/ "Godinë banimi dhe shërbimi 6, 8, 9 dhe 11 kat dhe 1 kat parkim nëntokë Jordan Misja te hargu | Nr. B-6729/6, datë 09.08.2020 | 27.09.2020 | 27.09.2024 | Kontakt | Kontakt |
| 2 | Kontakt Shpk Marga 2/ "Godinë banimi dhe shërbimi 9 kat me 1 kat parkim nëntokë, në pronë të shoqërisë "KONTAKT" sh.p.k" Rruga Petrela | Nr. A-14429/6, datë 06.10.2021 | 10.11.2021 | 10.11.2025 | Kontakt | Kontakt |
| 3 | Kontakt Shpk USL/ "Godinë banimi 5, 7, 10 dhe 11 kat me 2 kat parkim nëntokë dhe godinë banimi 7, 9, 10 dhe 11 kat me 2 kat parkim nëntokë si dhe kopësht 2 rr Frosina Plaku kat me mur rrethues, | Nr. A-26619/7, datë 27.02.2020 | 09.03.2020 | 09.03.2024 | Kontakt | Kontakt |
| 4 | Kontakt Shpk Siri 2/ "Godinë banimi dhe shërbimi 6, 7 dhe 10 kat, me 1 kat parkim nëntokë" në pronë të shoqërisë "KONTAKT" sh.p.k. rruga Ramazan Bogdani | Nr. B-14994/6, datë 30.11.2021. | 20.12.2021 | 20.12.2025 | Kontakt | Kontakt |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 5 | Kontakt Shpk Mangalem 21/ Kompleksi Mangalem 21, me struktura banimi dhe sherbimesh 3+9 kat, me 1,2 kat parkim nentoke, ne prone te familjes Kadiu rruga Mihal Grameno. | Nr. A-25138/7, date 14.12.2018 | 21.12.2018 | 21.02.2029 | Kontakt | Kontakt |
| 6 | Kontakt Shpk Kaimi/ "Kompleks me godina banimi 7 kat me 1 kat parkim nëntokë, në pronë të Astrit Kaimi, Silvana Shima, Jetmira Kaimi, "rruga Pasho Hysa" | Nr. B-18629/4, datë 05.10.2022 | 11.11.2022 | 11.11.2032 | Kontakt | Kontakt |

**153.3.** Nga procesverbali për këqyrje/marrjen e dokumenteve të dorëzuara nga shtetasi Fatmir Bektashi, administrator i shoqërisë "Kontakt shpk", administruar në fashikullin penal, rezulton se shoqëria "Kontakt" shpk, ka marrë nga Bashkia Tiranë një "Certifikatë Përdorimi të Pjesshëm" me nr. B-5112/4 e datës 06.05.2020, të lëshuar. Akti në fjalë është lëshuar për certifikimin e objekteve 1,2,3,4,5, fazë e parë, pjesë e strukturës së "Kompleksit Mangalem 21, me strukturë banimi dhe shërbimesh në 3+9 kat, me 1 dhe 2 kat parkim nëntokë". Kjo, në zbatim të lejes të miratuar me vendimin e kryetarit të bashkisë shtetasit Erion Veliaj, me nr. A-25138/7, datë 14.12.2018, zbardhur me leje ndërtimi me nr. A-25138/9, datë 21.12.2018, me vendimin e kryetarit të bashkisë me Tiranë me nr. A-4974/5 datë 02.05.2019, për miratimin e lejes së ndërtimit për "Punime që kryhen në ndryshimin të projektit dhe lejes së miratuar me vendimin nr. A-25138/7, datë 14.12.2018, të kryetarit të Bashkisë Tiranë", fletë 1 (një).

**153.4.** I pyetur në datë 09.01.2025, si person që ka dijeni për veprën penale, **shtetasi Fatmir Bektashi**, ndër të tjera shpjegon se: **[...]**

> Është pronar dhe administrator i shoqërisë "Kontakt" shpk. Në lidhje me sponsorizimet e shoqërisë Kontakt për organizatën "BYL-A", deklaruesi ka shpjeguar *se nuk i mban mend ato, pavarësisht se tregon që është ai personi që merr vendimet financiare dhe me sponsorizimet merret po vetë personalisht.* I pyetur konkretisht në lidhje me sponsorizimin e festivalit të parë ICDF (International Contemporary Dance Festival), deklaruesi shprehet *se është takuar me një shtetas anglez, emrin e të cilit nuk e di dhe nuk e di çfarë përfaqson.* Përsa i përket sponsorizimit të festivalit të dytë ICDF në vitin 2023, *nuk i kujtohet ndonjë gjë konkrete.* Deklaruesi shprehet se me shtetasen Ajola Xoxa nuk njihet personalisht, si dhe me të apo familjarë të saj nuk ka patur kontakte për këto evente.
>
> Pasi është njohur dhe pyetur në lidhje me disa dokumente të kompanisë turistike Alb-atlas, *ku evidentohet se janë paguar biletat e avionit për shtetasin Erjon Veliaj dhe Ajola Xoxa si edhe rezervuar një dhomë hoteli (Suite Executive) në emër të këtyre shtetasve,* deklaruesi është përgjigjur tekstualisht "***çuditem si paskam lënë gjurmë në lidhje me pagesat e biletave të avionit dhe të hoteleve që kam bërë për Erjon Veliaj dhe Ajola Xoxa.***" Në lidhje me këtë, deklaruesi ka shpjeguar <u>*se udhëtimi është bërë*</u>

*përpara se të bëhëj projekti "Mangalem 21" dhe se të dilte leja e ndërtimit të tij. Arsyeja e udhëtimit lidhet me një takim me kompaninë arkitekturore OMA në Rotterdam, dhe kompania Kontakt i kishte kërkuar Erion Veliajt që të ishte në **takim me qëllim që të njihej me projektin dhe ta miratonte atë. Për këtë arsye, tregon se ka paguar edhe biletat.***

Deklaruesi shpjegon se *janë akomoduar në hotel Marriot dhe të gjitha shpenzimet janë mbuluar nga shoqëria Kontakt Shpk.* Deklaruesi shpjegon gjithashtu se *me shtetasin Erion Veliaj është takuar vetëm në darkën përmbyllëse, të organizuar me përfaqësuesit e kompanisë OMA.* Shtetasen Ajola Xoxa nuk e ka parë gjatë udhëtimit. Deklaron se nuk ka paguar udhëtimet të tjera të shtetasit Erjon Veliaj apo Ajola Xoxa, dhe ***rasti në fjalë lidhet për interesin që kishte Fatmir Bektashi për realizimin e projektit Mangalem 21.*** Deklaruesi shpjegon se për këtë projekt kanë udhëtuar edhe punonjës të Bashkisë Tiranë, për takimin në Rotterdam, shpenzime këto të paguara nga Kontakt Shpk. Në fund, deklaruesi shprehet se leja për ndërtimin e kompleksit Mangalem 21 është miratuar në vitin 2018, ndërsa në vitin 2022 nga Bashkia Tiranë është marrë leja e përdorimit. **[...]**

**153.5.** Gjatë deklarimit të dhënë nga shtetësja **Adela Kondakçiu më datë 07.01.2025**, në cilësinë e personit që ka dijeni për veprën penale, në lidhje me *sponsorizimet* e bëra nga shoqëria "Kontakt" shpk tek "Byl-A" OJF, deklaruesja shpjegon se shoqëria Kontakt ka bërë dy të tilla, por herën e parë ka paguar direkt Tim Neuman për festivalin ICDF edicioni i parë në vitin 2022. Ndërsa për edicionin e dytë, në vitin 2023 është paguar "Byl-A", ***gjithmonë me konfirmim të Ajolës.*** Më pas është folur me ekonomisten e "Kontakt" shpk për kontratën dhe faturën, shtetasen Eralda Ikonomi. Në lidhje me këtë, është vendosur ***që kontrata duhet të ishte marrëveshje bashkëpunimi dhe jo kontratë sponsorizimi.***

**153.5.1.** Gjithashtu, gjatë kominikimit me Whatsapp me shtetasen Katrina lidhur me **shoqërinë "Kontakt" shpk**, Adela Kondakçiu vijon duke thënë se: ***edhe me Kontaktin, sa më marrin për kontratën unë jam në ajër".*** *Faqe 1363.* Ketrina i përgjigjet: *Na e uzin Opera me Ministrinë, po bëjnë sikur është i tyre festivali. As vende në sallë nuk po na lënë për sponsorat tanë.* ***Ajolën,*** shprehet Ketrina, *nuk e ka parë më të stresuar. Faqe 1363-1364-1365.* Nga këto komunikime provohet që financierja e Ajola Xoxës nuk kupton se çfarë bëhet dhe interesohet vetë shoqëria "Kontakt" shpk për të bërë sponsorizimet.

**153.5.2.** Nga analizimi i deklarimeve në sistemet tatimore C@TS dhe Portali Qendror për Kontroll dhe Menaxhim (fiskalizimi) rezulton se nga analizmi i librave të shitjes për periudhën 2022 – 2024, konstatohet se OJF Balkan Youth Link Albania (BYL-A) ka deklaruar në shitje një vlerë totale prej **31,521,286 lekë.** Kryesisht këto faturime përbëhen nga sponsorizime për evente të ndryshme që kjo OJF ka organizuar. Konkretisht: ***KONTAKT SHPK (ID: J92108006V):*** **6,507,456 lekë.** Kjo organizatë është kontrolluar nga Ajola Xoxa, si dhe vetëm kjo e fundit vendoste kush do financonte dhe kurrë. Ajo që vihet re është iniciativa e vetë kompanive që marrin leje ndërtimi pranë Bashkisë Tiranë që komunikojnë me financieren e shtetases Ajola Xoxa për të lidhur marrëveshjen e financimit.

**153.5.3. Sa më sipër, konstatohet se si prerja e biletave dhe pagesa për dhomën e hotelit përmendur më lart, ashtu edhe sponsorizimi për "BYL-A" OJF, e kontrolluar nga shtetësja Ajola Xoxa, ka ndodhur gjatë periudhës që i paraprin lëshimit të lejes së**

**ndërtimit por edhe gjatë procesit së çertifikimit për përdorim të objektit. Gjithashtu, nga deklarimet e shtetasit Fatmir Bektashi rezulton se kompania Kontakt i kishte kërkuar Erion Veliajt që të ishte në takim me qëllim që të njihej me projektin <u>dhe ta miratonte atë</u>. Për këtë arsye, tregon se ka paguar edhe biletat si dhe hotelin. Pra, rasti në fjalë lidhet për interesin që kishte Fatmir Bektashi për realizimin e projektit Mangalem 21, i cili duhej miratuar nga kryetari i Bashkisë Tiranë z. Erion Veliaj. Ky i fundit nuk e ka deklaruar këtë fakt në ILDKPKI. Në një rast të ngjashëm me vendimin Nr. 69, datë 29.01.2019 të Gjykatës së Shkallës së Parë për Krimet e Rënda Tiranë, lënë në fuqi me vendimin Nr. 19, datë 21.09.2020 të Gjykatës së Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar janë dënuar të pandehurit për figurën e veprat penale korrupsion aktiv dhe pasiv.**

**153.5.4.** Gjykata çmon se, subjektet e procesit penal janë të detyruara të respektojnë parimin e shtetit të së drejtës dhe atë të sigurisë juridike. Kuptimi i parimit të shtetit të së drejtës dhe sigurisë juridike është dhënë nga jurisprudenca e Gjykatës Kushtetuese. Kështu, Gjykata Kushtetuese në jurisprudencën e saj thekson, se nga parimi kushtetues i shtetit të së drejtës, buron e drejta e kujtdo, që pretendon se të drejtat ose liritë e tij janë cenuar, për një gjykim të drejtë përpara një gjykatë të pavarur dhe të paanshme të caktuar me ligj; që kjo e drejtë nuk mund të kufizohet artificialisht dhe që zbatimi i saj nuk duhet të pengohet në mënyrë të paarsyeshme; që e drejta e individit kundër veprimeve të paligjshme të individëve të tjerë apo institucioneve shtetërore nuk duhet të mbrohet vetëm formalisht, por dhe realisht e efektivisht.[31] Po ashtu,Gjykata Kushtetuese e ka theksuar vazhdimisht në jurisprudencën e saj rëndësinë e parimit të sigurisë juridike si një nga aspektet themelore të shtetit të së drejtës. Parimi i shtetit të së drejtës ku mbështetet një shtet demokratik, nënkupton sundimin e ligjit dhe mënjanimin e arbitraritetit, me qëllim që të arrihet respektimi dhe garantimi i dinjitetit njerëzor, drejtësisë dhe sigurisë juridike. Siguria juridike, përfshin, krahas qartësisë, kuptueshmërisë dhe qëndrueshmërisë së sistemit normativ, edhe besimin tek sistemi juridik.[32]

**153.5.4.1.** Gjithashtu, Gjykata Kushtetuese duke iu referuar jurisprudencës së saj dhe asaj GJEDNJ-së, ka pranuar se **mbrojtja kushtetuese dhe ligjore e të drejtave dhe lirive të individit mund të realizohet vetëm kur ushtrohet brenda afateve të përcaktuara në Kushtetutë dhe ligje. Përcaktimi i këtyre afateve nuk përbën një qëllim në vetvete, por bëhet për mbrojtjen e të drejtave të të tjerëve dhe në funksion të parimit të sigurisë juridike si një nga përbërësit themelorë të shtetit të së drejtës.**[33] Ky element theksohet edhe në një sërë vendimesh të mekanizmave të ndryshëm ndërkombëtarë të krijuar për garantimin e të drejtave të njeriut.[34]. Gjykata çmon se parashikimi i insitutit të parashkrimit të ndjekjes penale dhe të ekzekutimit të dënimit i shërben pikërisht parimit të sigurisë juridike.

**153.5.4.2.** Gjykata çon se në kreun e VIII[te] të Kodit Penal ligjvënësi ka parashikuar një institut më vete në lidhje me shuarjen e ndjekjes penale, të dënimeve dhe mosekzekutimin

[31]Vendimi Nr. 17, datë 19.06.2009 i Gjykatës Kushtetuese.
[32]Vendimi Nr. 37, datë 13.06.2012 i Gjykatës Kushtetuese.
[33]Vendimi Nr. 25, datë 10.11.2006 i Gjykatës Kushtetuese.
[34]Shih vendimin e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, datë 25.01.2000 në Baker kundër Mbretërisë së Bashkuar; vendimin e Komisionit të të Drejtave të Njeriut, datë 17.05.1984 në K.v.Irlandës; vendimin Ndër-Amerikan të të Drejtave të Njeriut, datë 29.05.2003 në Mendoza v.Argjentinës, etj.

e tyre. Brenda kuadrit të këtij instituti janë përfshirë dispozita të veçanta në lidhje me parashkrimin e ndjekjes penale (neni 66 i Kodit Penal); në lidhje **me parashkrimin e ekzekutimit të dënimit** (neni 68 i Kodit Penal) dhe shuarjen e dënimit ose, sikurse e ka emërtuar vetë ligjvënësi, rehabilitimin (neni 69 i Kodit Penal). Këto dispozita përmbajnë rregullimin ligjor të këtij instituti në tre aspekte të veçanta të tij. **Kështu, dispozita e nenit 66 të Kodit Penal bën fjalë për parashkrimin e ndjekjes penale me të cilin duhet kuptuar ndalimi që ekziston me ligj për të bërë ndjekje penale në qoftë se, nga koha kur është kryer vepra penale deri në momentin e marrjes si të pandehur të autorit të saj, kanë kaluar afatet e parashikuara në këtë dispozitë**. Në dispozitën e nenit 68 të Kodit Penal ligjvënësi ka parashikuar afatet, me kalimin e të cilëve, vendimi i dënimit, dhënë ndaj një personi për vepra penale të kryera prej tij, nuk mund të ekzekutohet më. Pra, ndodhemi para parashkrimit të së drejtës së organeve kompetente shteterore, të ngarkuara me ekzekutimin e vendimeve të dënimit për të ekzekutuar këto vendime. Kurse në dispozitën e nenit 69 të Kodit Penal janë parashikuar afatet, me kalimin e të cilëve, personi i dënuar për vepra penale të kryera prej tij do të quhet i padënuar ose, siç e ka vetë ligji i rehabilituar.

**153.5.4.3. Parashkrimi i ndjekjes penale është parashikuar nga neni 66 i Kodit Penal.** Në këtë dispozitë parashikohet shprehimisht: *"Nuk mund të bëhen ndjekje penale kur nga kryerja e veprës deri në çastin e marrjes së personit si të pandehur kanë kaluar: a) njëzet vjet për krimet që parashikojnë dënim jo më të ulët se dhjetë vjet burgim ose dënim tjetër më të rëndë; b) dhjetë vjet për krimet që parashikojnë dënim nga pesë gjer në dhjetë vjet burgim;* ***c) pesë vjet për krimet që parashikojnë dënim gjer në pesë vjet burgim ose gjobë;*** *ç) tre vjet për kundërvajtjet penale që parashikojnë dënim gjer në dy vjet burgim; d) dy vjet për kundërvajtjet penale që parashikojnë dënim me gjobë."*. Gjykata çmon se, në analizë të dispozitës së parashikuar në nenin 66 të KP, vëren se, objekti i masës së dënimit të parashikuar në këtë nen i referohet maksimumit të dënimit të parashikuar shprehimisht nga secila dispozitë që parashikon veprën penale. Parashikimi i një hapësire dënimi, duke filluar me një cak minimumi dhe një cak maksimumi të masës së dënimit shërben, jo vetëm për përcaktimin dhe individualizimin e sanksionit penal me parimin e fajësisë dhe realizimin e dhënies së drejtësisë, por gjithashtu edhe për përcaktimin e maksimumit të sakrifikimit të lirisë personale që mund të caktohet për cenimin e një marrëdhënieje juridike të mbrojtur penalisht nga dispozita penale e posaçme, dhe kriteri i maksimumit të marzhit të dënimit për secilën vepër përbën një baraspeshim të drejtë midis interesit publik për ndjekjen dhe ndëshkimin e veprës penale dhe ato të individit për lirinë dhe **sigurinë juridike.**[35]

**153.5.4.3.** Gjithashtu, nga përmbajtja e nenit 66 të Kodit Penal rezulton se, afati i parashkrimit llogaritet në ditë kalendarike, sipas rregullave të përgjithshme. Afati fillon në çastin kur vepra konsiderohet e kryer dhe përfundon ditën e fundit korresponduese të plotësimit të tij. Si pikë referimi merren çasti i kryerjes së veprës dhe çasti i marrjes së personit si i pandehur. Pra, kërkesë e detyrueshme e ekzistencës së parashkrimit është plotësimi i afateve të tij në momentin e marrjes së personit si i pandehur. Bazuar në teorinë e së drejtës penale dhe në praktikën gjyqësore rezulton se, për veprat penale të qëndrueshme afati i parashkrimit të ndjekjes penale fillon të ecë nga çasti i zhdukjes së gjendjes kriminale, ndërsa në veprat penale vazhduese afati i parashkrimit fillon nga momenti i kryerjes së

[35]Shiko vendimin Nr. 44, datë 16.03.2016 i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë.

veprimit të fundit kriminal të saj. Në rastin konkret, vepra penale për të cilën është regjistruar procedimi penale, bazuar në nenin 134 paragrafi i parë dhe i dytë i Kodit Penal, duke përjashtuar në mënyrë kategorike paragrafin e tretë, dënohet me burgim gjer në pesë vjet. Pra, nga interpretimi i nenit 66 pika "c" i Kodit Penal rezulton se, për veprën penale të "*Korrupsioni aktiv i funksionarëve të lartë shtetërorë ose i të zgjedhurve vendorë*" parashikuar nga neni 245 i Kodit Penal, ndjekja penale parashkruhet me plotësimin e afatit pesë vjeçar. Gjykata çmon se, në rastin konkret afati i parashkrimit të ndjekjes penale **vetëm për prerjen e biletave dhe akomonimin në hotel** nga shoqëria "Kontakt" sh.p.k për shtetasit Erion Veliaj dhe Ajola Xoxa fillon më datë **03.12.2016.** Duke marrë për bazë datën 03.12.2016, Gjykata çmon se, në rastin konkret, është parashkruar ndjekja penale, që më datë **03.12.2021**. Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë me vendimin Nr. 7, datë 11.10.2002 lidhur me institutin e parashkrimit të ndjekjes penale dhe të ekzekutimit të vendimit penal ka theksuar se: "*Qëllimi i ligjvënësit në vendosjen e këtij kufizimi kohor dhe ndalimi ka qënë së pari, realizimi në praktikë i efektit të përgjithshëm dhe të veçantë parandalues të dënimit në çdo rast konkret..*" Prandaj, gjykata vlerëson se, në rastin konkret me kalimin e afatit pesë vjeçar është arritur në praktik qëllimi i dënimit, si funksioni i parandalimit të përgjithshëm ashtu dhe parandalimi i posaçëm për këtë fakt kriminal. **Ndërkohë për faktin tjetër që lidhet me sponsorizimin e eventeve të shtetases Ajola Xoxa nuk është parashkruar ndjekja penale për personin nën hetim Fatmir Bektashi. Gjithashtu, nuk është parashkruar ndjekja penale për shtetasit Erion Veliaj dhe Ajola Xoxa për faktet e dhënies së përftimit të parregullt nga shoqëria "Kontakt" sh.p.k.**

*3) Lidhur me dhënien e përfitimit të parregullt nga shoqëria "Fusha" shpk.*

**154.** Nga aktet e administruara rezulton se, në kuadër të hetimeve paraprake, në Bashkinë Tiranë është proceduar me këqyrje/marrjen e praktikave të prokurimeve publike, që i përkasin disa subjekteve tregtare, të cilët rezultojnë të kenë financuar OJF-të dhe Personat Fizikë të kontrolluar efektivisht nga shtetësja Ajola Xoxa. Konkretisht, me vendim të prokurorit të datës 23.12.2024 është proceduar me këqyrje/marrjen e dokumenteve pranë institucionit të bashkisë, nga kërkimi në evidencat/regjistrat e protokollit të arkivës të të cilit u evidentuan procedurat e prokurimit si më poshtë vijon:

1. **Me shkresën Nr. 112 Prot.**, datë **12.04.2021** shoqëria **"Fusha" shpk** ka paraqitur pranë Bashkisë Tiranë kërkesën me **objekt**: *"Likujdimi garancie punimesh"*, që rrjedhinin nga zbatimi i punimeve në objektin "Rikualifikimi Urban i Sheshit Skënderbej, Faza e II-të", në vlerën **11, 738, 772 lekë**. Nga ana e bashkisë Tiranë më urdhër- shpenzimi nr. **1793 datë 07.06.2021**, **të nënshkruar nga krvetari i bashkisë Tiranë Erion Veliaj** i janë kaluar "Fusha" shpk, **shuma 11, 738, 772 lekë.**
2. Kontratë **Nr. 11087/1 Prot., datë 12.03.2021** *"Shërbimi i Pastrimit të Tiranës" Loti IV "Shërbimi i Pastrimit të Zonës Tirana IV"*, **(Kontraktor "Fusha" shpk) me vlerë totale te kontratës pa tvsh 287, 216, 290/95** (dyqind e tetëdhjetë e shtatë milion e dyqind e gjashtëdhjetë mijë e dyqind e nëntëdhjetë pikë nëndhjetë e pesë) lekë. **Kjo kontratë është nënshkruar nga krvetari i bashkisë Tiranë Erion Veliaj, dhe shoqërisë "Fusha" shpk.**

3. Marrëveshje Kuadër **Nr. 7476/7 Prot., datë 10.03.2021** me objekt: *"Shërbimi i Pastrimit të Tiranës" Loti IV "Shërbimi i Pastrimit të Zonës Tirana IV"*, të lidhur midis Bashkisë Tiranë **të nënshkruar nga kryetari i bashkisë Tiranë Erion Veliaj, dhe shoqërisë "Fusha" shpk.**
4. Me shkresën **Nr. 41302 Prot., datë 23.11.2020** është nxjerrë **Urdhëri i Prokurimit** ndër të tjera për objektin *"Shërbimi i Pastrimit të Tiranës" Loti IV "Shërbimi i Pastrimit të Zonës Tirana IV"*, **nënshkruar nga kryetari i bashkisë Tiranë Erion Veliaj.**
5. Me shkresën Nr. 204 Prot., datë **09.11.2020** shoqëria **"Fusha" shpk** ka paraqitur pranë Bashkisë Tiranë kërkesën me objekt: *"Likujdimi garancie punimesh"*, që rrjedhinin nga zbatimi i punimeve në objektin "Rikualifikimi Urban i Sheshit Skënderbej, Faza e II-të", në vlerën **58, 732, 731 lekë.** Nga ana e bashkisë Tiranë më urdhër- shpenzimi **nr. 4195 datë 31.12.2020, të nënshkruar nga kryetari i bashkisë Tiranë Erion Veliaj** i janë kaluar "Fusha" shpk, **shuma 58, 732, 731 lekë.**
6. Kontratë Sipërmarrje **Nr. 11233/6 Prot., datë 19.04.2018,** "Shtesë kontrate sipërmarrje, Shtesë kontrate për objektin "Ndërtim parkim nëntokësor, sheshi Skënderbej"; **(Kontraktor "Fusha" shpk) me vlerë totale te kontratës pa tvsh** 44,543,018 (dyzet e katër milion e pesëqind e dyzet e tre mijë e tetëmbëdhjetë ) lekë. Nga ana e bashkisë Tiranë më urdhër- shpenzimi nr. 1246 datë 11.04.2019, **të nënshkruar nga kryetari i bashksië Tiranë Erion Veliaj** i janë kaluar "Fusha" shpk, **shuma 50,779,040 lekë.** Me urdhër-shpenzimi nr. 402 datë 18.02.2022, **të firmosur nga kryetari bashkisë Tiranë Erion Veliaj** i janë kaluar "Fusha" shpk, **shuma 2,672,581. Lekë.**
7. Kontrata **Nr. 47392/6 Prot., datë 27.12.2018.** Shtesë **kontratë** sipërmarrje objekti "Shtesë kontrate për objektin "Rikualifikimi Urban i Sheshit Skënderbej, Faza e I-rë"; **(Kontraktor "Fusha" shpk, me vlerë totale me tvsh 126, 397, 825** (njëqind e njëzet e gjashtë milion e treqind e shtatë mijë e tetëqind e njëzetë e pesë tridhjetë e një mijë e pesëqind e njëzet e pesë) lekë. Nga ana e bashkisë Tiranë më urdhër shpenzimi nr. 2925, datë 19.08.2019, **të nënshkruar nga kryetari bashkisë Tiranë Erion Veliaj**, i janë kaluar "Fusha" shpk, shuma **30,000,000** lekë. Me urdhër-shpenzimi nr.3314 datë 25.09.2019, **të firmosur nga kryetari i bashkisë Tiranë Erion Veliaj** i janë kaluar **"Fusha"** shpk, **shuma 20,000,000 lekë.** Me urdhër-shpenzimi nr.3600 datë 08.10.2019, **të firmosur nga kryetari i bashkisë Tiranë Erion Veliaj** i janë kaluar "Fusha" shpk, **shuma 13,201,134 lekë.** Me urdhër-shpenzimi nr. 1792 datë 07.06.2021, **të firmosur nga kryetari i bashkisë Tiranë Erion Veliaj** i janë kaluar "Fusha" shpk, **shuma 6,319,891 lekë.** Me urdhër-shpenzimi nr.496 datë 19.02.2020, **të firmosur nga kryetari i bashkisë Tiranë Erion Veliaj** i janë kaluar "Fusha" shpk, **shuma 31, 598, 346 lekë.**
8. Kontrata nr. **626/4, dt. 08.3.2017**, kontratë sipërmarrje "Rikualifikimi Urban i Sheshit Skënderbej, Faza e II-të **(Kontraktor "Fusha" shpk, me vlerë totale me tvsh 1, 174, 654, 654.54** (një miliard e njëqind e shtatëdhjetë e katër milion e

gjashtëqind e pesëdhjetë e katër mijë e gjashtëqind e pesëdhjetë e katër pikë pesëdhjetë e katër) lekë.

9. Kontrata nr. **20575/6, dt. 06.9.2016**, kontratë sipërmarrje "Rikualifikimi Urban i Sheshit Skënderbej, Faza e I-rë **(Kontraktor "Fusha" shpk, me vlerë totale pa tvsh 527,535,937.5** (pesëqind e njëzet e shtatë milion e pesëqind e tridhjete e pesëmijë e nëntëqind e tridhjetë e shtatë pikë pesë). Nga ana e bashkisë Tiranë, më Urdhër shpenzimi nr. 1626, datë 17.05.2018, **<u>të nënshkruar nga kryetari bashkisë Tiranë Erion Veliaj</u>**, i janë kaluar "Fusha" shpk, shuma **186,284,337 lekë.** Me urdhër-shpenzimi nr. 3436 datë 26.12.2017, **<u>të firmosur nga kryetari i bashkisë Tiranë Erion Veliaj</u>** i janë kaluar "Fusha" shpk, **shuma 297,350,993 lekë.**

**154.1.** Gjithashtu, me vendim të prokurorit të datës 23.12.2024 është proceduar me këqyrje/marrjen e dokumenteve pranë Bashkisë Tiranë, Drejtoria e Përgjithshme e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit, në sistemin elektronik të *E-Leje*, në lidhje me Lejet e Ndërtimit të dhëna nga Bashkia Tiranë. Nga dokumentacioni i administruar ka rezultuar se nga ky institucion janë miratuar leje ndërtimi për disa firma, të cilat nga ana e tyre kanë kaluar shuma të hollash në favor të subjekteve tregtarë të kontrolluara nga shtetësja Ajola Xoxa. Konkretisht disa prej tyre janë listuar sa vijon:

1. **Leje ndërtimi e miratuar me vendim Nr. S-5746/5, <u>të nënshkruar nga kryetari i Bashkisë Tiranë, Erion Veliaj</u> për "Kompleks banimi 3 kat me 1 dhe 2 kat** parkim nëntokë me mure rrethuese", Njësia Administrative Farkë, Tiranë, në pronë të Shkëlqim Fusha, me zhvillues dhe subjekt ndërtues shoqërinë **"Fusha" sh.p.k. me administrator <u>Shkëlqim Fusha</u>, viti 2019.**
2. **Leje ndërtimi e miratuar me vendim Nr. S-7627/6, <u>të nënshkruar nga kryetari i Bashkisë Tiranë</u>, për "Kompleks vila banimi 1, 2 dhe 3 kat, me 1 kat nëntokë** dhe mur rrethues", të ndodhur në Farkë e Vogël, Njësia Administrative Farkë, në pronë të Shkëlqim Fusha, me zhvillues dhe subjekt ndërtues shoqërinë **"Fusha" sh.p.k." me administrator <u>Shkëlqim Fusha</u>, viti 2021.**
3. **Leje ndërtimi e miratuar me vendim Nr. S-7522/5,** "Rishikim i kushteve të lejes dhe ndryshim të projektit gjatë ndërtimit, për objektin miratuar me Vendimin Nr. S-**7627/6, datë 10.11.2021 ("Fusha" shpk), <u>të nënshkruar nga kryetari i Bashkisë Tiranë, Erion Veliaj</u>**.

**154.2.** Gjithashtu, në kuadër të hetimeve paraprake, janë administruar të dhëna që lidhen me marrëdhënien financiare që *Personat Fizikë Greta Domi dhe Ines Dani* kanë patur me Qendrën Harabel. Nga analizimi i deklarimeve në sistemin tatimor C@TS, të librave të shitjes/blerjeve të Qendrës Harabel dhe të subjekteve Greta Domi P.F dhe Ines Dani P.F rezulton si vijon: **i)** Në datën **26.11.2020**, subjekti Greta Domi P.F me nipt M01427002Q ka deklaruar në shitje faturën me nr. Serial 88856706, me blerës subjektin Fusha Shpk me NIPT J61922018S në vlerën 1,336,284 lekë; **ii)** Në datën **30.11.2020,** subjekti Greta Domi P.F me nipt M01427002Q ka deklaruar në blerje faturën me nr. 94105702 me shitës Qendra Harabel me NIPT L81509451A në vlerën 742,380 lekë; **iii)** Në datën **26.11.2020,** subjekti Ines Dani P.F me nipt L82201009O ka deklaruar në shitje faturën me nr. Serial 88856706, me blerës

subjektin Fusha Shpk me NIPT J61922018S në vlerën 1,336,284 lekë; **iv)** Në datën **30.11.2020**, subjekti Ines Dani P.F me nipt L82201009O ka deklaruar në blerje faturën me nr. 94105704 me shitës Qendra Harabel me nipt L81509451A në vlerën 593,904 lekë.

**154.3.** Konstatohet se **subjekti Fusha shpk** është faturuar në vlerën **2,672,568 lekë** nga dy subjektet Greta Domi P.F dhe Ines Dani P.F, të cilët vetëm tre ditë më pas kanë deklaruar nga një faturë në blerje përkatësisht në vlerat 593,904 lekë dhe 742,380 lekë ose ne total 1,336,284, ekzaktësisht sa gjysma e vlerës të faturar për Fusha shpk. Thënë ndryshe, gjysmën e shumës së marrë nga Fusha shpk këto shtetase, në cilësinë e personave fizikë, e kanë kaluar në llogaritë e Qendrës Harabel, siç më poshtë do të tregohet në hollësi.

**154.4.** Të pyetura në lidhje me blerjet e deklaruara nga Qendra Harabel, siç do të përshkruhet në vijim, shtetaset Greta Domi dhe Ines Dani kanë deklaruar se këto vlera përfaqësojnë *sponsorizim* kundrejt qendrës Harabel *por nuk i kujtohet se për çfarë eventi kontret e kanë bërë këtë sponsorizim.* Nga aktet e administruara dhe të këqyrura në Bashkinë Tiranë, pjesë e fashikullit penal, rezulton e provuar se "Fusha" shpk, ndër të tjera ka përfituar nga Bashkia Tiranë edhe Lejen e Ndërtimit Nr. Prot. 1-8789/8, dt. 23.11.2020, "Banesë individuale 1 kat, me mur rrethues" ndodhur në Yrshek, Tiranë, në pronë të z. Glentjan Karaj, me zhvillues z. Glentjan Karaj dhe subjekt ndërtues shoqëria "FUSHA" sh.p.k.", viti 2020. Afati i lejes 27 muaj. Gjithashtu, me shkresën Nr. 204 Prot., datë 09.11.2020 shoqëria "Fusha" shpk ka paraqitur pranë Bashkisë Tiranë kërkesën me objekt: *"Likujdimi garancie punimesh"*, që rrjedhinin nga zbatimi i punimeve në objektin "Rikualifikimi Urban i Sheshit Skënderbej, Faza e II-të", në vlerën 58, 732, 731 lekë. Po ashtu, shoqëria "Fusha" shpk ka marrë pjesë në procedurën e prokurimit të shpallur me Udhërin e Prokurimit Nr. 41302 Prot., datë 23.11.2020 për objektin *"Shërbimi i Pastrimit të Tiranës" Loti IV "Shërbimi i Pastrimit të Zonës Tirana IV"*, nënshkruar nga kryetari i bashkisë Tiranë Erion Veliaj. **Pra, vetëm 3 ditë pas përfitimit të lejes në fjalë, si dhe gjatë kohës që ishte në pritje të shqyrtimit të kërkesës nga Bashkia Tiranë e bërë nga shoqëria nga "Fusha" shpk më datë 09.11.2020 me objekt: *"Likujdimi garancie punimesh"*, që rrjedhinin nga zbatimi i punimeve në objektin "Rikualifikimi Urban i Sheshit Skënderbej, Faza e II-të", në vlerën 58, 732, 731 lekë, si dhe tre ditë pasi është nxjerrë Udhëri i Prokurimit Nr. 41302 Prot., datë 23.11.2020 (ku doli fitues më pas), subjekti tregtar "Fusha" shpk është faturuar me një shumë prej 2,672,568 lekë nga dy personat fizikë, të kontrolluar plotësisht nga shtetësja Ajola Xoxa, të cilët nga ana e tyre, vetëm 4 ditë më pas, faturohen nga "Harabel" duke i kaluar gjysmën e të hollave kësaj organizate. Në lidhje me këtë kalim, përveç dyshimeve të krijuara për dhënie përfitimi të parregullt, komunikimet e shtetases Adela Kondakçiu dhe Ajola Xoxa ekspozojnë qartë gjithashtu edhe mekanizmin e përdorur për të "injektuar" të hollat në llogaritë bankare të një OJF-je që kontrollohet nga kjo e fundit. Në këtë skemë të mirëorganizuar përveçse ka dyshime të arsyeshme se shoqëria "Fusha" shpk ka dhënë përfitim të parregullt njëkohësisht ka ndihmuar që ky "përftim parregullt" të duket si një marrëdhënie juridiko – civile edhe pse ka qenë tërësisht fiktive dhe e diktuar nga shtetësja Ajola Xoxa si shuma ashtu dhe mënyra se si do të kalohet kjo shumë nga subjektet me interesa pranë Bashkisë Tiranë. Kjo skemë duket se aplikohet pothuajse në të gjitha rastet.**

**154.5.** Faktet e mësipërme provohen edhe nëpërmjet komunikimit me Whatsapp midis shtetases Adela Kondakçiu dhe Ines Dani. Kështu, në faqen 112 evidentohet prodhimi i

faturave në emër të shtetases Ines Dani, për shërbime që nuk rezultojnë të jenë kryer nga kjo e fundit, dhe për të cilat duket qartë se nuk asnjë dijeni. Jo vetëm kaq, subjektet tregtarë që kërkojnë shërbimin, pra ata që paguajnë të hollat, në këtë rast rezultojnë të lidhur ngushtë me interesa financiarë më bashkinë Tiranë. Konkretisht, në faqen 112 shtetësja Adela Kondakçiu njofton shtetësen Ines Dani: ***Kam bërë edhe një faturë tjetër nga ty sot.*** **Pra, Ines Dani nuk ka asnjë ide për shërbimin që ka ofruar, subjektit të cilit ja ka ofruar dhe sigurisht për faturën që është lëshuar. Kjo, sepse personi i parë që pëmend këtë faturë dhe e njofton për lëshimin e saj është Adela Kondakçiu, pa ju kërkuar në asnjë moment kjo gjë nga shtetësja Ines Dani.** Në vijim, në faqen 113 Adela i dërgon Ines Dani *me foto një faturë tatimore shitje*. Konkretisht bëhet fjalë për faturën nr. 15 datë 26.11.2020, lëshuar nga personi fizik Ines Dani, në cilësinë e shitësit të shërbimit, për subjektin tregtar "FUSHA" shpk, në cilësinë e blerësit të shërbimit. Nga fatura rezulton se Ines Dani ka faturuar "FUSHA" shpk për shërbime konsulencë ligjore në vlerën 9.000 euro + TVSH, gjithsej 10.800 euro, që me kursin e kohës 1 euro=123 lekë, llogaritet në vlerën rreth 1.328.400 lekë (me TVSH). Ines Dani pasi njihet me faturën i thotë Adelës vetëm: *ok.* **Por në këtë pikë, gjithnjë në faqen 113, Ines Dani kujtohet të kërkojë diçka që paraqet shumë interes për hetimin, përsa kohë provon xhirimin e parave për faturime fiktive nga subjekte tregtarë të lidhur me bashkinë Tiranë në llogarinë e saj si person fizik, dhe përsa kohë nga ana tjetër, shfaq mekanizmin e kalimit të këtyre përfitimeve të paligjshme nëpër llogaritë bankare deri në mbylljen e plotë të ciklit të destinacionit të të hollave, duke nxjerrë në pah mjaft qartë se në favor të kujt përfundojnë ato.**

**154.6.** Konkretisht, **Ines Dani** pasi njihet me faturën i thotë Adelës: *Aman na bëj një tabelë për hyrjet dhe daljet nga llogaria ime, që të di sa janë të miat dhe sa jo. Faqe 113.* Adela i përgjigjet në faqen 14: *Po do ta bëj.* Në faqen 115 Adela Kondakçiu mban premtimin dhe i dërgon Ines Danit tabelën e kërkuar. E sqaron pas dërgimit të fotos së tabelës: *Ines kjo ka qenë gjëndja deri në fund të tetorit me tërheqjet, nëse ke tërhequr në nëntor duhet zbritur nga vlera e mbetur dmth kjo vlera 357.219 lekë.* Nga tabela e derguar tek shtetësja Ines Dani rezulton se totali në llogarinë e shtetases Ines Dani është 965.149 lekë, të cilat përbëhen nga gjendja ekzistuese e llogarisë, pagat e Inesit (maj-nëntor) (ndërkohë që është përson fizik). Tërheqjet e bëra nga Inesi, në muajt Qershor Tetor, sipas tabelës janë 607.930 lekë dhe pjesa e mbetur për t'u terhequr është 357.219 lekë.

**154.7. Për të provuar në thelb se sa realisht përfiton shtetësja Ines Dani nga puna e saj si avokate e licensuar si përson fizik janë me interes komunikimet e faqes 117.** Ines Dani pasi njihet me tabelën pyet Adela Kondakçiun: ***357 janë të miat?*** Adela Kondakçiu i përgjigjet në faqen 118: ***Po.*** Por, shtetësja **Ines Dani** pas saktësimit se sa para ishin të saj dhe sa jo, i drejtohet Adelës duke i thënë në faqen 133: *ADELA, DO E FLAS EDHE ME AJOLËN, POR PARAPRAKISHT, NËSE DO JU DUHET TË TËRHIQNI LEKË NGA LLOGARIA PF (PERSON FIZIK) IME, ME THUAJ MUA ME PËRPARA QË TË TI JAP UNË DHE MOS TI TËRHEQESH TI NGA LLOGARIA. (KONFIDENCIALE KJO ☺).* Pra, më se pari është e qartë se në llogarinë e personit fizik Ines Dani nuk është vetëm titullari i saj që disponon, por edhe Ajola Xoxa. Jo vetëm kaq, por **ky komunikim provon faktin që të ardhurat e gjeneruara *de jure* nga personi fizik Ines Dani, në një mënyrë ose një tjetër, në rastin konkret nëpërmjet tërheqjeve në llogari, merren nga shtetësja Ajola**

Xoxa. Në lidhje me këtë kërkesë, Adela Kondakçiu i thotë Ines Dani *se këtë radhë pagesa, siç i kishte thënë Ajola, do të kalohej ndryshe. Konkretisht:* Në faqen 134, në përgjigje të kërkesës së Ines Dani për të mos bërë tërheqje nga llogaria e saj si person fizik, Adela Kondakçiu i thotë: ***PAGESA ME KA THËNË AJOLA QË DO KALOJË ME TRANSFERTË TE HARABEL NË FAKT.*** Sa është thënë në këtë komunikim provohet me xhirimet bankare të evidentuar në statement e llogarisë së OJF "Harabel". **Pra, në rastin konkret, sipas udhëzimeve të Ajola Xoxës lekët nuk do të merren direkt nga llogaria e personit fizik Ines Dani, në formë CASH, por do të kalohen me transfertë bankare në një OJF të kontrolluar plotësisht nga shtetësja Ajola Xoxa. Një gjë e tillë në fakt edhe ka ndodhur dhe është e njëjtë me mekanizmin e përdorur edhe nga personi tjetër fizik që ushtron aktivitetin e avokatisë në zyrat e "Partners Law", shtetësja Greta Domi.** Ines Dani ka vetëm një përgjigje: *Ok.*

**154.8.** Në faqen 135 Adela Kondakçiu vijon diskutim në lidhje me këtë ide të Ajolës, duke i thënë Ines Danit: *INES MUND TË KALOJMË 4.000 EURO PLUS TVSH TE HARABEL KËTË DHE PJESËN TJETËR VITIN TJETËR.* Thënë ndryshe, shuma e të hollave që në rastin konkret kalohet nga "FUSHA" shpk tek personi fizik Ines Dani, për shërbime konsulence ligjore, me urdhër të Ajola Xoxës kalohet më pas pjesërisht tek organizata "Harabel". **Gjykata çmon se i gjithë mekanizmi që përmendet më lart, i cili nis që nga subjekti tregtar "Fusha" shpk, i lidhur ngushtë me interesa financiarë me Bashkinë Tiranë, vijon me kalimin e një sasie të hollash, rreth 2.600.000 lekë, të ndara mes personave fizikë Ines Dani dhe Greta Domi, në llogaritë e tyre bankare, dhe kalimi nga këto të fundit tek destinacioni fundor që rezulton të jetë shtetësja Ajola Xoxa, sipas udhëzimeve të qarta të lëshuara nga kjo e fundit, si nëpërmjet tërheqjeve në CASH ashtu edhe nëpërmjet transfertave në OJF të e kontrolluara nga vetë kjo shtetase, dëshmon qartë dhe plotësisht të gjithë rrugën e ndjekur për pastrimin dhe injektimin në sistemin bankar të përfitimeve të paligjshme të siguruara nga bashkëshortja e kryetarit të bashkisë Tiranë, Erjon Veliaj, shtetësja Ajola Xoxa, për shkak të veprimeve dhe mosveprimeve që lidhen me funksionin zyrtar të bashkëshortit të saj.**

**154.9.** Faktet e mësipërme provohen dhe gjatë deklarimit të shtetases **Adela Kondakçiu** më datë 12.12.2024 e cila ka shpjeguar se ka njohje me Greta Domin, e cila ndjek çështje ligjore të zyrës Partners Law Shpk, por edhe të OJF-ve nëse do të kishin ndonjë çështje. Shpjegon se Greta Domit si person fizik, vetë Adela i mban kontabilitetin dhe i bën deklarimet. **Pasi është njohur me një faturë të lëshuar nga Greta Domi me blerës Fusha Shpk, *deklaruesja shpjegon se Ajola Xoxa e ka vendosur vlerën e faturimit*.** Kjo shtetase shpjegon se *çdo faturë që është lëshuar nga Greta Domi tek subjektet tregtare të tjera apo OJF, është kërkuar dhe vendosur nga ana e Ajolës.* Deklaruesja shpjegon se *Greta për të gjithë shërbimet e saj kishte tarifë mujore/fee, në vlerë 120,000 lekë të reja.*

*4) Lidhur me dhënien e përfitimit të parregullt nga shoqëria "Palushi" shpk.*

**155.** Gjithashtu, nga aktet e administruara rezulton se familjarët e shtetases Ajola Xoxa kanë krijuar edhe një qendër tjetër me karakter jofitimprurës. Konkretisht, me aktin e themelimit të **Qendrës "Eventus"** me Nr. 3704 Rep., Nr. 1782 Kol., datë 02.11.2021, anëtarët themelues shtetasit Emil Simixhiu, Erald Simixhiu, dhe Linda Kazani (përkatësisht

djali i dajës, daja dhe bashkëshortja e dajës së shtetases Ajola Xoxa), kanë vendosur që të themelojnë një qendër joftitimprurëse me emrin "Eventus", përcaktuar kjo edhe në nenin 1 të aktit të themelimit. Sikurse është provuar gjatë hetimit paraprak kjo shoqëri është nën kontrollin e shtetases **Ajola Xoxa. Konstatohet se financimin më të madh kjo qendër e ka nga Bashkia Tiranë në vlerën 10,580,000 Lekë dhe nga subjekti Palushi shpk në vlerën 3,237,300 Lekë (faturë e cila dyshohet fiktive bazuar në aktet e këtij procedimi).** Gjithashtu evidentohen edhe financime në vlera më të vogla nga Ministria e Kulturës.

**155.1.** Në lidhje me **"Palushi" shpk,** me vendim të prokurorit të datës 22.01.2025 është proceduar me këqyrje/marrjen e dokumenteve pranë Bashkisë Tiranë, Drejtoria e Përgjitshme e Planifikimit dhe Zhvillimit të Terriorit. Në sistemin elektronik të E-Leje rezulton se ky subjekt ka përfituar: *1)* Leje ndërtimi miratuar me **vendim nr. A14369/9, datë 05.11.2019,** të nënshkruar nga kryetari i bashkisë Tiranë, Erion Veliaj, **me afat kohor 48 muaj,** për godinë Banimi dhe shërbimi me 8 kat, me 2 kat parkimi nëntokë", ndërtuesi "Palushi" shpk, me NUIS K12202004R. ***2)* Leje ndërtimi nr. Prot. A-19418/8 prot., datë 19.07.2023,** të nënshkruar nga kryetari i bashkisë Tiranë, Erion Veliaj **me afat kohor 60 muaj,** zhvillues dhe ndërtues "Palushi" shpk, me NUIS K12202004R, banesë individuale 2 kat me 1 kat nëntokë dhe mur rrethues; ***3)* Leje ndërtimi nr. Prot. A-16289/8, dt. 04.06.2024, të nënshkruar nga kryetari i bashkisë Tiranë, Erion Veliaj, me afat kohor 48 muaj**, ndërtues dhe zhvillues "Palushi" shpk, me NUIS K12202004R, "Godinë banimi dhe shërbimi 4, 5, 6, 7, 8, 9 dhe 10 kat me 2 kat parkim nëntokë". Përfaqësues ligjor i subjektit tregtar **"Palushi"** shpk, me NIPT K12202004R është shtetasi **Meriman Palushi.**

**Në lidhje me këto leje ndërtimi të dhëna nga Bashkia Tiranë, konstatohet se marrëdhënia e subjektit tregtar me këtë të fundit vijon edhe aktualisht (kuptohet që vijonte edhe në vitin 2023), përsa kohë nuk është marrë ende çertifikata e përdorimit të objekteve të ndërtuara. Sipas organit procedues theksohet se çdo leje ndërtimi është objekt kontrolli nga bashkia deri në momentin që për të lëshohet çertifikata e përdorimit.**

**155.2. Gjithashtu, nga verifikimet e kryera në sistemin e tatimeve rezulton se gjatë periudhës që marrëdhënia e "Palushi" shpk me Bashkinë Tiranë vijon, ky subjekt tregtar ka financuar dy OJF, konkretisht "Qendra Eventus" me NUIS M12422451B dhe OJF- "BYL-A" me NUIS K41828009Ë, të kontrolluara faktikisht nga shtetësja** Ajola Xoxa, **me shumën totale prej 50.000 euro.** Konkretisht, më datë 06.09.2023 ora 13:34, me numër fature 4, Qendra Eventues i ka faturuar subjektit "Palushi" shpk, shumën **30.000 Euro** me përshkrimin **"Financim festival artistik".** Po në datë 06.09.2023 ora 13:38, **OJF- "BYL-A",** me numër fature 23 i ka faturuar shoqërisë "Palushi" shpk, shumën **20.000 Euro** me përshkrimin **"Financim Festival artistik".**

**155.3.** Në lidhje me fiktivitetin e këtyre faturave, nga komunikimet mes **shtetases Adela Kondakçiu dhe Albana Koçollari,** të zhvilluara më datë 05.09.2023, konstatohet se kjo e fundit i kërkon Adela Kondakçiut t'i niste faturat që në total bëjnë 50.000 euro. Paraprakisht kësaj kërkese, **Albana Koçollari** i kërkon Adela Kondakçiut që faturat të lëshohen pa TVSH **nga persona fizikë, pa përcaktuar se cilët duhet të ishin këta persona. Kjo, në mënyrë që "Palushi" shpk mos paguante më tepër sesa kishin rënë dakord.** Por Adela Kondakçiu, në një material *attachment*, i nis Albana Koçollarit dy fatura, të lëshuara jo nga persona fizikë për subjektin "Palushi" shpk, **por nga OJF "BYL-A" dhe OJF**

**"Eventus"**, përkatësisht 20.000 Euro dhe 30.000 Euro, me përshkrimin "Financim Festivali Artistik". **<u>Me interes është këtu është fakti se për faturat flitet mes Adela Kondakçiut dhe Albana Koçollarit, dhe jo me përfaqësuesit e "Palushi" sh.p.k, si edhe të dyja faturat me këtë përshkrim lëshohen në të njëjtën datë dhe me të njëjtin përshkrim, pa TVSH, sipas kërkesës së bërë më parë nga shtetasja Albana Koçollari.</u>**

155.4. Nga analizimi i deklarimeve të blerjeve në Portalin Qendror për Kontroll dhe Menaxhim (fiskalizimi) rezulton se **qendra "Eventus"** ndër të tjera ka deklaruar blerjet e mëposhtme: i) AVA Studio shpk (Faturë nga Shitësi) (ID: M12212012O): 3,397,774 Lekë; ii) Arts Lab (Faturë nga Shitësi) (ID: M12305006H): 2,570,000 Lekë; iii) Adela Kondakçiu (Faturë nga Shitësi) (ID: M32306039N): 80,000 Lekë.

**155.5.** E pyetur në datë **12.12.2024** si person që ka dijeni për veprën penale, **shtetësja Adela Kondakçiu,** me profesion ekonomiste, ka shpjeguar shumë detaje që paraqesin mjaft interes për hetimin. Kjo shtetase ndër të tjera ka deklaruar se **njeh përfaqësues të kompanisë Palushi Shpk, i cili ka sponsorizuar me nga 25,000 Euro** *(dy herë në total)* **qendrën BYL-A dhe qendrën MUZA.** Njëra vlerë është për sponsorizimin për festivalin e Dancit, ndërsa vlera tjetër 25,000 euro do të ishte për eventet e qendrës Eventus. **Deklaruesja ka shpjeguar** se ***Ajola i ka treguar se si duhen prerë faturat tatimore, vlerën, dhe nga cila organizatë.***

155.6. Sa më sipër u arsyetua, **Gjykata çmon se edhe në rastin e dhënies së "përfitimit të parregullt" në shumën prej 50.000 euro prej shoqërisë "Palushi" shpk sikurse ishtë "dakortësuar" më parë është ndjekur e njëjta skemë si tek rasti i shoqërisë "Fasha" shpk. Pra, tregohet kujdes që këto shuma mos të kalojnë tek shoqëri që judikisht është ortake Ajola Xoxa por të kalohet tek shoqëri që kontrollohen** ***de facto nga kjo e fundit.*** Ndorkohë që e gjithë **skema e kalimit të këtij** ***"përfitimi të parregullt"*** **si dhe shuma përkatëse diktohet pikërisht nga shtetësja Ajola Xoxa. Gjithësesi të gjitha këto shuma kalojnë në formën e emërtimit "sponsorizime" në buxhetin e familjes Veliaj-Xoxa në mënyrë indirekte, duke u realizuar transaksionet nëpërmjet shoqërive dhe personave fizik të kontrolluar nga shtetësja Ajola Xoxa ose duke u tërhequr cash nga personat që u kalon shuma dhe pasi tërhiqen prej tyre u jepet cash shtetases Ajola Xoxa.** **<u>Janë këto të ardhura të përfituara në mënyrë të paligjshme që kanë bërë që shtetësja Ajola Xoxa dhe të afërmit e saj të shpenzojnë për katër vite shifrën prej 86,721,175 lekë vetëm</u>** ***<u>për rroba, produkte kozmetike, buzëkuq, vathë, etj.</u>*** **Këto shpenzime nuk janë deklaruar kurrë në ILDKPKI, pasi ekziston dyshimi i arsyeshëm i bazuar në prova se vijnë nga burime të paligjshme.**

*5) Lidhur me dhënien e përfitimit të parregullt nga shoqëria "Gerard-A" shpk.*

156. Nga aktet e administruara rezulton se, **shoqëria "Gerard – A" Shpk**, me NIPT L12407005L, është regjistruar fillimisht në organin tatimor në datën 31.11.2011, nga shtetasi Altin Kumara, ne objekt aktiviteti; *Import - eksport brenda dhe jashtë vendit, Transport publik, Transport urban,* me adresë; *Rruga "Ded Gjo Luli", me pasurinë e paluajtshme nr.6/901, Zona Kadastrale 8350,vol.38, faqe 211,* me kapital fillestar 33.400.000 lekë. **Në datën 07.04.2021, pranë QKB-së është bërë Depozitimi i vendimit të ortakut të vetëm, datë 01.04.2021, ku është vendosur: Miratimi i transferimit nëpërmjet kontratës së shitjes se kuotave me Nr. 1422 Rep., Nr. 398 Kol., datë 02.04.2021, nga shtetasi Altin**



SPIJUNI.AL

**Kumara në favor të shtetasit *Sokol Kryeziu.*** Nga analizimi i historikut të punësimit në sistemin informatikë tatimor C@TS rezulton se shtetasi **Sokol Kryeziu** ka punuar më parë si ***fatorino*** në shoqërinë "Gerard-A" nga viti 2016. Më ky shtetas ka punuar si ***kontrollor*** deri në momentin që ka blerë shoqërinë. Sipas kontratës së shitjes shoqëria është blerë për shumën **33.4 milion lekë**, vlerë e cila do paguhej me këste për gjashtë vjet. Gjithashtu, i njëjti shtetas rezulton se në periudhën **21.10.2017 deri në 26.02.2018, ka punuar si *fshesar* në Drejtorinë e Përgjithshme të Pastrim Gjelbërimit**, dhe në vijim si ***punëtor ngarkim-shkarkimi mbetjesh* në shoqërinë Alb Tech Plast.** Më pas, ky shtetas rezulton të ketë punuar si *drejtor* me pagë 50,000 lekë në shoqërinë Green Line.

**156.1.** Nga aktet e administruara rezulton se, në kuadër të hetimeve paraprake, në Bashkinë Tiranë është proceduar me këqyrje/marrjen e praktikave të prokurimeve publike, që i përkasin disa subjekteve tregtare, të cilët rezultojnë të kenë financuar OJF-të dhe Personat Fizikë të kontrolluar efektivisht nga shtetësja Ajola Xoxa. Konkretisht, me vendim të prokurorit të datës 23.12.2024 është proceduar me këqyrje/marrjen e dokumenteve pranë institucionit të bashkisë, nga kërkimi në evidencat/regjistrat e protokollit të arkivës të të cilit u evidentuan Kontratë Sipërmarrje **Nr. 28111/8 Prot., datë 02.11.2020,** "Sistemi i Lanës, FAZA 1", **(Kontraktor "Gerard-A"), me vlerë totale te kontratës pa TVSH 19,453,542** (nëntëmbëdhjetë milion e katërqind e pesëdhjetë e tre mijë e pesëqind e dyzetë e dy) lekë. Nga ana e bashkisë Tiranë, me urdhër shpenzimi nr. 5272 datë 31.12.2021, **<u>të nënshkruar nga kryetari i Bashkisë Tiranë Erion Veliaj</u>**, i janë kaluar "Gerard-A" shpk, **shuma prej 19,755,951.00 lekë.** Me urdhër-shpenzimi nr. 4079 datë 02.11.2022, **<u>të firmosur nga kryetari i Bashkisë Tiranë Erion Veliaj</u>**, i janë kaluar "Gerard-A" shpk, **shuma prej 2,421,064 lekë.**

**156.2.** Nga verifikimi në burime të hapura rezulton se shoqëria **"Gerard–A" shpk** ne NIPT L12407005L në **periudhën 2018-2023 ka fituar rreth 20 procedura** me autoritet kontraktor UKT, Drejtoria e Pastrimit dhe Gjelbërimit apo Drejtoria nr. 2 e Punëtorëve të Qytetit. Me Drejtorinë e Pastrimit dhe Gjelbërimit, e cila gjatë periudhës është drejtuar nga Arlinda Binjaku, shoqëria "Gerard-A" ka fituar 13 procedura prokurimi. **Nga analizimi i librave të shitjes të shoqërisë të deklaruara në organin tatimor, rezulton se shoqëria "Gerard – A" Shpk, me NIPT L12407005L, ka marrëdhënie tregtare me entet publike. Nga totali i deklaruar, shitjet me burim nga realizimi i kontratave me ente publike janë në vlerën <u>600.076.636 lekë me TVSH,</u> të cilat janë rezultat i procedurave të prokurimit që janë fituar nga shoqëria me entet në varësi të Bashkisë së Tiranës.**

**156.3.** Gjithashtu, me vendim të prokurorit të datës 23.12.2024 është proceduar me këqyrje/marrjen e dokumenteve pranë Bashkisë Tiranë, Drejtoria e Përgjitshme e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit, në sistemin elektronik të *E-Leje*, në lidhje me Lejet e Ndërtimit të dhëna nga Bashkia Tiranë. Nga dokumentacioni i administruar ka rezultuar se nga ky institucion janë miratuar leje ndërtimi për disa firma, të cilat nga ana e tyre kanë kaluar shuma të hollash në favor të subjekteve tregtarë të kontrolluara nga shtetësja Ajola Xoxa. Konkretisht disa prej tyre janë listuar sa vijon: i) **Leje ndërtimi e miratuar me vendim Nr. S-16100/7, <u>të nënshkruar nga kryetari i Bashkisë Tiranë, Erion Veliaj</u>,** për **"Hoteleri studentore 2 dhe 3 kat me mur rrethues"**, në Sauk, Njësia Administrative Farkë, Tiranë, me pronar dhe zhvillues Fatmir Gjeçi, Hamide Gjeçi dhe Klodjan Gjeçi, dhe subjekt ndërtues shoqëria **"Gerard-A" sh.p.k., me administrator <u>Sokol Kryeziu</u>, viti 2019; ii) Leje**

ndërtimi e miratuar me vendim Nr. S-11181/6 të nënshkruar nga kryetari i Bashkisë Tiranë, Erion Veliaj për "Godinë hotelerie studentore 2 kat me 2 kat pjesërisht nëntokë dhe 2 kat nëntokë dhe mur rrethues", në Sauk, Njësia Administrative Farkë, Tiranë, në pronë të shoqërisë "Gerard-A" sh.p.k., me zhvillues dhe subjekt ndërtues shoqërinë "Gerard-A" sh.p.k." me administrator Sokol Kryeziu, viti 2023; iii) Leje ndërtimi e miratuar me vendim Nr. S-5746/5, të nënshkruar nga kryetari i Bashkisë Tiranë, Erion Veliaj për "Kompleks banimi 3 kat me 1 dhe 2 kat parkim.

**156.4.** Nga ana tjetër, gjatë periudhës Dhjetor 2023 dhe Janar 2024, pronari i saj dhe administratori i shoqërisë Sokol Kryeziu, provohet të ketë blerë disa piktura nga shoqëria "NAN Gallery" shpk, me NIPT M31920013O, me administratore shtetasen Daniela Vuksani, shoqëri kjo e kontrolluar faktikisht nga shtetësja Ajola Xoxa dhe zotëruar ligjërisht nga "Harabel" OJF. Vlera totale e pikturave të blera është në shumën 5. 037. 064 lekë. Shitja e tyre evidentohet e deklaruar në librat e shitjes të shoqërisë Nan Gallery Shpk, në datën 28.12.2023 në vlerën 2.176.230 lekë me tvsh, me numër fature 10/2023, me adresë "Spanjë", me blerës Sokol Kryeziu me numër personal I70806002Q, dhe faturën tjetër të datës 08.01.2024, në vlerën 2,860,834 lekë me tvsh, me numër 1/2024, me adresë "Spanjë", me blerës Sokol Kryeziu me numër personal I70806002Q.

**156.5.** Gjithashtu, nga aktet e administruara rezulton se ka komunikime midis shtetaseve **Adela Kondakçiu dhe Ajola Xoxa** lidhur me pagesat e kompanieve që zotërohen nga kjo e fundit, ku bën pjesë dhe **"Nan Gallery" e cila zotërohet në masën 100% nga Qendra "Harabel" dhe mbi të cilën kjo shtetase ka kontroll faktik.** Mjafton këtu të përmenden komunikimet e ndodhura në faqet 881-882, ku i kërkohet financieres Adela Kondakçiu t'i dërgojë numrin IBAN të "Nan Gallery" tek Banka Intesa Sanpaolo. **Gjithashtu, pyetjes së financieres se nga do paguhet piktori E.B., shtetësja Ajola Xoxa i përgjigjet nga "Nan".** Përveç kësaj, shtetësja Adela Kondakçiu, sipas sa përmendet në faqen 882, i dërgon shtetases Ajola Xoxa pagesat e kryera nga "Nan" shpk. Shitjet e realizuara nga kjo shpk. sipas këtyre komunikimeve, rezultojnë të jenë në masën 21.000 euro. Por këto blerje tek "Nan Gallery" shpk janë kryer nga shtetasi Sokol Kryeziu, i cili rezulton të jetë aksioner i vetëm i shoqërisë "Gerard-A". Pra, ky shtetas, si individ, ka blerë nga "Nan" shpk disa piktura, të cilat sipas deklarimeve tatimore kapin shifrën e 5.037.064 lekë (të ndara në dy fatura, rreth 21.000 Euro dhe rreth 27.000 euro) shifër nga e cila të paktën deri në këtë moment rezulton të jetë paguar vlera prej 21.000 euro, referuar në këtë rast deklarimeve të shtetases Adela Kondakçiu. Sipas të njëjtave deklarime, vlera e cila i është likujduar shtetasit Idlir Koka, piktor, për të gjithë punët e prodhuara prej tij, nga "Nan" shpk ka qenë 13.000 Euro. Ndërkohë, vlera e shitjes së tyre tek shtetasi Sokol Kryeziu është rreth 50.000 euro. **Pra, edhe në këtë rast, një tjetër përfitues i madh i fondeve publike nga Bashkia Tiranë, jep shuma monetare në favor të kompanive që kontrollohen efektivisht nga shtetësja Ajola Xoxa, duke zgjedhur si mekanizëm për dhënien e këtyre të hollave blerjen e të gjithë koleksionit të pikturave të shtetasit Idlir Koka, dhe me një diferencë prej 30.000 Euro nga çmimi i blerjes së tyre prej shoqërisë "Nan Gallery" shpk.**

**156.6. Nga sa më lart, Gjykata çmon se krijohen dyshime të arsyeshme të bazuara në prova se për shkak të përfitimit të fondeve publike nga Bashkia Tiranë prej shtetasit Sokol Kryeziu, sipas burimeve të hapura si Open Procurement, ky i fundit ka**

**kaluar tek "Nan Gallery" shpk një shumë prej të paktën 21.000 euro (aq sa rezulton nga këto komunikime).**

*6) Lidhur me dhënien e përfitimit të parregullt të siguruara nëpërmjet OJF-ve.*

**157.** Ndërsa në lidhje me përfitimet e parregullta të siguruara nëpërmjet OJF-ve, të cilave u është atribuuar vepra penale në regjistrin përkatës në Prokurorinë e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, por të cilat nuk janë objekt i kësaj kërkese, Gjykata e çmon të drejtë kërkesën e Prokurorisë së Posaçme se episodet konkrete për të cilat deri në këtë moment ka dyshime të arsyeshme të bazuara në prova, lidhen me: **1)** Marrjen e përfitimit të parregullt (në formë sponsorizimi për evente artistike) nëpërmjet **OJF Qendra "Eventus"**, me drejtor ekzekutiv shtetasen Linda Kazani (bashkëshortja e dajës së shtetases Ajola Xoxa), për të kryer veprime të cilat lidhen me funksionin publik. Këto përfitime të parregullta të dhëna me firmën e kryetarit të Bashkisë Tiranë, shtetasit nën hetim Erion Veliaj, kanë kaluar me transferta bankare nga kjo OJF në shoqëritë me përgjegjësi të kufizuara të kontrolluara *de facto* dhe *de jure* nga shtetësja Ajola Xoxa, **dhe rrjedhimisht me përfitues fundorë bashkëshortët Veliaj-Xoxa; 2)** Marrjen e përfitimit të parregullt (në formë sponsorizimi për evente artistike) nëpërmjet **OJF Qendra "Muza"**, me drejtor ekzekutiv shtetasen Alketa Spartaku (kushërirë e shtetases Ajola Xoxa), pronarë përfitues Erald Simixhiu (daja i shtetases Ajola Xoxa), Arben Spartaku (kushëri i shtetases Ajola Xoxa) dhe Rea Spartaku (kushërirë e shtetases Ajola Xoxa), për të kryer veprime të cilat lidhen me funksionin publik. Këto përfitime të parregullta të dhëna me firmën e kryetarit të Bashkisë Tiranë, shtetasit nën hetim Erion Veliaj, kanë kaluar me transferta bankare nga kjo OJF në shoqëritë me përgjegjësi të kufizuar të kontrolluara *de facto* dhe *de jure* nga shtetësja Ajola Xoxa, **dhe rrjedhimisht me përfitues fundorë bashkëshortët Veliaj-Xoxa; 3)** Marrjen e përfitimit të parregullt (në formë sponsorizimi për evente artistike) nëpërmjet **OJF Qendra "Frobolous"**, me drejtor ekzekutiv shtetasen Frosina Bollo, për të kryer veprime të cilat lidhen me funksionin publik. Këto përfitime të parregullta të dhëna me firmën e kryetarit të Bashkisë Tiranë, shtetasit nën hetim Erion Veliaj, kanë kaluar me transferta bankare nga kjo OJF në shoqëritë me përgjegjësi të kufizuar si edhe persona fizikë të kontrolluar *de facto* nga shtetësja Ajola Xoxa, **dhe rrjedhimisht me përfitues fundorë bashkëshortët Veliaj-Xoxa; iv)** Marrjen e përfitimit të parregullt (në formë sponsorizimi për evente artistike) nëpërmjet **OJF "BYL-A"**, me drejtor ekzekutiv shtetasen Reada Lemnusha, për të kryer veprime të cilat lidhen me funksionin publik. Këto përfitime të parregullta të dhëna me firmën e kryetarit të Bashkisë Tiranë, shtetasit nën hetim Erion Veliaj, kanë kaluar me transferta bankare nga kjo OJF në shoqëritë me përgjegjësi të kufizuar si edhe persona fizikë të kontrolluar *de facto* dhe *de jure* nga shtetësja Ajola Xoxa, dhe **rrjedhimisht me përfitues fundorë bashkëshortët Veliaj-Xoxa.**

**157.1.** Gjykata çmon se faktet dhe provat që i janë paraqitur gjykatës nga Prokuroria e Posaçme, krijojnë dyshimin e arsyeshëm se në rastin konkret bëhet fjalë për një sistem të organizuar korrupsioni dhe shpërdorimi të fondeve publike, të udhëhequr nga kryetari i bashkisë Tiranë dhe bashkëshortja e këtij të fundit. Në qendër të kësaj skeme korrupsioni, rezulton të jetë kryetari i Bashkisë Tiranë, nënshkrimi i të cilit ka qenë determinant për shpërndarjen e fondeve publike, prej të cilave ai dhe familjarët e ngushtë të tij kanë përfituar

drejtpërsëdrejti në mënyrë të parregullt. **Gjykata e çmon të drejtë kërkesën e Prokurorisë së Posaçme nga hetimet paraprake të kryera deri në këtë fazë, përveç pasurive të paluajtshme të përfituara nga shtetasit nën hetim Erion Veliaj dhe Ajola Xoxa (*nën regjimin pasuror të bashkësisë ligjore*), këta të fundit përmes shoqërive "Partners Law" shpk, "Arts Lab" shpk, "Ava Studio" shpk, "Nan Gallery" shpk, "Byl-A" OJF, "Harabel" OJF, "Eventus" OJF dhe "Muza" OJF, për të cilat tërësisht nga bashkëshortja e kryetarit të Bashkisë Tiranë, kanë gjeneruar të ardhura të cilat kapin shifrën e rreth <u>110.000.000 lekë.</u>**

**158. Në lidhje me anën subjektive të figurës së veprës penale "*Korrupsioni aktiv i funksionarëve të lartë shtetërorë ose i të zgjedhurve vendorë*".** Gjykata vlerëson se, figura e veprës penale të *"Korrupsioni aktiv i funksionarëve të lartë shtetërorë ose i të zgjedhurve vendorë"*, parashikuar nga neni 245 i Kodit Penal kërkon si formë faji dashjen direkte. Gjykata vlerëson se, ana subjektive e figurës së veprës penale zbulohet dhe qartësohet nëpërmjet anës objektive, sepse proceset e brendshme psikike dhe psikologjike jo vetëm që ngacmohen nga faktorë të jashtëm, por edhe materializohen në veprimtarin kriminale gjatë dhe nëpërmjet procesit të zhvillimit të anës objektive.

**159. Në lidhje me subjektin e veprës penale. Në lidhje me subjektin e veprës penale,** në nenin 12 të Kodit Penal thuhet shprehimisht se: *"Ka përgjegjësi penale personi që në kohën e kryerjes së një krimi ka mbushur moshën katërmbëdhjetë vjeç. Personi që kryen një kundërvajtje penale ka përgjegjësi kur ka mbushur moshën gjashtëmbëdhjetë vjeç"*. Kështu, personi fizik që të konsiderohet subjekt i figurës së veprës penale, dhe si rrjedhojë të plotësojë kushtin paraprak për fajin dhe përgjegjësinë penale, duhet të plotësojë dy kritere ekskluzive ligjore (*condicio sine qua non*): ***i)*** Të ketë mbushur moshën për përgjegjësi penale dhe ***ii)*** të jetë i përgjegjshëm. Kështu, neni 17 i Kodit Penal parashikon se: *"Nuk ka përgjegjësi penale personi që në kohën e kryerjes së veprës vuante nga një turbullim psikik ose neuropsikik që ka prishur tërësisht ekuilibrin e tij mendor dhe për pasojë nuk ka qënë në gjëndje të kontrollojë veprimet apo mosveprimet e tij dhe as të kuptojë se kryen vepër penale"*. Ky kusht ka të bëjë me domosdoshmërinë për të proceduar penalisht vetëm personat e përgjegjshëm, që kanë të paktën një ndërgjegje minimale sa për t'i bërë ato të aftë të kuptojnë rëndësinë e veprimeve që kryejnë, në mënyrë që realisht të ekzistojë ana subjektive e autorit të veprës penale, që për organin procedues do të thotë të jetë i mundur të identifikohet forma e fajësisë. Megjithatë, që të përjashtohet nga përgjegjësia penale, për shkak të gjendjes mendore, duhet te plotësohen në mënyrë kumulative disa kushte. ***Së pari***: personi të vuajë nga një turbullim psikik ose neuropsikik. ***Së dyti***: ky turbullim të ketë prishur tërësisht ekulibrin mendor të personit. ***Së treti:*** turbullimi të ketë ekzistuar në kohën e kryerjes së veprës. Ky kusht buron nga rregulli se përgjegjësia penale përcaktohet në momentin e kryerjes së veprës penale.

**B. Lidhur me figurën e veprës penale "*Korrupsioni pasiv i funksionarëve të lartë shtetërorë ose i të zgjedhurve vendorë*".**

**160.** Gjithashtu, në çështjen objekt gjykimi, prokuroria i ka atribuar personave nën hetim **Erion Veliaj** dhe **Ajola Xoxa** faktin se ka dyshime të arsyeshme se ka konsumuar elementët e figurës së veprës penale *"Korrupsioni pasiv i funksionarëve të lartë shtetërorë*

*ose i të zgjedhurve vendorë"* e kryer në bashkëpunim, parashikuar nga neni 260 e 25 i Kodit Penal. Në këtë dispozitë parashikohet shprehimisht se: *"Kërkimi ose marrja, drejtpërdrejt ose tërthorazi, i çdo lloj përfitimi të parregullt apo i një premtimi të tillë, për vete ose për persona të tjerë, ose pranimi i një oferte a premtimi që vjen nga përfitimi i parregullt, nga funksionari i lartë shtetëror ose i zgjedhuri vendor, për të kryer ose mos kryer një veprim që lidhet me detyrën a funksionin e tij, dënohet me burgim nga* ***katër deri në dymbëdhjetë vjet****."*.

**161. Në lidhje me objektin e veprës penale, *"Korrupsioni pasiv i funksionarëve të lartë shtetërorë ose i të zgjedhurve vendorë"*.** Për të pasur konfigurimin e veprës penale të korrupsionit pasiv të personave që ushtrojnë detyra publike, duhet që të realizohet cenimi i objektit të veprës penale, domethënë që të vërtetohet cenimi i një marrëdhënie juridike të rëndësishme, siç është ajo e vendosur nga shteti për të siguruar autoritetin dhe funksionimin e rregullt dhe të paanshëm të administratës publike, si dhe mbrojtjen e interesave të ligjshme të personave fizikë apo juridikë të mbrojtura posaçërisht nga legjislacioni penal. Kështu, nga vepra penale mund të cenohen në mënyrë të përgjithshme si parimet kryesore udhëheqëse të veprimtarisë së administratës publike, ashtu edhe interesat e personave fizikë dhe juridikë konkretë dhe ato të publikut në përgjithësi. Qëllimi i mbrojtjes së marrëdhënies juridike nga norma penale është mbrojtja dhe ruajtja e ushtrimit të ligjshëm të funksioneve publike, si dhe ruajta e besimit që individët kanë tek funksionarët që ushtrojnë detyra publike në përputhje me parimin e ligjshmërisë dhe besnikërisë së ushtrimit të detyrës publike, duke i shërbyer me përpikëri vetëm interesave publikë, në mënyrë të paanshme dhe objektive. Në bazë të nenit 107/1 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, nëpunësit publikë zbatojnë ligjin dhe janë në shërbim të popullit. Prandaj, edhe ushtrimi i detyrës publike duhet të udhëhiqet vetëm nga respektimi i ligjit dhe shërbimi ndaj interesave publike, dhe jo i atyre interesave private të shkëmbimit që nuk duhet të mbivendosen apo të dalin mbi ndjekjen e interesave publike.[36]

**162. Në lidhje me anën objektive *(actus rea)* të figurës së veprës penale *"Korrupsioni pasiv i funksionarëve të lartë shtetërorë ose i të zgjedhurve vendorë"*.** Gjykata thekson se ajo është element i domosdoshëm për përgjegjësinë penale, sepse nëse nuk ka veprim ose mosveprim të dënueshëm nuk ka vepër penale. Askush nuk mund të dënohet për mendimet apo idetë e tij. Në kuptim të nenit 260 të Kodit Penal, figura e veprës penale "*Korrupsioni pasiv i funksionarëve të lartë shtetërorë ose i të zgjedhurve vendorë*" nga ana objektive kryhet me veprime aktive të shprehura në mënyra të ndryshme, me anë të kërkimit ose marrjes, drejtpërdrejt ose tërthorazi, të çfarëdo përfitimi të parregullt nga ana e funksionarëve të lartë shtetërorë ose i të zgjedhurve vendorë, apo/ose pranimit të një oferte a premtimi, *për vete ose për persona të tjerë*, me qëllimin për të kryer ose moskryer një veprim që lidhet me detyrën a funksionin e tyre. Gjykata çmon se në respektim të parimit të ligjshmërisë që lidhet me cilësimin juridik të faktit penal duhet të sqarohet kuptimi i termave të përmendura në këtë dispozitë. ***"Kërkimi"*** i referohet një veprimi të njëanshëm të kryer nga gjyqtari, prokurori ose funksionarë të tjerë të organeve të drejtësisë, i cili në mendjen e një personi tjetër i jep të kuptojë në mënyrë të qartë ose të nënkuptuar se ai duhet të paguajë për veprimin e kërkuar. ***"Marrja"*** është pranimi i një përfitimi të parregullt drejtpërdrejt nga ana e funksionarëve të lartë shtetërorë ose i të zgjedhurve vendorë ose nga një ndërmjetës që mund të jetë i afërm, familjar etj. ***"Tërthorazi"*** nënkupton rastet kur transaksioni mund të

---

[36] Shiko Vendimin Nr. 216, datë 16.12.2015 i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë.

realizohet edhe me anë të ndërmjetësve, pavarësisht faktit nëse përfituesi ose pranuesi i përfitimit të parregullt mund të jetë zyrtari publik ose një palë e tretë. ***"Për vete ose për persona të tjerë"*** nënkupton rastin kur përfitues është vetë personi subjekt i veprës penale të korrupsionit aktiv apo pasiv, ndërsa ***"persona të tjerë"*** përfshin rastet kur përfitimi i parregullt jo domosdoshmërisht i jepet personalisht zyrtarit, sepse përfitimi i parregullt mund ti jepet p.sh. të afërmit ose të njohurit të zyrtarit, partisë anëtar i së cilës është zyrtari etj. I rëndësishëm në rastet kur "*përfitimi shkon në dobi të një personi të tretë*", është kushti që gjyqtari, prokurori ose funksionarë të tjerë të organeve të drejtësisësë paku duhet të jenë në dijeni të këtij veprimi, dhe në mënyrë të shprehur apo të heshtur "pranon" që përfitimi i parregullt të shkojë në dobi *"të personit të tretë" (i cili mund të jetë familjar, mik, i afërt, shok apo bashkëpunëtor i tij)*. **"Pranimi i një oferte a premtimi që vjen nga përfitimi i parregullt"** nënkupton shprehjen e vullnetit pranues në lidhje me një ofertë apo premtim që subjekti i korrupsionit aktiv i bën zyrtarit drejtpërdrejt ose në mënyrë të tërëthortë.

**162.1.** Gjykata çmon të theksoj se që të konsumohet vepra penale e korrupsionit pasiv i funksionarëve të lartë shtetërorë ose i të zgjedhurve vendorë, duhet që i pandehuri të kryejë veprën penale me veprime aktive ose mosveprime të kundërligjshme; ose duke kërkuar ose marrë, drejtpërdrejtë ose tërthorazi, *"çdo lloj përfitimi të parregullt"* si: **para apo përfitime të tjera jo materiale, si dhe krijimi i favorizimeve, përfitimi i shërbimeve apo privilegjeve të parregullta**, për vete ose për persona të tjerë; ose të pranojë një ofertë a premtim që vjen nga këto përfitime të parregullta, për të kryer ose mos kryer, një veprim, që lidhet me detyrën a funksionin e tij. Sikundër mund të vërehet, në themel të anës objektive të kësaj figure të veprës penale, parashikohet **një shkëmbim i kundërligjshëm dhe i ndërsjellë**, në të cilën veprimet ose mosveprimet e funksionarit publik konsistojnë në kërkimin e premtimit ose marrjen e një përfitimi për vete ose për të tjerë, apo pranimin e një oferte, me ato të një subjekti të jashtëm, i cili nga ana e tij premton ose ofron një përfitim të paligjshëm.[37] Gjithashtu, vepra penale e korrupsionit pasiv i funksionarëve të lartë shtetërorë ose i të zgjedhurve vendorë, realizohet, si në rastin kur përfitimi i padrejtë lidhet me një veprim a mosveprim me qëllim për të mos e kryer funksionin publik siç duhej, ashtu edhe në rastin kur përfitimi i padrejtë lidhet me një veprim a mosveprim me qëllim për ta kryer "në dukje" siç duhet funksionin publik apo detyrën në fjalë. Vepra penale e korrupsionit pasiv konsiderohet e kryer që nga çasti i kërkimit ose marrjes apo pranimit të një oferte a premtimi nga ana e funksionarëve të lartë shtetërorë ose i të zgjedhurve vendorë, pavarësisht nga ardhja e pasojave të tjera. Kësisoj, vepra penale do të quhet e konsumuar edhe pa u realizuar konkretisht një shkëmbim parash apo shpërblim në përfitime të tjera mes dy palëve, pasi mjafton që të arrihet një marrëveshje (*pactum sceleris*) në formë premtimi për përfitime të parregullta të dyanshme, edhe pa marrjen e kontaktit të drejtpërdrejtë mes palëve, mjafton që funksionari të ketë dijeni rreth saj dhe marrëveshja korruptive mund të bazohet edhe nga fakte përmbyllëse.[38]Gjykata vlerëson se "*parregullsi e përfitimit*" do të thotë që ai nuk është ligjshëm dhe i detyrueshëm, sipas normave të së drejtës dhe se funksionari nuk ka as të drejtën, as tagrin, as detyrimin për ta marrë atë. Kësisoj, Gjykata vlerëson se mund të merret dhënia e një përfitimi material apo pranimi i një premtimi të parregullt, në mënyrë të

[37] Shiko vendimin Nr. 216, datë 16.12.2015 i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë.
[38] Po aty.

shprehur, të heshtur, në mënyrë të drejtpërdrejtë apo edhe të tërthortë, por gjithnjë nëse ekziston dijenia që marrja apo pranimi është në korrelacion më dhënien apo premtimin e një të treti.[39]

**162.2.** Duke u rikthyer në rastin konkret, Gjykata çmon se ekzistojnë dyshime të arsyeshme të bazuara në prova se personat nën hetim **Erion Veliaj dhe Ajola Xoxa**, kanë konsumuar elementët e figurës së veprës penale *"Korrupsioni pasiv i funksionarëve të lartë shtetërorë ose i të zgjedhurve vendorë"*, e kryer në bashkëpunim parashikuar nga neni 260 e 25 i Kodit Penal.

**162.3.** Përpara se të analizojë episodet përkatëse, Gjykata çmon se në rastin konkret duhet të japi kuptimin dhe interpretimin e togfjalëshit *"për të kryer ose mos kryer një veprim që lidhet me detyrën a funksionin e tij"* në secilën prej figurave të posaçme të veprës penale të korrupsionit pasiv të parashikuara në Kodin Penal. **Mbështetur në orientimet e dhëna nga Gjykata e Posaçme e Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar me vendimin Nr. 25, datë 24.06.2024** Gjykata çmon se përmes këtij kushtëzimi ligjor ligjvënësi nuk ka dashur dhe nuk mund të ketë si qëllim që gjykatës penale t'i ngarkojë detyra dhe pushtetin e mirëfilltë të ushtrimit të gjyqësisë sikurse të një gjykate administrative. Kjo do të thotë se gjykata penale nuk mund të konceptohet të ushtrojë juridiksionin gjyqësor sikurse gjykata administrative, për të pasur si detyrë parësore sakaq vetëm verifikimin e ushtrimit të pushtetit publik *ultra vires* nga organet administrates publike. Përkundrazi, nuk mund të jetë kurrësesi ky funksioni i gjykatave me juridiksion penal, pasi ato e ushtrojnë porcionin e sovranitetit të pushtetit të gjyqësor me qëllim për të verifikuar nëse ka fakte penale apo jo në mënyrën se si është ushtruar pushteti publik nga funksionarët titullarë të tij. Funksioni i gjykatave penale në këtë mënyrë fokusohet jo tek kontrolli i ligjshmërisë *ultra vires* të ushtrimit të pushtetit administrativ por tek elementet penal të fajit në mënyrën se si formësohet vullneti i funksionarëve shtetërorë kur e performojnë ushtrimin e pushtetit publik të besuar.

**162.3.1.** Për rrjedhojë Gjykata vlerëson se figurat e veprës penale të korrupsionit e plotësojnë kushtin organik dhe objektiv të ekzistencës së lidhjes integrale të kryerjes apo moskryerjes së veprimit që lidhet me detyrën a funksionin e tij edhe kur funksionari publik kryen veprimtari administrative *ultra vires*. Mjafton që në formësimin e këtij vullneti të funksionarit publik në një mënyrë të caktuar të provohet dyshimi i arsyeshëm, sipas nenit 4 të Kodit të Procedurës Penale, se ka faktorë determinant të fajit penal. **Kjo do të thotë se funksionari publik titullar apo epror do të mbajë përgjegjësi penale për veprën e korrupsionit pasiv edhe kur, duke përdorur tagrat e tij të dhëna nga ligji, akti nënligjor, kontrata publike, apo akti individual administrativ, ushtron pushtetin në atë mënyrë që të ndihmojë, nxisë, diktojë, përgatisë apo edhe rakordojë organet e tjera brenda hierarkisë së atij institucioni apo të varura jo në mënyrë të drejtpërdrejtë nga ai.** Kumti i veprave penale të korrupsionit pasiv, në elementin e lidhjes me detyrën funksionale të funksionarit, nuk qëndron tek respektimi – në kuptimin e së drejtës administrative – të kompetencave të njohura me ligj, akt nënligjor normativ, kontratë të së drejtës publike apo edhe akt administrativ individual. Përkundrazi, kumti i veprave penale të korrupsionit pasiv, përsa i përket lidhjes organike dhe të domosdoshme me ushtrimin e funksionit, përfshin çdo sjellje me keqbesim kriminal të funksionarit publik, që përdor në çdo formë kriminale autoritetin e besuar

[39] Shiko vendimin Nr. 139, datë 22.11.2017 i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë.

atij nga ligji, akti nënligjor normativ, kontrata publike apo akti administrativ individual për të orientuar, përgatitur apo formësuar një vendimmarrje të caktuar zyrtare, edhe kur kjo vendimmarrje sipas legjislacionit respektiv merret nga një organ apo njësi tjetër administrative e lidhur me veprimtarinë publike të tij.[40]

**162.3.2.** Nga ana tjetër Gjykata vlerëson se figurat e veprës penale të korrupsionit pasiv kanë fushëveprim edhe atëherë kur veprimtaria administrative reale apo formale e një organi brenda një institucioni ushtrohet me keqbesim kriminal si fazë paraprake e shqyrtimit të asaj çështje në organin tjetër të të njëjtit institucion, të një institucioni varësie apo të një institucioni tjetër të lidhur nga legjislacioni respektiv si bashkëvendimmarrës apo bashkëveprues në një procedure të caktuar ligjore. Edhe kjo fazë paraprake e procesit administrativ përbën ushtrim të pushtetit publik dhe se për rrjedhojë vendoset nga Kodi Penal nën mbrojtjen e posaçme penale të figurave të korrupsionit pasiv. **Kjo do të thotë se në çdo rast kur një porcion i caktuar i pushtetit publik ushtrohet i ndikuar nga përvetësimi i mitës nga ana e një funksionari publik, pavarësisht natyrës ekzekutive, urdhërdhënëse, përgatitore, ndihmëse, udhëzuese, vendimmarrëse që ka veprimtaria publike e ushtruar, do të duhet të konsiderohet se edhe kjo pjesë e veprimtarisë publike përfshihet në fushën e veprimit të veprave penale të korrupsionit pasiv të parashikuara si figura të posaçme të veprës penale në dispozita të ndryshme në Kodin Penal.**[41]

**162.4.** Megjithatë në rastin konkret, Gjykata çmon se në rastin konkret ekziston dyshimi i arsyeshëm se përfitimet e parregullta jepen edhe për arsye që lidhen drejtpërdrejtë me kompetencat funksionale që i përkasin kryetarit të Bashkisë Tiran, shtetasit Erion Veliaj. Për këto arsye, Gjykata çmon të evidentoj disa nga kompetencat e tij në funksion të zgjidhjes së çështjes objekt gjykimi. Në këto kushte, Gjykata në rastin konkret çmon të nevojshme, që t'i referohet Ligjit Nr. 139/2015 "PËR VETËQEVERISJEN VENDORE", i ndryshuar. Në nenin 3 të këtij Ligji nën titullin **"Misioni i vetëqeverisjes vendore"**, parashikohet shprehimisht se: *"Vetëqeverisja vendore në Republikën e Shqipërisë siguron qeverisjen e efektshme, efikase dhe në një nivel sa më afër qytetarëve nëpërmjet: a) njohjes së ekzistencës së identiteteve dhe vlerave të ndryshme të bashkësive; b) respektimit të të drejtave dhe lirive themelore të shtetasve, të sanksionuara në Kushtetutë ose në ligje të tjera; c) zgjerimit të* ***llojeve të ndryshme të shërbimeve*** *dhe lehtësive të tjera publike vendore* ***<u>në dobi të bashkësisë</u>; ç) ushtrimit efektiv të funksioneve, kompe-tencave dhe realizimit të detyrave nga organet e vetëqeverisjes vendore;*** *d) realizimit të shërbimeve në forma të përshtatshme, bazuar në nevojat e anëtarëve të bashkësisë; dh) nxitjese fektive të pjesëmarrjes gjithë-përfshirëse të bashkësisë në qeverisjen vendore;* ***e) realizimit të shërbimeve, në përputhje me standardet e kërkuara me ligj*** *ose akte të tjera* ***normative."***, ndërsa në nenin 40 të këtij Ligji nën titullin **"Shpenzimet"** parashikohet se: ***<u>"1. Njësitë e vetëqeverisjes vendore kryejnë shpenzime, sipas akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi, në përputhje me parimet e disiplinës fiskale, menaxhimit financiar dhe kontrollit, si dhe përdorimin me eficencë, efektivitet dhe ekonomi të burimeve të tyre financiare."</u>*** Ndërkohë në nenin 64 të këtij Ligji, nën titullin **"Kompetencat dhe detyrat e kryetarit të bashkisë"**, parashikohet shprehimisht se:

[40] Shiko paragrafët 134 dhe 135 të vendimit Nr. 25, datë 24.06.2024 të Gjykatës së Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar.
[41] Po aty faqe 136.

*"Kryetari i bashkisë ka këto kompetenca dhe detyra: a) ushtron të gjitha kompetencat në kryerjen e funksioneve të bashkisë, me përjashtim të atyre që janë kompetencë vetëm e këshillit përkatës;...".*

**162.4.1.** Gjithashtu, në nenin 27 Ligjit Nr. 107/2014 "PËR PLANIFIKIMIN DHE ZHVILLIMIN E TERRITORIT", i ndryshuar, nën titullin **"Autoritetet përgjegjëse"** parashikohet shprehimisht se: *"Autoritetet përgjegjëse për zhvillimin e territorit janë: 1. Këshilli Kombëtar i Territorit.* ***2. kryetari i bashkisë."***, ndërsa në nenin 29 të këtij Ligji nën titullin **"Përgjegjësitë e kryetarit të bashkisë"**, parashikohet se: *"Kryetari i bashkisë është përgjegjës për:* ***a) vendimmarrjen lidhur me aplikimet për leje zhvillimi dhe leje ndërtimi në territorin administrativ të bashkisë; b) vlerësimin e respektimit të kërkesave ligjore për punimet e kryera mbi bazën e deklaratës paraprake për kryerje punimesh; c) dhënien e certifikatës së përdorimit, sipas nenit 42 të këtij ligji, për lejet e ndërtimit të miratuara prej tij."***, ndërsa në nenin 51 të këtij Ligji nën titullin **"Inspektimi"** parashikohet se: *"1. Inspektimi ka për mision garantimin dhe mbrojtjen e interesit kombëtar për një zhvillim të drejtë dhe të qëndrueshëm të territorit, përmes parandalimit të punimeve dhe ndërtimeve të paligjshme, sipas këtij ligji dhe akteve të nxjerra në zbatim të tij, si dhe ndëshkimin e drejtë të kundërvajtësve, që shkelin dispozitat e këtij ligji. 2. Inspektimi për verifikimin e respektimit të kërkesave ligjore, sipas këtij ligji, kryhet në përputhje me këtë ligj, aktet nënligjore të nxjerra në zbatim të tij dhe legjislacionit të zbatueshëm për inspektimin e ndërtimit në Republikën e Shqipërisë.".*

**162.4.2.** Gjithashtu, në rastin konkret, Gjykata çmon që t'i referohet Ligjit Nr. 9780, datë 16.07.2007 "Për inspektimin e ndërtimit" i ndryshuar. Kështu, në nenin 4 të këtij Ligji nën titullin **"Përgjegjësitë e inspektoratit të mbrojtjes së territorit të njësisë vendore"** parashikohet shprehimisht se: *"Pranë çdo njësie vendore ngrihet inspektorati i mbrojtjes së territorit, i cili, nëpërmjet kryeinspektorit e* ***inspektorëve, brenda territorit administrativ të kësaj njësie, ushtron përgjegjësinë e kontrollit të territorit dhe zbatimit të ligjshmërisë së standardeve teknike e kushteve zhvillimore në fushën e planifikimit dhe zhvillimit të territorit dhe të atyre të parashikuara shprehimisht në ligje të tjera. Inspektorati i mbrojtjes së territorit i njësisë vendore drejtohet nga kryeinspektori, i cili emërohet nga kryetari i njësisë vendore përkatëse.*** *Për përmbushjen e përgjegjësive të parashikuara me ligj, inspektorati i mbrojtjes së territorit i njësisë vendore mbështetet nga policia e njësisë vendore dhe pajiset me mjetet dhe makineritë e nevojshme nga njësia vendore.".*

**162.4.3.** Në ligjin Nr. 9643, datë 20.11.2006 *"Për prokurimin publik"*, të ndryshuar,[42] janë parashikuar rregulla të posaçme për kryerjen e prokurimeve publike, për përgjegjësinë e autoriteti kontraktor, llojin dhe mënyrën e përdorimit të proçedurave të prokurimit, për llogaritjen e vlerës së kontratës, përgatitjen e dokumentacionit të tenderit. Kështu, në nenin 12 të këtij Ligji nën titullin **"Përgjegjësia e autoritetit kontraktor"** parashikohet shprehimisht se: *"1. Autoriteti kontraktor është përgjegjës për prokurimin e fondeve* ***publike1, në përputhje me dispozitat e këtij ligji dhe të akteve nënligjore, të nxjerra në zbatim të tij. 2. Autoriteti kontraktor duhet të mbajë procesverbale dhe dokumentacion të plotë për procedurat e kryera në përcaktimin e fituesit të kontratës, në mënyrë të tillë që të***

[42] Citohen këto rregulla pasi kanë qenë në fuqi në disa nga procedurat e prokurimit që janë zhvilluar pranë Bashkisë Tiranë dhe që janë objekt i çështjes objekt gjykimi.

*lejojnë kontrollin e zbatimit të ligjit…".* Gjithashtu, në Ligjin Nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për Prokurimin publik" i ndryshuar, nuk parashikohen strukturat që merren me zhvillimin e një procedure prokurimi. Në këto kushte, Gjykata çmon së për të përcaktuar strukturën që merret me këtë procedurë, duhet t'i referohemi vendimit Nr. 914, datë 29.12.2014 të Këshillit të Ministrave "PËR MIRATIMIN E RREGULLAVE TË PROKURIMIT PUBLIK", i ndryshuar, ku në nenin 56 të kësaj VKM-je nën titullin **"Titullari i autoritetit kontraktor ose zyrtari i autorizuar"** parashikohet shprehimisht se: ***"Titullari i autoritetit kontraktor ose zyrtari i autorizuar prej tij është përgjegjës për ngritjen e grupeve të punës, komisioneve të përfshira në procesin e prokurimit dhe nxjerrjen e urdhrit të prokurimit.*** *Zyrtari i autorizuar për fillimin e prokurimit duhet të jetë njëri nga drejtuesit kryesorë të autoritetit kontraktor, zakonisht zëvendëstitullari. Ai duhet të sigurojë një ndarje të qartë ndërmjet detyrave të zyrta-rëve/nëpunësve të përfshirë në hartimin e dokumenteve të tenderit dhe atyre të përfshirë në procesin e vlerësimit dhe të përzgjedhjes së fituesit.* ***Kërkesat ligjore për parandalimin e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi, duhet të mbahen parasysh në emërimin e një nëpunësi prokurimi.*** *Çdo nëpunës, që merr pjesë në procesin e prokurimit, nënshkruan një deklaratë, përmes së cilës deklaron se nuk ndodhet në kushtet e konfliktit të interesit. Nuk lejohet që titullari i autoritetit kontraktor apo zyrtari i autorizuar të drejtojë një komision ose të marrë pjesë në fazën e procedurës së përzgjedhjes së fituesit, në përputhje me LPP-në dhe me këto rregulla.* ***Në çdo rast, detyrat që përcaktohen në këto rregulla për titullarin e autoritetit kontraktor ose zyrtarin e autorizuar prej tij duhet të kryhen në përputhje me ligjin nr. 10296, datë 8.7.2010, "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", të ndryshuar.",*** ndërsa në nenin 60 të këtij vendimi nën titullin **"Urdhri i prokurimit"**, parashikohet se: *"1. Me miratimin e ligjit për buxhetin dhe pas përllogaritjes së fondit limit sipas Nenit 59 të këtyre rregullave, kur ka nevojë për punë/mallra/shërbime,* ***titullari i autoritetit kontraktor*** *apo zyrtari i autorizuar* ***nxjerr menjëherë urdhrin e*** *prokurimit, i cili duhet të përmbajë: - objektin e prokurimit; -* ***fondin e përllogaritur të vitit ushtrimor si dhe fondin total të përllogaritur, në rastin e kontratave shumëvjeçare;*** *- llojin e procedurës së prokurimit dhe arsyet e përdorimit të saj; - emrat e anëtarëve të njësisë së prokurimit."*[43]

**162.4.4.** Menaxhimi financiar i qeverisjes qendrore dhe vendore rregullohet nga Ligji Nr. 10 296, datë 8.7.2010 "PËR MENAXHIMIN FINANCIAR DHE KONTROLLIN". Në nenin 2 të këtij Ligji, nën titullin **"Qëllimi i ligjit"** parashikohet shprehimisht se: *"Qëllimi i këtij ligji është* ***përdorimi sa më efiçient, efektiv dhe ekonomik i burimeve financiare publike, duke respektuar parimet e transparencës dhe të ligjshmërisë, si dhe shmangia e shpërdorimit, keqpërdorimit*** *dhe vjedhjes së pasurisë."*, ndërsa në nenin 8 të Ligjit Nr. 10 296, datë 8.7.2010 "PËR MENAXHIMIN FINANCIAR DHE KONTROLLIN", nën titullin **"Përgjegjshmëria menaxheriale e titullarit"** parashikohet se: *"1.* ***Titullarët e njësive publike,*** *të përmendura në nenin 3 të këtij ligji,* ***përgjigjen për vendosjen e përmbushjen e qëllimeve dhe të objektivave të njësive publike, nëpërmjet krijimit të një sistemi të përshtatshëm dhe efektiv të menaxhimit financiar dhe kontrollit, si dhe përdorimit të fondeve publike, në mënyrë të ligjshme, me ekonomi, efektivitet dhe efiçencë. 2. Titullarët e***

[43] Këto rregulla janë parashikuar edhe në Ligjin Nr. 162/2020 "Për prokurimin publik", i ndryshuar dhe VKM Nr. 285, datë 19.5.2021 "MIRATIMIN E RREGULLAVE TË PROKURIMIT PUBLIK", i ndryshuar.

*njësive publike*, *të përmendura në pikën 1 të nenit 3 të këtij ligji,* ***caktojnë nëpunësit autorizues****, sipas përcaktimeve të ligjit "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë". 3. Titullarët e njësive publike, të përmendura në pikat 2 e 3 të nenit 3 të këtij ligji, mund të caktojnë një nëpunës të nivelit më të lartë drejtues dhe t'i ngarkojnë atij përgjegjësi që janë të barasvlershme me ato të nëpunësit autorizues.* ***4. Në rast moscaktimi të nëpunësit autorizues, përgjegjshmëria menaxheriale dhe përgjegjësitë, sipas parashikimeve të nenit 9 të këtij ligji, i takojnë titullarit të njësisë publike."***. Nga përmbajtja e këtyre dispozitave rezulton se titullari i njësisë publike ka kompetencën për autorizimin e të gjitha pagesave në cilësinë e nëpunësit autorizues.

**162.5.** Gjithashtu, në rastin konkret Gjykata çmon të trajtoj nëse të ardhurat e deklaruara nga Deklaratat e Pasurisë nga punësimi apo bizneset, të shtetasve Erion Veliaj dhe Ajola Xoxa, të cilët kanë lidhur martesë ligjore do të konsiderohen pasuri e përbashkët apo si pasuri personale e secilit prej tyre. Në këto kushte, Gjykata çmon se për t'i dhënë zgjidhje kësaj çështje duhet t'i referohet nenit 73 të Kodit të Familjes nën titullin **"Bashkësia ligjore"** ku parashikohet shprehimisht se: *"Regjimi pasuror martesor i bashkësisë ligjore zbatohet kur bashkëshortët nuk kanë lidhur kontratë për regjim tjetër pasuror martesor."*, ndërsa në nenin 74 të këtij Kodi nën titullin **"Përbërja e bashkësisë"** parashikohet se: ***"Bashkësia përbëhet nga: a) pasuria e fituar nga të dy bashkëshortët, së bashku ose veç e veç, gjatë martesës; b) të ardhurat nga veprimtaria e veçantë e çdo bashkëshorti gjatë martesës, nëse nuk janë konsumuar deri në mbarimin e bashkëpronësisë; c) frytet e pasurisë së çdo bashkëshorti, që janë marrë dhe nuk janë konsumuar*** *deri në mbarimin e bashkëpronësisë;...".* Gjithashtu, në nenin 76 të Kodit të Familjes parashikohet shprehimisht se: ***"Pasuria e bashkëshortëve prezumohet si e përbashkët, me përjashtim të rastit kur bashkëshorti provon karakterin e saj vetjak"***, ndërsa në nenin 77 të këtij Kodi nën titullin **"Pasuria vetjake"** parashikohet shprehimisht se: *"Pasuri vetjake e bashkëshortit që nuk bën pjesë në bashkësi është: a) pasuria, e cila para lidhjes së martesës ishte në bashkëpronësi të bashkëshortit me persona të tjerë ose kundrejt së cilës ai ishte titullar i një të drejte reale përdorimi; b) pasuria e fituar gjatë martesës me anë të dhurimit, të trashëgimisë ose legut, kur në aktin e dhurimit ose në testament nuk përcaktohet se ato janë dhënë në favor të bashkësisë; c) pasuritë e përdorimit ngushtësisht vetjak të secilit bashkëshort dhe pasuritë e fituara si aksesorë të pasurisë vetjake; ç) mjetet e nevojshme të punës për ushtrimin e profesionit të njërit prej bashkëshortëve, përveç atyre që janë caktuar për administrimin e një veprimtarie tregtare; d) pasuria e fituar nga shpërblimi i dëmit vetjak, me përjashtim të të ardhurave që rrjedhin nga pensioni i fituar për shkak të humbjes së pjesshme ose të plotë të aftësisë për punë; dh) pasuria e fituar nga tjetërsimi i pasurive vetjake të sipërpërmendura; e) shkëmbimi i tyre kur është deklaruar shprehimisht në aktin e blerjes."*. Nga përmbajtja e këtyre dispozitave rezulton pasi lidhjes së martesës çdo e ardhur konsiderohet pasuri e përbashkët pavarësisht se deklarohet në vlerën 100% në Deklaratën Periodike Vjetore. Pra, është në bashkëpronësi midis bashkëshortëve. Bashkëpronësia, në kuptimin e së drejtës materiale, nuk është gjë tjetër veçse një formë e veçantë e shfaqjes së të drejtës së pronësisë, ku dy ose më shumë persona ushtrojnë këtë të drejtë bashkërisht mbi një ose disa sende, si dhe mbi të drejtat reale të lidhura me to.[44] Përsa kohë që një pasuri nuk është pjesëtuar,

[44] Shiko vendimin Nr. 45, datë 01.02.2011 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë.



SPORTELI AL

atëherë askush nuk mund të pretendojë pronësinë e një sendi konkret si pasuri vetjake, por secili prej tyre është pronar i tyre derisa të individualizohet sendi nëpërmjet pjesëtimit. Ajo çfarë dihet me siguri para pjesëtimit është vetëm pjesa ideale. **Ndodhur në këto kushte, çdo e ardhur gjatë martese e shtetasve Erion Veliaj dhe Ajola Xoxa nga veprimtaria e veçantë e tyre konsiderohet pasuri e përbashkët.** ***(Sipas akteve këta të fundit kanë lidhur kanë lidhur martesë ligjore më datë 15.10.2018).*** **Për këto arsye, Gjykata çmon se çdo e ardhur që deklarohet apo nuk deklarohet nga shtetësja Ajola Xoxa që lidhet me veprimtarinë e saj të veçantë e që në mënyrë të tërthortë për të vijnë financime edhe nga financime të Bashkisë Tiranë nëpërmjet ndikimit dhe kooridimit të këtaj të fundit tek bashkëshorti i saj Erion Veliaj në thelb konsiderohen pasuri edhe të këtij të fundit.**

**162.6.** Gjykata çmon se ekzistenca e një fakti mund të nxirret nga indicjet kurr këto janë të rëndësishme, të sakta dhe në përputhje me njëra-tjetrën. Duke u rikthyer në rastin konkret, Gjykata çmon se ekziston dyshimi i arsyeshëm i bazuar në prova se personat nën hetim Ajola Xoxa dhe Erion Veliaj nëpërmjet një skeme të mirëorganizuar kanë pranuar përfitime të parregullta në mënyrë të drejtëpërdrejtë dhe të tërthortë, për arsye që lidhen me detyrën e këtij të fundit. Konkretisht:

**1)** Nga analiza e provave dhe fakteve të cituara në paragrafët 24, 25, 26, 27, 28, 29, 29.1, 29.2, 29.3, 29.3.1, 29.3.2, 29.4, 29.5, 30, 30.1, 31, 31.1, 32, 32.1, 32.2, 32.3, 32.4, 32.5, 32.6, 32.7, 32.8, 32.9, 32.10, 33, 34, 35, 35.1, 35.2, 35.3, 35.4, 35.5, 35.6, 35.7, 35.8, 35.8.1, 35.8.2, 35.8.3, 36, 37, 37.1, 38, 35.8.1, 35.8.1, 35.8.3, 36, 37, 37.1, 38, 38.1, 39, 40, 41, 42, 42.1, 43, 43.1, 43.2, 43.3, 43.3.1, 44, 44.1, 45, 46, 47, 47.1, 47.2, 48, 152.4, 152.4.1, 152.4.2 dhe 152.4.3 të këtij vendimi të para në unitet me njëra tjetrën, Gjykata çmos se ekziston dyshimi i arsyeshëm se shoqëria "Agi Kons" shpk me pronar 100% të kuotave personin nën hetim Gentjan Sula[45] i ka dhënë shtetasve Ajola Xoxa dhe Erion Veliaj në cilësinë e kryetarit të Bashkisë Tiranë si përfitim të parregullt, konkretisht <u>**një vilë në Marea Resort, në Qerret, Kavajë me numër pasurie 1/647, Vol 29, faqe 103, ZK. 3101**</u>, për shkak të detyrës së këtij të fundit si titullar i Autoritetit Kontraktor në procedurat e prokurimit dhe koncesionit që ka përfituar kjo shoqëri, si dhe në cilësinë e autoritetit përgjegjës për dhënien e lejeve të zhvillimit, ndërtimit dhe lejeve të përdorimit.

**2)** Nga analiza e provave dhe fakteve të cituara në paragrafët **153, 153.1, 153.2, 153.3, 153.4, 153.5, 153.5.1, 153.5.2 dhe 153.5.3 të këtij vendimi të para në unitet me njëra tjetrën,** Gjykata çmos se ekziston dyshimi i arsyeshëm se shoqëria "Kontakt" sh.p.k me përfaqësues shtetasin Fatmir Bektashi ka porositur prerjen e biletave të avionit për bashkëshortët Veliaj-Xoxa, për një udhëtim në Roterdam, Hollandë. Gjithashtu, nga të njëjtat rezulton se i njëjti shtetasi ka porositur një dhomë (Double-suitë ekzekutive) në Hotel Marriott për qëndrim të bashkëshorteve Veliaj-Xoxa. Konkretisht, rezulton se më datë 24.11.2016 **"Alb-atlas"** Travel Agency, i dërgon email shtetasit Fatmir Bektashi pas porosisë së këtij të fundit, ku e njofton

---

[45] Në lidhje me subjektin "AGI KONS" u këqyr ekstrakti historik i regjistrimit tregtar për të dhënat e këtij subjekti në faqen e internetit të "Qendrës Kombëtare të Biznesit" nga ku u morën këto të dhëna: ***Numri Unik i Identifikimit të Biznesit*** – *K21622001M.* ***Data e Regjistrimit*** *– 24/02/2002.* ***Data e Themelimit*** *– 04/02/2002.* **Zyra Qëndrore e shoqërisë në Shqipëri** – Tiranë, Parkë Kodra e Diellit, Kompleks Hotelerie me struktura 2.3 dhe 5 kate, me dy kate nën tok, Nr. Pasurie 51/256. **Objekti i aktivitetit** - Veprimtari ne fushen e ndertimit te pergjithshem. **Ortakët – Gentjan Sula, me vlerë kapitali 1.501.000.000,00 me nr të pjesëve 1,00 dhe përqindje 100,00**

se totali i çmimit të biletave të udhëtimit për shtetasit Erion Veliaj dhe Ajola Xoxa është **2688 Euro.** Itinerari i udhëtimit ka qenë: Vajtja (biznes) Tiranë – Romë, Romë – Amsterdam dhe Kthimi (biznes) Amsterdam – Vienë, Vienë – Tiranë. Akomodimi i shtetasve Erion Veliaj dhe Ajola Xoxa është prenotuar pranë Hotel "Marriot" me adresë: Ëeena 686 Rotterdam (Nl), 3012 Cn Netherlands. Prenotimi është bërë për datën 03.12.2016 – 04.12.2016 (1 natë qëndrimi), në dhomën tip 1 Double – Suite Executive. Nga emaili i dërguar me datë 25.11.2016 nga "Alb-atlas" Travel Agency, në adresën elektronike të shtetasit Fatmir Bektashi, **rezulton se çmimi për 1 Double – Suite Executive është 677 Euro.** Gjithashtu, me procesverbalin për këqyrjen e të dhënave nga sistemi TIMS, datë 09.01.2025, rezulton se: i) Më datë 03.12.2016, ora 05:31 në Pikën Kufitare Rinas, shtetasi **Erion Veliaj** ka dalë nga Shqipëria me linjën e udhëtimit ALITALIA - AZ 510/507 ROME; ii) Më datë 03.12.2016, ora 04:56 në Pikën Kufitare Rinas, shtetasi **Fatmir Bektashi** ka dalë nga Shqipëria me linjën e udhëtimit ALITALIA - AZ 510/507 ROME; iii) Më datë 05.12.2016, ora 01:06 në Pikën Kufitare Rinas, shtetasi **Erion Veliaj** ka hyrë në Shqipëri me linjën e udhëtimit AUSTRIAN AIRLINES - OS 849/850 VIENA; iv) Më datë 05.12.2016, ora 01:08 në Pikën Kufitare Rinas, shtetasi **Fatmir Bektashi** ka hyrë në Shqipëri me linjën e udhëtimit AUSTRIAN AIRLINES - OS 849/850 VIENA. Ndërkohë nga analizimi i deklarimeve në sistemet tatimore C@TS dhe Portali Qendror për Kontroll dhe Menaxhim (fiskalizimi) rezulton se nga analizmi i librave të shitjes për periudhën 2022 – 2024, konstatohet se OJF Balkan Youth Link Albania (BYL-A) ka deklaruar në shitje një vlerë totale prej **31,521,286 lekë.** Kryesisht këto faturime përbëhen nga sponsorizime për evente të ndryshme që kjo OJF ka organizuar. Konkretisht: ***KONTAKT SHPK (ID: J92108006V): 6,507,456*** lekë. Kjo organizatë është kontrolluar nga Ajola Xoxa, si dhe vetëm kjo e fundit vendoste kush do financonte dhe kurrë. Ajo që vihet re është iniciativa e vetë kompanive që marrin leje ndërtimi pranë Bashkisë Tiranë që komunikojnë me financieren e shtetases Ajola Xoxa për të lidhur marrëveshjen e financimit.

Sa më sipër, konstatohet se si prerja e biletave dhe pagesa për dhomën e hotelit përmendur më lart, ashtu edhe sponsorizimi për "BYL-A" OJF, e kontrolluar nga shtetësja Ajola Xoxa, ka ndodhur gjatë periudhës që i paraprin lëshimit të lejes së ndërtimit por edhe gjatë procesit së çertifikimit për përdorim të objektit. Gjithashtu, nga deklarimet e shtetasit Fatmir Bektashi rezulton se kompania Kontakt i kishte kërkuar Erion Veliajt që të ishte në takim me qëllim që të njihej me projektin dhe ta miratonte atë. Për këtë arsye, tregon se ka paguar edhe biletat si dhe hotelin. Pra, rasti në fjalë lidhet për interesin që kishte Fatmir Bektashi për realizimin e projektit Mangalem 21, i cili duhej miratuar nga kryetari i Bashkisë Tiranë z. Erion Veliaj. Ky i fundit nuk e ka deklaruar këtë fakt në ILDKPKI. Në një rast të ngjashëm me vendimin Nr. 69, datë 29.01.2019 të Gjykatës së Shkallës së Parë për Krimet e Rënda Tiranë, lënë në fuqi me vendimin Nr. 19, datë 21.09.2020 të Gjykatës së Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar janë dënuar të pandehurit për figurën e veprat penale korrupsion aktiv dhe pasiv.

3) Nga analiza e provave dhe fakteve të cituara në paragrafët 154, 154.1, 154.2, 154.3, 154.4, 154.5, 154.6 154.7, 154.8 dhe 154.9 të këtij vendimi të para në unitet me njëra tjetrën, rezulton se **subjekti Fusha shpk** është faturuar në vlerën **2,672,568 lekë** nga dy subjektet Greta Domi P.F dhe Ines Dani P.F, të cilët vetëm tre ditë më pas kanë deklaruar nga një

faturë në blerje përkatësisht në vlerat 593,904 lekë dhe 742,380 lekë ose ne total 1,336,284, ekzaktësisht sa gjysma e vlerës të faturar për Fusha shpk. Thënë ndryshe, gjysmën e shumës së marrë nga Fusha shpk këto shtetase, në cilësinë e personave fizikë, e kanë kaluar në llogaritë e Qendrës Harabel. Dy subjektet Greta Domi P.F dhe Ines Dani P.F është provuar që janë punonjëse të shtetases Ajola Xoxa dhe kontrollohen prej saj. Nga aktet e administruara dhe të këqyrura në Bashkinë Tiranë, pjesë e fashikullit penal, rezulton e provuar se "Fusha" shpk, ndër të tjera ka përfituar nga Bashkia Tiranë edhe Lejen e Ndërtimit Nr. Prot. I-8789/8, dt. 23.11.2020, "Banesë individuale I kat, me mur rrethues" ndodhur në Yrshek, Tiranë, në pronë të z. Glentjan Karaj, me zhvillues z. Glentjan Karaj dhe subjekt ndërtues shoqëria "FUSHA" sh.p.k.", viti 2020. Afati i lejes 27 muaj. Gjithashtu, me shkresën Nr. 204 Prot., datë 09.11.2020 shoqëria "Fusha" shpk ka paraqitur pranë Bashkisë Tiranë kërkesën me objekt: *"Likujdimi garancie punimesh"*, që rrjedhinin nga zbatimi i punimeve në objektin "Rikualifikimi Urban i Sheshit Skënderbej, Faza e II-të", në vlerën 58, 732, 731 lekë. Po ashtu, shoqëria "Fusha" shpk ka marrë pjesë në procedurën e prokurimit të shpallur me Urdhërin e Prokurimit Nr. 41302 Prot., datë 23.11.2020 për objektin *"Shërbimi i Pastrimit të Tiranës" Loti IV "Shërbimi i Pastrimit të Zonës Tirana IV"*, nënshkruar nga kryetari i bashkisë Tiranë Erion Veliaj. Pra, vetëm 3 ditë pas përfitimit të lejes në fjalë, si dhe gjatë kohës që ishte në pritje të shqyrtimit të kërkesës nga Bashkia Tiranë e bërë nga shoqëria nga "Fusha" shpk më datë 09.11.2020 me objekt: *"Likujdimi garancie punimesh"*, që rrjedhinin nga zbatimi i punimeve në objektin "Rikualifikimi Urban i Sheshit Skënderbej, Faza e II-të", në vlerën 58, 732, 731 lekë, si dhe tre ditë pasi është nxjerrë Udhëri i Prokurimit Nr. 41302 Prot., datë 23.11.2020 (ku doli fitues më pas), subjekti tregtar "Fusha" shpk është faturuar me një shumë prej 2,672,568 lekë nga dy personat fizikë, të kontrolluar plotësisht nga shtetësja Ajola Xoxa, të cilët nga ana e tyre, vetëm 4 ditë më pas, faturohen nga "Harabel" duke i kaluar gjysmën e të hollave kësaj organizate. Në lidhje me këtë kalim, përveç dyshimeve të krijuara për dhënie përfitimi të parregullt, komunikimet e shtetases Adela Kondakçiu dhe Ajola Xoxa ekspozojnë qartë gjithashtu edhe mekanizmin e përdorur për të "injektuar" të hollat në llogaritë bankare të një OJF-je që kontrollohet nga kjo e fundit. Në këtë skemë të mirëorganizuar përveçse ka dyshime të arsyeshme se shoqëria "Fusha" shpk ka dhënë përfitim të parregullt njëkohësisht ka ndihmuar që ky "përfitim parregullt" të duket si një marrëdhënie juridiko – civile edhe pse ka qenë tërësisht fiktive dhe e diktuar nga shtetësja Ajola Xoxa si shuma ashtu dhe mënyra se si do të kalohet kjo shumë nga subjektet me interesa pranë Bashkisë Tiranë. Kjo skemë duket se aplikohet pothuajse në të gjitha rastet.

Gjykata çmon se i gjithë mekanizmi që përmendet më lart, i cili nis që nga subjekti tregtar "Fusha" shpk, i lidhur ngushtë me interesa financiarë me Bashkinë Tiranë, vijon me kalimin e një sasie të hollash, rreth 2.600.000 lekë, të ndara mes personave fizikë Ines Dani dhe Greta Domi, në llogaritë e tyre bankare, dhe kalimi nga këto të fundit tek destinacioni fundor që rezulton të jetë shtetësja Ajola Xoxa, sipas udhëzimeve të qarta të lëshuara nga kjo e fundit, si nëpërmjet tërheqjeve në CASH ashtu edhe nëpërmjet transfertave në OJF të e kontrolluara nga vetë kjo shtetase, dëshmon qartë dhe plotësisht të gjithë rrugën e ndjekur për pastrimin dhe injektimin në sistemin bankar të përfitimeve të paligjshme të siguruara nga bashkëshortja e kryetarit të bashkisë Tiranë, Erion Veliaj, shtetësja Ajola Xoxa, për shkak të veprimeve dhe mosveprimeve që lidhen me funksionin zyrtar të bashkëshortit të saj.

SPORTI JETA.AL

4) Nga analiza e provave dhe fakteve të cituara në paragrafët 155, 155.1, 155.2, 155.3, 155.4, 155.5 dhe 155.6 të këtij vendimi të para në unitet me njëra tjetrën, rezulton se **familjarët e shtetases Ajola Xoxa kanë krijuar edhe një qendër tjetër me karakter jofitimprurës. Konkretisht, me aktin e themelimit të Qendrës "Eventus"** me Nr. 3704 Rep., Nr. 1782 Kol., datë 02.11.2021, anëtarët themelues shtetasit Emil Simixhiu, Erald Simixhiu, dhe Linda Kazani (përkatësisht djali i dajës, daja dhe bashkëshortja e dajës së shtetases Ajola Xoxa), kanë vendosur që të themelojnë një qendër joftitimprurëse me emrin "Eventus", përcaktuar kjo edhe në nenin 1 të aktit të themelimit. **Sikurse është provuar gjatë hetimit paraprak kjo shoqëri është nën kontrollin e shtetases Ajola Xoxa.** Konstatohet se financimin më të madh kjo qendër e ka nga Bashkia Tiranë në vlerën 10,580,000 Lekë dhe **nga subjekti Palushi shpk në vlerën 3,237,300 Lekë (faturë e cila dyshohet fiktive bazuar në aktet e këtij procedimi).** Gjithashtu evidentohen edhe financime në vlera më të vogla nga Ministria e Kulturës. E pyetur në datë **12.12.2024** si person që ka dijeni për veprën penale, **shtetësja Adela Kondakçiu,** me profesion ekonomiste, ka shpjeguar shumë detaje që paraqesin mjaft interes për hetimin. Kjo shtetase ndër të tjera ka deklaruar se **njeh përfaqësues të kompanisë Palushi Shpk, i cili ka sponsorizuar me nga 25,000 Euro (*dy herë në total*) qendrën BYL-A dhe qendrën MUZA.** Njëra vlerë është për sponsorizimin për festivalin e Dancit, ndërsa vlera tjetër 25,000 euro do të ishte për eventet e qendrës Eventus. **Deklaruesja ka shpjeguar se *Ajola i ka treguar se si duhen prerë faturat tatimore, vlerën, dhe nga cila organizatë.***

Sa më sipër u arsyetua, Gjykata çmon se edhe në rastin e dhënies së "përfitimit të parregullt" në shumën prej 50.000 Euro prej **shoqërisë "Palushi" shpk** sikurse ishtë "dakortësuar" më parë është ndjekur e njëjta skemë si tek rasti i shoqërisë "Fusha" shpk. Pra, tregohet kujdes që këto shuma mos të kalojnë tek shoqëri që judikisht është ortake Ajola Xoxa por të kalohet tek shoqëri që kontrollohen *de facto nga kjo e fundit.* Ndërkohë që e gjithë skema e kalimit të këtij *"përfitimi të parregullt"* si dhe shuma përkatëse diktohet pikërisht nga shtetësja Ajola Xoxa. Gjithësesi të gjitha këto shuma kalojnë në formën e emërtimit "sponsorizime" në buxhetin e familjes Veliaj-Xoxa në mënyrë indirekte, duke u realizuar transaksionet nëpërmjet shoqërive dhe personave fizik të kontrolluar nga shtetësja Ajola Xoxa ose duke u tërhequr cash nga personat që u kalon shuma dhe pasi tërhiqen prej tyre u jepet cash shtetases Ajola Xoxa. **<u>Janë këto të ardhura të përfituara në mënyrë të paligjshme që kanë bërë që shtetësja Ajola Xoxa dhe të afërmit e saj të shpenzojnë për katër vite shifrën prej 86,721,175 lekë vetëm *për rroba, produkte kozmetike, burekug, vathë, etj.*</u>** Këto shpenzime nuk janë deklaruar kurrë në ILDKPKI, pasi ekziston dyshimi i arsyeshëm i bazuar në prova se vijnë nga burime të paligjshme.

5) Nga analiza e provave dhe fakteve të cituara në paragrafët 156, 156.1, 156.2, 156.3, 156.4 dhe 156.5 të këtij vendimi të para në unitet me njëra tjetrën, rezulton se, gjatë periudhës Dhjetor 2023 dhe Janar 2024, pronari i saj dhe administratori i shoqërisë Sokol Kryeziu, provohet të ketë blerë disa piktura nga shoqëria "NAN Gallery" shpk, me NIPT M31920013O, me administratore shtetasen Daniela Vuksani, shoqëri kjo e kontrolluar faktikisht nga shtetësja Ajola Xoxa dhe zotëruar ligjërisht nga "Harabel" OJF. Vlera totale e pikturave të blera është në shumën <u>5, 037, 064 lekë</u>. Shitja e tyre evidentohet e deklaruar në librat e shitjes të shoqërisë Nan Gallery Shpk, në datën 28.12.2023 në vlerën <u>2,176,230 lekë</u>

me tvsh, me numër fature 10/2023, me adresë "Spanjë", me blerës Sokol Kryeziu me numër personal I70806002Q, dhe faturën tjetër të datës 08.01.2024, në vlerën 2.860.834 lekë me tvsh, me numër 1/2024, me adresë "Spanjë", me blerës Sokol Kryeziu me numër personal I70806002Q. Gjithashtu, nga aktet e administruara rezulton se ka komunikime midis shtetaseve **Adela Kondakçiu dhe Ajola Xoxa** lidhur me pagesat e kompanieve që zotërohen nga kjo e fundit, ku bën pjesë dhe **"Nan Gallery" e cila zotërohet në masën 100% nga Qendra "Harabel" dhe mbi të cilën kjo shtetase ka kontroll faktik.** Mjafton këtu të përmenden komunikimet e ndodhura në faqet 881-882, ku i kërkohet financieres Adela Kondakçiu t'i dërgojë numrin IBAN të "Nan Gallery" tek Banka Intesa Sanpaolo. **Gjithashtu, pyetjes së financieres se nga do paguhet piktori E.B., shtetësja Ajola Xoxa i përgjigjet nga "Nan".** Përveç kësaj, shtetësja Adela Kondakçiu, sipas sa përmendet në faqen 882, i dërgon shtetases Ajola Xoxa pagesat e kryera nga "Nan" shpk. Shitjet e realizuara nga kjo shpk, sipas këtyre komunikimeve, rezultojnë të jenë në masën 21.000 euro. Por këto blerje tek "Nan Gallery" shpk janë kryer nga shtetasi Sokol Kryeziu, i cili rezulton të jetë aksioner i vetëm i shoqërisë "Gerard-A". Pra, ky shtetas, si individ, ka blerë nga "Nan" shpk disa piktura, të cilat sipas deklarimeve tatimore kapin shifrën e 5.037.064 lekë (të ndara në dy fatura, rreth 21.000 Euro dhe rreth 27.000 euro) shifër nga e cila të paktën deri në këtë moment rezulton të jetë paguar vlera prej 21.000 euro, referuar në këtë rast deklarimeve të shtetases Adela Kondakçiu. Sipas të njëjtave deklarime, vlera e cila i është likujduar shtetasit Idlir Koka, piktor, për të gjithë punët e prodhuara prej tij, nga "Nan" shpk ka qenë 13.000 Euro. Ndërkohë, vlera e shitjes së tyre tek shtetasi Sokol Kryeziu është rreth 50.000 euro. **Pra, edhe në këtë rast, një tjetër përfitues i madh i fondeve publike nga Bashkia Tiranë, jep shuma monetare në favor të kompanive që kontrollohen efektivisht nga shtetësja Ajola Xoxa, duke zgjedhur si mekanizëm për dhënien e këtyre të hollave blerjen e të gjithë koleksionit të pikturave të shtetasit Idlir Koka, dhe me një diferencë prej 30.000 Euro nga çmimi i blerjes së tyre prej shoqërisë "Nan Gallery" shpk. Gjykata çmon se krijohen dyshime të arsyeshme të bazuara në prova se për shkak të përfitimit të fondeve publike nga Bashkia Tiranë prej shtetasit Sokol Kryeziu, sipas burimeve të hapura si Open Procurement, ky i fundit ka kaluar tek "Nan Gallery" shpk një shumë prej të paktën 21.000 euro (aq sa rezulton nga këto komunikime).**

**6)** Në lidhje me përfitimet e parregullta të siguruara nëpërmjet OJF-ve, të cilave u është atribuuar vepra penale në regjistrin përkatës në Prokurorinë e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, por të cilat nuk janë objekt i kësaj kërkese, Gjykata e çmon të drejtë kërkesën e Prokurorisë së Posaçme se episodet konkrete për të cilat deri në këtë moment ka dyshime të arsyeshme të bazuara në prova, lidhen me: **1)** Marrjen e përfitimit të parregullt (në formë sponsorizimi për evente artistike) nëpërmjet **OJF Qendra "Eventus"**, me drejtor ekzekutiv shtetasen Linda Kazani (bashkëshortja e dajës së shtetases Ajola Xoxa), për të kryer veprime të cilat lidhen me funksionin publik. Këto përfitime të parregullta të dhëna me firmën e kryetarit të Bashkisë Tiranë, shtetasit nën hetim Erion Veliaj, kanë kaluar me transferta bankare nga kjo OJF në shoqëritë me përgjegjësi të kufizuara të kontrolluara *de facto* dhe *de jure* nga shtetësja Ajola Xoxa, **dhe rrjedhimisht me përfitues fundorë bashkëshortët Veliaj-Xoxa; 2)** Marrjen e përfitimit të parregullt (në formë sponsorizimi për evente artistike) nëpërmjet **OJF Qendra "Muza"**, me drejtor ekzekutiv shtetasen Alketa

Spartaku (kushërirë e shtetases Ajola Xoxa), pronarë përfitues Erald Simixhiu (daja i shtetases Ajola Xoxa), Arben Spartaku (kushëri i shtetases Ajola Xoxa) dhe Rea Spartaku (kushërirë e shtetases Ajola Xoxa), për të kryer veprime të cilat lidhen me funksionin publik. Këto përfitime të parregullta të dhëna me firmën e kryetarit të Bashkisë Tiranë, shtetasit nën hetim Erion Veliaj, kanë kaluar me transferta bankare nga kjo OJF në shoqëritë me përgjegjësi të kufizuar të kontrolluara *de facto* dhe *de jure* nga shtetësja Ajola Xoxa, **dhe rrjedhimisht me përfitues fundorë bashkëshortët Veliaj-Xoxa; 3)** Marrjen e përfitimit të parregullt (në formë sponsorizimi për evente artistike) nëpërmjet **OJF Qendra "Frobolous",** me drejtor ekzekutiv shtetasen Frosina Bollo, për të kryer veprime të cilat lidhen me funksionin publik. Këto përfitime të parregullta të dhëna me firmën e kryetarit të Bashkisë Tiranë, shtetasit nën hetim Erion Veliaj, kanë kaluar me transferta bankare nga kjo OJF në shoqëritë me përgjegjësi të kufizuar si edhe persona fizikë të kontrolluar *de facto* nga shtetësja Ajola Xoxa, dhe **rrjedhimisht me përfitues fundorë bashkëshortët Veliaj-Xoxa; iv)** Marrjen e përfitimit të parregullt (në formë sponsorizimi për evente artistike) nëpërmjet **OJF "BYL-A",** me drejtor ekzekutiv shtetasen Reada Lemnusha, për të kryer veprime të cilat lidhen me funksionin publik. Këto përfitime të parregullta të dhëna me firmën e kryetarit të Bashkisë Tiranë, shtetasit nën hetim Erion Veliaj, kanë kaluar me transferta bankare nga kjo OJF në shoqëritë me përgjegjësi të kufizuar si edhe persona fizikë të kontrolluar *de facto* dhe *de jure* nga shtetësja Ajola Xoxa, dhe **rrjedhimisht me përfitues fundorë bashkëshortët Veliaj-Xoxa.**

Gjykata çmon se faktet dhe provat që i janë paraqitur gjykatës nga Prokuroria e Posaçme, krijojnë dyshimin e arsyeshëm se në rastin konkret bëhet fjalë për një sistem të organizuar korrupsioni dhe shpërdorimi të fondeve publike, të udhëhequr nga kryetari i bashkisë Tiranë dhe bashkëshortja e këtij të fundit. Në qendër të kësaj skeme korrupsioni, rezulton të jetë kryetari i Bashkisë Tiranë, nënshkrimi i të cilit ka qenë determinant për shpërndarjen e fondeve publike, prej të cilave ai dhe familjarët e ngushtë të tij kanë përfituar drejtpërsëdrejti në mënyrë të parregullt. **Gjykata e çmon të drejtë kërkesën e Prokurorisë së Posaçme nga hetimet paraprake të kryera deri në këtë fazë, përveç pasurive të paluajtshme të përfituara nga shtetasit nën hetim Erion Veliaj dhe Ajola Xoxa (*nën regjimin pasuror të bashkësisë ligjore*), këta të fundit përmes shoqërive "Partners Law" shpk, "Arts Lab" shpk, "Ava Studio" shpk, "Nan Gallery" shpk, "Byl-A" OJF, "Harabel" OJF, "Eventus" OJF dhe "Muza" OJF, për të cilat tërësisht nga bashkëshortja e kryetarit të Bashkisë Tiranë, kanë gjeneruar të ardhura të cilat kapin shifrën e rreth <u>110.000.000 lekë.</u>**

**162.7. Nga provat e administruara ekziston dyshimi i arsyeshëm i bazuar në prova se shtetasi Erion Veliaj interesohet për ecurinë e aktivitetit të OJF-ve të kontrolluara nga bashkëshortja e tij,** specifikisht në rastin konkret të "Harabel". Kështu, ~~nga procesverbali i këqyrjes datë 21.01.2025, i përpiluar nga Hetuesi i Byrosë Kombëtare të~~ Hetimit (BKH), rezulton se në rrjetin social "Instagram", tek adresa "Erion Veliaj", evidentohet një postim i bërë nga ky i fundit më datë 20 Shtator 2023. Ky postim lidhet me eventin që do të organizohet më datën 23.09.2023-22.10.2023, "International Contemporary Dance Festival". **Në këtë postim, publikohet se "<u>Harabel Contemporary</u>", D18 Paris, <u>BYL-A</u> në bashkëpunim me Teatrin Kombëtar të Operës dhe Baletit (por edhe me mbështetjen e Bashkisë Tiranë) organizojnë edicionin e dytë të festivalit nën drejtimin**

**artistik të koreografit të mirënjohur me origjinë shqitpare, Angelin Preljocaj". Në vijim të tekstit publikohet edhe kalendari i shfaqjeve. Postimi përmban në total 8 fotografi/reklama/postera, njëra pas tjetrës.**

**162.7.1.** Nga procesverbali i këqyrjes së pjesshme të datës **22.01.2025** në lidhje me të dhënat e përftuara nga telefoni celular i shtetasit Driant Zeneli, administruar në fashikullin penal, ka rezultuar në përmbledhje se, **shtetasi Erion Veliaj interesohet për ecurinë e aktivitetit të OJF-ve të kontrolluara nga bashkëshortja e tij.** Konkretisht, nga këqyrja rezulton se më datë 02.11.2021 shtetasit Driant Zeneli dhe Ajola Xoxa komunikojnë rreth një shtetasi të huaj, të quajtur Jesus Hernandez, me profesion arkitekt. Nga biseda e zhvilluar kuptohet që shtetasi Erion Veliaj jo vetëm ka dijeni rreth aktivitetit të "Harabel" por edhe e promovon atë. Nga biseda konstatohet se shtetasi Jesus Hernandez ka patur një takim me kryetarin e Bashkisë Tiranë, Erion Veliaj, dhe ky i fundit i ka folur për "Harabel". Konkretisht, më datë 02.11.2021 është zhvilluar biseda sa vijon: *Ora 6:55 Pm,* ***Driant Zeneli:*** *"Jesus po ben dy projekte nje ne Shkoder dhe tjetri ne Gjirokaster. Ai kerkon sponsor" "Thjesht te parapri ate qe me tha". Ora 6:57 Pm,* ***Ajola Xoxa:*** *"Jesus ka ardhur sepse ka 1 projekt ne Gjirokaster dhe disa ne Tirane". Ora 6:57 Pm,* ***Ajola Xoxa: "Sot kishte takim ne Bashki me Erin".*** *Ora 6:57 Pm,* ***Ajola Xoxa: "Eri i kishte folur per Harabel".*** *Ora 6:57 Pm,* ***Ajola Xoxa: "Ai i kishte thene se eshte takuar me ty, por jo me mua".*** *Ora 6:57 Pm,* ***Ajola Xoxa: "Dhe do të me takoje bashke me gruan, se punojne te dy".*** *Ora 6:58 Pm, Ajola Xoxa: "Sa per kortezi". Ora 7:02 Pm,* ***Driant Zeneli: "Po po ai me shkoi para disa javesh*** *po nuk me tha per Harabel. Donte te me takonte nese mund te marre pjese une ose Anri Sala ose Adriani tek ekspozita qe duan te bejn ne muzeumin e ri te Gjirokastres ne Kala". Ora 7:02 Pm, Driant Zeneli:* ***Dërgohet dokumenti*** *077428e3-a266-453a-a662-dd77bf19daae.jpg.* ***I cili është screenshot i bisedës me kontaktin Jesus Hernandez ku bisedojnë për një takim në lidhje me disa projekte kulturore në Shqipëri.*** *Ora 7:05 Pm, Driant Zeneli: "Sa per korrektesi ky eshte mesazhi qe me shkroi para disa ditesh". (fq 7213-7216).* Në lidhje me shtetasin Jesus Hernandez provohet se, pikërisht në datën që shtetësja Ajola Xoxa i referon bashkëbiseduesit se është takuar me bashkëshortin e saj Erion Veliaj, ky shtetas ka qenë në territorin shqiptar. Konkretisht, referuar procesverbalit të këqyrjes së sistemit *Tims*, në rubrikën "Hyrje" konstatohet se shtetasi Jesus Hernandez ka hyrë në Shqipëri me Nr. dokumenti XDD799845-ES. Data e hyrjes 01.11.2021 14:51. Linja Austrian Airlines-OS 847/848 Viena. Kalimi kufitar: Komisariati i Policisë Rinas. Ndërsa, në rubrikën "Daljet" konstatohet se ky shtetas ka dalë nga Shqipëria me Nr. dokumenti XDD799845-ES. Data e daljes 03.11.2021 13:38. Linja Air Serbia-Beograd 212-213. Kalimi kufitar: Komisariati i Policisë Rinas.

**162.7.2.** Një provë tjetër që shtetasi Erion Veliaj është aktiv përsa i përket ecurisë dhe promovimit të OJF-së në fjalë, rezulton të jetë përftuar nga komunikimet e datës 21.04.2022, mes shtetases Ajola Xoxa dhe Driant Zeneli. Nga këto komunikime konstatohet se në Itali, supozohet Venezia (Lido), ka ndodhur një takim ku i pranishëm ka qenë edhe kryetari i bashkisë Tiranë, bashkëshortja e tij dhe disa shtetas të tjerë të huaj përfshirë këtu një shtetas italian të quajtur Casamonti. Ky i fundit, sipas shtetases Ajola Xoxa, ka folur në lidhje me "Harabel" dhe bashkëpunime të mundshme të kësaj organizate. Gjithashtu, nga të njëjtat komunikime konstatohet se shtetasit Erion Veliaj dhe Driant Zeneli kanë një marrëdhënie e cila lidhet me aktivitetin e këtij të fundit tek "Harabel". **Shtetasi Erion Veliaj evidentohet**

qartë se jo vetëm që ka dijeni për aktivitetet e kryera nga bashkëshortja e tij, në fushën e organizimeve me natyrë artistike, por edhe ndihmon në forma konkrete kur i kërkohet nga kjo e fundit. Nga komunikimet rezulton një rast, ku shtetësja Ajola Xoxa i ka kërkuar ndihmë për vënien në dispozicion të një hapësire publike në lidhje me një aktivitet që do të zhvillonte shtetasi Kushtrim Juniku. Konkretisht: *Në datë 29.11.2018 Ora 02:55 PM,* ***Driant Zeneli:*** *"__Shoge arrite me fol me Erin per punen e Kushtrimit__?"* **(Fq 2000). Në datë 03.12.2018.** *Ora 08:19 PM,* ***Driant Zeneli:*** *"Shoge me.mori Kushtrimi me tel tashi. Ke noj info kur dhe tek kush mund te shkojm Kushtrimi te prezantojn projketin? Se ditet po i afrohen ai ka ndermend per 29/30/31". Ora 08:56 PM, Ajola Xoxa:* ***"__Eri dje ka ardhur sepse ka qene jashte__", "Dhe kemi qene vetem me vizita dje", "__Ja sot sa ta takoj e pyes__" (Fq 2007). Në datë 05.12.2018.*** *Ora 12:34 PM,* ***Driant Zeneli:*** *"Ciao Shoqe more gje vesh ku te shkoi Kushtrimi? "Ora 01:25 PM,* ***Ajola Xoxa: "__Po pres Erin te me thote__",*** *"Se parimisht kane edhe disa aktivitete te tjera ne ato lokacione". Ora 01:46 PM,* ***Driant Zeneli:*** *"Ah ok please sa po te kesh njoftim me.thuaj". Ora 02:01 PM,* ***Ajola Xoxa: "__Ok tha Eri do zgjidhim gjithcka tjeter__", "Me jep nje kontakt", "Qe ta pasoj", "__Se i pelqen shume shume ideja se ia dergova ta shihte tamam__".*** *Ora 02:01 PM,* ***Driant Zeneli:*** *Dërgohet kontakti i shtetasit Kushtrim Juniku me numër telefoni Phone: Mobile +355 67 276 9831* **(Fq 2008-2010). Në lidhje me shtetasin Kushtrim Juniku, nga këto akte konstatohet se ka përfituar fonde nga Agjencia e Mbrojtjes së Konsumatorit pranë Bashkisë Tiranë, nëpërmjet shoqërisë së tij "KUJU Studio" me NIPT L71310015L, më datë 22.12.2018, periudhë kjo e cila korrespondon me bisedën e treguar më lart. Vlera e përfituar është 4, 296, 000 lekë, sipas faturës nr. 27 datë 22.12.2018.**

**162.7.3.** Gjithashtu, e pyetur në datë **13.12.2024** si person që ka dijeni për veprën penale, **shtetësja Ina Goxhaj**, ish-drejtoreshë ekzekutive e qendrës BYL-A, e cila ndër të tjera ka deklaruar se në lidhje me furnitorët e BYL-A, apo sponsorizimet që janë marrë nga Kontakt Shpk, Bashkia e Tiranës, Shoqata Konkresi Rinor Kombëtar, QTU, Ministria e Kulturës, Palushi, Gogel, Jedas, Banka Credins, Albtelecom, *__ajo shpjegon se nuk ka dijeni pasi nuk ka qenë në brendësi të gjërave, por kishte emrin dhe nënshkruante kur i kërkohej.__* **E pyetur konkretisht për *__fondet e marra pranë Bashkisë Tiranë apo institucioneve të tjera, tregon se ato siguroheshin prej Ajola Xoxës, për shkak të ndikimit apo njohjeve që kishte.__*** Nga përmbajtja e këtij deklarimi rezulton se është Ajola Xoxa që siguron fondet tek Bashkia Tiranë nëpërmjet ndikimit të saj, ku kryetar i saj është bashkëshorti Erion Veliaj.

**162.7.4.** Gjithashtu, me shumë interes shfaqet komunikimi që ndodhet në faqen 658 midis shtetases Ina Goxhaj dhe Adela Kondakçiu me Whatsapp. Konkretisht, Ina Goxhaj shprehet në faqen 657-658 në lidhje me një person që ka takuar në Bashkinë Tiranë: ***Dje e di si me tha ai cuni. Te Bashkisë. THA KETO SI MERRNI JU. THA EUU KUSH I MERR KETO LEKET. JU VINI DHE FIRMOSNI KAQ.*** Adela e pyet në faqen 658: ***Ju te organizates apo ju punonjesit e kishte ai?*** Ina Goxhaj i përgjigjet: ***OJF.*** *Faqe 659.* Ina Goxhaj vijon: ***JANE TE MEDHENJ ATA QE I MARRIN.*** *Faqe 658.* Adela Kondakçiu i përgjigjet: ***__AMAN SE JANE NGATERRUAR ME SHUME GJERA__***. *Faqe 659.* Ina Goxhaj vijon në faqen 670 duke i referuar çfarë kishte thënë personi që kishte takuar në bashki: ***__DMTH I MERR AJO PER JU.__*** **Nga përmbajtja e këtij rezulton se edhe punonjësit e Bashkisë Tiranë e kanë kuptuar se kush qëndron pas OJF që financohen nga kjo bashki.** Gjykata çmon se është e pamundur që mos të ketë dijeni bashkëshorti i shtetases

Ajola Xoxa se kush janë OJF-të që kontrollohen nga kjo e fundit, të cilat financohen nga Bashkia Tiranë, ndërkohë që kanë dijeni dhe punonjësit e thjesht që merren me projekte në Bashkinë Tiranë.

**163. Në lidhje me anën subjektive të figurës së veprës penale *"Korrupsioni pasiv i funksionarëve të lartë shtetërorë ose i të zgjedhurve vendorë"*.** Gjykata vlerëson se, figura e veprës penale të *"Korrupsioni pasiv i funksionarëve të lartë shtetërorë ose i të zgjedhurve vendorë"*, parashikuar nga neni 260 i Kodit Penal kërkon si formë faji dashjen direkte. Gjykata çmon të theksoj se për konfigurimin e veprës penale të korrupsionit pasiv të personave që ushtrojnë detyra publike, mund të merret apo pranohet përfitim, nëse funksionari publik është i ndërgjegjshëm (ka dijeni) që subjekti tjetër, jep ose ofron një përfitim të parregullt. Parregullsi e përfitimit do të thotë që ai nuk është ligjshëm dhe i detyrueshëm, sipas normave të së drejtës dhe se funksionari nuk ka as të drejtën, as tagrin, as detyrimin për ta marrë atë. Prandaj, mund të merret dhënia e një përfitimi material apo pranimi i një premtimi të parregullt, në mënyrë të shprehur, të heshtur, në mënyrë të drejtpërdrejtë apo edhe të tërthortë, por gjithnjë nëse ekziston dijenia që marrja apo pranimi është në korrelacion me dhënien apo premtimin e një të treti. Një premtim i thjeshtë për përfitime në të ardhmen, pa iu drejtuar konkretisht funksionarit dhe pa u pranuar nga ana e tij, duke u ndërgjegjësuar dhe pasur dijeninë rreth saj nuk do të mjaftonte për konfigurimin e kësaj vepre penale. Prandaj premtimi duhet të jepet në mënyrë të atillë që jetë i konkretizuar dhe të lejojë ndërgjegjësimin dhe njohjen e tij nga ana e funksionarit në mënyrë që të mundësojë mbajtjen e tij.[46] Gjykata vlerëson se tek dispozita e nenit 260 të Kodit Penal, qëllimi, pra kërkimi ose marrja e çfarëdo përfitimi të parregullt ose pranimi i një oferte të parregullt është element i domosdoshëm i figurës së kësaj vepre penale.[47] Interpretimi i një elementi të ndërgjegjes së individit që kryen në një vepër penale është sa e vështirë ashtu edhe e rëndësishme për përcaktimin e fajësisë nëpërmjet kualifikimit ligjor. Natyrisht ky perceptim për gjykatën nuk duhet bërë mbi baza subjektive, por në bazë të "leximit" të veprimeve konkrete dhe të vlerësimit në harmoni të të gjitha provave dhe të konkluzionit që del prej tyre. Pra, Gjykata vlerëson se, ana subjektive e figurës së veprës penale zbulohet dhe qartësohet nëpërmjet anës objektive, sepse proceset e brendshme psikike dhe psikologjike jo vetëm që ngacmohen nga faktorë të jashtëm, por edhe materializohen në veprimtarin kriminale gjatë dhe nëpërmjet procesit të zhvillimit të anës objektive. Kështu, në plotësim të këtij elementi gjykata çmon se për personat nën hetim Ajola Xoxa dhe Erion Veliaj ka dyshime të arsyeshme të bazuara në prova se kanë vepruar me dashje të drejtëpërdrejtë në rastin konkret, pasi kanë parashikuar karakterin e kundraligjshëm të veprimeve të tij dhe me ndërgjegje kanë vepruar, kundrejt marrjes së një përfitimi në mënyrë të parregullt, në mënyrë direkte dhe indirekte.

**164. Në lidhje me subjektin e veprës penale.** Gjykata çmon se, neni 260 i Kodi Penal është një dispozitë, subjekti i të cilës hyn në kategorinë e subjekteve të posaçme. Si rrjedhim, subjekti aktiv i veprës penale, duhet të ketë disa cilësi të veçanta të njohura nga ligji dhe këto cilësi duhet të jenë ndikuese në kryerjen e veprës penale. Konkretisht, funksionari publik duhet të ketë kompetenca vendimmarrëse domethënë subjekti aktiv i veprës penale

[46] Shiko vendimin Nr. 216, datë 16.12.2015 i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë.
[47] Shiko vendimin Nr. 484, datë 19.05.2010 i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë.

duhet të zotërojë autoritet publik, të njohur me ligj për shkak të detyrës së ai kryen. Në rastin konkret, personi nën hetim Erion Veliaj i plotëson kushtet e përgjithshme dhe të posaçme për t'u konsideruar subjekt i kësaj vepre penale, pasi kualifikohet tek *"funksionarët e lartë shtetëror"*. Gjykata çmon se tashmë praktika gjyqësore ka pranuar që nëse një subjekt i përgjithshëm bashkëpunon me një subjekt të posaçëm, të dy do të akuzohet për figurën e veprës penale për të cilën duhet të akuzohet subjekti i posaçëm, duke shtuar rrethanën rënduese të bashkëpunimit. Këtë qëndrim ka mbajtur ***Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë me vendimin Nr. 36, datë 22.01.2021.*** Gjithashtu, të njëjtën praktikë ka mbajtur Gjykata e Posaçme e Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar në raste të ngjashme me **vendimin Nr. 52, datë 12.12.2023**.

**C. Lidhur me figurën e veprës penale të *"Refuzimi për deklarimin, mosdeklarimi, fshehja ose deklarimi i rremë i pasurive të personave të zgjedhur dhe nëpunësve publikë"*.**

**165.** Gjithashtu, në çështjen objekt gjykimi, prokuroria i ka atribuar personit nën hetim **Ajola Xoxa** faktin se ka dyshime të arsyeshme se ka konsumuar elementët e figurës së veprës penale *"Refuzimi për deklarimin, mosdeklarimi, fshehja ose deklarimi i rremë i pasurive të personave të zgjedhur dhe nëpunësve publikë"*, parashikuar nga neni 257/a/2 i Kodit Penal, ku parashikohet shprehimisht se: *"Refuzimi për deklarimin ose mosdeklarimi i pasurisë së personave të zgjedhur ose nëpunësve publikë sipas ligjit, kur më parë janë marrë masa administrative, përbën kundërvajtje penale dhe dënohet me gjobë ose me burgim deri në 6 muaj. Fshehja ose deklarimi i rremë i pasurive të personave të zgjedhur dhe nëpunësve publikë dënohet me gjobë ose me burgim deri në tre vjet."*.

**166. Në lidhje me objektin e veprës penale *"Refuzimi për deklarimin, mosdeklarimi, fshehja ose deklarimi i rremë i pasurive të personave të zgjedhur dhe nëpunësve publikë"*.** Gjykata thekson se **objekti** i kësaj vepre penalë janë marrëdhëniet juridike të vendosura me ligj për të siguruar saktësinë e burimeve të pasurisë së personave te zgjedhur ose nëpunësve publike, të mbrojtura posaçërisht me legjislacionin penal nga veprimet ose mosveprimet e kundraligjshme, të parashikuara në Ligjin Nr. 9049 date 10.04.2003 *"Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publike"*, i ndryshuar, ku një nga qellimet kryesore të këtij ligji sanksionuar në nenin 1 është pikërisht *"përcaktimi i rregullave për deklarimin dhe kontrollin e pasurisë, të legjitimitetit të burimeve të krijimit të saj, detyrimeve financiare për të zgjedhurit, nëpunësit publikë, për familjarët e tyre dhe për personat e lidhur me ta"*, me objekt mbrojtjen e *shtetit të së drejtës* dhe *funksionimin normal të shërbimit publik* për të parandaluar përfitimet e padrejta dhe ushtrimin prej funksionarëve publikë të detyrave në përputhje me ligjin. Në këtë mënyrë, rritet trasparenca e administratës në tërësi por edhe rritet besueshmëria e publikut, ndaj administratës publike, dhe ndaj politikave të ndjekura nga kjo e fundit, në funksion të përmbushjes së detyrës me efektivitet. Në të kundërt, mosbërja e këtyre deklarimeve dhe moslejimi i publikimit të tyre, do të shtonte në mënyrë të konsiderueshme rrezikun e fshehjes apo manipulimit të të dhënave mbi pasurinë e subjektit deklarues, duke zbehur kështu dukshëm zbatimin me efikasitet të këtij ligji në praktikë.

**166.1.** Gjithashtu, për të përcaktuar objektin e kësaj figure të veprës penale, Gjykata mban parasysh jurisprudencën e Gjykatës Kushtetuese, e cila në vendimin Nr. 16, datë 11.11.2004, ndër të tjera ka theksuar: "... *Gjykata Kushtetuese konstaton se qëllimi kryesor për miratimin e ligjit nr. 9049 "Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë"* ***ka qenë marrja e masave sa më efektive për intensifikimin e luftës kundër korrupsionit, rritja e besimit në institucionet shtetërore, transparenca, parandalimi i rasteve të abuzimit me pushtetin shtetëror dhe pasurimit të paligjshëm të personave të zgjedhur ose të atyre që kryejnë funksione të caktuara shtetërore.*** *Këto fenomene të dëmshme pengojnë zhvillimin e vendit, mirëqenien e përgjithshme dhe ndërtimin e një shteti të lirë e demokratik. Prandaj ligjvënësi ka synuar që në këtë betejë të rëndësishme për fatet e demokracisë në Shqipëri t'i sigurohet një pjesëmarrje aktive dhe publikut. Kjo pjesëmarrje garantohet përmes transparencës, njohjes dhe vlerësimit të publikut të gjerë edhe me të dhënat mbi deklarimet e pasurisë së personave të zgjedhur apo zyrtarë. ... Në ushtrimin e detyrave dhe funksioneve zyrtare, personi i zgjedhur apo nëpunësi publik nuk duhet të ndikohet nga interesat e ngushta personale. Në këtë kuptim, përmes veprimeve, mosveprimeve apo vendimmarrjes së tij, ai nuk mund të krijojë përfitime apo avantazhe për vete, për familjarët, të afërmit apo personat e tjerë fizike dhe juridikë, me të cilët ndan interesa ekonomike ose politike. Deklarimi dhe regjistrimi i pasurisë së personave të zgjedhur dhe nëpunësve publikë, verifikimi i tyre si dhe mundësia e bërjes publike të të dhënave që kanë këto deklarime ndikojnë pozitivisht në identifikimin ose shmangien e rasteve të konfliktit të interesave, pra edhe të rasteve korruptive.... Transparenca dhe besimi i publikut në këtë kategori njerëzish luajnë rol të rëndësishëm në shtetin e lirë e demokratik. Pikërisht për këtë arsye, në jurisprudencën e vendeve të ndryshme demokratike është deklaruar se "publikimi i detajeve mbi të ardhurat ose pasurinë personale nuk përbën ndërhyrje në jetën private, veçanërisht nëse personi ushtron funksione publike ose kuazi - publike"*. Pra, qëllimi i Ligjvënësit në sanksionimin e kësaj vepre penale është për të luftuar korrupsionin dhe për të kontrolluar pasuritë e vëna në mënyre abuzive nga funksionarët e zgjedhur dhe nëpunësit publike, të cilët mund të vënë pasuri të cilat rrjedhin nga përfitime të paligjshme duke abuzuar me funksionin e tyre, si dhe për të parandaluar që persona që kanë vënë pasuri në mënyrë të jashtëligjshme, të mund të fillojnë punë në administratën e lartë shtetërore.

**167. Në lidhje me anën objektive (actus rea) të figurës së veprës penale të *"Refuzimi për deklarimin, mosdeklarimi, fshehja ose deklarimi i rremë i pasurive të personave të zgjedhur dhe nëpunësve publikë"*.** Gjykata thekson se ajo është element i domosdoshëm për përgjegjësinë penale, sepse nëse nuk ka veprim ose mosveprim të dënueshëm nuk ka vepër penale. Askush nuk mund të dënohet për mendimet apo idetë e tij. Pra, ana objektive paraqet sulmin kriminal të shqyrtuar nga ana e tij e jashtme, nga pikëpamja e zhvillimit gradual dhe konsekuent të ngjarjeve dhe fenomeneve, të cilat fillojnë të vihen në lëvizje me kryerjen nga subjekti i veprimit ose mosveprimit dhe përfundojnë me ardhjen e një rezultati të caktuar kriminal. Në kuptim të nenit 257/a/ të Kodit Penal, vepra penale *"Refuzimi për deklarimin, mosdeklarimi, fshehja ose deklarimi i rremë i pasurive të personave të zgjedhur dhe nëpunësve publikë"* nga ana objektive kryhet në disa forma, konkretisht sipas paragrafit të parë kjo vepër kryhet nëpërmjet *i)* refuzimit për deklarimin ose *ii)* nëpërmjet mosdeklarimi të pasurisë së personave të zgjedhur ose nëpunësve publikë sipas

ligjit. Që të konisderohet e kryer sipas paragrafit të parë duhet që më parë të jetë marrë nga ILDKPKI masa administrative me gjobë sikurse parashikon ligji i posaçëm. Gjykata çmon se neni 257/a i Kodit Penal është një dispozitë blankete, prandaj për të përcaktuar kuptimin dhe qëllimin e kësaj dispozite penale duhet t'i referohemi Ligjit Nr. 9049, datë 10.04.2003 "Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë", i ndryshuar. Kështu, në nenin 4 të këtij ligji nën titullin **"Afati dhe objekti i deklarimit" parashikohet shprehimisht:** *"Subjektet e përcaktuara në nenin 3 të këtij ligji detyrohen të deklarojnë në Inspektoratin e Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave* ***brenda datës 31 mars të çdo viti, gjendjen deri më 31 dhjetor të vitit paraardhës të interesave private, burimet e krijimit të tyre, si dhe të detyrimeve financiare*** *si më poshtë:..."*, ndërsa në nenin 5/1 të këtij ligji nën titullin **"Deklarimi para fillimit të punës" parashikohet se:** *"1. Të gjitha subjektet, që mbartin detyrimin për deklarim, sipas këtij ligji, duhet të deklarojnë para fillimit të punës: a) të gjitha pasuritë e grumbulluara, detyrimet financiare dhe interesat e tjerë të përcaktuar në nenin 4 të këtij ligji, përfshirë* ***burimet e krijimit të tyre****; b) angazhimet në veprimtari private me qëllim fitimi ose çdo lloj veprimtarie që krijon të ardhura, që ekzistojnë në datën e fillimit të punës, përfshirë çdo lloj të ardhure të krijuar nga këto angazhime ose veprimtari, nga data 1 janar deri në datën e fillimit të punës të vitit të deklarimit.* ***2. Deklarimi para fillimit të punës dorëzohet jo më vonë se 30 ditë nga data e fillimit të detyrës."***

**167.1.** Gjithashtu, në nenin 7 të Ligjit Nr. 9049, datë 10.04.2003 "Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë", i ndryshuar, nën titullin **"Deklarimi periodik vjetor" parashikohet se:** *"1. Në deklarimin periodik jepen vetëm ndryshimet e ndodhura në pasuritë, detyrimet financiare dhe interesat private, të deklaruar më parë, sipas nenit 6 të këtij ligji, ata të lindur gjatë vitit që deklarohet dhe çdo e ardhur e fituar dhe shpenzim i deklarueshëm, i kryer gjatë gjithë vitit për të cilin bëhet deklarimi.* ***2. Deklarimi para fillimit të punës, sipas nenit 6, dhe ai pas largimit nga funksioni, sipas nenit 8 të këtij ligji, janë raste të veçanta të deklarimit periodik.*** *3.* ***Të gjithë zyrtarët dhe personat e tjerë të lidhur, që mbartin detyrim për deklarim,*** *detyrohen të paraqesin deklaratën e tyre, të mbyllur në zarf,* ***deri më 31 mars të çdo viti, pranë autoritetit ose strukturës përgjegjëse të institucionit publik,*** *të parashikuar në shkronjën "b" të pikës 2 të nenit 41 të ligjit nr. 9367, datë 7.4.2005 "Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike",[48] të ndryshuar. ...5.* ***Për qëllim të deklarimit periodik vjetor, sipas pikave të mësipërme të këtij neni, ndër personat e lidhur me zyrtarin, mbartin detyrim për deklarim vetëm bashkëshorti/ja dhe fëmijët madhorë."***, ndërsa në nenin 7/1 të këtij ligji nën titullin **"Deklarimi pas largimit nga funksioni"**

[48] Në nenin 41 të Ligjit Nr. 9367, datë 7.4.2005 "Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike", të ndryshuar, **nën titullin "Autoritetet përgjegjëse për parandalimin, kontrollin dhe zgjidhjen e gjendjeve të konfliktit të interesave" parashikohet shprehimisht se:** *"1. Autoriteti qendror përgjegjës për zbatimin e këtij ligji është Inspektorati i Lartë për Deklarimin dhe Kontrollin e Pasurive dhe Konfliktit të Interesave dhe që përmendet në këtë ligj me shkurtimin "Inspektorati i Lartë". Inspektorati i Lartë vihet në lëvizje me kërkesë të institucioneve publike, palëve të interesuara dhe kryesisht me nismën e tij. 2. Autoritetet ose strukturat përgjegjëse për zbatimin e këtij ligji në institucionet publike janë: a) eprorët e zyrtarëve, sipas hierarkisë, brenda një institucioni publik;* ***b) drejtoritë, njësitë e burimeve njerëzore apo njësi të ngarkuara a të ngritura posaçërisht, sipas nevojës dhe mundësive të çdo institucioni publik; c)*** *institucionet eprore."*

parashikohet se: "*1. Deklarimi pas largimit nga funksioni kryhet vetëm një herë për periudhën nga deklarimi i fundit deri në datën e largimit, me përjashtim të rastit kur zyrtari fillon punë në një detyrë tjetër, që, sipas këtij ligji, vazhdon të mbartë detyrimin për deklarim. 2. Në deklarimin pas largimit nga funksioni jepen vetëm ndryshimet e ndodhura në pasuritë, detyrimet financiare dhe interesat private, për periudhën nga deklarimi i fundit deri në datën e largimit nga funksioni.* ***3. Deklarimi kryhet jo më vonë se 15 ditë nga data e largimit nga funksioni."***.

**167.2.** Më tej në Ligjin Nr. 9049, datë 10.04.2003 "Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë", i ndryshuar, parashikohen sanksionet që vijnë nga mosdeklarimi në afat dhe refuzimi për deklarimin e pasurisë. Kështu në nenin 5 të këtij ligji nën titullin "**Refuzimi për deklarim" parashikohet shprehimisht: "*1. Refuzimi për deklarim sjell humbjen e funksionit dhe ndëshkimin në përputhje me Kodin Penal***. *Inspektori i Përgjithshëm, brenda 30 ditëve, i dërgon organit përgjegjës njoftimin e motivuar për largimin nga puna të personit që refuzon të deklarojë. Organi përgjegjës, brenda 30 ditëve nga marrja e njoftimit, është i detyruar të marrë masa për largimin nga puna të punonjësit që ka refuzuar deklarimin. 2. Kur deklarimi refuzohet nga personat e zgjedhur ose nga ata me imunitet, Inspektori i Përgjithshëm vë në dijeni Kuvendin dhe, kur është rasti, edhe organin epror të personit. Në të gjitha rastet e refuzimit të deklarimit, me kalimin e 30 ditëve nga njoftimi i organit përgjegjës, Inspektori i Përgjithshëm detyrohet t'i bëjë publike rastet e refuzimit të deklarimit.*", ndërsa në nenin 40 të këtij ligji nën titullin "**Kundërvajtjet administrative" parashikohet shprehimisht:** "*1. Çdo shkelje e detyrimeve të përcaktuara në këtë ligj, kur nuk përbën vepër penale, përbën kundërvajtje administrative dhe dënohet me gjobë, sipas kufijve të përcaktuar më poshtë: a)* ***Për mosdeklarim periodik*** *apo me kërkesë,* ***në afat dhe pa shkaqe të arsyeshme,*** *zyrtari ose personi i lidhur me të, që mbart detyrimin për deklarim, dënohet me gjobë nga 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë deri në 100 000 (njëqind mijë) lekë;...*".

**167.3.** Nga përmbajtja e dispozitave të mësipërme rezulton se figura e veprës penale "*Refuzimi për deklarimin, mosdeklarimi, fshehja ose deklarimi i rremë i pasurive të personave të zgjedhur dhe nëpunësve publikë*" sipas paragrafit të parë të nenit 257/a/ të Kodit Penal, konsiderohet e kryer nga ana objektive nëse subjektet e deklarimit të parashikuar nga neni 3 i Ligjit Nr. 9049, datë 10.04.2003 "Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë", i ndryshuar apo personat e lidhur me ta bashkëshorti/ja dhe fëmijët madhor të tyre: ***i)*** refuzojnë në mënyrë të hapur duke deklaruar se nuk dëshirojnë të paraqesin deklaratën e pasurisë para fillimit të detyrës, deklaratën periodike të pasurisë dhe deklaratën pas largimit nga detyra edhe pas paralajmërimit të detyrimit për deklarim nga ana e ILDKPKI; **ose *ii)*** nuk plotësojnë deklaratën e pasurisë para fillimit të detyrës brenda 30 ditëve nga fillimi i punës, deklaratën periodike të pasurisë brenda datë 31 mars të çdo viti apo dorëzimit e deklaratës pas largimit nga detyra brenda jo më vonë se 15 ditë nga data e largimit nga funksioni pranë autoritetit ose strukturës përgjegjëse të institucionit publik dhe pa shkaqe të arsyeshme; **dhe *iii)*** në çdo rast duhet që nga ILDKPKI të jetë marrë masa administrative e gjobës ndaj subjektit të deklarimit dhe/ose personave të lidhur të tyre, gjobë e cila duhet t'i jetë komunikuar këtyre të fundit së bashku me paralajmërimin për plotësimin e deklaratës së pasurisë.

**167.4.** Ndërkohë sipas paragrafit të dytë të nenit 257/a i Kodit Penal vepra konsiderohet e konsumuar kur subjekti i deklarimit apo personi i lidhur me të bashkëshorti/ja dhe fëmijët madhor kryejnë ***fshehje të pasurisë*** apo bëjnë ***deklarim të rremë të pasurisë.*** Do të kishim të bënim me kryerjen e veprës penale të parashikuar nga neni 257/a paragrafi i dytë i Kodit Penal, ***nëpërmjet fshehjes së pasurisë***, në rastin kur personi, ka kryer veprime të caktuara, si këmbim të pasurisë, trasferim të saj, fshehje apo mbulim të natyrës së vërtetë të burimit, vendosjes, zhvendosjes, pronësisë ose të drejtave të tjera pasurore, fitim të pronësisë, posedim apo përdorim, që do të çonin në moslidhjen dot të pasurisë me pronarin e vërtetë të saj, duke e vendosur atë në emër të një personi tjetër, të ndryshëm nga rrethi i personave për të cilët i pandehuri është i detyruar që të deklarojë pasurinë. Subjekti në këtë rast ndërmerr veprime të caktuara, shoqërisht të rrezikshme, për t'i humbur gjurmët e pasurisë, apo duke e gëzuar atë, me ndërmjetësinë e personave të tretë. Të gjitha këto veprime të ndërmarra nga ana e një të pandehuri bëhen me një qëllim të mirëpërcaktuar, për t'u mos u evidentuar dhe deklaruar në ILDKPKI, sepse këto pasuri rrjedhin nga përfitime të paligjshme duke abuzuar me funksionin e tyre, pasi në të kundërt nuk do të kishte sens logjik dhe juridik për t'u fshehur pasuritë që vijnë nga burime të ligjshme e të justifikuara. Në këtë përfundim arrijmë duke bërë interpretimin historikë, logjik dhe sistematik të legjislacionit që ka rregulluar deklarimin e pasurive të të zgjedhurve dhe funksionarëvë publik ndër vite. Kështu, në nenin 8 të Ligjit Nr. 7903, datë 08.03.1995 "Për deklarimin e pasurive të zgjedhura dhe të disa drejtuesve e punonjësve të shërbimit publik", thuhet shprehimisht se: "*Shkeljet e parashikuara në nenet 1 dhe 2 të këtij ligji nga persona të tjerë me përjashtim të atyre të përmendur në nenin 7, përbëjnë kundërvajtje administrative dhe dënohen: - Për mosparaqitjen në kohën e duhur pa shkaqe të arsyeshme të deklaratës me gjobë në masën 1000 deri në 50000 lekë nga inspektorët e tatimeve të rrethit. -* ***<u>Për daklarata të rreme me dashje</u>*** *me gjobë në masën 500 000 deri në 1 000 000 lekë për çdo rast nga kryetari i degës së policisë financiare, si dhe me heqjen e së drejtës së ushtrimit të profesionit deri në 5 vjet. Kundër vendimeve të dënimit mund të bëhet ankim në gjykatën e rrethit deri brenda 10 ditëve nga dita e shpalljes së vendimit. Kur shkelja përbën vepër penale, bëhet kallëzim në organet e prokurorisë.*", ndërsa në nenin 9 të këtij ligji parashikohet se: "***Organet e ngarkuara me gjykimin e kundërvajtjeve administrative sipas këtij ligji, krahas dënimit me gjobë vendosin <u>edhe për pasurinë e fituar nga burime të paligjshme</u> prej personave të përcaktuar në nenet 1 dhe 4 të këtij ligji. Kjo pasuri konfiskohet nga policia financiare dhe kalon në dobi të shtetit.***". Pra, nga përmbajtja e këtyre dispozitave rezulton se masa administrative meret për deklarata të rreme me dashje dhe vetëm për **pasuritë e deklaruara të cilat janë fituara nga burime të paligjshme**, sepse nuk ekziston logjika juridike që bëhet deklaratë e rreme me dashje për pasuritë e deklaruara apo edhe të padeklaruara e që janë fituar në mënyrë të ligjshme nga burime të ligjshme e të justifikuara. Në këtë konkluzion arrihet duke bërë interpretimin gramatikor të nenit 9 të këtij ligji, konkretisht lidhësa "*edhe*" *për pasurinë e fituar nga burime të paligjshme*, nënkupton që dënimi me gjobë shoqërohet gjithmon me konfiskimin e pasurisë të fituar nga burime të paligjshme, për rrjedhojë nuk mund të kemi deklarim të rremë pa pasur pasuri të paligjshme. Kjo përforcohet edhe me jurisprudencën e Gjykatës Kushtetuese, e cila në vendimin Nr. 16, datë 11.11.2004, ndër të tjera thekson: "... *Gjykata Kushtetuese konstaton se qëllimi kryesor për miratimin e ligjit nr. 9049 "Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa*

*nëpunësve publikë"* ***ka qenë marrja e masave sa më efektive për intensifikimin e luftës kundër korrupsionit, rritja e besimit në institucionet shtetërore, transparenca, parandalimi i rasteve të abuzimit me pushtetin shtetëror dhe pasurimit të paligjshëm të personave të zgjedhur ose të atyre që kryejnë funksione të caktuara shtetërore."***.[49]

167.5. Gjithashtu, nga ana objektive kjo vepër penale konsumohet nëpërmjet veprimeve që përbëjnë ***deklarim të rremë të pasurisë*** që përmendet në deklaratën e pasurisë. Sikurse theksuam më lartë neni 257/a i Kodit Penal *"Refuzimi për deklarimin, mosdeklarimi, fshehja ose deklarimi i rremë i pasurive të personave të zgjedhur dhe nëpunësve publikë"* është një dispozitë blankete. Prandaj për të përcaktuar kuptimin e kësaj figure të veprës penale, duhet t'i referohemi Ligjit Nr. 9049, datë 10.04.2003 "Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë", i ndryshuar. Kështu, në nenin 38 të këtij ligji nën titullin **"Deklarimi i rremë" parashikohet shprehimisht se:** ***"Deklaratat dhe të gjitha dokumentet që i shoqërojnë ato janë dokumente zyrtare. Paraqitja në to e të dhënave të rreme përbën vepër penale*** *dhe dënohet sipas legjislacionit në fuqi."*. Nga përmbajtja e kësaj dispozite që të kemi deklarim të rremë duhet të plotësohen në mënyrë kumulative dy kushte: **së pari**, subjekti i deklarimit dhe bashkëshorti/ja e fëmijët madhor të kenë plotësuar deklaratën e pasurisë dhe **së dyti**, në deklaratën e pasurisë dhe dokumentet justifikues të jenë paraqitur të dhëna të rreme që nuk i përgjigjen realitetit. **Gjykata çmon se nga interpretimi *a contrario* i kësaj dispozite arrihet në konkluzionin se nuk do të kemi deklarim të rremë të pasurisë, nëse subjekti i deklarimit për shkak të neglizhencës, harresës apo për shkak të paqartësisë se plotësimit të deklaratës së pasurisë, që vjen nga mungesa e trajnimit nga organet kompetente, nuk pasqyron në deklaratën e pasurisë një ose disa nga interesat privat, burimet e krijimit apo detyrimet financiare të parashikuar nga neni 4 i Ligjit Nr. 9049, datë 10.04.2003 "Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë", i ndryshuar. Kjo për faktin pasi nuk mund të flitet për deklarim të rremë kur "nuk ka deklarim" për një pasuri, por kemi deklarim të rremë kur paraqiten të dhëna të rreme me pasurinë e deklaruar, me qëllim për të mbuluar një të ardhur të paligjshme nga burime të paligjshme e të pajustifikuara.** Gjykata çmon se në këtë përfundim arrihet duke bërë interpretimin logjik të paragrafit të parë dhe të dytë të nenin 257/a të Kodit Penal. Kështu, sipas paragrafit të parë të këtij neni refuzimi për bërë deklarimin e të gjithë pasurisë apo mosdeklarimin e të gjithë pasurisë në afat dhe pa shkaqe të arsyeshme (ku mund të përfshihen edhe pasuri të paligjshme që vijnë si rrjedhojë e akteve korruptime apo abuzimit me detyrën), përbën kundërvajtje penale, ndërsa paragrafi i dytë i këtij neni ku përfshihet dhe deklarimi i rremë i pasurisë përbën krim. Ndodhur në këto kushte, Gjykata çmon se nëse në deklarimin e rremë të pasurisë do të përfshihej dhe mosdeklarimi në deklaratën e pasurisë të një ose disa nga interesat privat, burimet e krijimit apo detyrimet financiare, kjo do të binte në kundërshtim

---

[49] Në vendimin Nr. 5, datë 2 Shkurt 2001 të Gjykatës Kushtetuese ndër të tjera thuhet se: ***"Ndikimi i padiskutueshëm i vendimeve të Gjykatës Kushtetuese është i tillë që iu imponon të gjithë organeve shtetërore, duke mos përjashtuar as gjykatat, fuqinë detyruese të arsyetimit të vendimit të saj.*** *Arsyetimi që përdor Gjykata Kushtetuese në vendimet e saj ka forcën e ligjit, çka buron nga autoriteti i këtij organi për të thënë fjalën e fundit në çështjet për të cilat të tjerët tashmë janë shprehur. Çdo qëndrim i kundërt krijon një precedent të rrezikshëm në marrëdhëniet institucionale."*.

me qëllimin e ligjvënësit, pasi do të sillte që një person që refuzon dhe nuk e paraqet fare deklaratën e pasurisë, ku mund të përfshihen edhe pasuri të paligjshme që vijnë si rrjedhojë e akteve korruprime apo abuzimit me detyrën, të dënohet më pak se një person që deklaron në mënyrë të saktë një pjesë të pasurisë dhe nuk deklaron një pjesë tjetër, e cila vjen nga burime të ligjshme e që mund të justifikohet me dokumente ligjor nga subjektet e deklarimit. **Nëse do të rezultonte se pasuria e padeklaruar në deklaratë dhe e konstatuar pas hetimit nga organet kompetente sikurse është ILDKPKI nuk justifikohet me burime të ligjshme atëherë do të ishim përpara fshehjes së pasurisë dhe jo përpara deklarimit të rremë.**

**167.6.** Gjykata çmon se do të ishin përpara deklarimit të rremë të pasurisë që është pasqyruar në deklaratë nga subjekti i deklarimit, kur funksionari fillon punë dhe bëhet subjekt i deklarimit të pasurisë, ai deklaron më tepër pasuri se sa ka, në mënyrë që me vonë të mund të justifikojë shtimin e pasurisë nga ndonjë veprim i mundshëm korruptiv dhe jo të lërë pa deklaruar pasuri që janë përfituar në mënyrë të ligjshme. Gjithashtu, do të ishim përpara deklarimit të rremë të pasurisë, të pasqyruar në deklaratën e pasurisë nëse subjekti i deklarimit pasqyron si fakt fitimin e një pasurie nëpërmjet dhurimit, ndërkohë që provohet që ky akt është fiktiv, pasi realisht subjekti e ka blerë nga burime të paligjshme, si dhe rastet kur subjekti i deklarimit deklaron blerjen e një pasurie në një vlerë më të vogël se vlera reale e blerë apo shitjen e një pasurie me një vlerë më të lartë se vlera reale e shitur. Të gjitha deklarimet e rreme duhet të bëhen nga subjekti i deklarimit me qëllim futjen e pasurive të vëna në mënyrë të paligjshme në sistemin e rregullt fiskal dhe pasqyrimi në formularët e deklarimit të interesave privat duke përdorur forma të ndryshme justifikimi. Pra, Gjykata thekson se deklarata e rreme e pasurisë bëhet me dashje dhe vetëm për pasuritë e deklaruara të cilat janë fituara nga burime të paligjshme, sepse nuk ekziston logjika juridike që bëhet deklaratë e rreme me dashje për pasuritë e deklaruara e që janë fituar në mënyrë të ligjshme nga burime të ligjshme e të justifikuara. Në këtë rast do të ishin përpara një deklarate pasurie të paplotë dhe të parregullt që korrigjohet në përputhje me procedurën e parashikuar nga ligji.

**167.7.** Gjithashtu, Gjykata çmon të theksoj se duhet bërë dallimi midis deklarimit të rremë të pasurisë që është pasqyruar në deklaratën e pasurisë nga subjekti i deklarimit, nga gabimet materiale, pasaktësitë, plotësimet e gabuara dhe parregullsitë që evidentohen në deklaratë, për shkak të neglizhencës, harresës apo për shkak të paqartësisë se plotësimit të deklaratës së pasurisë, që vjen nga mungesa e trajnimit nga organet kompetente. Kështu, në nenin 24 të Ligjit Nr. 9049, datë 10.04.2003 "Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë", i ndryshuar, nën titullin **"Përpunimi paraprak" parashikohet shprehimisht se:** *"Inspektorati i Lartë bën përpunimin paraprak të deklarimeve, i cili përfshin juridiksionin,* ***rregullsinë e plotësimit të deklaratës dhe të anekseve të saj****. Kur nga përpunimi paraprak vërtetohen gabime materiale ose plotësime të gabuara, Inspektorati njofton subjektin që ka paraqitur këto deklarime, i cili, brenda 15 ditëve nga marrja e njoftimit, është i detyruar t'i ndreqë ato. Deklaratat e interesave private pas dorëzimit dhe regjistrimit kalojnë menjëherë në skanimin fizik dhe ruhen në sistemin e programuar elektronik të ILDKPKI-së. Vetëm pas përfundimit të procedurave të skanimit deklaratat e interesave private kalojnë në përpunimin paraprak, kontrollin aritmetik e logjik dhe me pas në kontroll të plotë. Procedurat e pranimit, skanimit dhe përpunimit paraprak miratohen nga Inspektori i Përgjithshëm."*, ndërsa në nenin 25 të këtij ligji nën titullin **"Llojet e kontrollit"**, parashikohej se: *"1. Kontrolli i deklarimeve*

*përfshin kontrollet, aritmetik e logjik, dhe verifikimin e miratimin e te dhënave te deklaratës (kontroll i plote).* ***Kontrollet, aritmetik dhe logjik, kryhen për çdo deklarim për te vërtetuar saktësinë e vlerësimit te pasurisë se deklaruar, saktësinë e burimeve financiare te deklaruara dhe mjaftueshmerine e mbulimit te pasurisë nga burimet e deklaruara.*** *Verifikimi e miratimi i te dhënave te deklaratës (kontroll i plote) behen për ato deklarime, te cilat, nga kontrollet e përcaktuara ne piken 1 te këtij neni, paraqesin probleme, papajtueshmëri dhe parregullsi ne justifikimin e burimeve te mbulimit te pasurisë ose ne pasurinë e deklaruar dhe ne deklarime te tjera, sipas skemës se kontrollit.* ***Në kuptim te këtij ligji, janë parregullsi në justifikimin e burimeve rastet kur burimet dhe pasuritë e krijuara nuk përputhen për shumën mbi 1 000 000 lekë për deklarimet vjetore dhe për shumën mbi 2 000 000 leke për deklarimet e bëra sipas neneve 6 dhe 9 te këtij ligji.*** *Skema e kontrollit te deklarimeve duhet te përfshijë kontrollin e plote te deklaratave, jo me pak se një here në dy vjet. 2. Verifikimi dhe kontrolli i pasurisë, i detyrimeve financiare kryhet i plote, për çdo vit, për Presidentin e Republikës, Kryetarin e Kuvendit, Kryeministrin, Zevendëskryeministrin, ministrat dhe drejtuesit, funksionet e te cilëve barazohen me ta. 3. Metodikat dhe manualet e ushtrimit te kontrollit miratohen nga Inspektori i Përgjithshëm.".* Pika 1, paragrafi i tretë, i katërt e i pestë, dhe pika 2 e këtij neni është shfuqizuar me nenin 50 të Ligjit 9367, datë 07.04.2005 "Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike". Gjithashtu, në nenin 27 të këtij ligji nën titullin **"Thirrja e subjektit për të dhënë shpjegime"** parashikohet se: *"Kur gjatë kontrollit zbulohet se deklarimet nuk janë të sakta ose burimet e deklaruara nuk identifikohen dhe nuk mbulojnë pasuritë e deklaruara, Inspektorati i Lartë thërret subjektin për të dhënë shpjegime të hollësishme dhe argumentet përkatëse, të cilat paraqiten kurdoherë me shkrim brenda 15 ditëve nga data e njoftimit."*, ndërsa në nenin 28 të këtij ligji nën titullin **"Pasuritë e fituara në mënyrë të paligjshme"** parashikohet shprehimisht se: *"****Kur edhe nga procedurat e përcaktuara në nenin 27 nuk mund të justifikohen me burime të ligjshme pasuritë e krijuara dhe kur këto mospërputhje janë mbi 2 000 000 lekë për deklarimet vjetore dhe mbi 3 000 000 lekë për deklarimet sipas neneve 6 dhe 9 të këtij ligji, atëherë vlerësohet se pasuritë janë krijuar në mënyrë të paligjshme dhe Inspektori i Përgjithshëm njofton menjëherë prokurorinë.****"*. Kjo dispozitë është shfuqizuar nga neni 17 i Ligjit 9475, datë 09.02.2006 "Për disa ndryshime dhe shtesa në Ligjin Nr. 9367, datë 07.04.2005 "Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike". Gjykata çmoj të evidentojë këto dispozita ligjore në kuadrin e interpretimit historik të këtyre normave për të përcaktuar më drejt qëllimin e ligjvënësit në parashikimin e figurës së veprës penale ***"Refuzimi për deklarimin, mosdeklarimi, fshehja ose deklarimi i rremë i pasurive të personave të zgjedhur dhe nëpunësve publikë"*** parashikuar nga neni 257/a të Kodit Penal, e cila është parashikuar me Ligjin Nr. 9030, datë 13.3.2003 "Për një shtesë në Ligjin Nr. 8204, datë 10.04.1997 "Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë", ndryshuar me Ligjin Nr. 8279, datë 15.01.1998 dhe me Ligjin Nr. 8733, datë 24.01.2001", duke pasur parasysh faktin që këto dispozita kanë plotësuar njëra-tjetrën, përderisa kanë ekzistuar në të njëjtën kohë. **Prandaj, Gjykata arrinë në konkluzionin se nga përmbajtja e këtyre dispozitave rezulton se nuk konsiderohet deklarimi i rremë i pasurive kur kemi të bëjmë me gabime materiale, parregullsi ku futen dhe mosplotësimi i të gjitha rubrikave të deklaratës, duke lënë pasuri të ligjshme të padeklaruara apo plotësime të gabuara të deklaratës së pasurisë, për të cilat subjekti i deklarimit thirret**



SPORTELI.AL

nga ILDKPKI-ja për t'i ndrequr ato. Gjithashtu, neni 28 i këtij ligji ka përcaktuar qartësisht se ILDKPKI-ja bën kallëzim penal në prokurori vetëm atëherë kur konstatohet se pasuritë që subjekti i deklarimit ka deklaruar apo që nuk ka deklaruar dhe që janë konstatuar gjatë hetimit administrativ janë krijuar në mënyrë të paligjshme, ku përshihen rastet e korrupsionit apo abuzimit me detyrën shtetërore. Ky qëllim i Ligjvënësit ka ekzistuar që me miratimit e Ligjit Nr. 7903, datë 08.03.1995 "Për deklarimin e pasurive të zgjedhura dhe të disa drejtuesve e punonjësve të shërbimit publik", ku në nenin 9 të këtij ligji parashikohej se: *"Organet e ngarkuara me gjykimin e kundërvajtjeve administrative sipas këtij ligji, krahas dënimit me gjobë vendosin edhe për pasurinë e fituar nga burime të paligjshme prej personave të përcaktuar në nenet 1 dhe 4 të këtij ligji. Kjo pasuri konfiskohet nga policia financiare dhe kalon në dobi të shtetit."*. Pra, nëse nuk provohet se pasuritë janë krijuar në mënyrë të paligjshme, ILDKPKI nuk mund të bëjë kallëzim penal, përsa kohë ligji e ka përcaktuar qartësisht se kush është pasuri e paligjshme dhe kush konsiderohet parregullsi apo pasaktësi në plotësimin e deklaratës. Ndërkohë nëse provohet se pasuritë janë fituar nga burime të ligjshme, por subjekti deklarues nuk ka paguar detyrimet fiskale, atëherë veprohet sipas nenit 32 të Ligjit Nr. 9049, datë 10.04.2003 "Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë", i ndryshuar, nën titullin **"Pasuritë e fituara nga fshehja e detyrimeve fiskale"**, ku parashikohet shprehimisht se: *"Kur pasuritë e fituara gjykohen se janë rrjedhojë e fshehjes së detyrimeve fiskale, Inspektori i Përgjithshëm njofton organet tatimore të cilët detyrohen të njoftojnë rast pas rasti Inspektoratin e Lartë për masat e marra."*.

**167.8.** Më tej në Ligjin Nr. 9049, datë 10.04.2003 "Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë", i ndryshuar se kush përbën kundërvajtje administrative në kuptim të këtij ligji. Kështu, në nenin 40 të këtij ligji të pandryshuar parashikohej se: ***"Në kuptim të këtij ligji, kur veprimi ose mosveprimi nuk përbën vepër penale, përbën kundërvajtje administrative dhe kundërvajtësit dënohen si me poshtë: a) kur deklaratat dhe dokumentet shoqëruese nuk paraqiten në afatin e caktuar, pa shkaqe të arsyeshme, subjekti që mbart detyrimin për deklarim gjobitet me 25 000 lekë.*** *Në qoftë se edhe pas 15 ditëve të komunikimit të gjobës subjektet e përcaktuara në nenet 3 dhe 7 vazhdojnë të mos deklarojnë, gjoba dyfishohet. Në këtë rast njoftohen menjëherë organet përkatëse; b) për mosngritjen e inspektoratit të ulët, sipas nenit 18 të këtij ligji, titullari i subjektit gjobitet me 50 000 leke; c) kur kryetari i inspektoratit të ulet nuk dërgon në afat në Inspektoratin e Lartë të dhënat për deklarimin, ai gjobitet me 20 000 lekë; ç) kur nuk jepen të dhënat e kërkuara sipas nenit 26 të këtij ligji, subjektet gjobiten me 50 000 lekë; d) kur ekspertët refuzojnë kryerjen e ekspertimit ose kur ata nuk paraqiten, pa shkaqe të arsyeshme, për kryerjen e ekspertimit, sipas nenit 29 të këtij ligji, gjobiten me 100 000 lekë; dh) kur, pa shkaqe të arsyeshme, organet e ngarkuara për këtë qëllim nuk ekzekutojnë gjobat, sipas nenit 41 të këtij ligji, ato gjobiten me 50 000 lekë. Të drejtën e këtyre gjobave e ka Inspektori i Përgjithshëm, me propozimin e personelit të Inspektoratit të Lartë. Ndërsa kryetari i inspektoratit të ulët ka të drejtën e gjobave vetëm për shkronjat "a", "d" e "dh" të këtij neni, kryesisht ose me propozimin e anëtarëve të inspektoratit të ulët. Kundër vendimit të gjobës se vënë nga Inspektori i Përgjithshëm mund të bëhet ankim në gjykatën e rrethit brenda 30 ditëve nga dita e marrjes se njoftimit, ndërsa për*

*vendimet e gjobës së vënë nga inspektorati i ulët mund të bëhet ankim tek Inspektori i Përgjithshëm brenda 30 ditëve nga marrja e njoftimit dhe më pas, brenda 30 ditëve nga marrja e këtij vendimi, mund të bëhet ankim në gjykatë.".* **Nga përmbajtja e kësaj dispozite rezulton se ILDKPKI-ja kishte të drejtë të vendoste masën administrative gjobë ndaj subjektit të deklarimit vetëm nëse nuk paraqeste deklaratën dhe dokumentat shoqërues brenda afatit ligjor dhe jo për ndonjë parregullsi apo pasaktësi në plotësimin e saj, për të cilën ligji parashikonte se subjekti thirret për t'i korrigjuar gabimet ose pasaktësitë. Pra, deri më datë 26.10.2012 përbënte kundërvajtje administrative për subjektin e deklarimit vetëm mos dorëzimi i deklaratës brenda afatit ligjor.**

**167.8.1.** Megjithatë me Ligjin Nr. Nr. 85/2012 "Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin Nr. 9049, datë 10.04.2003 "Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve finaciare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë", të ndryshuar, i botuar në Fletoren Zyrtare Nr. 132, datë 11 Tetor 2012, i cili ka hyrë në fuqi **më datë 26.10.2012** neni 40 i këtij ligji ka ndryshuar, duke pasur aktualisht këtë përmbajtje: "*1. Çdo shkelje e detyrimeve të përcaktuara në këtë ligj, kur nuk përbën vepër penale, përbën kundërvajtje administrative dhe dënohet me gjobë, sipas kufijve të përcaktuar më poshtë: a) Për mosdeklarim periodik apo me kërkesë, në afat dhe pa shkaqe të arsyeshme, zyrtari ose personi i lidhur me të, që mbart detyrimin për deklarim, dënohet me gjobë nga 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë deri në 100 000 (njëqind mijë) lekë; b)Për moslëshim autorizimi, sipas nenit 10 të këtij ligji, zyrtari dënohet me gjobë nga 30 000 (tridhjetë mijë) lekë deri në 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë; c) Kur nuk jepen të dhëna e kërkuara nga Inspektorati i Lartë, sipas nenit 26 të këtij ligji, personat përgjegjës të institucioneve publike dhe private dënohen me gjobë nga 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë deri në 100 000 (njëqind mijë) lekë. ç) Kur ekspertët refuzojnë kryerjen e ekspertimit ose kur ata nuk paraqiten, pa shkaqe të arsyeshme, për kryerjen e ekspertimit, sipas nenit 29 të këtij ligji, dënohen me gjobë nga 100 000 (njëqind mijë) lekë deri në 200 000 (dyqind mijë) lekë; **d) Për shkelje të tjera të këtij ligji, të përcaktuara me urdhër të Inspektorit të Përgjithshëm** e të konstatuara **gjatë veprimtarisë kontrolluese të Inspektoratit të Lartë, Inspektori i Përgjithshëm** dënon personat përgjegjës me **gjobë** në masën **50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë deri në 100 000 (njëqind mijë)** lekë. 2. Të drejtën për vendosjen e masave administrative për rastet e shkeljeve të mësipërme e ka Inspektori i Përgjithshëm. 3. Procedurat për zbatimin e masave administrative dhe ankimin ndaj tyre rregullohen sipas Kodit të Procedurave Administrative dhe dispozitave të ligjit nr. 10 279, datë 20.5.2010 "Për kundërvajtjet administrative". 4. Shqyrtimi i kundërvajtjeve administrative të konstatuara gjatë kryerjes së inspektimeve të Inspektoratit të Lartë bëhet jo më vonë se 6 muaj pas konstatimit të shkeljes.".* Duke bërë interpretimin logjik dhe sistematik të pikës 1 gërma "d" të kësaj dispozite arrihet në përfundimin se është Inspektori i Përgjithshëm që përcakton se kush nga shkeljet e tjera të dispozitave të parashikuara në këtë ligj, do të përbëjë kundërvatje administrative. Pra, në vetvete rastet e tjera të shkeljes së këtij ligji e që do të përbëjnë kundërvajtje administrative, do të përcaktohen me aktin nënligjor, të cilin ky ligj e përcakton "udhër" i të Inspektorit të Përgjithshëm. Gjykata konstaton se kjo dispozitë ndonëse i referohet Ligjit Nr. 10279, datë 20.5.2010 "Për kundërvajtjet administrative" është në kundërshtim të hapur me nenin 4 të këtij ligji nën titullin "**Kundërvajtja administrative**" ku parashikohet se: "*Kundërvajtje administrative është shkelja me faj e dispozitave ligjore ose **nënligjore**, të kryera me veprim ose mosveprim dhe për të cilat ligji parashikon dënim*

*administrativ.*", dhe me nenin 6 të këtij ligji nën titullin **"Shkeljet që përbëjnë kundërvajtje administrative"** ku thuhet se: *"Shkeljet që përbëjnë kundërvajtje administrative parashikohen:* ***a) me ligj; b) me akte të këshillit bashkiak apo të këshillit të komunës,*** *për shkelje që nuk janë parashikuar si të tilla në ligje të veçanta, që kanë lidhje me fushat e veprimtarisë së tyre në njësitë territoriale përkatëse, ku, sipas ligjit, ushtrojnë funksionet e veta."*. Pra, kur ligji ja delegon përcaktimin e kundërvajtjeve administrative aktit nënligjor nënkupton vetëm aktet e këshillit bashkiak. Gjithashtu, Gjykata konstaton se urdhri i Inspektorit të Përgjithshëm të ILDKPKI-së, si drejtues i një institucioni qendror, në zbatim të nenit 119 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, ku thuhet shprehimisht se: *"1. Rregulloret e Këshillit të Ministrave, të ministrive e **<u>të institucioneve të tjera qendrore</u>**, si dhe **<u>urdhrat</u>** e Kryeministrit, të ministrave **<u>e</u>** të **<u>drejtuesve të institucioneve qendrore kanë karakter të brendshëm dhe janë të detyrueshme vetëm për njësitë administrative që varen prej tyre. 2. Këto akte nxirren në bazë të ligjit dhe nuk mund të shërbejnë si bazë për të marrë vendime në lidhje me individët dhe subjektet e tjera.</u>** 3. Rregulloret dhe urdhrat nxirren në bazë dhe për zbatim të akteve që kanë fuqi juridike të përgjithshme."*, nuk mund të shërbejë si bazë për të marrë vendimet për subjekte të tjerë që nuk bëjnë pjesë në njësinë administrative që varen prej tij, pra në rastin konkret personelin e ILDKPKI-së. Pra, urdhri ka karakter të brendshëm dhe nuk mund të përcaktojë rregulla sjellje të përgjithshme sikurse janë përcaktimi i rasteve që përbëjnë shkelje administrative, për subjektet e deklarimit dhe personat e lidhur të tyre, parashikuar nga neni 3 i Ligjit Nr. 9049, datë 10.04.2003 "Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve finaciare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë", të ndryshuar, përsa kohë që këto subjekte nuk bëjnë pjesë në njësinë administrative që varen prej ILDKPKI-së. Prandaj, në kuadrin e përcaktimit të fuqisë juridike për të përcaktuar nësë një fakt do të përbëjë vepër penale apo kundërvajtje penale, në respektim të nenit 119 të Kushtetutës dhe në respektim të parimit të hierarkisë së akteve normative (parimi i shtetit të së drejtës),[50] Gjykata çmon se përsa i përket shkeljeve administrative duhet të marrë për bazë vetëm ato raste që parashikohen në mënyrë eksplicite në ligj dhe jo ato shkelje që mund të përcaktohen me urdhër të Inspektorit të Përgjithshëm, pasi me urdhër nuk mund të përcaktohen rregulla të përgjithshme sjellje, për rrjedhojë nuk mund t'i kundrejtohet subjekteve të deklarimit, por **mund të kundrejtohet vetëm personave që janë nën varësinë administrative të ILDKPKPI-së, pra personelit të saj.**

**167.8.2.** Gjithashtu, në rastin konkret, Gjykata çmon të evidentojë faktin se në zbatim të pikës 1 gërma "d" të Ligjit Nr. 9049, datë 10.04.2003 "Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve finaciare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë", të ndryshuar, ka dalë urdhri Nr. 27, datë 13.03.2014 i Inspektorit të Përgjithshëm të ILKPKI-së **"Për përcaktimin e shkeljeve të tjera të Ligjit Nr. 9049, datë 10.04.2003 "Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve finaciare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë"**, të ndryshuar, i cili **është botuar në Fletoren Zyrtare Nr. 29, datë 13 Mars 2014**. Në këtë

[50] Në vendimin Nr. 22, datë 24.04.2015 të Gjykatës Kushtetuese ndër të tjera thuhet se: *"Neni 4/3 i Kushtetutës parashikon se, <u>dispozitat kushtetuese zbatohen drejtpërsëdrejti</u>, përveç rasteve kur Kushtetuta parashikon ndryshe. Sipas këtij parimi themelor kur rregulli kushtetues parashikohet shprehimisht, ai nuk mund të mënjanohet dhe as të tejkalohet, por duhet të zbatohet drejtpërsëdrejti."* Neni 119 i Kushtetutës është një dispozitë që mund të zbatohet drejtpërdrejtë, pasi nuk i është deleguar Ligjvënësit për të përcaktar se çfarë fuqie kanë urdhrat e institucioneve qendrore, por e ka përcaktuar vetë Kushtetuta qartësisht se çfarë fuqie juridike kanë.

urdhër parashikohet shprehimisht: "***URDHËROJ:*** *Përcaktimin e shkeljeve të tjera të ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003 "Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë", të ndryshuar, që konstatohen gjatë veprimtarisë kontrolluese të Inspektoratit të Lartë, të cilat do të sanksionohen sipas masës së parashikuar në pikën 1, germa "d", të nenit 40 të këtij ligji, në rastet kur: 1. Deklarimi i pasurive, burimeve të krijimit të tyre dhe detyrimeve financiare nga subjekti apo personi i lidhur me të, nuk bëhet sipas kërkesave të parashikuara në ligj: a) Zyrtari nuk ka plotësuar formularin e duhur të deklaratës së interesave private, sipas llojit të detyrimit për deklarim ose sipas modelit të formularit të miratuar nga Inspektori i Përgjithshëm dhe të botuar në Fletoren Zyrtare. b) Zyrtari, apo personat e lidhur me të, nuk kanë nënshkruar të gjitha fletët e formularit të deklaratës së interesave private ku janë pasqyruar të dhëna lidhur me objektin e deklarimit. c) Zyrtari nuk ka plotësuar autorizimin dhe nuk ka pasqyruar në deklarimin e tij të interesave private faktin nëse ka ose jo persona të tjerë të lidhur me të, sipas kërkesave të nenit 21 të ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003, të ndryshuar. d) Zyrtari deklaron të dhënat edhe për pesonat e lidhur, kur këto të fundit disponojnë pasuri të regjistruar veçmas dhe për pasojë detyrohen ligjërisht të plotësojnë fletët përkatëse të këtij formulari. e) Zyrtari, apo personat e lidhur me të, nuk deklarojnë sipas kërkesave të formularit të interesave private vlerën e të ardhurave neto. f) Zyrtari nuk ka pasqyruar saktë vlerën e aseteve, të ardhurave apo të detyrimeve sipas monedhës përkatëse. g) Zyrtari, në deklarimin e interesave private periodikë vjetorë apo pas largimit nga funksioni, nuk pasqyron sipas kërkesave ligjore shtesa dhe ndryshime të gjendjes pasurore, por deklaron gjendjen e tyre. 2. Subjekti deklarues, apo personat e lidhur me të, nuk marrin masa për të rregulluar brenda afatit ligjor pasaktësitë e konstatuara gjatë përpunimit paraprak të deklaratës së interesave private, sipas kërkesave të parashikuara në nenin 24 të ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003, të ndryshuar. 3. Subjekti deklarues, apo personat e lidhur me të, nuk paraqitet brenda afatit ligjor të përcaktuar në nenin 27 të ligjit nr.9049, datë 10.4.2003, të ndryshuar, për të dhënë shpjegime mbi deklarimin e interesave private. 4. Subjekti deklarues apo personat e lidhur me të nuk depoziton dokumentet justifikues për pasuritë, detyrimet financiare dhe burimet e krijimit të tyre, gjatë kontrollit dhe hetimit administrativ.* ***Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare."***. Pra, edhe sikur të pranonim faktin se ky urdhër do të kishte fuqi të përgjithshme edhe pse nenin 119 i Kushtetutës e ndalon, përsëri shkeljet e evidentuara në këtë urdhër do t'i kundrejtoheshin subjekteve të deklarimit dhe personave të lidhur vetëm nga <u>data 13 Mars 2014</u> e në vijim dhe nuk mund të ketë fuqi prapaveprues, pasi në të kundërt do të cenohej parimit i sigurisë juridike. Kështu, Gjykata Kushtetuese në jurispredencën e saj ka theksuar në fakt, ashtu si edhe në fushat e tjera të së drejtës, edhe në të drejtën penale parim i përgjithshëm është ai i ndalimit të fuqisë prapaveprucse të ligjit. Një gjë e tillë diktohet para së gjithash për shkak të domosdoshmërisë së garantimit të stabilitetit dhe të sigurisë së marrëdhënieve juridike që vendosen ndërmjet subjekteve të ndryshme të së drejtës. Në rastin e ligjit penal dhe administrativ, i cili si rregull kufizon lirinë individual dhe pasurinë, është mëse e nevojshme që çdo qytetar, të dijë paraprakisht kufijtë e lirisë së tij si dhe sanksionet që mund t'i vijnë për shkak të kapërcimit të këtyre kufijve. Ai nuk duhet të ndjejë për asnjë çast rrezikun që një ligj i ri dhe për më tepër një akt nënligjor (urdhër) që mund të parashikojë si të dënueshëm një veprim apo mosveprim të caktuar, do të ketë në të ardhmen fuqi prapaveprucse. **(shiko vendimin Nr. 35, datë 20.12.2005 të Gjykatës**

**Kushtetuese). Pra, nga data 01.06.2003 që ka hyrë në fuqi Ligji Nr. 9049, datë 10.04.2003 "Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve finaciare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë", botuar në Fletoren Zyrtare Nr. 31, datë 15.05.2003 deri më datë 26.10.2012 përbënte kundërvajtje administrative për subjektin e deklarimit vetëm mos dorëzimi i deklaratës brenda afatit ligjor dhe nga data 26.10.2012 deri më datë 13.03.2014 (gjithmon nëse pranojmë logjikën që urdhri i Inspektorit të Përgjithshëm do të ketë status të ndryshëm nga neni 119 i Kushtetutës, duke përcaktuar rregulla të përgjithshme sjellje edhe pse është thjesht një urdhër që duhet të ketë fuqi vetëm për vartësit e tij) përbënte kundërvajtje administrative për subjektin e deklarimit refuzimi për të deklaruar, mos dorëzimi i deklaratës brenda afatit ligjor dhe moslëshim autorizimi, sipas nenit 10 të këtij ligji. Ndodhur në këto kushte, Gjykata vlerëson se pasaktësitë që lidhen dhe me mos plotësimin si duhet të deklaratës së pasurisë, ku përfshihen dhe rastet e mos deklarimit të plotë të pasurisë së ligjshme si dhe gabimet materiale në deklaratën e pasurisë nuk përbëjnë as kundërvajtje administrative, për rrjedhojë nuk kanë se si të përbëjnë vepër penale në formën e fshehjes dhe apo të deklarimit të rremë të pasurisë.**

**167.9.** Duke u rikthyer në rastin konkret, Gjykata çmon se ekzistojnë dyshime të arsyeshme të bazuara në prova se personi nën hetim **Ajola Xoxa** ka konsumuar nga ana objektive figurën e veprës penale *"Refuzimi për deklarimin, mosdeklarimi, fshehja ose deklarimi i rremë i pasurive të personave të zgjedhur dhe nëpunësve publikë"* parashikuar nga neni 257/a/2 i Kodit Penal. Gjykata e çmon të drejtë arsyetimin e Prokurorisë së Posaçme se, në këtë rast, konstatohet se ekzistojnë dyshime të arsyeshme të bazuara në prova se nuk ka deklaruar, duke fshehur, angazhimin e saj çdo lloj veprimtarie që krijon të ardhura, përfshirë çdo lloj të ardhure, të krijuar nga kjo veprimtari ose ky angazhim, sipas detyrimeve që burojnë nga ligjit nr. 9049 datë 10.04.2023, *neni 4 gërma "g" i tij*. Këto angazhime të kësaj shtetase, lidhen specifikisht me pjesëmarrjen e saj në bordin e Qendrës "Harabel", qendër kjo që provohet të ketë gjeneruar të ardhura, siç më lart u argumentua, dhe njëkohësisht pronare (Qendra "Harabel") e shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar "Nan Gallery" shpk, e cila është një subjekt tregtar me natyrë fitimprurëse. Fshehja e këtyre fakteve nga shtetësja nën hetim, ka pamundësuar organet ligjzbatuese për të patur një panoramë të plotë dhe të qartë përsa i përket jo vetëm pjesëmarrjes së kësaj shtetase në borde organizatash, që nga ana e tyre zotërojnë shpk, por çfarë është më e rëndësishme, ka pamundësuar *"konstatimin"* dhe *"gjurmimin"* e një sasie të konsiderueshme të hollash, të cilat kanë qarkulluar nëpërmjet këtyre subjekteve të kontrolluara faktikisht nga shtetësja nën hetim. Pikërisht, mungesa e plotë e kësaj transparence ka lejuar më pas edhe funksionimin e një skeme kaq të organizuar të lëvizjes së të hollave nga dhe nëpërmjet këtyre OJF-ve dhe shpk-ve. Gjithashtu, nga aktet e tjera rezulton personi nën hetim Ajola Xoxa duke mos deklaruar qiranë e ambienteve në ~~vlerën 24 000 Euro në vit siç rezulton nga hetimi ka bërë deklarim të rremë lidhur me~~ mundësin e kursimit. **Po ashtu, nëse do të ishin deklaruar interesat private do të konstatoheshin me lehtësi shpenzimet që ka bërë shtetësja Ajola Xoxa dhe të afërmit e saj, të cilët shpenzojnë për katër vite shifrën prej 86,721,175 lekë vetëm *për rroba, produkte kozmetike, buzëkuq, vathë, etj.***

**168. Në lidhje me anën subjektive të figurës së veprës penale.** Gjykata vlerëson se, vepra penale e "*Refuzimi për deklarimin, mosdeklarimi, fshehja ose deklarimi i rremë i pasurive të personave të zgjedhur dhe nëpunësve publikë*" parashikuar nga neni 257/a/2 i Kodit Penal kërkon si formë faji dashjen e drejtpërdrejtë. Gjithashtu, Gjykata vlerëson se paragrafi i dytë i nenit 257/a2 i Kodit Penal si një dispozitë blankete, duke e interpretuar në mënyrë logjike dhe sistematike me Ligjin Nr. 9049, datë 10.04.2003 "Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve finaciare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë", të ndryshuar, ka si qëllim fshehjen e pasurisë të cilat rrjedhin nga burime të paligjshme e të pajistifikuara, për shkak të veprimet të paligjshme duke abuzuar me detyrën apo si rezultat i veprimeve korruptive, qëllim i cili nxirret nga veprimet konkrete rast pas rasti, si këmbim të pasurisë, trasferim të saj, fshehje apo mbulim të natyrës së vërtetë të burimit, vendosjes, zhvendosjes, pronësisë ose të drejtave të tjera pasurore, fitim të pronësisë, posedim apo përdorim, që do të çonin në moslidhjen dot të pasurisë me pronarin e vërtetë të saj, duke e vendosur atë në emër të një personi tjetër, të ndryshëm nga rrethi i personave për të cilët i pandehuri është i detyruar që të deklarojë pasurinë. Subjekti në këtë rast ndërmerr veprime të caktuara, shoqërisht të rrezikshme, për t'i humbur gjurmët e pasurisë, apo duke e gëzuar atë, me ndërmjetësinë e personave të tretë. Të gjitha këto veprime të ndërmarra nga ana e një të pandehuri bëhen me një qëllim të mirëpërcaktuar, për t'u mos u evidentuar dhe deklaruar në ILDKPKI. Gjithashtu, deklarimet e rreme në deklaratën e pasurisë duhet të bëhen nga subjekti i deklarimit me qëllim futjen e pasurive të vëna në mënyrë të paligjshme në sistemin e rregullt fiskal dhe pasqyrimi në formularët e deklarimit të interesave privat duke përdorur forma të ndryshme justifikimi. Pra, Gjykata thekson se si fshehja e pasurisë ashtu dhe deklarata e rreme e pasurisë bëhet me dashje për të fshehur pasuritë e padeklaruara dhe/ose për pasuritë e deklaruara të cilat janë fituara nga burime të paligjshme e të pajustifikuara, sepse nuk ka sens logjik dhe juridik që bëhet deklaratë e rreme me dashje për pasuritë e deklaruara e që janë fituar në mënyrë të ligjshme nga burime të ligjshme e të justifikuara. Në këtë rast do të ishin përpara një deklarate pasurie të paplotë dhe të parregullt që korrigjohet në përputhje me procedurën e parashikuar nga ligji.

**169. Në lidhje me subjektin e veprës penale,** në nenin 12 të Kodit Penal thuhet shprehimisht se: "*Ka përgjegjësi penale personi që në kohën e kryerjes së një krimi ka mbushur moshën katërmbëdhjetë vjeç. Personi që kryen një kundërvajtje penale ka përgjegjësi kur ka mbushur moshën gjashtëmbëdhjetë vjeç*". Kështu, personi fizik që të konsiderohet subjekt i figurës së veprës penale, dhe si rrjedhojë të plotësojë kushtin paraprak për fajin dhe përgjegjësinë penale, duhet të plotësojë dy kritere ekskluzive ligjore (*condicio sine qua non*): *i)* Të ketë mbushur moshën për përgjegjësi penale dhe *ii)* të jetë i përgjegjshëm. Kështu, neni 17 i Kodit Penal parashikon se: "*Nuk ka përgjegjësi penale personi që në kohën e kryerjes së veprës vuante nga një turbullim psikik ose neuropsikik që ka prishur tërësisht ekuilibrin e tij mendor dhe për pasojë nuk ka qënë në gjendje të kontrollojë veprimet apo mosveprimet e tij dhe as të kuptojë se kryen vepër penale*". Ky kusht ka të bëjë me domosdoshmërinë për të proceduar penalisht vetëm personat e përgjegjshëm, që kanë të paktën një ndërgjegje minimale sa për t'i bërë ato të aftë të kuptojnë rëndësinë e veprimeve që kryejnë, në mënyrë që realisht të ekzistojë ana subjektive e autorit të veprës penale, që për organin procedues do të thotë të jetë i mundur të identifikohet forma e fajësisë. Megjithatë, që të përjashtohet nga përgjegjësia penale, për shkak të gjendjes mendore, duhet



SPRETIUETA.AL

te plotësohen në mënyrë kumulative disa kushte. ***Së pari***: personi të vuajë nga një turbullim psikik ose neuropsikik. ***Së dyti***: ky turbullim të ketë prishur tërësisht ekulibrin mendor të personit. ***Së treti:*** turbullimi të ketë ekzistuar në kohën e kryerjes së veprës. Ky kusht buron nga rregulli se përgjegjësia penale përcaktohet në momentin e kryerjes së veprës penale. Në rastin konkret, subjekt i kësaj vepre penale janë **subjektet që mbartin detyrimet për deklarimin sipas neneve 3, 3/1 dhe 9** të Ligjit Nr. 9049, datë 10.04.2003 "Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë", i ndryshuar. Në rastin konkret personi nën hetim **Ajola Xoxa** është subjekt deklarues si person i lidhur i Kryetari të Bashkisë Tiranë personit nën hetim Erion Veliaj.

### D. Lidhur me figurën e veprës penale *"Pastrimi i produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale"*.

**170.** Gjithashtu, në çështjen objekt gjykimi, prokuroria i ka atribuar personave nën hetim **Erion Veliaj, Ajola Xoxa dhe Elman Abule** faktin se ka dyshime të arsyeshme se kanë konsumuar elementët e figurës së veprës penale *"Pastrimi i produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale"*, kryer në bashkëpunim dhe më shumë se një herë, parashikuar nga neni 287/2 i Kodit Penal. Prandaj, në çështjen objekt gjykimi, gjykata, duhet të analizojë elementët e kësaj figure të veprës penale. Në këtë dispozitë parashikohet shprehimisht se: ***"Pastrimi i produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale, nëpërmjet: a) këmbimit ose transferimit të pasurisë, me qëllim fshehjen ose mbulimin e origjinës së paligjshme të saj,*** *duke ditur se kjo pasuri është produkt i veprës penale ose i veprimtarisë kriminale;* ***b) fshehjes ose mbulimit të natyrës së vërtetë,*** *burimit, vendndodhjes, disponimit, zhvendosjes, pronësisë* ***ose të drejtave në lidhje me pasurinë,*** *duke ditur që kjo pasuri është produkt i veprës penale ose i veprimtarisë kriminale;* ***c) fitimit të pronësisë, posedimit ose përdorimit të pasurisë, duke e ditur në çastin*** *e marrjes në dorëzim të saj, që kjo pasuri është produkt i* ***veprës penale ose i veprimtarisë kriminale;*** *ç) kryerjes së veprimeve financiare ose transaksioneve të copëzuara për shmangien nga raportimi, sipas* ***legjislacionit*** *për parandalimin e pastrimit të parave* [51]*; d)* ***investimit në veprimtari ekonomike ose financiare të parave a sendeve,*** *duke ditur se janë produkte* ***të veprës penale ose veprimtarisë kriminale; dh) këshillimit, ndihmës,*** *nxitjes ose thirrjes* ***publike*** *për kryerjen e secilës prej veprave të përcaktuara më sipër; dënohet me burgim nga pesë gjer në dhjetë.* ***Kur kjo vepër kryhet gjatë ushtrimit të një veprimtarie profesionale, në bashkëpunim ose më shumë se një herë, dënohet me burgim nga shtatë gjer në pesëmbëdhjetë vjet. E njëjta vepër, kur ka sjellë pasoja të rënda, dënohet jo më pak se pesëmbëdhjetë vjet me burgim.*** *Dispozitat e këtij neni zbatohen edhe kur: a) vepra penale, produktet e së cilës pastrohen, është kryer nga një person që nuk mund të merret si i pandehur ose që nuk mund të dënohet; b) ndjekja penale për veprën, produktet e së cilës pastrohen, është parashkruar ose amnistuar; c) personi që kryen pastrimin e produkteve është i njëjtë me personin që ka kryer veprën, nga e cila kanë rrjedhur produktet; ç) për veprën penale, nga e cila kanë ardhur produktet, nuk është filluar asnjëherë çështja penale apo nuk është dhënë një dënim me vendim penal të formës së prerë; d) vepra penale, produktet e së cilës pastrohen, është kryer nga një person, pavarësisht*

[51] Ligji nr.9917, datë 19.05.2008, "Për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit", i ndryshuar.

*shtetësisë së tij, jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë dhe është njëkohësisht e dënueshme, si në shtetin e huaj, ashtu edhe në Republikën e Shqipërisë. Dijenia dhe qëllimi, sipas paragrafit të parë të këtij neni, nxirren nga rrethana fakti objektive.".*

**171. Në lidhje me objektin e veprës penale, *"Pastrimi i produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale"*.** Vepra penale për të cilën akuzohen të pandehurit është parashikuar nga Kodi Penal ne Pjesën e posacme të tij, në SEKSIONI III, "VEPRA PENALE KUNDËR RENDIT DHE SIGURISË PUBLIKE". **Objekti** i kësaj vepre penale përfaqëson tërësinë e marrëdhënieve juridike të vendosura nga ligjvënësi me qëllim garantimin e funksionimit të rregullt dhe normal të organeve të administratës publike dhe mbrojtja e interesit të shtetit dhe shtetasve nga pastrimi i produkteve të veprës penale. Objekti material përfaqëson vetë produktin e veprës penale që pastrohet.

**172. Në lidhje me anën objektive *(actus rea)* të figurës së veprës penale *"Pastrimi i produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale"*.** Gjykata thekson se ajo është element i domosdoshëm për përgjegjësinë penale, sepse nëse nuk ka veprim ose mosveprim të dënueshëm nuk ka vepër penale. Gjykata çmon të trajtojë paraprakisht nocionin ***"produktit të veprës penale ose veprimtarisë kriminale"***, përpara se të trajtojë format më të cilat ajo kryhet. Neni 1 i Konventës së Këshillit të Evropës *"Për Pastrimin, Kërkimin, Kapjen dhe Konfiskimin e Produkteve të Krimit dhe Për Financimin e Terrorizmit"* jep këtë përkufizim: *"Për qëllime të kësaj Konvente: a)* ***"produkt"*** *nënkupton çdo avantazh ekonomik të nxjerrë nga veprat penale. Ky avantazh mund të konsistojë në çdo pasuri, siç përcaktohet në nënparagrafin b të këtij neni; b)* ***"pasuri"*** *nënkupton pasuri të çdo natyre, fizike ose jofizike,* ***e luajtshme*** *ose* ***e paluajtshme***, *si dhe aktet juridike ose dokumentet që vërtetojnë një titull ose interes mbi këtë pasuri;".* Nocionin e *"produktit të veprës penale"* e gjejmë edhe në nenin 36 të Kodit Penal, i cili parashikon se: *"1.) Konfiskimi jepet detyrimisht nga gjykata dhe ka të bëjë me marrjen dhe kalimin në favor të shtetit: a) të sendeve që kanë shërbyer ose janë caktuar si mjete për kryerjen e veprës penale; b) të produkteve të veprës penale, ku përfshihet çdo lloj pasurie, si dhe dokumentet ose instrumentet ligjore që vërtetojnë titulj ose interesa të tjerë në pasurinë që rrjedh ose fitohet drejtpërdrejtë ose tërthorazi nga kryerja e veprës penale;".* Parashikimi i nenit 36 të Kodit Penal në lidhje me nocionin e *"produktit të veprës penale"* është i ngjashëm me atë të nenit 1 të Konventës së Këshillit të Evropës ***"Për Pastrimin, Kërkimin, Kapjen dhe Konfiskimin e Produkteve të Krimit dhe Për Financimin e Terrorizmit"***, **që do të thotë se, produkt të veprës penale,** do të kuptojmë çdo avantazh ekonomik i nxjerrë nga një vepër **penale,** i cili mund të **konsistojë** në pasuri të çdo natyre si dhe në dokumente apo akte juridike që vërtetojnë një titull apo një interes mbi këtë pasuri.

**172.1.1.** Në kuptim të nenit **287** të Kodit Penal, figura e veprës penale ***"Pastrimi i produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale"***, nga ana objektive kryehet nëpërmjet:

**172.1.2. a)** këmbimit ose transferimit të pasurisë, me qëllim fshehjen ose mbulimin e origjinës së paligjshme të saj, duke ditur se kjo pasuri është produkt i veprës penale ose i veprimtarisë kriminale. Gjykata çmon se, pastrimi i produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale është ndryshimi, kthimi në një gjë tjetër; zëvendësimi ose transferimi i një të drejte nga një person në tjetrin; transfertat elektronike të parave nga një llogari bankare në një tjetër janë të përfshira gjithashtu në këtë proces; konvertimi dhe transferimi i pronës me qëllim pastrimit i cili kryhet në mënyrë të fshehtë apo që fsheh origjinën e saj të



SPORTELI.AL

paligjshme apo për të ndihmuar çdo person i cili është i përfshirë në kryerjen e një vepre penale. Transferimi është i definuar si kalimi i parave nga një pikë në një tjetër. Një kuptim tjetër është kalimi i remitancave nga një llogari në një tjetër në emër të të njëjtit person ose të personave të tjerë. Qëllimi i sjelljes së tillë është për të transformuar një pjesë të pronës në një tjetër, me synim për ta bërë atë legjitime, në mënyrë që prona e paligjshme të fillojë të bëhet e ligjshme. Ligji nuk duket se kufizon mënyrën në të cilën pasuritë këmbehen ose transferohen. Sigurisht që çdo lloj transaksioni financiar, si blerja e një çeku të arkëtueshëm, këmbimi i një çeku me një tjetër monedhë ose blerja e mallrave janë në përputhje me këtë përkufizim. Gjithashtu, edhe një transaksion jofinanciar si lëvizja apo dorëzimi i parave nga një person tek personi tjetër janë në përputhje me këtë përcaktim;

**172.1.3. b)** fshehjes ose mbulimit të natyrës së vërtetë, burimit, vendndodhjes, **disponimit, zhvendosjes, pronësisë** ose të drejtave në lidhje me pasurinë, duke ditur që kjo pasuri është produkt i veprës penale ose i veprimtarisë kriminale. Sipas *"The Oxford English Dictionary"*, të fshehësh do të thotë *"të mbash sekret, të mos lejosh të shihet diçka"*. Ajo i referohet largimit të një diçkaje nga një vend ku mund të shihet dhe vendosja aty ku askush nuk e di se ku është, duke e fshehur atë pikërisht sepse personi që e fsheh i di pasojat, dënimin. Sjellja e definuar këtu është për të fshehur, mbuluar apo për të maskuar burimin, vendndodhjen, disponimin ose lëvizjen e pronës. Kjo mund të kryhet nga një sjellje aktive - fshehur, maskuar, mbuluar ose pasive – në rastin kur subjekti ka një obligim ligjor për të vepruar. Sipas rregulloreve të Komisionit Amerikan të Kontrollit të Abuzimit me Drogën, fshehja i referohet një personi i cili pengon përcaktimin e natyrës së vërtetë, burimit, vendndodhjes, disponimit, lëvizjes, të drejtave në lidhje me pronësinë e produktit. Me mbulim ose maskim siç njihet ndryshe sipas *"The Oxford English Dictionary"* definon termin *"për të maskuar"* si për të ndryshuar, për të fshehur, për të mbuluar identitetin. Dallimi kryesor në mes fshehjes dhe maskimit (mbulimit) është fakti se një person fsheh çfarë i takon atij apo asaj që rrezikon ligjërisht të konfiskohet, ndërsa maskimi ka të bëjë me fshehjen e akteve apo pronën e tjetrit. Po t'i referohemi Konventës së Vjenës 1988 (Neni 3/1) dhe Konventës së Palermos 2000 (Neni 6/2) vetëfshehja nuk dënohet, por dënohet veprimi i mëvonshëm i fshehjes. Maskimi është kriminalizuar tradicionalisht si një formë e pjesëmarrjes, nëpërmjet të ashtuquajturve bashkëpunëtorë *aposteriori*, pas përfundimit të krimit. Maskimi i natyrës së vërtetë, burimit, vendit, destinacionit, lëvizjes ose pronësisë së vërtetë apo i të drejtave që lidhen me pasurinë është diçka e dallueshme nga maskimet klasike siç janë kriminalizuar në shumicën e kodeve penale. Prandaj, ashtu si edhe modeli i krijuar nga Konventa e Vjenës, ky lloj maskimi është i ndryshëm nga vepra tradicionale e maskimit, pasi në veprën penale të pastrimit subjekti pa pasur nevojë të marrë pjesë në veprën penale dhe pa bashkëpunim të mëparshëm në kryerjen e tij, ndihmon autorin e veprës penale kryesore ose për të siguruar produktin e saj ose për të shmangur dënimin;

**172.1.4. c)** fitimit të pronësisë, posedimit ose përdorimit të pasurisë, duke e ditur në çastin e marrjes në dorëzim të saj, që kjo pasuri është produkt i veprës penale ose i veprimtarisë kriminale. Ndodhur në këto kushte, me qëllim zbatimin korrekt të kësaj dispozite, Gjykata çmon se duhen sqaruar termat juridik **"pronësi"**, **"posedim"** dhe **"përdorim"** sipas kuptimit që i ka dhënë Kushtetuta, Kodi Civil dhe jurisprudenca e Gjykatës Kushtetuese dhe asaj të Gjykatës së Lartë. Kështu, **"pronësia"** është një institut qëndror i së drejtës civile. Nga ana tjetër, e drejta e pronësisë është një nga të drejtat

themelore, të garantuara në dispozitat kushtetuese dhe në aktet ndërkombëtare të pranuara nga shteti shqiptar.[52] Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë nuk prezanton ndonjë përkufizim të konceptit të pronësisë, përveçse rregullimit të nenit 41, sipas të cilit: "*Prona fitohet me dhurim, me trashëgimi, me blerje dhe me çdo mënyrë tjetër* ***klasike të parashikuar në Kodin Civil.***" Duke qënë se kjo e drejtë përbën bazën e sistemit ekonomik në Republikën tonë (*funksioni publik kushtetues*[53]) dhe një të drejtë themelore kushtetuese të kujtdo (*funksioni privat kushtetues*[54]), Legjislatori ka përcaktuar qartë në ligj volumet e tagrave që rrjedhin nga ajo, mënyrën se si ajo realizohet efektivisht, mbrojtjen juridike që gëzon dhe mjetet ligjore për të realizuar një të drejtë të tillë në rast se gëzimi i qetë i kësaj të drejte cënohet. Kështu, ashtu sikurse juristkonsultët romak përkufizonin "*Proprietas est jus utendi, jus fruendi, jus abudendi re sua, quatenus juris ratio patitus.*", edhe Kodi ynë Civil në nenin 149 përkufizon se "*Pronësia është e drejta për të gëzuar dhe disponuar lirisht sendet, brenda kufijve të caktuar nga ligji.*". Nga përmbajtja e kësaj dispozite rezulton se, pronari gëzon tre tagra, që është e drejta e pronarit për "*të disponuar*", "*për të gëzuar*" dhe "*për të poseduar*" pronën e tij brenda kufijve të caktuara nga ligji. Posedimi si njëri prej tagrave të pronësisë ndonëse nuk përmendet shprehimisht në nenin 149 të Kodit Civil del nga përmbajtja e nenit 305 të Kodit Civil, nëpërmjet shprehjes "*posedim i është i ligjshëm kur posedhesi e ka posedimin nga pronari*". Nga ana tjetër, ligji i detyron të gjithë personat e tjerë që të mos kryejnë veprime të cilat i cënojnë apo shkelin tagrat e mësipërme të pronarit, me fjalë të tjera e pengojnë atë të ushtrojë të drejtën e posedimit, të gëzimit dhe disponimit. Në analizë të tre tagrave të pronarit, teoria e të drejtës civile mes **posedimit** (i cili kupton sundimin efektiv të pronës), dhe **gëzimit** (i cili ka të bëjë me përdorimin dhe shfrytëzimin e pronës për nxjerrjen e të ardhurave, frutave civile të tij), **disponimin** e konsideron si e drejta më thelbësore e pronarit. Me **"disponim"** kuptohet pikërisht e drejta e pronarit për të kryer veprime juridike në lidhje me sendet e paluajtshme në pronësi të tij, t'i tjetërsojë ato duke i shitur, apo dhuruar; t'i jape hua, apo me qira (në gëzim të përkohshëm); apo t'i lërë peng e t'i vërë hipoteke, sipas mënyrave të përcaktuara në Kodin Civil.[55]

172.1.5. Pronësia dhe posedimi janë gjendje juridike të ndryshme midis tyre edhe pse në gjuhën e përditshme të dy kuptimeve u jepet një vlerë e njëjtë. E para është gjendje juridike është e drejta mbi sendin sipas nenit 149 të Kodit Civil, e dyta është gjendje fakti. Kështu, në nenin 304 të Kodit Civil thuhet shprehimisht se: "***Posedimi është sundimi efektiv i një personi mbi një send dhe mbi të drejtat e tjera reale mbi atë. Posedimi mund të ushtrohet drejtpërdrejtë ose nga një person që mban sendin***". Kështu, posedim shpreh marrëdhënien më të ngushtë të faktit që mund të ekzistojë ndërmjet një sendi trupor dhe personit që e posedon atë, duke nënkuptuar ose (sipas etimologjise strikte të tij) një kontroll fizik aktual, si qëndrimi ulur, ose (si disa duan të kenë atë) duke qëndruar mbi një send.[56] Pra, posedimi është një marrëdhënie thjesht fakti e njeriut me sendet. Por, posedimi njëkohësisht është edhe një marrëdhënie juridike, mbasi ligji e lidhë këtë me efekte të ndryshme juridike në marrëdhëniet me personat e tjerë. Sipas doktrinës bashkëkohore që e ka zanafillën e saj në të

---

[52] Shiko Vendimin Nr. 5, datë 31.05.2011 i Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë.
[53] Shiko për më tepër Vendimin Nr. 30, datë 01.12.2005 të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë.
[54] Po aty (*Idem*).
[55] Shiko Vendimin Nr. 1, datë 06.01.2009 i Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë.
[56] Burrill, Law Dict. 313", Bryan v. Spivey, 109 NC 57, 13 So 766, 767 (1891).

drejtën Romake posedimi përbëhet nga dy elementë që janë: **a) Corpus-** elementi trupor (material) dhe **b) Animus-** vullneti (shpirti) ose qëllimi për ta mbajtur sendin. Elementi i dytë i posedimit animus - vullneti për të poseduar sendin, përcaktohet shprehimisht në nenin 169 të Kodit Civil nëpërmjet shprehjes *"duke u sjellë si pronar"*.[57] Kështu duke iu referuar dispozitave që rregullojnë posedimin e sendit, arrijmë në përfundimin se posedimi i sendit, realizohet nëpërmjet ekzistencës së të dy elementëve përbërës të tij ***corpus* dhe *animus***, ç'ka do të thotë, se poseduesi e posedon sendin vetëm në rast të plotësimit të të dy elementëve përbërës të sipercituar të tij: elementit fizik, që manifestohet në sundimin efektiv të sendit (corpus), edhe elementit psikologjik, që manifestohet në vullnetin e poseduesit për të poseduar sendin (animus domini).

**172.1.6.** Me pasuri në **"përdorim"** do të nënkuptojmë ato pasuri ku personi gëzon të drejtën e gëzimit të pasurisë, që lidhet me të drejtën e pronarit për ta përdorur ose për të mos e përdorur, mënyrën e përdorimit, transformimit dhe në fund të shkatërrimit të sendit.[58] Për sendet që prodhojnë fruta, e drejta e gëzimit të pronarit përfshinë edhe të drejtën për të përvetësuar frutet e sendit, qoftë këto frute natyrore ose civile. Gjithashtu, me pasuri në "përdorim" do të kuptojmë edhe pasuritë ku subjekti i rivlerësimit ka fituar ligjërisht të drejtën reale të uzufruktit,[59] përdorimit, banimit[60] dhe enfiteozës.[61] Megjithatë që të jemi përpara marrëdhënies juridike të uzufruktit, përdorimit, banimit dhe enfiteozës duhet që të respektohet forma e kryerjes së veprimit juridik. Kështu, në nenin 235 të Kodit Civil nën titullin **"Mënyra e krijimit"** parashikohet shprehimisht se: *"Uzufrukti që krijohet me veprim juridik __duhet të bëhet me akt noterial__, ndërsa kur fitohet me testament veprohet sipas dispozitave përkatëse.* ***Uzufrukti mbi një send të paluajtshëm duhet të regjistrohet në regjistrat e pasurive të paluajtshme."***, ndërsa në nenin 260 të këtij Kodi thuhet shprehimisht se: *"Dispozitat që kanë lidhje me uzufruktin zbatohen dhe për të drejtën e përdorimit dhe të banimit, për aq sa përputhen me këto të drejta."*. Ndërkohë në nenin 786 të Kodit Civile thuhet se: *"Kontrata e enfiteozës duhet të bëhet në formën që kërkohet për kalimin e pronësisë për pasuritë e paluajtshme."*.[62] Pra, për të drejtat reale forma e kryerjes së veprimit

---

[57] **Animus:** Qellimi me u sjelle kundrejt sendit si zotnues (për poseduesin legjitim) ose qellimi me e mbajt sendin n'interes e vet ose të tjeterit (për poseduesin prekar) asht i nevojshëm për vehtësimin e posedimit, po ashtu si elementi trupnuer (corpus): ay qi mban nji gja pa dashtë me ushtrue mbi të të drejtat e zotnuesit ose një të drejtë tjetër, nuk posedon, B. Benussi, fq. 244, Të njëjtin përkufizim jep edhe F. Galgano, fq.146, "Për të qënë posedues është i nevojshëm shpirti ose qëllimi për të poseduar, pra qëllimi për tu sjellë si pronar i sendit".

[58] Po aty, faqe 138.

[59] Në nenin 232 të Kodit Civil nën titullin **"Përmbajtja e uzufruktit"** parashikohet shprehimisht se: *"Uzufrukti është e drejta e një personi (uzufruktari) për të gëzuar një send që është në pronësi të një tjetri, me detyrim që ta ruajë e ta mirëmbajë atë."*.

[60] Në nenin 259 të Kodit Civil parashikohet shprehimisht se: ***"Personi që ka një të drejtë thjeshtë përdorimi mbi*** *një send, e përdor atë dhe gëzon frutet e tij në masën që ka nevojë për vete e për familjen e tij. Kur objekti i të drejtës së përdorimit është një banesë, personi ka të drejtë të banojë atje sipas nevojave të tij e të familjes së tij. Sendi ose banesa që përdoret sipas kësaj dispozite nuk mund të tjetërsohet, të rëndohet dhe as të përdoret nga persona të tjerë."*.

[61] Në nenin 784 të Kodit Civil nën titullin **"Kuptimi i enfiteozës"** parashikohet shprehimisht se: *"Enfiteoza është një kontratë, me të cilën një personi i jepet e drejta të përdorojë e të përmirësojë një pasuri të paluajtshme, kundrejt një shpërblimi periodik në të holla ose në natyrë."*.

[62] Në nenin 83 të Kodit Civile thuhet shprehimisht se: ***"Veprimi juridik për kalimin e pronësisë së sendeve të paluajtshme dhe të të drejtave reale mbi to, duhet të bëhet me akt noterial dhe të regjistrohet, përndryshe nuk është i vlefshëm. Është i pavlefshëm veprimi juridik që nuk është bërë në formën e kërkuar shprehimisht nga ligji."***

juridik me akt noterial është elementë thelbesor për vlefshmërinë e veprimit juridik, mungesa e të cilës e bën të pavlefshëm veprimin juridik. Në mungesë të një veprimi juridik të tillë, bën që personi të mos konsiderohet përdorues i një sendi të luajtshëm, të paluajtshëm apo i një të drejtë reale, por një mbajtës i thjeshtë i sendit nëse njeh pronësinë e personit që i ka kaluar nëndorësin. Kjo për faktin pasi edhe posedimi në vetvete sipas neneve 232, 259 dhe 784 të Kodit Civil për të ushtruar të drejtën e përdorimit të të drejtave reale duhet të kryehet me veprim juridik sipas nenit 309 të Kodit Civil.[63] Gjykata çmon se, koncepteve të pronësisë, posedimit dhe përdorimit të pasurisë nuk mund t'i jepet një interpretim më i zgjeruar se sa ai i dhënë nga kuadri ligjor në fuqi. Kjo për faktin pasi sipas jurisprudencës së GJEDNJ-së sa herë që jemi përpara kufizimit të të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, duhet bërë interpretimi sa më i kufizuar i ligjit, ndërsa kur jemi përpara zgjerimit të të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, duhet bërë interpretimi i zgjeruar. Ligji penal në vetvete sjellë si pasojë kufizimin e së drejtave dhe lirisë së personit. Prandaj, nuk lejohet interpretimi i zgjeruar;

**172.1.7. ç)** kryerjes së veprimeve financiare ose transaksioneve të copëzuara për shmangien nga raportimi, sipas legjislacionit për parandalimin e pastrimit të parave. Gjykata çmon se, kjo është një dispozitë blankete. Ndodhur në këto kushte, për të përcaktuar se kush janë ato veprimet ose transaksione që duhen raportuar duhet t'i referohemi Ligjit Nr. 9917, datë 19.05.2008 "Për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit" i ndryshuar. Kështu, në nenin 2 të këtij ligji nën titullin **"Përkufizime"** parashikohet shprehimisht se: *"Në këtë ligj termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:...16.* ***"Transaksion"*** *është një marrëdhënie biznesi apo një shkëmbim që përfshin dy ose më shumë palë. 17. "Transaksione të lidhura me njëri-tjetrin" janë dy ose më shumë transaksione (duke përfshirë transfertat e drejtpërdrejta), ku secila prej tyre është më i vogël se sa shuma e përcaktuar si prag, në bazë të nenit 4 të këtij ligji dhe kur këto transaksione në shumë totale barazojnë ose tejkalojnë shumën e pragut të zbatueshëm."*, ndërsa në nenin 4 të këtij ligji nën titullin **"Identifikimi i klientëve"** parashikohet shprehimisht se: *"1. Subjektet duhet të identifikojnë klientët dhe të verifikojnë identitetin e tyre me anë të dokumenteve të identifikimit: a) para se të vendosin një marrëdhënie biznesi; b) kur klienti, në raste të ndryshe nga ato të përcaktuara në shkronjën "a" të kësaj pike, kryen ose kërkon të kryejë një transfertë të drejtpërdrejtë brenda ose jashtë vendit në një shumë të barabartë ose më të madhe se* ***100 000 (njëqind mijë) lekë ose kundërvlerën e saj në monedha të huaja;*** *në* ***transaksion me një shumë të barabartë me: i) jo më pak se 200 000 (dyqind mijë) lekë ose kundërvlerën e saj në monedha të huaja*** *për subjektet e përcaktuara në shkronjat "a" dhe "g" të nenit 3 të këtij ligji; ii)* ***jo më pak se 1 500 000 (një milion e pesëqind mijë) lekë ose kundërvlerën e saj në monedha të tjera të huaja, kryer në një transaksion të vetëm, ose në disa transaksione të lidhura me njëritjetrin. Nëse shuma e transaksioneve nuk dihet në kohën e veprimit,*** *identifikimi duhet të kryhet sapo të bëhet e ditur shuma dhe të arrihet pragu i mësipërm;* ***c) kur ka*** *dyshime për vërtetësinë e të dhënave të identifikimit të marra më parë; ç) në të gjitha rastet kur ka të dhëna ose dyshime të mjaftueshme për pastrim parash ose financim të terrorizmit. 2. Subjektet duhet të identifikojnë dhe të verifikojnë identitetin e*

[63] Në nenin 309 të Kodit Civil nën titullin **"Mënyrat e fitimit të posedimit"** parashikohet shprehimisht se: ***"Posedimi fitohet me anë veprimesh juridike, me trashëgim dhe me pushtim. Ai që ka fituar posedimin me mirëbesim, mund të bashkojë në posedimin e vet, edhe kohën e posedimit me mirëbesim të personit nga i cili ka fituar sendin."***.

*pronarit përfitues.".* Gjithashtu, në nenin 12 të këtij ligji nën titullin **"Raportimi tek autoriteti përgjegjës"** parashikohet shprehimisht se: *"1. Subjektet i paraqesin një raport autoritetit përgjegjës, ku parashtrojnë dyshimet që kanë për rastet kur e dinë apo dyshojnë se po kryhet, është kryer apo tentohet të kryhet pastrimi i produkteve të veprës penale apo financimi i terrorizmit. Raportimi bëhet menjëherë dhe jo më vonë se periudha e përcaktuar në aktet nënligjore në zbatim të këtij ligji. 2. Kur subjekti, të cilit i kërkohet nga klienti të kryejë një transaksion, ka dyshime se transaksioni mund të përfshijë pastrim parash ose financim terrorizmi, ai duhet t'ia raportojë menjëherë çështjen autoritetit përgjegjës dhe të kërkojë udhëzime nëse duhet ta kryejë apo jo transaksionin. Autoriteti përgjegjës është i detyruar të kthejë përgjigje brenda 48 orëve. 3. Subjekteve u kërkohet t'i raportojnë autoritetit përgjegjës, sipas afateve të përcaktuara në aktet nënligjore, në zbatim të këtij ligji, të gjitha transaksionet në para fizike, në një vlerë të barabartë ose më të madhe se 1 500 000 (një milion e pesëqind mijë) lekë ose kundërvlerën në monedha të huaja, të kryera si një transaksion i vetëm ose si transaksione të lidhura me njëra-tjetrën. 4. Subjektet e përcaktuara në shkronjat "a" dhe "b" të nenit 3 të këtij ligji duhet t'i raportojnë autoritetit përgjegjës, sipas afateve të përcaktuara në aktet nënligjore në zbatim të këtij ligji, të gjitha transaksionet jo në para fizike, në një shumë të barabartë në vlerë ose më të madhe se 6 000 000 (gjashtë milionë) lekë ose kundërvlerën në monedha të huaja, të kryera si një transaksion i vetëm ose si transaksione të lidhura me njëra-tjetrën"*, ndërsa në nenin 17 të këtij ligji nën titullin **"Raportimi i organeve doganore"** parashikohet se: *"1. Çdo person, shqiptar ose i huaj, i cili hyn/largohet në/nga territori i Republikës së Shqipërisë është i detyruar të deklarojë shumat në të holla, çdo lloj instrumenti të negociueshëm, metalet ose gurët e çmuar, sendet me vlerë dhe objektet antike,* ***duke filluar nga shuma 1 000 000 (një milion) lekë ose kundërvlera e saj në monedha të tjera të huaja****, si dhe qëllimin e mbartjes së tyre, për të cilat duhet të paraqesë dokumente justifikuese. Autoritetet doganore duhet të dërgojnë tek autoriteti përgjegjës kopje të formularëve të deklarimeve të mësipërme dhe të dokumenteve justifikuese të paraqitura. Autoritetet doganore duhet t'i raportojnë menjëherë dhe jo më vonë se 72 orë autoritetit përgjegjës çdo dyshim, informacion ose të dhënë, që kanë lidhje me pastrim parash ose financim terrorizmi, për veprimtaritë nën juridiksionin e tyre. 2. Organet doganore zbatojnë kërkesat e nenit 11 të këtij ligji."*. Po ashtu, në nenin 19 të këtij ligji nën titullin **"Raportimi i Zyrës Qendrore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme"** parashikohet shprehimisht se: *"1. Zyra Qendrore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme raporton brenda 72 orëve regjistrimin e kontratës së* ***tjetërsimit të pronës me një vlerë të barabartë ose më të madhe se 6 000 000 (gjashtë milionë) lekë ose kundërvlerën e saj në monedha të tjera të huaja****. 2. Zyra Qendrore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme raporton menjëherë dhe jo më vonë se 72 orë pranë autoritetit përgjegjës çdo dyshim, informacion ose të dhëna për pastrim parash apo financim terrorizmi për veprimtaritë nën juridiksionin e vet. 3. Zyra Qendrore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme zbaton kërkesat e neneve 5 dhe 11 të këtij ligji."*. Gjithashtu, nga ana objektive kjo figurë e veprës penale kryhet nëpërmjet: **d)** investimit në veprimtari ekonomike ose financiare të parave a sendeve, duke ditur se janë produkte të veprës penale ose veprimtarisë kriminale dhe **dh)** këshillimit, ndihmës, nxitjes ose thirrjes publike për kryerjen e secilës prej veprave të përcaktuara më sipër.

172.1.8. Rrethana cilësuese parashikohen në paragrafin e dytë të nenit 287 të Kosit
Penal në rastet kur kjo vepër kryhet gjatë ushtrimit të një veprimtarie profesionale, në
bashkëpunim[64] ose më shumë se një here, kur ajo është kryer më parë dhe pas saj, kryhet
edhe herë të tjera. Gjithashtu, kusht i domosdoshëm është që i pandehuri të mos ketë qënë
dënuar më parë për ndonjë nga episodet për të cilën kërkohet të gjykohet, sepse ndryshe
quhet përsëritës në kuptimin e nenit 50 të Kodit Penal. Ndërsa në paragrafin e tretë të nenit
287 Kodit Penal parashikohet shprehimisht: ***"E njëjta vepër, kur ka sjellë pasoja të rënda,
dënohet jo më pak se pesëmbëdhjetë vjet me burgim."***. Ashtu si shumica e kodeve penale në
përputhje me detyrimet e akteve ndërkombëtare të ratifikuara dhe rekomandimet e FATF e të
Këshillit të Evropës, rezulton se dispozitat e nenit 287 të Kodit Penal zbatohen edhe kur
vepra penale, produktet e së cilës pastrohen, është kryer nga një person që nuk mund të
merret si i pandehur ose që nuk mund të dënohet, ose është kryer nga një person, pavarësisht
shtetësisë së tij, jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë dhe është njëkohësisht e
dënueshme, si në shtetin e huaj, ashtu edhe në Republikën e Shqipërisë. Ndryshimet e bëra në
Kodin penal me ligjin Nr. 23 datë 01.03.2012 janë në përputhje të plotë dhe me detyrimet e
Konventës së Varshavës të vitit 2005, ratifikuar nga Kuvendi i Shqipërisë, në Nenin 9 të së
cilës parashikohet se *"çdo palë do të sigurojë që një dënim i mëparshëm ose i njëkohshëm
për veprën penale kryesore nuk është parakusht për një dënim për pastrim parash"*. Gjykata,
arsyeton më tej se çmon me rëndësi në këtë pikë, të evidentojë faktin se midis produktit të
veprës penale *(vepra penale mëmë)* nga njëra anë dhe veprës penale të pastrimit të këtij
produkti *(vepra penale bijë)*, duhet të ekzistojë gjithmonë lidhje shkakësore ekskluzive dhe e
domosdoshme *(condicio sine qua non)*. Pra, nëse nuk kemi të konsumuar nga ana objektive
një vepër penale mëmë nuk mund të flitet për pastrim të produktit të saj, pasi produkti sipas
nenit 287 të Kodit Penal, duhet të rrjedhë si rezultat i një fakti i cili parashikohet nga ligji si
vepër penale. Prandaj, në çdo rast duhet që midis veprimeve të autorit të veprës penale që
synojnë pastrimin e produktit të veprës penale dhe pasojës apo mundësisë së ardhjes së
pasojës, pastrimi i produktit të veprës penale, duhet të ekzistojë lidhje shkakësore.

172.2. Duke u rikthyer në rastin konkret, Gjykata çmon se për personat nën hetim
**Erion Veliaj, Ajola Xoxa dhe Elman Abule**, ekzistojnë dyshime të arsyeshme se kanë
konsumuar elementët e figurës së veprës penale *"Pastrimi i produkteve të veprës penale ose
veprimtarisë kriminale"*, kryer në bashkëpunim dhe më shumë se një herë, parashikuar nga
neni 287/2 i Kodit Penal. Kjo për këto arsye:

**172.3.Së pari,** personat nën hetim **Erion Veliaj, Ajola Xoxa dhe Elman Abule** me
veprimet e tyre të kundërligjshme, të kryera në bashkëpunim dhe më shumë se një herë, të
cilat konsistojnë në integrimin në sistemin bankar të shumave monetare të siguruara si
përfitime të parregullta, por edhe të fshehjes ose mbulimit të natyrës së vërtetë së pasurisë, në
kushtet kur këto pasuri dihet se janë produkte të veprës penale sipas nenit 260 të Kodit Penal,
shtetasit e dyshuar kanë përmbushur elementët e parashikuar në gërmat *a)* dhe *b)* të

[64] **Kolegjet e Bashkuara në vendimin Nr. 4 datë 15.04.2011, kanë unifikuar praktikën gjyqësore në lidhje
me bashkëpunimin në kryerjen e veprës penale duke përcaktuar se:** *"Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së
Lartë vlerësojnë se që të ndodhemi në kushtet e bashkëpunimit duhet të bashkekzistojnë si kushte sine qua non:
1. dy ose më shumë subjekte (pluralitet personash); 2. realizimi i faktit kriminal në të gjithë elementet e tij
materiale; 3. dhënia e një kontributi rilevant në kryerjen e veprës penale nga secili prej bashkëpunëtorëve; 4.
ana subjektive, të paktën në formën e saj minimale, që është dijenia e të paktën njërit prej bashkëpunëtorëve për
të bashkëpunuar me të tjerët në kryerjen e faktit kriminal."*.

dispozitës, forma objektive këto të kryerjes se veprës penale sipas nenit 287 të Kodit Penal, kryer në bashkëpunim sipas paragrafit të dytë. Qëllimi kriminal i personave nën hetim për integrimin në sistemin bankar të shumave monetare të cilat janë rezultat i përfitimeve të parregullta, do të ishte i pamundur të përmbushej pa rolin përcaktues të subjekteve të tjera tregtare, shpk dhe OJF, të identifikuar deri tani në regjistrin e njoftimit të veprave penale. OJF-të "Harabel", "Eventus", "Muza" dhe "BYL-A", të kontrolluara plotësisht nga shtetësja nën hetim Ajola Xoxa, deri në këtë fazë të hetimit paraprak dyshohet të kenë kryer veprime konkrete të kundërligjshme në drejtim të pastrimit të produkteve të veprës penale, nëpërmjet transferimit të pasurisë me qëllim fshehjen ose mbulimin e origjinës së paligjshme të saj, duke ditur se këto pasuri janë produkt i veprës penale sipas nenit 260 të Kodit Penal. Në këtë këndvështrim, OJF-të "Eventus", "Muza" dhe "BYL-A", por edhe OJF "Frobolous", dyshohet të kenë kryer veprime aktive të kundërligjshme të cilat përmbajnë elementë të veprës penale të parashikuar nga neni 245 i Kodit Penal. Deri në këtë moment, përtej episodeve të evidentuara të cilat lidhen me këto subjekte, është arritur në konkluzionin se emrat tregtarë të këtyre OJF-ve duhen regjistruar në regjistrin e njoftimit të veprave penale dhe hetimet për to duhet të vijojnë. Kjo provohet me aktet procedurale të Prokurorisë së Posaçme të administruara nga gjykata.

**172.4. Së dyti,** qëllim kriminal për pastrimin e produkteve të veprës penale, që i referohet rastit të kalimit të të hollave nga shoqëritë e administruara **nga shtetasi Elman Abule** dhe familjarë të tij, do të ishte i pamundur të realizohej pa bashkëpunimin e këtij të fundit në kryerjen e veprimeve të kundërligjshme të cilat kanë kulmuar në pagesat e bëra për shoqëritë tregtare si edhe personat fizikë të kontrolluar nga shtetësja Ajola Xoxa. Komunikimet e zhvilluara mes shtetases Adela Kondakçiu dhe financieres së shoqërisë "Rametal" shpk, të përfaqësuar nga shtetasi nën hetim Elman Abule, por edhe shtetases Adela Kondakçiu dhe Marisa Nito (bashkëshortja e shtetasit Elman Abule), të cilat përfshijnë si lëshimin e faturave tërësisht fiktive ashtu edhe pagesat e bëra për "Partners Law" shpk, menjëherë sapo "Rametal" shpk është likuiduar nga Ministria e Kulturës, krijojnë dyshimin e arsyeshëm të bazuar në prova se qëllimi i këtyre transfertave bankare ka qenë "injektimi" në llogaritë e entiteteve tregtare të kontrolluara nga shtetësja Ajola Xoxa, të shumave monetare që janë produkt i veprimtarisë kriminale. Nga provat e administruara ekziston dyshimi i arsyeshëm i bazuar në prova se vetëm nga "Rametal" shpk dhe "Sapientia" shpk, sipas faturave të lëshuara, rakordimeve si dhe dokumenteve bankarë, "Partners Law" si edhe shoqëritë e kontrolluara faktikisht nga shtetësja Ajola Xoxa "Ava Studio" shpk dhe "Arts Lab" shpk, përfshirë këtu edhe personin fizik Greta Domi, **kanë arkëtuar një shumë totale prej <u>30,766,626 lekë.</u>** Gjykata çmon se veprimtaria kriminale e pastrimit të produkteve të veprës penale nga shtetasi Elman Abule nëpërmjet kompanive të tij, për të justifikuar të ardhurat nga shtetasit Ajola Xoxa dhe Erion Veliaj[65] sikur vijnë nga një veprimtari e ligjshme por që në të vërtetë kanë qenë fiktive, provohet nga analiza e të gjitha fakteve që përmenden në paragrafët **103, 103.1, 103.2, 103.3, 103.4, 103.5, 103.6, 103.6.1, 103.7, 103.8, 103.9, 103.10, 103.11, 103.12, 118, 118.1, 118.2, 118.3, 118.4, 118.5, 118.6, 118.6.1, 118.7, 118.8, 1188.1 dhe 118.8.2 të këtij vendimi.**

---

[65] Përfitues drejtpërdrejtë është dhe shtetasi Erion Veliaj për shkak të regjimit të bashkësisë ligjore. Por jo vetëm nga ky fakt pasi të gjitha burimet e paligjshme nga analiza e provave rezultojnë të vijnë për shkak të detyrës së ushtruar nga ky i fundit si Kryetar i Bashkisë Tiranë.

**172.4.1.** Konkretisht me mjaft interes për çështjen objekt gjykimi, me qëllim për të kuptuar si financohen shoqëritë me përgjegjësi të kufizuar të krijuara nga familjarë të afërt të shtetases Ajola Xoxa, por të kontrolluara faktikisht nga kjo e fundit, janë edhe komunikimet mes shtetases **Adela Kondakçiu dhe një personi tjetër, emri i të cilit në aparatin celular të kësaj shtetase është regjistruar "Financa Rametal"**. Konkretisht, në faqen 1 kjo shtetase që duket se eshtë e seksit femër, i shkruan Adela Kondakçiut duke i thënë se është ekonomistja e Marisës. **Në këtë rast bëhet fjalë për shtetasen Marisa Nito, bashkëshortja e shtetasit Elman Abule, pronar i "Rametal" shpk.** Në faqen 2 ekonomistja e "Rametal" shpk njofton Adelën *se do bëjë një kalim 20 (duket se bëhet fjalë për shumë të hollash) në ditën e komunikimit, pra më datë 15.11.2022.* Për këtë kalim, kjo shtetase pyet *se cilën nga faturat do ishte më mirë të mbyllte.* Adela i përgjigjet: ***Të lutem nëse mund të bësh një faturë që është nga Greta Domi Person Fizik dhe pjesën tjetër pastaj te Arts Lab.*** Ekonomistja i përgjigjet: *në rregull.* **Gjykata çmon se faturat janë lëshuar nga personi fizik Greta Domi në mënyrë krejt fiktive, duke patur në konsideratë këtu edhe mënyrën si funksionin këta persona fizikë pranë zyrës së shtetases Ajola Xoxa, por edhe përsa kohë vetë ekonomistja e "Rametal" shpk nuk ka asnjë ide për këtë fakt, duke thënë vetëm dakord.** Kjo provohet edhe më tej nga komunikimet e datës 09.01.2023, në faqen 6, ku ekonomistja e "Rametal" shpk, i lejon vetes të mendojë për shpërndarjen e të hollave mes shoqërive që kontrollohen nga Ajola Xoxa. Konkretisht, ekonomistja e "Rametal" shpk, në faqen 6 i komunikon Adela Kondakçiut: ***Do bëj një likujdim sot prej 20.000 (duket se është në monedhën euro). Cilën nga shoqëritë të mbyll? MENDOVA 12 AVA STUDIO DHE 8 NGA ARTS LAB. Eshtë ok? DHE PASTAJ NA MBETET 25 NGA ARTS LAB.*** **Pra, rezulton e qartë se shpk në fjalë kanë faturuar për shërbime të pakryera ndonjëherë, përsa kohë nuk kanë çfarë të ofrojnë duke patur parasysh objektin e aktivitetit të tyre në raport me një shoqëri që operon në fushën e aluminit si "Rametal" shpk, por edhe shoqëritë e tjera që zotërohen nga bashkëshortët Elman Abule** dhe **Marisa Nito.**

**172.4.2. Vetë komunikimet e ekonomistes së "Rametal" shpk, e cila vendos si do shpërndahen fondet, <u>pra rëndësi ka që të shpërndahen dhe jo se kujt i shpërndahen</u>, provon më tej fiktivitetin e pagesave që kryhen për shërbime të supozuara të ofruara nga shpk e kontrolluara nga shtetësja** Ajola Xoxa. Mbahet në konsideratë këtu edhe njëherë se, **"Ava Studio"** është themeluar nga shtetësja Valbona Xoxa dhe "Arts Lab" shpk nga shtetasi Erald Simixhiu, **përkatësisht** nëna dhe daja i **shtetases** Ajola Xoxa. Të dyja shoqëritë kanë karakter fitimprurës. **Adela,** në lidhje me **këtë bisedë** i thotë në faqen 7: ***Po më mirë të mbyllni <u>Ava një herë.</u>*** Ekonomistja i përgjigjet: *Në rregull.* Por pagesat nga "Rametal" shpk vijojnë: Në faqen 9 Adela *i kërkon ekonomistes të konfirmojë pagesat që kane mbetur për t'u bërë nga Rametal.* Përgjigja e dërguar në faqen 11 është: ***Ndjesë për vonesën por kam genë e zënë dje, Detyrimi i Rametalit: Partners=25.200 euro.*** *Ava Studio=18000 euro.* ***<u>Është edhe diçka e hapur me kompaninë Jedas por nuk jam shumë e qartë.</u>*** Pra, "Rametal" shpk i detyrohet ende "Partners Laë" shpk të shtetases Ajola Xoxa <u>25.200 Euro</u> dhe "Ava Studio" shpk të Valbona Xoxa, nënës së Ajola Xoxa, kontrolluar *de facto* nga kjo e fundit, një shumë prej <u>18.000 euro</u>. **Por, ekonomistja njofton financieren e shtetases Ajola Xoxa që ka dhe diçka të hapur (supozohet një pagesë) me kompaninë Jedas**, e cila shfaqet për herë të parë në komunikimet. Madje ajo shton: *nuk jam shumë e qartë.* ***<u>Është bisedë ndërmjet shefave</u>***. <u>Këto komunikime që dëshmojnë mënyrën e financimit</u>

të shtetases Ajola Xoxa tek të dy shoqëritë e menaxhuara prej saj, prej një subjekti tregtar pronari i të cilit rezulton i lidhur ngushtë me bashkinë Tiranë, si për shkak të njohjes personale me kryetarin e saj Erion Veliaj ashtu edhe me përfitime të lidhura me bashkinë që ky shtetas drejton, hedhin edhe pikëpyetje në lidhje me një shoqëri tjetër, të emërtuar Jedas, për të cilën ekonomistja e "Rametal" shpk jep llogari që ka disa pagesa të palikuiduara tek financierja e shtetases Ajola Xoxa, Adela Kondakçiu. Adela nga ana e saj, në faqen 12 i kthen përgjigjen: ***Jemi në rregull për Rametal. PËR JEDAS KAM FOLUR ME SHEFEN SKA PROBLEM*. Duke patur në konsideratë se "shefja" e Adelës, referuar të gjitha komunikimeve nga organi procedues, është shtetësja Ajola Xoxa, duket se ekziston dyshimi që edhe shoqëria "Jedas", ka lidhje me këtë të fundit.**

**172.4.3.** Më tej, ekonomistja e "Rametal" shpk i thotë Adelës në faqen 13: ***Sapo mora një konfirmim nga shefi. Javën e ardhshme do procedojmë me një pagesë prej 30.000 (supozohet në monedhën Euro).*** Në faqen 15 Adela i kërkon të konfirmojë *nëse është bërë ndonjë pagesë*. Ekonomistja i përgjigjet në faqen 16: ***Brenda ditës së premte do mbyllim të gjitha faturat sipas konfirmimit me shefat.*** Në fakt, në faqen 18 të komunikimeve ekonomistja e "Rametal" shpk i dërgon Adelës dy pagesa të kryera më datë 20.09.2023. Konkretisht bëhet fjalë për pagesën e bërë për "Partners Law" shpk në shumën prej 37.200 Euro, për likuidim të faturave nr. 3/2023, 4/2023, 17/2023. Pagesa tjetër bëhet për "Ava Studio" në shumën 18.000 euro, për likujdim të faturës 2/2023. Por, pasi e falënderon, Adela Kondakçiu i kujton *se janë dhe disa fatura që janë lëshuar për shoqërinë "Sapienta" dhe që duhej të fliste një herë për pagesat e tyre. Faqe 19.* **Paraprakisht sipas organit procedues duhet sqaruar se, shoqëria "Sapientia" e formës tregtare me përgjegjësi të kufizuar, është themeluar dhe përfaqësohet nga shtetësja Marisa Nito, bashkëshorte e shtetasit Elman Abule, i cili zotëron shoqërinë "Rametal" shpk, që ka kryer pagesat e përmendura më sipër.** Por pagesat mesa kuptohet nga komunikimet dhe siç rezulton dhe nga dokumentet bankare, nuk bëhen veç nga shoqëria "Rametal" shpk në favor të bashkëshortës së kryetarit të bashkisë por edhe vjehrrës së këtij të fundit, por edhe nga shoqëria tjetër e bashkëshortes së pronarit të Rametal, "Sapienta", shtetësja Marisa Nito. **Me interes këtu është fakti se kjo shoqëri, pra "Sapienta" ka për objekt të aktivitetit të saj tregtar edhe ofrimin e shërbimeve për konsulencë ligjore. Duke patur këtë kapacitet ekspertize, kjo shoqëri e krijuar për të ofruar shërbime konsulence ligjore paguan shifra të konsiderueshme në favor të një shoqërie tjetër që ka për objekt të njejtën fushë aktiviteti, atë të shërbimeve ligjore, pra "Partners Laë" shpk. Pa përmendur këtu që do të ishte më e arsyeshme dhe e besueshme që edhe "Rametal" shpk, në pronësi të Elman Abules të shfrytëzonte ekspertizën ligjore të shoqërisë "Sapientia" shpk, në pronësi të bashkëshortes së tij Marisa Nito. Shfrytëzimi i një mundësie të tillë me siguri do rezultonte në fund edhe në uljen e shpenzimeve "astronomike" të treguara më poshtë, të bëra nga "Rametal" dhe "Sapientia" shpk në vetëm 2 vite, vetëm për konsulenca ligjore.**

**172.4.4.** Në vijim, në faqen 20, ekonomistja e "Rametal" shpk i thotë se *për Sapientën do të ketë konfirmimin javën e ardhshme, por në këtë pikë i kërkon një "nder"*. Ekonomistja i kërkon Adela Kondakçiut në faqen 20: ***Por të lutem faturën e fundit të datës 07.09 mundeni ta bëni me Rametal? Meqë akoma nuk është mbyllur muaji.* Pra, rezulton qartë që edhe nëse do pranojmë që ka patur vërtet një shërbim nga shoqëritë e kontrolluara nga**

**Ajola Xoxa, në rastin konkret nga "Partners Law" shpk, ky shërbim nuk ka qenë ofruar për "Rametal" shpk, por duket për një nga shoqëritë e tjera të kontrolluara nga bashkëshortët Elman Abule dhe Marisa Nito.** Pasi e saktëson për cilën faturë bëhet fjalë, dmth atë të lëshuar nga Partners, *Adela shprehet dakord për ta bërë për Rametal. Faqe 21.* Kjo rezulton akoma më qartë në faqen 22, kur Adela i thotë: ***FATURËN E MODIFIKOVA.*** Më pas i kërkon edhe *likujdimin e një fature nga Sapienta në vlerën* __*3.000 Euro*__*, e cila ka mbetur nga vitet e kaluara.* Ekonomistja ja konfirmon vlerën e vjetër prej 3.000 Euro dhe i thotë: *dhe 12 këtë vit.* Duke iu referuar faturës që është bërë ditën e sotme (datë 21.09.2023) për "Rametal" shpk, *pasi i ka kërkuar ta modifikojë atë. Faqe 24.* Në faqen 26, ekonomistja interesohet *nëse ka akoma fatura të paprera për "Rametal" shpk dhe Adela i përgjigjet në faqen 27 se ajo nuk ka asnjë faturë për të prerë.* Ekonomistja i përgjigjet: *Qartë.* Megjithatë, Adela i përgjigjet se ***do flasi njëherë me shefen, se nuk e di nëse e kanë diskutuar.*** Pas kësaj, ekonomistja i kërkon një kartelë dhe ajo nga ana e "Rametal" shpk po bën gati të tyren. *Faqe 28.* **Pra, rezulton e qartë se vetë "Rametal" shpk interesohet nëse ka pagesa të tjera për të bërë në favor të shoqërive të shtetases Ajola Xoxa.**

**172.4.5.** Në vijim, ekonomistja e Rametal i dërgon kartelën me detyrimet e "Rametal" shpk, ku përfshihen pagesat dhe faturimet. **Ky komunikim që gjëndet në faqen 30 ka në përmbajtje të tij tabelën përkatëse nga ku rezultojnë të dhëna me interes për hetimin.** Konkretisht, nga këqyrja e tabelës rezulton se "Rametal" shpk, **gjatë periudhës 2021-2023, ka marrë faturime nga "Partners Laë" shpk, "Ava Studio" shpk dhe Greta Domi PF një shumë të përgjithshme prej 191.800 euro.** Nga kjo shumë, nga e njëjta tabelë rezulton se janë paguar nga "Rametal" shpk, për "Partners Laë" shpk, "Ava Studio" shpk dhe Greta Domi PF, __**pra për shtetasen Ajola Xoxa, 179.800 euro.**__ Detyrimi i mbetur i "Rametal" shpk ndaj "Partners Laë" shpk është shënuar të jetë: 12.000 euro. Nuk mbaron me kaq. **Përsëri në këtë tabelë shfaqet shoqëria "Jedas" për detyrimet ndaj së cilës nuk kuptohet pse duhet të njoftohet financierja e Ajola Xoxës.** Për këtë shoqëri, konstatohet se, detyrimi i mbetur i "Rametal" shpk për vitet 2021-2023 është __**60.000 euro**__. __Ky detyrim, sipas shënimit të bërë është në CASH. Në këtë pikë duhet patur në konsideratë biseda e bërë më lart mes dy bashkebiseduesve, sipas së cilës për "Jedas"__ __**do bisedojnë "shefat"**, si edhe përgjigjen e dhënë më pas nga Adela Kondakçiu se për **Jedas ka folur me shefen** dhe nuk ka asnjë problem__, **për të krijuar dyshimin e arsyeshëm sipas organit procedues se detyrimi prej 60.000 euro, i shënuar si CASH ndaj shoqërisë "Jedas" do t'i likujdohet në këtë formë shtetases Ajola Xoxa.**

**172.4.6.** Megjithatë, detyrimet dhe pagesat e shoqërive të kontrolluara nga Elman Abule dhe bashkëshortja e tij Marisa Nito, duket se nuk përfundojnë me kaq. Në fund të tabelës janë përshkruar edhe detyrimet që shoqëria "Sapientia" shpk ka ndaj "Partners Laë" shpk dhe "Ava Studio" shpk, të cilat kapin shifrën e __30.000 euro__, nga të cilat __18.000 Euro__ për "Partners Laë" (viti 2021) dhe __12.000 Euro__ për "Ava Studio" shpk (viti 2023). Nga këto detyrime duket se janë likujduar __3.000 Euro__ për "Partners Laë" dhe __12.000 Euro__ për "Ava Studio" shpk, duke bërë që detyrimi i mbetur për të dyja shoqëritë të jetë në vlerën __15.000 Euro__. Në fund, sipas kësaj tabele detyrimi i mbetur ndaj këtyre shoqërive është __87.000 euro__, ndërsa pagesat e bëra në favor të tyre, duke hequr këtu pagesën cash për "Jedas" shpk, kap shifrën e __194.000 Euro në vetëm 2 vite__. __**Pra, në total shoqëritë e kontrolluara nga Ajola Xoxa, sipas kësaj tabele, përfitojnë nga shoqëritë e kontrolluara nga shtetasi Elman**__

**<u>Abule shumën prej 281.000 Euro në vetëm tre vjet</u>.** Shërbimet e ofruara kundrejt kësaj pagese janë për konsulencë ligjore.

**172.4.7.** Pas njihet me këtë kartelë, Adela Kondakçiu i kërkon në faqen 32 *të konfirmojë nëse pagesat janë mbyllur*. Përgjigja nga ekonomistja është negative. *Akoma nuk janë mbyllur*. Por kjo shtetase i thotë se *do komunikojë me shefat dhe besoj do i mbyllë të hënën e javës qe vjen maksimumi*. Në faqen 35 përsëri Adela Kondakçiu pyet ekonomisten e "Rametal" shpk *nëse pagesat janë mbyllur, por ajo i kërkon ndjesë dhe i thotë që do t'i procesojë javës tjetër*. Në fakt, javën pasardhëse, më datë 24.10.2023, në faqen 36 të komunikimeve Adela njoftohet nga ekonomistja se *është procesuar fatura e mbetur e Rametal*. Në lidhje me këtë, ekonomistja i *dërgon kalimin bankar i cili mban datën 23.10.2023, sipas të cilit Rametal shpk i kalon Partners Laë shpk edhe 12.000 euro të tjera, për likujdim faturash 25/22023 datë 21.09.2023*. Në këtë pikë konstatohet se detyrimi i "Rametal" shpk ndaj "Partners Law" është i mbyllur, duke bërë që detyrimi i mbetur të jetë tashmë <u>75.000 Euro.</u> Megjithatë, në faqen 37 Adela e pyet *nëse janë bërë pagesat e Sapientia shpk, por ekonomistja i thotë që për ato nuk ka akoma një datë, por do ta njoftojë*. Adela insiston për pagesat që duhet të bëhen nga "Sapienta" shpk, në faqen 38 te komunikimeve. Ekonomistja e "Rametal" shpk i përgjigjet *në faqen 39 se do t'i procesonte po atë ditë* (30.10.2023). Ekonomistja *i kërkon njëkohesisht edhe një kopje të faturës së vjetër prej 3.000 euro, e mbetur papaguar nga viti 2021*. Fatura së cilës i referohet mban numrin 62 datë 26.03.2021. Fatura që i dërgohet nga Adela Kondakçiu ka të bëjë me detyrimin që "Sapientia" shpk ka ndaj "Partners Laë" shpk për shumën e përgjithshme prej <u>18.000 euro,</u> nga e cila është likujduar <u>15.000euro</u> dhe mbeten <u>3.000 euro</u>, që ekonomistja kërkon ta likujdojë në këtë moment. **Fatura në fjalë, e cila ndodhet në faqen 40 dëshmon sa u tha më sipër. Pra, një shoqëri si "Sapientia" shpk, e krijuar ndër të tjera edhe për ofrim konsulence ligjore, paguan një shumë të konsiderueshme të hollash tek një shoqëri "konkurrente" si "Parners Laë" shpk, për të njëjtin shërbim që e disponon vetë.**

**172.4.8.** Më datë 30.10.2023, siç edhe dokumentohet nga komunikimet në faqen 42, "Sapientia" shpk shlyen dhe detyrimin e mbetur ndaj "Ava Studio" shpk, për likujdim fature nr. 258/2023, në masën <u>12.000 euro</u>. Kjo e fundit është themeluar nga nëna e shtetases Ajola Xoxa, Valbona Xoxa, por në fakt kontrollohet plotësisht nga e para. Pas kësaj, në faqen 43 ekonomistja i dërgon *edhe dokumentin bankar që provon likujdim prej <u>3.000</u> euro të mbetur pa paguar për shoqërinë "Partners Laë" shpk*. **Tashmë, detyrimi i "Rametal" shpk dhe "Sapientia" shpk ndaj shoqërive të kontrolluara faktikisht nga Ajola Xoxa është likujduar i plotë, pa përfshirë këtu shoqërinë "Jedas" shpk, për të cilën detyrimi në CASH është 60.000 Euro dhe për të cilin shtetësja Ajola Xoxa ka thënë se janë në rregull dhe nuk ka problem.** Në lidhje me këtë të fundit, ekonomistja e "Rametal" shpk, duke përforcuar edhe më tej dyshimet për një kontroll të mundshëm të shoqërisë "Jedas" nga shtetësja Ajola Xoxa, shprehet sa vijon në faqen 43: ***PASTAJ NA MBETET AJO 60-CJA QË ËSHTË KTHIM CASH. POR MESA DI UNE DO E DISKUTOJNE EDHE NJEHERE SI DO TA MBYLLIN (DO BEHEN FATURA APO JO)***. Adela Kondakçiu i përgjigjet në faqen 44: ***Ok, në rregull. Kur të vendosin i bëjmë.***

**172.4.9.** Në faqen 46 nis një tjetër bisedë me interes për hetimin. Ekonomistja i nis Adela Kondakçiut *disa foto që duket se kanë lidhje në përmbajtje të tyre me dy kontratë qiraje të lidhura mes "Rametal" shpk dhe TKOB*. Konkretisht, sipas njërës kontratë,

"Rametal" shpk merr përsipër të japë me qira, pra të përfitojë të ardhura nga TKOB nëpërmjet qirasë në këtë rast, një seri artikujsh të përcaktuar në aneks, për baletin "Preljocaj". Po kështu, në kontratën tjetër "Rametal" shpk i jep me qira TKOB një seri artikujsh skenikë, këtë radhë për eventin "Sonoma", i përmendur më lart kur folëm për financimet e marra nga "BYL-A" prej Bashkisë Tiranë dhe KRK-së. Shumat e qirasë për rastin e baletit "Preljocaj" janë 1.213.380 lekë dhe për "Sonoma" 1.868.220 lekë. Këto shuma është rënë dakord të kalohen në llogarinë bankare të "Rametal" shpk me përfaqësues shtetasin Elman Abule, i cili ka nënshkruar dhe kontratat, me transfertën përkatëse bankare. Në këtë moment, Adela Kondakçiu, në faqen 52 i thotë bashkëbiseduese: ***Për pjesën e rakordimit bashkë do flas me shefen.*** Ekonomistja i përgjigjet: *Po pa merak. Këtë e zgjidhim.* **Deri në këtë moment, edhe pse është e qartë se "Rametal" shpk financon në mënyrë jo të drejtpërdrejtë eventet artistike të organizuara nga OJF-të e shtetases Ajola Xoxa, sipas organit procedues nuk kuptohet pse këto kontrata qiraje janë objekt diskutimi mes dy financiereve.** Më pas, në lidhje me këtë nis të kuptohet diçka, kur Adela Kondakçiu në faqen 55 *i kërkon ekonomistes të dijë sa është diferenca për t'u faturuar nga ata (kuptohet nga OJF që organizon eventin).* Ekonomistja i përgjigjet: ***8326.25 (euro) është pagesa që kemi bërë ne për La Veronal.*** Adela i thotë se *sipas llogarive të saj i bie një vlerë prej 2.016.000 lekë me tvsh dhe kërkon konfirmimin për këtë.* Pasi merr kohë, ekonomistja i përgjigjet në faqen 57 se: *Totali i faturës të TOB është 36.436 euro, prej së cilës duhet të zbriten 8326 euro pagesa për La Veronal dhe 6072 euro TVSH. Në përfundim vlera është 22.037 euro.* Adela i përgjigjet në faqen 5859 se *ajo nuk i ka vlerat totale, por ka një konfirmim nga Keti (Ketrina Braho-Harabel) vetëm vlerën 28.800 euro e cila duhet të mbulohet nga Rametal shpk.* **Interesant në këtë pikë është fakti se kjo vlerë që duhet të mbulohet nga "Rametal" shpk, pra duhet të faturohet nga një prej OJF-ve ose shoqërive të Ajola Xoxës (sic më poshtë do tregojmë) është pak a shumë** (*sic shprehet në vijim ekonomistja e Rametal*) ***me vlerën e faturave të lëshuara nga Rametal për TOB.***

**172.4.10.** Në faqen 59 të komunikimeve Ekonomistja i dërgon dy fatura të prodhuara nga "Rametal" shpk për Teatrin e Operas, për vlerën 1.456.056 lekë dhe 2.241.864 lekë. Në faqen 61 Adela Kondakçiu i thotë që, *në mënyrë që edhe Rametal mos paguajë tvsh, fatura të mos bëhen tani në dhjetor.* Ekonomistja i përgjigjet në faqen 62: *Më mirë për ne me TVSH.* Në vijim Adela Kondakçiu e pyet në faqen 63: ***Po përshkrimet në fatura si doni që t'i bëjmë?*** Ekonomistja ja kthen: ***KA NDONJË HAPESIRË TË NA I BËNI NGA HARABEL FATURAT?*** Adela i përgjigjet po në faqen 63: ***NËSE E BËJMË NGA HARABEL I BIJE QË DO E BËJMË SPONSORIZIM. ËSHTË DHE PA TVSH NË FAKT (faqe 64).*** **Pra, nga këto komunikime më së paku rezulton e qartë se faturat që lëshohen nga OJF e shtetases Ajola Xoxa janë fiktive në shërbimet që supozohet të kenë ofruar. Në këtë rast, nga Rametal shpk kërkohet që një OJF të lëshojë faturë për një shpk si "Rametal" shpk, por kjo duket e pamundur objektivisht, pasi një organizatë jofitimprurëse mund të përfitojë vetëm sponsorizime nga subjekte të tjera private. Akoma më qartë del qëllimi i bashkëbiseduesve për të prodhuar fatura të cilat nuk pasqyrojnë realisht shërbimin e kërkuar dhe të ofruar, por shërbejnë vetëm për të kaluar shumën e të hollave tek llogaria bankare e "Partners Lab".** Konkretisht, në faqen 64, ekonomistja i përgjigjet Adela Kondakçiut: ***Shiko, nëse ju pret puna e bëjmë pas pushimeve. Në të kundërt bëje nga PARTNERS. ÇA TË THEM. Se nuk e di as unë tani.*** Adela vijon duke e

pyetur: ***Po të bëjmë faturë qira për pajisje nga një shpk?*** ***Jo Partners dmth*** *faqe 65-66.* **Edhe nga kjo rezulton e qartë se faturat që do të lëshohen në emër të "Rametal" shpk, nga OJF-të e kontrolluara nga shtetësja Ajola Xoxa, janë tërësisht fiktive.** Ekonomistja i përgjigjet: *Po edhe ashtu mirë është. faqe 66.*

**172.4.11.** Në vijim kujtohet dhe shton: ***Po i bie që edhe kontratën që bëm për Preljocaj duhet ta bëjmë me këtë shpk që do na bëni faturën. Se nuk lidhen pastaj.*** ***Faqe 66.*** Adela Kondakçiu i thotë që me *Preljocaj kanë bërë transport.* Ekonomistja i thotë *edhe pajisje* dhe shton: ***SE IDEJA ËSHTË QË NE KEMI NJË KONTRATË ME PRELJOCAJ POR SKEMI FATURË. DHE PËR ATË JEMI ZBULUAR. Faqe 68.*** Në këtë moment, Adela Kondakçiu e pyet ***nëse këtë kontratë e kanë dorëzuar diku, por ekonomistja e Rametal i përgjigjet: Deri tani jo. Vetëm noterja e ka. Faqe 68.*** Në faqen 69 Adela Kondakçiu i drejtohet ekonomistes duke i thënë: ***Doja të njoftoja që po bëj këtë faturën për Rametal sot për diferencat e TOB.*** ***Faturën do e bëj nga Partners Law*** ***edhe do të jetë me TVSH. Faqe 70.*** **Pra, më në fund vendosin se nga do lëshohet fatura dhe shoqëria është "Partners Laë" shpk e shtetases Ajola Xoxa.** Ekonomistja i përgjigjet: *Në rregull. Faqe 71.* Adela Kondakçiu i dërgon vlerën: *22.000 euro plus tvsh, Faqe 71.* Përgjigja është: *ok. Faqe 72.* Në faqen 72, Adela Kondakçiu i kërkon ekonomistes *të konfirmojë nëse është bërë pagesa e faturës për Partners.* Ekonomistja i përgjigjet në faqen 73 se *akoma nuk e kanë mbyllur dhe do e njoftojë sapo të procesohet.*

**172.4.12.** I pyetur në datë **09.01.2025**, si person që ka dijeni për veprën penale, **shtetasi Elman Abule**, bashkëshorti i shtetases Marisa Nito si dhe pronar i disa kompanive si Rametal Shpk, Ventus Shpk, Fidalba Shpk, shpjegon ndër të tjera **shpjegon se për vendimmarrje të mëdha financiare, për pagesat e faturave në vlera të mëdha vendos vetë ai,** ndërkohë që për pagesa të vogla i lë një buxhet të caktuar ekonomistes me qëllim kryerjen e pagesave. I **pyetur për marrëdhënien me shtetasin Erion Veliaj, deklaruesi ka shpjeguar** *se e konsideron* ***shok dhe në gjykimin e tij,*** *mendon se edhe* ***Erioni*** *e konsideron* ***shok.*** **Sqaron** *se bashkëshortet e tyre janë shoqe me njëra tjetrën.* **Po kështu, ka treguar** *se* ***me shtetasin Erion Veliaj ka bërë disa udhëtime jashtë vendit, si në Tokio, Itali, Angli, Hollandë, Ukrainë.*** Në lidhje me këto udhëtime deklaruesi ka dhënë edhe detaje, duke shpjeguar *se udhëtimi për në Tokio është bërë para vitit 2020, kanë qëndruar 4-5 ditë.* **Deklaruesi shpjegon** ***se kanë udhëtuar të katërt, pra, Erioni, ai vetë dhe bashkëshortet e tyre.*** Udhëtimi është bërë në itinerarin Tiranë-Stamboll-Tokio. Shpjegon se *secili ka paguar shpenzimet e tij.* Elmani Abule mohon t'i ketë paguar ndonjë gjë Erionit. Gjithashtu, deklaruesi shprehet se *nuk mban mend nëse nga* ***Tirana*** *në Stamboll kanë udhëtuar së bashku me bashkëshortet* ***Veliaj-Xoxa****, por di me siguri që nga* ***Stambolli*** *për në* ***Tokio*** *kanë qenë në të njëjtin avion.* **Në lidhje me udhëtimin në Kiev, deklaruesi** ***sqaron se shtetasi Erion Veliaj do të zhvillonte një takim me kryetarin e Bashkisë së Kievit, dhe në këtë udhëtim shpjegon se shkoi edhe ai për qejf.*** Deklaruesi shpjegon *se nuk ka marrë pjesë në takimet e zhvilluara nga Erioni në Kiev.* Shpjegon gjithashtu *se kanë qëndruar në të njëjtin hotel në Kiev.* Shpenzimet e tij, Elman Abule tregon *se i ka mbuluar vetë, ndërsa për Erionin nuk ka dijeni pasi ai ishte me vizitë zyrtare.*

**172.4.13.** I Në nenin 45 të Kodit Penal nën titullin **"Zbatimi i ligjit penal ndaj personave juridikë"** parashikohet shprehimisht se: ***"Personat juridikë,*** *me përjashtim të institucioneve shtetërore,* ***përgjigjen penalisht për vepra penale, të kryera në emër*** *ose* ***në***

***dobi të tyre nga organet dhe përfaqësuesit e tyre.*** *Njësitë e qeverisjes vendore përgjigjen penalisht vetëm për veprime të kryera gjatë ushtrimit të veprimtarisë së tyre, të cilat mund të ushtrohen nëpërmjet delegimit të shërbimeve publike.* ***Përgjegjësia penale e personave juridikë nuk përjashton atë të personave fizikë, të cilët kanë kryer ose janë bashkëpunëtorë në kryerjen e të njëjtave vepra penale.*** *Veprat penale dhe masat ndëshkuese përkatëse, që zbatohen ndaj personave juridikë, si dhe procedura për vendosjen dhe ekzekutimin e tyre rregullohen me ligj të veçantë."*. Më tej përgjegjësia penale e personave juridik është rregulluar me Ligjin Nr. 9754, datë 14.06.2007 "Për përgjegjësinë penale të personave juridik". Kështu, në nenin 3 të këtij ligji nën titullin **"Përgjegjësia e personit juridik për kryerjen e veprës penale"** parashikohet shprehimisht se: *"Personi juridik ka përgjegjësi për vepra penale të kryera: a)* ***në emër ose në dobi të tij, nga organet dhe përfaqësuesit e tij;*** *b) në emër ose në dobi të tij, nga një person, që është nën autoritetin e personit që përfaqëson, drejton dhe administron personin juridik;* ***c) në emër ose në dobi të tij, për shkak të mungesës së kontrollit apo të mbikëqyrjes nga personi që drejton, përfaqëson dhe administron personin juridik."***, ndërsa në nenin 4 të këtij ligji nën titullin **"Organe dhe përfaqësues që veprojnë në emër ose në dobi të personit juridik"** parashikohet shprehimisht se: *"Në kuptim të nenit 3 shkronja "a" të këtij ligji,* ***organ dhe përfaqësues i personit juridik, që vepron në emër ose në dobi të personit juridik, është çdo person fizik, i cili, sipas ligjit ose akteve të personit juridik,*** *është ngarkuar për përfaqësimin, drejtimin, administrimin ose kontrollin e fushës së veprimtarisë* ***së personit juridik dhe të strukturave të tij."***. Gjykata çmon se mungesa e kontrollit apo mbikëqyrjes se personit juridik që shoqërohen me kryejen e një vepre penale mund të sjellë përgjegjësi penale si për personin juridik ashtu dhe personin/at fizik që sipas ligjit ose akteve të personit juridik, është ngarkuar për përfaqësimin, drejtimin, administrimin ose kontrollin e fushës së veprimtarisë së personit juridik dhe të strukturave të tij. Në rastin konkret, Gjykata çmon se ekziston dyshimi i arsyeshëm se vepra penale "*Pastrimi i produkteve të veprës penale apo i veprimtarisë kriminale*" të parashikuara nga neni 287. të Kodit Penal, e kryer në rrethanën cilësuese "*në bashkëpunim*" dhe "më shumë se një herë" sipas nenit 287, paragrafi (2) i Kodit Penal, janë kryer në emër dhe për llogari të personave juridik që administrohen dhe janë në pronësi të personit nën hetim **Elman Abule**.

**173. Në lidhje me anën subjektive të figurës së veprës penale *"Pastrimi i produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale"*.** Gjykata vlerëson se, kjo vepër penale kryhet vetëm me dashje direkte, në kuptimin që, autori i veprës penale e parashikon dhe e dëshiron ardhjen e pasojës, pastrimin e produktit të veprës penale, pra ai ka dijeni se pasuria apo avantazhi ekonomik i ardhur nga vepra penale mëmë, përbën produkt të veprës penale dhe dëshiron që këtë produkt ta pastrojë përmes veprimeve aktive të realizuara në njërën nga format e parashikuara në nenin 287 të Kodit Penal. Qëllimi është element cilësues i dispozitës konkrete dhe ai konsiston në: *a) fshehjen, mbulimin e origjinës së pasurisë ose dhënien e ndihmës, për të shmangur pasojat juridike, që lidhen me kryerjen e veprës penale, b) shmangia nga raportimi sipas ligjit për pastrimin e parave.* Pra, autori i veprës penale, veprimtarinë e tij kriminale e kryen duke e ditur që avantazhet apo pasuria që ai disponon janë produkt i veprës penale dhe synon t'i pastrojë ato, duke i dhënë trajtën e një pasurie apo avantazhi ekonomik të ligjshëm. Gjithashtu, gjykata vlerëson se, ana subjektive e figurës së veprës penale zbulohet dhe qartësohet nëpërmjet anës objektive, sepse proceset e brendshme

psikike dhe psikologjike jo vetëm që ngacmohen nga faktorë të jashtëm, por edhe materializohen në veprimtarin kriminale gjatë dhe nëpërmjet procesit të zhvillimit të anës objektive. Prandaj, për të përcaktuar anën subjektive në çështjen objekt gjykimi, gjykata do të analizojë veprimet e të pandehurit. Dijenia dhe qëllimi, parashikohet në këtë nen, nxirren nga rrethana fakti objektive. Ky mund të jetë një nga elementët më të vështirë për t'u përcaktuar. Sigurisht, kur subjekti ka qenë drejtpërsëdrejti i përfshirë në veprimtarinë kriminale që mund të provohet, atëherë dijenia e tij në lidhje me origjinën e fondeve është e dukshme. Gjithsesi, bashkëpunëtorët që ndihmojnë kriminelët për të përdorur, "sistemuar", strukturuar pasuritë e tyre shpesh pretendojnë dhe mbrohen se nuk e dinin se pasuria ishte produkt i veprës penale. Në rrethana të tilla, agjencitë ligjzbatuese duhet të mbështetet në provat rrethanore. Përshembull, prova se një afarist ka marrë sasi të mëdha parash *cash* nga një individ në rrethana të dyshimta; **ose që personi që i ka dhënë paratë njihej ose kishte opinionin se ishte i përfshirë në veprimtari kriminale jashtë shtetit; ose se ka pasur një sërë transaksionesh të komplikuara të cilat janë pa kuptim për biznesin, mund të mbështesin konkluzionin se i akuzuari për pastrim parash e dinte se paratë ishin produkt i një lloj veprimtarie kriminale.** Është tashmë një standard i krijuar i jurisprudencës në Shqipëri që disa elemente objektivë të veprave penale shpesh mjaftojnë për të bindur gjyqtarin për dashjen kriminale të të pandehurit. Në interpretim të nenit 287 të Kodit Penal, dijenia e subjektit për origjinën kriminale të produkteve të cilët përbëjnë objektin të veprës penale, nxirret jo vetëm nga provat direkte por edhe nga ato jo te drejtpërdrejta. Kështu, në plotësim të këtij elementi, Gjykata çmon se ekzistojnë dyshime të arsyeshme se personat nën hetim në bashkëpunim me njëri tjetrin kanë vepruar me dashje direkte, pasi personat nën hetim, kanë përdorur skemën e mësipërme fiktive të kryerjes së pagesave, të realizuar nëpërmjet shoqërive tregëtare dhe OJF-ve, për të mbuluar dhe për të fshehur natyrën e vërtetë të origjinës së paligjshme të shumave monetare, natyrën e vërtetë të transferimit dhe të zhvendosjes së tyre, të cilat në të vërtetë përbëjnë *"përftim të parregullt"* si rrjedhim edhe produkt të veprës penale të korrupsionit aktiv dhe pasiv.

**174. Në lidhje me subjektin e veprës penale, pra subjektin** *(aktiv)*, Gjykata vlerëson se në rastin konkret plotësohet ky element, duke pasur parasysh nenin 12 të Kodit Penal, ku thuhet se *"Ka përgjegjësi penale personi që në kohën e kryerjes së një krimi ka mbushur moshën katërmbëdhjetë vjeç. Personi që kryen një kundërvajtje penale ka përgjegjësi kur ka mbushur moshën gjashtëmbëdhjetë vjeç"*. Kështu, personi fizik që të konsiderohet subjekt i figurës së veprës penale, dhe si rrjedhojë të plotësojë kushtin paraprak për fajin dhe përgjegjësinë penale, duhet të plotësojë dy kritere ekskluzive ligjore (*condicio sine qua non*): ***i)*** Të ketë mbushur moshën për përgjegjësi penale dhe ***ii)*** të jetë i përgjegjshëm. Kështu, neni 17 i Kodit Penal parashikon se: *"Nuk ka përgjegjësi penale personi që në kohën e kryerjes së veprës vuante nga një turbullim psikik ose neuropsikik që ia ka prishur tërësisht ekuilibrin e tij mendor dhe për pasojë nuk ka qenë në gjendje të kontrollojë veprimet apo mosveprimet e tij dhe as të kuptojë se kryen vepër penale"* Ky kusht ka të bëjë me domosdoshmërinë për të proceduar penalisht vetëm personat e përgjegjshëm, që kanë të paktën një ndërgjegje minimale sa për t'i bërë ato të aftë të kuptojnë rëndësinë e veprimeve që kryejnë, në mënyrë që realisht të ekzistojë ana subjektive e autorit të veprës penale, që për organin procedues do të thotë të jetë i mundur të identifikohet forma e fajësisë. Megjithatë, që të përjashtohet nga përgjegjësia penale, për shkak të gjendjes mendore, duhet

te plotësohen në mënyrë kumulative disa kushte. ***Së pari***: personi të vuajë nga një turbullim psikik ose neuropsikik. ***Së dyti***: ky turbullim të ketë prishur tërësisht ekulibrin mendor të personit. ***Së treti:*** turbullimi të ketë ekzistuar në kohën e kryerjes së veprës. Ky kusht buron nga rregulli se përgjegjësia penale përcaktohet në momentin e kryerjes së veprës penale. Në rastin konkret i plotësojnë kushtet për të qenë subjekt i kësaj figure të veprës penale.

**2. Lidhur me kushtet e tjera për caktimin e masave të sigurimit.**

**175. <u>Në lidhje me *"ekzistencën e veprës penale"*,</u>** si kusht i përgjithshëm për caktimin e masës së sigurimit, Gjykata çmon se ky kusht nënkupton që fakti i dhënë për të cilin akuzohet personi nën hetim të parashikohet nga ligji si vepër penale dhe kjo vepër të mos jetë shuar për efekt të parashkrimit ose dispozitës përkatëse. Në lidhje me këtë kusht GJEDNj në vendimmarrjen e saj ka arsyetuar se nuk mund të flitet për *"dyshime të bazuara"* nëse veprimi për të cilin akuzohet një person nuk përbën shkelje ligjore të dënueshme sipas ligjit në çastin e kryerjes së veprës penale *(shih çështjen Lonkanov kundër Bullgarisë)*. Në rastin konkret fakti, i cili i atribuohet personave nën hetim përbën elementë të figurave të veprës penale "*Korrupsioni aktiv i funksionarëve të lartë shtetërorë ose i të zgjedhurve vendorë*", të parashikuar nga neni 245 Kodit Penal, "*Korrupsioni pasiv i funksionarëve të lartë shtetërorë ose i të zgjedhurve vendorë*", kryer në bashkëpunim (9 herë), parashikuar nga neni 260 e 25 i Kodit Penal, "*Refuzimi për deklarimin, mosdeklarimi, fshehja ose deklarimi i rremë i pasurive, interesave private të personave të zgjedhur dhe nëpunësve publikë ose i çdo personi tjetër që ka detyrimin ligjor për deklarimi*", parashikuar nga neni 257/a/2 i Kodit Penal, si dhe "*Pastrimi i produkteve të veprës penale apo i veprimtarisë kriminale*" të parashikuara nga neni 287, e kryer në rrethanën cilësuese "*në bashkëpunim*" dhe "*më shumë se një herë*" sipas nenit 287, paragrafi (2) i Kodit Penal dhe nuk rezulton që këto vepra të jenë parashkruar[66] ose shuar.

**176. <u>Në lidhje me *"ekzistencën e kushteve të dënueshmërisë sipas të drejtës penale"*,</u>** si kusht i përgjithshëm për caktimin e masave të sigurimit, në kuptim dhe zbatim të nenit 228/2 të K.Pr.Penale, Gjykata çmon se ky kusht lidhet me plotësimin e kushteve, për të qenë subjekt i veprës penale, si dhe me mosekzistencën e shkaqeve ligjorq që e përjashtojë të dyshuarin nga përgjegjësia penale, siç janë kryerja e veprës penale në kushtet e mbrojtjes së nevojshme dhe të nevojës ekstreme. Në nenin 12 të Kodit Penal thuhet shprehimisht se: ***"Ka përgjegjësi penale personi që në kohën e kryerjes së një krimi ka mbushur moshën katërmbëdhjetë vjeç. Personi*** *që kryen një kundërvajtje penale ka përgjegjësi kur ka mbushur moshën gjashtëmbëdhjetë vjeç*". Kështu, personi fizik që të konsiderohet subjekt i figurës së veprës penale, dhe si rrjedhojë të plotësojë kushtin paraprak për fajin dhe përgjegjësinë penale, duhet të plotësojë dy kritere ekskluzive ligjore (condicio sine qua non): **i)** Të ketë mbushur moshën për përgjegjësi penale dhe **ii)** të jetë i përgjegjshëm. Kështu, neni 17 i Kodit Penal parashikon se: ***"Nuk ka përgjegjësi penale personi që në kohën e kryerjes së veprës vuante nga një turbullim psikik ose neuropsikik që ka prishur tërësisht ekuilibrin e tij mendor dhe për pasojë nuk ka qënë në gjendje të kontrollojë veprimet apo mosveprimet e tij dhe as të kuptojë se kryen vepër penale***". Ky kusht ka të bëjë me domosdoshmërinë për të proceduar

---

[66] Me përjashtim të faktit penal në ngarkim të personit nën hetim Fatmir Bektashi që përmendet në paragrafët 153.5.4, 153.5.4.1, 153.5.4.2, 153.5.4.3 dhe 153.5.4.4 të këtij vendimi.

penalisht vetëm personat e përgjegjshëm, që kanë të paktën një ndërgjegje minimale sa për t'i bërë ato të aftë të kuptojnë rëndësinë e veprimeve që kryejnë, në mënyrë që realisht të ekzistojë ana subjektive e autorit të veprës penale, që për organin procedues do të thotë të jetë i mundur të identifikohet forma e fajësisë. Megjithatë, që të përjashtohet nga përgjegjësia penale, për shkak të gjendjes mendore, duhet te plotësohen në mënyrë kumulative disa kushte. **Së pari:** personi të vuajë nga një turbullim psikik ose neuropsikik. **Së dyti:** ky turbullim të ketë prishur tërësisht ekulibrin mendor të personit. **Së treti:** turbullimi të ketë ekzistuar në kohën e kryerjes së veprës. Ky kusht buron nga rregulli se përgjegjësia penale përcaktohet në momentin e kryerjes së veprës penale. Në rastin konkret, personat nën hetim në kohën që dyshohet se kanë kryer veprën penale kanë qënë mbi 18 vjeç, dhe rrjedhimisht Gjykata, në vështrim të nenit 12/1 të Kodit Penal, çmon se në drejtim të moshës, personat nën hetim kanë qenë madhor e të përgjegjshëm penalisht në datën që dyshohet se kanë kryer veprën penale objekt gjykimi dhe, si të tillë, ata kanë patur moshën për përgjegjësi penale. Gjithashtu, në çështjen objekt gjykimi nuk u provua që personat nën hetim të vuajnë nga ndonjë turbullim psikik ose neuropsikik që ka prishur tërësisht ekuilibrin e tyre mendor dhe për pasojë nuk kanë qënë në gjëndje të kontrollojnë veprimet apo mosveprimet e tyre dhe as të kuptojnë se kryen vepër penale. Në këto kushte, gjykata vlerëson se personat nën hetim janë subjekt të përgjegjshëm penalisht.

**177.** Në konkluzion, duke konstatuar se plotësohen në mënyrë komulative të tre kushtet e përgjithshme të parashikuara nga neni 228 i K.Pr.Penale, Gjykata çmon të vijojë me analizën e kushteve të veçanta të cilat janë përkatësisht **i)** ekzistenca e shkaqeve të rëndësishme që vënë në rrezik marrjen ose vërtetësinë e provës; **ii)** largimi ose ekzistenca e rrezikut që i hetuari të largohet dhe **iii)** ekzistenca e rrezikut që personi nën hetim të kryejë krime më të rënda ose të të njëjtit lloj me atë për të cilin ai po procedohet. Pika 3 e nenit 228 vë kushte të cilat nuk janë domosdoshmërisht kumulative për t'u plotësuar, megjithatë mund të ekzistojnë edhe njëherazi, por mjafton ekzistenca e njërës prej tyre që të nxjerrë në konkluzion gjykatën se jemi para një rasti të ligjshëm për të caktuar një masë sigurimi personal, pra kanë karakter ligjor alternative. Gjykata çmon të trajtojë plotësimin e këtyre kushteve, në raport dhe me nenet 229 e 230 të K.Pr.Penale.

**177.1.** <u>Në lidhje me ekzistencën e *"rrezikut të helmimit të provave"*</u>, si një nga kushtet alternative për caktimin e masave të sigurimit, Gjykata mban parasysh qëndrimin e Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë me vendimin Nr. 7, datë 14.10.2011, ku ndër të tjera theksohet se: *"Nga interpretimi i drejtë i kuptimit që duhet t'i jepet termit "rrezik" në nenin 228 në tërësi, pra edhe për rastin e shkronjës "a" të këtij neni, Kolegjet e Bashkuara vijnë në përfundimin unifikues se **në çdo fazë të procedimit, kërkesa e paraqitur nga ana e prokurorit dhe vendimi i gjykatës për caktimin e masës së sigurimit duhet të motivohen dhe të argumentojnë** (konkretisht) nevojën e sigurimit, ekzistencën e shkaqeve të rëndësishme, të "rrezikut", pra të probabilitetit, mundësisë reale që të ndodhë (id quod plerumque accidit) vënia **në rrezik e procesit të së provuarit nga ana e të pandehurit. Kjo gjendje "rreziku" mund të verifikohet, pra mund të lindë, ndryshojë apo mbarojë, rast pas rasti, në dinamikë, si gjatë fazës së hetimit paraprak, ashtu edhe gjatë fazës së gjykimit. Përfundimi i gjykatës lidhur me gjendjen e rrezikut, arrihet bazuar në tërësinë e rrethanave të faktit e të ligjit që e sjellin atë gjykatë në përfundimin mbi ekzistencën e kësaj gjendje, e cila pengon, ngadalëson apo devijon në mënyrë të parregullt procesin e të provuarit dhe***

*vërtetimin e rrethanave të faktit të lidhura me procedimin penal përkatës, në kuadër të garantimit të procesit të dhënies së drejtësisë në tërësi të parashikuar nga Kushtetuta e që pikërisht justifikon parashikimin në ligj të caktimit dhe zbatimit të masës së sigurimit. Vlerësimi i rrethanave mbi ekzistencën ose jo të rrezikuar për "helmimin" e provave, bëhet rast pas rasti. Ndërmjet të tjerave, mund të evidentohet verifikimi që i bën gjykata edhe rrethanës mbi kohën që ka kaluar nga çasti i vënies në dijeni të të pandehurit për procedimin penal në ngarkim të tij, në lidhje me rrethanën nëse ka kryer apo mund të kryejë ndonjë veprim a sjellje që "rrezikon" procesin e marrjes dhe vërtetësisë së provës. Në këtë kontekst, në parim, edhe e drejta e heshtjes së të pandehurit, si një strategji mbrojtje e tij, nuk përbën në vetvete "rrezik" që mund të shërbejë si motiv për të kërkuar caktimin e masës së sigurimit ndaj tij. Gjithsesi, edhe kjo rrethanë mund të vlerësohet në harmoni dhe në lidhje me sjelljet e tjera të tij ndaj veprës që ka kryer dhe procedimit penal të filluar, të cilat mund të çojnë gjykatën në bindjen se ekziston dyshim i bazuar në prova se i pandehuri nëse lihet i lirë do të helmojë provat dhe procesin e të provuarit, sikurse janë kërkimi, marrja, vërtetësia dhe ruajtja e provës e të burimeve të provës, nga ana e të gjykuarit."*. Në rastin konkret hetimi është në vazhdim dhe nuk rezultojnë që të jenë mbledhur të gjitha provat. Prandaj, ekziston mundësia që personi nën hetim të ndikojnë në marrjen dhe vërtetësin e provës.

**177.1.1.** Në rastin konkret Gjykata e çmon të drejtë qëndrimin e Prokurorisë së Posaçme se në rastin e titullarit të Bashkisë Tiranë, shtetasit Erion Veliaj, por edhe të bashkëshortes së tij, shtetases Ajola Xoxa, rreziku i marrjes ose vërtetësisë së provës, bazuar kjo në tërësinë e rrethanave të faktit është real dhe i vazhdueshëm, nëse shtetasit nën hetim vijojnë të mos i nënshtrohen kufizimeve të lirisë nga ato që Kushtetuta e Republikës dhe ligji procedural penal parashikon. Kjo kërkesë argumentohet me qëllimin e Prokurorisë së Posaçme për të shmangur sa më shumë të jetë e mundur pengimin, ngadalësimin apo dhe devijimin në mënyrë të parregullt të procesit të të provuarit dhe vërtetimin e rrethanave të faktit të lidhura këto me procedimin penal në fjalë. Në këtë kuptim, duke patur në konsideratë ambientin ku shtetasit nën hetim jetojnë, funksionin publik që ushtron shtetasi Erion Veliaj, njohjet e shumta, lidhjet e siguruara dhe ndikimi mjaft i fortë që buron nga ushtrimi i këtij funksioni, rëndësia e të cilit shtohet në mënyrë eksponenciale nisur nga territori që mbulon dhe fondet publike që administron Bashkia Tiranë, si Bashkia me e madhe në vend, duke vlerësuar sjelljen e shfaqur nga vetë shtetasi nën hetim Erion Veliaj ndërsa dërgon mesazhe me natyrë të fortë intimiduese në drejtim të hetuesve të BKH-së, të cilëve u kërkon hapur të ndalojnë me thirrjen e bashkëshortes së tij për të dhënë deklarime, pranisë së një prej vartësve të kryetarit të Bashkisë Tiranë gjatë takimeve të zhvilluara nga bashkëshortja e këtij të fundit me personat e thirrur nga organi procedues, si edhe gjatë kontrollit të ushtruar nga hetuesit e BKH-së, si edhe duke patur në konsideratë sjelljen e shtetases Ajola Xoxa veçanërisht pas kontrolleve të ushtruara sipas vendimit të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, organi procedues ka arritur në përfundimin se ekziston rreziku real që disa prova të mos merren apo të merren në një formë të "*helmuar*".

**177.1.1.** Ky rrezik është provuar të jetë i prekshëm gjatë gjithë hetimit paraprak deri në këtë moment, sidomos në raport me personat që janë thirrur për të bërë deklarime pranë organit procedues, por edhe me sjelljen që kanë shfaqur shtetasit nën hetim gjatë kësaj periudhe. Në kushtet kur shtetasi nën hetim Erion Veliaj provohet të ketë dërguar mesazhe të shkruara në adresë të hetuesve të Byrosë Kombëtare të Hetimit, mesazhe këto që duket se

kanë synimin të intimidojnë këta zyrtarë gjatë kryerjes së detyrës së tyre, mund të imagjinohet lehtë më pas sesi ky shtetas mund të sillet me dëshmitarët potencialë në këtë proces, pra me provat që kërkohet të merren nga organi procedues. Gjithashtu, prania e punonjësve të rëndësishëm të bashkisë Tiranë, vartës të drejtpërdrejtë të shtetasit Erion Veliaj, si gjatë kontakteve që shtetësja Ajola Xoxa ka patur me personat e thirrur për të dhënë deklarime në Prokurorinë e Posaçme, ashtu edhe gjatë momenteve të kontrollit në zyrat e "Partners Law" shpk, dëshmon synimin për të vënë në rrezik marrjen e provave, por nga ana tjetër edhe miksimin e funksioneve publike me ato private të titullarit të bashkisë, duke i kërkuar personave që varen prej tij të kenë kontakte të paautorizuara me hetues në kryerje e sipër të detyrës. Nga ana tjetër, duke qenë se pjesa kryesore e hetimit penal është përqendruar në aktivitetet që lidhen me Bashkinë Tiranë, është e qartë se mundësia për të rrezikuar marrjen e provave të nevojshme nga zyrat e këtij institucioni është e prekshme, përsa kohë që nga vetë natyra e tij hierarkike persona të varur në funksionet e tyre mund të intimidohen nga shtetasi nën hetim.

**177.1.2.** Gjithashtu, Gjykata çmon se ekzistojnë prova të pakundërshtueshme se shumica e deklaruesve të thirrur nga Prokuroria e Posaçme janë kontaktuar para dhe pas seancave të marrjes në pyetje nga shtetasit nën hetim, specifikisht bashkëshortja e kryetarit të bashkisë Tiranë. Akoma më e rëndë paraqitet kjo situatë po të kemi në konsideratë dyshimet për kryerjen e veprimeve të cilat pengojnë zbulimin e së vërtetës. Një pjesë e madhe e deklaruesve ka pohuar se janë kontaktuar nga shtetësja Ajola Xoxa dhe madje janë thirrur prej saj, duke i dhënë orientime si duhet të sillen para organit procedues. Akoma më e rëndë paraqitet situata kur bëhet fjalë për shtetasen Ina Goxhaj, e cila është treguar mjaft e qartë në lidhje me takimet e zhvilluara para se të paraqitej në Prokurorinë e Posaçme, çfarë e ka orientuar shtetësja Ajola Xoxa dhe Klotilda Bushka, si edhe faktin që ka takuar shtetasen Ajola Xoxa dhe Klotilda Bushka pasi ka dalë nga Prokuroria e Posaçme, sipas orarit të lënë nga këto të fundit. Ky takim është dokumentuar nga grupet e vëzhgimit të hetuesve të BKH-së. Për më tepër, nisur nga deklarimet e shtetases Ina Goxhaj, kësaj të fundit i është kërkuar telefoni, i cili në fakt i është marrë, për t'ju zëvendësuar me një tjetër nga shtetësja Ajola Xoxa. Po, ashtu sipas të njëjtave deklarime, të cilat do të jenë objekt hetimi përgjatë hetimit paraprak, ka dyshime se aparati telefonik celular i kësaj shtetase është asgjësuar me ndihmën e shtetases Klotilda Bushka, në shtëpinë e prindërve të kësaj të fundit. E pyetur në lidhje me këto kontakte për persona që nuk janë pjesë e stafit të "Partners Law" shpk, shtetësja Ajola Xoxa i mohoi në mënyrë kategorike.

**177.2.** **<u>Gjithashtu, në lidhje me ekzistencën e *"rrezikut të largimit"*</u>**, si një nga kushtet alternative për caktimin e masave të sigurimit, Gjykata mban parasysh qëndrimin e Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë me vendimin Nr. 7, datë 14.10.2011, ku ndër të tjera theksohet: "*... "rreziku i largimit", krahas elementëve të tjerë, mund të lidhet e të rezultojë edhe nga vetë natyra e akuzave në ngarkim të të gjykuarit, nga rëndësia e faktit, e sanksionit për veprën penale dhe lloji e shkalla e pasojave të ardhura prej saj. Prej tyre mund të arrihet në përfundimin logjik juridik, në trajtën e probabilitetit të arsyeshëm apo edhe të sigurisë, mbi mundësinë apo përgatitjen reale dhe efektive të ikjes, nëse nuk ndërhyhet për ta izoluar të pandehurin. Po kështu shqyrtohet edhe sjellja e të pandehurit para dhe pas kryerjes së veprës (post delictum), personaliteti dhe pozita e tij etj. Gjithsesi, caktimi i masës së sigurimit sipas nenit 128, pika 1, shkronja "b" nuk mund të motivohet*

***mbi baza thjesht hipotetike, në prezumime të përgjithshme apo imagjinare mbi probabilitet të ikjes së të gjykuarit.*** *Për efekt të motivimit të caktimit të masës së sigurimit, një nga rastet që përbën element objektiv për të sjellë gjykatën në përfundime mbi largimin dhe rrezikun e largimit, është edhe gjendja e ikjes pa lënë gjurmë (fshehjes) të pandehurit. Kjo gjendje, në vetvete, mishëron logjikisht e juridikisht prirjen e të pandehurit për të shkelur dhe mos zbatuar masat e sigurimit (përfshi arrestin në burg), qenien e tij në mënyrë permanente në pozitën e mosbindjes së paligjshme përballë ligjit, prirjen për t'iu shmangur hetimit dhe gjykimit, si dhe vuajtjes së dënimit. Kjo gjendje rreziku normalisht mbetet e tillë edhe nëse i pandehuri i deklaruar i ikur, më pas, tregon disponibilitetin e tij që të paraqitet apo kur paraqitet vullnetarisht para organeve të procedimit. Një nga arsyet e caktimit dhe zbatimit të masave të sigurimit personal është nevoja për të garantuar vijimësisht prezencën e të gjykuarit në procedimin penal në ngarkim të tij, si për të siguruar normalitetin e hetimit dhe të gjykimit në çështjen në ngarkim të tij, nevojën për të evituar rrezikun për kryerjen e veprave të tjera penale prej tij, ashtu edhe për të siguruar që ai të mos largohet, të fshihet por t'i nënshtrohet ekzekutimit (vuajtjes) së dënimit kur vendimi i dënimit të ketë marrë formë të prerë.".*

**177.2.1.** Problemi i përcaktimit të mundësisë që i dyshuari t'i shmanget hetimit ose gjykimit të çështjes, si rrethanë që e bën të justifikuar zgjedhjen e njërës nga masat e sigurimit të përcaktuara nga ligji, paraqet vështirësi për faktin se gjykata mbi bazën e materialeve të çështjes duhet të zgjidhë me supozime çështjen e paraqitjes së të dyshuarit në hetim apo gjykim, sa herë të jetë e nevojshme. Vetëkuptohet se vetëm mbi bazën e provave të mbledhura në çështjen penale do të përcaktohet mundësia që i dyshuari t'i shmanget hetimit ose gjykimit të çështjes si dhe shkalla e kësaj mundësie në varësi të së cilës është edhe zgjedhja e kësaj apo e asaj mase sigurimi. Kur flitet për shmangie nga hetimi apo gjykimi i çështjes kemi parasysh një veprim të kryer me dashje, me ndërgjegje të plotë dhe me qëllim të caktuar, domethënë që i dyshuari braktis vendbanimin apo vendqëndrimin e tij të zakonshëm dhe largohet në drejtim të paditur me qëllim që t'i shmanget hetimit dhe gjykimit. Pra, jo çdo largim i të dyshuarit nga vendqëndrimi ose vendbanimi i tij duhet quajtur shmangie nga hetimi dhe gjykimi por duhet vlerësuar rast pas rasti. Duke qenë se mendimi për t'iu shmangur hetimit dhe gjykimit të çështjes është i fshehur në psikikën e të dyshuarit, ai nuk mund të vërehet menjëherë. Për përcaktimin e drejtë të saj do të ndihmonin shumë njohja e motiveve të ndryshme që e bëjnë të besueshme në një masë të përafërt por të mjaftueshme se i pandehuri kërkon t'i shmanget hetimit apo gjykimit. Pjesërisht faktorët që e motivojnë shmangien janë të shprehura edhe në ligj. Këta faktorë, dhe të tjerë që lindin gjatë procesit penal, duhen vlerësuar drejt dhe në mënyrë të gjithanshme, nga gjykata, duke mbajtur kurdoherë parasysh tërësinë e provave që janë mbledhur, deri në atë moment, për çështjen. Kështu në nenin 229/2 të K.Pr.Penale si kriter në caktimin e masës së sigurimit mund të shërbejë edhe rrezikshmëria shoqërore e veprës penale. Duke trajtuar në ligj rrezikshmërinë shoqërore të veprës ligjvënësi ka parasysh jo vetëm vendin që zë një vepër e caktuar në pjesën e posaçme të Kodit Penal por edhe rëndësinë e marrëdhënieve shoqërore të prekura apo të cënuara prej saj, pasi ligji parashikon shprehimisht si kriter rëndësinë e faktit dhe sanksionin që parashikohet për veprën penale konkrete. Nga studimi i të gjitha rrethanave që lidhen me rrezikshmërinë shoqërore të veprës mund të zgjidhet drejt edhe çështja e mundësisë të të pandehurit për t'iu shmangur hetimit apo gjykimit. Dihet se sa më e madhe të

SPIRETI.ET.AL

jetë rrezikshmëria shoqërore e veprës penale për të cilën dyshohet personi aq më i rëndë është edhe dënimi i parashikuar për veprën penale konkrete. **Por, një dënim i rëndë për një vepër penale të dyshuar se është kryer nga personi, është plotësisht logjike të pranohet se mund të lindë tek ai mendimin për t'iu shmangur hetimit apo gjykimit me qëllim për t'i shpëtuar vuajtjes së këtij dënimi.**[67]

**172.2.2.** Gjykata, vlerëson se në çështjen objekt gjykimi, duke pasur parasysh sanksionin e veprës penale dhe prirjen normale dhe natyrore të çdokujt për gëzimin e lirisë personale ka vend për të dyshuar racionalisht se, personi nën hetim ka nevojë të sigurohet. Kështu, në rastin objekt gjykimi, Gjykata vlerëson se, kemi të bëjmë me një frikë, mendim dhe dyshim të arsyeshëm se të dyshuarit po të lihen pa masë, ata mund të largohen për të pamundësuar apo penguar qëllimisht zhvillimin normal të procedimit penal, duke pasur parasysh pasojat e veprës dhe marzhin e dënimit të veprës penale që dyshohet se kanë konsumuar, që **dënohet me 5, 12 dhe 15 vjet burgim.**

**172.3.** **Në lidhje me ekzistencën e *"rrezikut që personi nën hetim të kryejë krime më të rënda ose të të njëjtit lloj me atë për të cilin ai po procedohet"***, si një nga kushtet alternative për caktimin e masave të sigurimit, Gjykata, gjithashtu, mban parasysh qëndrimin e Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë me vendimin Nr. 7, datë 14.10.2011, ku ndër të tjera theksohet: *"11. Në shkronjën "c" të pikës 3 të nenit 228 të Kodit të Procedurës Penale, parashikohet rasti (kushti) "kur për shkak të rrethanave të faktit dhe personalitetit të së pandehurit ka rrezik që ai të kryejë krime të rënda ose të së njëjtit lloj me atë për të cilin procedohet". Përmbajtja e dispozitës së sipërcituar të shkronjës "c" të pikës 3 të nenit 228 të Kodit të Procedurës Penale lidhet me nevojën për caktimin e masës së sigurimit për të përmbushur funksionin parandalues të posaçëm të shtetit për garantimin e rendit e të sigurisë publike, paprekshmërinë e jetës, shëndetit, pronës dhe interesave e të drejtave të tjera të ligjshme nga kryerja e veprave të tjera penale nga ana e të pandehurit. Në këtë aspekt, për të legjitimuar kufizimin e lirisë së të pandehurit, pra caktimin e masës së sigurimit, mes të tjerave, objekti i gjykimit është verifikimi i rrethanave konkrete të faktit të cilat i shërbejnë gjykatës për të vlerësuar e konkluduar mbi rrezikshmërinë e autorit dhe, nga ana tjetër, për të përcaktuar veprat penale që ka rrezik të kryhen prej tij. Në këtë kuptim, për pranimin e ekzistencës së nevojës së sigurimit, të rrezikut konkret për komunitetin, cënimin e rendit dhe të sigurisë publike, të cilat justifikojnë caktimin e masës së sigurimit sipas kësaj dispozite, objekt i hetimit gjyqësor duhet të jetë vlerësimi konkret i rrethanave të faktit, duke nxjerrë nga sjellja në tërësi e të gjykuarit elemente konkretë të vlefshme për të bazuar dhënien e vendimit. Sikurse për rastet e rrezikut për "eliminimin" e provave dhe atij të ikjes, edhe në lidhje me rrezikun e kryerjes së krimeve të tjera, Kolegjet e Bashkuara konkludojnë se, nisur* ***nga kriteret e përcaktuara në pikat 1 e 2 të nenit 229 të Kodit të Procedurës Penale dhe atyre të neneve 48 e 50 të Kodit Penal, gjykata duhet të hetojë, në gjendjen që është procedimi, në drejtim të personalitetit të së pandehurit, nëse ka precedentë penale, mënyrën e jetesës së tij, vendin dhe rrethanat të cilat e kanë sjellje në kryerjen e veprës, rrethanat lidhur me natyrën, llojin, mjetet, kohën, vendin e mënyrën e kryerjes së veprës penale, llojin dhe shkallën e pasojave të ardhura nga kryerja e veprës, llojin e shkallën e fajësisë dhe motivet për kryerjen e veprës, sjellja e autorit si para ashtu edhe pas kryerjes së***

[67] Shiko vendimin Nr. 92, datë 03.06.2015 i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë.

*veprës, si dhe rrethanat e tjera të jetës individuale, familjare e sociale të tij. Bazuar në vlerësimin e provave mbi ekzistencën e elementeve konkrete të rrethanave të faktit dhe të personalitetit të së gjykuarit, jo domosdoshmërisht kumulative, gjykata nxjerr përfundimin nëse ekziston dyshim i arsyeshëm mbi rrezikshmërinë e tij dhe nevojën për të garantuar paprekshmërinë e komunitetit, nëse ekziston mundësia reale që i gjykuari në të ardhmen, duke qenë në gjendje të lirë, mund të kryejë vepra penale të rënda apo të së njëjtit lloj me atë për të cilën është proceduar.".*

**172.3.1.** Studimi i personalitetit të të pandehurit nga pikëpamja e rrezikshmërisë shoqërore të tij ka gjithashtu rëndësi të madhe jo vetëm për zgjidhjen e problemit të masës së sigurimit por edhe për zgjidhjen e shumë problemeve të tjera juridike. Në radhë të parë të dhëna të tilla do të sigurohen nëpërmjet pyetjes së të pandehurit. Kështu, në këtë fazë gjykata sqaron qëndrimin e të dyshuarit ndaj veprës penale të kryer, qëndrimin në familje, në shoqëri, në punë etj, motivet e kryerjes së veprës penale dhe në varësi nga këto përcakton mundësinë ose jo të shmangies së të dyshuarit nga hetimi apo gjykimi i çështjes. Në qoftë se ai është i penduar thellë për veprën penale të kryer, nuk është përsëritës, ka mbajtur vazhdimisht qëndrim të mirë në shoqëri, në këtë rast mundësia e shmangies së tij nga hetimi apo gjykimi është minimale dhe për rrjedhojë edhe zgjedhja e masave të sigurimit nuk do të ishte e justifikuar, veçanërisht masa më e rëndë që është arresti në burg. Rëndësi të veçantë në zgjedhjen e masës së përshtatshme të sigurimit ka edhe mosha e të dyshuarit ashtu si edhe gjendja shëndetësore e tij.[68]

**172.3.2.** Sa më sipër u arsyetua, për të individualizuar masën e sigurimit sipas standarteve të vlerësimit të rrëfyera më lart Gjykata, duke patur parasysh se duhet të konkludojë mbi drejtësinë e masës së sigurimit të artikuluar në kërkesë nga prokuroria, Gjykata vlerëson se duhet mbajtur parasysh përshtatshmërinë masës së sigurimit me shkallën e nevojave të sigurimit që duhen marrë në rastin konkret, rëndësinë e faktit dh sanksionin që parashikohet për veprat penale konkrete, për të cilat ligji parashikon një dënim **me 5, 12 dhe 15 vite burgim**, gjë që paraqet rrezikshmëri të lartë shoqërore. Rrezikshmëria e autorit lidhet me rrezikshmërinë e veprës. Gjykata çmon të theksojë se i konsideron të drejta arsyet e cituara nga prokuroria për justifikimin e kritereve të veçanta të masave të sigurimit të cituara në paragrafët **146.4.1, 146.4.1, 146.4.2, 146.4.3, 146.4.4, 146.4.5, 146.4.6, 146.4.7, 146.5 dhe 146.5.1, të këtij vendimi**. Në rastin konkret, Gjykata mban parasysh faktin se vepra penale është kryer në rrethana rënduese sikurse është kryerja e veprës penale "*për të vënë para përgjegjësisë ose për të fshehur përgjegjësinë penale të një tjetri apo për të shmangur dënimin për një vepër penale tjetër ose për të realizuar, ose për të siguruar për vete a për të tretët fitime pasurore, ose çdo lloj përfitimi tjetër material*", "*kryerja e veprimeve që rëndojnë apo shtojnë pasojat e veprës penale*", "*duke shpërdoruar funksionin publik*", "*bashkëpunimi*" dhe "*më shumë se një herë*", parashikuar nga neni 50 gërma "b", "d", "dh", "gj" dhe "h" të Kodit Penal. **Gjithashtu, Gjykata mban parasysh pasojat që kanë ardhur në rastin konkret.** Kështu, nga provat e administruara rezulton se: i) Personat nën hetim Erion Veliaj dhe Ajola Xoxa (*nën regjimin pasuror të bashkësisë ligjore*), këta të fundit përmes shoqërive "Partners Law" shpk, "Arts Lab" shpk, "Ava Studio" shpk, "Nan Gallery" shpk, "Byl-A" OJF, "Harabel" OJF, "Eventus" OJF dhe "Muza" OJF, për të cilat tërësisht

---

[68] Shiko vendimin Nr. 92, datë 03.06.2015 i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë.

nga bashkëshortja e kryetarit të Bashkisë Tiranë, kanë gjeneruar të ardhura të cilat kapin shifrën e rreth <u>**110.000.000 lekë;**</u> **ii)** personi nën hetim **Ajola Xoxa** dhe të afërmit e saj, **kanë shpenzuar për katër vite shifrën prej <u>86.721.175 (tetëdhjetë milion e shtatëqind e njëzetë e një mijë e njëqind e shtatëdhjetë e pesë) Lekë</u> vetëm** ***për rroba, produkte kozmetike, buzëkuq, vathë, etj;*** **iii) Pasuria** Nr. 1/647, Vol 29, faqe 103, ZK. 3101, ndodhur në Zonën e Stimuluar "Ardian Çarçani", Qerret, lloji "truall", **sipërfaqe trualli të objektit 494 m2, vilë, me sipërfaqe të bazës së njësisë 82 m2,** në pronësi të "Agi Kons" shpk; (MAREA RESORT, QERRET), ka dyshime të arsyeshme të bazuara në prova se personat nën hetim Erion Veliaj dhe bashkëshortja e tij Ajola Xoxa, janë zotëruesit faktikë të pasurisë nr. 1/647, e dhënë në formën e përfitimit të parregullt nga personi nën hetim Gentjan Sula. **Në rastin konkret mbahet në konsideratë vlera e tregut e kësaj vile si produktet i veprës penale të korrupsionit aktiv dhe pasiv; iv)** në ambjentet e shoqërisë **Partners Law Shpk,** me administratore Ajola Xoxa, konkretisht në kasafortë janë sekuestruar <u>**115.000 Euro**</u> **kryesisht prerje 500 euro.** Nga analiza e prova të para në unitetin e tyre krijohet dyshimi i arsyeshëm se kjo shumë vjen nga burime të paligjshme.

**172.3.2.1.** Gjithashtu, në lidhje me gërmën *c)* të pikës 3 të nenit 228 të Kodit të Procedurës Penale, Gjykata mban në konsideratë personalitetin e shtetasve nën hetim, edhe natyrën, llojin, mjetet, kohën dhe vendin e kryerjes se veprës penale, por edhe llojin dhe shkakun e pasojave të ardhura nga kryerja e saj, llojin dhe shkallën e fajësisë, por edhe sjelljen e autorëve të dyshuar pas momentit të marrjes dijeni se ndaj tyre kishte nisur një procedim. Kështu, në lidhje me personalitetin e personave nën hetim konstatohet se nga ana e tyre deri në këtë fazë të hetimeve nuk është shfaqur asnjë pendesë për veprimet e kryera në shkelje të ligjit. Ndërsa janë pyetur nga organi procedues, në kundërshtim me të gjitha provat evidente, këta shtetas kanë mohuar çdo përgjegjësi në lidhje me veprimet e kryera. Argumentat e tyre për mungesë përgjegjësie për shkak të të drejtave të tyre kushtetuese për të zhvilluar lirshëm aktivitete ekonomike, pa u kufizuar për kryerjen e tyre nga asnjë ligj apo akt nënligjor, apo dhe për mungesë dijenie si dhe mungesë memorie, në rastet kur janë ballafaquar me prova të qarta, dëshmon më së paku për një qasje aspak bashkëpunuese me organin procedues dhe nga ana tjetër tregon potencialin e përsëritjes së veprimeve të tyre në kundërshtim me ligjin. Po ashtu këta shtetas, gjatë kësaj faze kanë kryer veprime të cilat fillojnë më kontaktimin e deklaruesve të thirrur nga organi procedues, dhe përfundojnë me orientimin e këtyre të fundit se çfarë duhet të deklarojnë para këtij organi. Çfarë bën më të rëndë këtë situatë, është dyshimi i bazuar se këta shtetas mund të kenë tentuar të prishin provat, të cilat lidhen me sende të zotëruara më parë nga shtetas të përmendur më lart. Nga ana tjetër, sjellja e personit nën hetim Erion Veliaj, kur bëhet fjalë për komunikimin e përdorur me hetuesit e BKH-së dhe "kurajon" e shfaqur nga ky shtetas për t'i lënë të shkruara mesazhet e tij intimiduese në adresë të organit procedues, dëshmon qartë për personalitetin e këtij të fundit.

**172.3.2.2.** Gjithashtu, Gjykata mban në konsideratë mekanizmin që personat nën hetim kanë ideuar, vënë në funksion dhe zbatuar për një kohë të gjatë, duket i veshtirë të ndalet edhe prej vetë tyre. **Pra,** sa më tepër që këta **shtetas** vijojnë të qëndrojnë të lirë aq më i madh është rreziku që ata të kryejnë krime të rënda, të të njëjtit lloj më ato për të cilat procedohen. Gjatë gjithë kësaj periudhe të hetimit paraprak, por edhe së fundmi, ekziston dyshimi i arsyeshëm se përfitimet e parregullta të titullarit të Bashkisë Tiranë, të marra

drejtpërdrejt apo tërthorazi, për vete por edhe për familjarët e afërt të tij, për kryerjen e veprimeve që lidhen me funksionin e tij, kanë vijuar pa u ndalur. Në këtë kuptim, nga hetimi deri në këtë fazë konstatohet se veprimet që i përkasin pastrimit të produkteve të veprës penale që lidhet me nenin 260 të Kodit Penal, nga personi nën hetim Erion Veliaj, për shkak edhe të mekanizmit të ngritur përgjatë gjithë këtyre viteve, të kryera në bashkëpunim dhe më shumë se një herë me bashkëshorten e tij Ajola Xoxa, kanë vijuar edhe për arsyen se një skemë e tillë, për shkak të kompleksitetit që paraqet, është objektivisht e vështirë të pushojë së ekzistuari përsa kohë që subjektet tregtare vijojnë e marrin financime apo përfitime të tjera nga Bashkia Tiranë, për të cilat në një formë ose një tjetër i duhet të jenë "mirënjohës" titullarit të këtij institucioni. Pra, mënyra si është vepruar për kryerjen e veprave penale, mjetet e përdorura, vijimësia në kryerjen e shkeljeve ligjore edhe pas marrjes dijeni për to, bashkëpunimi dhe kryerja më shumë se një herë si rrethanë cilësuese përsa i përket veprës penale të parashikuar nga neni 287/2 i Kodit Penal, shpërfillja prej titullarit të Bashkisë Tiranë ndaj fondeve publike të cilat për shkak të veprimeve të tij kanë përfunduar në llogaritë bankare të bashkëshortes së tij dhe organizatave e shoqërive që ajo efektivisht kontrollon, dhe rrjedhimisht në pasurimin personal të tij, vlerat e larta monetare të cilat dyshohet se janë përfituar nga bashkëshortët **Veliaj-Xoxa**, sugjeron edhe më tepër se personat nën hetim rrezikojnë realisht për të kryer krime njësoj të rënda me ato për të cilat po procedohen. Në rastin konkret, Gjykata mban parasysh faktin se personi nën hetim Erion Veliaj vijon që të ushtrojnë funksione publike dhe ekziston rreziku ai të abuzoj me detyrën. Ndërkohë përsa i përket personit nën hetim **Elman Abule**, nga hetimi deri në këtë fazë **ka rezultuar se veprimet e kundërligjshme të tij, të cilat lidhen me pastrimin e produkteve të veprës penale, kanë zgjatur në kohë dhe kanë sjellë si pasojë "justifikimin" e shumave të konsiderueshme monetare të cilat më pas kanë hyrë si përfitim pasuror në bashkësinë ligjore të shtetasve Veliaj-Xoxa**.

**172.3.2.3.** Gjithashtu, Gjykata, vlerëson se në çështjen objekt gjykimi, duke pasur parasysh sanksionin e veprës penale dhe prirjen normale dhe natyrore të çdokujt për gëzimin e lirisë personale ka vend për të dyshuar racionalisht se, personat nën hetim kanë nevojë të sigurohet, për t'i caktuar një masë sigurimi personal, për të garantuar vijimësisht prezencën e të dyshuarit në procedimin penal në ngarkim të tij, si për të siguruar normalitetin e hetimit dhe të gjykimit në çështjen në ngarkim të tij, **dhe për të siguruar që ai të mos largohet, të fshihet por t'i nënshtrohet ekzekutimit (vuajtjes) së dënimit kur vendimi i dënimit të ketë marrë formë të prerë.**[69] **Ndodhur në këto kushte, Gjykata** vlerëson se për personat nën hetim

---

[69] Rreziku i ikjes dhe marrjes dhe vërtetësisë së provës nuk ekzistojnë vetëm në fazën e hetimeve paraprake, por edhe gjatë gjykimit. Këtë qëndrim kanë mbajtur edhe Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë në vendimin unifikues Nr.7, datë 14.10.2011, ku ndër të tjera thuhet se: ***"Ndonëse për vetë natyrën dhe mënyrën e zhvillimit të një procedimi penal**, masat e sigurimit normalisht e zakonisht caktohen në fazën e hetimit paraprak, nuk ka asnjë logjikë juridike apo pengesë ligjore që këto masa të mos caktohen për herë të parë edhe në fazën e gjykimit. Nëse ekzistojnë nevojat e sigurimit, të cilat, sikurse edhe respektimi i lirisë së individit, janë garanci e detyrime që burojnë nga Kushtetuta, pra nëse janë kushtet paraprake dhe verifikohen rrethanat e rrezikut të parashikuara nga ligji, jo vetëm që nuk është pengesë, por përkundrazi, është detyrim për gjykatën që të pranojë kërkesën e prokurorit dhe të caktojë masën e sigurimit. Qëllimi dhe efektet e parashikuara nga ligji procedural penal për masën e sigurimit, koncepti juridik i "rrezikut" dhe parimi i "përshtatshmërisë" për caktimin dhe zbatimin e saj, qëndrojnë dhe i shërbejnë njësoj, si fazës së hetimit paraprak, ashtu edhe asaj të gjykimit."*, **Gjithashtu, në lidhje me ekzistencën e** ***"rrezikut të largimit"***, si një nga kushtet alternative për caktimin e masave të sigurimit, Gjykata mban parasysh qëndrimin e Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së

**Erion Veliaj dhe Elman Abule** masa më e përshtatshme që arrin të sigurojë nevojat e procedimit penal të nisur, për të garantuar mospërsëritjen e së njëjtës vepër penale, largimin si dhe për të garantuar ekzekutimin e dënimit me burgim që mund të caktojë gjykata e themelit në rastin konkret, për shkak të rrezikshmërisë së veprës dhe autorëve në rastin konkret, është ajo e ***"Arrestit në burg"*** parashikuar nga neni 238 i K.Pr.Penale.

**172.3.2.4.** Ndërkohë për personin nën hetim **Ajola Xoxa**, Gjykata çmon se nëse nuk do të kishte në ngarkim një fëmijë të mitur masa më e përshtatshme do të ishte ajo e ***"arrestit në burg"*** parashikuar nga neni 238 i K.Pr.Penale. Megjithatë në rastin konkret, Gjykata mban parasysh faktin që bashkëshorti i saj duhet të hetohet e gjykohet me masën e *"arrestit në burg"* për të gjitha arsyet e cituara më lartë, për rrjedhojë për fëmijën e tyre të mitur duhet të kujdeset njëri prej prindërve, ku roli i nënës është i pazëvendësueshëm për moshën që ka fëmija. Gjykata çmon se është në interesin më të lartë të fëmijës së mitur të personit nën hetim Ajola Xoxa që të rritet pranë saj. Pra, për shkak të interesit më të lartë të fëmijës së saj të mitur për të qëndruar pranë nënës, në rastin konkret e gjen të drejtë masën e sigurimit të kërkuar nga Prokuroria e Posaçme për personin nën hetim **Ajola Xoxa**, sikurse është ***"Arresti në shtëpi"*** parashikuar nga neni 237 i Kodit Penal.

**172.3.2.5.** Për personat nën hetim **Gentjan Sulaj, Meriman Palushi, Fatmir Bektashi, Sokol Kryeziu dhe Shkëlqim Fusha**, Gjykata mban në konsideratë nenin 244 pika 3 të K.Pr.Penale nën titullin **"Kërkesa për caktimin e masave të sigurimit"**, ku thuhet shprehimisht se: *"3. Gjykata nuk mund të caktojë një masë sigurimi më të rëndë se ajo e kërkuar nga prokurori."*.

**Sakaq, Gjykata u tërhoq në Dhomën e Këshillimit dhe si u kthye, në bazë dhe për zbatim të nenit 112 dhe 244 të Kodit të Procedurës Penale:**

**VENDOSI:**

1. Caktimin ndaj personit nën hetim **Erion Veliaj**, të masës së sigurimit personal **"*arrest në burg*"** parashikuar nga neni 238 i K.Pr.Penale, si i dyshuar për veprat penale "*Korrupsioni pasiv i funksionarëve të lartë shtetërorë ose i të zgjedhurve vendorë*", kryer në bashkëpunim *(9 herë)*, parashikuar nga neni 260 e 25 i Kodit Penal dhe "*Pastrimi i produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale*", kryer në bashkëpunim dhe më shumë se një herë, parashikuar nga neni 287/2 i Kodit Penal.
2. Caktimin ndaj personit nën hetim **Elman Abule**, të masës së sigurimit personal "***arrest në burg***" parashikuar nga neni 238 i K.Pr.Penale, si i dyshuar për veprwn penale "***Pastrimi i produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale***", kryer në bashkëpunim dhe më shumë se një herë, parashikuar nga neni 287/2 i Kodit Penal.
3. Caktimin ndaj personit nën hetim **Ajola Xoxa** të masës së sigurimit personal "***arrest në shtëpi***" parashikuar nga neni 237 i K.Pr.Penale, si e dyshuar për veprat penale të

Lartë me vendimin Nr. 7, datë 14.10.2011, ku ndër të tjera theksohet: "...***Një nga arsyet e caktimit dhe zbatimit të masave të sigurimit personal është nevoja për të garantuar*** *vijimësisht prezencën e të gjykuarit në procedimin penal në ngarkim të tij, si për të siguruar normalitetin e hetimit dhe të gjykimit në çështjen në ngarkim të tij, nevojën për të evituar rrezikun për kryerjen e veprave të tjera penale prej tij, ashtu edhe për të siguruar* ***që ai*** *të mos largohet, të fshihet por* ***t'i nënshtrohet ekzekutimit (vuajtjes) së dënimit kur vendimi i dënimit të ketë marrë formë të prerë***.".

"*Korrupsioni pasiv i funksionarëve të lartë shtetërorë ose i të zgjedhurve vendorë*", kryer në bashkëpunim (9 herë), parashikuar nga neni 260 e 25 i Kodit Penal, "*Pastrimi i produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale*", kryer në bashkëpunim më shumë se një herë, parashikuar nga neni 287/2 i Kodit Penal, "*Refuzimi për deklarimin, mosdeklarimi, fshehja ose deklarimi i rremë i pasurive, interesave private të personave të zgjedhur dhe nëpunësve publikë ose i çdo personi tjetër që ka detyrimin ligjor për deklarim*", parashikuar nga neni 257/a/2 i Kodit Penal.

**3.1.** Detyrohet personi nën hetim **Ajola Xoxa** të mos largohet nga banesa e saj me adresë: **Kodra e Diellit, Nd. 22, H.1, Farkë, Selitë.**

**3.2.** Detyrimin e personit nën hetim **Ajola Xoxa,** të mos komunikojë me persona të tjerë me përjashtim të atyre që bashkëjetojnë me të.

**3.3.** Zbatimi dhe mbikëqyrja e kësaj mase të bëhet nga oficerët e policisë gjyqësore që mbulojnë vendbanimin e personit nën hetim **Ajola Xoxa.**

4. Caktimin ndaj personit nën hetim **Gentjan Sulaj**, të masës së sigurimit personal "***Detyrim për t'u paraqitur në policinë gjyqësore***" parashikuar nga neni 234 i K.Pr.Penale, si i dyshuar për veprën penale "*Korrupsioni aktiv i funksionarëve të lartë shtetërorë ose të zgjedhurve vendorë*", parashikuar nga neni 245 i Kodit Penal.

**4.1** Urdhërohet personi nën hetim **Gentjan Sulaj** që të paraqitet para oficerit të policisë gjyqësore pranë Byros Kombëtare të Hetimit, **një herë në javë, ditë e hënë, ora 10:00.**

5. Caktimin ndaj personit nën hetim **Meriman Palushi**, të masës së sigurimit personal "***Detyrim për t'u paraqitur në policinë gjyqësore***" parashikuar nga neni 234 i K.Pr.Penale, si i dyshuar për veprën penale "*Korrupsioni aktiv i funksionarëve të lartë shtetërorë ose të zgjedhurve vendorë*", parashikuar nga neni 245 i Kodit Penal.

**5.1** Urdhërohet personi nën hetim **Meriman Palushi** që të paraqitet para oficerit të policisë gjyqësore pranë Byros Kombëtare të Hetimit, **një herë në javë, ditë e martë, ora 10:00.**

6. Caktimin ndaj personit nën hetim **Fatmir Bektashi**, të masës së sigurimit personal "***Detyrim për t'u paraqitur në policinë gjyqësore***" parashikuar nga neni 234 i K.Pr.Penale, si i dyshuar për veprën penale "*Korrupsioni aktiv i funksionarëve të lartë shtetërorë ose të zgjedhurve vendorë*", parashikuar nga neni 245 i Kodit Penal.

**6.1** Urdhërohet personi nën hetim **Fatmir Bektashi** që të paraqitet para oficerit të policisë gjyqësore pranë Byros Kombëtare të Hetimit, **një herë në javë, ditë e mërkurw, ora 10:00.**

7. Caktimin ndaj personit nën hetim **Sokol Kryeziu**, të masës së sigurimit personal "***Detyrim për t'u paraqitur në policinë gjyqësore***" parashikuar nga neni 234 i K.Pr.Penale, si i dyshuar për veprën penale "*Korrupsioni aktiv i funksionarëve të lartë shtetërorë ose të zgjedhurve vendorë*", parashikuar nga neni 245 i Kodit Penal.

**7.1** Urdhërohet personi nën hetim **Sokol Kryeziu** që të paraqitet para oficerit të policisë gjyqësore pranë Byros Kombëtare të Hetimit, **një herë në javë, ditë e enjte, ora 10:00.**

8. Caktimin ndaj personit nën hetim **Shkëlqim Fusha**, të masës së sigurimit personal "***Detyrim për t'u paraqitur në policinë gjyqësore***" parashikuar nga neni 234 i

SPYETUET.AL

K.Pr.Penale, si i dyshuar për veprën penale "*Korrupsioni aktiv i funksionarëve të lartë shtetërorë ose të zgjedhurve vendorë*", parashikuar nga neni 245 i Kodit Penal.

8.1. Urdhërohet personi nën hetim **Shkëlqim Fusha** që të paraqitet para oficerit të policisë gjyqësore pranë Byros Kombëtare të Hetimit, **një herë në javë, ditë e premte, ora 10:00.**

9. Ngarkohet Prokuroria e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar në bashkëpunim me policinë gjyqësore për ekzekutimin e këtij vendimi.

10. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në në Gjykatën e Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar brenda 5 (pesë) ditëve, duke filluar ky afat nga e nesërmja e marrjes dijeni për këtë vendim.

**U shpall sot në Tiranë, më datë 09.02.2025**

**GJYQTAR**

**ERJON BANI**

5PYETJE.AL

5 PYETJET.AL